

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRËNDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJËNDJES CIVILE

LEGJISLACIONI PËR SHËRBIMIN E GJËNDJES CIVILE

TIRANË 2024

LEGJISLACIONI PËR SHËRBIMIN E GJËNDJES CIVILE

i përditësuar 2024

Punuan:
Rudina Bërrari
Edmond Gjoleka
Irida Zogolli

Dizajn: petanidesign
Shtypi: gentgrafik

Ky botim është mbështetur financiarisht nga UNHCR.

UNHCR
The UN Refugee Agency

Ky botim u përgatit nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS

TLAS
Adresa: Blv. Bajram Curri, Pallatet Agimi,Shk.18, p.322, Tiranë
Email: tlas@tlas.org.al
TEL : Cel: 069 20 93 731

Viti i Publikimit - 2024
© Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS

PËRMBAJTJA

Ligj Nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", ndryshuar.....9
(Ndryshuar me ligjet nr.6/2012, datë 2.2.2012, nr.130/2013, datë 25.4.2013, nr. 134/2016, datë 22.12.2016, nr. 69/2018, datë 11.10.2018 dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011, nr.130/2020, datë 22.10.2020 ; 56/2024

Ligj Nr. 8951, datë 10.10.2002 "Për numrin personal".....56

Vendim Nr. 332, datë 17.03.2010 "Për "përcaktimin e formës, elementëve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile." 58
I ndryshuar me: Vendim nr.31, datë 19.1.2011; Vendim nr.325, datë 29.4.2011;

Vendim Nr.1299, datë 16.12.2009 , " Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake dhe degët e qarqeve.....137

Udhëzim Nr 361, datë 14.10.2010. "Për proçedurat e verifikimit të shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç dhe veprimet per ç'regjistrim të tyre kur vertetohet vdekja sipas kërkesave ligjore.....165

Vendim Nr. 288, datë 10.4.2020 "Për përcaktimin e masës dhe të procedurës së dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyrën e bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile". *(Ndryshuar me Vendim Nr. 824, datë 28.12.2023)* 167

Vendim Nr. 252, datë 29.4.2022 "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve ***on-line*** nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre". 176

Udhëzim nr. 7, datë 10.01.2012 "Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve, që do të plotësohen nga përfaqësues të policisë së shtetit dhe të bashkive/njësive bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile".....183

Udhëzim nr. 370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe regjistri kombëtar i gjendjes civile".....188

Udhëzim Nr. 284, datë 11.03. 2019 "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes". 197

Udhëzim Nr. 285, datë 11/03/ 2019 " Për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet raportuara".....200

Udhëzim Nr. 286, datë 11/03/ 2019 "Për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile kur në aktin e lindjes mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar rubrika e emrit".....204

Udhëzim Nr. 90, datë 02.04.2014 "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit".....209

Udhëzim Nr. 91, datë 02. 04. 2014 "Për rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave të konsideruar të papërshtatshëm dhe të atyre me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare, apo të mirënjohura në bashkinë/ komunën, ku ka vendbanimin personi i interesuar".....211

Urdhër Nr. 146, datë 19.05.2014 "Për caktimin e tarifave për paraqitjen e kërkesës dhe afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit"..... 214

Udhëzim Nr. 7733/4, datë 23.10.2014 "Për mënyrën e plotësimit të rubrikës "vendlindja" në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve shqiptarë"..... 216

Udhëzim Nr. 269, datë 01.07.2021 "Për përcaktimin e procedurës së regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë"..... 218

Udhëzim Nr. 180, datë 19.09.2024 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për regjistrimin e fëmijëve që lindin të vdekur"..... 220

Udhëzim nr. 188, datë 27.09.2024 "Për rregullat dhe procedurat për lidhjen e martesës dhe dokumentacionit që duhet të mbahet nga zyrat e gjendjes civile për lidhjen e saj, si dhe për ndryshimin e mbiemrit, kur ndodh për shkak të martesës"..... 222

Udhëzim i Përbashkët Nr. 439, datë 21.8.2015 "Për kryerjen e shërbimeve të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore"..... 227

Udhëzim i Përbashkët Nr. 463, datë 10.12.2020 "Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin"
Ndryshuar me Udhëzim të Përbashkët Nr. 189, datë 4.10.2022 (Përditësuar)..... *231*

Urdhër Nr. 181, datë 19.09.2024 "Për procedurën e korrigjimit si gabim material të emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës"..... 256

Ligj Nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë".
(Ndryshuar me ligjin nr.10 066, datë 2.2.2009 dhe nr.10 328, datë 30.9.2010, nr. 11/2019, datë 5.3.2019, meaktin normativ nr. 25, datë 10.6.2020, me ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020; ndryshuar me aktin normativ nr.11, datë 25.3.2021; nr. 2, datë 2.3.2022 3; nr. 1, datë 27.4.2023)..... *259*

Vendim Nr. 418, datë 27.04.2009 "Për njohjen dhe përdorimin e letërnjoftimit si dokument identifikimi"..... 264

Ligj Nr. 8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit".
(Ndryshuar me aktin normativ nr. 5, datë 31.8.2001, miratuar me ligjin nr. 8822, datë 15.10.2001, ndryshuar me ligjin nr. 8998, datë 30.1.2003, nr. 10 306, datë 22.7.2010, nr. 41/2014, datë 17.4.2014, 2/2019, datë 31.1.2019, ndryshuar me aktin normativ nr. 23, datë 3.6.2020[1]; me aktin normativ nr. 13, datë 31.3.2021)..... *266*

Udhëzim Nr. 93, datë 27.05.2024 "Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme"..... 271

Vendim Nr. 843, datë 26.12.2024 Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare. 279

Vendim Nr. 845, datë 26.12.2024 për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare. 282

Ligj Nr. 9062, datë 08.05.2003, "Kodi i familjes".
(Ndryshuar me ligjin nr. 134/2015, datë 5.12.2015)..... *286*

Ligj i nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"..... 362

Ligj Nr. 10 424, datë 02.06.2011 "Për ratifikimin e konventës së këshillit të europës "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës"..... 379

Ligj Nr. 109/2012 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore"..... 384

Ligj Nr.9270, datë 29.7.2004 "Për sistemin e adresave".
(Nryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016; nr.53/2024, datë 30.5.2024)(i përditësuar)..... *394*

Ligj Nr. 14/2016 "Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"..... 407

Manual për vetëdeklarimin e adresës së shtetasve shqiptarë të cilët jetojnë jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë..... 413

Vendim Nr. 915, datë 04.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe të dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj shtetasve"..... 424

Manuali i përdorimit të Shërbimi elektronik "Vetëdeklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"..... 427

Ligj nr. 113/2020 "Për shtetësinë", *i ndryshuar. (i përditësuar).*..... 434

Vendim. Nr. 1008, datë 25.11.2020 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë"..... 449

Vendim Nr. 135, datë 06.03.2024 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit"..... 453

Udhëzim Nr. 66, datë 04.02.2021 "Për miratimin e formatit të regjistrit për regjistrimin e dekretit për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare" 466

Udhëzim i përbashkët Nr. 45, datë 12.04.2023 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit për aplikim për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit, kulturës, arsimit, shkencës dhe sportit"..... 468

Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit"..... 470

Ligj Nr. 79/2021 "Për të huajt". 490

Ligj Nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë". 606
Vendim Nr. 450, datë 29.06.2022 "Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes
së lejeve të qëndrimit për të huajt". 673

Vendim Nr. 159, datë 17.2023 "Për miratimin e formës e të përmbajtjes
së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi, të dokumentit të udhëtimit,
lejes së kalimit, të dokumentit të përkohshëm, dublikatës së lejes së qëndrimit
e të lejes unike, si dhe të letërnjoftimit për të huajt". 677

Udhëzim Nr. 245, datë 3.6.2021 "Për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit
dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin
dhe refugjatin..... 687

Udhëzim Nr. 28, datë 16.01.2017 "Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes
Civile (RKGJC) të vitit 2010, të personave me status refugjati ose mbrojtje
plotësuese në Republikën e Shqipërisë". 690

Udhëzim Nr. 114, datë 9.7.2024 Për procedurën e lëshimit, e refuzimit të lëshimit,
e ripërtëritjes apo e anulimit të lejes së qëndrimit dhe lejes unike për të huajin". 694

Udhëzim Nr. 116, datë 11.07.2024 "Për procedurat dhe formularin e regjistrimit
e të huajit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile". 702

Vendim Nr. 134, datë 7.3.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve
të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe
të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit ". (Shtuar pika 2.1
me vendimin e KM nr.727, datë 30.10.2003) i përditësuar 711

Lista e shteteve për pranimin e drejtëpërdrejtë të dokumentave..... 714

Lista e shteteve për legalizim të dokumentave në ambasada. 714

Lista e shteteve me vulë " Apostille " (sipas Konventës së Hagës së 5 tetorit 1961
lidhur me heqjen e legalizimit të akteve publike të huaja) 715

Ligj Nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë"..... 716

Ligj Nr.8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore
nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore". 736

Vendim Nr. 816, datë 07.10.2015 "Për miratimin e Rregullores së Shërbimit
të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë" 749

Ligj Nr. 9220, datë 15.04.2004 "Për administrimin e shërbimit të varrimit".
(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014) *(I përditësuar)* 779

Vendim Nr.426, datë 09.07.1998 "Për përballimin nga shteti të shpenzimeve
të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit"
(Ndryshuar me VKM Nr.788, datë 26.11.2003 dhe Nr.721, datë 30.10.2007) 792

Udhëzim Nr.16, datë 18.4.2008 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.721,
datë 30.10.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr.426, datë 9.7.1998 të
Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit
për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", të ndryshuar. 794

Vendim Nr. 867, datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit
në institucionet e administratës shtetërore" *(ndryshuar me vkm-në nr. 139,
datë 20.3.2019; nr. 435, datë 26.6.2024; nr. 727, datë 20.11.2024) (i përditësuar)* *798*

Vendim Nr. 623, datë 26.10.2018 "Për miratimin e kartës së të drejtave
për përfitimin shërbimeve publike. 823

Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK).... 831

Ligj Nr. 8116, date 29. 03. 1996 "Kodi Procedurës Civile". 834

Ligj Nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", *i ndryshuar*..... 834

LIGJ

Nr. 10 129, datë 11.5.2009

PËR GJENDJEN CIVILE

(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011;Ndryshuar me ligjet nr. 6/2012, datë 2.2.2012; nr. 130/2013, datë 25.4.2013; nr. 134/2016, datë 22.12.2016; nr. 69/2018, datë 11.10.2018; nr. 130/2020, datë 22.10.2020 dhe nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtje plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

(Ndryshuar pika 7 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013, shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, shtuar fjalë në pikën 7 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018; ndryshuar pika 1, 2 dhe 4 dhe shtuar pika 9 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Gjendja civile" është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre.
2. "Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile" në vijim "Regjistri Kombëtar", është baza e të dhënave shtetërore, ku pasqyrohen dhe përditësohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.
3. "Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile" është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile. Ky libër ruhet në arkivin e zyrës së arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.
4. "Përbërës të gjendjes civile" janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.
5. "Përbërës të prezumuar" janë përbërësit e gjendjes civile, të cilët vlerësohen të mirëqenë deri në çastin, që vërtetohet ndryshe.
6. "Dokumente të arkivuara" është i gjithë dokumentacioni, që mbahet dhe përdoret nga zyra e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.
7. "Emra/mbiemra të papërshtatshëm" janë emrat dhe mbiemrat me karakter fyes, imoral ose racist, qesharakë, të vështirë për t'u thirrur, apo që të çojnë në konfuzion, të përcaktuar si të tillë në udhëzim të ministrit, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.
8. "Ministri"/"Ministria" është ministri/ministria përgjegjëse për shërbimin e gjendjes civile.
9. "Vendbanimi" dhe "Vendqëndrimi", si përbërës të gjendjes civile, kanë të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në Kodin Civil.

Neni 3

Karakteri personal i të dhënave

(Shtuar pika 2/1, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkresore për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përkasin këto të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

2 Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.

2/1. Çdo institucion, organ, person juridik apo fizik, privat apo shtetëror, që nuk përfshihet në pikën 2 të këtij neni, mund të kërkojë dhe të marrë të dhënat e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse merr pëlqimin me shkrim nga ana e personit, subjekt i të dhënave. Në këtë rast, të dhënat e gjendjes civile përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë dhe për të cilin ka dhënë pëlqimin me shkrim personi, subjekt i të dhënave.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej subjekteve të treta, sipas pikave 2 dhe 2/1 të këtij neni, sipas procedurës të parashikuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë udhëzim përcaktohen lloji, mënyra e dhënies dhe sasia e informacionit, që mund t'u jepet subjekteve kërkuese, në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre apo pëlqimin me shkrim të dhënë nga personi, subjekt i të dhënave, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale[1].

[1] Udhëzim i Përbashkët Nr. 463, datë 10.12.2020 "Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin"
Ndryshuar me Udhëzim të Përbashkët Nr. 189, datë 4.10.2022 (Përditësuar)

Neni 4
Vlera juridike e të dhënave
(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme kur lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile ose kur lëshohen me mjete elektronike, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.
2. Për çdo dokument fizik që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon në mënyrë të plotë emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.
3. Çdo dokument elektronik, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, përmban nënshkrimin elektronik të nëpunësit që e lëshon. Dokumentet elektronike që postohen nga Regjistri Kombëtar, në sesionin "Dokumentet e mia", në portalin unik qeveritar "e-Albania", përmbajnë vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 5
Papajtueshmëria e veprimeve
Nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile aty ku është emëruar, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këtë rast veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile.

KREU II
GJENDJA CIVILE

Neni 6
Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve
(Shfuqizuar termi "kombësi" me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.
2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.
3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 7
Numri personal
1. Numri personal është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.
2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 8
Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile
(Shfuqizuar termi "kombësi" me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 9

Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit

Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja.

Neni 11

Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera

(shtuar fjalë me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Birësimi, shtetësia, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë të gjendjes civile, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë të gjendjes civile, kur ndryshohen sipas ligjit.

Neni 12

Përbërës që vërtetohen nga burime të tjera

Përbërësit e tjerë vërtetohen sipas ligjit nga organet dhe institucionet shtetërore, subjektet juridike, shtetërore e private, ose drejtpërdrejt nga ligji i veçantë dhe marrin cilësinë e përbërësit, kur pasqyrohen në dokumentet e gjendjes civile.

Neni 13

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Gjendja civile e një personi mund të jetë:

a) "beqar/e", shtetasi, i cili nuk ka lidhur akt martese;
b) "i/e martuar", shtetasi, i cili është lidhur me akt martese;
c) "i/e ve", shtetasi, të cilit i ka vdekur bashkëshorti/ja, me të cilin ishte i/e lidhur me akt martese;
ç) "i/e divorcuar", shtetasi, martesa e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë

KREU III

DEKLARIMI DHE REGJISTRIMI I VENDBANIMIT

Neni 14

Deklarimi dhe ndryshimi i vendbanimit ose vendqëndrimit

(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e vendbanimit dhe vendqëndrimit brenda vendit, si dhe ndryshimin e tyre, sipas të gjitha elementeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sistemin e adresave.
2. Institucionet shëndetësore dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale bëjnë deklarimin e vendqëndrimit të shtetasve, qëndrimi i të cilëve në këto institucione zgjat më shumë se 3 (tre) muaj, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e përmbushjes së afatit.
3. Regjistrimi i vendbanimit dhe vendqëndrimit kryhet nga zyra e gjendjes civile në njësinë administrative, që ka në juridiksion territorial vendbanimin ose vendqëndrimin, pas marrjes së kërkesës nga shtetasi. Shtetasi nuk mund të deklarojë më shumë se një vendbanim ose një vendqëndrim njëherazi.
4. Ndryshimi i vendbanimit ose vendqëndrimit kryhet nga zyra e gjendjes civile të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial vendbanimin ose vendqëndrimin e ri, pas marrjes së kërkesës nga shtetasi. Shtetasi duhet të deklarojë vendbanimin ose vendqëndrimin e ri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga zhvendosja në këtë vendbanim ose vendqëndrim.
5. Një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një familjeje tjetër vetëm kur plotësohen standardet për sipërfaqen minimale të banimit që duhet të ketë një individ në banesë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
6. Nëpunësi i gjendjes civile, në mbështetje të dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse ku përcaktohet sipërfaqja e banesës, kryen verifikimin nëse përmbushet standardi i sipërfaqes minimale të banimit, sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Mënyra e paraqitjes së kërkesës, dokumentacionit të nevojshëm, rregullat për deklarimin dhe ndryshimin e vendbanimit ose vendqëndrimit të shtetasve dhe institucioneve shtetërore, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Shtetasit, që kërkojnë të kryejnë veprime në regjistrin e gjendjes civile, duhet të kenë përmbushur detyrimin për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit ose vendqëndrimit.

Neni 15

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 16

E drejta për deklarimin e vendbanimit

1. Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes.
2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtareve të tjerë të familjes, bën deklarim individual të vendbanimit. Shtetasi mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak.
3. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të, bëhet sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit.

Neni 17

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 18

Vendbanimi në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë për qëllime zgjedhore

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Për shtetasit që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo janë vendosur në institucionet e paraburgimit ose shtetasit që qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore për kurim afatgjatë dhe që përfshin qëndrimin e tyre në to edhe datën e zgjedhjeve, vendbanim për qëllime të zbatimit të legjislacionit për zgjedhjet konsiderohet adresa e institucionit përkatës.
2. Institucionet përkatëse jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që qëndrojnë në këto institucione në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nëpërmjet zyrave përkatëse të gjendjes civile dhe sipas përcaktimeve të ligjit për zgjedhjet harton dhe printon listat e zgjedhësve për këta shtetas që deri në datën e zgjedhjeve ndodhen në këto institucione. Këtyre shtetasve iu mundësohet votimi në qendrën e votimit të krijuar, sipas ligjit zgjedhor në këto institucione. Lista e zgjedhësve e hartuar sipas këtij neni është e vlefshme vetëm për zgjedhjet e radhës dhe ripërsëritet sipas të njëjtave modalitete për çdo zgjedhje.
3. Ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri i Drejtësisë përcaktojnë me udhëzim të përbashkët rregullat e njoftimit dhe bashkëpunimit të institucioneve për këta shtetas, procedurën e çregjistrimit dhe regjistrimit të gjendjes civile të vendbanimit për qëllime zgjedhore sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen.

Neni 19

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 20

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 21

Regjistrimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi dhe të personave pa shtetësi, me vendqëndrim në

Republikën e Shqipërisë, kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të huajt.

2. Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj, që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për azilin.

Neni 21/1

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

(shtuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 22

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 23

Veprimet për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcjell në zyrën e gjendjes civile, ku do të regjistrohet shtetasi, dekretin e Presidentit të Republikës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Në këtë rast, zyra e gjendjes civile, në momentin e paraqitjes së shtetasit, cakton datën dhe orën e kryerjes së betimit.
2. Në rastin e dekretit të Presidentit të Republikës për lënien e shtetësisë shqiptare, zyra e gjendjes civile, ku shtetasi rezulton i regjistruar, kryen veprimet për çregjistrimin e tij nga Regjistri Kombëtar brenda 30 ditëve, nga marrja e dekretit. Kopje e këtij dekreti i përcillet Ministrisë së Punëve të Jashtme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
3. Rregullat, procedurat për kryerjen e betimit dhe teksti i betimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

Neni 24

E drejta e DPGJC-së të mbledhë të dhëna nga institucione të treta

1. DPGJC-ja ka të drejtë të ketë akses ose të kërkojë informacion, në mënyrë periodike apo rast pas rasti, nga institucione ose ente shtetërore e private të tjera që mbledhin dhe administrojnë baza të dhënash të shtetasve që përmbajnë të dhëna lidhur me adresën e personit apo të vendbanimit të tij.
2. Institucionet dhe entet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara që t'i sigurojnë akses të menjëhershëm e të papenguar DPGJC-së në bazat përkatëse të të dhënave, ose t'i dërgojnë asaj informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës.
3. DPGJC-ja i përdor të dhënat e siguruara në zbatim të këtij neni, për aq sa është e nevojshme për të verifikuar dhe siguruar saktësinë e të dhënave të Regjistrit Kombëtar. Të dhënat e siguruara nga baza alternative të dhënash nuk përbëjnë burim të drejtpërdrejtë dhe të vetëm të dhënash, në lidhje me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. DPGJC-ja i përdor të dhënat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.
4. Këshilli i Ministrave përcakton llojin, sasinë, organizimin e informacionit dhe rregullat për marrjen dhe përpunimin e informacionit, sipas këtij neni.

KREU IV

NATYRA DHE DOKUMENTIMI I PËRBËRËSVE TË GJENDJES CIVILE

Neni 25

Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve

(Shfuqizuar shkronja "b" e pikës 3 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe shkronja ''dh", shtuar togfjalësh në pikën 2 dhe shkronja ''ë", shfuqizuar shkronja ''a" e pikës 3 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, të shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, vërtetohen e dokumentohen në dokumentet bazë të gjendjes civile.

Këto dokumente hartohen nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga nëpunësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë, të ardhura nga të tretët, në formë fizike ose elektronike, sipas ligjit në fuqi.

2. Dokumentet bazë, që mban, harton dhe administron shërbimi i gjendjes civile, janë:
   a) akti i lindjes;
   b) akti i martesës;
   c) akti i vdekjes;
   ç) regjistrat themeltarë;
   d) Regjistri Kombëtar;
   dh) vendimet e komisionit kombëtar për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit;
   e) procesverbali/procesverbalet për bashkim dhe veçim familjar.
   ë) vendimet për korrigjimin e gabimit material të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.
3. Dokumentet bazë, që lëshon zyra e gjendjes civile, janë:
   a) shfuqizuar;
   b) shfuqizuar;
   c) certifikata e lindjes;
   ç) certifikata martesore;
   d) certifikata e familjare;
   dh) certifikata e vdekjes.
4. Forma, elementet përbërëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi e gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave[2].

Neni 26
Letërnjoftimi

1. Dokumenti bazë i përhershëm për identifikimin e shtetasve është letërnjoftimi.

[2] Vendim Nr. .332, datë 17.03.2010 "Për "përcaktimin e formës, elementëve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile." I ndryshuar me: Vendim nr. 31, datë 19.1.2011; Vendim nr. 325, datë 29.4.2011; Vendim nr. 340, datë 23.05.2012; Vendim nr. 1007,datë 13.11.2013; Vendim nr. 555, datë 27.8.2014; Vendim nr. 432, datë 20.5.2015 ; Vendim nr. 496, datë 13.9.2017; Vendim nr. 224, datë 26.4.2018; Vendim nr. 761, datë 13.12.2024

2. Personat, të cilët, për efekt moshe, sipas ligjit, nuk përfitojnë letërnjoftim, pajisen nga zyra e gjendjes civile me certifikatën e lindjes me fotografi, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 27
Aktet për lindjet, martesat e vdekjet
(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016 dhe me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklarimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.
2. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.
3. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për shtetasit shqiptarë, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i shteteve të huaja ose nga misionet diplomatike dhe postet konsullore atje, përcillen në zyrat e gjendjes civile përkatëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, nga vetë i interesuari ose nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 28
Nënshkrimi i akteve

1. Nëpunësi i gjendjes civile, i interesuari, si dhe të pranishmit, kur parashikohet nga ky ligj, nënshkruajnë me të njëjtin mjet, si dhe shënojnë emrin e mbiemrin. Nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes

civile, në çdo rast, shoqërohet me vulën e zyrës së gjendjes civile, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm.

2. Kur personi nuk di ose nuk është në gjendje fizike të nënshkruajë, në akt shënohen shkaqet, të vërtetuara me nënshkrim të veçantë të përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, të nëpunësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë, të pranishëm në veprim.

Neni 29

Dokumentet e tjera bazë

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Dokumente të tjera janë aktet zyrtare, shtetërore ose joshtetërore, të cilat, sipas ligjit, vërtetojnë ose ndryshojnë faktet juridike, të vërtetuara me aktet e gjendjes civile. Përmbajtja e tyre, kur pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar, shndërrohet në përbërës të gjendjes civile të shtetasit.
2. Dokumentet e tjera bazë, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër, me karakter administrativ, plotësohen e administrohen, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse, sipas llojit të dokumentit.
3. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh apo dokumentesh bazë, të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të fletës familjare.

Neni 30

Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara

(Shfuqizuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Neni 31

Detyrimet e organeve të tjera

Të gjitha organet, të cilat, në mbështetje të këtij ligji apo sipas një ligji të veçantë, janë përgjegjëse për caktimin, vërtetimin ose ndryshimin e një përbërësi të gjendjes civile, detyrohen të dërgojnë, zyrtarisht e drejtpërdrejt, një kopje të aktit, vendimit, në zyrën e gjendjes civile, ku personi figuron i regjistruar, brenda 15 ditëve nga data e lëshimit të aktit ose nga marrja e formës së prerë të vendimit.

Neni 32

Administrimi i dokumentacionit

(shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; hequr togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Aktet mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjegjësi i gjendjes civile në degën e qarkut rishikon saktësinë e veprimeve të kryera në aktet e lindjeve, të martesave e të vdekjeve dhe, në bashkëpunim me nëpunësin përkatës të zyrës së gjendjes civile, bën mbylljen e tyre. Pas verifikimit, aktet dorëzohen në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës dhe ruhen përgjithmonë.
2. Dokumentet, mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, vendosen në arkivin e zyrës së gjendjes civile, në njësinë e qeverisjes vendore, në muajin e parë të vitit pasardhës dhe ruhen për një periudhë 10-vjeçare.

3 Me krijimin e Regjistrit Kombëtar, regjistrat themeltarë të shtetasve në bashki/njësi administrative dorëzohen në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, sipas procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3/1. Për kryerjen e veprimeve, zyrat e gjendjes civile pranojnë vetëm akte ose dokumente origjinale.

4. Për administrimin e të gjithë dokumentacionit, shërbimi i gjendjes civile zbaton rregullat e përgjithshme për arkivat, për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

KREU V
REGJISTRI KOMBËTAR

Neni 33
Regjistri Kombëtar
(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.201, ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018; shfuqizuar pikat 1 dhe 4 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Shfuqizuar.

1/1. Në Regjistrin Kombëtar transkriptohen të dhënat për shtetasit shqiptarë sipas akteve të zyrave të gjendjes civile të vendeve të huaja. Pasqyrimi i këtyre akteve bëhet kronologjikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile janë kryer verifikimet e nevojshme për përputhshmërinë e të dhënave në dokumentacionin e administruar me ato të shërbimit të gjendjes civile.

2. Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Veprimet në Regjistrin Kombëtar dhe në aktet e gjendjes civile bëhen me anë të teknikave informatike.

4. Shfuqizuar.

Neni 34
Veprimet në Regjistrin Kombëtar
(hequr fjalë me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Veprimet në Regjistrin Kombëtar kryhen vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile në njësi administrative dhe nga nëpunësi në misionet diplomatike dhe postet konsullore, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 35
Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar
(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Në Regjistrin Kombëtar, në seksionin e të dhënave personale, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi të përcaktuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Rregullat e regjistrimit, të dhënat parësore, të dhënat dytësore, dhënësit e informacionit, ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave dhe niveli i aksesimit për bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36
Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar
(ndryshuar titulli dhe shtuar një paragraf në fund të shkronjës "c" me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Kur në Regjistrin Kombëtar vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;
b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;
c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.

Për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 57/7 e vijues të këtij ligji.

Neni 37
Mungesa e së dhënës

1. Kur e dhëna, që kërkohet për aktin e lindjes dhe të vdekjes, është e pamjaftueshme ose nuk vërtetohet nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse pranë organit, që ka dijeni për faktin juridik, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji.
2. Me vërtetimin e së dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet plotësimi vetëm në Regjistrin Kombëtar.

KREU VI
REGJISTRIMI I AKTIT TË LINDJES

Neni 38
Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, në mungesë të personelit mjekësor.
2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.
3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

Neni 38/1
Akti i lindjes i lëshuar jashtë vendit
(shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Në rastet kur akti i lindjes i lëshuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.
2. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqesin subjektet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.
3. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi.
4. Gjykata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur, me cilësinë e personit të interesuar, zyrën e gjendjes civile.
5. Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankim, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij.

Neni 39
Dokumentet bazë të personave të gjetur

1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.
2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.
3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë/ njësisë administrative, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërish imagjinarë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjërisht të prindërve.
4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paaftë mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.
5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.
6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paaftë mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.

Neni 40
Deklarimi i lindjes
(shtuar fjalë në pikën 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, njësitë për mbrojtjen e fëmijës, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.
3. Nëse deklarimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga lindja, nga personat e përcaktuar në pikën 1, deklarimi kryhet nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile[3].

Neni 41

Regjistrimi i lindjes

(shfuqizuar pika 3 dhe ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, shtuar pika 3 dhe shfuqizuar pika 6 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.
2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.
3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në misionet diplomatike ose postet konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja.
4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
5. Fondi për shpërblimin për regjistrimin e lindjes brenda afatit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit. Procedurat për përfitimin e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.
6. Shfuqizuar.

[3] Udhëzim Nr. 284, datë 11.03. 2019 "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes".

7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë.

Neni 41/1

Raportimi dhe regjistrimi i lindjeve me procedurë të veçantë

(shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që, për çdo lindje të ndodhur pranë institucioneve të tyre, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, dokumentacionin/njoftimet përkatëse. Ky proces kryhet çdo ditë të hënë, për javën pararendëse.
   Modalitetet, lloji i dokumentacionit, forma dhe mënyra e komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës që mbulojnë institucionet e lartpërmendura[4].
2. Për çdo lindje të raportuar, sipas pikës 1, të këtij neni, zyra përkatëse e gjendjes civile pasqyron lindjen në regjistrin e përkohshëm.
   Ministri përgjegjës për gjendjen civile përcakton me udhëzim rregulla të hollësishme për krijimin dhe administrimin e regjistrit të përkohshëm të lindjeve të raportuara[5].
3. Nëse regjistrimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë vendore, e cila ndërmerr veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile.
   Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile[6].

[4] Udhëzim i përbashkët nr. 870, datë 24.12.2018 , "Për përcaktimin e veprimeve dhe procedurës që kryejnë nëpunësit e zyrave të gjendjes civile dhe personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor për përfitimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të sapolindura". *I ndryshuar*

[5] Udhëzim nr. 285, datë 11.03.2019 "Për krijimin, administrimin & përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet e raportuara.

[6] Udhëzim Nr. 284, datë 11.03. 2019 "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes".

Neni 42
Akti i lindjes

(Shfuqizuar termi "kombësi" në shkronjën "e" me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

1. Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit.
2. Akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe deklaruesi. Ai përmban:
   a numrin rendor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile;
   b) datën e plotë dhe orën e lindjes;
   c vendin e lindjes;
   ç emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
   d) numrin personal të fëmijës;
   dh gjininë;
   e) Shfuqizuar.
   ë) shtetësinë;
   f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;
   g) numrin personal dhe identitetin e nënës;
   gj) numrin personal dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
   h) identitetin, numrin personal dhe cilësinë e deklaruesit;
   i) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

Neni 43
Vlefshmëria dhe kundërshtimi i aktit të lindjes

1. Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm.
2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.
3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrojnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.
4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 44
Ndryshimi i të dhënës së aktit të lindjes

(Ndryshuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar, mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Neni 45
Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

(shtuar pika 3/a me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Në Regjistrin Kombëtar pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme.
2. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklarimit e nënshkrimit të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.
3. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuara, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykate.

3/a. Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e paplotësuar rubrika e emrit, plotësimi i saj bëhet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile[7].

4. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

[7] Udhëzim Nr. 286, datë 11/03/ 2019 "Për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile kur në aktin e lindjes mbajtur jashtë republikës së shqipërisë është e paplotësuar rubrika e emrit".

KREU VII
REGJISTRIMI I AKTIT TË MARTESËS

Neni 46
Forma e aktit të martesës
(hequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.
2. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet. Kur është e mundur, bëhet verifikimi i menjëhershëm dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen.

Neni 47
Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar
(ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt.
2. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve.
3. Martesa e shtetasit të huaj ose e personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data që kërkohet të lidhet martesa, përveç rasteve kur ka mënyra dhe një afat tjetër, të përcaktuar në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.
4. Për të huajt, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ose janë refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi përkatës shqiptar ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi.

5. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile, me dëshirën e vet. Gjithashtu, martesa mund të lidhet kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.
6. Rregullat dhe procedura për lidhjen e martesës dhe dokumentacioni që duhet të mbahet nga gjendja civile për lidhjen e martesës, si dhe për ndryshimin e mbiemrit, kur ndodh për shkak të martesës, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile[8].

Neni 48
Përmbajtja e aktit të martesës
Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm:

a) zyra e gjendjes civile, ku kryhet akti i martesës;
b) numri dhe data e mbajtjes së aktit të martesës;
c) numri dhe data e shpalljes së martesës;
ç) numri dhe data e vendimit të gjykatës;
d) vendi i lidhjes së martesës dhe ora;
dh) identiteti, numri personal të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm;
e) vendbanimi /vendqëndrimi para martesës;
ë) vendbanimi pas martesës;
f) mbiemri që do të mbajë pas lidhjes së martesës secili nga bashkëshortët;
g) njohja e atësisë ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve, të lindur para martesës;
gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve;
h) numri personal emri, mbiemri dhe vendbanimi i dëshmitarëve;
i) numri personal, emri, mbiemri i përkthyesit;
j) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 49
Vërtetimi i martesës
Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në

[8] Udhëzim Nr. 188, DATË 27.09.2024 "Për rregullat dhe procedurat për lidhjen e martesës dhe dokumentacionit që duhet të mbahet nga zyrat e gjendjes civile për lidhjen e saj, si dhe për ndryshimin e mbiemrit, kur ndodh për shkak të martesës".

përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të nëpunësit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve.

Neni 50

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet për mbajtjen e aktit të martesës në Regjistrin Kombëtar dhe përditëson të dhënat, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.
2. Transkriptimi i të dhënave referuese të aktit të martesës, që shtetasit shqiptarë kanë lidhur në zyrat e gjendjes civile në vende të huaja, në Regjistrin Kombëtar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Shtetasi, që pretendon se i është cenuar një e drejtë nga pasaktësi në aktin e martesës, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

KREU VIII
REGJISTRIMI I AKTIT TË VDEKJES

Neni 51

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; shtuar pika 3 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Akti i vdekjes është dokumenti që vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit dhe mbahet për çdo të vdekur. Ky akt nënshkruhet nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi, pasi të jetë administruar dokumenti "skedë vdekjeje", i lëshuar nga institucionet e autorizuara shëndetësore, që kanë të drejtë të vërtetojnë këtë fakt.
2. Akti i vdekjes përmban:
   a) zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku mbahet akti i vdekjes;
   b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;
   c) vendin dhe orën e vdekjes;
   ç) shkakun e vdekjes, të përcaktuar sipas dokumentit shëndetësor;
   d) identitetin dhe numrin personal të të vdekurit ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura, që nuk mund të identifikohen;

   dh) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit mjeko-ligjor, që ka plotësuar skedën e vdekjes;
   e) të dhënat referuese të njoftimit përkatës të institucionit të prokurorisë, që autorizon kryerjen e veprimeve për raste të përcaktuara në këtë ligj;
   ë) emrin, mbiemrin e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile.
3. Rregullat dhe procedurat për regjistrimin e fëmijëve, që lindin të vdekur, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile[9].

Neni 52
Deklarimi i vdekjes

(ndryshuar pika1, 3 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar shkronja "c", shtuar një fjali në fund të pikës 4 dhe shfuqizuar pika 9 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga:
   a) çdo pjesëtar madhor i familjes;
   b) nga persona të afërt të familjes;
   c) në rastin kur ka përfunduar afati i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, dhe nuk është bërë deklarimi i vdekjes nga subjektet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, i ngarkuari i posaçëm i bashkisë bën deklarimin në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi që ka ndërruar jetë ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin në momentin e vdekjes.
2. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor.
3. Afati për deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë, nga data e vdekjes ose gjetja e kufomës, për vdekjet brenda vendit, dhe 90 ditë, nga data e vdekjes, për vdekjet jashtë vendit.

3/1. Për vdekjen aksidentale, afati i deklarimit në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë nga lëshimi i lejes nga prokurori, e cila paraqitet në zyrën e gjendjes civile nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Drejtuesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre. Rregulla të

[9] Udhëzim Nr. 180, datë 19.09.2024 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për regjistrimin e fëmijëve që lindin të vdekur".

hollësishme për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile me ministrat që mbulojnë institucionet e përmendura në këtë pikë.

5. Kur vdekja ndodh ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.
6. Me deklarimin e vdekjes, zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit.
7. Në fshatra, në juridiksionin e komunave, që nuk kanë zyrë të gjendjes civile, lejen për varrimin e jep kryeplaku i fshatit. Në këtë rast, kryeplaku, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.
8. Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas pikës 4 të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarimin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit vendor, kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.
9. Shfuqizuar.
10. DPGJC-ja është detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga Regjistri Kombëtar listën e shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe për çdo datë 5 të muajit pasardhës shpërndan listën, sipas zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile, në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor, bën verifikimin rast pas rasti, sipas procedurës së miratuar nga ministri përgjegjës për gjendjen civile[10].

Neni 53

Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

(ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt edhe në rastet kur me vendim gjyqësor të shkallës së parë vërtetohet fakti juridik i vdekjes. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes kanë të drejtë ta bëjnë subjektet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji.
2. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.
3. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale.
4. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar e/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes.
5. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

Neni 54

Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është nënshkruar edhe nga prokurori.

Neni 55

Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

1. Akti i vdekjes është absolutisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër.
2. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt.

[10] Udhëzim Nr. 361, datë 14.10.2010 "Për procedurat e verifikimit të shtetasve që kanë mbushur 100-vjec dhe veprimet për çregjistrimin e tyre kur vërtetohet vdekja sipas kërkesave ligjore".

3. Akti i vdekjes shpallet relativisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit, për sa i përket kohës, shkakut e vendit të vdekjes.
4. Pavlefshmëria, sipas pikës 1 të këtij neni, konstatohet nga gjykata, pas kërkesës së paraqitur, në çdo kohë, nga personi, për të cilin është mbajtur akti i vdekjes. Kur personi është i mitur, i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar ose nuk është në gjendje mendore apo fizike, këtë të drejtë e kanë përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e tij dhe, kur nuk ka të tillë apo kur kjo e drejtë nuk ushtrohet prej tyre, të drejtën e ka edhe prokurori.
5. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, përveç personit, që rezulton i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasoja juridike nga mungesa e aktit të të vdekurit në fakt. Kur këta janë të mitur, u është hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore apo fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor apo kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori.
6. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi, që rezulton i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht.
7. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por, në çdo rast, duke mbajtur një akt tjetër vdekjeje.
8. Pavlefshmëria, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkohet nga të interesuarit, që kanë zotësi juridike ose nga prokurori, kur pasojat rëndojnë mbi të miturit, personat madhorë, që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur:
   a) kjo nuk ushtrohet nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestari;
   b) nuk ka të tillë;
   c) pasojat lidhen me shtetin.
9. Me shpalljen e pavlefshmërisë së aktit të vdekjes me vendim gjyqësor, shënimet në fletën familjare të regjistrit themeltar ose në Regjistrin Kombëtar anulohen ose ndryshohen dhe ky veprim pasqyrohet në rubrikën e vërejtjeve dhe në vetë aktin e vdekjes.

KREU IX
EMRI, MBIEMRI DHE NDRYSHIMI I TYRE

Neni 56
Emri e mbiemri
(Shfuqizuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013 (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, që ka detyrimin e mbajtjes së aktit të lindjes, pasi administron deklaratën e shkruar të personave të përcaktuar në nenin 40, të këtij ligji, lidhur me:
   a) emrin që do t'i vendosin fëmijës së lindur, përveç emrave të klasifikuar të papërshtatshëm, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
   b) mbiemrin që do të mbajë fëmija, në përputhje me Kodin e Familjes, i pasqyron këta përbërës të gjendjes civile në aktin e lindjes.
2. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore.
3. Kur prindërit nuk bien dakord, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër, me shënimin në kllapa "i përkohshëm", deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata.
4. Shfuqizuar.
5. Shfuqizuar.
6. Mbiemri i fëmijës përcaktohet në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Familjes.
7. Kur prindërit kanë vdekur apo nuk janë në gjendje fizike a mendore ose nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë dhe, në mungesë të tyre, nga nëpunësi i gjendjes civile.

Neni 57
Rastet e ndryshimit të mbiemrit dhe të emrit
(Ndryshuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Mbiemri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
   a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes;
   b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji.

2. Emri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
   a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes, në rastin e birësimit;
   b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji, brenda 1 viti nga mbushja e moshës madhore, dhe vetëm një herë, si dhe sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 57/1

Procedura për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit me kërkesë të personit të interesuar

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Me përjashtim të rastit të korrigjimit të emrit/mbiemrit, çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.
2. Kërkesa për ndryshimin e emrit të përkohshëm, të vendosur nga prindërit, mund të bëhet nga vetë personi brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore. Në këtë rast kërkesa përmban datën dhe nënshkrimin e kërkuesit, i cili duhet të përcaktojë qartë emrin e përhershëm që kërkon të marrë.
3. Kërkesa për ndryshimin e emrit ose mbiemrit duhet të bëhet vetëm një herë dhe vetëm për shkaqe papërshtatshmërie. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të përkohshëm, sipas pikës 2 të këtij neni.
   Në asnjë rast nuk mund të kërkohet marrja e mbiemrave që u përkasin personave me rëndësi historike, apo të tillë që mund të çojnë në lajthim, lidhur me përkatësinë e familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, të përcaktuara si të tilla sipas procedurës së përmendur në pikën 4 të këtij neni.
4. Ministri përgjegjës për gjendjen civile parashikon me udhëzim rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave që konsiderohen të papërshtatshëm, si dhe listën me emra dhe mbiemra të personave

që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, së bashku me një listë, pasi merr paraprakisht mendimin e institucioneve të specializuara. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga zyrat e gjendjes civile, si dhe çdo organ tjetër shtetëror[11].

Neni 57/2

Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin e gjendjes gjyqësore/formularin e plotësuar të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
b) vërtetimin nga prokuroria se nuk është në ndjekje penale;
c) vërtetimin nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor;
ç) kopjen e letërnjoftimit;
d) certifikatën e lindjes dhe certifikatën e përbërjes familjare;
dh) vërtetimin se nuk është marrë ndaj tij ndonjë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër;
e) vendimin gjyqësor, i njohur sipas legjislacionit shqiptar, në rast të ndryshimit të emrit apo mbiemrit në një vend tjetër, jashtë rasteve të parashikuara nga Kodi i Familjes.

Neni 57/3

Rastet kur ndalohet ndryshimi i emrit dhe mbiemrit

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Emri dhe mbiemri nuk ndryshohen në rastet kur:

a) shtetasi është në proces gjyqësor ose nuk ka mbaruar ndjekja penale;
b) vërtetohet se ndaj shtetasit është marrë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër.

Neni 57/4

Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

[11] Udhëzim Nr. .91, datë 02.04.2014, "Për rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave të konsideruar të papërshtatshem dhe të atyre me rëndesi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare, apo të mirënjohura në bashkinë/komunën, ku ka vendbanimin personi i interesuar".

1. Kërkesa për ndryshimin e emrit/mbiemrit i paraqitet përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Tarifat për paraqitjen e kërkesës përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhen nga kërkuesi me depozitimin e kërkesës[12].
2. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile formon fashikullin e kërkesës me dokumentet përkatëse dhe, pasi ka verifikuar nëse ka shënime të mëparshme në regjistrin e gjendjes civile, brenda 60 ditëve, e përcjell fashikullin pranë prefektit të qarkut, nën juridiksionin e të cilit ndodhet zyra e gjendjes civile, së bashku me mendimin e tij lidhur me plotësimin e dokumentacionit dhe verifikimin paraprak të arsyeve të kërkesës së paraqitur.
3. Prefekti, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kërkesës, kryen këto verifikime:
   a) pasjen ose mospasjen e juridiksionit;
   b) hetimin për praninë e shkaqeve që legjitimojnë kërkesën dhe legjitimimin e kërkuesit, sipas nenit 57 të këtij ligji;
   c) respektimin e procedurave dhe të afateve kohore, brenda të cilave duhej të ishte paraqitur kërkesa;
   ç) vlerësimin e arsyeve të kërkesës;
   d) marrjen e dokumenteve zyrtare, provave të nevojshme apo informacionit të nevojshëm për trajtimin e kërkesës.

   Prefekti, kur çmon se janë përmbushur kushtet dhe procedurat, sipas këtij ligji, urdhëron afishimin e shpalljes të kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa, pranë vendbanimin të kërkuesit, si dhe në dy prej gazetave për një periudhe prej 15 ditësh, si dhe/ose në Fletoren Zyrtare. Shpallja duhet t'u njoftohet personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuesit apo të atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar. Forma dhe përmbajtja e shpalljes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile[13].

[12] Urdhër Nr. 146, datë 19.05.2014 "Për caktimin e tarifave për paraqitjen e kërkesës dhe afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit".

[13] Udhëzim Nr. 90, datë 02.04.2014 "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit".

Tarifat për afishimin e shpalljes përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhen nga kërkuesi përpara se të bëhet afishimi i shpalljes[14].
4. Prefekti, kur çmon se kërkesa nuk plotëson dokumentacionin shoqërues apo elementet formale të saj, cakton një afat jo më të shkurtër se 30 ditë për plotësimin e kërkesës, duke njoftuar kërkuesin dhe zyrën e gjendjes civile, ku ai ka vendbanimin. Nëse brenda këtij afati kërkuesi nuk plotëson të metat e kërkesës, prefekti vendos për deklarimin e braktisjes së procedurës dhe arkivimin e kërkesës. Në këtë rast kërkesa nuk evidentohet në shënimet e gjendjes civile.

Neni 57/5
Kundërshtimi i të tretëve
(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.
2. Kundërshtimi bëhet me kërkesë me shkrim dhe duhet të depozitohet pranë prefektit ose në zyrën e gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Në këtë rast, kërkesa i përcillet pa vonesë prefektit të qarkut ku bën pjesë zyra e gjendjes civile.

Neni 57/6
Vendimi për kërkesën
(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Me kalimin e afatit të parashikuar për kundërshtimin e të tretëve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së parashikuar, si dhe vlerësimit të kundërshtimeve që mund të jenë paraqitur, prefekti nxjerr mendim të arsyetuar për themelin e kërkesës për ndryshimin, sipas rastit, të emrit apo mbiemrit, duke i propozuar Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesës për ndryshimin e emrave apo të mbiemrave pranimin apo refuzimin e ndryshimit.

[14] Urdhër Nr. 146, datë 19.05.2014 "Për caktimin e tarifave për paraqitjen e kërkesës dhe afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit".

Mendimi i prefektit për kërkesën për ndryshimin e emrit apo mbiemrit, së bashku me fashikullin e kërkesës, i përcillet për shqyrtim dhe miratim Komisionit Kombëtar pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, i cili vendos për kërkesën, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky ligj dhe në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative[15].

2. Nëse prefekti vlerëson se ndryshimi i kërkuar ka të bëjë me mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara apo të mirënjohura në juridiksion e tij, që nuk janë në listën e miratuar me udhëzim, përpara përcjelljes së kërkesës pranë Komisionit Kombëtar, ai ka të drejtë t'i kërkojë mendim këshillit komunal ose atij bashkiak apo institucioneve të tjera publike të specializuara të fushës për marrjen e emrave apo mbiemrave që kërkohen të merren nga kërkuesi. Mendimi i këshillit komunal/bashkiak, apo i institucionit të specializuar, përfshihet në fashikullin që shoqëron kërkesën. Nëse këshilli komunal/bashkiak apo institucioni i specializuar nuk shprehen brenda afatit 90 ditor, ky fakt konsiderohet si mos kundërshtim i heshtur i kërkesës dhe evidentohet në procesverbal nga ana e prefektit.
3. Me qëllim vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave/mbiemrave, pranë ministrisë përgjegjës për punët e brendshme, krijohet Komisioni Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave. Përbërja dhe rregullat për funksionimin e Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e brendshme.
4. Pas përcjelljes së kërkesës dhe fashikullit shoqërues në Komisionin Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, ky i fundit, në përfundim të procedurës administrative për marrjen e të dhënave të nevojshme, shprehet me vendim përfundimtar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit.
5. Vendimi i komisionit, i arsyetuar, i njoftohet kërkuesit dhe personave të interesuar, prefektit, si dhe zyrës së gjendjes civile përkatëse për

[15] Urdhër nr. 236/1, datë 20.01.2014, "për krijimin e Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrit & mbiemrit".

veprim, sipas rastit, si dhe për mbajtjen e shënimeve përkatëse në regjistër.

Neni 57/7

Kërkesa për korrigjimin e emrit dhe mbiemrit

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Çdo person, që ka interes për të korrigjuar emrin/mbiemrin e vet, për shkak të një gabimi të provuar material, të bërë gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile, mund të paraqesë kërkesë pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin.

Neni 57/8

Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës për korrigjim material

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) kopje të aktit të lindjes;
b) çdo dokument tjetër që provon gabimin.

Neni 57/9

Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

1. Në rastin e gabimeve materiale të provuara në një akt të gjendjes civile, personi i interesuar apo pjesëtarët e familjarët që preken nga ai akt, mund të kërkojnë ndreqjen e gabimit të ndodhur, kur provojnë gabimin material gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar. Nëpunësi i gjendjes civile, pas pranimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, ia përcjell atë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, së bashku me një mendim mbi themelin e saj. Vendimi i drejtorit i komunikohet prefektit të qarkut përkatës dhe ky i fundit ka të drejtë t'ia njoftojë atë Komisionit Kombëtar.
2. Rregullat për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për korrigjim miratohen me urdhër të ministrit[16].

[16] Urdhër Nr. 181, datë 19.09.2024 "Për procedurën e korrigjimit si gabim material të emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës".

Neni 57/10

Efektet e ndryshimit të emrit dhe mbiemrit të ri

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Pas miratimit të kërkesës së shtetasit, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar. Në procesverbalin, që mbahet në këtë rast, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar.

Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

Rregullat dhe procedurat për pasqyrimin e ndryshimit të emrit/mbiemrit në Regjistrin Kombëtar përcaktohen nga ministri përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

KREU X

GJENDJA CIVILE E SHTETASVE TË HUAJ DHE E PERSONAVE PA SHTETËSI"

(Ndryshuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Neni 58

Kombësia

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

Neni 59

Gjendja civile e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe shtetasit e huaj, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të gjitha të drejtat, sipas këtij ligji, me përjashtim të të drejtave, që lidhen ngushtë me shtetësinë shqiptare dhe të veçorive në mënyrën e dokumentimit.
2. Gjendja civile e shtetasit të huaj me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në dokumentet e shtetit përkatës, ndërsa ajo e personit pa shtetësi, në dokumentet e shtetit ku ka lindur ose prej nga ka ardhur. Gjendja civile e shtetasit të huaj, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë vërtetohet nga të dhënat, që ka organi përkatës administrativ për refugjatët.
3. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm, vizitorë ose që janë tranzit në Shqipëri, kanë të drejtë që, nëpërmjet shërbimit të gjendjes civile, të evidentojnë dhe të vërtetojnë faktet juridike të tyre, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, sikurse çdo shtetas shqiptar, përveçse kur ka pengesë ose një procedurë të veçantë, të përcaktuar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare.

KREU XI

SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 60

Natyra dhe funksioni

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, hequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson dhe përditëson Regjistrin Kombëtar, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Shërbimi i gjendjes civile, krahas detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i jep informacion subjekteve të përcaktuar nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, mbi bazën e dokumentacionit që administron, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, kundrejt tarifës që përcaktohet, sipas parashikimit të nenit 73 të këtij ligji.

Neni 61

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016 hequr fjalë në shkronjën "c" të pikës 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018; ndryshuar togfjalësh në pikën 2 dhe shfuqizuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile organizohet, si më poshtë vijon:
   a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
   b) zyrat e arkivit së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut;
   c) zyrat e gjendjes civile në bashki;
   ç) shërbimi i gjendjes civile në misionet diplomatike dhe postet konsullore shqiptare.

   Shërbimi i gjendjes civile në misionet diplomatike dhe postet konsullore shqiptare funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Veprimet e nëpunësve të autorizuar e të trajnuar në Regjistrin Kombëtar, në postet konsullore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme.
2. Shërbimi i gjendjes civile mund të ofrohet, në mënyrë të kufizuar, edhe në institucione të tjera shtetërore, të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

Neni 62

Struktura dhe organika

(hequr fjalë me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Struktura, organika dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave[17].

Neni 63

Buxheti

(hequr fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Të ardhurat që sigurohen nga shërbimi i gjendjes civile duhet të përdoren në përputhje me aktet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë përdorimin dhe administrimin e të ardhurave që krijohen nga institucionet buxhetore.
2. Buxheti i shërbimit të gjendjes civile është program më vete, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Brendshme.
3. Bashkitë, në përputhje me objektivin e tyre, mund të parashikojnë dhe kryejnë shpenzime, operative ose kapitale, shtesë, për përmirësimin e shërbimit të zyrës së gjendjes civile.

[17] Vendim Nr. 1299, datë 16.12.2009 , " Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake dhe degët e qarqeve.

Neni 64

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 64/1

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile

(shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 65

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

(hequr fjalë në shkronjat "d" dhe 'g' dhe shfuqizuar shkronja "c" me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen këto detyra:

a) I propozon ministrit projektaktet në zbatim të ligjit.
b) Harton dhe i propozon për miratim ministrit treguesit e cilësisë së shërbimit, metodikat dhe rregulloret për funksionimin e zyrave të shërbimit të gjendjes civile.
c) Shfuqizuar.
ç) Harton programe dhe merr masa për zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit të gjendjes civile.

d) Bën drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut, bashki, si dhe në misionet diplomatike dhe postet konsullore.
dh) Bashkëpunon me institucione dhe donatorë të interesuar për problemet e shërbimit të gjendjes civile dhe i paraqet ministrit për miratim projektmarrëveshje, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim.
e) Merr masa, harton dhe zbaton programe për kualifikimin dhe rekrutimin e nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.
ë) Propozon modelet e dokumenteve që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile, si dhe programet kompjuterike që përdor ky shërbim.
f) Vendos kriteret profesionale që duhen plotësuar nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për pranimin e tyre në këtë shërbim[18].
g) Kur vëren shkelje, i propozon kryetarit të bashkisë dhe prefektit të qarkut masa administrative për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Masat e propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile janë të detyrueshme për zbatim nga kryetarët dhe prefekti i qarkut.
gj) Zgjidh konfliktet për veprimet apo mosveprimet e zyrave të gjendjes civile, në ushtrim të funksioneve të tyre.

Neni 66
Emërimi dhe lirimi i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut
(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)
Emërimi dhe lirimi nga detyra i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, bëhet nga prefekti i qarkut, me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

Neni 67
Detyrat e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut
(ndryshuar pika "b" me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; shtuar shkronja ''ë" me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut kanë këto detyra:

[18] Urdhër Nr. 577, datë 04.11.2015, "Per miratimin e rregullores për pranimin në detyrë të nëpunësit të zyrës së gjendjes civile në bashki".

a) zbatojnë metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
b) administrojnë arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile, nivel qendër qarku;
c) lëshojnë certifikata të shërbimit të gjendjes civile, për dokumentet që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile në bashki /komunë;
ç) u japin të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
d) pranojnë dhe shpërndajnë në zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna njoftimet, që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
dh) kontrollojnë veprimtarinë e zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna dhe u propozojnë organeve përkatëse marrjen e masave të nevojshme;
e) raportojnë para prefektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e degës së qarkut dhe të zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna.
ë) lëshojnë vërtetim ku konfirmohet fakti që është i njëjti person, kur, për shtetasit shqiptarë, nga një transkriptim në tjetrin ka gabime në një ose më shumë përbërës të gjendjes civile.

Neni 68
Zyrat e gjendjes civile në bashki, Buxheti
(hequr fjalë në pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)
1. Shërbimi i gjendjes civile ushtron funksionet në bashki.
2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë, sipas kritereve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile[19].
3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 69
Detyrat e zyrave të gjendjes civile në bashki, njësi administrative
(shtuar fjalë në shkronjën "a" dhe ndryshuar shkronja "dh" me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

[19] Urdhër Nr. 577, datë 04.11.2015, "Per miratimin e rregullores për pranimin në detyrë të nëpunësit të zyrës së gjendjes civile në bashki".

Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative kanë këto detyra:

a) përditësojnë Regjistrin Kombëtar dhe ofrojnë shërbimin e gjendjes civile për shtetas që kanë vendbanimin brenda juridiksionit territorial të tyre;
b) mbajnë aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;
c) lëshojnë dokumentin e identitetit, certifikatat e lindjes, ato familjare, të martesës dhe të vdekjes, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
ç) kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi;
d) plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve të interesuara;
dh) informojnë kryetarin e bashkisë, si dhe zyrat e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, për veprimtarinë e tyre, sipas kërkesës së tyre.
e) plotësojnë të gjitha detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 69/1

(shtuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Dokumenti "certifikatë", që sipas dispozitave të këtij ligji lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, nga zyra e gjendjes civile në njësi administrative, mund të lëshohet edhe nga zyra e gjendjes civile në bashki, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësia.
2. Në rastin e ofrimit të shërbimit, sipas parashikimit të bërë në pikat 2 dhe 3, të nenit 61, të këtij ligji, dokumenti "certifikatë" lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 70

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 71

Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në misione diplomatike dhe poste konsullore

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore kryejnë të njëjtat veprime si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në territorin

e Republikës së Shqipërisë dhe trajnohen përpara fillimit të detyrës si nëpunësit e gjendjes civile.
2. Nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore, përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile, administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar për shtetasit shqiptarë me vendqëndrim jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.
3. Veprimet, rregullat e administrimit dhe përcjelljes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, të cilat kryhen nga nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

Neni 72

Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile

Të drejtat dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve në regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i kanë vetëm nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, ndërsa për misionet diplomatike dhe postet konsullore, vetëm nëpunësit e trajnuar për këtë qëllim.

Neni 73

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Informacionet që jepen nga shërbimi i gjendjes civile për subjektet private, të përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kryhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Financave.
2. Të ardhurat e siguruara nga tarifat, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 74

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar shkronjat "a", "b" , "c" të pikës 1, me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013, ndryshuar shkronja "a" dhe shtuar shkronja "ç" me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar fjalë në shkronjën "a" dhe "b" me

ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018, shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 1 me ligjin nr. 130/2020, datë 22.10.2020; ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:
   a) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 52, pikat 5 dhe 7, dënohet me gjobë në masën nga 3 000 lekë deri në 5 000 lekë.
   b) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 3, pika 1, nenin 41/1, pika 1, në nenin 52, pika 4, nenin 65, shkronja "g", nenin 66 dhe në nenin 68, pikat 2 dhe 3, dënohet me gjobë në masën nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.
2. Gjobat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni vendosen nga drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile. Kundër vendosjes së masës administrative me gjobë bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve pranë ministrit përgjegjës për gjendjen civile, i cili brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër urdhrit të ministrit përgjegjës për gjendjen civile bëhet ankim në gjykatë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.
3. Masat administrative të gjobës, të cilat nuk ankimohen brenda afatit, si dhe ato të cilat lihen në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat përmbarimore për ekzekutimin e tyre.

KREU XII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 76
Nxjerrja e akteve nënligjore

(Ndryshuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për gjendjen civile që të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 15 pika 4, 18 pikat 3 dhe 4, 20 pika 4, 22 pika 2, 24 pika 4, 25, 52 pika 10, 62 dhe 63 të këtij ligji.

Dispozita kalimtare

(Shtuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Procedura për ndryshimin e emrit/mbiemrit, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojë të rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në datën e paraqitjes së kërkesës.

Neni 24
Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Gjoba e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në nenin 22, të këtij ligji, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Gjoba e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 74, të ligjit, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 6180, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

L I G J

Nr. 8951, datë 10.10.2002

PËR NUMRIN PERSONAL TË SHTETASVE

(Ndryshuar me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

Qëllimi i ligjit është përcaktimi i kuptimit, mënyrës së formimit dhe sferës së përdorimit të numri personal, si një nga përbërësit e veçantë të gjendjes civile, i cili përcakton dhe shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

1. Numri personal është unik dhe vendoset nga shërbimi i gjendjes civile. Ai përbëhet nga dhjetë elemente me informacion të koduar dhe ka strukturën e mëposhtme:

Elementi 1-2	viti i lindjes
Elementi 3-4	muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6	data e lindjes
Elementi 7-9	numri serial brenda së njëjtës datë
Elementi 10	element kontrolli.

2. Numri personal lëshohet nga shërbimi i gjendjes civile.

Neni 3

(Ndryshuar togfjalësh në fjalinë hyrëse dhe pika 2, shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

Numri personal shërben:

1. Për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
2. Për letërnjoftimin.
3. Si numër i sigurimit shoqëror për të identifikuar, regjistruar dhe për të kërkuar përfitime nga sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe për programet e tjera të mbrojtjes shoqërore.
4. Shfuqizuar.
5. Për sistemin tatimor.
6. Për dëshminë e aftësisë së drejtimit të automjeteve.
7. Për nevojat e organeve dhe të institucioneve të tjera shtetërore, si organeve të drejtësisë, të rendit, të prokurorisë, të mbrojtjes, të arsimit dhe të Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë.

Neni 4

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 2, datë 26.1.2012)

Mënyra e kodimit të numrit personal, masat dhe detyrat e organeve shtetërore për pajisjen e shtetasve me numër personal, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 1, nenet 2, 3, 6, 7, si dhe paragrafi i tretë i nenit 13 të ligjit nr. 7845, datë 13.7.1994 "Për numrin e sigurimit shoqëror", shfuqizohen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 12 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3541, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Vendim

Nr. 332, datë 17.3.2010

Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile[20]

(Ndryshuar me VKM nr. 31, datë 19.1.2011; nr. 340, datë 23.5.2012; nr. 1007, datë 13.11.2013; nr. 555, datë 27.8.2014; nr. 432, datë 20.5.2015; nr. 496, datë 13.9.2017; nr. 224, date 26.4.2018; nr. 761[21], datë 13.12.2024)
(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 25 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forma dhe elementet përbërëse të dokumenteve që mban dhe lëshon Shërbimi i Gjendjes Civile, të jenë sipas modeleve bashkëlidhur në lidhjen nr. 1, përkatësisht:

a Mod. nr. 1: Akt lindjej
b) Mod. nr. 2: Akt martese;
c) Mod. nr. 3: Akt vdekjeje;
ç) Mod. nr. 4: Procesverbal për ndryshim emri/mbiemri;
d) Mod. nr. 5: Procesverbal për bashkim familjeje;
dh) Mod. nr. 6: Procesverbal për veçim familjeje;
e) Mod. nr. 7: Procesverbal për njohje atësie;
ë) Mod. nr. 8: Shpallje martese;
f) Mod. nr. 9: Vendim për pezullimin e procedurës për lidhje martese;
g) Mod. nr. 10: Vendim për refuzim për lidhje martese;
gj) Mod. nr. 11: Vendim për ndreqje gabimi material;
h) Mod. nr. 12: Leje varrimi;
i) Mod. nr. 13: "Certifikatë familjare" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
j) Mod. nr. 13/1: "Certifikatë familjare" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
k) Mod. nr. 14: "Certifikatë personale" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
l) Mod. nr. 14/1: "Certifikatë lindjeje" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
ll) Mod. nr. 14/2: "Certifikatë martese" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
m) Mod. nr. 14/3: "Certifikatë vdekjeje" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna;
n) Mod. nr. 14/4: "Certifikatë lindjeje" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
nj) Mod. nr. 14/5: "Certifikatë martese" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
o) Mod. nr. 14/6 : "Certifikatë vdekjeje" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut;
p) Mod. nr. 14/7: "Certifikatë lindjeje" "për përdorim nga autoritetet e huaja" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna/degët e qarkut;
q) Mod. nr. 14/8: "Certifikatë për lidhje martese" "për përdorim nga autoritetet e huaja" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.

[20] VKM nr. 332, datë 17.3.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 66, datë 31 maj 2010.
VKM nr. 31, datë 19.1.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 24 janar 2011.
VKM nr. 340, datë 23.5.2012 është botuar në Fletoren Zyrtate nr. 60, datë 31 maj 2012.
VKM nr. 1007, datë 13.11.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 185, datë 22 nëntor 2013.
VKM nr. 555, datë 27.8.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 140, datë 10 shtator 2014.
VKM nr. 432, datë 20.5.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 27 maj 2015.
VKM nr. 496, datë 13.9.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 19 shtator 2017.
VKM nr. nr. 224, date 26.4.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 61, date 30 prill 2018.

[21] Vendimi nr. 761, datë 13.12.2024 botuar në F.Z nr. 210, datë 17.12.2024 në kreun II dhe III shprehet:
"II. Kërkesat dhe procedurat administrative, që, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë në proces shqyrtimi nga shërbimi i gjendjes civile, përfshirë edhe atë pranë konsullatave dhe/ose ambasadave, zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.
III. Procedura për lëshimin e dokumenteve bazë, që mbahen e lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile, do të vijojë të kryhet sipas mënyrës ekzistuese deri në momentin e krijimit të infrastrukturës teknike të nevojshme për ofrimin e shërbimit nëpërmjet portalit "e-Albania"."

r) Mod. nr. 14/9: "Certifikatë martese" "për përdorim nga autoritetet e huaja" që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në bashki/ njësi bashkiake/komuna/degët e qarkut.

s) Modeli nr. 15, "Certifikatë vdekjeje," për përdorim nga autoritetet e huaja;

sh) Modeli nr. 16, "Certifikatë familjare," për përdorim nga autoritetet e huaja.

t) Mod. nr. 17, "Certifikatë lindjeje," për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

th) Mod. nr. 17/1, "Certifikatë për lidhje martese","për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

u) Mod. nr. 17/2, "Certifikatë martese","për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

v) Mod. nr. 17/3, "Certifikatë vdekjeje," për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore;

x) Mod. nr. 17/4, "Certifikatë familjare," për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore.

1/1. Në të gjitha modelet e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja, që lëshojnë zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, informacioni në rubrikën "vendlindja" të plotësohet, i shkruar sipas rasteve:

a) Për shtetet, të cilat kanë depozituar pranë OKB-së katalogët zyrtarë të emrave gjeografikë të romanizuar (toponimet), sipas listës së vënë në dispozicion nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe kodin 3-karakterësh të shtetit përkatës, sipas standardit ICAO;

b) Për shtetet, të cilat nuk kanë depozituar pranë OKB-së këta katalogë, sipas shkrimit në dokumentin e hartuar nga vendi i origjinës, por me simbole, germa latine/romane, si dhe kodin 3-karakterësh të shtetit përkatës, sipas standardit ICAO;

c) Rubrikat e tjera të certifikatave, për përdorim nga autoritetet e huaja, të plotësohen në gjuhën zyrtare shqipe.

2. Certifikata për përdorim brenda vendit do të ketë numër rendor progresiv, në të cilin tre numrat e parë tregojnë kodin e përcaktuar për çdo zyrë të gjendjes civile, sipas lidhjes nr. 2, të bashkëlidhur, dhe 6 shifrat e tjera numrin e serisë së certifikatës.

Për zyrat në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shtohen 3 (tri) kodet:
- kodi 501 për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë;
- kodi 502 për Konsullatën e Përgjithshme në Milano;
- kodi 503 për Konsullatën e Përgjithshme në Bari.

2/1. Certifikatat, të ofruara përmes shërbimit publik elektronik, në përputhje me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, lëshohen me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, sipas modeleve në version elektronik, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Të gjitha dokumentet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, plotësohen on-line nga nëpunësit e nëpunësit e zyrës së gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake e komuna nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.
4. Përmasat e fletëve të dokumenteve bazë të gjendjes civile janë të formatit A-4.
5. Afati i ruajtjes së dokumenteve, sipas modeleve, është së më poshtë vijon:
   a) Me ruajtje të përhershme, mod.nr. 4, mod.nr. 5, mod.nr. 6, mod. nr. 7 dhe mod.nr. 11;
   b) Me ruajtjes për një periudhë dyvjeçare, mod.nr. 8;
   c) Për një periudhë njëvjeçare, mod.nr. 9 dhe mod.nr. 10.
6. Specifikimet teknike të shtypshkrimeve dhe mënyra e lidhjes së akteve e të procesverbaleve përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

6/1 Në ushtrim të veprimtarisë së tyre, zyrat e gjendjes civile në bashki dhe zyrat konsullore në përfaqësitë diplomatike, të cilat kryejnë veprime për pasqyrimin e akteve të mbajtura në shtetet e huaja, përsa u përket të dhënave të pasqyruara në to, për përbërësit e gjendjes civile (emrat, mbiemrat e përveçëm), zbatojnë rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

6/2 Në përkthimin e dokumenteve të hartuara në shtetet e huaja që pranohen nga shërbimi i gjendjes civile, emrat dhe mbiemrat e personave nuk shqipërohen. Ato ruajnë formën grafike origjinale të emrit/mbiemrit, duke e riprodhuar atë shkronjë për shkronjë, përfshirë shenjat diakritike të alfabetit latin të gjuhës në të cilën është hartuar akti.

6/3 Në rastet kur akti është hartuar në një gjuhë me alfabet jolatin (cirilik, grek, arab etj.), përkthyesit riprodhojnë shkronjë për shkronjë emrin dhe mbiemrin në alfabetin latin sipas sistemit ndërkombëtar të transliterimit.

6/4 Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki dhe nëpunësit konsullorë bëjnë pasqyrimin e emrave/mbiemrave, sipas të njëjtit rregull gjatë regjistrimit të akteve të mbajtura jashtë shtetit.

7. Vendimi nr. 828, datë 11.12.2003, i Këshillit të Ministrave "Për formën, mënyrën e mbajtjes, elementet përbërëse dhe afatin e përdorimit të dokumenteve të gjendjes civile", i ndryshuar, shfuqizohet.
8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA Nr. 1

(Ndryshuar me VKM nr. 31, datë 19.1.2011; nr. 340, datë 23.5.2012)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 1

AKT LINDJE

Nr. ____ Datë: ____ / ____ / _____
(dita) (muaji) (viti)

Datëlindja: ____ / _____ / _____ **Ora e lindjes:** ____ : ____
(dita) (muaji) (viti)

Vendlindja: _____ / _____
(fshati / qyteti) (rrethi)

Emri: _____ (_____) **Mbiemri:** _____ **Gjinia:** M ☐ F ☐
Emri i përkohshëm

Shtetësia: _____ **Numri personal** _____

Lloji i lindjes: Normal ☐ Binjakë ☐ Më shumë se dy ☐ Siamezë ☐

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E BABAIT	TË DHËNAT E NËNËS
Emri, mbiemri		
Mbiemri para martese		
Numri personal		
Datëlindja		
Vendlindja (fshati/qyteti, rrethi)		
Shtetësia		
Vendbanimi (adresa) dhe ZGjC-ja		
Vendqëndrimi (adresa)		

Deklaruesi: Emri mbiemri		
Numri personal		
Vendbanimi (adresa) ZGjC-ja		
Lidhja e deklaruesit me fëmijën		
Përkthyesi: Emri, mbiemri		
Numri personal		

Vërejtje _____

Ky akt, pasi u redaktua, u lexua, u nënshkrua nga deklaruesi dhe unë.

Deklaruesi

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Përkthyesi

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënime nga verifikimi vjetor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 2

AKT MARTESE

Nr. _____ Datë: _____ / _____ / _____ **Ora mbajtjes së aktit:** _____ : _____
(dita) (muaji) (viti)

Nr. _____ Data e shpalljes së martesës: _____ / _____ / _____
(dita) (muaji) (viti)

Vendim Nr. _____ Data _____ / _____ / _____ i Gjykatës _____
(dita) (muaji) (viti)

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E BASHKËSHORTIT	TË DHËNAT E BASHKËSHORTES
Emri, mbiemri		
Numri personal		
Emri i babait		
Emri i nënës		
Datëlindja		
Vendlindja (fshati/qyteti, rrethi)		
Gjendja Civile		
Shtetësia		
Vendbanimi (adresa)		
Vendqëndrimi (adresa)		

Mbiemri që do të mbajë secili prej bashkëshortëve pas martesës		
Njohja e atësisë dhe amësisë së fëmijëve të lindur para martese		
Nr. data e kontratës së regjimit pasuror		
Dëshmitarët: Emri, Mbiemri, Numri personal, Vendbanimi (adresa)	1.	
	2.	
Përkthyesi: Emri, Mbiemri Numri personal		

Vërejtje

Ky akt, pasi u redaktua, u lexua u nënshkrua prej të gjithëve e meje.

Dëshmitarët **Bashkëshortët** **Përkthyesi**

_____ _____ _____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi) (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi) (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

_____ _____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi) (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënime nga verifikimi vjetor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 3

AKT VDEKJE

Nr. _____ Datë: _____ / _____ / _____
(dita) (muaji) (viti)

Data e vdekjes: _____ / _____ / _____ Ora e vdekjes _____ : _____
(dita) (muaji) (viti)

Vendi i vdekjes: _____
Shtëpi/institucion mjekësor/etj

Shkaku i vdekjes: _____ Kodi i sëmundjes: _____

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E PERSONIT TË VDEKUR
Emri, mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja (fshati/qyteti, rrethi)	
Gjendja Civile	
Emri dhe mbiemri i bashkëshortit/es	
Shtetësia	
Vendbanimi (adresa)	
Vendqëndrimi (adresa)	

Deklaruesi: Emri, mbiemri, Numri personal	
Lidhja e deklaruesit me personin e vdekur	
Vendbanimi (adresa)	
Mjeku ose eksperti ligjor: Emri, mbiemri Numri personal	
Leja e Prokurorisë (Nr. Datë)	
Vendim Gjykate (Nr. Datë)	

Vërejtje

Ky akt, pasi u redaktua, u lexua , u nënshkrua nga deklaruesi dhe unë.

Deklaruesi **Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile**

_____ _____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi) (Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Shënime nga verifikimi vjetor:

(Ndryshuar me VKM nr. 1007, datë 13.11.2013)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 4

PROÇESVERBAL Nr. ____

"PËR MIRATIMIN E PASQYRIMIT TË NDRYSHIMIT TË EMRIT / MBIEMRIT TË PRINDËRVE, PËR RASTET E PAPËRSHTATSHMËRISE"

Sot më datë ____/____/_____ në praninë time _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër personal _____, emri i babait _____, emri i nënës _____, i datëlindjes ____/____/_____, vendlindja_____, banues në adresën _____

i cili, pranon të pasqyrojë ndryshimin e emrit /mbiemrit të babait/nënës, për shkakun se: me Vendim Nr.____, Datë ____ /_____ /____ të Komisionit Kombëtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i është miratuar kërkesa për ndryshimin e emrit/ mbiemrit si i papërshtatshëm _____.

Bazuar në Nenin 57/10, të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për Gjendjen Civile", të ndryshuar, të bëhet pasqyrimi i vendimit të Komisionit Kombëtar për ndryshimin e emrit/mbiemrit,

nga (_____) në (_____)
në të dhënat e pjestarëve madhorë të familjes, të cilët bien dakort për pasqyrimin e këtij ndryshimi në përbërësit e tyre të gjendjes civile dhe nënshkruajnë në këtë proçesverbal.

Kërkuesi

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Personat madhorë të familjes

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 5

PROÇESVERBAL Nr. _____

PËR BASHKIM FAMILJE

Sot më datë ___/___/_____ në praninë time _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër personal _____, emri i babait _____, emri i nënës_____, i datëlindjes ___/___/_____, vendlindja _____, banues në adresën _____ regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili me kërkesën Nr. _____, Datë ___/___/_____ kërkon të bashkohet me familjen _____ për arsye se: _____.

Në përputhje me nenin _____, të Ligjit _____, Datë ___/___/_____ "Për Gjendjen Civile", unë e pranoj këtë kërkesë, për bashkim familje.

Ky proçesverbal nënshkruhet nga nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile, kërkuesi dhe të gjithë personat madhorë të familjes pranuese.

Kërkuesi

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Personat madhorë të familjes

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 6

PROÇESVERBAL Nr. _____

PËR VEÇIM FAMILJE

Sot më datë ___/___/_____ në praninë time _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____ me numër personal _____, emri i babait_____, emri i nënës _____, i datëlindjes ___/___/_____, vendlindja _____, banues në adresën _____ regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili me kërkesën Nr. _____, Datë ___/___/_____ kërkon të veçohet nga familja _____

për arsye se:

_____.

Në përputhje me nenin _____, të Ligjit _____, Datë ___/___/_____ "Për Gjendjen Civile", unë e pranoj këtë kërkesë, për veçim nga familja.

Ky proçesverbal nënshkruhet nga nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile, kërkuesi dhe të gjithë personat madhorë të familjes.

Kërkuesi

1. _____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Personat madhorë të familjes

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 7

PROÇESVERBAL Nr. _____

PËR

NJOHJE ATËSIE

Sot, më datë_____ para meje_____, nëpunëse e zyrës së gjendjes civile të _____, u paraqiten:

Z._____, emri i babait _____, emri i nënës _____, i datëlindjes_____, me profesion _____, banues në _____, me Numër personal _____ me zotësi të plotë për të vepruar; dhe

Znj._____, emri i babait _____, emri i nënës _____, i datëlindjes_____, me profesion _____, banuese në _____, me Numër personal _____ me zotësi të plotë për të vepruar,

Të cilët deklarojnë se:
Fëmija me emër _____, i regjistruar në aktin e lindjes Nr._____, datë _____, në Zyrën e Gjendjes Civile _____, si fëmijë me mëmësi _____dhe me atësi të paqenë _____, e njohin si fëmijë të tyre.

Për këtë njohje jep pëlqimin dhe nëna e fëmijës.
Ky proçesverbal u redaktua ne tre kopje, iu lexua deklarueseve me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua prej tyre dhe meqenëse u gjet sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë u nënshkrua prej deklaruesve e meje.

Deklaruesit

_____
(Emri, Mbiemri i babait, Nënshkrimi,)

_____
(Emri, Mbiemri i nënës, Nënshkrimi,)

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Bashkëlidhur vendoset dhe fotokopja e letërnjoftimit e deklaruesve dhe çertifikata e aktit lindjes ose Fotokopje e aktit të lindjes

Një kopje mbahet ne zyrën e protokollit, një ne zyrën e gjendjes civile dhe një i jepet shtetasit. Ky dokument është me afat ruajtje të përhershme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 8

SHPALLJE MARTESE Nr. _____

Sot, më datë _____/_____/_____, publikohet shpallja e martesës së shtetasve:
(dita) (muaji) (viti)

_____ me _____
(Emri, Mbiemri) (Emri, Mbiemri)

të cilët kërkuan të lidhin martesë në Zyrën e Gjendjes Civile _____.

PËRBERES TË GJENDJES CIVILE	TË DHËNAT E BASHKËSHORTIT TË ARDHSHMËM	TË DHËNAT E BASHKËSHORTES SË ARDHSHME
Emri		
Mbiemri		
Emri i babait		
Emri u nënës		
Numri personal		
Datëlindja		
Vendlindja		
Shtetësia		
Vendbanimi (Adresa)		
Vendqëndrimi (Adresa)		

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Personat, të cilët kanë shkaqe ligjore, duhet të paraqesin brenda 10 ditëve, nga dita e sotme, kundërshtimet për lidhjen e kësaj martese.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 9

VENDIM

Nr. _____ Datë: ___ /___ /_____

PËR
PEZULLIMIN E PROÇEDURËS PËR LIDHJE MARTESE

Në bazë të Nenit _____, të Ligjit Nr. _____, datë ___/___/_____ "Kodi i Familjes", proçedura e lidhjes së marteses ndërmjet _____, dhe _____, shpallur më datë ___/___/_____ në Zyrën e Gjendjes Civile _____, pezullohet për shkak se:

_____

_____

_____

_____

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 10

VENDIM

Nr. _____ **Datë:** ___ /___ / _____

PËR
REFUZIM PËR LIDHJE MARTESE

Unë, _____, nëpunës i Zyrës së Gjendjes Civile _____ në bazë të Nenit _____, të Ligjit Nr. _____, datë ___/___/_____ "Kodi i Familjes", refuzoj lidhjen e martesës ndërmjet shtetasve _____, dhe _____, shpallur më datë ___/___/_____ në Zyrën e Gjendjes Civile _____, për shkak se:

_____

_____

_____

_____

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 11

VENDIM

Nr. _____ **Datë:** ___ /___ / _____

PËR
NDREQJE GABIMI MATERIAL

Sot më datë ___/___/_____ në praninë time, _____, Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile _____, u paraqit shtetasi _____, me numër personal_____, emri i babait _____, emri i nënës _____, i datëlindjes ___/___/_____, vendlindja _____, banues në adresën _____ regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili me anë të kërkesës Nr. _____ Prot., datë ___/___/_____, kërkon ndreqje në rubrikën _____.

Pas verifikimeve rezultoi se dokumentacioni i paraqitur, ishte në përputhje me ligjin.

Për këtë arsye, bazuar në Nenin _____ të Ligjit _____, datë _____. ____. 2009, "Për Gjendjen Civile",

VENDOSA:

Të bëhet ndreqja e gabimit material në rubrikën

_____ nga _____ në _____
_____ nga _____ në _____

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Për çdo ndreqje gabim material, shtetasi duhet të paraqesë certifikatën e marrë nga akti i lindjes si dhe certifikata të të gjitha regjistrimeve pas vitit të lindjes.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 12

LEJE VARRIMI

Për shtetasin _____, i cili vdiq më datë ___/___/_____,
u mbajt akti i vdekjes Nr. ____ , datë ___/___/_____.

Lejohet kryerja e varrimit pas orës ___ : ___ , më datë ___/___/_____.

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 13

Mod. 13

36301965

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____
Zyra e Gjendjes Civile _____

, më ___ ___ ___

ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja			Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri personal
						Dita	Muaji	Viti				
1												
2												
3												
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____
(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 13/1

Mod. 13 / 1

363019465

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QARKU _____, RRETHI _____

Zyra e Gjendjes Civile _____, më ___ . ___ . _____

ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit _____ të vitit _____, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja: Dita	Muaji	Viti	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14

Mod Nr. 14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

353 019 464

BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Pa vulë

_____, më ___ . ___ . _____

ÇERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombetar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 13/1

Mod Nr. 14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË 353 019 464

BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

biolegrama

_____, më ____. ___. _____

ÇERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombetar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14

Mod Nr. 14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË 353 019 464

BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

biolegrama

_____, më ____. ___. _____

ÇERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombetar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____


(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/1



Mod Nr. 14 / 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

353 019 464

hologrami

BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

_____, më ____. ___. _____

ÇERTIFIKATË LINDJE

Në bazë të Aktit të Lindjes Nr. _____., datë ____ . ____ . _____, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____


(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/2



Mod Nr. 14 / 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

353 019 464

hologrami

BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

_____, më ____. ___. _____

ÇERTIFIKATË MARTESE

Në bazë të Regjistrit Kombetar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri		
Mbiemri		
Numri personal		
Emri i babait		
Emri i nënës		
Datëlindja		
Vendlindja		
Vendbanimi (adresa)		
Gjinia		
Gjendja Civile		
Shtetësia		
Data e lidhjes së martesës		
Vendi i lidhjes së martesës		
Mbiemri para/pas martese		

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/3

Mod Nr. 14 / 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË 353 019 464

hologram

BASHKIA / NJËSIA BASHKIAKE / KOMUNA _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

_____, më ____. ____. _____

ÇERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të Regjistrit Kombetar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	
Data e vdekjes	
Vendi i vdekjes	
Shkaku i vdekjes	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/4

Mod Nr. 14 / 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË 353 019 464

hologram

QARKU _____, RRETHI _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

_____, më ____. ____. _____

ÇERTIFIKATË LINDJE

Në bazë të Regjistrit _____, të vitit _____

vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/5

Mod Nr. 14 /5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

353 019 464

hologrami

QARKU _____, RRETHI _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

_____, më ___. ___. _____

ÇERTIFIKATË MARTESE

Në bazë të Librit / Akteve të martesës _____, të vitit _____,

Nr. _____ vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri		
Mbiemri		
Numri personal		
Emri i babait		
Emri i nënës		
Datëlindja		
Vendlindja		
Vendbanimi		
Gjinia		
Gjendja Civile		
Shtetësia		
Data e lidhjes së martesës		
Vendi i lidhjes së martesës		
Mbiemri para/pas martese		

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/6

Mod Nr. 14 /6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

353 019 464

hologrami

QARKU _____, RRETHI _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

_____, më ___. ___. _____

ÇERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të Librit _____, të vitit _____,

Nr. _____ vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	
Data e vdekjes	
Vendi i vdekjes	
Shkaku i vdekjes	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **363 019 465** Mod Nr. 14/7 Holograma

State- Etat – Estado – Staat – Stato – Κράτος Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	Zyra e Gjendjes Civile _____ Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATË LINDJE
Birth Certificate – Certificat de Naissance – Certificado de Nacimiento – Geburtsurkunde
Certificato di Nascita - Πιστοποιητικό Γέννησης

Emri – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα	
Mbiemri – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο	
Numri personal – Personal number – Numéro personnel – Número personal – Personal nummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός	
Emri i babait – Father's name – Prénom du père – Nombre del padre Vorname des vaters – Nome del padre - Όνομα Πατρός	
Emri i nënës – Mother's name - Prénom de la mère – Nombre de la madre – Vorname der mutter – Nome della madre - Όνομα μητρός	
Datëlindja - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	
Vendlindja – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	
Vendbanimi – Place of domicile – Lieu de domicile– Domicilio – Wohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	
Gjinia – Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο	
Gjendja civile – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile Κατάσταση του πολίτη **Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe - Αγαμος/η **i/e Martuar** – Married – Marié/e – Casado/a – Verheiratet – Coniugato/a - Έγγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a – Verwitwet – Vedovo/a - Χήρος/α	□ □ □ □
Shtetësia – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Υπηκοότητα	
Mbiemri para martese – Surname before marriage – Nom avant le mariage – Apellido antes del matrimonio – Geburtsname – Cognome prima del matrimonio - Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο	
Data e lëshimit – Date of issue – Date de délivrance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης **Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula** Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου	_____ _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË **363 019 465** Mod. Nr. 14/8 Holograma

State- Etat – Estado – Staat – Stato – Κράτος Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	Zyra e Gjendjes Civile _____ Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATË PËR LIDHJE MARTESE
Certificate of Capacity to Contract Marriage – Certificat de Capacité à Contracter Mariage – Acta de Matrimonio – Ehefähigkeitszeugnis - Certificato per Contrarre Matrimonio - Πιστοποιητικό για Σύναψη Γάμου

Emri – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα	
Mbiemri – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο	
Numri personal – Personal number –Numéro personnel – Número personal – Personal nummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός	
Datëlindja - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	
Vendlindja – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento - Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	
Vendbanimi – Place of domicile – Lieu de domicile – Domicilio – Wohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	
Gjinia – Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο	
Gjendja civile – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση **Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe/Nubile - Αγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a – Witwer /Witwe – Vedovo/a - Χήρος/α	□ □ □
Shtetësia – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Υπηκοότητα	
Emri – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα	
Mbiemri – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο	
Numri personal – Personal number –Numéro personnel – Número personal – Personal nummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός	
Datëlindja - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum – Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	
Vendlindja – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento - Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	
Vendbanimi – Place of domicile – Lieu de domicile – Domicilio – Wohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	
Gjinia – Sex- Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο	
Gjendja civile – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση **Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe/Nubile - Αγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a –Witwer /Witwe – Vedovo/a - Χήρος/α	□ □ □
Shtetësia – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Υπηκοότητα	
Nuk ka pengesë ligjore për të lidhur martesë në: No legal impediments to contract marriage in – Il n'y a pas d'obstacle légal pour contracter mariage au – No existe impedimento legal para contraer matrimonio a - Keine hindernisse für die eheschließung in – Non ci sono impedimenti per contrarre matrimonio a – Δεν υπάρχει νομικό κώλυμα για το γάμο στη	
Data e lëshimit – Date of issue – Date de déliverance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης **Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula** Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial del Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, επώνυμο, υπογραφή, σφραγίδα του υπαλλήλου του Ληξιαρχείου	_____ _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË 363 019 465 Mod 14 / 9 Holograma

State- Etat – Estado – Staat – Stato – Κράτος Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	Zyra e Gjendjes Civile _____ Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATË MARTESE

Marriage Certificate – Certificat de Mariage – Certificado de Matrimonio – Heiratsurkunde

Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου

Emri – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα		
Mbiemri – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο		
Numri personal – Personal number – Numéro personnel– Número personal – Personal nummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός		
Emri i babait – Father's name – Prénom du père – Nombre del padre Vorname des vaters – Nome del padre - Όνομα πατρός		
Emri i nënës – Mother's name - Prénom de la mère – Nombre de la madre – Vorname der mutter – Nome della madre - Όνομα μητρός		
Datëlindja - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		
Vendlindja – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		
Vendbanimi – Place of domicile – Lieu de domicile - Domicilio – Wohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		
Gjinia – Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο		
Gjendja civile – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile Κατάσταση του πολίτη **Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe/Nubile - Άγαμος/η **i/e Martuar** – Married – Marié/e – Casado/a – Verheiratet – Coniugato/a - Έγγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a –Witwer/Witwe – Vedovo/a - Χήρος/α	☐ ☐ ☐ ☐	☐ ☐ ☐ ☐
Shtetësia – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza – Υπηκοότητα		
Nr., data e aktit të martesës–No., date of marriage act -Nr, date de l'acte de mariage - No. fecha de registro del acta del matrimonio –Nr., Datum der eheschließungsurkunde -Nr, data dell'atto di matrimonio– Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου		
Vendi i lidhjes së martesës – Place of marriage – Lieu du mariage– Lugar donde ocurrió el matrimonio – Ort der eheschließung – Luogo del matrimonio – Τόπος γάμου		
Mbiemri para / pas martese – Surname before/after marriage – Nom avant/après mariage – Apellido antes/despues del matrimonio – Geburtsname/Ehename – Cognome prima/dopo matrimonio - Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο		
Data e lëshimit – Date of issue – Date de délivrance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης **Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula** Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature , Sceau de l'Officier de L'Etat civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial del Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή, Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου,	_____ _____	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/10

Holograma

363 019 465


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA / KOMUNA / NJËSIA BASHKIAKE NR. _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

Mod Nr. 14/11



(Shtuar Modeli me VKM nr. 555, datë 27.8.2014)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Holograma

363019465 **Mod Nr. 15**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie República de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	Zyra e Gjendjes Civile _____ Civil Registry Office Service d'état Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο
ÇERTIFIKATË VDEKJEJE **Death Certificate – Acte de décès – Certificado de la Muerte– Sterbeurkunde** **Certificato della Morte**- Πιστοποιητικό Θανάτου	
Emri – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα	
Mbiemri – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο	
Numri personal – Personal number – Numéro personnel – Número personal – Personalnummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός	
Emri i babait – Father's name – Prénom du père – Nombre del padre Vorname des Vaters – Nome del padre - Όνομα Πατρός	
Emri i nënës – Mother's name - Prénom de la mère – Nombre de la madre – Vorname der Mutter – Nome della madre - Όνομα μητρός	
Datëlindja - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	
Vendlindja – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	
Vendbanimi – Place of residence – Lieu de domicile– Domicilio – Ëohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	
Gjinia – Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο	
Gjendja civile – Civil status – Etat civil - Estado civil – Familienstand – Stato civile Οικογενειακή κατάσταση **Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe - Άγαμος/η **I/e martuar** – Married – Marié/e – Casado/a – Verheiratet – Coniugato/a - Έγγαμος/η **I/e shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **I/e ve** – Ëidoëer/Ëidoë – Veuf/veuve – Viudo/a – Verwitwet – Vedovo/a - Χήρος/α	 □ □ □ □
Shtetësia – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Ιθαγένεια	

Data e vdekjes - Date of death – Date de déccs – Fecha de la muerte - Zeitpunkt des Todes – Data della morte - Ημερομηνία θανάτου	
Data e lëshimit – Date of issue – Date de délivrance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης **Emri, mbiemri, nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, vula** Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature et Cachet de l'Officier d'état civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift des Standesbeamten, Dienstsiegel Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου	_____ _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mod Nr. 16

363019465

Holograma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie República de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	**Zyra e Gjendjes Civile** _____ Civil Registry Office Service de l'état Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

CERTIFIKATË FAMILJARE
FAMILY CERTIFICATE / FICHE FAMILIALE D'ĒTAT CIVIL / CERTIFICADO DE FAMILIA/ AUSZUNG AUS DEM FAMILIENBUCH / CERTIFICATO DI STATO DI FAMIGLIA
ΠΙΣΤΟΠΟΙΗΤΙΚΟ ΟΙΚΟΓΕΝΕΙΑΚΗΣ ΚΑΤΑΣΤΑΣΗΣ

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme / Based upon the National Civil Registry of 2010, the folloëing information is hereby certified/ Sur la base du Registre national de l'état civil 2010, sont certifiées les données suivantes / En la base de la Registraduría Nacional del Estado Civil 2010, está certificada la siguiente información / Gemäß dem Nationalen Standesamtsregister vom Jahr 2010 ëerden folgende Angaben zertifiziert / In base al registro nazionale dello Stato Civile 2010, si certificano i seguenti dati / Βάσει του Εθνικού Μητρώου του Ληξιαρχείου 2010, πιστοποιούνται τα ακόλουθα δεδομένα:

1. Name – Surname ; Prénom – Nom; Nombre – Apellido; Vorname – Familienname; Nome – Cognome; Όνομα – Επώνυμο.
2. Father's name – Prénom du pčre – Nombre del padre - Vorname des Vaters – Nome del padre - Όνομα Πατρός
3. Mother's name - Prénom de la mčre – Nombre de la madre – Vorname der Mutter – Nome della madre - Όνομα μητρός
4. Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο
5. Lidhja me kryefamiljarin / Relation to the head of the household /

Relation avec le chef de famille / Los lazos familiares / Bezug zum Familienoberhaupt/ Relazione con il capofamiglia/ Σχέση με τον οικογενειάρχη.

6. Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως
7. Civil status – Etat civil - Estado civil – Familienstand – Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση
8. Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento - Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως
9. Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Ιθαγένεια
10. Personal number – Numéro personnel – Número personal – Personalnummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός

Nr.	**1 Emri e mbiemri**	*2 Emri i babait*	*3 Emri i nënës*	**4. Gjinia**	**5 Lidhja me K. familjarin**	*6 Datëlindja*			**7 Gjendja civile**	**8 Vendlindja**	**9 Shtetësia**	**10 Numri personal**
						Dita	*Muaji*	*Viti*				
1												
2												
3												
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												
11												

Kjo certifikatë lëshohet për përdorim jashtë vendit / This certificate is issued to be used in a foreign country / La présente Fiche familiale est délivrée afin d'ętre utilisée ŕ l'étranger / El presente certificado se expide para uso en el extranjero / Diese Urkunde ist im Ausland gültig/Il presente certificate viene rilasciato per uso all'estero / Το πιστοποιητικό αυτό εκδίδεται για χρήση στο εξωτερικό.

Emri, mbiemri, nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, vula

Name, Surname, Signature Superintendent registrar

Prénom, Nom, Signature et Cachet de l'Officier d'état civil

Nombre, Apellido, Firma y Sello del Officier de Registro Civil

Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile

Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου

(Shtuar Modeli nr. 17, 17/1, 17/2, 17/3, 17/4 me VKM nr. 432, datë 20.5.2015)

Mod Nr. 17

Mod I4 / 9

Holograma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

363 019 465

State- Etat – Estado – Staat – Stato – Κράτος	Zyra e Gjendjes Civile _____
Republic of Albania	Civil Registry Office
République d'Albanie	Office de l'Etat Civil
Republica de Albania	Servicio del Registro Civil
Republik Albanien	Standesamtsbehörde
Repubblica d'Albania	Ufficio dello Stato Civile
Δημοκρατία της Αλβανίας	Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATË MARTESE

Marriage Certificate – Certificat de Mariage – Certificado de Matrimonio – Heiratsurkunde
Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου

Emri – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα		
Mbiemri – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο		
Numri personal – Personal number – Numéro personnel– Número personal – Personal nummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός		
Emri i babait – Father's name – Prénom du père – Nombre del padre – Vorname des vaters – Nome del padre - Όνομα πατρός		
Emri i nënës – Mother's name - Prénom de la mère – Nombre de la madre – Vorname der mutter – Nome della madre - Όνομα μητρός		
Datëlindja - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		
Vendlindja – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento – Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		
Vendbanimi – Place of domicile – Lieu de domicile - Domicilio – Wohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		
Gjinia – Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο		
Gjendja civile – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile Κατάσταση του πολίτη **Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe/Nubile - Άγαμος/η **i/e Martuar** – Married – Marié/e – Casado/a – Verheiratet – Coniugato/a - Έγγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a –Witwer/Witwe – Vedovo/a - Χήρος/α	☐ ☐ ☐ ☐	☐ ☐ ☐ ☐
Shtetësia – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Υπηκοότητα		
Nr., data e aktit të martesës–No., date of marriage act -Nr, date de l'acte de mariage - No. fecha de registro del acta del matrimonio –Nr., Datum der eheschließungsurkunde -Nr, data dell'atto di matrimonio– Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου		
Vendi i lidhjes së martesës – Place of marriage – Lieu du mariage– Lugar donde ocurrió el matrimonio – Ort der eheschließung – Luogo del matrimonio – Τόπος γάμου		
Mbiemri para / pas martese – Surname before/after marriage – Nom avant/après mariage – Apellido antes/despues del matrimonio – Geburtsname/Ehename – Cognome prima/dopo matrimonio - Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο		
Data e lëshimit – Date of issue – Date de délivrance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης **Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula** Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature , Sceau de l'Officier de L'Etat civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial del Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Ονομα, Επώνυμο, Υπογραφή, Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου,	_____ _____	

Mod Nr. 17.1

267646

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome
Republic of Albania	Civil Registry Office
République d'Albanie	Office de l'Etat Civil
Republica de Albania	Servicio del Registro Civil
Republik Albanien	Standesamtsbehörde
Repubblica d'Albania	Ufficio dello Stato Civile
Δημοκρατία της Αλβανία	Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATË PER LIDHJE MARTESE

Certificate of Capacity to Contract Marriage - Certificat de Capacité à Contracter Mariage - Acta de Matrimonio - Ehefähigkeitszeugnis - Certificato per Contrarre Matrimonio - Πιστοποιητικό για Σύναψη Γάμου

Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Όνομα	Arian
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο	SOJLI
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal nummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός	H20915188H
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	15-09-1972
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	Berat, Berat, ALB
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	bbbb 0000/000/00 0000 Berat
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο	M
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση **Beqar/e** - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α	☐ x ☐
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα	ALB
Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Όνομα	Monik
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο	SOJLI
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal nummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός	H85120230A
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	20-01-1978
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	Durrës, Durrës, ALB
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	aaaaa 000/000/00 0000 Berat
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο	F
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση **Beqar/e** - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α	x ☐ ☐
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα	ALB
Nuk ka pengesë ligjore për të lidhur martesë në: No legal impediments to contract marriage in - Il n'y a pas d'obstacle légal pour contracter mariage au - No existe impedimento legal para contraer matrimonio a - Keine Hindernisse für die Eheschließung in - Non ci sono impedimenti per contrarre matrimonio a – Δεν υπάρχει νομικό κώλυμα για το γάμο στη	Manëz
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης	07-04-2015
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Ονομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου	Miranda Harizaj

Mod Nr. 17.2

267646

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma
Republic of Albania	Civil Registry Office
République d'Albanie	Office de l'Etat Civil
Republica de Albania	Servicio del Registro Civil
Republik Albanien	Standesamtsbehörde
Repubblica d'Albania	Ufficio dello Stato Civile
Δημοκρατία της Αλβανίας	Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATE MARTESE

Marriage Certificate - Certificat de Mariage - Certificado de Matrimonio - Heiratsurkunde
Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου

Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Ονομα	Artan	Monik
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο	SOJLI	SOJLI
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal nummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός	H20915188H	H85120230A
Emri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Ονομα Πατρός	Gilbert	Altin
Emri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Ονομα μητρός	Anjola	Ana
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	15-09-1972	20-01-1978
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	Berat, Berat, ALB	Durrës, Durrës, ALB
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	bbbb 0000/000/00 0000 Berat	bbbb 0000/000/00 0000 Berat
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο	M	F
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Κατάσταση του πολίτη		
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η	□	□
i/e Martuar - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η	x	x
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η	□	□
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α	□	□
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα	ALB	ALB
Nr.,data e aktit të martesës - No.,date of marriage act - No.,date de l'acte de mariage - No.,fecha de registro del acta del matrimonio - Nr.,Datum der Eheschließungsurkunde - No.,data dell'atto di matrimonio - Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου	No. 1 Date 31-03-2015	
Vendi i lidhjes së martesës - Place of marriage - Lieu du mariage - Lugar donde ocurrió el matrimonio - Ort der Eheschließung - Luogo del matrimonio - Τόπος γάμου	Manëz	
Mbiemri para martese - Surname before marriage - Nom avant mariage - Apellido antes del matrimonio - Geburtsname - Cognome prima matrimonio - Επώνυμο πριν το γάμο	Sojli	Sojli
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης	07-04-2015	
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου τοῦ Ληξιαρχείου	Miranda Harizaj	

Mod Nr. 17.3

267646

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma
Republic of Albania	Civil Registry Office
République d'Albanie	Office de l'Etat Civil
Republica de Albania	Servicio del Registro Civil
Republik Albanien	Standesamtsbehörde
Repubblica d'Albania	Ufficio dello Stato Civile
Δημοκρατία της Αλβανίας	Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATE VDEKJE

Death Certificate - Certificat de Décès - Certificado de Defunción - Sterbeurkunde
Certificato della Morte - Πιστοποιητικό Θανάτου

Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Ονομα	Monika
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο	SOJLI
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal nummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός	L55330001J
Emri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Ονομα Πατρός	Alban
Emri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Ονομα μητρός	Emira
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως	30-03-1986
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως	Tiranë, Tiranë, ALB
Vendbanimi - Place of residence - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας	Ali Demi 000/000/000 0000 Njesia bashkiake nr. 1
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο	F
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Familienstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση **Beqar/e** - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe - Άγαμος/η **i/e Martuar** - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η **i/e Shkurorëzuar** - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **i/e Ve** - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Verwitwet - Vedovo/a - Χήρος/α	x □ □ □
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Ιθαγένεια	ALB
Data e vdekjes - Date of death - Date du Décès - Fecha de la muerte - Zeitpunkt des Todes - Data della morte - Ημερομηνία θανάτου	07-04-2015
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης	07-04-2015
Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula Name, Surname, Signature and Seal of Keeper Prénom, Nom, Signature et Cachet de l'Officier d'état civil Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil Vorname, Familienname, Unterschrift des Standesbeamten, Dienstsiegel Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου	Miranda Harizaj

100

000942201

Tirane 501 , më 07.04.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	Zyra e Gjendjes Civile Ambasada Rome / Ambasciata dell' Albania, Roma Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

CERTIFIKATË FAMILJARE
FAMILY CERTIFICATE / FICHE FAMILIALE D'ÉTAT CIVIL / CERTIFICADO DE FAMILIA/
AUSZUNG AUS DEM FAMILIENBUCH / CERTIFICATO DI STATO DI FAMIGLIA/
ΠΙΣΤΟΠΟΙΗΤΙΚΟ ΟΙΚΟΓΕΝΕΙΑΚΗΣ ΚΑΤΑΣΤΑΣΗΣ

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme / Based upon the National Civil Registry of 2010, the following information is hereby certified/ Sur la base du Registre national de l'état civil 2010, sont certifiées les données suivantes / En la base de la Registraduría Nacional del Estado Civil 2010, está certificada la siguiente información / Gemäß dem Nationalen Standesamtsregister vom Jahr 2010 werden folgende Angaben zertifiziert / In base al registro nazionale dello Stato Civile 2010, si certificano i seguenti dati / Βάσει του Εθνικού Μητρώου του Ληξιαρχείου 2010, πιστοποιούνται τα ακόλουθα δεδομένα:

1. Name - Surname ; Prénom - Nom; Nombre - Apellido; Vorname - Familienname; Nome - Cognome; Όνομα - Επώνυμο.
2. Father`s name - Prénom du père - Nombre del padre - Vorname des Vaters - Nome del padre - Όνομα Πατρός
3. Mother`s name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der Mutter - Nome della madre - Όνομα μητρός
4. Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο
5. Lidhja me kryefamiljarin / Relation to the head of the household / Relation avec le chef de famille / Los lazos familiars / Bezug zum Familienoberhaupt / Relazione con il capofamiglia / Σχέση με τον οικογενειάρχη
6. Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως
7. Civil status - Etat civil - Estado civil - Familienstand - Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση
8. Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως
9. Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Ιθαγένεια
10. Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personalnummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός

Faqe 1 nga 2

Mjedis testimi

Mod Nr. 17.4

101

000942201

Nr.	1 Emri e mbiemri	2 Emri i babait	3 Emri i nënës	4 Gjinia	5 Lidhja me K. Familjarin	6 Datëlindja			7 Gjendja Civile	8 Vendlindja	9 Shtetësia	10 Numri personal
						Dita	Muaji	Viti				
1.	Monik SOJLI	Altin	Ana	F	I panj.	20	01	1978	I/e martuar	Durrës, Durrës, ALB	Shqipëri	H85120230A
2.	----------											
3.	----------											
4.	----------											
5.	----------											
6.	----------											
7.	----------											
8.	----------											
9.	----------											
10.	----------											
11.	----------											
12.	----------											
13.	----------											
14.	----------											
15.	----------											

Kjo certifikatë lëshohet për përdorim jashtë vendit / This certificate is issued to be used in a foreign country / La présente Fiche familiale est délivrée afin d'être utilisée à l'étranger / El presente certificado se expide para uso en el extranjero / Diese Urkunde ist im Ausland gültig/ Il presente certificate viene rilasciato per uso all'estero / Το πιστοποιητικό αυτό εκδίδεται για χρήση στο εξωτερικό.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula
Name, Surname, Signature Superintendent registrar
Prénom, Nom, Signature et Cachet de l'Officier d'état civil
Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial de Registro Civil
Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten
Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile
Όνομα, Επώνυμο, Υπογραφή και Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου

Miranda Harizaj

Faqe 2 nga 2

Mjedis testimi

Mod Nr. 17.4

(Shtuar me VKM nr. 496, datë 13.9.2017)

Model nr. 1 (elektronik)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA , NJESIA ADMINISTRATIVE

ÇERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombetar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhenat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri personal	
Emri i babait	
Emri i nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo çertifikate lëshohet për _____

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Pergj.Fashme e Gjendjes Civile
Date:2017/09/11 10:52:25 +02:00
150761121

Shenim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)

Model nr. 2 (elektronik)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA , NJESIA ADMINISTRATIVE

ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja		Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetesia	Numri personal
						Dita	Muaji	Viti			
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Pergj.Fashme e Gjendjes Civile
Date:2017/09/11 10:58:43 +02:00
86316515

Shenim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)

(Shtuar modeli 3-19 me vendimin nr. 761, datë 13.12.2024)

Mod. Nr. 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia
Njësia administrative
Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË LINDJE (NGA AKTI)

Në bazë të aktit të lindjes nr. datë vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri Personal	
Emri i Babait	
Emri i Nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vula digjitale

Mod. nr.3

Mod. Nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Αλβανική Δημοκρατία	Zyra e Gjendjes Civile Office of Civil Registry Office de l'Etat Civil Oficina de Registro Civil Standesamt Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

CERTIFIKATË LINDJE
Birth Certificate / Certificat de Naissance / Certificado de Nacimiento / Geburtsurkunde
Certificato di Nascita / Πιστοποιητικό Γέννησης

Emri / Name / Prénom / Nombre / Vorname / Nome / Όνομα	
Mbiemri / Surname / Nom /Apellido / Familienname / Cognome / επώνυμο	
Numri personal / Personal number /Numéro personnel / Numero personal / Personalnummer / Numero personale / Προσωπικός αριθμός	
Emri i babait / Father's name / Prénom du père / Nombre del padre / Vorname des Vaters / Nome del padre / Όνομα Πατρός	
Emri i nënës / Mother's name / Prénom de la mère / Nombre de la madre / Vorname der Mutter / Nome della madre / Όνομα μητρός	
Datëlindja / Date of birth / Date de naissance / Fecha de nacimiento / Geburtsdatum / Data di nascita / Ημερομηνία γεννήσεως	
Vendlindja / Place of birth / Lieu de naissance / Lugar de nacimiento / Geburtsort / Luogo di nascita / Τόπος γεννήσεως	
Vendbanimi / Place of domicile / Lieu de domicile / Domicilio / Wohnort / Luogo di domicilio / Τόπος κατοικίας	
Gjinia / Gender / Sexe / Sexo / Geschlecht / Sesso / Φύλο	
Gjendja civile / Civil status / Etat civil / Estado civil / Zivilstand / Stato civile / Κατάσταση του πολίτη **Beqar/e** / Single / Célibataire / Soltero/a / Ledig / Celibe / Nubile / Άγαμος/η **I/e Martuar** / Married / Marié/e / Casado/a / Verheiratet / Coniugato/a / Έγγαμος/η **I/e Shkurorëzuar** / Divorced / Divorcé/e / Divorciado/a / Geschieden / Divorziato/a / Διαζευγμένος/η **I/e Ve** / Widow/er / Veuf/veuve / Viudo/a / Verwitwet / Vedovo/a / Χήρος/α	
Shtetësia / Citizenship / Citoyenneté / Nacionalidad / Staatsangehörigkeit / Cittadinanza / Υπηκοότητα	
Mbiemri para martese / Maiden name / Nom de jeune fille / Apellido de soltero/a / Geburtsname / Nome da nubile / Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο	
Data e lëshimit / Date of issuance / Date de délivrance / Fecha de expedición / Ausstellungsdatum / Data del rilascio / Ημερομηνία έκδοσης	

Vula digjitale

Mod. nr.4

Mod Nr. 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia
Njësia administrative
Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË MARTESE (NGA AKTI)

Në bazë të aktit të martesës nr. datë vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri		
Mbiemri		
Numri Personal		
Emri i Babait		
Emri i Nënës		
Datëlindja		
Vendlindja		
Vendbanimi (adresa)		
Gjinia		
Gjendja Civile		
Shtetësia		
Data e lidhjes së martesës		
Vendi i lidhjes së martesës		
Mbiemri para/pas martese		

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vula digjitale

Mod. nr.5

Mod Nr. 6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia
Njësia administrative
Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË MARTESE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri		
Mbiemri		
Numri Personal		
Emri i Babait		
Emri i Nënës		
Datëlindja		
Vendlindja		
Vendbanimi (adresa)		
Gjinia		
Gjendja Civile		
Shtetësia		
Data e lidhjes së martesës		
Vendi i lidhjes së martesës		
Mbiemri para/pas martese		

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vula digjitale

Mod. nr.6

Mod Nr. 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Αλβανική Δημοκρατία	Zyra e Gjendjes Civile Office of Civil Registry Office de l'Etat Civil Oficina de Registro Civil Standesamt Rathaus Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο Δήμος

CERTIFIKATE MARTESE

Marriage Certificate - Certificat de Mariage - Certificado de Matrimonio - Heiratsurkunde
Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου

Emri / Name / Prénom / Nombre / Vorname / Nome / Όνομα		
Mbiemri / Surname / Nom /Apellido / Familiennname / Cognome / Επώνυμο		
Numri personal / Personal number /Numéro personnel / Numero personal / Personalnummer / Numero personale / Προσωπικός αριθμός		
Emri i babait / Father's name / Prénom du père / Nombre del padre / Vorname des Vaters / Nome del padre / Όνομα Πατρός		
Emri i nënës / Mother's name / Prénom de la mère / Nombre de la madre / Vorname der Mutter / Nome della madre / Όνομα μητρός		
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		
Gjinia / Gender / Sexe / Sexo / Geschlecht / Sesso / Φύλο		
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Κατάσταση του πολίτη **Beqar/e** - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η **I/e Martuar** - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η **I/e Shkurorëzuar** - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **I/e Ve** - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α	□	□
Shtetësia / Citizenship / Citoyenneté / Nacionalidad / Staatsangehörigkeit / Cittadinanza / Υπηκοότητα		
Nr.,data e aktit të martesës - No.,date of marriage act - No.,date de l'acte de mariage - No.,fecha de registro del acta del matrimonio - Nr.,Datum der Eheschließungsurkunde - No.,data dell'atto di matrimonio - Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου		
Vendi i lidhjes së martesës - Place of marriage - Lieu du mariage - Lugar donde ocurrió el matrimonio - Ort der Eheschließung - Luogo del matrimonio - Τόπος γάμου		
Mbiemri para martese - Surname before marriage - Nom avant mariage - Apellido antes del matrimonio - Geburtsname - Cognome prima matrimonio - Επώνυμο πριν το γάμο		
Data e lëshimit / Date of issuance / Date de délivrance / Fecha de expedición / Ausstellungsdatum / Data del rilascio / Ημερομηνία χορήγησης		

Vula digjitale

Mod Nr. 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	Zyra e Gjendjes Civile Office of Civil Registry Office de l'Etat Civil Oficina de Registro Civil Standesamt Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

CERTIFIKATE MARTESE (NGA AKTI)

Marriage Certificate (from the Act) - Certificat de Mariage (de l'acte) - Certificado de Matrimonio (Del acto) - Heiratsurkunde (aus der Akte) - Certificato di Matrimonio (dall'atto) - Πιστοποιητικό Γάμου (από την πράξη)

Emri / Name / Prénom / Nombre / Vorname / Nome / Όνομα		
Mbiemri / Surname / Nom /Apellido / Familiennname / Cognome / Επώνυμο		
Numri personal / Personal number /Numéro personnel / Numero personal / Personalnummer / Numero personale / Προσωπικός αριθμός		
Emri i babait / Father's name / Prénom du père / Nombre del padre / Vorname des Vaters / Nome del padre / Όνομα Πατρός		
Emri i nënës / Mother's name / Prénom de la mère / Nombre de la madre / Vorname der Mutter / Nome della madre /Όνομα μητρός		
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento - Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile - Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		
Gjinia / Gender / Sexe / Sexo / Geschlecht / Sesso / Φύλο		
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile - Κατάσταση του πολίτη **Beqar/e** - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe/Nubile - Άγαμος/η **I/e Martuar** - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η **I/e Shkurorëzuar** - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η **I/e Ve** - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Witwer/Witwe - Vedovo/a - Χήρος/α	□	□
Shtetësia / Citizenship / Citoyenneté / Nacionalidad / Staatsangehörigkeit / Cittadinanza / Υπηκοότητα		
Nr.,data e aktit të martesës - No.,date of marriage act - No.,date de l'acte de mariage - No.,fecha de registro del acta del matrimonio - Nr.,Datum der Eheschließungsurkunde - No.,data dell'atto di matrimonio - Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου		
Vendi i lidhjes së martesës - Place of marriage - Lieu du mariage - Lugar donde ocurrió el matrimonio - Ort der Eheschließung - Luogo del matrimonio - Τόπος γάμου		
Mbiemri pas martese - Surname after marriage - Nom après mariage - Apellido despues del matrimonio - Ehename - Cognome dopo matrimonio - Επώνυμο μετά το γάμο		
Data e lëshimit / Date of issuance / Date de délivrance / Fecha de expedición / Ausstellungsdatum / Data del rilascio / Ημερομηνία χορήγησης		

Vula digjitale

Mod. nr.8

Mod Nr. 9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia
Njësia administrative
Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË VDEKJE (NGA AKTI)

Në bazë të aktit të vdekjes nr. datë vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri Personal	
Emri i Babait	
Emri i Nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	
Data e vdekjes	
Vendi i vdekjes	
Shkaku i vdekjes	

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Mod. nr.9

Mod Nr. 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË	Zyra e Gjendjes Civile
Republic of Albania	Office of Civil Registry
République d'Albanie	Office de l'Etat Civil
Republica de Albania	Oficina de Registro Civil
Republik Albanien	Standesamt Rathaus
Repubblica d'Albania	Ufficio dello Stato Civile
Αλβανική Δημοκρατία	Ληξιαρχείο Δήμος

CERTIFIKATE VDEKJE
Death Certificate - Certificat de Décès - Certificado de Defunción - Sterbeurkunde
Certificato della Morte - Πιστοποιητικό Θανάτου

Emri / Name / Prénom / Nombre / Vorname / Nome / Όνομα	
Mbiemri / Surname / Nom /Apellido / Familienname / Cognome / πώνυμο	
Numri personal / Personal number /Numéro personnel / Numero personal / Personalnummer / Numero personale / Προσωπικός αριθμός	
Emri i babait / Father's name / Prénom du père / Nombre del padre / Vorname des Vaters / Nome del padre / Όνομα Πατρός	
Emri i nënës / Mother's name / Prénom de la mère / Nombre de la madre / Vorname der Mutter / Nome della madre / Όνομα μητρός	
Datëlindja / Date of birth / Date de naissance / Fecha de nacimiento / Geburtsdatum / Data di nascita / Ημερομηνία γεννήσεως	
Vendlindja / Place of birth / Lieu de naissance / Lugar de nacimiento / Geburtsort / Luogo di nascita / Τόπος γεννήσεως	
Vendbanimi / Place of domicile / Lieu de domicile / Domicilio / Wohnort / Luogo di domicilio / Τόπος κατοικίας	
Gjinia / Gender / Sexe / Sexo / Geschlecht / Sesso / Φύλο	
Gjendja civile / Civil status / Etat civil / Estado civil / Zivilstand / Stato civile / Κατάσταση του πολίτη **Beqarë** / Single / Célibataire / Soltero/a / Ledig / Celibe / Nubile / Άγαμος/η **I/e Martuar** / Married / Marié/e / Casado/a / Verheiratet / Coniugato/a / Έγγαμος/η **I/e Shkurorëzuar** / Divorced / Divorcé/e / Divorciado/a / Geschieden / Divorziato/a / Διαζευγμένος/η **I/e Ve** / Widow/er / Veuf/veuve / Viudo/a / Verwitwet / Vedovo/a / Χήρος/α	□ □ □ □
Shtetësia / Citizenship / Citoyenneté / Nacionalidad / Staatsangehörigkeit / Cittadinanza / Υπηκοότητα	
Data e vdekjes - Date of death - Date du Décès - Fecha de la muerte - Zeitpunkt des Todes Data della morte - Ημερομηνία θανάτου	
Data e lëshimit / Date of issuance / Date de délivrance / Fecha de expedición / Ausstellungsdatum / Data del rilascio / Ημερομηνία έκδοσης	

Vula digjitale

Mod. nr. 10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia
Njësia administrative
Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri Personal	
Emri i Babait	
Emri i Nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	
Data e vdekjes	
Vendi i vdekjes	
Shkaku i vdekjes	

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Republic of Albania
République de l'Albanie
Republik Albanien
Repubblica d'Albania
Αλβανική Δημοκρατία

Zyra e Gjendjes Civile
Office of Civil Registry
Office de l'Etat Civil
Oficina de Registro Civil
Standesamt Rathaus
Ufficio dello Stato Civile
Ληξιαρχείο Δήμος

CERTIFIKATË FAMILJARE
FAMILY CERTIFICATE / CERTIFICAT DE FAMILLE / CERTIFICADO FAMILIAR / FAMILIENZERTIFIKAT / CERTIFICATO DI FAMIGLIA/ ΟΙΚΟΓΕΝΕΙΑΚΟ ΠΙΣΤΟΠΟΙΗΤΙΚΟ

Faqe 1 nga 2

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme / Based on the National Civil Register of 2010, the following information is certified / Sur la base du registre national de l'état civil 2010, les informations suivantes sont certifiées / Basado en el Registro Nacional de Estado Civil 2010, la siguiente información está certificada / Basierend auf dem Nationalen Zivilregister von 2010 sind die folgenden Informationen zertifiziert / Sulla base del registro civile nazionale del 2010, si certificano i seguenti dati / Βάσει του Εθνικού Δημάτολογίου έτους 2010, πιστοποιούνται τα ακόλουθα στοιχεία: Βάσει του Εθνικού Μητρώου του Ληξιαρχείου 2010, πιστοποιούνται τα ακόλουθα δεδομένα:

1. Name – Surname / Prénom – Nom de famille / Nombre – Apellido / Vorname – Familienname / Nome – Cognome / Ονομα – Επώνυμο
2. Father's Name / Prénom du Père / Nombre del Padre / Vorname des Vaters / Nome del Padre / Ονομα Πατρός
3. Mother's Name / Prénom de la Mère / Nombre de la Madre / Vorname der Mutter / Nome della Madre / Ονομα Μητρός
4. Gender / Sexe / Sexo / Geschlecht / Genere / Φύλο
5. Relation to Head of Household / Liens Familiaux avec le Chef de Famille / Relación con el Titular del Hogar Familiar / Familienbeziehung / Relazione con il Capofamiglia / Οικογενειακοί δεσμοί
6. Date of Birth / Date de Naissance / Fecha de Nacimiento / Geburtsdatum / Data di Nascita / Ημερομηνία γεννήσεως
7. Civil Status / Etat Civil / Estado Civil / Zivilstand / Stato Civile / Κατάσταση του πολίτη
8. Place of Birth / Lieu de Naissance / Lugar de Nacimiento / Geburtsort / Luogo di Nascita / Τόπος Γεννήσεως
9. Citizenship / Citoyenneté / Nacionalidad / Staatsangehörigkeit / Cittadinanza / Υπηκοότητα
10. Personal Number / Numéro Personnel / Numero Personal / Personalnummer / Numero Personale / Προσωπικός Αριθμός

Nr.	1. Emri e Mbiemri	2. Emri i Babait	3. Emri i Nënës	4. Gjinia	5. Lidhja me K. Familjarin	6. Datëlindja			7. Gjendja Civile	8. Vendlindja	9. Shtetësia	10. Numri Personal
						Dita	Muaji	Viti				
1.												
2.												
3.												
4.												
5.												
6.												
7.												
8.												
9.												
10.												

Kjo certifikatë lëshohet për përdorim jashtë vendit. / This certificate is issued for usage abroad. / Ce certificat est délivré pour usage à l'étranger. / El presente se expide a efectos de trámites en el extranjero. / Dieses Zertifikat wird für die Verwendung im Ausland ausgestellt. / Il presente certificato viene rilasciato per uso all'estero. / Το παρόν πιστοποιητικό χορηγείται για χρήση στο εξωτερικό.

Vula Digjitale

Mod. nr. 12

Faqe 2 nga 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia

Njësia administrative

Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri Personal	
Emri i Babait	
Emri i Nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

nri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Vula digjitale

Mod. Nr. 13

Mod Nr. 14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU , RRETHI
Zyra e Gjendjes Civile **(Arkiva)**

Tiranë . më

ÇERTIFIKATË **Martese (nga Akti)**

Në bazë të Librit / Akteve të martesës: Akt Martese , te vitit

vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërësit e Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri		
Mbiemri		
Numri personal		
Emri i babait		
Emri i nënës		
Datëlindja		
Vendlindja		
Vendbanimi		
Gjinia		
Gjendja Civile		
Shtetësia	-	-
Data e lidhjes së martesës	Date:	
Vendi i lidhjes së martesës		
Mbiemri para/pas martese		

Kjo çertifikatë lëshohet për

Nënpunësi i Gjendjes Civile

(nënshkrimi, vula)

Vula digjitale

Mod. Nr. 14

Mod Nr. 15

State- Etat - Estado - Staat - Stato - Κράτος Republic of Albania République d'Albanie Republica de Albania Republik Albanien Repubblica d'Albania Δημοκρατία της Αλβανίας	ZGJC (Arkiva) Civil Registry Office Office de l'Etat Civil Servicio del Registro Civil Standesamtsbehörde Ufficio dello Stato Civile Ληξιαρχείο

ÇERTIFIKATE MARTESE
Marriage Certificate - Certificat de Mariage - Certificado de Matrimonio - Heiratsurkunde
Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου

Emri - Name - Prénom - Nombre - Vorname - Nome - Όνομα		
Mbiemri - Surname - Nom - Apellido - Familienname - Cognome - Επώνυμο		
Numri personal - Personal number - Numéro personnel - Número personal - Personal nummer - Numero personale - Προσωπικός αριθμός		
Emri i babait - Father's name - Prénom du père - Nombre del padre Vorname des vaters - Nome del padre - Όνομα Πατρός		
Emri i nënës - Mother's name - Prénom de la mère - Nombre de la madre - Vorname der mutter - Nome della madre - Όνομα μητρός		
Datëlindja - Date of birth - Date de naissance - Fecha de nacimiento - Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως		
Vendlindja - Place of birth - Lieu de naissance - Lugar de nacimiento Geburtsort - Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως		
Vendbanimi - Place of domicile - Lieu de domicile- Domicilio - Wohnort - Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας		
Gjinia - Sex - Sexe - Sexo - Geschlecht - Sesso - Φύλο		
Gjendja civile - Civil status - Etat civil - Estado civil - Zivilstand - Stato civile Κατάσταση του πολίτη		
Beqar/e - Single - Célibataire - Soltero/a - Ledig - Celibe - Άγαμος/η		
i/e Martuar - Married - Marié/e - Casado/a - Verheiratet - Coniugato/a - Έγγαμος/η	☐	☐
i/e Shkurorëzuar - Divorced - Divorcé/e - Divorciado/a - Geschieden - Divorziato/a - Διαζευγμένος/η	☐	☐
i/e Ve - Widower/Widow - Veuf/veuve - Viudo/a - Verwitwet - Vedovo/a - Χήρος/α	☐	☐
Shtetësia - Citizenship - Citoyenneté - Ciudadanía - Staatsangehörigkeit - Cittadinanza - Υπηκοότητα		
Nr., data e aktit të martesës-No., date of marriage act -Nº, date de l'acte de mariage - No. fecha de registro del acta del matrimonio -Nr., Datum der eheschließungsurkunde -Nº, data dell'atto di matrimonio- Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου	Akt no. Date:	
Vendi i lidhjes së martesës - Place of marriage - Lieu du mariage- Lugar donde ocurrió el matrimonio - Ort der eheschließung - Luogo del matrimonio - Τόπος γάμου		
Mbiemri para / pas martese - Surname before/after marriage - Nom avant/après mariage - Apellido antes/despues del matrimonio - Geburtsname/Ehename - Cognome prima/dopo matrimonio - Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο		
Data e lëshimit - Date of issue - Date de délivrance - Fecha de expedición - Ausstellungsdatum - Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης		

Vula digjitale

Mod. Nr. 15

Mod Nr. 16

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia

Njësia administrative

Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË MARTESE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Përbërës të Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri		
Mbiemri		
Numri Personal		
Emri i Babait		
Emri i Nënës		
Datëlindja		
Vendlindja		
Vendbanimi (adresa)		
Gjinia		
Gjendja Civile		
Shtetësia		
Data e lidhjes së martesës		
Vendi i lidhjes së martesës		
Mbiemri para/pas martese		

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Vula digjitale

_____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Mod. Nr. 16

Mod Nr. 17

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia

Njësia administrative

Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	
Mbiemri	
Numri Personal	
Emri i Babait	
Emri i Nënës	
Datëlindja	
Vendlindja	
Vendbanimi	
Gjinia	
Gjendja Civile	
Shtetësia	
Data e vdekjes	
Vendi i vdekjes	
Shkaku i vdekjes	

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile


Vula digjitale

_____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Mod. Nr. 17

120



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia
Njësia administrative
Zyra e Gjendjes Civile

Datë:

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Nëpunësi i Gjendjes Civile

_____

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Mod. Nr. 18

Faqe 1 nga 1

Shënim : Ky dokument është gjenerur dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përpunimeve e Gjendjes Civile)

Mod Nr. 18

121

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU , RRETHI
Zyra e Gjendjes Civile **(Arkiva)** Bashkia

Tiranë , më

ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit , të vitit 1950-1974 vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia	Lidhja me K.familjarin	Datëlindja			Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia
						Dita	Muaji	Viti			
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											

Kjo çertifikatë lëshohet për DOKUMENT

Nënpunësi i Gjendjes Civile

Faqe nr.1 nga 1

Mod. Nr. 19

Mod Nr. 19

LIDHJA Nr. 2

QARKU BERAT			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Berat			001
	Berat, Rajoni Nr. 1		002
	Berat, Rajoni Nr. 2		003
	Berat, Rajoni Nr. 3		004
	Dimal		005
		Kutalli	006
		Lumas	007
		Otllak	008
		Poshnje	009
		Roshnik	010
		Sinje	011
		Terpan	012
		Velabisht	013
		Vertop	014
		Cukalat	015
Kuçovë			016
	Kuçovë		017
		Kozarë	018
		Perondi	019
Skrapar			020
	Çorovodë		021
	Poliçan		022
		Bogovë	023
		Çepan	024
		Gjerbës	025
		Leshnjë	026
		Potom	027
		Qender	028
		Vendreshë	029
		Zhepë	030

QARKU DIBER			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Dibër			**031**
	Peshkopi		032
		Arras	033
		Fushë Çidhen	034
		Fushë Muhurr	035
		Kala e Dodës	036
		Kastriot	037
		Lure	038
		Luzni	039
		Maqellarë	040
		Melan	041
		Tomin	042
		Selishtë	043
		Sllovë	044
		Zall Dardhe	045
		Zall Reç	046
Mat			047
	Burrel		048
	Klos		049
		Derjan	050
		Gurrë	051
		Baz	052
		Komsi	053
		Lis	054
		Macukull	055
		Rukaj	056
		Suç	057
		Ulëz	058
		Xibër	059
Bulqizë			060
	Bulqizë		061
		Gjoricë	062
		Trebisht	063
		Martanesh	064
		Ostren	065
		Shupenzë	066
		Zerqan	067
		Fushë Bulqizë	068

QARKU DURRES			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Durrës			069
	Durrës, Rajoni 1		070
	Durrës, Rajoni 2		071
	Durrës, Rajoni 3		072
	Durrës, Rajoni 4		073
	Durrës, Rajoni 5		074
	Manëz		075
	Sukth		076
	Shijak		077
		Gjepalaj	078
		Ishëm	079
		Katund i ri	080
		Maminas	081
		Rrashbull	082
		Xhafzotaj	083
Krujë			084
	Krujë		085
	Fushë Krujë		086
		Bubq	087
		Cudhi	088
		Thumanë	089
		Nikël	090

QARKU ELBASAN			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Elbasan			091
	Elbasan, Rajoni Nr. 1		092
	Elbasan, Rajoni Nr. 2		093
	Elbasan, Rajoni Nr. 3		094
	Elbasan, Rajoni Nr. 4		095
	Elbasan, Rajoni Nr. 5		096
	Cërrik		097
	Belsh		098
		Bradashesh	099
		Fierze	100
		Funarë	101
		Gostimë	102
		Gracen	103

		Grekan	104
		Gjinar	105
		Gjergjan	106
		Kajan	107
		Klos	108
		Labinot-Mal	109
		Labinot-Fushë	110
		Mollas	111
		Papër	112
		Rrasë	113
		Shales	114
		Shirgjan	115
		Shushicë	116
		Tregan	117
		Zavalinë	118
Gramsh			119
	Gramsh		120
		Kodovjat	121
		Kukur	122
		Kushovë	123
		Lenie	124
		Pishaj	125
		Poroçan	126
		Skënderbegas	127
		Sult	128
		Tunjë	129
Peqin			130
	Peqin		131
		Karinë	132
		Gjocaj	133
		Pajovë	134
		Përparim	135
		Shezë	136
Librazhd			137
	Librazhd		138
	Prrenjas		139
		Hotolisht	140
		Lunik	141
		Orenjë	142
		Polis	143
		Qender	144

		Qukës	145
		Rajcë	146
		Stravaj	147
		Steblevë	148

QARKU FIER			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Fier			149
	Fier, Rajoni 1		150
	Fier, Rajoni 2		151
	Fier, Rajoni 3		152
	Fier, Rajoni 4		153
	Patos		154
	Roskovec		155
		Cakran	156
		Dermenas	157
		Frakull	158
		Kuman	159
		Kurjan	160
		Libofsh	161
		Levan	162
		Mbrostar	163
		Portez	164
		Qender Fier	165
		Ruzhdie	166
		Strum	167
		Topojë	168
		Zharëz	169
Lushnjë			170
	Lushnje, Rajoni 1		171
	Lushnje, Rajoni 2		172
	Divjakë		173
		Allkaj	174
		Ballagat	175
		Bubullimë	176
		Dushk	177
		Fier Shegan	178
		Golem	179
		Grabian	180
		Gradishtë	181

		Hysgjokaj	182
		Karbunarë	183
		Kolonjë	184
		Krutje	185
		Remas	186
		Tërbuf	187
Mallakastër			188
	Ballsh		189
		Aranitas	190
		Fratar	191
		Greshicë	192
		Hekal	193
		Kute	194
		Ngracan	195
		Qender	196
		Selitë	197

QARKU GJIROKASTER			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Gjirokastër			198
	Gjirokastër		199
	Libohovë		200
		Qendër	201
		Cepo	202
		Dropull i Poshtëm	203
		Dropull i Sipërm	204
		Lazarat	205
		Lunxhëri	206
		Odrie	207
		Picar	208
		Pogon	209
		Antigon	210
		Zagori	211
Tepelenë			212
	Tepelenë		213
	Memaliaj		214
		Buz	215
		Memaliaj Fshat	216
		Krahes	217
		Kurvelesh	218

		Lopes	219
		Luftinje	220
		Qesarat	221
		Qendër	222
Përmet			223
	Përmet		224
	Këlcyrë		225
		Ballaban	226
		Carcove	227
		Frasher	228
		Petran	229
		Qendër	230
		Suke	231
		Dishnice	232

QARKU KORCE			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Korçë			233
	Korçë, Rajoni 1		234
	Korçë, Rajoni 2		235
	Korçë, Rajoni 3		236
	Korçë, Rajoni 4		237
	Maliq		238
		Drenovë	239
		Gorë	240
		Lekas	241
		Libonik	242
		Liqenas	243
		Moglicë	244
		Mollaj	245
		Pirg	246
		Pojan	247
		Bulgarec	248
		Vithkuq	249
		Voskop	250
		Voskopojë	251
		Vreshtas	252
Kolonjë			253
	Ersekë		254
	Leskovik		255

		Barmash	256
		Çlirim	257
		Leskovik	258
		Mollas	259
		Novoselë	260
		Qendër Ersekë	261
Pogradec			262
	Pogradec		263
		Buçimas	264
		Çerravë	265
		Dardhas	266
		Hudenisht	267
		Proptisht	268
		Trebinjë	269
		Velçan	270
Devoll			271
	Bilisht		272
		Qender Bilisht	273
		Miras	274
		Hoçisht	275
		Progër	276

QARKU KUKES			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Kukës			277
	Kukës		278
		Arren	279
		Bicaj	280
		Bushtrice	281
		Malzi	282
		Ujmisht	283
		Tërthorë	284
		Shtiqen	285
		Zapod	286
		Shishtavec	287
		Topojan	288
		Surroj	289

		Kolsh	290
		Kalis	291
		Gryk-Caje	292
Has			293
	Krumë		294
		Golaj	295
		Fajzë	296
		Gjinaj	297
Tropojë			298
	Bajram Curri		299
		Bujan	300
		Bytyç	301
		Fierzë	302
		Lekbibaj	303
		Llugaj	304
		Margegaj	305
		Tropojë	306

QARKU LEZHE			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Lezhë			307
	Lezhë		308
		Balldre	309
		Blinisht	310
		Dajç	311
		Kallmet	312
		Kolsh	313
		Shëngjin	314
		Ungrej	315
		Shënkoll	316
		Zejmen	317
Mirditë			318
	Rrëshen		319
	Rubik		320
		Fan	321
		Kaçinar	322

		Kthellë	323
		Orosh	324
		Selitë	325
Kurbin			326
	Laç		327
	Mamurras		328
		Fushë-Kuqe	329
		Milot	330

QARKU SHKODER			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Shkodër			331
	Shkodër, Lagja 1		332
	Shkodër, Lagja 2		333
	Shkodër, Lagja 3		334
	Shkodër, Lagja 4		335
	Vau-Dejës		336
		Ana-Malit	337
		Bushat	338
		Barbullush	339
		Bërdicë	340
		Dajç	341
		Gur i Zi	342
		Hajmel	343
		Postribë	344
		Pult	345
		Rrethinat	346
		Shalë	347
		Shosh	348
		Temal	349
		Velipojë	350
		Vig-Mnelë	351
		Shllak	352
Pukë			353
	Pukë		354
	Fushë-Arrës		355
		Blerim	356
		Iballë	357
		Fierzë	358
		Gjegjan	359

		Qafë-Mali	360
		Qelëz	361
		Qerret	362
		Rrapë	363
Malësi e Madhe			364
	Koplik		365
		Gruemirë	366
		Kastrat	367
		Kelmend	368
		Qender	369
		Shkrel	370

Shënim: Komuna Barbullush është bashkuar me komunën Bushat

QARKU TIRANE			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Tiranë			371
	Bashkia Tiranë		372
	Njesia Bashkiake Nr. 1		373
	Njesia Bashkiake Nr. 2		374
	Njesia Bashkiake Nr. 3		375
	Njesia Bashkiake Nr. 4		376
	Njësia Bashkiake Nr. 5		377
	Njësia Bashkiake Nr. 6		378
	Njësia Bashkiake Nr. 7		379
	Njësia Bashkiake Nr. 8		380
	Njësia Bashkiake Nr. 9		381
	Njësia Bashkiake Nr. 10		382
	Njësia Bashkiake Nr. 11		383
	Bashkia Kamëz		384
	Bathore		385
	Bashkia Vorë		386
		Baldushk	387
		Berzhitë	388
		Berxullë	389
		Dajt	390
		Farkë	391
		Kashar	392
		Ndroq	393
		Paskuqan	394
		Petrelë	395

		Pezë	396
		Prezë	397
		Shëngjergj	398
		Vaqarr	399
		Vaqarr	400
		Zall-Bastar	401
		Krrabë	402
Kavaje			403
	Kavajë		404
	Rrogozhinë		405
		Golem	406
		Gosë	407
		Helmes	408
		Kryevidh	409
		Lekaj	410
		Luz i vogël	411
		Sinaballaj	412
		Synej	413

Shënim: Bathore është mbyllur.

QARKU VLORE			
Rrethi	**Bashkia**	**Komuna**	**Kodi**
Vlorë			414
	Vlorë, Rajoni 1		415
	Vlorë, Rajoni 2		416
	Vlorë, Rajoni 3		417
	Vlorë, Rajoni 4		418
	Vlorë, Rajoni 5		419
	Himarë		420
	Orikum		421
	Selenice		422
		Armen	423
		Brataj	424
		Hore-Vranisht	425
		Kote	426
		Novoselë	427
		Qender	428
		Sevaster	429
		Shushicë	430
		Vllahinë	431
Sarandë			432

	Sarandë		433
	Konispol		434
		Aliko	435
		Dhiver	436
		Dhiver 2 (mbyllur)	437
		Ksamil	438
		Livadhja	439
		Lukove	440
		Markat	441
		Xarrë	442
Delvinë			443
	Delvinë		444
		Finiq	445
		Mesapotam	446
		Vergo	447

Shënim: Dhiver 2 është mbyllur.

Kodet për zyrat në përfaqësitë diplomatike dhe konsullor
(shtuar me VKM nr. 432, datë 20.5.2015; shtuar kode me VKM nr. 224, date 26.4.2018)

- kodi 501 për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë;
- kodi 502 për Konsullatën e Përgjithshme në Milano;
- kodi 503 për Konsullatën e Përgjithshme në Bari.
- Kodi 504, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Abu Dhabi;
- Kodi 505, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Ankara;
- Kodi 506, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë;
- Kodi 507, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Beograd;
- Kodi 508, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Berlin;
- Kodi 509, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Bernë;
- Kodi 510, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Bratislavë;
- Kodi 511, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Brazilia;
- Kodi 512, për Zyrën Konsullore në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Bruksel;
- Kodi 513, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Budapest;
- Kodi 514, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Bukuresht;
- Kodi 515, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Doha;
- Kodi 516, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Hagë;
- Kodi 517, për Konsullatën e Përgjithshme në Janinë;
- Kodi 518, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kajro;
- Kodi 519, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kopenhagën;
- Kodi 520, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Kuvajt Siti;
- Kodi 521, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Londër;
- Kodi 522, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Lubjanë;
- Kodi 523, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Madrid;
- Kodi 524, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Moskë;
- Kodi 525, për Konsullatën e Përgjithshme në Mynih;
- Kodi 526, për Zyrën Konsullore në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Nju Jork;
- Kodi 527, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Otava;
- Kodi 528, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Paris;
- Kodi 529, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Pekin;
- Kodi 530, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Podgoricë;

- Kodi 531, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Pragë;
- Kodi 532, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Prishtinë;,
- Kodi 533, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Riad;
- Kodi 534, për Konsullatën e Përgjithshme në Selanik;
- Kodi 535, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Shkup;
- Kodi 536, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Sofje;
- Kodi 537, për Konsullatën e Përgjithshme në Stamboll;
- Kodi 538, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Stokholm;
- Kodi 539, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Tel Aviv;
- Kodi 540, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Tokio;
- Kodi 541, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Uashington;
- Kodi 542, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Varshavë;
- Kodi 543, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Vjenë;
- Kodi 544, për Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Zagreb.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Vendim

Nr. 1299, datë 16.12.2009

PËR "MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË NUMRIT TË NËPUNËSVE TË SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI/ *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARQEVE"

(ndryshuar me VKM nr. 785, datë 9.11.2016; nr. 32, datë 23.1.2019; nr. 257, datë 29.4.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 62 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Struktura e shërbimit shtetëror të gjendjes civile është sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*
2. Organika e shërbimit të gjendjes civile në Bashki/Njësi Bashkiake/ *Njësi Administrative* dhe në Degët e Qarkut, është sipas pasqyrës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Numri prej 37 nëpunësish, i cili pakësohet nga numri i nëpunësve të miratuar për institucionin e Prefektit, si nëpunës të gjendjes civile në degët e qarkut, i kalon numrit të përgjithshëm të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.
4. *Shërbimi publik i gjendjes civile ofrohet në 394 zyra të gjendjes civile, 150 prej të cilave funksionojnë si sportele fizike, ndërsa pjesa tjetër si sportele on-line.*

4/1. Dokumentet aktlindje, sipas modelit nr. 1, dhe aktvdekje, sipas modelit nr. 3, të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formës, të elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar, mbahen edhe nga nëpunësit e gjendjes civile të atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor publik dhe privat, ku kryhet lindja (apo ndodh vdekja e foshnjës), nën juridiksionin territorial të bashkive.

4/2. Shërbimi i gjendjes civile ofrohet nga 524 nëpunës, gjithsej, të cilët në mënyrë alternative ofrojnë këtë shërbim.

4/3. Organizimi i sporteleve fizike në nivel qarku/bashkie bëhet sipas pasqyrës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


4/4. Kryetarët e bashkive, bazuar në nevojat dinamike të komunitetit, përcaktojnë zyrat e gjendjes civile që funksionojnë si sportele fizike çdo vit brenda datës 5 janar. Përjashtimisht për vitin 2022, ky përcaktim bëhet brenda datës 1 maj 2022.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i shtetit për Ministrinë e Brendshme, programi i gjendjes civile.
6. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi nr. 21, datë 9.1.2008 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra nr. 1



ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU BERAT						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	**Njësi administrative**	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Berat			1	(1 përgjegjës)	1
2		Berat, rajoni nr. 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Berat, rajoni nr. 2		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4		Berat, rajoni nr. 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Ura Vajgurore		1	1 përgjegjës	1
6			Cukalat	1	1 përgjegjës	1
7			Kutalli	1	1 përgjegjës	1
8			Lumas	1	1 përgjegjës	1
9			Otllak	1	1 përgjegjës	1
10			Poshnje	1	1 përgjegjës	1
11			Roshnik	1	1 përgjegjës	1
12			Sinje	1	1 përgjegjës	
13			Terpan	1	1 përgjegjës	1
14			Velabisht	1	1 përgjegjës	1
15			Vertop	1	1 përgjegjës	1
	Total			15		18

1	Kuçovë			1	1 përgjegjës	1
2		Kuçovë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Kozarë	1	1 përgjegjës	1
4			Perondi	1	1 përgjegjës	1
	Total			4		5
1	Skrapar			1	1 përgjegjës	1
2		Çorovodë		1	1 përgjegjës	1
3		Poliçan		1	1 përgjegjës	1
4			Bogovë	1	1 përgjegjës	1
5			Gjerbës-Zhepë	1	1 përgjegjës	1
6			Qendër+Vendreshë+Leshnjë	1	1 përgjegjës	1
7			Potom	1	1 përgjegjës	1
8			Çepan	1	1 përgjegjës	1
	Total			8		8
		Total bashki		7		11
		Total komunë		17		17
		Total dega e qarkut		3		3
Total qarku Berat				27		31

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU DIBER						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Dibër			1	(1 përgjegjës)	1
2		Peshkopi		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Arras	1	1 përgjegjës	1
4			Lure	1	1 përgjegjës	1
5			Fushë Çidhen	1	1 përgjegjës	1
6			Kala e Dodës	1	1 përgjegjës	1
7			Kastriot	1	1 përgjegjës	1
8			Luzni	1	1 përgjegjës	1
9			Maqellarë	1	1 përgjegjës	1
10			Melan	1	1 përgjegjës	1
11			Muhurr	1	1 përgjegjës	1
12			Selishtë	1		
13			Tomin	1	1 përgjegjës	1
14			Sllovë	1	1 përgjegjës	1
15			Zall Dardhe + Zall Reç	1	1 përgjegjës	1
	Total			15		15
1	Mat			1	1 përgjegjës	1
2		Burrel		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Klos		1	1 përgjegjës	1
4			Baz	1	1 përgjegjës	1
5			Ulëz	1	1 përgjegjës	1
6			Gurrë	1	1 përgjegjës	1

7			Komsi	1	1 përgjegjës	1
8			Lis	1	1 përgjegjës	1
9			Rukaj	1	1 përgjegjës	1
10			Derjan + Macukull	1	1 përgjegjës	1
11			Suç	1	1 përgjegjës	1
12			Xibër	1	1 përgjegjës	1
	Total			12		13
1	Bulqizë			1	1 përgjegjës	1
2		Bulqizë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Gjoricë	1	1 përgjegjës	1
4			Ostren + Trebisht	1	1 përgjegjës	1
5			Martanesh	1	1 ppërgjegjës	1
6			Shupenzë	1	1 përgjegjës	1
7			Zerqan	1	1 përgjegjës	1
8			Fushë Bulqizë	1	1 përgjegjës	1
	Total			8		9
		Totali bashki		**4**		7
		Totali komunë		**28**		27
		Total dega e qarkut		**3**		3
	Total Qarku Dibër			**35**		37

(shtuar nënndarja 6/1 me VKM nr. 785, datë 9.11.2016)

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU DURRES						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**Z.GJ.C**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Durrës			1	(1 përgjegjës)	1
2		Durrës, rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Durrës, rajoni 2		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4		Durrës, rajoni 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Durrës, rajoni 4		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
6		Durrës, rajoni 5		1	(1përgjegjës + 4 nëpunës)	5
6/1	*Durrës*	*Durrës, rajoni 6*		*1*		
7		Manëz		1	1 përgjegjës	1
8		Sukth		1	(1 përgjegjës + 1 punonjes)	2
9		Shijak		1	(1 përgjegjës + 1 punonjes)	2
10			Gjepalaj	1	1 përgjegjës	1
11			Ishëm	1	1 përgjegjës	1
12			Katund i ri	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
13			Maminas	1	1 përgjegjës	1
14			Rrashbull	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
15			Xhafzotaj	1	(1 përgjegjës+ 1 nëpunës)	2
	Total			**15**		**31**
1	Krujë			1	1 përgjegjës	1
2		Krujë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Fushë Krujë		1	(1përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Bubq	1	1 përgjegjës	1

5			Cudhi	1	1 përgjegjës	1
6			Thumanë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
7			Nikël	1	1 përgjegjës	1
	Total			**7**		**10**
		Total bashki		**10**		**24**
		Total komunë		**10**		**14**
		Total dega e qarkut		**2**		**2**
	Total qarku Durrës			**22**		**40**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU ELBASAN						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Elbasan			1	(1 përgjegjës)	1
2		Elbasan, Rajoni Nr. 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Elbasan, Rajoni Nr. 2		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4		Elbasan, Rajoni Nr. 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Elbasan, Rajoni Nr. 4		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
6		Elbasan, Rajoni Nr. 5		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
7		Belsh +	Rrasë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2

8		Cërrik		1	1 përgjegjës	1
9			Bradashesh + Gracen	1	1 përgjegjës	1
10			Fierzë	1	1 përgjegjës	1
11			Funarë	1	1 përgjegjës	1
12			Gjergjan	1	1 përgjegjës	1
13			Gjinar + Zavalinë	1	1 përgjegjës	1
14			Gostimë	1	1 përgjegjës	1
15			Grekan	1	1 përgjegjës	1
16			Kajan	1	1 përgjegjës	1
17			Klos	1	1 përgjegjës	1
18			Labinot-Fushë	1	1 përgjegjës	1
19			Labinot-Mal	1	1 përgjegjës	1
20			Mollas	1	1 përgjegjës	1
21			Papër	1	1 përgjegjës	1
22			Shalës	1	1 përgjegjës	1
23			Shirgjan	1	1 përgjegjës	1
24			Shushicë	1	1 përgjegjës	1
25			Tregan	1	1 përgjegjës	1
	Total			**25**		**31**
1	Gramsh			1	1 përgjegjës	1
2		Gramsh +	Skënderbegas + Kushovë	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Kodovjat + Lenie	1	1 përgjegjës	1
4			Kukur	1	1 përgjegjës	1
5			Pishaj + Poroçan + Sult	1	1 përgjegjës	1
6			Tunjë	1	1 përgjegjës	1
	Total			**6**		**7**

1	Peqin			1	1 përgjegjës	1
2		Peqin +	Karinë	1	1 përgjegjës	1
3			Gjocaj	1	1 përgjegjës	1
4			Pajovë	1	1 përgjegjës	1
5			Përparim	1	1 përgjegjës	1
6			Shezë	1	1 përgjegjës	1
	Total			**6**		**6**
1	Librazhd			1	1 përgjegjës	1
2		Librazhd +	Steblevë	1	1 përgjegjës	1
3		Prrenjas		1	1 përgjegjës	1
4			Hotolisht	1	1 përgjegjës	1
5			Lunik	1	1 përgjegjës	1
6			Orenjë	1	1 përgjegjës	1
7			Polis	1	1 përgjegjës	1
8			Qender	1	1 përgjegjës	1
9			Qukës	1	1 përgjegjës	1
10			Rajcë	1	1 përgjegjës	1
11			Stravaj	1	1 përgjegjës	1
	Total			**11**		**11**
		Totali bashki		**11**		**18**
		Totali komunë		**33**		**33**
		Total dega e qarkut		**4**		**4**
Total qarku Elbasan				**48**		**55**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU FIER						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Fier			1	(1 përgjegjës)	1
2		Fier, Rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Fier, Rajoni 2		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
4		Fier, Rajoni 3		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5		Fier, Rajoni 4		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
6		Patos		1	(1 pergjegjes + 2 nëpunës)	3
7		Roskovec		1	1 përgjegjës	1
8			Cakran	1	(1 përgjegjës+ 1nëpunës)	2
9			Dermenas	1	1 përgjegjës	1
10			Frakull	1	1 përgjegjës	1
11			Kuman	1	1 përgjegjës	1
12			Kurjan	1	1 përgjegjës	1
13			Levan	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
14			Libofsh	1	1 përgjegjës	1
15			Mbrostar	1	1 përgjegjës	1
16			Portez	1	1 përgjegjës	1
17			Qender Fier	1	1 përgjegjës	1
18			Ruzhdie	1	1 përgjegjës	1
19			Strum	1	1 përgjegjës	1
20			Topojë	1	1 përgjegjës	1
21			Zharëz	1	1 përgjegjës	1

	Total			**21**		**30**
1	Lushnjë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Lushnje, Rajoni 1		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Lushnje, Rajoni 2		1	2 nëpunës	2
4		Bashkia Divjakë		1	1 përgjegjës	1
5			Allkaj	1	1 përgjegjës	1
6			Ballagat	1	1 përgjegjës	1
7			Bubullimë	1	1 përgjegjës	1
8			Dushk	1	1 përgjegjës	1
9			Fier Shegan	1	1 përgjegjës	1
10			Golem	1	1 përgjegjës	1
11			Grabian	1	1 përgjegjës	1
12			Gradishtë	1	1 përgjegjës	1
13			Hysgjokaj	1	1 përgjegjës	1
14			Karbunarë	1	1 përgjegjës	1
15			Kolonjë	1	1 përgjegjës	1
16			Krutje	1	1 përgjegjës	1
17			Remas	1	1 përgjegjës	1
18			Tërbuf	1	1 përgjegjës	1
	Total			**18**		**20**
1	Mallakastër			1	1 përgjegjës	1
2		Ballsh		1	1 përgjegjës	1
3			Aranitas + Ngracan	1	1 përgjegjës	1
4			Fratar + Selitë	1	1 përgjegjës	1
5			Greshicë	1	1 përgjegjës	1

6			Hekal	1	1 përgjegjës	1
7			Kute	1	1 përgjegjës	1
8			Qender	1	1 përgjegjës	1
	Total			**8**		**8**
		Total bashki		**10**		**19**
		Totali komunë		**34**		**36**
		Total dega e qarkut		**3**		**3**
Total qarku Fier				**47**		**58**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU GJIROKASTER						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	***Njësi administrative***	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Gjirokastër			1	(1 përgjegjës)	1
2		Gjirokastër		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Libohovë +	Zagori + Qendër	1	1 përgjegjës	1
4			Cepo + Picar	1	1 përgjegjës	1
5			Dropull i Poshtëm	1	1 përgjegjës	1
6			Dropull i Sipërm	1	1 përgjegjës	1
7			Lazarat	1	1 përgjegjës	1
8			Lunxhëri + Antigon + Odrie	1	1 përgjegjës	1
9			Pogon	1	1 përgjegjës	1

	Total			**9**		**11**
1	Tepelenë			1	1 përgjegjës	1
2		Tepelenë		1	1 përgjegjës	1
3		Memaliaj		1	1 përgjegjës	1
4			Memaliaj Fshat	1	1 përgjegjës	1
5			Krahes + Qesarat	1	1 përgjegjës	1
6			Luftinje + Buz	1	1 përgjegjës	1
7			Qendër + Kurvelesh + Lopes	1	1 përgjegjës	1
	Total			**7**		**7**
1	Përmet			1	1 përgjegjës	1
2		Përmet		1	1 përgjegjës	1
3		Këlcyrë		1	1 përgjegjës	1
4			Ballaban	1	1 përgjegjës	1
5			Carcove	1	1 përgjegjës	1
6			Dishnice	1	1 përgjegjës	1
7			Petran	1	1 përgjegjës	1
8			Qendër + Frasher	1	1 përgjegjës	1
9			Suke	1	1 përgjegjës	1
	Total			**9**		**9**
		Total bashki		**6**		**8**
		Total komunë		**16**		**16**
		Total dega e qarkut		**3**		**3**
	Total qarku Gjirokastër			**25**		**27**

(Ndryshuar rreshti me numër rendor 3 me VKM nr. 785, datë 9.11.2016)

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT

QARKU KORÇË						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Korçë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Korçë		4	(1 përgjegjës + 6 nëpunës)	7
3		Maliq		1	1 përgjegjës	1
4			Gorë	1	1 përgjegjës	1
5			Drenovë	1	1 përgjegjës	1
6			Libonik	1	1 përgjegjës	1
7			Liqenas	1	1 përgjegjës	1
8			Mollaj + Vithkuq	1	1 përgjegjës	1
10			Pirg	1	1 përgjegjës	1
11			Pojan	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
12			Bulgarec	1	1 përgjegjës	1
13			Voskop	1	1 përgjegjës	1
14			Voskopojë + Lekas + Moglicë	1	1 përgjegjës	1
17			Vreshtas	1	1 përgjegjës	1
	Total			**17**		**21**
1	Kolonjë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Ersekë	*Barmash*	1	1 përgjegjës	1
3		Leskovik +	Leskovik	1	1 përgjegjës	1
4			Mollas + Çlirim	1	1 përgjegjës	1
5			Qendër Ersekë + Novoselë	1	1 përgjegjës	1

	Total			**5**		**5**
1	Pogradec			1	(1 përgjegjës)	1
2		Pogradec		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3			Buçimas	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Çerravë	1	1 përgjegjës	1
5			Dardhas	1	1 përgjegjës	1
6			Hudenisht	1	1 përgjegjës	1
7			Proptisht	1	1 përgjegjës	1
8			Trebinjë	1	1 përgjegjës	1
9			Velçan	1	1 përgjegjës	1
	Total			**9**		**12**
1	Devoll			1	(1 përgjegjës)	1
2		Bilisht		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Qender Bilisht	1	1 përgjegjës	1
4			Miras	1	1 përgjegjës	1
5			Progër	1	1 përgjegjës	1
6			Hoçisht	1	1 përgjegjës	1
	Total			**6**		**7**
		Total bashki		**9**		**15**
		Total komunë		**24**		**26**
		Total dega e qarkut		**4**		**4**
	Total qarku Korçë			**37**		**45**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU KUKËS						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Kukës			1	(1 përgjegjës)	1
2		Kukës +	Kolsh	1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3			Bicaj + Ujmisht	1	1 përgjegjës	1
4			Bushtrice + Gryk-Caje + Kalis	1	1 përgjegjës	1
5			Malzi	1	1 përgjegjës	1
6			Shishtavec	1	1 përgjegjës	1
7			Shtiqen	1	1 përgjegjës	1
8			Surroj + Arren	1	1 përgjegjës	1
9			Tërthorë	1	1 përgjegjës	1
10			Topojan	1	1 përgjegjës	1
11			Zapod	1	1 përgjegjës	1
	Total			**11**		**13**
1	Has			1	1 përgjegjës	1
2		Krumë +	Gjinaj	1	1 përgjegjës	1
3			Fajza	1	1 përgjegjës	1
4			Golaj	1	1 përgjegjës	1
	Total			**4**		**4**
1	Tropojë			1	1 përgjegjës	1
2		Bajram Curri		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Bytyç	1	1 përgjegjës	1
4			Bujan	1	1 përgjegjës	1
5			Lekbibaj	1	1 përgjegjës	1
6			Fierzë	1	1 përgjegjës	1
7			Tropojë	1	1 përgjegjës	1
8			Llugaj	1	1 përgjegjës	1
9			Margegaj	1	1 përgjegjës	1
		Total		**9**		**10**
		Totali bashki		**3**		**6**
		Totali komunë		**18**		**18**
		Total dega e qarkut		**3**		**3**
	Total qarku Kukës			**24**		**27**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU LEZHE						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Lezhë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Lezhë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3			Balldre	1	1 përgjegjës	1
4			Blinisht	1	1 përgjegjës	1
5			Dajç	1	1 përgjegjës	1
6			Kallmet	1	1 përgjegjës	1
7			Kolsh	1	1 përgjegjës	1
8			Shëngjin	1	1 përgjegjës	1
9			Shënkoll	1	1 përgjegjës	1

10			Ungrej	1	1 përgjegjës	1
11			Zejmen	1	1 përgjegjës	1
	Total			**11**		**12**
1	Mirditë			1	1 përgjegjës	1
2		Rrëshen +	Kaçinar	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
3		Rubik		1	1 përgjegjës	1
4			Fan	1	1 përgjegjës	1
5			Kthellë + Selitë	1	1 përgjegjës	1
6			Orosh	1	1 përgjegjës	1
	Total			**6**		**7**
1	Kurbin			1	1 përgjegjës	1
2		Laç		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Mamurras		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Fushë-Kuqe	1	1 përgjegjës	1
5			Milot	1	1 përgjegjës	1
	Total			**5**		**8**
		Total bashki		**5**		**10**
		Total komunë		**14**		**14**
		Total dega e qarkut		**3**		**3**
	Totali qarku Lezhë			**22**		**27**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT						
QARKU SHKODËR						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Shkodër			1	(1 përgjegjës)	1
2		Shkodër		1	(1 përgjegjës + 9 nëpunës)	10
3		Vau-Dejës+	Temal	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
4			Ana-Malit	1	1 pergjegjes	1
5			Bushat	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
6			Bërdicë	1	1 përgjegjës	1
7			Dajç	1	1 përgjegjës	1
8			Gur i Zi	1	1 përgjegjës	1
9			Hajmel + Vig-Mnelë	1	1 përgjegjës	1
10			Postribë	1	1 përgjegjës	1
11			Pult	1	1 përgjegjës	1
12			Rrethinat	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
13			Shalë + Shosh	1	1 përgjegjës	1
14			Velipojë	1	1 përgjegjës	1
15			Shllak	1	1 përgjegjës	1
	Total			**15**		**27**
1	Pukë			1	1 përgjegjës	1
2		Pukë +	Rrapë	1	1 përgjegjës	1
3		Fushë-Arrës +	Blerim + Qafë-Mali	1	1 përgjegjës	1
4			Iballë	1	1 përgjegjës	1

5			Fierzë	1	1 përgjegjës	1
6			Gjegjan	1	1 përgjegjës	1
7			Qerret + Qelëz	1	1 përgjegjës	1
	Total			**7**		**7**
1	Malësi e Madhe			1	1 përgjegjës	1
2		Koplik		1	1 përgjegjës	1
3			Gruemirë	1	1 përgjegjës	1
4			Kastrat	1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
5			Kelmend	1	1 përgjegjës	1
6			Qender	1	1 përgjegjës	1
7			Shkrel	1	1 përgjegjës	1
	Total			**7**		**8**
		Total bashki		**5**		**15**
		Total komunë		**21**		**24**
		Total dega e qarkut		**3**		**3**
Total qarku Shkodër				**29**		**42**

ORGANIKA E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT

QARKU TIRANË						
Nr.	**Rrethi**	**Bashkia**	*Njësi administrative*	**Zyra ZGJC**	**Numri nëpunësve për çdo zyrë**	
1	Tiranë			1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
2		Bashkia Tiranë		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Njesia administrative nr. 1		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
4		Njesia administrative nr. 2		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
5		Njesia administrative nr. 3		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
6		Njësia administrative nr. 4		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
7		Njësia administrative nr. 5		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
8		Njësia administrative nr. 6		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
9		Njësia administrative nr. 7		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
10		Njësia administrative nr. 8		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
11		Njësia administrative nr. 9		1	(1 përgjegjës + 3 nëpunës)	4
12		Njësia administrative nr. 10		1	(1përgjegjës + 2 nëpunës)	3
13		Njësia administrative nr. 11		1	(1 përgjegjës + 4 nëpunës)	5
14		Bashkia Kamëz		1	(1 përgjegjës + 5 nëpunës)	6
15		Bashkia Vorë		1	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
16			Baldushk	1	1 përgjegjës	1
17			Berxullë	1	1 përgjegjës	1
18			Berzhitë	1	1 përgjegjës	1
19		*Njësia administrative Dajt dhe Dajt/1*	Dajt	*2*	1 përgjegjës	1
20		*Njësia administrative Farkë dhe Farkë/1*	Farkë	*2*	1 përgjegjës	1
21		*Njësia administrative Kashar dhe Kashar/1*	Kashar	*2*	(1 përgjegjës + 1 nëpunës)	2
22			Krrabë	1	1 përgjegjës	1
23			Ndroq	1	1 përgjegjës	1
24			Paskuqan	1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
25			Pezë	1	1 përgjegjës	1
26			Prezë	1	1 përgjegjës	1
27			Petrelë	1	1 përgjegjës	1
28			Shëngjergj	1	1 përgjegjës	1

29			Vaqarr	1	1 përgjegjës	1
30			Zall-Bastar	1	1 përgjegjës	1
31			Zall-Herr	1	1 përgjegjës	1
	Total			**31**		**79**
1	Kavajë			1	(1 përgjegjës)	1
2		Kavajë		1	(1 përgjegjës + 2 nëpunës)	3
3		Rrogozhinë +	Sinaballaj	1	1 përgjegjës	1
4			Golem	1	1 përgjegjës	1
5			Gosë	1	1 përgjegjës	1
6			Helmes	1	1 përgjegjës	1
7			Kryevidh	1	1 përgjegjës	1
8			Lekaj	1	1 përgjegjës	1
9			Luz i vogël	1	1 pergjegjes	1
10			Synej	1	1 përgjegjës	1
	Total			**10**		**12**
		Total bashki		**16**		**62**
		Totali komunë		**23**		**26**
		Total dega e qarkut		**2**		**3**
Total qarku Tiranë				**41**		**91**

PËRMBLEDHËSE E ORGANIKËS SË ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT

Nr.	**Qarku**	**Z.Gj.C**	**Nëpunës**	**Z.Gj.C**	**Nëpunës**	**Z.Gj.C**	**Nëpunës**	**Z.Gj.C**	**Nëpunës**
		Bashki	**Bashki**	*Njësi administrative*	*Njësi administrative*	**Rreth**	**Rreth**	**Total qark**	**Total qark**
1	Berat	7	11	17	17	3	3	**27**	**31**
2	Dibër	4	7	28	27	3	3	**35**	**37**
3	Durrës	10	24	10	14	2	2	**22**	**40**
4	Elbasan	11	18	33	33	4	4	**48**	**55**
5	Fier	10	19	34	36	3	3	**47**	**58**
6	Gjirokastër	6	8	16	16	3	3	**25**	**27**
7	Korçë	9	15	24	26	4	4	**37**	**45**
8	Kukës	3	6	18	18	3	3	**24**	**27**
9	Lezhë	5	10	14	14	3	3	**22**	**27**
10	Shkodër	5	15	21	24	3	3	**29**	**42**
11	Tiranë	16	62	23	26	2	3	**41**	**91**
12	Vlorë	11	20	19	21	3	3	**33**	**44**
Totali		**97**	**215**	**257**	**272**	**36**	**37**	**390**	**524**

PËRMBLEDHËSE E ORGANIKËS SË ZYRAVE TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI, *NJËSI ADMINISTRATIVE* DHE NË DEGËT E QARKUT

Nr.	Qarku	Z.Gj.C	Nëpunës	Z.Gj.C	Nëpunës	Z.Gj.C	Nëpunës	Z.Gj.C	Nëpunës
		Bashki	**Bashki**	*Njësi administrative*	*Njësi administrative*	**Rreth**	**Rreth**	**Total Qark**	**Total Qark**
1	Berat	7	11	17	17	3	4	27	32
2	Dibër	4	7	28	27	3	4	35	38
3	Durrës	10	24	10	14	2	3	22	41
4	Elbasan	11	18	33	33	4	5	48	56
5	Fier	10	19	34	36	3	5	47	60
6	Gjirokastër	6	8	16	16	3	4	25	28
7	Korçë	9	15	24	26	4	5	37	46
8	Kukës	3	6	18	18	3	4	24	28
9	Lezhë	5	10	14	14	3	4	22	28
10	Shkodër	5	15	21	24	3	4	29	43
11	Tiranë	16	62	23	26	2	4	41	92
12	Vlorë	11	20	19	21	3	5	33	46
Totali		**97**	**215**	**257**	**272**	**36**	**51**	**390**	**538**
Numri i zyrave te gjendjes civile ne bashki e *Njësi administrative*				357					
Numri i punonjësve ne Bashki e *Njësi administrative*				488					

Pasqyra nr. 3

Sportelet e ofrimit të shërbimit të gjendjes civile

Qarku	Bashkia	Sportel fizik Bashki	Sportel fizik Prefekturë	Sportele fizikeTotal
Berat	Bashkia Berat	3	1	4
	Bashkia Dimal	1		1
	Bashkia Kuçovë	1		1
	Bashkia Poliçan	1		1
	Bashkia Skrapar	1		1
	Total sportele	**7**	**1**	**8**
Dibër	Bashkia Bulqizë	1		1
	Bashkia Dibër	2	1	3
	Bashkia Klos	1		1
	Bashkia Mat	1		1
	Total sportele	**5**	**1**	**6**
Durrës	Bashkia Durrës	10	1	11
	Bashkia Krujë	2		2
	Bashkia Shijak	2		2
	Total sportele	**14**	**1**	**15**
Elbasan	Bashkia Belsh	1		1
	Bashkia Cërrik	2		2
	Bashkia Elbasan	6	1	7
	Bashkia Gramsh	1		1
	Bashkia Librazhd	1		1
	Bashkia Peqin	1		1
	Bashkia Prrenjas	1		1
	Total sportele	**13**	**1**	**14**
Fier	Bashkia Divjakë	2		2
	Bashkia Fier	8	1	9
	Bashkia Lushnje	4		4
	Bashkia Mallakastër	1		1
	Bashkia Patos	1		1
	Bashkia Roskovec	1		1
	Total sportele	**17**	**1**	**18**
Gjirokastër	Bashkia Dropull	1		1
	Bashkia Gjirokastër	2	1	3
	Bashkia Këlcyrë	1		1
	Bashkia Libohovë	1		1
	Bashkia Memaliaj	1		1
	Bashkia Përmet	1		1
	Bashkia Tepelenë	1		1
	Total sportele	**8**	**1**	**9**

Korcë	Bashkia Devoll	1		1
	Bashkia Kolonjë	1		1
	Bashkia Korçë	3	1	4
	Bashkia Maliq	2		2
	Bashkia Pogradec	3		3
	Bashkia Pustec	1		1
	Total sportele	**11**	**1**	**12**
Kukes	Bashkia Has	1		1
	Bashkia Kukës	2	1	3
	Bashkia Tropojë	1		1
	Total sportele	**4**	**1**	**5**
Lezhë	Bashkia Kurbin	2		2
	Bashkia Lezhë	3	1	4
	Bashkia Mirditë	1		1
	Total sportele	**6**	**1**	**7**
Shkodër	Bashkia Fushë-Arrëz	1		1
	Bashkia Malësi e Madhe	2		2
	Bashkia Pukë	1		1
	Bashkia Shkodër	6	1	7
	Bashkia Vau-Dejës	2		2
	Total sportele	**12**	**1**	**13**
Tiranë	Bashkia Kamëz	2		2
	Bashkia Kavajë	3		3
	Bashkia Rrogozhinë	1		1
	Bashkia Tiranë	20	2	22
	Bashkia Vorë	1		1
	Total sportele	**27**	**2**	**29**
Vlorë	Bashkia Delvinë	1		1
	Bashkia Finiq	1		1
	Bashkia Himarë	1		1
	Bashkia Konispol	1		1
	Bashkia Sarandë	2		2
	Bashkia Selenicë	1		1
	Bashkia Vlorë	6	1	7
	Total sportele	**13**	**1**	**14**
TOTAL SPORTELE NË RSH		**137**	**13**	**150**

UDHËZIM

Nr 361, datë 14.10.2010

PËR PROÇEDURAT E VERIFIKIMIT TË SHTETASVE QË KANË MBUSHUR 100 VJEÇ DHE VEPRIMET PER Ç'REGJISTRIM TË TYRE KUR VERTETOHET VDEKJA SIPAS KËRKESAVE LIGJORE.

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 52 pika 10 të Ligjit Nr. 10 129, datë 11. 05. 2009 "Për Gjendjen Civile", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Zyra e gjendjes civile pasi ka marrë nga DPGJC, listën emërore të shtetasve mbi 100 vjeç, e ndan atë sipas adresës shifrore zgjedhore dhe ia paraqet Kryetarit të Bashkisë/Njësisë Bashkiake/Komunës.
2. Këtë listë zyra e gjendjes civile e afishon në vende të dukshme pranë mjediseve të veta për 30 ditë, me shënimin "Kërkohet informacion për këta shtetas".
3. Kryetari i Bashkisë/Njësisë Bashkiake/Komunës, listën emërore ia ndan përkatësisht administratorëve të lagjes për Bashkitë/Njësitë Bashkiake dhe kryepleqve të fshatrave për komunat.
4. Secili prej të ngarkuarve nga kryetari përkatës merr listën dhe do të bëjë verifikimin në terren për çdo person që ndodhet në listë
5. Për personat që ndodhen në listë dhe janë gjallë do të jepet informacioni pranë zyrës së gjendjes civile, e cila për këtë kategori do të njoftojë DPGJC me shkresë të posaçme ku të jenë hedhur të gjitha të dhënat e shtetasit.
6. Për personat që janë në listë dhe nga informacioni rezultojnë të vdekur, zyra e gjendjes civile duhet t'i ndajë në këto kategori:
   a) persona që nuk jetojnë më dhe që të afërmit mund të sigurojnë dokumente që vërtetojnë vdekjen sipas ligjit "Për gjendjen civile",
   b) persona që nuk jetojnë më dhe që të afërmit nuk kanë dokument për të vërtetuar vdekjen,
   c) persona për të cilët nuk gjenden në atë njësi dhe nuk ka informacion.

7. Për shtetasit që përfshin germa a) e pikës 6 të këtij Udhëzimi, zyra e gjendjes civile administron dokumentin që vërteton vdekjen dhe mban akt vdekje të cilin mund ta deklarojë edhe përfaqësuesi i pushtetit vendor.
8. Për shtetasit që nuk kanë dokument, por që ka të afërm që dëshmojnë vdekjen, atëherë zyra e gjendjes civile do të veprojë si për rastet e parashikuara në pikën 9, të nenit 52, të ligjit 10 129 "Për gjendjen civile".
9. Për shtetasit që përfshin germa c) e pikës 6 të këtij udhëzimi, zyra e gjendjes civile njofton DPGjC, e cila duhet të bëjë të mundur gjetjen e vendbanimit të fundit për këta shtetas.
10. Zyra e gjendjes civile deri në momentin e përfundimit të proçedurave për të gjitha rastet e provuara të shtetasve që nuk jetojnë, nuk i shfaq në RKGJC si persona aktivë, sipas rregullave të përcaktuara nga DPGJC.
    Për çdo rast i cili është klasifikuar si jo aktivë dhe më pas vërtetohet gjallesa e tij,, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile përkatëse e rikthen në gjendjen e mëparshme.
11. Për të gjithë shtetasit të paraqitur në listën e DPGJC-se, zyra përkatëse do të mbajë praktikë të veçantë e cila do të ruhet sipas rregullave të arkivës.
12. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Kryetarët e Bashkive/Njësive Bashkiake/Komunave dhe Zyrat e Gjendjes Civile në Bashki/Njësi Bashkiake/Komuna.

M I N I S T R I
Lulzim BASHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 288, datë 10.4.2020

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË PROCEDURËS SË DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FOSHNJAT E PORSALINDURA DHE MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE

(Ndryshuar me Vkm nr. 824, datë 28.12.2023)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. MASA E DHËNIES SË NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) për prindin/prindërit me foshnja të porsalindura është, si më poshtë vijon:
   a) Në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së parë;
   b) Në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e foshnjës së dytë;
   c) Në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e foshnjës së tretë dhe të foshnjave të tjera në vijim;
   ç) Për prindërit që sjellin në jetë dy foshnja të lindura njëherësh (binjakë), masa e përfitimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilën foshnjë;
   d) Për prindërit që sjellin në jetë më shumë se dy foshnja të lindura njëherësh (trinjakë dhe më shumë), masa e përfitimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilën foshnjë.

2. Në masën e ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi), të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfshihet edhe shpërblimi në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për regjistrimin e lindjes brenda afatit, të përcaktuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar.

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE

1. *Ndihmën e menjëhershme financiare (bonusi) sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, e përfitojnë:*
   a) prindi/prindërit e foshnjës së porsalindur, shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të paktën 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike të vitit paraardhës, sipas të dhënave të sistemit TIMS dhe të regjistruar sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile.
   b) prindi/prindërit me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, të cilëve nga shteti shqiptar u është dhënë statusi i refugjatit, i mbrojtjes plotësuese ose i azilkërkuesit dhe vendosin t'i japin foshnjës shtetësi shqiptare, sipas ligjit për shtetësinë shqiptare, dhe e regjistrojnë si shtetas shqiptar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
2. Nëpunësi i gjendjes civile, i atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, kryen veprimet e verifikimit on-line të statusit të prindit dhe regjistron foshnjën e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010.

   Pas regjistrimit kryen verifikimet e nevojshme për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.
3. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi), sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, i jepet prindit/prindërve, menjëherë pas lëshimit të dokumentit "Certifikatë asistence në lindje", në përfundim të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

   Në rastin kur foshnja ndërron jetë pas lindjes, por për të është plotësuar nga ana e institucionit spitalor dokumenti "Certifikatë asistence në lindje", prindi/prindërit përfitojnë ndihmën e menjëhershme financiare (bonusin) pasi të kryhet regjistrimi në RKGJC, nga ana e nëpunësit të

shërbimit të gjendjes civile dhe të lëshohet dokumenti "Certifikatë nga akti i lindjes" dhe certifikata familjare sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.
4. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare jepet në formën e një çeku, të emetuar në emër të prindit/prindërve, dhe ose sipas rasteve të përcaktuara në pikën 2, të kreut II, të këtij vendimi, dhe të pagueshëm:
   a) 35 (tridhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "Certifikatë asistence në lindje";
   b) 75 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "Certifikatë asistence në lindje";
   c) 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "Certifikatë asistence në lindje";
   ç) Diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
5. Vlera e përcaktuar në çek tërhiqet në bankat e nivelit të dytë me të cilat Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

III. MËNYRA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË SHËRBIMIT SPITALOR DHE ATYRE TË GJENDJES CIVILE

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton formatin e dokumentit "Certifikatë asistence në lindje", e cila është e njëjtë në të gjitha institucionet e shërbimit spitalor publik dhe miraton formatin e shërbimit spitalor jopublik që ka vendosur vetë institucioni.
2. Institucioni i shërbimit spitalor publik ose jopublik ku ndodh lindja e foshnjës plotëson dokumentin **"Certifikatë asistence në lindje" në dy kopje** dhe pajis prindin/prindërit me një kopje të saj. Orari i pajisjes së prindit/prindërve me dokumentin "Certifikatë asistence në lindje" është nga ora 9:00 deri në 13:00, nga e hëna në të shtunë. Orari i nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile pranë shërbimit spitalor publik ose jopublik është nga ora 09:00-14:00, nga e hëna në të shtunë.

3. Prindi/prindërit e pajisur me dokumentin "Certifikatë asistence në lindje" paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile, të ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor për mbajtjen e "Aktit të lindjes", çdo ditë, nga e hëna në të shtunë, nga ora 9:00 deri në 13:00. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, në prezencë të prindit/prindërve, administron dokumentin "Certifikatë asistence në lindje", si dhe mjetin e identifikimit të tyre.
4. Kopja e dytë e dokumentit **"Certifikatë asistence në lindje"**, së bashku me fotokopjen e dokumentit të identitetit të prindit/prindërve i jepet zyrtarisht (dorëzohet) me procesverbal nga personi i autorizuar i institucionit të shërbimit spitalor te nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, i ngarkuar me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor, në përfundim të çdo dite.
5. Për lindjet e ndodhura jashtë institucionit të shërbimit spitalor, si banesë, tren, anije etj. apo në çdo ambient tjetër që nuk është përmendur në këtë vendim personeli që asiston ose verifikon lindjen ka detyrimin të plotësojë dokumentin "Cerfikatë asistence në lindje" e të pajisë me një kopje të saj prindin/prindërit dhe kopjen e dytë ta dorëzojë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e lindjes së foshnjës në zyrën e gjendjes civile në territorin ku ka ndodhur lindja.
6. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentet e listuara sipas pikave 4 dhe 5, të këtij kreu, kryen verifikimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, verifikon përbërjen familjare, numrin e foshnjave, dhe pasi bie dakord me prindin/prindërit mbi numrin e pjesëtarëve të familjes, printon certifikatën me gjendje familjare para mbajtjes së aktit të lindjes.
7. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile mban aktin e lindjes, në prezencë të prindit/prindërve, sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim. Pas mbajtjes së aktit të lindjes printon certifikatën nga akti i lindjes, si dhe certifikatën familjare, duke pasqyruar në përbërjen familjare edhe foshnjën.
8. Në rastet kur prindi/prindërit kanë pretendime mbi numrin e anëtarëve të familjes, nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile kryen verifikimet e nevojshme deri në zgjidhjen përfundimtare.
9. Certifikatat e plotësuara dhe të lëshuara sipas pikës 8, të këtij kreu, kanë shënimin "Lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare" (Baby Bonus).

10. Prindi/prindërit pasi janë pajisur me certifikatat e sipërpërmendura, paraqiten pranë nëpunësit të autorizuar nga institucioni i shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, për tërheqjen e çekut.
11. Në rastet kur prindi/prindërit nuk mbajnë aktin e lindjes së foshnjës në institucionin e shërbimit spitalor, personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor ia depoziton kopjen e dokumentit "Certifikatë asistence në lindje" nëpunësit të gjendjes civile të atashuar pranë këtij institucioni për verifikimin e pjesëtarëve të familjes. Nëpunësi i gjendjes civile i atashuar pranë shërbimit spitalor publik/jopublik lëshon certifikatën familjare të prindit/prindërve dhe ia jep nëpunësit të autorizuar të institucionit spitalor, me qëllim përcaktimin e vlerës së çekut. Të gjitha veprimet e sipërpërmendura bëhen në prani të prindit/prindërve.
12. Për rastet e përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, çeku lëshohet në emër të prindit/prindërve pasi foshnja regjistrohet si shtetas i Republikës së Shqipërisë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
13. Për foshnjën e lindur në institucionet e kujdesit shëndetësor dhe të braktisur nga prindi/prindërit, për emetimin e çekut kujdestarit ligjor të fëmijës, merren parasysh afatet për marrjen e kujdestarisë ligjore, sipas legjislacionit në fuqi.
14. Pas verifikimit, nëpunësi i autorizuar i shërbimit spitalor plotëson dy çeqe. Çeku i parë do të jetë në vlerat e përcaktuara në pikën 4, të kreut II, të këtij vendimi.
15. Çeku i dytë do të jetë në masën prej 5 000 (pesë mijë) lekë dhe do të emetohet nga banka pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të foshnjës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
16. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile me detyrë pranë institucionit të shërbimit spitalor publik ose jopublik, çdo ditë të hënë, bën bilancin e të gjitha dokumenteve "Certifikatë asistence në lindje" të mbajtuara gjatë javës pararendëse dhe të dorëzuara nga institucioni i shërbimit spitalor, sipas pikës 2, të këtij kreu, duke evidentuar ato raste për të cilat është mbajtur akti i lindjes.
17. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, për rastet kur prindi/prindërit refuzojnë të bëjnë regjistrimin e foshnjës së lindur pranë institucionit të shërbimit spitalor ku ka ndodhur lindja, i dërgon Zyrës së Gjendjes Civile të vendbanimit të nënës dokumentin "Certifikatë asistence në

lindje", së bashku me dokumentin e identitetit të prindit/prindërve.

18. Nëpunësi i gjendjes civile pranë institucionit të shërbimit spitalor i dërgon informacion me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, çdo ditë të hënë, për dokumentet "Certifikatë asistence në lindje", të mbajtuara në javën pararendëse dhe të përcjella për veprim të mëtejshëm në zyrat e gjendjes civile të vendbanimit të nënës.
19. Në rastin kur akti i lindjes nuk mbahet në institucionin e shërbimit spitalor, prindi/prindërit ose njëri nga personat e parashikuar nga ligji i shërbimit të gjendjes civile, për deklarimin e lindjes paraqiten pranë zyrës së gjendjes civile ku kanë vendbanimin. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pas paraqitjes së deklaruesit, kryen veprimet sipas legjislacionit në fuqi dhe pajis me certifikatat e nevojshme deklaruesin.
20. Nëpunësit e zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin prindi/prindërit, të cilit i ka ardhur njoftimi "Certifikatë asistence në lindje", verifikon fillimisht nëse është regjistruar foshnja e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëse foshnja nuk është e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile e regjistron atë në Regjistrin e Përkohshëm.
21. Pas regjistrimit të foshnjës në Regjistrin e Përkohshëm, nëpunësi i gjendjes civile vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjendjen civile.
22. Në rastet kur lindja ka ndodhur në shërbimin spitalor jopublik të licencuar sipas legjislacionit në fuqi, prindi/prindërit pasi e regjistrojnë foshnjën në zyrën e gjendjes civile, pajisen me certifikatën personale nga akti i lindjes dhe familjare me shënimin:

    -–"*Lindje në institucion jopublik (emri i institucionit), lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare" (Bonusi),*

    do të paraqiten pranë Shërbimit Social Shtetëror për tërheqjen e çekut, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vendim. Përfituesit e çeqeve paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror:

    a) certifikatën e lindjes, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
    b) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
    c) kartat e identitetit të prindit/prindërve.
25. Në rastet kur akti i lindjes është mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile pasqyron lindjen në RKGJC, sipas procedurës. Nëpunësi, pasi verifikon nëse lindja është

pasqyruar sipas afateve ligjore brenda 90 ditëve pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin:

-- Lindje jashtë shtetit, nr. .. akti, datë..., muaj..., viti, vendin ku ka ndodhur lindja, lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare, regjistruar brenda afatit 90-ditor (Bonusi),

i cili do të paraqitet pranë Shërbimit Social Shtetëror për tërheqjen e çekut, sipas vlerave të përcaktuara në këtë vendim. Përfituesit e çeqeve paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror:

a) certifikatën e lindjes, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
b) certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile;
c) kartat e identitetit të prindit/prindërve.

26. Në rast se deklarimi i aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit kryhet jashtë afatit 90-ditor, nëpunësi i gjendjes civile kryen pasqyrimin e lindjes në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin:

    -- Lindje jashtë shtetit, nr. .akti, datë..., vendin ku ka ndodhur lindja, "Për përfitim të ndihmës së menjëhershme financiare Bonus, regjistruar jashtë afatit 90-ditor, nuk përfiton çekun prej 5 000 pesë mijë lekësh).

    Në këto raste prindi/prindërit nuk përfitojnë pagesën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

    26/1. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura, në çdo rast, prindi/prindërit, krahas dokumentacionit të përcaktuar në këtë vendim, paraqesin edhe formularin e vetëdeklarimit, që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
27. Për të gjitha rastet që nuk janë parashikuar nga ky vendim veprohet sipas legjislacionit në fuqi.
28. Tërheqja e çekut (Baby Bonus) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës, për foshnjat e lindura brenda ose jashtë shtetit.
29. Të gjitha institucionet e shërbimit spitalor, publike dhe jopublike, që kanë shërbimin e lindjes së foshnjës, duhet të bëjnë me dije dhe të kenë të njoftuar në mënyrë publike se në institucionin e tyre ofrohet edhe shërbimi i gjendjes civile për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të foshnjës së porsalindur.

30. Drejtuesi i shërbimit spitalor, publik dhe jopublik, i licencuar sipas legjislacionit në fuqi, ka detyrimin t'i ofrojë kushte pune dhe një mjedis të përshtatshëm nëpunësit të shërbimit së gjendjes civile, brenda institucionit për kryerjen e detyrave të tij, sipas legjislacionit në fuqi.

IV. SANKSIONET

1. Zbatimi i përcaktimeve të bëra në këtë vendim nga ana e institucionit të shërbimit spitalor publik dhe/ose jopublik, që ka shërbimin e lindjes së foshnjës, është subjekt kontrolli nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Në rast se strukturat përgjegjëse konstatojnë përfitimin pa të drejtë të ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr masa, sipas legjislacionit në fuqi, për kthimin e shumës së përfituar pa të drejtë.
3. Shkelja e përcaktimeve të bëra në këtë vendim nga ana e institucionit të shërbimit spitalor, publik dhe/ose jopublik, që ka shërbimin e lindjes së foshnjës, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) do të jepet sipas përcaktimeve në vendimin nr. 740, datë 12.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij," për të gjithë përfituesit që kanë nisur procedurat për marrjen e këtij përfitimi, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 740, datë 12.12.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (Bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij", shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Aneks nr. 1

(shtuar aneksi me Vkm nr. 824, date 28.12.2023)

FORMULAR I VETËDEKLARIMIT

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Emër Mbiemër	
Atësia/ Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jetoj pa ndërprerje në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Shërbimi Social Shtetëror autorizohet të verifikojë të dhënat e sistemit TIMS për vitin paraardhës, lëshuar nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, që vërteton se 180 ditë kalendarike, kam qenë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

DEKLARUESI

_____

Emër Mbiemër/firmë

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

_____

Emër Mbiemër/firmë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 252, datë 29.04.2022

PËR PROCEDURAT E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE *ON-LINE* NGA INSTITUCIONET SHËRBIMOFRUESE DHE PËR METODOLOGJINË E MONITORIMIT E TË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË ADMINISTRATIVE TË OFRIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen shërbimet e të gjitha institucioneve shërbimofruese, aplikimet e të cilave kryhen nëpërmjet platformës "*e-Albania*" dhe që duhet të realizohen vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.
2. Ky vendim ka për qëllim të sigurojë që ofrimi në mënyrë elektronike i shërbimeve të institucioneve shtetërore të jetë sa më cilësor dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 61, të ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen", dhe të legjislacionit në fuqi.
3. Ky vendim ka për objekt rregullimin e:
   a) procedurës së ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike nga institucionet shtetërore, duke lëshuar dokumentin përfundimtar elektronik, me nënshkrim ose vulë elektronike, në favor të subjektit kërkues;

   b) procedurës dhe të afateve të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në marrjen e shërbimit dhe të dokumentit elektronik me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik;
   c) metodologjisë së monitorimit dhe të kontrollit të veprimtarisë administrative, që kryhet në funksion të ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike.
4. Ndërveprimi i institucioneve ofruese të shërbimit me subjektet kërkuese, si dhe vendosja në dispozicion të tyre e dokumentit elektronik kryhen nëpërmjet platformës *"e-Albania"*. Të gjitha institucionet, që ofrojnë shërbime publike të lëshimit të dokumenteve zyrtare, janë të detyruara t'ia vendosin ato në dispozicion subjekteve kërkuese, në formën e dokumentit elektronik, me nënshkrim ose vulë elektronike, nëpërmjet platformës së sipërpërmendur.
5. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
   a) **"Institucion shtetëror"**, institucioni i administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas kuptimit të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
   b) **"Shërbim** *on-line*", procesi që konsiston në apo konkludohet me vendosjen në dispozicion të informacionit, lëshimin e një akti administrativ apo dokumenti zyrtar, në favor të subjektit kërkues apo përfitues, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe që në kuadër të këtij vendimi kryhet vetëm elektronikisht, sipas nenit 61, të ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen";
   c) "**Platforma "***e-Albania***""** ose **"Portali unik qeveritar "***e-Albania***""**, ka të njëjtin kuptim si në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Portali unik qeveritar "*e-Albania*"" dhe miratimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit;
   ç) "**Sistemi i qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik**", në vijim i quajtur "SQDNE", është sistemi i cili bën të mundur komunikimin, shkëmbimin e dokumenteve shoqërues

të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës "*e-Albania*", deri në lëvrimin e tij dhe lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e lëvrimit të shërbimit sipas afateve ligjore.

II. PROCEDURAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT NË MËNYRË ELEKTRONIKE DHE TË SHKËMBIMIT TË DOKUMENTEVE NDËRMJET INSTITUCIONEVE

A) Ofrimi i shërbimit në mënyrë elektronike, pa shkëmbim dokumentacioni me institucione të tjera

6. Institucioni shtetëror është i detyruar të administrojë kërkesat për shërbim nëpërmjet platformës "*e-Albania*".
7. Në rast se pranë institucionit paraqiten kërkesa për shërbim në rrugë postare në formën e dokumentit shkresor apo nëpërmjet postës elektronike, atëherë ai nuk e realizon atë, por i kthen përgjigje kërkuesit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke e udhëzuar ta paraqesë kërkesën nëpërmjet platformës "*e-Albania*".
   Përjashtimisht, vetëm dokumentet shoqëruese të kërkesës, të cilat nuk mund të ngarkohen në format elektronik, i dërgohen institucionit në format shkresor (hard copy). Në këto raste, kërkuesi paraqet kërkesën për shërbim nëpërmjet platformës "*e-Albania*", ndërsa dokumentacionin shoqërues të saj, origjinal apo të njësuar me të, e dorëzon në rrugë postare pranë institucionit përkatës.
8. Afati i institucionit shtetëror për realizimin e shërbimit, në kuptim të neneve 56 dhe 57 të Kodit të Procedurave Administrative, llogaritet dhe fillon të ecë pas ditës kur kërkuesi ka paraqitur kërkesën në platformën "*e-Albania*".
9. Afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit nga institucioni shtetëror është ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e tij dhe procedurën administrative konkrete.
10. Në mungesë të një afati të shprehur në legjislacionin e posaçëm, atëherë zbatohen, sipas rastit, afatet e mëposhtme për realizimin e shërbimeve *on-line*:
    a) 10 (dhjetë) ditë pune nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 1, të nenit 15, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", kur shërbimi ka të bëjë vetëm me vendosjen në dispozicion të informacionit apo lëshimin e një dokumenti që realizohet apo hartohet pa nevojën e hetimit administrativ;
    b) 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 5, të nenit 49, të Kodit të Procedurave Administrative, kur shërbimi ka të bëjë me njësimin e dokumenteve;
    c) 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 2, të nenit 91, të Kodit të Procedurave Administrative, kur shërbimi kërkon kryerjen e hetimit administrativ ose në rastet kur për kryerjen e shërbimit nevojiten procedura vendimmarrjeje dhe miratimi nga komisione të posaçme.
11. Shërbimi i vendoset në dispozicion kërkuesit, brenda afatit përkatës, në formën e dokumentit elektronik me nënshkrim ose vulë elektronike, duke ia përcjellë nëpërmjet platformës "*e-Albania*", në sesionin "hapësira ime".

B) Ofrimi i shërbimit në mënyrë elektronike, kur nevojitët shkëmbimi i dokumentacionit me institucione të tjera

12. Nëpunësi i administratës është i detyruar që kërkesën për ndihmë administrative për kryerjen e një ose disa veprimeve të nevojshme, veçanërisht për njohjen me dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër, sipas përcaktimit të nenit 71, të Kodit të Procedurës Administrative, ta dërgojë jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga paraqitja e kërkesës nga kërkuesi. Në çdo rast, ndihma administrative, sipas kësaj pike, kërkohet nëpërmjet SQDNE-së.
13. Detyrimi i nëpunësit të administratës shtetërore, për mundësimin e dokumenteve në SQDNE nis në momentin e marrjes së kërkesës për dokumentacionin shoqërues nëpërmjet SQDNE-së.
14. SQDNE-ja mundëson komunikimin për shkëmbimin e dokumenteve shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës "*e-Albania*", deri në lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e ofrimit të shërbimit, sipas afateve ligjore.
15. Shkëmbimi i dokumenteve dhe komunikimi ndërmjet institucioneve kryhen vetëm nëpërmjet SQDNE-së, në të cilin kanë akses punonjësit e administratës shtetërore, të caktuar për ndjekjen e procesit.

16. Në rastet kur nëpunësi i caktuar, për shkak pamundësie apo të kryerjes së pushimeve vjetore të pagueshme apo pushimeve të tjera me ose pa pagesë, nuk është prezent në punë, institucioni duhet të marrë masa për personin zëvendësues, i cili akseson sistemin me kredencialet e tij, me qëllim respektimin e afateve të shërbimit.
17. Aksesimi në sistem i punonjësit të administratës bëhet nëpërmjet kredencialeve personale, duke bërë të mundur identifikimin e tij në sistemin SQDNE, sipas legjislacionit që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
18. Dokumentet e hedhura në SQDNE nga punonjësi i administratës duhet të jenë të ngarkuara në këtë sistem sipas formatit të zyrtarizuar, të jenë të nënshkruara elektronikisht ose të pajisura me vulë elektronike, në varësi të dokumentit. Dokumentet, të cilat janë të ngarkuara në SQDNE dhe rezultojnë si të përfunduara, kanë vlerë të njëjtë me dokumentet e lëshuara në formën e shkresës fizike nga institucioni.
19. Të gjitha institucionet, që marrin kërkesën për dokumentacion shoqërues nga institucionet kërkuese, kanë detyrimin t'u vendosin atyre në dispozicion në SQDNE dokumentet shoqëruese të kërkuara, brenda afatit të përcaktuar në ligjin përkatës ose, në mungesë të tij, brenda 2 (dy) ditëve pune nga e nesërmja e marrjes së kërkesës për dokumentet shoqëruese në sistem.
20. Bëjnë përjashtim nga pika 19, e këtij vendimi, rastet kur shërbimi i kërkuar nga kërkuesi duhet t'i mundësohet atij brenda 1 (një) dite pune. Në varësi të këtyre shërbimeve, shkëmbimi i dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet SQDNE-së duhet të kryhet brenda 1 (një) dite pune nga e nesërmja e marrjes së kërkesës për dokumentet shoqëruese në sistem.
21. Në rastet kur dokumentacioni shoqërues, i cili mundësohet apo gjenerohet nga institucionet, ka detyrim financiar, kërkesa konsiderohet e vlefshme vetëm pas pagesës së kryer *on-line* ose pas hedhjes në sistem të mandatpagesës së kryer. Në këto raste, afati i shkëmbimit të dokumenteve shoqëruese në sistem nis nga e nesërmja e momentit kur vlerësohet se detyrimi financiar është përcjellë në sistem.
22. Për ndërveprimin e institucionit shtetëror me kërkuesin dhe për realizimin përfundimtar të shërbimit në favor të kërkuesit, zbatohen të

njëjtat rregulla si në pikat 6 deri në 11 të këtij vendimi, duke vendosur në dispozicion të tij dokumentin përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, nëpërmjet platformës "*e-Albania*".

III. MONITORIMI DHE KONTROLLI I ZBATIMIT, SHKELJET DHE PASOJAT

23. Në mënyrë që të zbatohen afatet për shërbimin ndaj kërkuesit, nëpunësit, eprori apo titullari duhet të kenë mundësinë e monitorimit nëpërmjet sistemit për të verifikuar statusin e kërkesës. Çdo nëpunës përgjegjës duhet të vetëdeklarojë, nëpërmjet sistemit, ofrimin e shërbimit ose statusin e kërkesës, duke përfshirë dhe datën në të cilën është ofruar ky shërbim te qytetari ose subjekti që ka paraqitur kërkesën.
24. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE-së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në ofrimin e shërbimit dhe të dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik në platformën "*e-Albania*", sipas afateve ligjore.
25. Nëpunësit përgjegjës raportojnë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për vonesat, kërkesat e refuzuara apo gabimet gjatë procesit për kërkim dokumentacioni, ofrimin e shërbimit dhe masat e marra nga institucioni në rast vonese në ofrimin e shërbimit.
26. Moskthimi brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim i një dokumenti shoqërues nga institucioni përgjegjës nuk përbën pengesë për institucionin kërkues që të vijojë procedurat e mëtejshme të trajtimit të kërkesës.
27. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim përbën kundërvajtje administrative dhe trajtohet sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen", duke nisur procedurën e inspektimit. Në përfundim të inspektimit, në rast se konstatohen shkeljet e afateve dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, ndaj punonjësit apo nëpunësit përgjegjës të administratës dhe/ose titullarit të institucionit merren masat e parashikuara në dispozitën e sipërpërmendur të ligjit nr. 107/2021.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

28. Institucionet shtetërore, që ofrojnë shërbime publike, për të cilat nuk aplikohet ende vetëm në platformën "*e-Albania*", janë të detyruara të dorëzojnë pranë AKSHI-t informacion lidhur me këto shërbime (emërtimi, formulari i aplikimit, dokumentacioni shoqërues dhe përshkrimi), brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, në mënyrë që AKSHI të marrë masa për realizimin e zhvillimeve teknike për përfshirjen e tyre në platformë, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen".
29. Subjekti kërkues mund të ushtrojë secilin nga këto mjete ligjore, më vete apo njëkohësisht, për të kundërshtuar mosveprimin e institucionit shtetëror ose përmbajtjen e dokumentit të lëshuar prej tij:
    a) ankimin administrativ, në përputhje me rregullat, formën dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në legjislacionin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e institucionit;
    b) ankesën pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, sipas ligjit nr. 107/2021, "Për bashkëqeverisjen".
30. Ngarkohen institucionet shtetërore për të miratuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregullore me karakter të brendshëm për mënyrën e zbatimit nga ana e punonjësve dhe strukturave të tyre përgjegjëse të detyrimeve që burojnë nga ky vendim.
31. Vendim nr. 43, datë 15.1.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik", i ndryshuar, shfuqizohet.
32. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Udhëzim

Nr. 07, datë 10.01.2012

Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve, që do të plotësohen nga përfaqësues të policisë së shtetit dhe të bashkive/njësive bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, pikës 1, 2, 3 të nenit 40, pikës 2 dhe 7 të nenit 41 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

Udhëzoj:

1. Përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, të cilët duhet të përcaktohen më parë nga titullari përkatës, kur konstatojnë sipas rastit:
    a) fëmijë, të cilët janë të pajisur me "certifikatën e asistencës në lindje"/"procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes", por që për shkaqe të ndryshme nuk janë të regjistruar dhe nënat e tyre i kanë lënë nën kujdesin e të afërmve;
    b) fëmijë të lindur dhe të pajisur me dokumentacion, por që nuk janë regjistruar në kohë për arsye subjektive;
    c) fëmijë të gjetur, të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacion, "certifikatën e asistencës në lindje"/"procesverbalin e hartuar në kohën e lindjes"; duhet të hartojnë menjëherë procesverbalin dhe të ndjekin regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjendjes civile, nën juridiksionin territorial të së cilës është gjetur/deklaruar si i paregjistruar fëmija.
2. Përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit që kanë gjetur/konstatuar rastin, bëjnë dokumentimin e tij, sipas përcaktimeve në pikën 1/a., b., c., duke plotësuar përkatësisht formularin tip Mod.1/Mod.2 Mod.3 në tri kopje.

3. Secili përfaqësues krijon dosjen përkatëse, në të cilën përfshihen:
   - kopja e procesverbalit;
   - asistenca e lindjes, apo çdo dokument që mund të disponojë i interesuari sipas rastit;
   - foto të çastit të gjetjes së fëmijës.
4. Përfaqësuesi i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, si dhe pala e interesuar nëse ka, së bashku me fëmijën, paraqiten para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile për të bërë deklarimin e lindjes së fëmijës pas plotësimit të praktikave, sipas përcaktimeve në pikën 1:
   a) për rastin e përcaktuar në pikën 1.a., do të plotësohet procesverbali Mod.1, të cilit i bashkëlidhet "certifikata e asistencës në lindje"/"procesverbali i hartuar në kohën e lindjes", që disponojnë të afërmit e fëmijës;
   b) për rastin e përcaktuar në pikën 1.b., do të plotësohet procesverbali Mod.2., të cilit i bashkëlidhet "certifikata e asistencës në lindje";
   c) për rastin e përcaktuar në pikën 1.c të këtij udhëzimi, do të plotësohet procesverbali Mod.3., të cilit i bashkëlidhet "raporti mjekësor", i plotësuar nga mjeku i zonës ku është gjetur fëmija.
5. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile zbaton rast pas rasti të gjitha procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", për këto kategori fëmijësh dhe për çdo akt të mbajtur njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.
6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryetarët e bashkive/njësive bashkiake/komunave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
7. Ngarkohet Zëvendësministri i Brendshëm për monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi.
8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Flamur NOKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMEPËRGJITHSHËM
ZYRA E GJENDJES CIVILE

Mod. 1

PROÇES-VERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.a)

I mbajtur sot, më datë __ . ___ . ____, nën juridiksionin e territorit të Bashkisë/ Njësisë Administrative/_____,Rrethi_____ nga:

1. Z./Znj._____ , pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

2. përfaqësues i Policisë së Shtetit, Komisariati _____ ;

3. Z./Znj._____, i pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

përfaqësues i Bashkisë/Njësisë Bashkiake/Komunës_____

në prani të:

Z./Znj._____, i pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është _____ dhe se fëmija ka lindur në _____

(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të pikës 2 të nenit 40 dhe të pikës 2 dhe 7 të nenit 41, të Ligjit Nr. 10129, datë 11. 05. 2009 "Për gjendjen civile", mbahet ky proçes-verbal për konstatimin e gjetjes së fëmijës, faktin e lindjes së të cilit, deklaruesi e vërteton me dokumentin "asistencë lindje" që i bashkëlidhet këtij proçes-verbali.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit	**Përfaqësuesi i Bashkisë / Njësisë Bashkiake / Komunës**
_____	_____
Emër, Atësi, Mbiemër (nënshkrimi)	Emër, Atësi, Mbiemër (nënshkrimi)

Pala e interesuar_____

Emër, Atësi, Mbiemër

- Shënim: Mbas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile, sipas Nenit 39 (pika 1, 2, 3, 5) të Ligjit Nr. 10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile" dhe pajisjes së tij çertifikatë lindje, personi i interesuar duhet t'i drejtohet gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijës / ose për njohjen e atësisë /amësisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMEPËRGJITHSHËM
ZYRA E GJENDJES CIVILE

Mod. 2

PROÇES-VERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.b)

I mbajtur sot, më datë __ . ___ . ____, nën juridiksionin e territorit të Bashkisë/ Njësisë Bashkiake/Komunës/_____,Rrethi_____ nga:

1. Z./Znj._____ , pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

përfaqësues i Policisë së Shtetit, Komisariati _____ ;

2. Z./Znj._____, i pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

përfaqësues i Bashkisë/Njësisë Bashkiake/Komunës_____

në prani të:

Z./Znj._____, i pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është _____ dhe se fëmija ka lindur në _____

(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 dhe 7 të nenit 41, të Ligjit Nr. 10 129, datë 11. 05. 2009 "Për gjendjen civile", mbahet ky proçes-verbal për konstatimin e gjetjes së fëmijës së paregjistruar, faktin e lindjes së të cilit, deklaruesi e vërteton me dokumentin "asistencë lindje" që i bashkëlidhet këtij proçes – verbali.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit

_____

Emër, Atësi, Mbiemër (nënshkrimi)

Përfaqësuesi i Bashkisë / Njësisë Bashkiake / Komunës

_____

Emër, Atësi, Mbiemër (nënshkrimi)

Pala e interesuar_____

Emër, Atësi, Mbiemër

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMEPËRGJITHSHËM
ZYRA E GJENDJES CIVILE

Mod. 3

PROÇES-VERBAL

(Për rastet e fëmijëve, të parashikuar në pikën 1.b)

I mbajtur sot, më datë __ . ___ . ____, nën juridiksionin e territorit të Bashkisë/ Njësisë Bashkiake/Komunës/_____,Rrethi_____ nga:

1. Z./Znj._____ , pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

përfaqësues i Policisë së Shtetit, Komisariati _____ ;

2. Z./Znj._____, i pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

përfaqësues i Bashkisë/Njësisë Bashkiake/Komunës_____

në prani të:

Z./Znj._____, i pajisur me dokument identifikimi me Numër Personal_____

i cili deklaron se është kujdesur për rritjen e fëmijës, pretendon se është _____ dhe se fëmija ka lindur në _____

(lidhja biologjike me fëmijën) (institucion, shtëpi, etj)

dhe ka mbetur i paregjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të pikës 2 të nenit 40 dhe të pikës 2 të nenit 41, të Ligjit Nr. 10129, datë 11. 05. 2009 "Për gjendjen civile", mbahet ky proçes-verbal për konstatimin e fëmijës së gjetur, të seksit _____, në vendin e quajtur _____ .

Bazuar në pikën 2 të nenit 39 të Ligjit Nr. 10 129, datë 11. 05. 2009 "Për gjendjen civile", këtij proçes – verbali, i bashkëlidhet dhe raporti mjekësor, i lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur fëmija.

Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit

_____

Emër, Atësi, Mbiemër (nënshkrimi)

Përfaqësuesi i Bashkisë / Njësisë Bashkiake / Komunës

_____

Emër, Atësi, Mbiemër (nënshkrimi)

Pala e interesuar_____

Emër, Atësi, Mbiemër

- Shënim: Mbas regjistrimit të fëmijës në gjendjen civile, sipas Nenit 39 (pika 1, 2, 3, 5) të Ligjit 10 129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile" dhe pajisjes së tij çertifikatë lindje, personi i interesuar duhet t'i drejtohet gjykatës për marrjen e kujdestarisë së fëmijës / ose për njohjen e atësisë /amësisë

UDHËZIM

Nr. 370, datë 07.12.2012

PËR PROCEDURAT E PASTRIMIT TË DUBLIMEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË NGA REGJISTRAT THEMELTARË DHE REGJISTRI KOMBËTAR I GJENDJES CIVILE

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 14,15, të pikës 3 të nenit 30, të nenit 36, të germave "a", "c" dhe "d" të nenit 65 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", si dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 11.12.2009 "Për përcaktimin e dokumenteve që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe institucionet shtetërore të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

I. VEPRIMTARITË PARAPRAKE

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mbështetur në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, të identifikojë dhe të hartojë listën e shtetasve të dyshuar si të dubluar, sipas procedurës në aneksin nr. 1.

   Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile verifikon edhe listat me emra të personave të dyshuar si të dubluar që mund të dërgojnë institucionet shtetërore të përfshira në procesin zgjedhor, si: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; bashki/njësi bashkiake dhe komuna në formatin elektronik excel me rubrikat: emri, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, datëlindja, vendlindja, gjinia, numri personal (në pamundësi të numrit personal, numri rendor sipas ekstraktit të përbërësve zgjedhorë) dhe vendbanimi (njësia vendore). Këto lista dorëzohen në DPGJC brenda 20 (njëzet) ditëve nga publikimi i ekstraktit të parë të përbërësve zgjedhorë sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. DPGJC-ja i grupon këto lista në një listë sipas formatit të aneksit nr. 2.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën sipas aneksit nr. 1 do ta ballafaqojë me listën emërore, sipas aneksit nr. 3, në të cilën përfshihen binjakët dhe personat e ndryshëm të identifikuar nga zyrat e gjendjes civile nga zbatimi i udhëzimit nr. 359, datë 11.10.2010 të Ministrit të Brendshëm.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën e përftuar nga procedura sipas pikës 2, do ta ballafaqojë me bazën e të dhënave të shtetasve që janë pajisur me letërnjoftim elektronik.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën e ardhur nga institucionet shtetërore të përfshira në proces, të hartuar sipas aneksit nr. 2, do ta ballafaqojë me RKGJC. Listën që përftohet nga ky proces, do ta ballafaqojë me listën sipas aneksit nr. 3.
5. Listën e përftuar sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, do ta ballafaqojë me bazën e të dhënave të shtetasve që janë pajisur me letërnjoftim.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, listën e përftuar sipas procedurës së pikës 3 e dërgon në çdo zyrë të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

   Listën e përftuar sipas pikës 5, DPGJC e dërgon në çdo zyrë të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunë brenda 5 ditëve nga marrja e listës nga institucionet e përfshira në proces. Listat emërore të shtetasve të dyshuar si të dubluar, grupohen si më poshtë:

   a) Dublime të dyshuara brenda së njëjtës zyrë të gjendjes civile.

   b) Dublime të dyshuara midis zyrave të gjendjes civile.
7. Zyra e gjendjes civile, pasi të marrë listën emërore, mbledh gjithë informacionin e nevojshëm për këta shtetas, si:
   - datën e regjistrimit në regjistrin themeltar;
   - arsyen e regjistrimit;
   - zyrën e gjendjes civile nga ka ardhur;
   - si dhe çdo informacion tjetër që ndihmon në saktësinë e procedurës së pastrimit të dublimit për individin/familjen.

II. VEPRIMET ME DUBLIMET BRENDA Së NJËJTËS ZYRë Të GJENDJES CIVILE

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, pasi ka mbledhur informacionin sipas pikës 7, fillon së pari me grupin e shtetasve të dyshuar si të dubluar brenda zyrës.

9. Për këtë përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile duhet të gjejë, të kontrollojë dhe të krahasojë përbërësit e gjendjes civile të këtyre shtetasve në regjistrin themeltar. Në rast se këto të dhëna përputhen dhe krijon bindjen se është i njëjti individ/familje, atëherë duhet të çregjistrojë individin/familjen në fletën ku arsyeton se duhet të kryhet. Për këtë duhet të shfrytëzojë të gjitha të dhënat e tjera shtesë që ka regjistri për individin/familjen.
10. Pasi ka mbaruar me veprimet në regjistrin themeltar, duhet të fillojë procedurën me veprimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Për të gjitha rastet e konstatuara si të dubluara apo fiktive, për individin/familjen, do të kryejë veprimet në RKGJC, sipas manualit bashkëlidhur.

III. VEPRIMET ME DUBLIMET MIDIS ZYRAVE TE GJENDJES CIVILE

Grupi parë (në regjistrin themeltar kemi shënime në rubrikën "burimi i informacionit")

11. Secila zyrë e gjendjes civile do të ballafaqojë nëse të dhënat e individit/familjes, që gjendet në listën e sjellë nga DPGJC, janë në përputhje me të dhënat e individit/familjes që ka të regjistruar në regjistrat themeltarë.
12. Kur binden se të dhënat i përkasin këtij individi/familje, atëherë i krahasojnë me të dhënat që kanë në RKGJC.
13. Zyra e gjendjes civile, që verifikon se:
    a) shënimet në rubrikën "Burimi i informacionit", si numri i librit dhe i fletës, emri i regjistrit dhe emri i zyrës së gjendjes civile, përputhen me të dhënat e zyrës, ku ky shtetas figuron i dubluar; dhe
    b) dinamika e të dhënave të individit/familjes provon se ku ky individ/familje është aktiv/e, atëherë punonjësi i zyrës së gjendjes civile plotëson dhe printon menjëherë nga sistemi në letër A4 (jo certifikatë) të dhënat në formën e certifikatës familjare dhe ia dërgon zyrës së gjendjes civile nga e cila rezulton se ka ardhur.
14. Zyra e gjendjes civile, që merr njoftim sipas pikës 13, kryen çregjistrimin e individit/familjes, fillimisht në regjistrin themeltar dhe më pas në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
15. Pasi kryen çregjistrimin nga të dy regjistrat, i dërgon konfirmimin zyrës nga e cila i erdhi formulari, duke e informuar se çregjistrimi u krye.

Grupi dytë (në regjistrin themeltar nuk kemi shënime në rubrikën "Burimi i informacionit")

16. Për rastet kur në regjistrin themeltar nuk kemi shënime në rubrikën "Burimi i informacionit", atëherë kjo zyrë duhet t'i kërkojë informacion zyrës ku kjo familje figuron e dubluar sipas listës bashkëlidhur.
17. Zyra që merr kërkesën për informacion, brenda 5 ditëve, plotëson të dhënat që rezultojnë në të gjitha rubrikat e regjistrit (nga rubrika 1-32, ose fotokopje të fletës së familjes) dhe ia dërgon këto zyrës që ka kërkuar informacion.
18. Zyra që kërkoi informacion sipas pikës 16 dhe mori përgjigje sipas pikës 17, e ballafaqon informacionin e marrë me të dhënat e fletëfamiljes së saj. Në këtë rast, ka dy mundësi:
    a) Kur fletëfamilja përmban të gjitha të dhënat, që përcaktojnë se familja është regjistruar në këtë fletë familje si pasojë e një transkriptimi, do të ketë prioritet për të qëndruar në këtë regjistër, në krahasim me familjen, e cila gjendet e regjistruar në zyrën tjetër dhe nuk ka shënim në rubrikën "Burimi i informacionit", si dhe nuk ka kryer asnjë veprim në këtë fletëfamilje. Pasi krahason të dy fletëfamiljet, zyra e gjendjes civile, ku individi/familja është regjistruar pa burim informacioni dhe nuk ka kryer veprime, duhet ta çregjistrojë atë nga regjistri themeltar dhe nga RKGJC. Pasi kryen këto veprime, informon zyrën e gjendjes civile nga e cila mori të dhënat se çregjistrimi u krye.
    b) Kur individi/familja, edhe pse në fletë familjen e tij/saj, nuk ka shënim në rubrikën "Burimi i informacionit ", por ka kryer veprime në këtë zyrë si regjistrime lindje, martese, vdekje etj, ky/kjo individ/familje do të qëndrojë në këtë regjistër dhe nëpunësi i zyrës së gjendjes civile do t'i kërkojë zyrës së gjendjes civile nga e cila mori informacionin që të çregjistrojë individin/familjen. Zyra e gjendjes civile që merr këtë kërkesë, bën çregjistrimin e individit/familjes në regjistrin themeltar dhe në RKGJC dhe njofton zyrën tjetër që çregjistrimi u krye.
    c) Në rast se pas verifikimit të të dhënave të individit/familjes me të dhënat në regjistrin themeltar rezulton se referencat janë po ato, por jo të gjitha rubrikat e të dhënave përputhen, atëherë kemi rastin e një fletëfamiljeje fiktive.

Kur bindet se ka të bëjë me një fletë familje fiktive, do të çregjistrojë individin/familjen nga regjistri themeltar, duke mbajtur procesverbalin e posaçëm dhe më pas do të bllokojë këtë individ/familje në RKGJC me anë të procedurës "Blloko person", siç shpjegohet në manualin bashkëlidhur.

Nëse më pas provohet se kjo familje nuk është fiktive, atëherë do të rikthehet në gjendjen e mëparshme, duke marrë miratimin në DPGJC.

ç) Për të gjitha praktikat e dublimeve të mbetura pezull, bëhet verifikimi dhe printimi nga regjistri kombëtar i përbërjes familjare në të dyja a më shumë zyra, sipas rastit, ku ato figurojnë si individ/familje të dubluar. Më pas plotësohet dosja përkatëse për secilin rast, duke kërkuar fotokopje dhe të fletëve të regjistrit nga kanë ardhur, dhe/ose nga zyrat ku ato figurojnë ende të dubluar. Pas verifikimit, kryhen veprimet për çregjistrimin e tyre sipas rastit si familje, kur ato figurojnë si familje dhe kur informacioni është i saktë e përputhet. Për rastet kur përmbajtja e fletës familjare ka mospërputhje dhe ndryshime në datëlindje dhe këto ndryshime nuk mbështeten në një libër aktesh apo dokument bazë, të pasqyruar si burim informacioni (zyra e gjendjes civile vërteton se kjo familje nuk ka qenë asnjëherë e regjistruar në atë zyrë nga ka ardhur fletëfamilja dhe nga ajo zyrë nuk është dërguar një fletë familje e tillë, d.m.th. nuk përputhet shënimi në regjistër i rubrikës se nga ka ardhur me zyrën përkatëse), atëherë në mbështetje të pikës 3 të nenit 30 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, përmbajtja e fletës familjare të regjistrit është e pavlefshme dhe për pasojë këta shtetas duhet të çregjistrohen nga regjistri themeltar dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, pasi janë shtetas të regjistruar fiktivë.

Grupi tretë (dublime të krijuara si pasojë e mosdërgimit të njoftimit të martesës)

19. a) Zyra që verifikon se individi që ballafaqoi në regjistrin e saj është i martuar dhe dublimi është krijuar si pasojë e mosdërgimit të njoftimit të martesës në zyrën e gjendjes civile, ku individi figuron beqar, nëpunësi i gjendjes civile vepron në këtë mënyrë: Zyra e gjendjes civile ku individi figuron i martuar, pasi bën verifikimin që vërteton se ka të bëjë me të njëjtin individ (në rubrikën burimi i informacionit

përputhen të dhënat që ky individ ka ardhur me martesë nga zyra ku figuron i dubluar), nëpunësi i zyrës së gjendjes civile plotëson njoftimin e martesës, duke cilësuar dhe vendin ku është lidhur martesa dhe ia dërgon zyrës ku ky i fundit figuron beqar.

b) Në të njëjtën mënyrë do të veprohet dhe për rastet kur martesat janë bërë në përfaqësitë tona diplomatike dhe njoftimi i martesës nuk i ka vajtur zyrës së gjendjes civile ku individi figuron beqar. Zyra e gjendjes civile ku individi figuron i martuar, plotëson certifikatën e martesës me shënimin se ku është e lidhur kjo martesë dhe ia dërgon zyrës së gjendjes civile ku individi figuron beqar.

c) Në të dyja rastet, sipas e germave "a" dhe "b" të pikës 19, zyra e gjendjes civile ku individi figuron beqar, pasi merr njoftimin apo certifikatën e martesës, bën ballafaqimin e të dhënave dhe më pas bën çregjistrimin sipas njoftimit të ardhur në regjistrin themeltar dhe në RKGJC.

Grupi i katërt (dublim i krijuar në sistemin *online*)

20. Në rast se dublimi ka ardhur si pasojë e mbajtjes së dy akteve lindjeje në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për të njëjtin person, atëherë do të verifikohen të dyja aktet:

a) Nëse janë të njëjtë në përmbajtje, do të fshihet akti i cili është mbajtur më vonë.

b) Nëse janë të ndryshëm, do të gjykohet rast pas rasti dhe do të vendoset nga nëpunësi i gjendjes civile, se cili nga aktet është i vlefshëm dhe cili rekord i krijuar prej tij do të mbahet.

21. Në rast se dublimi ka ardhur si pasojë e shtimit të shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, me procedurën "Shto person" kryhet verifikimi se kur është kryer veprimi dhe për çfarë arsye është krijuar personi. Sipas informacionit, nëpunësi i gjendjes civile gjykon dhe vendos se cilin prej rekordeve do të çregjistrojë dhe më pas kryen procedurën e pastrimit të dublimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

22. Në çdo rast pastrim dublimi, nëpunësi i gjendjes civile për çdo shtetas të listës së ardhur nga DPGJC, verifikon edhe të dhënat për çdo pjesëtar të familjes së tij në regjistrin themeltar dhe në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

23. Zyra e gjendjes civile, e cila ka marrë listë për dublime të dyshuara nga DPGJC, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së listës paraqet

në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile listën e individëve/familjeve që ka çregjistruar sipas procedurës së mësipërme, si dhe listën e atyre që nuk ka çregjistruar me arsyen përkatëse.

24. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe të gjitha zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.
25. Udhëzimi nr. 359, datë 11.10.2010 i Ministrit të Brendshëm, shfuqizohet.
26. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI i brendshëm
Flamur Noka

Procedura e kontrollit të dublimeve

Shënim. Procedurat nuk marrin parasysh ndryshimet e germave "C" me "Ç" dhe "E" me "Ë" pra "Clirim" dhe "Çlirim" quhet i njëjti emër dhe kapet si dublim (emrat Engjellushe e Engjëllushe).

1. **Procedura A:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i nënës, emri i babait**, dhe **datëlindje** të njëjtë.
2. **Procedura B1**: Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** dhe **vitlindje** të njëjtë.
3. **Procedura B2:** Kap personat **me emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** dhe **ditë** të njëjtë.
4. **Procedura B3:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** dhe **muaj** të njëjtë.
5. **Procedura B4:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, vendlindje** të njëjtë dhe ndryshon **datëlindja** në 1 shifër.
6. **Procedura Ç:** Kap personat me **emër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **mbiemri** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).
7. **Procedura D:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, datëlindje** të njëjtë dhe **emri** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).
8. **Procedura E:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i babait** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).
9. **Procedura F:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje, kod zgjc, të dhënat e regjistrit (emër, faqe, rendor)** të njëjtë ndryshon **emri**.
10. **Procedura G:** Kap personat me **emri i babait, mbiemër, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **emri** ndryshon me një germë ose dy, dhe numri i karaktereve të **emrit** ndryshon me një ose dy.
11. **Procedura H:** Kap personat me **emër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **mbiemri** ndryshon me një germë ose dy,

dhe numri i karaktereve të **mbiemrit** ndryshon me një ose dy.

12. **Procedura J:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i babait** ndryshon me një germë ose dy dhe numri i karaktereve të **emri i babait** se ndryshon me një ose dy.
13. **Procedura K:** Kap personat me **emër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë, Seksi=Femër dhe **mbiemri** ndryshon (Për të kapur gratë e martuara që kanë mbetur pa u çregjistruar).
14. **Procedura L:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i nënës** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).
15. **Procedura M:** Kap personat me **emri, mbiemri, emri i babait, datëlindje** të njëjtë dhe **emri i nënës** ndryshon me një germë ose dy dhe numri i karaktereve.
16. **Procedura N1:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe **vendlindja** ndryshon me një germë, por numri i karaktereve është i njëjtë (deri në 16 karaktere).
17. **Procedura N2:** Kap personat me **emër, mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje** të njëjtë dhe ndryshon me një germë deri në katër dhe numri i karaktereve te **vendlindja** ndryshon me një deri në katër.
18. **Procedura O:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje**, **vendlindja** të njëjtë dhe **emri** i ndryshëm.
19. **Procedura P:** Kap personat me **mbiemër, emri i babait, emri i nënës, datëlindje**, **vendlindja, kodi i zyrës** të njëjtë dhe **emri** i ndr

UDHËZIM

Nr. 284, datë 11.3.2019

PËR PROCEDURËN E MBAJTJES SË AKTIT TË LINDJES SË FËMIJËVE, NË RASTET KUR NUK ËSHTË RESPEKTUAR AFATI KOHOR I REGJISTRIMIT TË TYRE, BRENDA 60 DITËVE NGA DATA E LINDJES

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 40, pika 3 dhe të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme dhe procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki, në rastin kur nuk është bërë regjistrimi i fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar), brenda 60 ditëve nga data e lindjes.
2. Kur nëpunësi i gjendjes civile konstaton se, nuk është kryer regjistrimi i fëmijës së lindur në Regjistrin Kombëtar, brenda 60 ditëve nga data e lindjes, njofton me shkresë zyrtare për këtë fakt, drejtuesin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës.
3. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, dërgon për trajtim shkresën pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës, brenda 24 orëve nga paraqitja e saj. Në rastin e Bashkisë Tiranë, shkresa i dërgohet çdo njësie administrative që ka njësi të veçantë të mbrojtjes së fëmijës.
4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës (në vijim *punonjësi për mbrojtjen e fëmijës*) administron shkresën dhe dokumentacionin e dërguar nga nëpunësi i gjendjes civile, si dhe çdo akt tjetër që nxjerr sipas këtij udhëzimi, duke krijuar dosje të veçantë për çdo fëmijë të paregjistruar.

5. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë nga nëpunësi i gjendjes civile, i cili duhet të përgjigjet brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës.
6. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kontakton menjëherë me prindin/prindërit e fëmijës të paregjistruar në Regjistrin Kombëtar dhe në pamundësi të kontaktit me ta, kontakton me çdo person, që mund të deklarojë lindjen e fëmijës, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 40, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar dhe, në pamundësi për të kontaktuar edhe me këta persona, i drejtohet subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të po këtij neni.
7. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës informon personin e kontaktit përcaktuar në pikën 6, të këtij udhëzimi:
   a) për detyrimin për regjistrimin e fëmijës në gjendjen civile sipas legjislacionit në fuqi;
   b) për përfitimet dhe domosdoshmërinë e regjistrimit të fëmijës;
   c) se në rast se fëmija nuk regjistrohet brenda 60 ditëve nga data e lindjes procedura e regjistrimit të fëmijës kryhet nga njësia për mbrojtjen e fëmijës.

   Për takimin e zhvilluar mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të pranishmit dhe, nëse refuzohet nënshkrimi, evidentohet ky fakt. Procesverbali bëhet pjesë e dosjes së fëmijës së paregjistruar.
8. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës cakton një afat prej 10 ditësh nga zhvillimi i takimit sipas pikës 7, me qëllim që personi i kontaktuar sipas pikës 6, të regjistrojë fëmijën në Regjistrin Kombëtar.
9. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 8, të këtij udhëzimi, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës verifikon në zyrën e gjendjes civile nëse janë paraqitur personat sipas pikës 6, të këtij udhëzimi, për mbajtjen e aktit të lindjes dhe sipas rastit, kryen veprimet e mëposhtme:
   a) nëse fëmija është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës harton raportin përmbledhës për veprimet e kryera, pjesë e të cilit është edhe konkluzioni për mbylljen e dosjes;
   b) nëse fëmija nuk është regjistruar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, në bashkëpunim me nëpunësin e zyrës së gjendjes civile, përcaktojnë emrin e fëmijës, hartojnë aktin e lindjes dhe e nënshkruajnë atë.

   Emri i fëmijës, së regjistruar sipas kësaj procedure, është "i përkohshëm" dhe mund të ndryshojë vetëm me kërkesë të personave dhe sipas procedurës, të përcaktuar sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, për këtë rubrikë dhe vetëm në këto raste.
10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës njofton zyrtarisht personin me të cilin ka kontaktuar, sipas pikës 6, të këtij udhëzimi, për regjistrimin e fëmijës, modalitetet e regjistrimit, si dhe i dërgon kopje të aktit të lindjes.
11. Dokumentacioni për regjistrimin e fëmijës, sipas procedurës së parashikuar në këtë udhëzim, hartohet dhe protokollohet në dy kopje, një kopje pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe një kopje në zyrën e gjendjes civile ku është bërë regjistrimi.
12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

Fletore zyrtare nr. 44, datë publikimi 29.03.2019

UDHËZIM

Nr. 285, datë 11.3.2019

PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT TË PËRKOHSHËM PËR LINDJET E RAPORTUARA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Regjistri i Përkohshëm në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 41/1, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, është një modul elektronik, në të cilin do të pasqyrohen të dhënat vetëm për rastet e lindjeve të raportuara dhe të paregjistruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
2. Regjistri i Përkohshëm, këtu e në vijim i përmendur si "moduli", do të jetë i integruar në të njëjtin mjedis ku është i integruar Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, pra, portal *web*.
3. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i këtij moduli do të realizohet nga subjekti që mirëmban dhe zhvillon portalin *web* të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e të dhënave që ruhen në këtë modul.
   Përditësimi i të dhënave bëhet nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile të njësive administrative.
5. Në këtë modul pasqyrohen të dhënat për gjithë të lindurit e paregjistruar, të cilët prezumohet se kanë shtetësinë shqiptare, pavarësisht faktit se kanë lindur brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se kanë lindur në institucione spitalore publike/jopublike apo jashtë tyre, sipas përcaktimeve të pikës 6, të këtij udhëzimi.

6. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative pasqyron në këtë modul të dhënat:
   a) për të gjithë fëmijët e lindur në institucione spitalore, për të cilët ka marrë njoftimin prej këtyre institucioneve dhe ndërkohë personat që kanë të drejtën dhe detyrimin e deklarimit nuk janë paraqitur para nëpunësit për të mbajtur aktin e lindjes;
   b) për të gjithë të lindurit, për të cilët nëpunësi i gjendjes civile, pasi është njohur me kërkesën e deklaruesit konstaton se nuk mund të mbajë akt lindjeje, për shkak se dokumenti "asistencë në lindje" ose raporti mjekësor është me pasaktësi ose ka rubrika të paplotësuara;
   c) për të gjitha rastet kur deklaruesi nuk ka dokument që vërteton lindjen;
   ç) për rastet kur akti i lindjes i mbajtur jashtë vendit ka pasaktësi ose është i paplotë në rubrikat e tij;
   d) si dhe çdo rast tjetër që konstatohet i paregjistruar, për të cilin nuk mund të mbahet akt lindje në momentin e konstatimit/deklarimit.
7. Të dhënat e pasqyruara në modul do të qëndrojnë aty derisa rasti të zgjidhet. Zgjidhja mund të jetë nëpërmjet rrugës gjyqësore ose rrugës administrative dhe nëpunësi të ketë mundësinë e mbajtjes së aktit të lindjes ose të pasqyrimit të aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit.
8. Të dhënat që përmban moduli janë si më poshtë:
   - emri/mbiemri i personit të pa regjistruar;
   - emri i babait dhe numri personal i babait (nëse ka);
   - emri i nënës dhe numri personal i nënës;
   - datëlindja;
   - vendlindja;
   - gjinia;
   - adresa e banimit dhe numri i kontaktit;
   - arsyeja e mosregjistrimit;
   - dokumentet e paraqitura që mund të jenë:
     i. raportimi nga institucionet e shërbimit spitalor shtetëror, publik ose privat;
     ii. raportime nga institucione të ndryshme;
     iii. raportim nga vetë shtetasit;

- data e regjistrimit në Regjistrin e Përkohshëm;
- data e zgjidhjes së rastit/regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

9. Moduli përmban edhe opsionin e njoftimit të nëpunësit të gjendjes civile, në rastin kur kalohet afati 60-ditor nga data e lindjes.
   Me kalimin e afatit 60-ditor të përmendur më lart, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kryen këto veprime:
   a) kontrollon nëse të dhënat e regjistruara për lindjen dhe/ose regjistrimin janë regjistruar përfundimisht në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në rast se është bërë regjistrimi i të dhënave për personin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, atëherë nëpunësi i gjendjes civile vendos në modul shënimin: "E zgjidhur".
   b) në rast se nëpunësi i gjendjes civile konstaton se fëmija nuk është regjistruar ende në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, atëherë kryen veprimet e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm, "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes së fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes".
10. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në bazë të të dhënave të modulit lëshon vërtetim sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.
    Vërtetimi i lëshuar nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile i jepet të interesuarit për plotësimin e të drejtave të tij për arsim, trajtim shëndetësor ose përfitimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, apo në çdo aspekt tjetër për të cilin ka interes të ligjshëm.
11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nëpunësit e zyrave të gjendjes civile për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
Zyra e Gjendjes Civile _____

Nr. _____, prot Datë____,____,_____

VËRTETIM

Emri/mbiemri i personit_____
datëlindja _____
vendlindja _____
emri i babait _____, numri personal _____dhe,
emri i nënës_____, numri personal_____,

është i regjistruar në Regjistrin e Përkohshëm të Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Administrative_____.

Ky dokument lëshohet për efekt _____

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____

Emër / mbiemër vula

Shënim:
Ky vërtetim ka burimin dhe gjenerohet nga Regjistri i Përkohshëm që mbahet nga zyra e gjendjes civile.
Ky vërtetim ka vlerë juridike dhe lejohet të përdoret deri në momentin që personi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
Ky vërtetim është i vlefshëm vetëm për realizimin e të drejtave të ligjshme të personit, të tilla si arsimin, përkujdesje shoqërore, trajtim shëndetësor etj.
Të dhënat që përmban ky vërtetim nuk janë dokument identiteti për personin dhe të dhënat e pasqyruara janë vetëm në bazë të deklarimeve të bëra nga vetë personi/kërkuesi në momentin e regjistrimit në Regjistrin e Përkohshëm.

Fletore zyrtare nr. 44, datë publikimi 29.03.2019

UDHËZIM

Nr. 286, datë 11.3.2019

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE QË ZBATOHET NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE KUR NË AKTIN E LINDJES, MBAJTUR JASHTË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ËSHTË E PAPLOTËSUAR RUBRIKA E EMRIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 45, pika 3/"a" të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës administrative, që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile, për regjistrimin e fëmijëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në rastet kur në aktin e lindjes së tyre të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar vetëm rubrika e emrit të fëmijës.
2. Kërkesa për pasqyrimin e të dhënave të aktit të lindjes, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e paplotësuar të emrit, paraqitet nga të dy prindërit/prindi ose nga çdo person i parashikuar sipas ligjit "Për gjendjen civile", i ndryshuar. Kërkesa paraqitet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin prindërit/prindi.
3. Personi deklarues, sipas pikës 2, paraqet në zyrën e gjendjes civile ku kanë vendbanimin:
   a) kërkesën e nënshkruar prej tyre, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij;
   b) dokumentin origjinal të aktit të lindjes, i cili është në formën e kërkuar nga ligji me vulën "APOSTILLE", por që ka të paplotësuar rubrikën e emrit;
   c) deklaratën me shkrim për emrin që do të mbajë fëmija, sipas formularit 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij, duke përjashtuar emrat që janë parashikuar nga aktet nënligjore në fuqi, si të papërshtatshëm për t'u mbajtur;

   ç) kopje të letërnjoftimit;
   d) prokurën e posaçme, kur nuk është asnjë nga prindërit deklarues.
4. Nëpunësi i gjendjes civile, pasi ka administruar dokumentacionin sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, regjistron fëmijën në Regjistrin Kombëtar me emrin që kanë deklaruar deklaruesit sipas formularit 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
   Nëpunësi i gjendjes civile në rubrikën "përshkrimi" shënon: "*Regjistrim lindjeje sipas aktit nr. ___, datë ____/____/____, mbajtur në zyrën e gjendjes civile_____ dhe deklaratës së vendosjes së emrit nr. ___, datë ___/___/____*" .
5. Në rastin kur akti i lindjes, i mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ka rubrikën e emrit të paplotësuar dhe nuk përmban vulën "APOSTILLE", atëherë nëpunësi:
   a) këshillon deklaruesin për procedurën ligjore të vendosjes së vulës "APOSTILLE" në aktin e lindjes, kur ai shprehet se do ta kryejë vetë këtë procedurë;
   b) kur i interesuari është në pamundësi ta kryejë vetë këtë procedurë, nëpunësi i gjendjes civile duhet:
      i) të hartojë një procesverbal në të cilin provon se i interesuari ka depozituar në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së fëmijës, të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar;
      ii) të sqarojë deklaruesin për tarifën financiare që duhet të paguajë për këtë shërbim dhe mënyrën e arkëtimit të saj.

   Nëpunësi i gjendjes civile, aktin e lindjes të mbajtur me procesverbal, si dhe kopjen e mandatit të arkëtimit në bankë, të tarifës së përcaktuar sipas pikës 6, e dërgon me shkresë zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda 48 orëve dhe kjo e fundit e përcjell te strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme brenda 48 orëve nga data e marrjes. Në këtë rast, deklaruesit i jepet një kopje e procesverbalit, ku të jenë shënuar edhe kontaktet e nevojshme të tyre, së bashku me adresën e tij.
6. Deklaruesit kryejnë pagesën e tarifës së përcaktuar, në numrin e llogarisë bankare të ambasadës apo konsullatës përkatëse, ku do të dërgohet akti për vendosjen e vulës "APOSTILLE". Këto numra llogarie publikohen pranë çdo zyre të gjendjes civile.

7. Në rast të mosmbajtjes së aktit të lindjes sipas pikës 5 të këtij udhëzimi, nëpunësi i gjendjes civile i regjistron të dhënat e fëmijës në Regjistrin e Përkohshëm, sipas procedurës së parashikuar në udhëzimin përkatës.
8. Në rastin e parashikuar në pikën 5 ("a") të këtij udhëzimi, kur deklaruesi, risjell në zyrën e gjendjes civile aktin e lindjes së mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me rubrikën e emrit të paplotësuar në të cilën është vendosur vula "APOSTILLE", nëpunësi i gjendjes civile kryen procedurën e parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.
9. Në rastin e parashikuar në pikën 5, ("b"), procedura e regjistrimit fillon pasi mbërrin zyrtarisht në zyrën e gjendjes civile që e dërgoi, akti i lindjes i pajisur me vulën "APOSTILLE". Pasi merr aktin në formën e kërkuar, nëpunësi i gjendjes civile njofton deklaruesin dhe, pas paraqitjes së tij, fillon procedurën e parashikuar në pikën 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.
10. Pas përfundimit të kësaj procedure, nëpunësi i gjendjes civile pajis deklaruesin me certifikatën e lindjes së fëmijës së regjistruar.
11. Fashikulli i krijuar nga kjo procedurë është me afat ruajtje të përhershme.
12. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile dhe misionet diplomatike e postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

Formulari 1

KËRKESË

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Administrative_____ ____

KËRKUES: Z./Znj. _____, i biri _____dhe _____, e datëlindjes _____, me numër personal_____, banues në adresën: _____ _____ cel._____ose numër kontakti: _____

Lënda: Kërkesë për kryerjen e procedurës administrative për regjistrimin e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pasi në aktin e lindjes të mbajtur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar rubrika e emrit të personit.

Unë i/e quajturi/a _____, paraqes këtë kërkesë, pranë Zyrës së Gjendjes Civile _____, me anë të së cilës kërkoj, plotësimin e rubrikës së emrit të fëmijës, në aktin e lindjes të mbajtur në_____, sipas deklaratës bashkëlidhur.
Bashkëlidhur paraqes edhe aktin e lindjes origjinal, të mbajtur në shtetin _____.

KËRKUESI
_____

Datë: _____

Formulari 2

Nr. _____Prot. Datë_____

DEKLARATË E PËRBASHKËT E VENDOSJES SË EMRIT

Sot, më datë _____/_____/_____, unë i/e nënshkruari/a,
Z./Znj. _____, lindur në _____, më datë____/____/_____,
me numër personal_____, banues/e në_____

në cilësinë e _____, deklaroj se:

fëmija i gjinisë ____, i lindur në _____, më datë ____/____/_____,

nga prindërit _____ dhe _____,

do të **quhet "_____".**

E lëshojmë këtë deklaratë, pasi akti i lindjes me nr. _____, datë _____/_____/_____, i mbajtur pranë
zyrës së gjendjes civile _____, nuk e ka të pasqyruar rubrikën e emrit të fëmijës.

Unë, nëpunësi i gjendjes civile, bazuar në pikën 3/"a", të nenit 45, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar, si dhe mbështetur në deklarimin e bërë nga _____ dhe pasi verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se ato janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe në vullnetin e lirë dhe të pavarur të deklaruesit.

Për këtë arsye unë e nënshkruaj atë, duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.

Deklaruesi **Nëpunësi i Gjendjes Civile**

_____ _____

Përfaqësuesi me prokurë _____

Bashkëlidhur kësaj deklarate vendoset fotokopja e letërnjoftimit të deklaruesit; kërkesa e tij; akti i lindjes nr. _____, datë_____, i mbajtur nga zyra e Gjendjes Civile _____.

Ky fashikull është me afat ruajtjeje të përhershme.

Fletore zyrtare nr. 44, datë publikimi 29.03.2019

UDHËZIM

Nr. 90, datë 2.4.2014

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË SHPALLJES, PËR KËRKESËN E NDRYSHIMIT TË EMRIT/MBIEMRIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Forma dhe përmbajtja e shpalljes për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit, e cila duhet t'u njoftohet nëpërmjet publikimit, personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuesit, apo atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar, të jetë sipas modelit, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Prefekti, pasi kryen verifikimet mbi dosjen dhe çmon se janë përmbushur kërkesat dhe procedurat e ligjit për gjendjen civile, përsa i përket ndryshimit të emrit/mbiemrit, për shkak të papërshtatshmërisë, urdhëron afishimin e shpalljes së kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa dhe ku kërkuesi ka vendbanimin, si dhe në dy prej gazetave dhe/ose në Fletoren Zyrtare, për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefekti i qarkut, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarkut.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____

NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

Zyra e Gjendjes Civile _____

PUBLIKIM KËRKESE PËR NDRYSHIMIN EMRI/MBIEMRI

Në shqyrtim të praktikës për ndryshimin e emrit/mbiemrit, për shtetasin _____ , të paraqitur në zyrën e gjendjes civile të bashkisë/njësisë (emër, mbiemër) bashkiake/ komunës _____, ku shtetasi në fjalë ka vendbanimin e tij, banues në _____, pasi janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, në zbatim të pikës 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, sot më datë ___ . ____ . _____ prefekti i qarkut _____ autorizon publikimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit të shtetasit për shkak të papërshtatshmërisë

nga: _____ **në:** _____

Në zbatim të nenit 57/5 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

Shpallur në _____, më datë ___ . ____ . _____

Fletore zyrtare nr. 72, datë publikimi 23.05.2014

Udhëzim

Nr. 91, datë 2.4.2014

PËR RREGULLAT LIDHUR ME PËRCAKTUESHMËRINË E EMRAVE/ MBIEMRAVE TË KONSIDERUAR TË PAPËRSHTATSHËM DHE TË ATYRE ME RËNDËSI HISTORIKE, TË FAMILJEVE TË SHQUARA NË SHKALLË KOMBËTARE, APO TË MIRËNJOHURA NË BASHKINË/KOMUNËN, KU KA VENDBANIMIN PERSONI I INTERESUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 7 të nenit 2 nenit 57/2, të pikave 2 dhe 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile

UDHËZOJ:

1. Me paraqitjen pranë zyrës së gjendjes civile të kërkesës, në të cilën ka vendbanimin personi i interesuar që kërkon të kryejë ndryshimin e emrit/mbiemrit, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kryen këto veprime:
   a) Pasi bindet për ligjshmërinë e kësaj kërkese, përsa i përket arsyetimit të parashikuar nga ligjvënësi, kërkesë e cila duhet të bëhet vetëm për shkaqe papërshtatshmërie, i dërgon brenda 60 ditëve, praktikën përkatëse institucionit të prefektit të qarkut, nën juridiksionin e të cilit ndodhet bashkia/njësia bashkiake/ komuna, së bashku me njoftimin përkatës, në të cilin duhet të jetë specifikuar emri/mbiemri i kërkuesit, si dhe të dhënën e re (emër/mbiemër) që kërkon të marrë i interesuari në bazë të kërkesës së tij.
   b) Me marrjen e këtij njoftimi, institucioni i prefektit të qarkut nis procedurën me karakter verifikues, në bazë të listës së vënë në dispozicion për emrat e papërshtatshëm dhe të emrave me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare dhe lokale. Në këtë kuadër, ky institucion mund të ndërmarrë dhe iniciativa të mëtejshme konsultimi, për çdo (emër, mbiemër) që nuk është i përfshirë në listë, në kushtet kur gjykohet prej tij,

se mund t'i përkasë njërës prej kategorive të sipërpërmendura. Kjo procedurë mund të vijojë rast pas rasti, me institucionet e posaçme kompetente për rastet e papërshtatshmërisë dhe të emrave me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare.

2. Pasi të ketë përfunduar ky proces dhe të jenë mbledhur përgjigjet e institucioneve përkatëse, në rastet kur emri/mbiemri i ri nuk bën pjesë në kufizimet e paracaktuara ligjore, për të interesuarin, do të vijohet me fazat e mëtejshme të miratimit. Në rast të kundërt, nëpërmjet zyrës së gjendjes civile, të interesuarit do t'i kërkohet përcaktimi i një emri/mbiemri të ri, për të cilin duhet të ndiqet përsëri e njëjta procedurë, si në pikën 1 të këtij udhëzimi.
3. Ky proces do të vijojë me mbledhjen dhe dokumentimin e herëpashershëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në cilësinë e organit epror të shërbimit të gjendjes civile, i cili do të jetë përgjegjës për përditësimin e listës me emra të papërshtatshëm dhe të emrave të figurave me rëndësi historike, të mirënjohura në shkallë kombëtare dhe lokale. Kjo listë fillimisht do të gjenerohet në bazë të mendimeve respektive të dërguara nga institucionet kompetente, të specializuara, bashkëpunuese në këtë proces, si Qendra e Studimeve Albanologjike, Fakulteti i Histori-Filologjisë, dega Gjuhë-Letërsi dhe dega Histori, si dhe në bazë të përgjigjeve të kthyera nga këto institucione për kërkesat e paraqitura nga prefektët rast pas rasti.
4. Për çdo emër të klasifikuar në kategoritë e sipërpërmendura, institucioni i prefektit të qarkut do të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.
5. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektët e qarqeve, nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komunat dhe në degët e qarkut.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

Fletore zyrtare nr. 72, datë publikimi 23.05.2014

Lista me emrat & mbiemrat e papërshtatshëm (antroponimesh)

1.	Ankim	33.	Helme
2.	Arançanta	34.	Ironi
3.	Avash	35.	Jermësinë
4.	Bretk	36.	Keqan
5.	Berr	37.	Keqe
6.	Burgim	38.	Kralicë
7.	Ballokume	39.	Lëvere
8.	Car	40.	Meze
9.	Cub	41.	Mëshirë
10.	Curranë	42.	Mjafte
11.	Currelë	43.	Mjaftime
12.	Careva	44.	Mjaftoni
13.	Carina	45.	Mbarime
14.	Çbane	46.	Mbete
15.	Dert	47.	Mbylle
16.	Derman	48.	Marrëzi
17.	Dovlet	49.	Ndalime
18.	Durak	50.	Pikëllime
19.	Ekran	51.	Pafate
20.	Eros	52.	Pseerdhe
21.	Ferman	53.	Rikë
22.	Federatë	54.	Rakita
23.	Fodulle	55.	Spece
24.	Gazep	56.	Sose
25.	Gallata	57.	Stenatë
26.	Gabime	58.	Sherre
27.	Groshe	59.	Shkurte
28.	Gjezap	60.	Shkurtime
29.	Hyzmet	61.	Vajtime
30.	Hiçe	62.	Xhenaze
31.	Hafije	63.	Zehere
32.	Hale	64.	Marime

Mbiemra

1.	Pici	2.	Bilbilushi

URDHËR

Nr. 146, datë 19.5.2014

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS DHE AFISHIMIN E SHPALLJES SË KËRKESËS PËR NDRYSHIMIN E EMRIT/ MBIEMRIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 1 dhe 3 të nenit 57/4 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Financave

URDHËROJNË:

1. Tarifa për paraqitjen e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit të shtetasve do të jetë 200 (dyqind) lekë. Kjo tarifë parapaguhet nga kërkuesi në kohën e depozitimit të kërkesës, pranë zyrës së gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin.
2. Tarifa për afishimin e shpalljes pranë zyrës së gjendjes civile ku është depozituar kërkesa, ku kërkuesi ka vendbanimin do të jetë 400 (katërqind) lekë. Kjo tarifë parapaguhet nga kërkuesi në momentin e depozitimit të kërkesës, pranë zyrës së gjendjes civile, pasi kjo e fundit të jetë urdhëruar nga prefekti për afishimin e shpalljes së kërkesës.
3. Detyrimet financiare për afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit në dy gazeta, për një periudhë prej 15 ditësh, do të mbulohen nga kërkuesi, pasi prefekti të ketë urdhëruar afishimin e shpalljes së kërkesës. Për efekt dokumentimi, i interesuari duhet të depozitojë pranë zyrës së gjendjes civile, ku ka paraqitur kërkesën, numrat përkatës të dy gazetave ku është publikuar kërkesa për 15 ditë radhazi, dokumentacion i cili duhet t'i dërgohet prefektit brenda dy ditësh nga depozitimi i tij.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, nuk janë të rimbursueshme, pavarësisht vendimit përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për ndryshimin e emrit/ mbiemrit dhe derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Fletore zyrtare nr. 97, datë publikimi 26.06.2014

UDHËZIM

Nr. 7733/4, datë 23.10.2014

"PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË RUBRIKËS "VENDLINDJA" NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE TË SHTETASVE SHQIPTARË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 27.08.2014 "Për disa shtesa në Vendimin nr. 332, datë 17.03.2010, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i Gjendjes Civile", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

U D H Ë Z O J:

1. Për shtetasit shqiptarë do të plotësohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, krahas nënrubrikave ekzistuese "shteti i lindjes", "fshati/qyteti i lindjes" dhe "rrethi ku ka lindur", një nënrubrikë e re "vendlindja sipas toponimit", të cilat së bashku plotësojnë përbëjnë rubrikën "vendlindja".
2. Plotësimi i nënrubrikës së re të rubrikës "vendlindja":
   a. Për shtetasit shqiptarë të lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të plotësohet përveç nënrubrikave ekzistuese, të cilat plotësohen në drejtshkrimin e gjuhës shqipe dhe nënrubrika e re "vendlindja sipas toponimit" sipas rastit: fshati dhe rrethi/qyteti dhe rrethi/rrethi, ku shtetasi ka lindur;
   b. Për shtetasit shqiptarë të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të plotësohet përveç nënrubrikave ekzistuese, të cilat plotësohen në drejtshkrimin e gjuhës shqipe dhe nënrubrika e re "Vendlindja sipas toponimit" si më poshtë:
      - Për shtetet, të cilat kanë depozituar pranë OKB-së katalogët zyrtarë të emrave gjeografikë të romanizuar (toponimet), do të plotësohet sipas listës së emrave të toponimeve të shtetit përkatës, të siguruar nga Ministria e Punëve të Jashtme;
      - Për shtetet të cilat nuk kanë depozituar pranë OKB-së katalogët zyrtarë të emrave gjeografikë të romanizuar (toponimet), e cila nuk disponohet apo nuk mund të vihet në dispozicion, do të plotësohet mbështetur në dokumentin, që do të paraqesë i interesuari, i cili do të pranohet pasi të jetë përkthyer nga përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë ose nga përkthyes të autorizuar për përkthimet zyrtare.
3. Procedura e plotësimit të rubrikës "Vendlindja" në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile është e përcaktuar në manualin përkatës, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
4. Nënrubrika "Vendlindja sipas toponimit" do të pasqyrohet vetëm për plotësimin e certifikatave "Për përdorim nga autoritetet e huaja" për shtetasit shqiptarë të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
5. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të vërë në dispozicion të të gjitha zyrave të gjendjes civile, listën e emrave të toponimeve të siguruar nga Ministria e Punëve të Jashtme.
6. Nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile të kryejnë verifikimin për gjithë shtetasit që rezultojnë me vendbanim në zyrën e tyre, në mënyrë që në rastet e konstatuara, të plotësojnë dhe kryejnë veprimet e nevojshme për të unifikuar informacionin në nënrubrikat e rubrikës "Vendlindja" sipas pikës 2 të Udhëzimit.
7. Para plotësimit dhe lëshimit të certifikatave "Për përdorim brenda vendit"" dhe ato "Për përdorim nga autoritetet e huaja" për shtetasit shqiptarë duhet të jenë kryer veprimet për plotësimin dhe unifikimin e rubrikës "Vendlindja" sipas pikës 2 të udhëzimit;
8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore.
9. Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Saimir Tahiri

UDHËZIM

Nr. 269, datë 1. 7.2021

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE TË VITIT 2010, TË REFUGJATIT OSE TË PERSONIT NËN MBROJTJE PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, të nenit 92, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", nenet 21, 33 dhe 59 të ligjit nr. 10129, "Për gjendjen civile", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.
2. Të dhënat e refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese që i është miratuar leja e qëndrimit, importohen elektronikisht nga Regjistri Elektronik për të Huajt (FER) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).
3. Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese paraqitet për regjistrimin e vendbanimit pranë zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative në juridiksionin e së cilës ndodhet ndërtesa. Nëpunësi i gjendjes civile, pasi verifikon përputhshmërinë e të dhënave të dokumenteve të paraqitura, kryen regjistrimin e vendbanimit, duke aktivizuar më pas të dhënat e gjeneruara automatikisht nga ndërlidhja e sistemit FER në RKGJC.
4. Refugjatit ose personit nën mbrojtje plotësuese, të cilit leja e qëndrimit i lëshohet për herë të parë, duhet që brenda 30 ditëve nga dita e tërheqjes së dokumentit të lejes së qëndrimi, të regjistrojë vendbanimin pranë zyrës së gjendjes civile në bashki/njësisë administrative përkatëse, duke paraqitur:
   a) kërkesën me shkrim dhe lejen e qëndrimit;
   b) dokumentin e pronësisë së banesës ose kontratë qiramarrjeje/huadhënie/përdorimi apo banimi; kontratën apo çdo dokument tjetër të ligjshëm, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep personit të drejtën e përdorimit të banesës; ose vërtetimin e vendbanimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, nëse personi është me qëndrim pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues.
5. Për ndryshimin e vendbanimit të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese, zbatohet legjislacioni në fuqi për gjendjen civile.
6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sa herë që e çmon të nevojshme, kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, informacionin e plotë për refugjatin ose personin nën mbrojtje plotësuese të regjistruar në RKGJC.
7. Me marrjen e informacionit për ndryshime në përbërësit e gjendjes civile për refugjatin ose personin nën mbrojtje plotësuese, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ndjek këtë veprimtari me zyrat respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative në vlerësimin e dokumentacionit dhe përcjelljen e akteve të nevojshme shkresore për përditësimin e të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
9. Urdhri nr. 28, datë 16.1.2017, "Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve të huaj që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

Fletore zyrtare nr. 109, datë publikimi 09.07.2021

UDHËZIM

Nr. 180, datë 19.9.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE QË LINDIN TË VDEKUR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 56/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, 'Për gjendjen civile'", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të paktën njëri nga prindërit dhe në pamundësi të tyre pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët në rastet kur plotësohen parashikimet e legjislacionit, për shërbimin publik të varrimit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijën e lindur të vdekur dhe fetusin e vdekur gjatë lindjes, kanë të drejtë të aplikojnë pranë shërbimit të gjendjes civile për "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur".
2. Kërkesa për leje varrimi nga personat e përmendur në pikën 1 (një) të këtij udhëzimi, për fëmijën e lindur të vdekur dhe fetusin e vdekur gjatë lindjes, paraqitet në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative me dokumentin "Certifikatë asistence në lindje", në të cilën përcaktohet që fëmija është lindur i vdekur.
3. Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative në këtë rast nuk do të mbajnë akt lindje dhe akt vdekje për fëmijën e lindur të vdekur dhe fetusin e vdekur gjatë lindjes, por do të lëshojnë dokumentin "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur", sipas modelit në aneksin 1, të këtij udhëzimi.
4. Dokumenti "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur", nga zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, do të plotësohet me të dhënat mbi bazën e dokumentit të paraqitur "Certifikatë asistence në lindje".
   Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, me plotësimin e të dhënave do të lëshojnë dokumentin "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur", për kryerjen e procedurave të mëtejshme të varrimit.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Ministria e Brendshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

Aneksi 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
NJËSIA ADMINISTRATIVE _____
Zyra e Gjendjes Civile _____

LEJE VARRIMI PËR FËMIJËN E LINDUR TË VDEKUR

Shtetasi/shtetësja _____,me nr. personal_____, i cili paraqitet me dokumentin "Çertifikatë asistence në lindje" me nr._____, ku deklarohet që fëmija ka lindur i vdekur.

Lejohet kryerja e varrimit pas orës _____ , më datë __/__/ ____.

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Fletore zyrtare nr. 166, datë publikimi 30.09.2024

UDHËZIM

Nr. 188, datë 27.9.2024

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR LIDHJEN E MARTESËS DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË MBAHET NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE PËR LIDHJEN E SAJ, SI DHE PËR NDRYSHIMIN E MBIEMRIT, KUR NDODH PËR SHKAK TË MARTESËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 6, të nenit 47, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kërkesa për shpallje martese bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar *"e-Albania"* dhe në rast të pamundësisë objektive për të përdorur këtë portal, kërkesa mund të bëhet pranë zyrave të gjendjes civile nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga një përfaqësues i tyre i autorizuar me prokurë të posaçme. Në këtë prokurë duhet të specifikohet qartë veprimi që përfaqësuesi është i autorizuar të kryejë pranë shërbimit të gjendjes civile.
2. Kjo kërkesë i drejtohet zyrës së gjendjes civile në bashki/njësinë administrative ku janë të regjistruar bashkëshortët e ardhshëm.
3. Në rast se të dy bashkëshortët janë të regjistruar në të njëjtën bashki/njësi administrative, zyra e gjendjes civile kryen 1 (një) shpallje martese. Për rastet kur bashkëshortët e ardhshëm rezultojnë në 2 (dy) bashki/njësi administrative të ndryshme, ata paraqesin kërkesën për shpallje në zyrën ku kanë vendbanimin respektivisht. Secila zyrë e gjendjes civile kryen shpalljen e martesës për bashkëshortin që ka vendbanimin në bashkinë/njësinë administrative të saj.
4. Nëse njëri nga bashkëshortët është shtetas i huaj, në kërkesën për lidhjen e martesës duhet të specifikohet njohja ose jo e gjuhës shqipe. Në rast se konfirmohet njohja e gjuhës shqipe, lidhja e martesës do të kryhet pa praninë e përkthyesit. Në të kundërt, nëse shtetasi i huaj nuk njeh gjuhën shqipe, martesa do të lidhet në prani të një përkthyesi të autorizuar.

5. Shtetasit mund të aplikojnë për një shpallje tjetër martese pasi ka kaluar afati i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, apo nëse kanë refuzuar ose anuluar shpalljen e mëparshme.
6. Dokumentet që duhet të paraqesë shtetasi i huaj që kërkon të shpallë martesë janë:
   a) fotokopje pasaporte/dokument udhëtimi;
   b) certifikatë lindje me të dhëna të plota, përfshirë të dhënat e prindërve dhe rubrikën e gjendjes civile, statusin, në përputhje me legjislacionin në fuqi të përkthyer dhe të apostiluar/legalizuar sipas rastit. Shtetasit e huaj të cilët kanë vendbanimin e tyre në një shtet që është në konflikt dhe e kanë objektivisht të pamundur marrjen e dokumentit të përcaktuar, nga ana e tyre do të paraqitet deklaratë noteriale që vërteton të dhënat e këtyre shtetasve;
   c) dokument që vërteton vendbanimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi të përkthyer dhe të apostiluar/legalizuar sipas rastit, në rast se shtetasi nuk ka vendbanim në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).
7. Zyra e gjendjes civile në të cilën është paraqitur kërkesa për shpalljen e martesës vlerëson dokumentacionin e paraqitur për procedurën e shpalljes nga bashkëshortët ose personi i caktuar nga ato me prokurë.
8. Nëpunësi i gjendjes civile në të cilën është paraqitur kërkesa për shpalljen e martesës vlerëson nëse rezultojnë pengesa ligjore për shpalljen e martesës.
9. Zyrat përkatëse të gjendjes civile, ku është paraqitur kërkesa për shpallje kryejnë afishimin e shpalljes në vende të dukshme të përcaktuara nga bashkia/njësia administrative, për arsye transparence, me qëllim informimin e palëve të treta.
10. Pas kalimit të afatit 10- ditor (dhjetëditor) nga shpallja e martesës, për rastet kur martesa do të lidhet jashtë vendit, zyra e gjendjes civile, për shtetasit shqiptar, lëshon dokumentin leje për lidhje martese për përdorimin nga autoritetet e huaja.
11. Në rastet kur në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësinë administrative paraqitet akt kundërshtimi nga personat e legjitimuar për këtë kundërshtim, në përputhje me legjislacionin në fuqi, zyra e gjendjes civile pezullon procedurën e lidhjes së martesës, duke lëshuar aktin

e refuzimit sipas formatit të miratuar. Shtetasi njoftohet për këtë veprim nga zyra përkatëse e gjendjes civile.

12. Martesa lidhet me pëlqim të lirë dhe me paraqitjen e bashkëshortëve përpara nëpunësit të gjendjes civile ose në misionet diplomatike dhe postet konsullore, sipas përcaktimeve në kërkesën e tyre, vetëm pasi është plotësuar por nuk është tejkaluar afati i shpalljes së martesës, mes një burri dhe një gruaje që ka mbushur moshën 18 vjeç. Martesa nën këtë moshë lejohet vetëm në rastet e parashikuara nga Kodi i Familjes.
13. Dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e martesës është:
    a) letërnjoftimi ose çdo dokument identifikimi i bashkëshortëve;
    b) lejen për lidhjen e martesës ku konfirmohet që shtetasi me shtetësi shqiptare nuk ka pengesë ligjore për lidhjen e martesës, në rastet kur martesa do të lidhet në misionet diplomatike dhe postet konsullore;
    c) leje për lidhjen e martesës ose dokument në përputhje me legjislacionin në fuqi të shtetit të huaj, ku konfirmohet që shtetasi i huaj nuk ka pengesë ligjore për lidhjen e martesës jashtë vendit, të përkthyer dhe të apostiluar/legalizuar. Për shtete që nuk e lëshojnë këtë dokument, paraqitet dokument konsullor nga përfaqësia diplomatike e shtetit të huaj, në përmbajtje të së cilit konfirmohet se shtetasi i huaj nuk ka pengesë ligjore për të lidhur martesë. Shtetasit e huaj të cilët kanë vendbanimin e tyre në një shtet që është në konflikt dhe e kanë objektivisht të pamundur marrjen e dokumentit leje për lidhje martese, nga ana e tyre do të paraqitet deklaratë noteriale që nuk ka pengesa ligjore për lidhje martese.
14. Përpara kryerjes së veprimeve për lidhjen e martesës, nëpunësi i gjendjes civile ndjek me përpikëri veprimet e mëposhtme:
    a) sigurohet për identitetin e bashkëshortëve të ardhshëm;
    b) përcakton mbiemrin që do të mbajë secili nga bashkëshortët me lidhjen e martesës, në përputhje me Kodin e Familjes;
    c) përcakton vendbanimin e përbashkët sipas marrëveshjes së bashkëshortëve;
    ç) në rast se kanë fëmijë të lindur jashtë martese, udhëzon bashkëshortët për të drejtën për njohjen e atësisë së fëmijëve

    me lidhjen e martesës. Në këto raste, akti përmban dy deklarime, atë të bashkimit në martesë dhe të njohjes së atësisë vullnetare të fëmijës;
    d) regjistron kontratën e regjimit të pasurive, sipas depozitimit;
    e) kryen verifikime nëse bashkëshortët e ardhshëm kanë në përbërjen e tyre familjare: fëmijë të mitur, të lindur jashtë martese ose nga martesa të mëparshme pasi këta fëmijë do të rezultojnë në të njëjtën familje të bashkëshortëve të ardhshëm që do të krijohet me lidhjen e martesës, sipas përditësimit përkatës të relacionit familjar, marrëdhënies me kryefamiljarin.
15. Në rastet kur njëri prej bashkëshortëve ndryshon mbiemrin, nëpunësi i gjendjes civile raporton në rrugë shkresore pranë strukturës përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit, kur krijon bindjen se:
    a) bashkëshortët nuk janë takuar përpara se të lidhin martesë dhe nuk kanë qëllim jetesën e përbashkët;
    b) bashkëshortët nuk janë në gjendje të japin informacion për të dhënat e njëri-tjetrit në rast se pyeten nga nëpunësi i gjendjes civile;
    c) ka prova të një martese fiktive të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër;
    ç) për arsye të numrit të martesave të mëparshme, të zgjidhura që mund të ketë lidhur secili nga bashkëshortët;
    d) për arsye të diferencës së madhe të moshës midis bashkëshortëve, si dhe çdo dyshim tjetër i arsyeshëm që martesa mund të lidhet me qëllim të vetëm ndryshimin e identitetit.
16. Në rastet kur të njëjtët shtetas, të cilët kanë lidhur martesën dhe zgjidhur atë, kërkojnë të rilidhin përsëri të njëjtën martesë dhe zgjedhin mbiemër të përbashkët të ndryshëm nga ai i zgjedhur në martesën e parë, zyra e gjendjes civile raporton rastin në rrugë shkresore pranë strukturës përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit.
17. Nëpunësi i gjendjes civile mund të refuzojë lidhjen e martesës vetëm për shkaqe të parashikuara në Kodin e Familjes.
18. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile të njësisë administrative kryen veprimet për lidhjen e martesës vetëm pasi plotësohen parashikimet ligjore.

19. Pas lidhjes së martesës, duke mbajtur aktin e martesës nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet përkatëse të përditësimit të të dhënave të bashkëshortëve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, për:
    a) përditësimin e marrëdhënies me kryefamiljarin, sipas rastit kur në familje është shtuar bashkëshorti ose bashkëshortja, fëmijë të mitur që bashkëshorti/bashkëshortja mund të kenë nga martesa të mëparshme, ose fëmijë para martese për të cilët është njohur atësia, bazuar në mundësitë që përzgjidhen në RKGJC, si dhe përditësimi i rubrikës për ndryshimin e numrit të votimit, duke plotësuar dhe përshkrimin sipas arsyes: *"Bashkuar në familje me lidhjen e martesës, në bazë të aktit nr. ___, datë __ . ___ . ___ "*, në mënyrë që këto të dhëna të jenë të njëjta për të gjithë anëtarët e familjes;
    b) pas mbajtjes së aktit të martesës, plotësohen të gjitha rubrikat me informacionin përkatës.
20. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësinë administrative, shërbimi i gjendjes civile në misione diplomatike dhe poste konsullore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

Fletore zyrtare nr. 171, datë publikimi 09.10.2024

UDHËZIM I PËRBASHKËT

N. 439, datë 21.8.2015

PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË GJENDJES CIVILE NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE

Në zbatim të Kushtetutës, neni 102, pika 4, nenit 34, 61 dhe 71 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, nenit 11 të ligjit nr. 8372, datë 9.7.1998, "Për ushtrimin e funksioneve konsullore në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore", të ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008, "Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike"", ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Sagem Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes së afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar, me qëllim rregullimin e veprimtarisë së punës të nëpunësve të shërbimit konsullor, si dhe ofrimin e shërbimeve për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit,

UDHËZOJMË:

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre konsullore, kryejnë funksione/shërbime të gjendjes civile, respektivisht si më poshtë:

a) Lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja, sipas modeleve të miratuara për përdorim nga autoritetet e huaja në postet konsullore:
    - kodi 501, që i korrespondon Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë;
    - kodi 502, që i korrespondon Konsullatës së Përgjithshme në Milano;
    - kodi 503, që i korrespondon Konsullatës së Përgjithshme në Bari.

Ky shërbim do të ofrohet për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike, si dhe pasi të jenë kryer veprimet përkatëse në Regjistrin

Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) për plotësimin dhe saktësimin e rubrikave "vendlindja" dhe "vendbanimi", si përbërës të gjendjes civile.
Hapat e nevojshëm proceduralë, veprimet që do të kryhen nga nëpunësit e autorizuar të shërbimit konsullor në RKGJC ilustrohen në manualin përkatës, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, aneksi 1, "Manuali për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja në postet konsullore".

b) Certifikimin dhe autorizimin e aplikimit dhe pajisjen me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike), në përfaqësitë diplomatike/postet konsullore ku ofrohet shërbimi i pajisjes me dokumente identiteti.

Ky shërbim do të ofrohet për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike, si dhe pasi të jenë kryer veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) për plotësimin dhe saktësimin e rubrikave të "vendlindjes" dhe "vendbanimit".

c) Korrigjimin e rubrikës "vendlindja", vetëm për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike dhe që paraqiten për t'u pajisur me certifikata për përdorim nga autoritetet e huaja me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike), në përfaqësitë diplomatike/postet konsullore ku ofrohet ky shërbim.

Hapat e nevojshëm proceduralë, veprimet që do të kryhen nga nëpunësit e autorizuar të shërbimit konsullor në RKGJC ilustrohen në manualin përkatës, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, aneksi 2, "Manuali për mënyrën e plotësimit të rubrikës "vendlindja" në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve shqiptarë".

d) Plotësimin e rubrikës "vendbanimi", sipas elementeve të adresës jashtë vendit për shtetasit shqiptarë, të cilët duhet të identifikohen nëpërmjet paraqitjes së letërnjoftimit elektronik/pasaportë biometrike dhe që paraqiten për t'u pajisur me certifikata për përdorim nga autoritetet e huaja dhe me dokumente identiteti (letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike), në përfaqësitë diplomatike/postet konsullore ku ofrohet ky shërbim.

Hapat e nevojshëm proceduralë, veprimet që do të kryhen nga nëpunësit e autorizuar të shërbimit konsullor në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile ilustrohen në manualin përkatës, pjesë përbërëse e

këtij udhëzimi, aneksi 3, "Manuali për mënyrën e plotësimin e rubrikës "vendbanimi" sipas elementeve të adresës jashtë vendit të shtetasve shqiptarë". Rastet për të cilat lëshohen certifikatat dhe dokumentacioni përkatës, përcaktohen në pikën 5 të këtij udhëzimi.

Drejtoria e Çështjeve Konsullore do të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për çdo ndryshim apo emërim të ri të nëpunësve në shërbimin konsullor.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është përgjegjëse për trajnimin e nëpunësve konsullorë, sipas një plani të miratuar paraprakisht me Drejtorinë e Çështjeve Konsullore.

Nëpunësit konsullorë do të ofrojnë shërbime të gjendjes civile vetëm pasi të kenë kryer trajnimin e nevojshëm, si dhe:

a) me kërkesë të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile hap/mbyll llogarinë përkatëse, të drejtat e përdorimit për nëpunësit konsullorë në RKGJC;
b) për nëpunësit konsullorë bëhet njoftimi i fillimit të detyrës, të cilët depozitojnë specimenet e tyre në Drejtorinë e Çështjeve Konsullore dhe te autoritetet e vendit pritës.

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të miratuara, lëshojnë certifikata për përdorim nga autoritetet e huaja vendore, pasi të jetë verifikuar më parë se këto dokumente do të njihen dhe pranohen nga autoritetet e vendit pritës dhe:

a) pajisin me certifikata vetëm shtetasit me qëndrim në rrethin e juridiksionit të postit;
b) me kërkesë të prindërve, për shtetasit nën 16 vjeç, certifikata mund të lëshohet me foto;
c) për t'u pajisur me certifikatë për përdorim nga autoritetet e huaja vendore, shtetasi paraqitet personalisht me:
   c.1 letërnjoftim elektronik/pasaportë biometrike;
   c.2 dëshmi të qëndrimit të rregullt e të regjistruar në rrethin konsullor të postit, që mund të jetë një nga dokumentet e mëposhtme:
      - certifikatë rezidence/vendbanimi, e lëshuar nga komuna ose;
      - deklaratë personale për vendbanimin, e vërtetuar nga komuna ose;

- kopje kontrate banimi e vlefshme jo më pak se 12 muaj, e noterizuar ose;
- kartë identiteti, ku shënohen të dhënat për vendbanimin;

c. 3 dëshmi të kryerjes së pagesës së tarifës me bankë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile furnizon periodikisht me certifikata të papersonalizuara, Drejtorinë e Çështjeve Konsullore, me kërkesë të kësaj të fundit. Drejtoria Konsullore merr masat për shpërndarjen e dërgimin tyre në (drejtim të) posteve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Konsullore marrin masa për drejtimin metodik të aktivitetit lidhur me shërbimin e gjendjes civile në postet konsullore. Në aktivitetin e tyre postet marrin udhëzimet nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore.

Tarifa e lëshimit të certifikatës përcaktohet me aktin e përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Financave, përkatësisht me udhëzimin nr. 61/1, datë 5.1.2015, dhe 18132/1, datë 31.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet konsullore".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

Fletore zyrtare Nr. 160, data e publikimit 14.09.2015

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 463, datë 10.12.2020

PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE QË MARRIN TË DHËNA PERSONALE NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE, SI DHE MËNYRËN, LLOJIN DHE SASINË E INFORMACIONIT QË DUHET TË MARRIN

(ndryshuar me udhëzimin nr. 189, datë 4.10.2022; nr. 120, datë 17.7.2024) (i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; pikave 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, të pikës 2 të nenit 60, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, si dhe shkronjës "k" të pikës 1 të nenit 31 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZOJNË:

1. Institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë) mund të marrin të dhëna personale nga të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, nga regjistrat themeltarë të regjistrimit të popullsisë dhe nga aktet e gjendjes civile, nëse kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin përcaktohet në aneksin I, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
2. Informacioni, sipas aneksit I, përcillet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, siç parashikohet rast pas rasti në këtë aneks.
3. Personat juridikë apo fizikë privatë (kontrolluesit privatë), mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltarë dhe nga aktet e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse marrin pëlqimin me shkrim nga ana e subjektit të të dhënave. Përjashtim nga kjo rregull, bëjnë vetëm rastet kur një përpunim i tillë i të dhënave personale nga kontrolluesit privatë, autorizohet nga dispozitat e legjislacionit në fuqi.

4. Për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet konkrete përcaktohen në marrëveshje dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe kontrolluesit përkatës dhe/ose sipas parashikimeve të tjera të legjislacionit në fuqi.
   Në çdo rast, marrëveshjet në fjalë rregullohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Për marrjen e informacionit në formë shkresore, kontrolluesit i drejtohen me kërkesë të motivuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile ose zyrës përkatëse të gjendjes civile, sipas organizimit të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, ose zyrës së arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut që administron dokumentacionin, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.
6. Kërkesat drejtuar shërbimit të gjendjes civile, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, duhet të shoqërohen me formularin sipas aneksit III, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, në të cilin subjekti i të dhënave personale ka shprehur pëlqimin e tij.
7. Përjashtohen nga rregulla e përcaktuar në pikën 6 kontrolluesit, të cilët autorizohen me ligj për të përpunuar të dhënat personale të subjekteve të të dhënave personale për qëllime të veprimtarisë së tyre.
8. Kontrolluesit që kërkojnë të dhëna personale duhet të shprehin qartë bazën ligjore, mbi të cilën mbështesin kërkesën e tyre, qëllimin për të cilin do të përdoren këto të dhëna, si dhe llojin e të dhënave që kërkojnë. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor.
9. Kërkesa për marrjen e të dhënave personale bëhet duke plotësuar formularin "Kërkesë për marrjen e të dhënave personale", sipas aneksit II, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
10. Kontrolluesit, që marrin të dhëna personave, në asnjë rast nuk duhet t'i përhapin ato te palë të treta, pavarësisht faktit se këto të fundit mund të jenë të legjitimuara për t'i përpunuar këto të dhëna. Përjashtim nga kjo rregull bëjnë vetëm rastet e parashikuara me ligj.

11. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut regjistrojnë të gjitha kërkesat, duke evidentuar datën kur është paraqitur kërkesa, kontrolluesin që kërkon të dhëna personale, të dhënat që kërkohen të përpunohen dhe ato të cilat janë dhënë ose jo, si dhe qëllimin e deklaruar nga kontrolluesit në fjalë për përpunimin e këtyre të dhënave. Këto informacione i jepen, sipas kërkesës, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mund t'i përdorë për qëllime hetimi administrativ dhe/ose për qëllime statistikore.
12. Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përditësojnë aneksin I, në mënyrë periodike dhe/ose brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës së një kontrolluesi të caktuar për t'u përfshirë në këtë aneks.
13. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, si dhe të gjitha institucionet, organet, personat juridikë apo fizikë që përpunojnë të dhëna personale në bazë të këtij udhëzimi.
14. Udhëzimi nr. 95, datë 7.4.2014, "Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Sandër Lleshaj **Besnik Dervishi**

LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTIJ INFORMACIONI

(ndryshuar pika 1, 6, 12, 20, 22, 27, 31 dhe 32; shtuar pika 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 me Udhëzimin e përbashkët nr. 120, datë 17.7.2024)

Nr.	SUBJEKTET (KONTROLLUESIT) QË MARRIN TË DHËNA	BAZA LIGJORE	TË DHËNAT PERSONALE QË DUHET TË JEPEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN PËRKATËS PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË INFORMACIONIT TË KËRKUAR
1	**Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP)**	Ligji nr. 55/2023 *"Për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera"*	Të dhënat për personat debitorë si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - emri i babait; - datëlindje; - vendbanimi aktual dhe regjistrime të mëparshme (adresa); - të dhënat familjare dhe të vdekjes për shtetasit që kanë ndërruar jetë;	Në mënyrë shkresore ose elektronike.
2	**Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)**	Ligji nr. 111/2018, "Për kadastrën", neni 68, "Bashkëpunimi ndërinstitucional". Ligji 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27 "Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit".	Të dhënat që përmban certifikata e lindjes dhe certifikata familjare.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

3	**Autoritetet tatimore**	Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 62, "Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion". Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 13, "Detyrimi për të paguar" deri 13/10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 14.12.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, 'Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike'", pika 5.4. Udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.8	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.
4	**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)**	Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar - Neni 14 "Kompetencat e Bordit", pika 2 dhe 22; - Neni 15 "Kompetencat e kryetarit të Bordit"; - Neni 18 "Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit", pika 6, paragrafi 4. Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar, neni 38, "Krijimi i qendrës së informacionit të sigurimeve dhe lloji i të dhënave që duhet të administrojë".	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - atësia; - numri personal; - datëlindje; - gjinia; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.

5	**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**	Nenit 5, i ligjit nr. 45/2015, datë 30.4.2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".	Të dhënat si më poshtë: - emri; - mbiemri; - numri personal; - atësia; - amësia; - gjinia; - datëlindja; - vendlindje (qyteti, fshati); - vendbanimi (adresa); - gjendja civile; - mbiemri para/pas martese; - shtetësia; - bashkia /njësia administrative; - historikun e gjeneraliteteve të ndryshme gjatë viteve për periudhën kohore nga viti 1941–1991"	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
6	**Avokati i Popullit**	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, i ndryshuar; - Neni 19 "Procedura e hetimit"; - Neni 20 "E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore"; Ligji nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"*, i ndryshuar; - Nënseksioni II Procedura e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia Neni 31, "Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore" pikat 2, 3 dhe 4; - Nënseksioni II, Procedura e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Avokatia Neni 129, pikat 2, 3 dhe 4 "Verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore"	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me hetimin. Të gjitha të dhënat e domosdoshme, përbërësit e gjendjes civile të subjekteve, kandidatu rave që kanë shprehur pëlqimin për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe ndryshimeve në përbërësit e gjendjes civile.	Në formë shkresore, sipas kërkesës
7	**Avokatura e Shtetit**	Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar; Neni 16, "Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore"	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuara në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

8	**Banka e Shqipërisë**	Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", pika 1, e nenit 24 dhe shkronja "a", e nenit 29.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësia - datëlindje; - gjinia; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.
9	**Byroja Shqiptare e Sigurimit**	Ligji nr. 10 076/2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar. Kodi i Procedurës Civile, neni 154. Rregullorja nr. 53/2009 e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit"	Të dhënat si më poshtë: Vendbanimi (adresa)/vendqëndrimi për personat (shkaktarë/përfitues) të një procedure dëmshpërblimi.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
10	*Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*	*Ligji nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve," nenet 38, 39, 76, 78* *Vendimi nr. 209, datë 6.4.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së përgjithshme, të Burgjeve," nenet 10, 11, 12, 18, 19, 38, 49, 73*	*Të dhënat që lidhen me identifikimin e të dënuarit si dhe të dhënat e nevojshme për takimet, vizitat dhe lejet e veçanta si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për plotësimin e dosjes/ dokumentacionit të personit në paraburgim apo të burgosur.*	*Në formë shkresore, sipas kërkesës*
11	**Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore**	Ligj nr. 102, datë 31.7.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendbanimi (adresa). - të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

12	**Agjencia e Inteligjencës Financiare**	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit*", i ndryshuar. - neni 21 "Organizimi i autoritetit përgjegjës"; - neni 22 "Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës".	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendlindje; - gjendja civile; - gjinia; - lidhja me kryefamiljarin; - përbërja familjare aktuale dhe historike;	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
13	**Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor**	Kodi Rrugor, miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2012, "Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove të tyre", i ndryshuar.	Të dhënat si më poshtë: - numri personal; - emër; - mbiemër; - atësi; - mëmësi; - datëlindje; - vendlindje; - shteti i lindjes; - numri i letërnjoftimit ID; - lloji letërnjoftimit ID; - data e lëshimit të letërnjoftimit ID; - data e skadencës së letërnjoftimit ID; - adresa.	Në formë elektronike.

14	**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar**	Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'sekret shtetëror'", i ndryshuar, pika 4, e nenit 25' "Krijimi dhe detyrat" Ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", germa "a", neni 37, "Detyrat e grupit të punës", neni 39, "Procedura për kontrollin e figurës". Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregullores 'Për sigurimin e personelit'", pika 4, neni 3, "Përkufizime dhe parime të përgjithshme": - - neni 5, "Detyrimet e autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore"; - - neni 10, "Dokumentacioni bazë i aplikimit për pajisje me CSP"; - neni 12, "Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë"; - neni 13, "Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë"; - neni 19, "Rrethi i personave që verifikohen".	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër (para ose pas martese); - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendlindje; - vendbanimi (adresa); - gjendja civile; - të dhënat që përmban certifikata familjare; - shtetësia.	Në formë elektronike.
15	**Enti Kombëtar i Banesave**	Ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Akti normativ nr. 3, datë 1.3.2012, "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara".	Të dhënat që përmban certifikata familjare, si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - atësi; - amësi; - datëlindja; - gjendja civile; - vendlindje; - shtetësi - vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
16	**Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor**	Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë": - neni 5, "Personat e siguruar"; - neni 27, "Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar", paragrafët 5 dhe 6.	Të dhënat që përmban: - certifikata personale; - certifikata familjare; - certifikata e lëshuar nga akti i vdekjes.	Në formë elektronike.

17	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	Neni 9/1 dhe neni 26, i ligjit nr. 9046, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", i ndryshuar. Neni 9 dhe neni 42 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
18	**Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)**	Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 42, "Pagesat për vdekje". Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtari të familjes që ai e ka në ngarkim; b) personi që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimi. Udhëzimi nr. 3912, datë 21.6.2004, "Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit": "Ndihma në lekë tërhiqet nga të interesuarit pranë zyrës së financës në bashkinë apo komunën përkatëse kundrejt paraqitjes së certifikatës së vdekjes së të ndjerit me shënimin 'Shpenzime varrimi'. Për çdo rast pagese, financa e bashkisë apo e komunës, sipas certifikatës së paraqitur, llogarit masën e ndihmës, si dhe plotëson mandatpagesën."	Për të gjithë shtetasit shqiptare, të cilët janë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore. Të dhënat që përmban certifikata e vdekjes, si më poshtë: - emër; - mbiemër para ose pas martese; - numër personal; - atësi; - amësi - data e lindjes; - vendlindje; - gjinia; - gjendja civile - shtetësia; - data e vdekjes; - vendi i vdekjes; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.
19	**Instituti i Statistikave**	Ligj nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare"	Të gjitha të dhënat personale që përmban RKGJC-ja.	Në formë elektronike.

20	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. - neni 19 "Kompetencat e Komisionerit"; - pika 1, germa n) dhe pika 2; - neni 22 "Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje"; - neni 23"Procedura për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrja"; - neni 27 "Zonat e administrimit zgjedhor"; - neni 45 "Përbërësit zgjedhorë"; - neni 46 "Lista e zgjedhësve", ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012, ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020; - neni 48 "Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve"; - neni 51 "Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë"; - neni 56 "Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve"; - neni 61 "Mbikëqyrja e hartimit të listave të zgjedhësve nga KQZ-ja", pika 2 dhe pika 3. Aktet nënligjore, udhëzime dhe vendime të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, lidhur me verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. (Vendim nr. 2, datë 31.10.2020 i Komisionit Rregullator). Ligji nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"* - neni 2 "Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik"; - neni 5 "Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave"; - neni 8 "Organet kompetente për verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike"; - neni 11 "Verifikimi i kushteve të ndalimit në rastin e krijimit të vakancave në Kuvend ose në këshillin bashkiak"; - vendimi nr. 17/2016, i Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikua*ra në ligjin nr. 138/2015"*;	Të dhënat e shtetasve, të cilët në datën e zgjedhjeve kanë mbushur 18 vjeç, të vlerësuara të domosdoshme për procesin zgjedhor, respektivisht si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - emri i babait; - emri i nënës; - datëlindje; - të dhënat për vendbanimin, adresën; - gjininë e shtetasve votues; - shtetësia; - numri i qendrës së votimit; - adresa e qendrës së votimit; - letërnjoftimi i vlefshëm; - foto e votuesve. - Informacion për të gjitha të dhënat e vetëdeklaruara, të nevojshme për t'u verifikuar për subjektet, subjekte të këtij ligji, sipas formularit të vetëdeklarimit. - Informacion për ndryshimet e kryera në përbërësit e gjendjes civile.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike. Akses të plotë në RKGjC për auditët teknicienë

21	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural". Neni 23, "Marrja dhe përdorimi i bazave të tjera të të dhënave".	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
22	**Ministria e Kulturës** Drejtoria për të Drejtat e Autorit	Ligj nr. 8576, datë 3. 2. 2000 "*Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë*",i ndryshuar. - neni 28 "*Bibliotekat publike*", pika 7. - Pika 8, germa a) e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 22.11.2023 "*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri i të dhënave të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to" dhe përcaktimin e elementeve të regjistrit të të dhënave të hapura për publikun, dokumentar elektronik*".	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë. Të dhënat si më poshtë: - numri personal; - atësia; - vendlindja; - datëlindja; - gjinia; - vendbanimi, adresa;	Në formë shkresore, sipas kërkesës. Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
23	**Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe strukturat në varësi të tyre.**	Ligji nr. 65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes", neni 15, pika 1. Ligj nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake dhe Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë": - neni 18, "Veprimtaria Informative"; - neni 19, "Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale". Ligji 45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Ligji nr. 10142/2009, "Për sigurimet shoqërore të ushtarakut, punonjësve të gardës"; VKM 793, datë 24.9.2010, i ndryshuar, "Për zbatimin e ligjit nr. 10142/2009, 'Për sigurimet shoqërore të ushtarakut, punonjësve të gardës etj.'"; Ligj nr. 9047, datë 10.7.2003, "Për shërbimin informativ ushtarak"; VKM nr. 103, datë 10.2.2016, "Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme. Ligji nr. 80/2015 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendbanimi (adresa). Këto të dhëna u përkasin personave për të cilët ka filluar procedimi penal për vepra të parashikuara nga Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

24	**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**	Ligji nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".	Të dhënat që përmban certifikata familjare.	Në formë elektronike.
25	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007, "Për turizmin" Neni 15, "Njësitë e qeverisjes vendore dhe detyrat e tyre për turizmin". Neni 17, "Regjistri kombëtar i burimeve turistike".	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
26	**Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**	Ligji nr. 8372, datë 9.7.1998, "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore".	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Në formë elektronike.
27	**Organet e Qeverisjes Vendore** **Bashkitë dhe qarqet si njësi vetë-qeverisëse në Republikën e Shqipërisë** **Bashkia si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore** **Qarku si njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore** **Bashkitë** **Drejtoritë e Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës, Sektori i Kadastrës**	Ligji nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; - neni 48 "Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve". - Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; - neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3 ku parashikohet e drejta dhe përgjegjësia e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve. Ligji nr. 45, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile", - neni 59 "Kategoritë e përjashtuara" pika ç, ku parashikohen kategoritë e përjashtuara nga detyrimi për t'u angazhuar në operacione për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesës. Të dhënat për fëmijët, shtetas të moshës nën 18 (tetëmbëdhjetë)vjeç, respektivisht si vijon: - emër; - mbiemër; - numri personal; - emri i babait; - emri i nënës; - datëlindja; - vendlindja; - të dhënat për vendbanimin (adresën); - gjinia; dhe - shtetësia;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike. Në formë shkresore, sipas kërkesës

		Ligji nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Ligji nr. 20/2022 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të kalimit të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*". - neni 12 "Kushtet për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore" Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 126, datë 23.12.2022 "*Për miratimin e platformës për aplikimet on line të fëmijëve në kopshte e cerdhe*"	Të dhënat e domosdoshme lidhur me përbërësit e gjendjes civile, të konsideruar të nevojshëm në përmbushje të funksioneve të organeve të qeverisjes vendore: - emër; - emër i babait; - mbiemër; - datëlindje; - të dhënat për vendbanimin (adresën) dhe të përbërjes familjare; - personat kujdestarë që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara; - nënat me fëmijë nën 10 vjeç dhe prindërit e vetëm me fëmijë nën moshën 15 vjeç; - personat nën 18 dhe mbi 65 vjeç. Të dhënat e përbërjes familjare më datë 01. 08. 1991 për personat që nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banorë të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekt i kalimit të pronësisë. - Për fëmijën në kopshte dhe cerdhe: - numri personal; - numri personal i anëtarëve të familjes së fëmijës në kopshte dhe cerdhe; - emri i babait; - emri i nënës; - mbiemri; - datëlindja; - vendlindja; - adresa, vendbanimi;	Në formë elektronike
28	**Përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja**	Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, konkretisht nenet 8 dhe 9. Vendimi nr. 3, datë 20.11.2012, "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.	Të dhënat e domosdoshme, të cilat vlerësohen të nevojshme për plotësimin e qëllimit. Marrësi në kërkesë përcakton qartë qëllimin e marrjes së të dhënave. Transferuesi i të dhënave vlerëson dhënien e sasisë së të dhënave në përputhje me qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.

29	**Përfaqësuesit dhe avokatët me prokurë**	Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar, neni 3, "Karakteri personal i të dhënave". Ligj nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 11.	Të dhënat që kanë lidhje me personin që përfaqëson avokati dhe që kanë lidhje me çështjen ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
30	**Policia e Shtetit**	Ligji nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar: - neni 124, "Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale"; - neni 129, "Detyrimi i institucioneve shtetërore dhe private për dhënie informacioni".	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Në formë elektronike.
31	**Prefektët e qarqeve**	Ligji nr. 107/2016 "*Për prefektin e qarkut*"; Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*", i ndryshuar, neni 8; Udhëzimi nr. 1, datë 13.01.2010 i Këshillit të Ministrave "*Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin*" Udhëzimi nr. 2, datë 13.01.2010 i Këshillit të Ministrave "*Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione*".	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/akt nënligjor, vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.

32	**Prokuroria e Përgjithshme dhe organet e tjera të prokurorisë sipas organizimit të tyre**	Ligji nr. 97/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*. Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar - neni 2 "Respektimi i normave procedurale". Ligji nr. 138/2015, *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";* - neni 2 "Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik"; - neni 5 "Vetëdeklarimi dhe verifikimi i të dhënave"; - neni 8 "Organet kompetente për verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike"; - neni 11 "Verifikimi i kushteve të ndalimit në rastin e krijimit të vakancave në Kuvend ose në këshillin bashkiak"; Vendimi nr. 17/2016, i Kuvendit të Shqipërisë *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015"*.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me cështjen në shqyrtim dhe qëllimin. Informacion për të gjitha të dhënat e vetëdeklaruara, të nevojshme për t'u verifikuar për subjektet, subjekte të këtij ligji, sipas formularit të vetëdeklarimit. Informacion për ndryshimet e kryera në përbërësit e gjendjes civile.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
33	*Shërbimi i Provës*	*Ligji nr. 78/2020, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës", neni 31*	*Të dhënat që lidhen me identifikimin e personit nën mbikëqyrje dhe të dhënat e nevojshme për plotësimin e raportit.*	*Në formë shkresore, sipas kërkesës*

34	**Shërbimi Informativ i Shtetit**	Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998, "Për Shërbimin Informativ Kombëtar", i ndryshuar, neni 3.	Të dhënat si: - emri; - mbiemri; - atësia; - amësia; - numri personal; - datëlindja; - vendlindja; - vendbanimi (adresa); - statusi i gjendjes civile; - shtetësia; - kombësia; - të dhënat që përmban certifikata familjare; - mbiemri para/pas martese i shtetasve të gjinive (f/m); - historiku i plotë/pa afat kohor i regjistrimit dhe ndryshimit të emrave/ gjeneraliteteve të shtetasit; - data e përditësimit të të dhënave.	Në formë elektronike.
35	*Zyra vendore e Përmbarimit Përmbaruesi Gjyqësor Privat/ Zyra e Përmbarimit Privat*	*Ligji nr. 8116 datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 516/a* *Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor", i ndryshuar, neni 26, "Mbledhja e të dhënave"* *Ligji nr. 26, datë 8.5.2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", neni 24, "Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor", neni 36, "Të drejtat e përmbaruesit gjyqësor privat", neni 53 "Marrëdhëniet me të tretët"*	*Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.*	*Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike*

36	**Noterët**	Ligji nr. 110/2018, "Për noterinë": - neni 62, "Kompetencat e noterit"; - neni 96, "Qasja dhe aplikimi nëpërmjet sistemit; elektronik në regjistrat elektronikë publikë"; - neni 112, "Përmbajtja e dëshmisë së trashëgimisë"; - neni 125, "Tërheqja e akteve të gjendjes civile pranë zyrave të gjendjes civile nga noteri dhe aplikimi nëpërmjet sistemit".	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për çeljen e trashëgimisë sipas përcaktimeve ligjore.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
37	*Ministria e Drejtësisë*	*Vendimi nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristika te përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur," pika 10, shkronja "b," nënndarja "iv"*	*Të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative, adresa.*	*Në formë elektronike*
		Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore," neni 4 *Vendimi nr. 618, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit," i ndryshuar*	*Të dhënat e identifikimit të kërkuesit, si: emri, atësia, mbiemri*	*Në formë elektronike*
		Ligji nr. 10 193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar, neni 29, pika 5	*Të dhëna të gjendjes civile, si emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vendbanimi dhe vendqëndrimi.*	*Në formë elektronike*
		Ligji nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar," neni 10, pika 3	*Të dhëna referenciare të gjendjes civile, si numri personal i identifikimit, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia, adresa.*	*Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse*

38.	**Këshilli i Lartë Gjyqësor Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit**	*"Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"*, neni 135, pika 4. Ligji nr. 76/2016 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,"* të ndryshuar; Ligji nr. 138/2015, *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";*	Të dhënat, përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, respektivisht si vijon: - emri; - mbiemri; - emri i babait; - emri i nënës; - numri personal; - datëlindja; - vendlindja; - vendbanimi (adresa); - lidhja me kryefamiljarin; si dhe - të dhënat për vendbanimin e shtetasve me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; - certifikatë personale; - certifikatë familjare; - certifikatë vdekje; - certifikatë nga akti i lindjes. - certifikatë nga akti i martesës;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, në formë elektronike për kërkesat që lidhen me vënien në dispozicion të dokumenteve, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC. Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
39.	**Byroja Kombëtare e Hetimit. Njësia e Posaçme Hetimor**e	Ligji nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar,"* - neni 43, pika 2 dhe 3.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me cështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.
40.	**Gjykata Kushtetuese Kolegji i Posacëm i Apelimit**	Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Aneksi i Kushtetutës për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nenit Ç, pika 3. Ligji nr. 84/2016 *"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";* - neni 45, kreu VII "Rregullat e përgjithshme të hetimit të ceshtjes"; - neni 50, pika 1 dhe neni 53.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj që lidhen me ceshtjen në shqyrtim dhe me qëllimin. Për çështje të rivlerësimit dokumentet, respektivisht si vijon: - certifikatë personale; - certifikatë familjare; - certifikatë martese; - certifikatë vdekje. Për subjektet e rivlerësimit dhe denoncuesit, të dhënat, përbërësit e gjendjes civile si vijon: - emër; - mbiemër; - emri i babait; - emri i nënës; - datëlindje; - numër personal; - vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike, në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.

41.	**Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**	- Neni 179/b të Kushtetutës, pikat 1 dhe 2 - Aneksi Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve neni A dhe Ç; - Ligji nr. 84/2016 *"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, si dhe Shtojca 1, Shtojca 2 dhe Shtojca 3. - neni 3 "Përkufizime"; - neni 30 "Objekti i vlerësimit të pasurisë"; - neni 31 "Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë"; - neni 32, "Deklarimi i pasurisë"; - neni 45 "Rregullat e përgjithshme të hetimit të cështjes"; - neni 49, "Mjetet për kërkimin e provës"; - neni 50 "Aksesi në informacion";	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj që lidhen me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas shtojcës 3 të Deklaratës për Kontrollin e Figurës: - përbërësit e gjendjes civile dhe të dhënat familjare sipas historikut dhe ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile; - të dhënat e vendbanimit sipas historikut të regjistrimit; - të dhënat për dokumentin e identitetit, letërnjoftimin; - përbërja familjare e subjektit të verifikimit; - ndryshimet në përbërjen familjare për periudhat e kërkuara; - të dhënat për vendbanimin (adresën); - të dhëna për lidhjen e martesës, etj.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.
42.	**Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**	Vendimi nr. 188, datë 04.03.2015 i Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit."* Urdhri nr. 272, datë 28.05.2015 i Ministrit të Punëve të Brendshme *"Për procedurat e sigurimit të personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme."* - neni 3, pika 3 "autoritetet verifikuese"; - neni 12, gërmat "a" dhe "b", kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë.	Të dhënat, përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, të domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin, respektivisht si vijon: - emri; - mbiemri, (mbiemri para / pas martese i shtetasve të gjinive femër / mashkull); - emri i babait; - emri i nënës; - numri personal; - datëlindja; - vendlindja; - të dhënat për vendbanimin (adresën); - statusi i gjendjes civile; - historiku i plotë i regjistrimit dhe ndryshimet në përbërësit e gjendjes civile, përfshirë dhe informacionin për datën kur janë kryer këto ndryshime; - kombësia sipas të dhënave arkivore të gjendjes civile, në rastet kur ky përbërës rezulton i dokumentuar;	Në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.

43.	**Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)**	Ligji nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar."* - neni 28, pika 3.	Të gjitha të dhënat e domosdoshmepërkryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me objektin e hetimit. Të gjithë përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. Dokumentet: - certifikatë personale; - certifikatë familjare; - certifikatë martese; - certifikatë vdekje; - certifikatë historike e përbërjes familjare;	Në formë shkresore, sipas kërkesës, në formë elektronike, si dhe nëpërmjet identifikimit elektronik në RKGjC.
44.	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, neni 32, pika 2.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme lidhur me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, që konsiderohen të nevojshëm përkryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, në ushtrimin e kompetencave të këtij institucioni, të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë, që kanë lidhje me hetimin administrativ.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe elektronikisht.
45.	**Agjencia e Trajtimit të Pronave**	Ligji nr. 133/2015 *"Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"*, të ndryshuar, neni 36, pika 1.	Të dhënat si më poshtë: - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
46.	**Instituti i Shëndetit Publik**	Ligji nr. 15/2016 *"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"*, i ndryshuar, neni 28; Ligji nr. 10 138, datë 11.5.2009 *"Për shëndetin publik"*, neni 3;	Të dhënat si më poshtë: - për fëmijën: numri personal, emër, mbiemër, datëlindje; - për nënën: numri personal, emri dhe mbiemri; - për babain: numri personal, emri dhe mbiemri, në rastet kur është njohur atësia e fëmijës;	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.

47.	**Qendra e Shërbimeve Arsimore Drejtoria e Shërbimeve Arsimore**	Ligji nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; Kreu XII *Shkeljet e kërkesave ligjore në fushën e arsimit parauniversitar* - neni 66 *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale* - neni 67 *Mbrojtja e të dhënave personale* Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 27.07.2015 *"Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, përmbajtjen e dosjeve të tyre personale, si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave kontaktuese të prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve"*, i ndryshuar	Të dhënat për nxënësin: - numri personal; - emër; - mbiemër; - emri i babait; - shtetësi; - datëlindje; - vendlindje; - adresa, të dhënat për vendbanimin; - gjinia; - informacion mbi kujdestarin ligjor; Të dhënat për punonjësin arsimor: - numri personal; - emër; - mbiemër; - emri i babait; - shtetësi; - datëlindje; - vendlindje; - adresa, të dhënat për vendbanimin; - gjinia; Të dhënat për prindin/kujdestarin ligjor: - numri personal; - emër; - mbiemër; - shtetësi; - datëlindje; - adresa, të dhënat për vendbanimin; - gjinia;	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
48.	**Shkolla e Magjistraturës Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore**	Ligji nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"*, i ndryshuar; - Neni 262 Regjistrimi i konkurrentëve Ligji nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; - neni 29 "Thirrja për kandidatura" - neni 30 "Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve"	Të dhënat personale - emër; - mbiemër; - numër personal; - emri i babait; - datëlindje; - vendlindje; - vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.

49.	**Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)**	Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 *"Për regjistrimin e biznesit"*, i ndryshuar; Ligji nr. 131/2015 *"Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"*, i ndryshuar;	Të dhënat personale - emër; - mbiemër; - numër personal; - datëlindje; - vendbanimi (adresa);	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.
50.	**Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)**	**Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011** *"Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar"* - neni 5 Personat e siguruar - neni 27 Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar	Të dhënat personale të personave që kanë ndërruar jetë: - zyra e gjendjes civile në bashki/njësi administrative; - emër; - mbiemër; - numër personal; - datëlindje;vendlindje; - emri i babait; - emri i nënës; - gjinia; - gjendja civile; - shtetësia; - vendbanimi (adresa); - data e vdekjes; - vendi i vdekjes; - shteti i vdekjes; - shkaku i vdekjes; - data e ç'regjistrimit;	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse.

Protokolluar me nr. _____ , datë _____.

FORMULAR
KËRKESË PËR MARRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA TË DHËNA TË ADMINISTRUARA NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Kërkuesi: Emri i institucionit/organit
Emri i titullarit të institucionit/organit _____
Adresa _____
Telefon _____
Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile _____
Adresa: _____

Përmbajtja e kërkesës:
a) Lloji i të dhënave me karakter personal që kërkohet të merret nga të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile
_____

b) Baza ligjore mbi të cilën bazohet kërkesa (referencë te përmbledhësja e institucioneve dhe e organeve që marrin të dhëna me karakter personal nga të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile)
_____

c) Qëllimi për të cilin do të përdoren të dhënat me karakter personal të kërkuara
_____
_____
Emër, mbiemër dhe nënshkrimi i titullarit dhe vula e institucionit/organit
_____

Datë _____ .____. _____

DHËNIA E PËLQIMIT TË SUBJEKTIT PËR KONTROLL NË TË DHËNAT PERSONALE NË DOKUMENTACIONIN QË MBAN SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Unë _____ , pas marrjes së informacionit të detajuar, në lidhje me natyrën dhe rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi, si dhe pas marrjes së informacionit të detajuar mbi të drejtat e mia të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, jap pëlqimin tim të lirë për _____.

(Subjekti i autorizuar) të ketë të drejtën të kontrollojë të dhënat e mia personale, në lidhje me emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe (të dhëna të tjera sipas rastit), në dokumentacionin që mban shërbimi i gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i këtij përpunimi do të jetë ekskluzivisht verifikimi i _____ .

(Subjekti i autorizuar) _____, si kontrollues mund të përhapë ose të vërë në dispozicion të dhënat e mia personale te këta marrës: _____, me kusht që kjo përhapje të jetë absolutisht e nevojshme për përmbushjen e shërbimit të kërkuar ose nëse kontrolluesi kryen një përpunim që është thelbësor për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Kontrolluesi ka të drejtë të mbajë të dhënat e mia personale vetëm për një periudhë kohe prej ____ muajsh.

Kontrolluesi është i detyruar të shkatërrojë ose të bëjë anonime të dhënat e mia personale pas përfundimit të kësaj periudhe, përveç kur parashikohet ndryshe në bazë të një dispozite ose të një akti tjetër të veçantë.

Datë _____ .____. _____ Nënshkrimi _____

URDHËR

Nr. 181, datë 19.9.2024

PËR PROCEDURËN E KORRIGJIMIT SI GABIM MATERIAL TË EMRIT, MBIEMRIT, EMRIT TË BABAIT, EMRIT TË NËNËS

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 36, 57/7, 57/8, 57/9 dhe të germës "a", të nenit 65, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

URDHËROJ:

1. Shtetasi shqiptar që pretendon se në përbërësit e gjendjes civile, emër/mbiemër, emër i babait/emër i nënës, ka gabime materiale, të cilat mund të jenë shkaktuar gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile nga një regjistër themeltar në një tjetër, paraqet kërkesë për korrigjimin e tyre, drejtuar zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative ku rezulton i regjistruar, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*.
2. Kërkesa e shtetasit në formë elektronike administrohet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative. Pas marrjes së kërkesës, përgjegjësi i zyrës kërkon në arkiv të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas rendit kronologjik të lëvizjeve të mundshme që ka kryer shtetasi. Në rast të mosgjetjes së tyre, i drejtohet çdo zyre brenda shërbimit të gjendjes civile, për të siguruar dokumentin e nevojshëm.
3. Mbledhja e dokumentacionit ndërmjet zyrave të gjendjes civile kryhet në formë elektronike ose shkresore.
4. Përgjegjësi i cili trajton kërkesën, pasi mbledh dokumentacionin e nevojshëm, do të kryejë verifikimin e të gjithë përbërësve të gjendjes civile për shtetasin objekt verifikimi.
5. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, në përfundim të mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm dhe verifikimit të tij, në rastet kur i interesuari ka gabim material në emrin/mbiemrin/emrin e babait/emrin e nënës, harton relacionin ku shpreh mendimin e tij mbi objektin e kërkesës dhe e dërgon brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Kalimi i këtij afati duhet të pasqyrohet në relacion me arsyetimin përkatës.
6. Përgjegjësi, gjatë shqyrtimit të dokumenteve, kur vëren se shtetasi ka edhe gabime të tjera materiale, i pasqyron edhe ato në relacionin përkatës duke bërë me dije edhe shtetasin.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi administron praktikën e zyrës së gjendjes civile, kryhen verifikime të mëtejshme, nëse e sheh të nevojshme, në të dhënat e administruara nga shërbimi i gjendjes civile dhe në akte të organeve të tjera shtetërore, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar për korrigjimin e përbërësve të gjendjes civile si gabim i provuar material.
8. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, brenda 5 (pesë) ditëve pune, shqyrton praktikën e përgatitur nga sektori përkatës pranë drejtorisë dhe shprehet me vendim të arsyetuar.
9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësinë administrative, pas njohjes me vendimin e drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile, kryen veprimet në rubrikën përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010. Përgjegjësi, duke respektuar procedurën e miratuar për pasqyrimin e korrigjimit si gabim material, do të plotësojë të gjitha rubrikat dhe në secilën prej tyre do të vendosë informacionin përkatës, mosplotësimi i të cilave do të konsiderohet si shkelje administrative.
10. Në rastet kur korrigjimi i përbërësit të gjendjes civile është përbërës i gjendjes civile edhe për pjesëtarë të tjerë të familjes, përgjegjësi duhet të përditësojë edhe të dhënat e tyre për të reflektuar korrigjimin. Përgjegjësi njofton, nëpërmjet kërkuesit fillestar, personat e prekur nga ky veprim.
11. Korrigjimi i të gjithë përbërësve të tjerë të gjendjes civile do të kryhet nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile sipas procedurës së miratuar për këtë proces. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile për çdo gabim tjetër material në përbërësit e gjendjes civile zbaton procedurën e miratuar për këtë qëllim, duke dalë me vendim sipas procesverbalit tip nr. 11, miratuar me VKM-në nr. 332, datë 17.3.2010, "Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga

Shërbimi i Gjendjes Civile", i ndryshuar. Ky vendim duhet të hartohet dhe zbatohet brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja e kërkesës.

12. Rastet e zbatimit të korrigjimeve si gabim material i nënshtrohen kontrollit administrativ nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
13. Vendimi i drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile hartohet në tre kopje, nga të cilat një kopje i dërgohet zyrës së gjendjes civile që ka dërguar kërkesën, një kopje prefektit të qarkut dhe një kopje administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
14. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile njofton shtetasin, për vendimin e drejtorit të përgjithshëm të Gjendjes Civile, brenda 2 (dy) ditëve pune nga komunikimi i vendimit.
15. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 509, datë 27.8.2019, "Për procedurën e korrigjimit të emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, si gabim material", shfuqizohet.
16. Kërkesa dhe procedurat administrative që në datën e hyrjes në fuqi të këtij urdhri janë në proces shqyrtimi nga sistemi ministror i Ministrisë së Brendshme, zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të urdhrit të ministrit të Brendshëm, në kohën e paraqitjes së tyre.
17. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

Fletore zyrtare nr. 166, datë publikimi 30.09.2024

LIGJ

Nr. 8952, datë 10.10.2002

PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË

(ndryshuar me ligjin nr. 10 066, datë 2.2.2009 dhe nr. 10 328, datë 30.9.2010, nr. 11/2019, datë 5.3.2019, meaktin normativ nr. 25, datë 10.6.2020, me ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020; ndryshuar me aktin normativ nr. 11, datë 25.3.2021; nr. 2, datë 2.3.2022 3; nr. 1, datë 27.4.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ky ligj përcakton letërnjoftimin e shtetasve shqiptarë, me qëllim pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një letërnjoftim unik, kriteret për lëshimin e tij, si dhe përmbajtjen e këtij letërnjoftimi.

Neni 2

(shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 1, dhe shtuar pikat 3, 4, 5, me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010)

1. Letërnjoftimi i personave është dokumenti bazë, i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë.
2. Çdo shtetas duhet të mbajë me vete letërnjoftimin.
3. Shtetasi aplikon për letërnjoftim elektronik në zyrat e aplikimit.
4. Letërnjoftimi tërhiqet nga vetë shtetasi në zyrat e aplikimit.
5. Procedura e aplikimit dhe dokumentet që paraqiten për aplikim përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 3

(ndryshuar shkronja "a" e pikës 1 me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010)

Për pajisjen me letërnjoftim shtetasi duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

b) të ketë mbushur moshën 16 vjeç.

2. Çdo shtetas që plotëson kushtet e mësipërme është i detyruar të pajiset me letërnjoftim, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

(ndryshuar me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020)

Letërnjoftimi elektronik lëshohet me afat 10 vjet nga data e lëshimit.

Për shtetasit që kanë mbushur moshën 75 (shtatëdhjetë e pesë) vjeç, letërnjoftimi elektronik lëshohet pa afat.

Neni 5

(shtuar shkronja "ç" me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010)

Shtetasi pajiset me letërnjoftim të ri kur:

a) plotëson kushtet e nenit 3 pika 1 të këtij ligji;

b) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftimin, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

c) vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi i ka humbur ose i është vjedhur.

ç) është dëmtuar.

Neni 5/1

(shtuar me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010)

Letërnjoftimi shpallet i pavlefshëm kur:

a) ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i tij e ka siguruar në mënyrë të paligjshme;

b) vërtetohen rastet e përcaktuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nenit 5.

Neni 6

(ndryshuar me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010)

Letërnjoftimi është dokument identiteti, në të cilin janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda

informatike:

a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit:

i) numri personal (nup);

ii) emri;

iii) mbiemri;

iv) shtetësia;

v) vendlindja;

vi) datëlindja;

vii) gjinia;

b) fotografia e mbajtësit të këtij dokumenti;

c) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;

ç) elemente sigurie, brenda normave të Komunitetit Europian, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Shkelja e afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë. Të drejtën për vendosjen e gjobës e ka shërbimi i gjendjes civile.
2. Mënyra e vendosjes së gjobës dhe ankimi në gjykatë bëhen sipas ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

Neni 8

Forma, modeli i letërnjoftimit dhe mënyra e shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ligji nr. 4172, datë 13.9.1966 "Mbi pajisjen e shtetasve me letërnjoftim", ndryshuar me ligjet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Dispozitë kalimtare

(me ligjin nr. 10 328, datë 30.9.2010)

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me letërnjoftim elektronik janë të përcaktuara në kontratën koncesionare, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008. Me përfundimin e kësaj kontrate, këto tarifa do të jenë objekt i përcaktimit nga ky ligj.

Neni 9/1

Dispozitë kalimtare

(me ligjin nr. 11/2019, datë 5.3.2019)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike të shtetasve shqiptarë, të cilat janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, zgjatet deri në datën 31.12.2019.

Neni 9/2

Dispozitë kalimtare

(shtuar me me aktin normativ nr. 25, datë 10.6.2020)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve shqiptarë, që përfundon brenda vitit 2020, zgjatet deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

Neni 9/2

Dispozitë kalimtare

(shtuar me aktin normativ nr. 11, datë 25.3.2021)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve shqiptarë, që përfundon deri në datën 25 prill 2021, zgjatet deri në datën 30 prill 2021.

Neni 9/3

Dispozitë kalimtare

(shtuar me aktin normativ nr. 2, datë 2.3.2022)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve, që parashikohen në listat e zgjedhësve të njësive të vetëqeverisjes vendore, të shpallura me dekretin nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, që përfundon deri në datën 6 mars 2022, zgjatet deri në datën 7 mars 2022.

Neni 9/4

Dispozitë kalimtare

(shtuar me aktin normativ nr. 1, datë 27.4.2023)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve, votues në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të shpallura me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, që përfundon deri në datën 14 maj 2023, zgjatet deri në datën 31 maj 2023.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3542, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu

Vendim

Nr. 418, datë 27.04.2009

PËR NJOHJEN DHE PËRDORIMIN E LETËRNJOFTIMIT SI DOKUMENT IDENTIFIKIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3, 6 e 8 të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002 "Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë", të ndryshuar, të pikave 4 e 5 të nenit 19 të ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008 "Për ratifikimin e kontratës koncesionare, për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të SAGEM Securite e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Institucionet, publike dhe jopublike, vendase dhe të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do ta njohin si dokument identifikimi letërnjoftimin, sipas modelit të paraqitur në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Certifikata personale me fotografi do të përdoret si dokument identifikimi vetëm për shtetasit nën moshën 16 vjeç.
3. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, mbajnë shënim numrin personal dhe numrin e letërnjoftimit, si dhe mund të bëjnë fotokopje të letërnjoftimit të shtetasve, të cilëve u shërbejnë, nëse u nevojitet ky dokument si pjesë përbërëse e praktikës përkatëse.
4. Në rastet kur shtetasit nuk disponojnë letërnjoftim për arsye të justifikuara, lejohet përdorimi i certifikatës personale me fotografi, si dokument identifikimi, deri më 31 dhjetor 2009, në përputhje me dispozitat e parashikuara në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore.
5. Ndaj punonjësve të institucioneve, publike dhe jopublike, vendase, në rast të moszbatimit të dispozitave të parashikuara në këtë vendim, do të merren masa disiplinore fillimisht me gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës, në rast përsëritjeje gjobë në vlerën e një page dhe nëse ripërsëritet pezullim nga detyra.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr.1



Fletore zyrtare nr. 68, datë publikimi 20.05.2009

LIGJ

Nr. 8668, datë 23.10.2000

PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT

(Ndryshuar me aktin normativ nr. 5, datë 31.8.2001, miratuar me ligjin nr. 8822, datë 15.10.2001, ndryshuar me ligjin nr. 8998, datë 30.1.2003, nr. 10 306, datë 22.7.2010, nr. 41/2014, datë 17.4.2014, 2/2019, datë 31.1.2019, ndryshuar me aktin normativ nr. 23, datë 3.6.2020[22]; me aktin normativ nr. 13[23], datë 31.3.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(shtuar një fjali në fund të nenit me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)

Pasaporta për jashtë shtetit është dokumenti që vërteton identitetin dhe shtetësinë shqiptare të mbajtësit të saj, me anën e së cilës ai mund të dalë e të hyjë nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të udhëtojë nga një shtet i huaj në një tjetër.
Pasaporta për jashtë shtetit është një dokument me shkallë të lartë sigurie, në përputhje me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në elementet e sigurisë përfshihen të dhënat biometrike, përmbajtja e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Të gjithë shtetasit shqiptarë kanë të drejtë të pajisen me pasaportë. Shtetasit shqiptarë, që me vendim të gjykatës kanë zotësi të pjesshme për të vepruar ose nuk kanë zotësi për të vepruar, pajisen me pasaportë vetëm me kërkesë të prindërve ose të kujdestarit të tyre.

[22] Akti normativ nr. 23, datë 3.6.2020 është miratuar me ligjin nr. 77/2020, datë 25.6.2020.
[23] Akti normativ nr. 13 , datë 31.3.2021 është miratuar me ligjin nr. 56/2021, datë 4.5.2021.

Neni 3

(shfuqizuar paragrafi i dytë i nenit me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)

Shtetasit deri në moshën 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 5 vjet, ndërsa ata mbi 16 vjeç pajisen me pasaportë të vlefshme për 10 vjet.
Shfuqizuar.

Neni 4

Pasaporta shqiptare është e zakonshme, shërbimi dhe diplomatike. Kriteret për lëshimin e pasaportës së shërbimit dhe asaj diplomatike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Pasaporta e zakonshme lëshohet nga Ministria e Brendshme, ndërsa pasaporta e shërbimit dhe ajo diplomatike lëshohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.
Për shtetasit shqiptarë, me banim jashtë shtetit, veprohet sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 6

(ndryshuar me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)
Procedura e aplikimit dhe dokumentet që paraqiten për aplikim përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 7

(ndryshuar me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)
Pasaporta e zakonshme tërhiqet pranë drejtorive dhe komisariateve të policisë. Tërheqja e pasaportës kryhet nga shtetasi ose i ngarkuari me prokurë të posaçme apo një pjesëtar i afërt i familjes (bashkëshortja/prindi, fëmija madhor) apo kujdestari ligjor për të miturit dhe për shtetasit pa zotësi për të vepruar.
Pasaporta e shërbimit dhe ajo diplomatike tërhiqen pranë zyrës përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Neni 8

Shtetasit i bllokohet pasaporta kur:

- ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i saj e ka marrë atë duke falsifikuar dokumentet për lëshimin e saj;
- në pasaportë ka shënime të bëra nga organe ose persona të paautorizuar;
- ka lënë funksionin, për të cilin ka marrë pasaportën e shërbimit ose atë diplomatike.

Neni 9

(shtuar fjalë në paragrafin e parë dhe hequr fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)

Pasaporta shpallet e pavlefshme kur:

- denoncohet nga vetë shtetasi se i ka humbur, i është vjedhur ose grabitur, kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile;
- është dëmtuar;
- i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;
- vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10

Vlerësimi dhe administrimi i pasaportës së pavlefshme bëhet përkatësisht nga organi që e ka lëshuar.

Neni 11

Ripajisja me pasaportë biometrike e shtetasve

(ndryshuar me ligjin 2/2019, datë 31.1.2019)

1. Shtetasi ripajiset me pasaportë biometrike:
   a) në rastet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji;
   b) kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë;
   c) 6 muaj përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë, kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me afatin 6-mujor të vlefshmërisë së pasaportës.
2. Procedura për ripajisjen me pasaportë biometrike të zakonshme dhe dokumentacioni që paraqitet përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

Neni 12

(shfuqizuar me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)

Neni 13

(hequr fjalë me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)

Modeli i pasaportës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Pajisja me pasaportë të re, sipas këtij ligji, do të bëhet pas përfundimit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese me të cilën është pajisur çdo shtetas shqiptar.

Neni 14/1

Dispozitë kalimtare

(shtuar me aktin normativ nr. 5, datë 31.8.2001, miratuar me ligjin nr. 8822, datë 15.10.2001, ndryshuar me ligjin nr. 8998, datë 30.1.2003)

Neni 3 i këtij ligji zbatohet pas datës 31.12.2005. Deri në këtë datë, shtetasit e moshës mbi 16 vjeç pajisjen me pasaportë të modelit ekzistues të vlefshme për 5 vjet, me të drejtë përtëritjeje deri në 3 vjet, ndërsa të miturit e moshës deri 16 vjeç pajisen pranë organit të policisë me leje kalimi të modelit ekzistues të vlefshme për 6 muaj dhe vetëm për një udhëtim.

Neni 14/2

Dispozitë kalimtare

(shtuar me ligjin nr. 41/2014, datë 17.4.2014)

Afati i vlefshmërisë së pasaportave biometrike, të lëshuara gjatë periudhës 1 prill 2009 – 31 korrik 2010, me afat vlefshmërie 10 vjet, për të gjithë shtetasit shqiptarë me moshë deri në 16 vjeç në kohën e aplikimit, zgjatet me 1 vit nga dita e plotësimit të afatit ligjor prej 5 vitesh.

Neni 14/3

Dispozitë kalimtare

(shtuar me aktin normativ nr. 13, datë 31.3.2021)

Afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon deri në datën 25 prill 2021, zgjatet deri në datën 30 prill 2021.

Neni 15

(shtuar fjalë në fund të nenit me aktin normativ nr. 5, datë 31.8.2001, miratuar me ligjin nr. 8822, datë 15.10.2001)

Dekreti nr. 7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave", me ndryshimet e bëra, si dhe çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen duke mbetur në fuqi përkohësisht dispozitat e përcaktuara në nenin 14/1 të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(vendosur me ligjin nr. 10 306, datë 22.7.2010)

Pasaportat e vlefshme jobiometrike mund të nxirren nga qarkullimi përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë me vendim të Këshillit të Ministrave. Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me pasaportë biometrike janë të përcaktuara në kontratën koncesionare, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008. Me përfundimin e kësaj kontrate, këto tarifa do të përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore.

Dispozitë kalimtare

(shtuar me aktin normativ nr. 23, datë 3.6.2020)

Afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon brenda vitit 2020, zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2020.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2817, datë 5.12.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

UDHËZIM

Nr. 93, datë 27.05.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË DOKUMENTACIONIT QË PARAQITET PËR APLIKIMIN DHE PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË ZAKONSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 6 dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Vendi i aplikimit

1. Shtetasi shqiptar (në vijim "shtetasi") aplikon për t'u pajisur me pasaportë biometrike:
   a) brenda vendit: në zyrat e aplikimit pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, të përcaktuara nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në raste të veçanta, aplikimi mund të kryhet në institucionet shëndetësore, spitalore, shtëpitë e të moshuarve, në vendbanim ose ambiente të tjera, sipas kërkesës së Ministrisë së Brendshme;
   b) jashtë vendit: në zyrat e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, të përcaktuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Në raste të veçanta, me miratim të Ministrisë së Brendshme, aplikimet mund të kryhen në vende të tjera përveç zyrave të Misioneve Diplomatike dhe Posteve Konsullore.

Neni 2
Aplikimi për herë të parë

1. Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t'u pajisur me pasaportë biometrike, sipas nenit 1, duhet të plotësojë *online* nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania* formularin përkatës të vetëdeklarimit, si dhe të bashkëngjisë në portal një fotografi, sipas përmasave të përcaktuara në shtojcën 1, që i përcillet elektronikisht strukturës vendore të Policisë së Shtetit. Në rast se fotografia e dërguar nuk

rezulton sipas parametrave të shtojcës nr. 1, aplikimi refuzohet.

2. Kjo procedurë ndiqet edhe nga shtetasit të cilët nuk aplikojnë për herë të parë, por janë pajisur për herë të fundit me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011.
3. Në rastin kur prindi ose kujdestari ligjor aplikon për fëmijën nën 16 vjeç ose për persona nën kujdestari, ndiqet e njëjta procedurë.
4. Në çdo rast të aplikimit për pasaportë shtetasi shqiptar që ka mbushur moshën 16 vjeç duhet të paraqitet me një letërnjoftim elektronik të vlefshëm. Në rast se nuk zotëron një letërnjoftim të vlefshëm shtetasi duhet të aplikojë njëkohësisht edhe për këtë të fundit, përveç aplikimit fillestar për pasaportë biometrike.

Neni 3

Verifikimi i të dhënave të formularit të aplikimit

1. Në aplikimin për pasaportë biometrike sipas nenit 2, të dhënat e formularit të vetëdeklarimit me fotografi, verifikohen nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe përcillen elektronikisht ose fizikisht në Zyrën e Gjendjes Civile ose në Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore, brenda:
   a) 7 ditëve pune, për aplikimin me procedurë normale;
   b) 1 ditëve pune, për aplikimin me procedurë të përshpejtuar;
   c) 10 ditëve pune, për aplikimet jashtë vendit.

Neni 4

Pagesa për shërbimin

1. Për shërbimin e pajisjes së shtetasit me pasaportë biometrike, në çdo rast kërkohet pagesa e shërbimit nëpërmjet blerjes së një kuponi.

Neni 5

Ripajisja e shtetasve me pasaportë biometrike

1. Për ripajisjen e shtetasit me pasaportë, nuk zbatohet procedura e përcaktuar në nenet 2 dhe 3, të këtij udhëzimi.
2. Shtetasi aplikon direkt në zyrat e aplikimit, duke paraqitur kuponin dhe si mjet identifikimi letërnjoftimin elektronik, si edhe dorëzon pasaportën ekzistuese. Për shtetasit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nevojitet rezervimi *online* i takimit për aplikim.
3. Në mungesë të pasaportës dorëzon vërtetimin e deklarimit të humbjes ose vjedhjes i cili kryhet *online* ose fizikisht pranë

Komisariatit përkatës të Policisë së Shtetit. Për shtetasit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë deklarimi mund kryhet edhe pranë Misioneve Diplomatike ose Posteve Konsullore.

4. Për të gjitha aplikimet me procedurë të përshpejtuar, që nuk i nënshtrohen plotësimit të formularit të vetëdeklarimit për strukturat e Policisë së Shtetit, shtetasi mund të paraqitet për aplikim pranë çdo Zyre Aplikimi në territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Nëpunësi i Shoqërisë për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike "IdentiTek" sh.a. (në vijim "Shoqëria") informon shtetasin mbi procedurën e aplikimit dhe vijon me dëmtimin fizik të pasaportës së vjetër, duke prerë bandën e MRZ-së, e cila arkivohet. Pjesa tjetër e pasaportës i dorëzohet shtetasit.

Neni 6

Pajisja me pasaportë biometrike e shtetasve nën 16 vjeç

1. Shtetasi nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç, aplikon për pasaportë në prani të paktën të njërit prind, të kujdestarit ligjor ose të përfaqësuesit me prokurë në të cilën është parashikuar në mënyrë specifike ky shërbim.
2. Për shtetasit mbi moshën 12 vjeç është e detyrueshme marrja e shenjave të gishtave gjatë procesit të aplikimit për pasaportë biometrike.
3. Shtetasit nën moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç pajisjen me pasaportë pa marrë shenjat e gishtave.

Neni 7

Vlefshmëria e pasaportës biometrike

1. Për shtetasit mbi moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç vlefshmëria e pasaportës biometrike është 10 (dhjetë) vjet.
2. Për shtetasit nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç vlefshmëria e pasaportës biometrike është 5 (pesë) vjet.

Neni 8

Afati i pajisjes së shtetasve me pasaportë biometrike

1. Pajisja me pasaportë biometrike kryhet sipas afateve të mëposhtme:
   a) brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit me procedurë normale, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
   b) brenda 3 ditëve pune nga data e aplikimit me procedurë të përshpejtuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) brenda 30 ditëve pune nga data e aplikimit në përfaqësitë diplomatike/konsullore, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Në rast të një nevoje urgjente, të paparashikueshme, të vlerësuara si të tilla nga Ministria e Brendshme ose nga organet drejtuese të shoqërisë, procedurat e parashikuara në nenin 8.1 mund të përshpejtohen.
3. Në rastet e parashikuara në nenin 8, pika 2, kërkesa për shoqërinë bëhet me shkrim, në rrugë elektronike ose shkresore.
4. Afatet e parashikuara në nenin 8, pika 1, pezullohen në rastet kur aplikimi kërkon verifikime shtesë nga institucione të tjera, jashtë kompetencës së Shoqërisë.

Neni 9

Tërheqja e pasaportës biometrike

1. Tërheqja e pasaportës kryhet pranë zyrave të shoqërisë të ngarkuara për shpërndarjen e pasaportës biometrike të cilat gjenden pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, si dhe në Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore.
2. Tërheqja e pasaportës mund të kryhet:
   a) nga shtetasi mbi 16 vjeç, shoqëruar me letërnjoftimin biometrik dhe faturën e shpërndarjes;
   b) për shtetasit nën 16 vjeç, tërheqja e dokumentit mund të kryhet nga njëri nga prindërit, kujdestarit ligjor, përfaqësuesit ligjor ose me prokurë ku të jetë specifikuar shërbimi përkatës. Në këto raste personi i ngarkuar për tërheqjen e pasaportës duhet të paraqesë për verifikim para nëpunësit, sipas rastit; letërnjoftimin e tij, një certifikatë familjare që vërteton cilësinë e tij, prokurën, si dhe faturën e shpërndarjes;
   c) për shtetasit mbi 16 vjeç, në pamundësi fizike për t'u paraqitur personalisht pranë zyrave të shpërndarjes, tërheqja e dokumentit mund të kryhet nga ana e një pjesëtari të afërt të familjes (bashkëshorti/bashkëshortja, prindi, fëmija madhor), kujdestarit ligjor, përfaqësuesit ligjor ose me prokurë ku të jetë specifikuar shërbimi përkatës. Në këto raste, personi i ngarkuar për tërheqjen e pasaportës duhet të paraqesë për verifikim para punonjësit të shoqërisë, sipas rastit, letërnjoftimin e tij, një certifikatë që

vërteton lidhjen e tij me aplikuesin, prokurën, si dhe faturën e shpërndarjes.

Neni 10

Dërgimi me postë i pasaportës biometrike

1. Për raste të parashikuara në nenin 1, shkronja "b", pasaporta biometrike mund të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar të sigurt të shtetit të huaj, në bazë të parapagimit të kryer nga vetë shtetasit që kanë aplikuar.
2. Në rastet e parashikuara në këtë nen, shtetasi plotëson një deklaratë para operatorit përkatës nëpërmjet së cilës deklaron adresën e saktë, si dhe merr përsipër përgjegjësinë e dërgesës.

Neni 11

Ripajisja me pasaportë biometrike para mbarimit të afatit të vlefshmërisë

1. Shtetasi ripajiset me pasaportë para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese në rastet e mëposhtme:
   a) kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me një afat të caktuar vlefshmërie të pasaportës;
   b) kur ndryshojnë përbërësit e gjendjes civile;
   c) kur pasaportës i janë plotësuar fletët me shënime zyrtare;
   ç) kur pasaporta është dëmtuar fizikisht;
   d) kur pasaporta është deklaruar e humbur;
   dh) kur pasaporta është kallëzuar e vjedhur.
2. Në rastet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç", të pikës 1, të këtij neni, për ripajisjen me pasaportë, shtetasit dorëzojnë pasaportën ekzistuese në zyrën e aplikimit, ndërsa aplikimi vijon sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Në rastet e parashikuara në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij neni, shtetasi vetëdeklaron humbjen ose vjedhjen e pasaportës biometrike *online* ose fizikisht pranë komisariateve të Policisë së Shtetit. Në rastet e parashikuara në shkronjën "dh", të pikës 1, të këtij neni, shtetasi vetëdeklaron vjedhjen e pasaportës biometrike fizikisht pranë komisariateve të Policisë së Shtetit. Shtetasi mund të riaplikojë për pajisjen me pasaportë, vetëm pas lëshimit të vërtetimit mbi pranimin e vetëdeklarimit nga strukturat përkatëse. Të dhënat e

vërtetimit regjistrohen në formularin e aplikimit nga operatori i Zyrës së Aplikimit dhe i bashkëngjiten praktikës. Më pas, aplikimi vijon sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Për shtetasit që jetojnë jashtë vendit, vetëdeklarimi mund të bëhet *online* ose pranë Misioneve Diplomatike dhe Posteve Konsullore.
5. Konsiderohet si pasaportë e dëmtuar fizikisht ai dokument biometrik që përfshin rastet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:
   a) të dhënat janë të padeshifrueshme ose të palexueshme;
   b) është çngjyrosur faqja e të dhënave biometrike;
   c) kur ka dëmtime kimike ose me bojë në ndonjë faqe të pasaportës;
   ç) kur konstatohet mungesa, grisja ose dëmtimi fizik i ndonjë faqeje të pasaportës;
   d) kur konstatohet dëmtimi i elementit elektronik të pasaportës;
   dh) ka shënime nga persona të paautorizuar.

Neni 12

Dërgesa e informacionit mbi pasaportat e reja të prodhuara

1. Jo më vonë se 48 orë nga prodhimi i pasaportës biometrike, shoqëria dërgon raport ditor mbi pasaportat e prodhuara në mënyrë elektronike në strukturën përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me marrjen e raportit sipas pikës 1, të këtij neni, kryen këto veprime:
   a) përditëson informacionin në sistemin e Kontrollit Kufitar që përdor Policia e Shtetit;
   b) kryen çaktivizimin në këtë sistem të pasaportës së vjetër.
3. Protokollet teknike të komunikimit vendosen me marrëveshje midis drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe administratorit të shoqërisë.

Neni 13

Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit të aplikimit

1. Formularët e aplikimit bashkë me dokumentacionin shoqërues, si: banda MRZ e pasaportës së mëparshme, vërtetimi i vetëdeklarimit të humbjes/vjedhjes që kanë shërbyer për aplikim, pasi administrohen fillimisht në Zyrën e Aplikimit, dërgohen për arkivim në zyrën qendrore të shoqërisë.

2. Kopjet e formularëve të vetëdeklarimit me fotografi administrohen nga Policia e Shtetit dy vjet pas mbarimit të vlefshmërisë së pasaportës.
3. Të gjitha aplikimet e kryera arkivohen në zyrën qendrore të shoqërisë.
4. Akses në këtë arkiv ka shoqëria, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme të autorizuar nga ministri i Brendshëm dhe çdo përfaqësues i institucioneve të tjera të autorizuara paraprakisht nga ministri i Brendshëm ose kur legjislacioni në fuqi ia jep këtë të drejtë.

Neni 14

Ruajtja dhe arkivimi i pasaportës biometrike dhe bandës MRZ

1. Banda e MRZ-së e cila pritet nga pasaporta e vjetër nga ana e punonjësit të shoqërisë, ruhet dhe arkivohet për një periudhë 10-vjeçare. Pas përfundimit të këtij afati banda e MRZ-së asgjësohet fizikisht nga shoqëria, e cila evidenton në mënyrë administrative të gjithë procesin.
2. Pasaportat biometrike të prodhuara që gjenden në Zyrat e Shpërndarjes, ruhen për një periudhë 18-mujore nga momenti prodhimit. Në rast se pas përfundimit të këtij afati shtetasi nuk është paraqitur për tërheqjen e dokumentit, vijohet me:
   a) prerjen dhe arkivimin e bandës MRZ; si dhe
   b) asgjësimin e pjesës tjetër të pasaportës biometrike.

Neni 15

Hartimi i formularëve tip për aplikim në *e-Albania*

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, miraton formularët tip të parashikuar në nenin 2, pika 1 dhe nenin 11, pika 3, të këtij udhëzimi, si dhe kryen përditësimin periodik të tyre.

Neni 16


Dispozitat përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria "IdentiTek" sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ose struktura të tjera të autorizuara nga ministri i Brendshëm.

3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 289, datë 2.9.2020, "Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla



Kërkesat e fotografisë

Madhësia	Gjerësia 40mm, lartësia 50 mm
Rezolucioni (dpi)	600
Parametrat e imazhit	Lartësia e kokës (deri në majën e flokëve), 34 mm, lartësia nga lart e fotos në majën e flokëve 5 mm, pamja ballore, e ndriçuar
Ngjyra e sfondit	E bardhë, e ndriçuar
Formati i fotografisë	jpg, jpeg ose png
Elemente të tjera	Pa syze optike me ngjyrë dhe refleks, pa elemente të karakterit fetar që mbulon pjesën më të madhe të fytyrës, joaksesor që mbulojnë veshët dhe pjesën e qafës. Flokët të hedhur pas veshit, të rregullt, që të mos mbulojnë sytë dhe veshët.

Fletore zyrtare Nr. 91, datë publikimi 30.05.2024

VENDIM

Nr. 843, datë 26.12.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES, FUNKSIONEVE DHE PROCEDURËS SË KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NJOHJEN E NJË PAKICE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kërkesa për njohjen formale të një pakice kombëtare sipas pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", depozitohet nga grupi i shtetasve që përbëjnë mbi 1 % të numrit të përgjithshëm të shtetasve që kanë shtetësinë shqiptare në Republikën e Shqipërisë, të cilët pretendojnë se i përkasin një pakice. Kjo kërkesë paraqitet pranë Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme (në vijim referuar si "Komisioni").
2. Dokumentacioni për njohjen formale të një pakice kombëtare përbëhet nga:
   a) kërkesa e nënshkruar nga çdo pjesëtar i grupit që pretendon se i përket pakicës kombëtare që synohet të njihet;
   b) formulari individual i vetëdeklarimit për secilin nga shtetasit që kanë firmosur sipas shkronjës "a", për njohjen e statusit të pjesëtarit të pakicës kombëtare, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe ka në përbërje:
   a) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në ministrinë përgjegjëse për gjendjen civile;
   b) një përfaqësues nga ministri përgjegjës për pushtetin vendor;
   c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, përgjegjës për çështjet ligjore;

ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;
d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;
dh) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
e) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
ë) një përfaqësues nga Akademia e Shkencave;
f) një përfaqësues nga Instituti i Historisë, në Akademinë e Shkencave;
g) katër përfaqësues nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, ku njëri prej tyre është përfaqësues i pakicës kombëtare që kërkon të njihet, sipas rastit;
gj) tre përfaqësues nga shoqëria civile, të propozuar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, nga radhët e organizatave joqeveritare që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare.

4. Komisioni, për kryerjen e veprimtarisë së tij mbështetet nga sekretariati teknik, i cili është përgjegjës për organizimin e punës, të sigurojë komunikimin me paraqitësit e kërkesave, të koordinojë punën mes institucioneve përgjegjëse, si dhe për çdo detyrë tjetër të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Komisionit.
5. Sekretariati teknik kryesohet nga një nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe ka në përbërje katër anëtarë, si më poshtë vijon:
   a) Dy përfaqësues të caktuar nga titullari i ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme;
   b) Një përfaqësues i caktuar nga titullari i ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore;
   c) Një përfaqësues i caktuar nga titullari i Komitetit për Pakicat Kombëtare.
6. Përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, janë të nivelit të lartë drejtues.
7. Komisioni shqyrton kërkesën e paraqitur sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe verifikon plotësimin e kritereve ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe dokumentacionin e paraqitur sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7, të këtij ligji.

8. Komisioni shqyrton kërkesën e paraqitur sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda 9 (nëntë) muajve nga dita e pranimit nga ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme.
9. Për shqyrtimin e kërkesës, Komisioni bashkëpunon me të gjitha institucionet publike në nivel qendror, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", të ndryshuar.
10. Vendimi arsyetohet dhe i komunikohet grupit të shtetasve apo përfaqësuesit të autorizuar prej tyre, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Kundër vendimit të Komisionit për refuzimin e kërkesës për njohje të pakicës kombëtare mund të bëhet ankim pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.
11. Komisioni garanton transparencë në realizimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe programin e transparencës, duke i publikuar aktivitetet e tij në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme.
12. Në rastet kur Komisioni vendos pranimin e kërkesës, i dërgon ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme propozimin, shoqëruar me relacionin e argumentuar për vijimin e procedurave për njohjen formale të pakicës kombëtare.
13. Ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme harton projektligjin për njohjen formale të pakicës kombëtare dhe propozon projektvendimin përkatës pranë Këshillit të Ministrave, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e propozimit nga Komisioni.
14. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, ministritë dhe institucionet e parashikuara në pikën 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I
EDI RAMA

Fletore zyrtare nr. 225, datë publikimi 30.12.2024.

VENDIM

Nr. 845, datë 26.12.2024

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURAVE PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PËR IDENTIFIKIMIN E PERSONAVE QË U PËRKASIN PAKICAVE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbledhja e të dhënave për identifikimin e personave, që i përkasin pakicave kombëtare, kryhet në përputhje me të drejtën e tyre për vetidentifikim të lirë.
2. Personi, që pretendon se i përket një pakice kombëtare dhe kërkon të identifikohet si i tillë, paraqet formularin e vetidentifikimit, sipas aneksit 1, të këtij vendimi, pranë të njëjtit komision të ngritur në ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e një pakice kombëtare (në vijim komisioni). Në përbërjen e komisionit duhet të përfshihet gjithashtu një përfaqësues nga pakica kombëtare, pjesë e së cilës personi është vetidentifikuar, përveç rasteve kur kjo pakicë është e përfaqësuar në përbërjen e përhershme të komisionit.
3. Ky komision mblidhet të paktën 2 (dy) herë në vit dhe sa herë vlerësohet e nevojshme me kërkesë të 1/4 së anëtarëve të tij.
4. Komisioni pranon vetidentifikimin dhe pasqyron të dhënat në listën përkatëse për pakicat kombëtare, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i formularit të vetidentifikimit.
5. Në raste përjashtimore, bazuar në arsye, të cilat hedhin dyshime serioze për saktësinë e të dhënave të vetidentifikuara, mund të kërkohet verifikim i mëtejshëm i vetidentifikimit, me një shumicë prej 2/3 së anëtarëve të komisionit, në rastet kur:
   a) ka paraqitje të një numri të shtuar dhe të pazakontë vetidentifikimesh, brenda një periudhe gjashtëmujore;

   b) personi i vetidentifikuar banon në një njësi të vetëqeverisjes vendore, e cila, faktikisht, nuk shfaq karakteristika të dallueshme kulturore, etnike, gjuhësore, fetare apo karakteristika tradicionale,
   c) të evidentuara nga informacionet përkatëse, ndër të tjera, siç është mungesa e përfaqësimit kolektiv, përmes një mungese të qartë të pranisë aktive, të vazhdueshme dhe të konsoliduar të aktiviteteve të përfaqësimit kolektiv, përfshirë shoqatat e minoritetit kombëtar përkatës në njësinë e vetëqeverisjes vendore në fjalë etj;
   ç) ka ndryshime të gjenealiteteve të personit të vetidentifikuar, krahasuar me dokumente të mëparshme.
6. Komisioni mund të kërkojë, në rastet kur nis një procedurë verifikimi, informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me qëllim verifikimin e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 3, dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë".
7. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon kërkesën për verifikim zyrës përkatëse të arkivit të gjendjes civile të degës përkatëse të qarkut, duke u bazuar në të dhënat e vetidentifikimit të personit.
   8. Zyra e arkivit të gjendjes civile kryen verifikimet, nëse:
   a) personi rezulton i regjistruar në regjistrin përkatës të gjendjes civile, të administruar nga zyra e arkivës së gjendjes civile, ku janë evidentuar të dhëna lidhur me përkatësinë etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare;
   b) personi ka lindur nga të paktën një prind me përkatësi etnike joshqiptare dhe në aktin e lindjes së tij rezulton e evidentuar një përkatësi etnike tjetër;
   c) në aktin e lindjes së personit, përpara vitit 2011, ka qenë përcaktuar një përkatësi etnike, e ndryshme nga ajo shqiptare;
   ç) në dokumentet e arkivuara të gjendjes civile për periudhat e regjistrimeve të popullsisë për shtetasit që i përkasin një pakice etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare, ose për paralindësit e tyre, janë evidentuar të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare;

d) ka të dhëna plotësuese, që i referohen përkatësisë tjetër etnike, për elemente të gjendjes civile, që gjithashtu mund të rezultojnë në aktet e martesës dhe të vdekjes të administruara prej saj.

9. Zyra e arkivit të gjendjes civile i paraqet komisionit informacionin e mbledhur, lidhur me elementin e përkatësisë etnike. Komisioni rishikon dokumentacionin e mbledhur, sipas pikës 8, të këtij vendimi, duke i dhënë peshë vendimtare zgjedhjes subjektive të individit. Faktorë, si gjuha, feja, kultura ose traditat ofrojnë një bazë të mjaftueshme për qëllimin e vetidentifikimit. Dokumentacioni i marrë, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij vendimi, shërben si tregues, ndihmës në marrjen e mendimit nga ana e komisionit.
10. Komisioni, në rast të mosprovimit të vetidentifikimit, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij vendimi, u drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe institucioneve të tjera, nëse kanë dokumente zyrtare që mbështesin përkatësinë e shtetasit në një pakicë kombëtare.
11. Procedura e mbledhjes së të dhënave kryhet në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
12. Zyrat e arkivit të gjendjes civile në degët e qarkut lëshojnë të dhëna, që i referohen regjistrimit të shtetasve, sipas regjistrave themeltarë për periudhat e regjistrimit kur janë kryer. Përpunimi i këtij informacioni kryhet në bazë të konsultimit të të dhënave në regjistrat themeltarë, ku konfirmohen të dhënat e shtetasve me përkatësi etnike, të ndryshme nga ajo shqiptare. Personi i interesuar mund të paraqesë dokumentacione ose çdo material tjetër të nevojshëm në mbështetje të vetidentifikimit.
13. Komisioni, pasi shqyrton informacionin e marrë nga institucionet e lartpërmendura dhe nga personi për të cilin bëhet procedura e vetidentifikimit, vijon me marrjen e vendimit për konfirmimin ose jo të vetidentifikimit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e iniciimit të kryerjes së verifikimit, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij vendimi. Periudha e nisjes së këtij afati fillon nga data e njoftimit nga komisioni për palën e interesuar. Në rast se nuk merret një vendim brenda afatit të përcaktuar, vetidentifikimi konsiderohet i konfirmuar.
14. Vendimi i arsyetuar i komisionit i njoftohet menjëherë personit për të cilin është kryer procesi i verifikimit.

15. Në rastet kur personi kërkon të apelojë vendimin e komisionit, krijohet një komision apelimi.
16. Komisioni i apelit kryesohet nga përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe ka në përbërje:
    a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme;
    b) një përfaqësues nga Avokati i Popullit;
    c) një përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
    ç) një përfaqësues i emëruar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare;
    d) një përfaqësues nga një organizatë e shoqërisë civile, i angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me pakicat kombëtare, të propozuar nga Komiteti i Minoriteteve Kombëtare.
17. Kundër vendimit të komisionit të apelimit, personi ka të drejtë të paraqesë ankim pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.
18. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, komisioni, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektët e qarqeve, zyrat e arkivit të gjendjes civile në degën e qarkut dhe institucionet e tjera shtetërore, që administrojnë dokumente, të dhëna zyrtare në lidhje me përkatësinë e shtetasve shqiptarë në një pakicë kombëtare, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare", me përjashtim të shkronjës "a", të pikës 5, e cila hyn në fuqi pas dy vjetësh nga botimi i këtij vendimi dhe nuk ka efekt prapaveprues për vetidentifikimet e paraqitura deri në përfundim të afatit.

K R Y E M I N I S T R I
EDI RAMA

Fletore zyrtare nr. 225, datë publikimi 30.12.2024

LIGJ

Nr. 9062, datë 8.5.2003

KODI I FAMILJES

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2015, datë 5.12.2015)

Në mbështetje të neneve 53, 54, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

Neni 2

Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 3

Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

Neni 4

Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesa.

Neni 5

Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

Neni 6

Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohet, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij.

Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim tepër të motivuar.

I mituri mund të dëgjohet vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij.

Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale.

PJESA E DYTË BASHKËSHORTËT

TITULLI I
MARTESA

KREU I
KUSHTET THELBËSORE PËR LIDHJEN E MARTESËS

Neni 7

Mosha e lidhjes së martesës

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe.

Neni 8

Pëlqimi i bashkëshortëve

Martesa lidhet para nëpunësit të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm.

Neni 9

Ndalimi për lidhjen e martesës

Nuk mund të lidhë martesë të re personi që është martuar, derisa martesa e mëparshme nuk është shpallur e pavlefshme ose nuk është zgjidhur.

Neni 10

Nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungji dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave.

Gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave.

Neni 11

Nuk mund të lidhin martesë midis tyre vjehrri dhe nusja, vjehrra dhe dhëndri, njerku dhe thjeshtra, njerka dhe thjeshtri, pavarësisht se martesa që ka krijuar këtë lidhje është shpallur e pavlefshme, ka pushuar ose është zgjidhur.

Neni 12

Nuk mund të lidhë martesë personi që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës.

Neni 13

Ndalohet martesa midis kujdestarit dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria.

Neni 14

Ndalohet martesa midis birësuesit e të birësuarit dhe pasardhësve të tyre, të birësuarit dhe bashkëshortit të birësuesit, midis birësuesit e bashkëshortit të të birësuarit, midis të birësuarve, si dhe midis të birësuarit dhe fëmijëve të birësuesit.

Me birësimin nuk zhduket shkaku që ndalon martesën midis të birësuarit dhe gjinisë së tij të parashikuar nga neni 10 i këtij Kodi.

KREU II

FORMA E LIDHJES SË MARTESËS

Neni 15

Shpallja e martesës

Përpara lidhjes së martesës, nëpunësi i gjendjes civile bën shpalljen e saj, duke afishuar në vende të caktuara nga bashkia ose komuna aktin, ku tregohet identiteti, profesioni, vendbanimi dhe vendqëndrimi i bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe vendi ku do të lidhet martesa.

Neni 16

Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme.

Shpallja bëhet në bashkinë ose komunën e vendit ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

Nëse nuk kanë jetuar 6 muaj në vendbanimin ose vendqëndrimin aktual, shpallja duhet të bëhet edhe në bashkinë ose komunën ku bashkëshorti ka jetuar më parë.

Neni 17

Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes.

Në qoftë se shpallja ndërpritet përpara mbarimit të këtij afati, ky fakt duhet të përmendet në shpalljen e re.

Neni 18

Në qoftë se lidhja e martesës nuk është bërë brenda 1 viti nga shpallja, martesa nuk mund të lidhet pa u bërë shpallja e re e parashikuar në dispozitat për shpalljen e martesës.

Neni 19

Personi që kërkon shpalljen duhet t'i paraqesë nëpunësit të gjendjes civile certifikatat e lindjes së të dy bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe çdo dokument tjetër që është i nevojshëm dhe provon se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës.

Neni 20

Kundërshtimet e lidhjes së martesës

Prindërit dhe, në mungesë të tyre, paraardhësit e tjerë dhe të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallë të tretë, mund të kundërshtojnë lidhjen e martesës së të afërmve të tyre për çdo shkak që vjen në kundërshtim me kushtet e parashikuara në këtë Kod për lidhjen e martesës.

E drejta e kundërshtimit i takon edhe bashkëshortit të personit që do të lidhë një martesë tjetër, si dhe kujdestarit, nëse njëri prej bashkëshortëve është vënë në kujdestari.

E drejta e kundërshtimit të martesës i takon edhe prokurorit për shkaqet që parashikohen në ligj, për të cilat ai mund të kërkojë pavlefshmërinë e saj.

Neni 21

Kundërshtimi i lidhjes së martesës bëhet para nëpunësit të gjendjes civile ku do të lidhet martesa, i cili është i detyruar të bëjë shënimet përkatëse në regjistrin e martesave.

Nëpunësi i gjendjes civile është i detyruar që të bëjë shënimin e heqjes së kundërshtimit në regjistrin e martesave kur:

a) vlerëson se kundërshtimi nuk është bërë në përputhje me dispozitat e këtij Kodi;
b) për këtë ka një vendim gjyqësor;
c) hiqet dorë nga kundërshtimi.

Heqja dorë nga kundërshtimi nuk pengon nëpunësin e gjendjes civile të refuzojë lidhjen e martesës për shkaqet e parashikuara në këtë Kod.

Neni 22

Akti i kundërshtimit duhet të përmbajë cilësinë që i jep të drejtën kundërshtuesit të bëjë kundërshtimin, vendin ku martesa duhet të lidhet, shkaqet e kundërshtimit dhe dispozitën ligjore ku mbështetet ai.

Neni 23

Kur nëpunësi i gjendjes civile vlerëson se kundërshtimi është bërë në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, pezullon procedurën e lidhjes së martesës derisa gjykata të vendosë refuzimin e kundërshtimit ose të hiqet dorë prej tij.

Kundër vendimit të pezullimit, bashkëshortët e ardhshëm kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të pezullimit.

Neni 24

Akti i kundërshtimit të lidhjes së martesës nuk ka efekt pas kalimit të 1 viti nga data e regjistrimit të kundërshtimit.

Neni 25

Gjykata kompetente, me kërkesë të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, vendos për heqjen ose jo të kundërshtimit të bërë për lidhjen e martesës.

Neni 26

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë mund të ankimohet në gjykatën e apelit, e cila duhet të vendosë brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit të çështjes.

Neni 27

Në qoftë se kundërshtimi nuk pranohet, kundërshtuesit, me përjashtim të paraardhësve, mund të detyrohen me dëmshpërblim, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

Neni 28

Lidhja e martesës

Martesa lidhet publikisht përpara nëpunësit të gjendjes civile, të cilit i është bërë kërkesa për shpallje.

Neni 29

Me kërkesë të prokurorit të vendit ku lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm, gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të vendosë që martesa të lidhet edhe pa u shpallur.

Neni 30

Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës, nëpunësi i gjendjes civile, pasi bindet për identitetin e bashkëshortëve të ardhshëm, në bazë të akteve dhe të thënieve të dëshmitarëve, si dhe të vetë bashkëshortëve

të ardhshëm, në prani të dy dëshmitarëve, u lexon bashkëshortëve të ardhshëm nenet e këtij Kodi që përmbajnë të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, merr nga secili bashkëshort deklarimin se ata duan të lidhin martesë dhe, pasi merr pëlqimin e tyre, i shpall në emër të ligjit të martuar.
Akti i martesës hartohet menjëherë, nënshkruhet nga bashkëshortët, dëshmitarët dhe nëpunësi i gjendjes civile dhe regjistrohet në regjistrin e martesave.

Neni 31
Në qoftë se njëri nga bashkëshortët, për shkak të sëmundjes ose për ndonjë pengesë tjetër të justifikuar përpara nëpunësit të gjendjes civile, është në pamundësi për të shkuar në zyrën e gjendjes civile të komunës ose bashkisë, atëherë nëpunësi i gjendjes civile shkon në vendin ku ndodhet bashkëshorti që ka pengesë dhe lidh martesën, sipas procedurës së parashikuar në nenin 30 të këtij Kodi.

Neni 32
Refuzimi i lidhjes së martesës
Nëpunësi i gjendjes civile mund të refuzojë lidhjen e martesës vetëm për shkaqe të parashikuara në këtë Kod. Në këtë rast ai mund të lëshojë një akt ku të tregohen shkaqet e refuzimit.
Kundër aktit të refuzimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

KREU III
PAVLEFSHMËRIA E MARTESËS

Neni 33
Shkaqet e pavlefshmërisë
Martesa që është lidhur pa pëlqimin e lirë dhe pa vese të të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre është e pavlefshme.

Neni 34
Martesa e lidhur në lajthim për personin e bashkëshortit shpallet e pavlefshme.

Ka lajthim për personin, kur njëri nga bashkëshortët lidh martesë me një person që nuk është ai me të cilin dëshiron të martohet.
Shpallet e pavlefshme martesa e lidhur në lajthim për cilësitë thelbësore të bashkëshortit, të cilat po t'i dinte bashkëshorti tjetër, nuk do të lidhte martesën.

Neni 35
Martesa e lidhur nga një person që vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose ka zhvillim mendor të metë, që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës, është e pavlefshme.

Neni 36
Martesa e lidhur nga bashkëshortët pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua është e pavlefshme.

Neni 37
Martesa e lidhur në kushtet kur njëri nga bashkëshortët gjendet nën ndikimin e një kanosjeje, pa të cilën nuk do të lidhej martesa, shpallet e pavlefshme.

Neni 38
Kërkesa për pavlefshmërinë e martesës, në rastet e parashikuara në nenet 34 dhe 37 të këtij Kodi, parashkruhet kur ka pasur një bashkëjetesë të vazhdueshme për 6 muaj që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë ose nga çasti që gjendja e kanosjes ka mbaruar dhe ai ka marrë dijeni për lajthimin.

Neni 39
Martesa e lidhur nga personi që nuk ka mbushur moshën e parashikuar në këtë Kod është e pavlefshme.
Një martesë e tillë nuk shpallet e pavlefshme kur personi ka arritur moshën e kërkuar, ose kur gruaja ka lindur fëmijë ose ka mbetur shtatzënë.

Neni 40
Martesa e lidhur midis personave që përmenden në nenet 9, 10, 11, 13 dhe 14 të këtij Kodi është e pavlefshme.

Gjykata nuk shpall të pavlefshme martesën e lidhur midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave, kur çmon se ka shkaqe me rëndësi.

Neni 41

Martesa e lidhur gjatë vazhdimit të një martese të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve është e pavlefshme.

Kur gjatë gjykimit për pavlefshmërinë e martesës, bashkëshortët pretendojnë se martesa e mëparshme ka qenë e pavlefshme ose e zgjidhur, gjykohet më parë vlefshmëria ose ekzistenca e martesës së mëparshme dhe, në qoftë se kjo martesë shpallet e pavlefshme, martesa e dytë mbetet e vlefshme.

Martesa e dytë, e lidhur gjatë vazhdimit të martesës së mëparshme të njërit prej bashkëshortëve, nuk shpallet e pavlefshme, në qoftë se në këtë kohë zgjidhet martesa e mëparshme.

Neni 42

Martesa që nuk është lidhur publikisht dhe përpara nëpunësit të gjendjes civile është e pavlefshme.

Kërkesa mund të bëhet nga bashkëshortët, nga prindërit e tyre, nga të paralindurit dhe nga të gjithë ata që kanë një interes të drejtpërdrejtë, si dhe nga prokurori.

Neni 43

Bashkëshorti, në dëm të të cilit është lidhur një martesë e dytë, mund të kërkojë pavlefshmërinë e kësaj martese.

Në qoftë se bashkëshortët nga martesa e dytë pretendojnë pavlefshmërinë e martesës së parë, pavlefshmëria e martesës së parë do të gjykohet paraprakisht.

Neni 44

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur pa pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre e kanë të dy bashkëshortët ose bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk ka qenë i lirë.

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës së lidhur me kanosje ose me lajthim e ka vetëm bashkëshorti që ka qenë i kanosur ose në lajthim.

E drejta e padisë parashkruhet, në qoftë se nga data që ka pushuar kanosja, që është zbuluar lajthimi ose bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë në rast të martesës pa pëlqim të lirë, kanë kaluar 6 muaj, por në çdo rast jo më tepër se 3 vjet nga lidhja e martesës.

E drejta e padisë, në rastet kur ka pasur një bashkëjetesë të vazhdueshme për 6 muaj që nga çasti që bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë ose nga çasti që ai ka marrë dijeni për lajthimin, parashkruhet me kalimin e këtij afati.

Neni 45

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës për shkaqet e parashikuara në nenet 36, 39, 40 dhe 41 të këtij Kodi e kanë secili nga bashkëshortët, prokurori dhe kushdo tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës.

E drejta e padisë për pavlefshmërinë e martesës nuk parashkruhet, përveç rasteve të parashikuara në nenet 44 dhe 46 të këtij Kodi.

Neni 46

Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës, për shkaqet e parashikuara në nenin 35, pas shërimit të bashkëshortit të sëmurë, e ka secili nga bashkëshortët.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 6 muajve nga shërimi i bashkëshortit.

Neni 47

Kur bashkëshortit i është hequr zotësia për të vepruar, padia për pavlefshmërinë e martesës mund të ngrihet nga kujdestari i tij.

Neni 48

E drejta e padisë për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës nuk u kalon trashëgimtarëve, përveçse kur gjykimi ka filluar përpara vdekjes së bashkëshortit.

E drejta e trashëgimtarëve kufizohet vetëm për rastet që prekin rendin publik dhe jo për raste që kanë të bëjnë thjesht me mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortëve, si lajthimi e kërcënimi.

Neni 49
Pasojat e pavlefshmërisë
Martesa që shpallet e pavlefshme me vendim të formës së prerë konsiderohet se nuk është lidhur.
Për bashkëshortin që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës, pasojat fillojnë nga data që vendimi merr formë të prerë.
Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme, quhen si të lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen si në rastet kur zgjidhet martesa.

TITULLI II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET QË LINDIN NGA MARTESA

KREU I
TË DREJTAT DHE DETYRIMET RECIPROKE TË BASHKËSHORTËVE

Neni 50
Detyrimi për besnikëri, ndihmë dhe bashkëpunim
Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime.
Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës.

Neni 51
Mbiemri i bashkëshortit
Bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet.
Mbiemri regjistrohet në regjistrin e martesave.

Neni 52
Mbiemri i fëmijëve
Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Kur prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që do të vendosin prindërit me marrëveshje. Kur marrëveshja nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit.

Neni 53
Detyrimi ndaj fëmijëve
Martesa vendos mbi të dy bashkëshortët detyrimin për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e fëmijëve.

Neni 54
Kontributi i bashkëshortëve
Në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesa nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre.

Neni 55
Vendbanimi i bashkëshortëve
Bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët.
Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët.
Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës, e cila, pasi dëgjon mendimet e të dy bashkëshortëve dhe, nëse është rasti, edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mundohet të arrijë një zgjidhje me mirëkuptim.
Kur kjo nuk është e mundur, gjykata vendos zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për kërkesat e familjes.

Neni 56
Largimi nga vendbanimi
E drejta për ndihmë morale dhe materiale e parashikuar në këtë Kod ndërpritet kundrejt bashkëshortit, që është larguar pa shkak nga vendbanimi familjar dhe refuzon të kthehet.
Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga martesa, gjykata, sipas rrethanave, mund të urdhërojë sekuestrimin e të mirave të bashkëshortit të larguar, në masën e duhur.

Neni 57
Pëlqimi i bashkëshortit
Bashkëshortët nuk mund të disponojnë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e tjetrit, cilido qoftë regjimi pasuror martesor.

Bashkëshorti që nuk ka dhënë pëlqimin për veprimin juridik të kryer nga tjetri, lidhur me banesën bashkëshortore, mund të kërkojë anulimin e tij brenda 1 viti nga data kur ai ka marrë njoftim për këtë veprim juridik, por jo më tepër se 1 vit nga data që regjimi pasuror martesor ka marrë fund.

Neni 58
Autorizimi i gjykatës
Çdo bashkëshort mund të autorizohet nga gjykata për të kryer një veprim juridik, për të cilin bashkëpunimi ose pëlqimi i bashkëshortit tjetër do të ishte i nevojshëm, në qoftë se ky i fundit nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose në qoftë se refuzimi i tij vjen në kundërshtim me interesin e familjes.
Veprimi juridik i kryer si më sipër, mund të kundërshtohet nga bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk është marrë, për të mos e ngarkuar atë me asnjë detyrim.

Neni 59
Autorizimi i përfaqësimit
Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, bashkëshorti tjetër mund ta përfaqësojë në të gjitha veprimet juridike ose në veprime juridike të caktuara që lidhen me regjimin pasuror martesor. Kushtet dhe gjerësia e përfaqësimit përcaktohen në autorizimin e dhënë nga gjykata.

Neni 60
Veprime pa pëlqimin e bashkëshortit
Secili nga bashkëshortët mund të kryejë vetë, pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, veprimet juridike që kanë të bëjnë me mbajtjen e familjes ose me edukimin e fëmijëve. Për detyrimet e marra përsipër nga njëri bashkëshort, detyrohet solidarisht edhe bashkëshorti tjetër.
Përgjegjësia solidare nuk ka vend për shpenzimet haptazi të tepërta, duke pasur parasysh mënyrën e jetesës në familje, dobishmërinë e veprimit të kryer, si dhe mirëbesimin ose keqbesimin e personave të tretë kontraktues.

Neni 61
Masat urgjente
Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes, gjykata, me kërkesën e bashkëshortit tjetër, mund të përcaktojë të gjitha masat urgjente që lidhen me ta.
Zgjatja e masave të parashikuara në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar dhe në asnjë rast të mos i kalojë 3 vjet.

Neni 62
Masat kundër dhunës
Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore.

Neni 63
Disponimi i të ardhurave
Secili nga bashkëshortët mund të ushtrojë lirisht një profesion, të disponojë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit pasuror martesor përkatës, pasi të ketë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa.

Neni 64
Administrimi i sendeve vetjake
Secili nga bashkëshortët ka të drejtën e administrimit dhe të tjetërsimit lirisht të sendeve të tij vetjake, pa qenë nevoja e pëlqimit të bashkëshortit tjetër.

Neni 65
Përparësia e detyrimeve që rrjedhin nga martesa
Zbatimi i dispozitave të këtij kreu rrjedh nga martesa dhe zbatohet pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve.

TITULLI III
REGJIMET PASURORE MARTESORE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 66
Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve
Regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës.

Neni 67
Të drejta të pashmangshme
Bashkëshortët nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesa, si dhe përgjegjësisë prindërore dhe rregullave të administrimit ligjor dhe të kujdestarisë.

Neni 68
Përfaqësimi i bashkëshortit
Secili nga bashkëshortët mund t'i japë të drejtën bashkëshortit tjetër për ta përfaqësuar gjatë regjimit pasuror martesor, sipas dispozitave të Kodit Civil.
Mandati i përfaqësimit mund të revokohet në çdo kohë.

Neni 69
Forma e Kontratës
Kontrata martesore bëhet me akt noterial, në prani dhe me pëlqimin e njëkohshëm të dy bashkëshortëve të ardhshëm ose të përfaqësuesve të tyre.
Në çastin e nënshkrimit të kontratës, noteri i lëshon palëve një akt noterial, i cili përmban identitetin e plotë, adresën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe datën e lidhjes së kontratës.
Noteri ka detyrimin të depozitojë kopje të kontratës në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës.

Në qoftë se në aktin e martesës tregohet se bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.

Neni 70
Në rastin e martesës së të miturit, sipas nenit 7 paragrafi i dytë, zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore derisa të mbushë moshën 18 vjeç, çast pas të cilit mund të kërkohet ndryshimi i regjimit ligjor të pasurisë.

Neni 71
Në qoftë se një nga bashkëshortët ushtron veprimtari tregtare, ndryshimet në kontratën e martesës lidhur me veprimtarinë tregtare duhet të depozitohen, në çdo rast, edhe në regjistrin tregtar.
Efektet për personat e tretë fillojnë nga çasti i depozitimit të ndryshimit, parashikuar në paragrafin e parë.

Neni 72
Bashkëshortët mund të bien dakord, në interes të familjes, për ta ndryshuar pjesërisht ose tërësisht regjimin pasuror martesor vetëm pas kalimit të 2 vjetëve të zbatimit të tij.
Ndryshimet, në këtë rast, duhet të bëhen në të njëjtën formë që kërkohet për kontratën fillestare të martesës.
Ndryshimi i regjimit pasuror martesor ka efekt kundrejt të tretëve, 3 muaj pasi ndryshimi të jetë depozituar në regjistrin ku është pasqyruar akti i martesës. Në mungesë të këtij shënimi, ndryshimi nuk kundërshtohet nga të tretët, në qoftë se në aktet e bëra midis tyre, bashkëshortët kanë deklaruar se kanë ndryshuar regjimin pasuror martesor.

KREU II
REGJIMI PASUROR MARTESOR NË BASHKËSI

Neni 73
Bashkësia ligjore
Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor.

Neni 74

Përbërja e bashkësisë

Bashkësia përbëhet nga:

a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës;
b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.

Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit.

Neni 75

Pasuria e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare

Pasuria e krijuar gjatë martesës, e caktuar për administrimin e veprimtarisë tregtare të njërit prej bashkëshortëve dhe shtesat e prodhimit të saj janë objekt i bashkëpronësisë vetëm nëse ekzistojnë si të tilla në çastin e mbarimit të martesës.

Neni 76

Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.

Neni 77

Pasuria vetjake

Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:

a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;
b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë;
c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesorë të pasurisë vetjake;

ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare;
d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;
dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura;
e) shkëmbimi i tyre, kur kjo është deklaruar shprehimisht në aktin e blerjes.

Neni 78

Bashkësia mund të përfitojë kompensim, pas mbarimit të saj, për të ardhurat dhe pasuritë që bashkëshorti ka neglizhuar të marrë ose për ato që ai ka shpenzuar në keqbesim.

Kërkesa për kompensim duhet të paraqitet nga bashkëshorti i interesuar para mbarimit të procedurës të ndarjes së pasurisë.

Neni 79

E drejta e kompensimit

Pasuria e fituar në shkëmbim të një pasurie, e cila i përkiste individualisht njërit prej bashkëshortëve, është pasuri vetjake, me përjashtim të kompensimit që i bëhet bashkësisë ose e kundërta, kur nga shkëmbimi rezulton të ketë diferenca.

Nëse diferenca në ngarkim të bashkësisë është më e madhe se vlera e pasurisë vetjake të tjetërsuar, pasuria e fituar në këtë shkëmbim i përket bashkësisë, përveç kompensimit në favor të pasurisë vetjake të bashkëshortit.

Neni 80

Të ardhurat e përfituara, si pasojë e një ankandi ose forme tjetër, të një pasurie të paluajtshme, ku njëri nga bashkëshortët është bashkëpronar në pjesë të pandarë, nuk përbën pasuri të fituar gjatë martesës, me përjashtim të kompensimit që duhet t'i bëhet bashkësisë për shpenzimin që ajo ka bërë.

Neni 81

Detyrimet mbi bashkësinë

Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi:

a) për të gjitha barrët dhe detyrimet që rëndojnë mbi ta në çastin e fitimit të pronësisë;
b) për të gjitha shpenzimet e administrimit të pasurisë së përbashkët;
c) për të gjitha shpenzimet për mbajtjen e familjes dhe për çdo detyrim të kontraktuar nga bashkëshortët, qoftë dhe veçmas, që është në interes të familjes;
ç) për çdo detyrim tjetër kontraktues ose jokontraktues, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara si vetjake në këtë Kod.

Neni 82

Detyrimet që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës ose që rëndojnë trashëgimitë dhe dhurimet që fitojnë gjatë martesës mbeten detyrime vetjake.

Neni 83

Kreditorët e bashkëshortit, në rastin e nenit 82, mund t'i kërkojnë pagesat e tyre fillimisht mbi pasurinë vetjake dhe të ardhurat e bashkëshortit debitor. Ata mund të kërkojnë dhe vënien sekuestro mbi pasurinë e bashkësisë, atëherë kur pasuritë e luajtshme që i përkasin debitorit të tyre datën e lidhjes së martesës ose që i fitojnë me trashëgimi ose me dhurim janë përzier me pasurinë në bashkësi dhe nuk mund të identifikohen, sipas këtij Kodi.

Neni 84

Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi deri në gjysmën e vlerës së saj, kundrejt kreditorëve vetjakë të çdo bashkëshorti, kur pasuria vetjake e tij nuk mjafton për përmbushjen e:

a) detyrimeve që ai ka marrë përsipër vetëm për administrimin e pasurisë në bashkësi, jashtë kufijve të tagrave të tij të administrimit;
b) detyrimeve të tij vetjake, cilido qoftë çasti i lindjes së tyre.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet, nëse ka pasur mashtrim nga bashkëshorti debitor dhe keqbesim nga kreditori.

Neni 85

Në rast se detyrimi vetjak i njërit bashkëshort është shlyer nga bashkësia, ai detyrohet të bëjë kompensimin e bashkësisë.

Neni 86

Të ardhurat vetjake të një bashkëshorti nuk mund të preken nga kreditorët e bashkëshortit tjetër, vetëm nëse detyrimi ka qenë i kontraktuar për mirëmbajtjen e banesës dhe të familjes, sipas nenit 81 të këtij Kodi.

Neni 87

Detyrimet e kontraktuara veçmas nga bashkëshortët

Në rastin kur detyrimi është kontraktuar në interesin vetjak të njërit prej bashkëshortëve dhe ai është shlyer nga pasuria në bashkësi, bashkëshorti përfitues detyrohet të bëjë kompensimin e bashkësisë.

Neni 88

Në rast se nga pasuria në bashkësi janë paguar gjoba ose dëmshpërblime, për të cilat është detyruar njëri prej bashkëshortëve për shkak të një dënimi penal ose administrativ, ai detyrohet të kompensojë pasurinë në bashkësi.

Bashkësia ka të drejtën për kompensim nëse detyrimi që bashkësia ka shlyer ishte kontraktuar nga njëri prej bashkëshortëve në kundërshtim me detyrimet që i imponon martesa.

Neni 89

Detyrimet solidare të bashkëshortëve me pasurinë në bashkësi

Kur një detyrim vjen në bashkësi për shkak të njërit bashkëshort, ai nuk mund të kërkohet mbi pasuritë vetjake të bashkëshortit tjetër. Nëse ka detyrime solidare të të dy bashkëshortëve, ai mund të kërkohet mbi pasurinë në bashkësi.

Neni 90

Administrimi i bashkësisë

Secili bashkëshort ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë në bashkësi.

Secili bashkëshort është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër përpara organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të

bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi.
Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve.

Neni 91
Administrimi nga një bashkëshort
Në rast largësie ose pengese tjetër të njërit bashkëshort dhe në mungesë të prokurës ose autorizimit të gjykatës, bashkëshorti tjetër mund të kryejë veprimet që janë të nevojshme edhe në rastin kur kërkohet pëlqimi i të dy bashkëshortëve, sipas nenit 90 të këtij Kodi.

Neni 92
Refuzimi i pëlqimit
Nëse njëri prej bashkëshortëve refuzon të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi të administrimit të jashtëzakonshëm ose për veprime të tjera, për të cilat kërkohet pëlqimi, bashkëshorti tjetër mund t'i drejtohet gjykatës për të marrë autorizimin.
Gjykata vendos dhënien e autorizimit kur kryerja e veprimit është e nevojshme për interesa të familjes ose të veprimtarisë tregtare që bën pjesë në bashkësi.

Neni 93
Zëvendësimi në administrim
Nëse njëri nga bashkëshortët, për një kohë të vazhdueshme, ndodhet jashtë gjendjes për të shprehur vullnetin e tij, ose nëse administrimi i bashkësisë nga ana e tij dëshmon për paaftësi ose keqbesim, bashkëshorti tjetër mund t'i kërkojë gjykatës të zëvendësojë atë në ushtrimin e të drejtave të tij.
Bashkëshorti i privuar nga të drejtat e administrimit të bashkësisë mund t'i kërkojë gjykatës rikthimin e tyre, nëse provon se janë zhdukur shkaqet e përjashtimit të tij nga administrimi.

Neni 94
Tejkalimi i të drejtave
Nëse njëri nga bashkëshortët tejkalon të drejtat e tij mbi pasurinë në bashkësi, mund të kërkohet nga bashkëshorti tjetër anulimi i veprimit, nëse më vonë ai nuk ka dhënë pëlqimin për këtë veprim.

Kjo padi mund të ngrihet brenda 1 viti nga data e marrjes dijeni për veprimin dhe, në çdo rast, jo më vonë se 1 vit nga mbarimi i bashkësisë.

Neni 95
Administrimi i pasurisë vetjake të bashkëshortit
Secili bashkëshort ka të drejtë të administrojë dhe të disponojë lirisht pasuritë vetjake.
Nëse gjatë martesës njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij vetjake, zbatohen rregullat e përfaqësimit.
Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë vetjake të tjetrit, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një akt përfaqësimi në heshtje, që mbulon veprimet e administrimit dhe të përdorimit, me përjashtim të tagrit të disponimit. Në këtë rast, ai përgjigjet kundrejt bashkëshortit tjetër me cilësinë e përfaqësuesit dhe, nëse është rasti, detyrohet të dorëzojë vetëm frytet që ekzistojnë, duke mos u përgjigjur për ato që janë konsumuar.
Nëse njëri nga bashkëshortët, me gjithë kundërshtimin e tjetrit, administron pasurinë e tij vetjake dhe kryen veprime lidhur me të, përgjigjet për dëmin e shkaktuar dhe për frytet që duhet të ishin marrë. Në këtë rast, bashkëshorti i dëmtuar ka të drejtë të ngrejë padi për anulimin e veprimit të kryer, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 94 të këtij Kodi.

Neni 96
Mbarimi i bashkësisë
Bashkësia mbaron me:
a) vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, shpalljen i zhdukur ose i vdekur të njërit prej tyre, shpalljen të pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës;
b) pjesëtimin e pasurive;
c) ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjell mbarimin e bashkësisë.

Neni 97
Ndalimi i pjesëtimit
Pjesëtimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një marrëveshjeje të bashkëshortëve.

Neni 98

Pjesëtimi i pasurisë

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi mund të kërkohet në gjykatë në rast paaftësie dhe administrimit të keq të njërit prej bashkëshortëve, kur mënyra e administrimit të pasurisë prej tij vë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes, ose kur njëri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë dhe kur ka ndodhur një pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi.

Ndarja e pasurisë mund të kërkohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga përfaqësuesi i tij ligjor. Kreditorët e njërit bashkëshort nuk mund të kërkojnë vetë ndarjen e pasurisë.

Vendimi i gjykatës për ndarjen ka fuqi që nga data kur është paraqitur kërkesa dhe i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive martesore të ndara, të parashikuar në këtë Kod.

Neni 99

Kur procedura për pjesëtimin e pasurisë ka filluar, kreditorët mund të kërkojnë të njihen me kërkesën dhe dokumentet e paraqitura nga bashkëshortët, si dhe të ndërhyjnë në seancën gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Neni 100

Depozitimi

Kërkesa dhe vendimi i ndarjes së pasurisë duhet të depozitohen pranë zyrës së gjendjes civile dhe, nëse është rasti, edhe në regjistrin tregtar.

Vendimi shënohet në regjistrin e gjendjes civile, si dhe në origjinalin e kontratës së martesës.

Neni 101

Kompensimet

Secili nga bashkëshortët duhet të kompensojë shumat e marra nga pasuria në bashkësi, që janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ai i përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në nenin 81 të këtij Kodi.

Neni 102

Kompensimet dhe kthimet realizohen në çastin e mbarimit të bashkësisë. Gjykata mund të autorizojë dhe të urdhërojë për ato në çdo çast nëse e kërkon dhe e lejon interesi i familjes.

Neni 103

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi

Pjesëtimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivit dhe pasivit të saj.

Pasi të jenë zbritur nga bashkësia detyrimet që ajo ka ndaj bashkëshortëve ose të tretëve, pasuria që mbetet ndahet në pjesë të barabarta midis bashkëshortëve.

Gjykata, në bazë të nevojave të fëmijëve dhe nga fakti se kujt do t'i besohen ata, mund të vendosë në favor të një bashkëshorti kalimin e një pjese të pasurisë së bashkësisë që i takon bashkëshortit tjetër.

Neni 104

Kur kompensimi bëhet në dobi të njërit bashkëshort, ky i fundit merr nga pasuria e bashkësisë një shumë të barabartë me vlerën që bashkësia i detyrohet atij. Në qoftë se aktivi i pasurisë së bashkësisë është i pamjaftueshëm, bashkëshorti tjetër është i detyruar për diferencën.

Në rastet kur aktivi i pasurisë nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e bashkësisë ndaj të tretëve, kreditorët kanë të drejtë t'i drejtohen secilit prej bashkëshortëve, të cilët përgjigjen solidarisht. Bashkëshorti që ka shlyer detyrimin e bashkësisë si më sipër, ka të drejtën e regresit ndaj bashkëshortit tjetër për pjesën e detyrimit të shlyer për llogari të tij.

Neni 105

Në fillim të procedurës së pjesëtimit të pasurisë në bashkësi, bashkëshortët ose trashëgimtarët e tyre kanë të drejtë të marrin pasurinë e luajtshme vetjake, që u përkiste para bashkësisë ose që ata e kanë fituar gjatë bashkësisë në formë trashëgimie ose dhurimi. Në mungesë të provave të kundërta prezumohet se pasuria e luajtshme bën pjesë në bashkësi.

Neni 106

Marrja e vlerës në rast të mungesës së pasurisë së luajtshme

Nëse pasuria e luajtshme nuk ekziston në natyrë, bashkëshorti ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të marrin vlerën e saj duke zbritur amortizimin e tij nga përdorimi në bashkësi, me kusht që mungesa e pasurisë të ketë ardhur për shkak të konsumit për përdorim, për shkak të shkatërrimit ose humbjes së saj ose për çdo shkak që nuk mund t'i kundërvihet bashkëshortit tjetër.

Neni 107
Pjesëtimi i pasurisë së bashkëshortëve bëhet sipas këtij Kodi, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile.

KREU III
BASHKËSIA ME KONTRATË

Neni 108
Bashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të ndryshojnë bashkësinë ligjore me marrëveshje, e cila nuk duhet të vijë në kundërshtim me nenet 66 dhe 67 të këtij Kodi.
Bashkëshortët mund të bien dakord që:

a) bashkësia të përfshijë pasuritë e luajtshme para martesës dhe fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës;
b) të ndryshohen rregullat lidhur me administrimin;
c) të kenë pjesë jo të barabarta;
ç) të ketë ndërmjet tyre bashkësi universale.

Rregullat e bashkësisë ligjore mbeten të zbatueshme për të gjitha pikat që nuk janë bërë objekt i kontratës së martesës ndërmjet palëve.

Neni 109
Kur bashkëshortët bien dakord që të ketë ndërmjet tyre bashkësi, sipas nenit 108 shkronja "a", pasuria në bashkësi përbëhet nga pasuria në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore, nga pasuria e luajtshme para martesës dhe fitimet nga pasuritë vetjake gjatë martesës.
Mbetet pasuri vetjake dhe nuk mund të përfshihet në bashkësi pasuria e luajtshme e parashikuar në shkronjat "c", "ç", "d" të nenit 77 të këtij Kodi.

Neni 110
Bashkëshortët, për detyrimet e tyre para martesës, përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi deri në kufirin e vlerës së pasurisë së tyre, e cila, në bazë të kontratës së lidhur, sipas këtij Kodi, është pjesë përbërëse e bashkësisë.

Neni 111
Administrimi i përbashkët
Bashkëshortët mund të bien dakord që ta administrojnë së bashku bashkësinë. Në këtë rast, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë së bashkësisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të dy bashkëshortëve dhe përmbajnë detyrimin solidar të tyre.

Neni 112
Pjesët jo të barabarta
ashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të bien dakord të caktojnë pjesë jo të barabarta për pasurinë në bashkësi, ndryshe nga bashkësia ligjore.

Neni 113
Në rastet kur bashkëshortët, në kontratën e martesës, kanë përcaktuar pjesë jo të barabarta në bashkësi, ata ose trashëgimtarët e tyre i përballojnë detyrimet në raport me pasurinë që kanë në bashkësi ose që kanë përfituar nga bashkësia.
Çdo klauzolë e kontratës është e pavlefshme nëse detyron bashkëshortin me pjesë të kufizuar ose trashëgimtarët e tij të përballojnë një detyrim më të madh se pjesa e tyre në bashkësi ose të përjashtohen nga përballimi i detyrimit të tyre në raport me këtë pjesë.

Neni 114
Bashkësia universale
Bashkëshortët mund të vendosin në kontratën e martesës një bashkësi universale të pasurisë së tyre, të luajtshme dhe të paluajtshme, që ekziston dhe që do të vihet në të ardhmen, me përjashtim të pasurisë vetjake të parashikuar në shkronjat "c", "ç" dhe "d" të nenit 77 të këtij Kodi.
Bashkësia universale përballon të gjitha detyrimet e bashkëshortëve, që ekzistojnë në çastin e lidhjes së kontratës dhe gjatë martesës.

KREU IV
REGJIMI I PASURIVE TË NDARA

Neni 115
Kur bashkëshortët kanë përcaktuar në kontratën e martesës regjimin e pasurive të ndara, secili prej tyre ruan të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij.
Secili prej bashkëshortëve përballon vetë detyrimet që i kanë lindur atij, para ose gjatë martesës, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 70 të këtij Kodi.

Neni 116
Detyrimet që rrjedhin nga martesa
Bashkëshortët kontribuojnë në detyrimet që rrjedhin nga martesa, sipas përcaktimit të kushteve në kontratën e martesës.
Në rast se kontrata e martesës nuk përmban asgjë lidhur me detyrimet që rrjedhin nga martesa, bashkëshortët kontribuojnë sipas nenit 54 të këtij Kodi.

Neni 117
Administrimi i pasurisë
Në rast se gjatë martesës, njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij, zbatohen rregullat e përfaqësimit.
Bashkëshorti përfaqësues nuk është i detyruar të japë llogari për kthimin e fryteve, nëse prokura nuk e detyron shprehimisht për një gjë të tillë.

Neni 118
Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë e bashkëshortit tjetër, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një mandat të heshtur, i cili mbulon veprimet lidhur me administrimin, por jo ato të disponimit.
Në këtë rast, bashkëshorti përfaqësues përgjigjet ndaj bashkëshortit tjetër vetëm për frytet që ekzistojnë dhe nuk përgjigjet për ato që janë konsumuar.
Nëse njëri nga bashkëshortët, me gjithë kundërshtimin e tjetrit, administron pasurinë e këtij të fundit ose kryen veprime lidhur me këtë pasuri, ai përgjigjet për dëmin dhe për frytet që duhet të ishin marrë.

Neni 119
Pasuria e luajtshme që posedohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga të dy bashkëshortët prezumohet, në lidhje me kreditorët e secilit prej tyre, se i përket bashkëshortit debitor. Ky prezumim nuk është i vlefshëm në rast të ndërprerjes së jetesës së përbashkët.
Pasuria e luajtshme që posedohet nga të dy bashkëshortët prezumohet, në lidhje me njëri- tjetrin, se i përket të dy bashkëshortëve në pjesë të barabarta.
Pasuria e luajtshme, e paracaktuar për përdorim vetjak nga njëri prej bashkëshortëve, prezumohet se i përket këtij të fundit.

Neni 120
Me mbarimin e martesës për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort, pjesëtimi i pasurisë ndërmjet bashkëshortëve me regjime pasurish të ndara, për sa i përket formës, ruajtjes së pandarë të sendit të papjesëtueshëm, radhës së preferencave, shitjes në ankand të sendeve të papjesëtueshme, efekteve të ndarjes, garancisë dhe diferencave, i nënshtrohet rregullave të trashëgimisë për ndarjen midis trashëgimtarëve. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe pas zgjidhjes së martesës, me përjashtim të radhës së preferencave. Mund të vendoset që diferenca e mundshme të paguhet me para në dorë.

Neni 121
Nëse martesa mbaron ose shpallet e pavlefshme dhe pasuria e njërit prej bashkëshortëve është shtuar nga lidhja e martesës, bashkëshorti tjetër, në rastin kur ai ka kontribuar në një mënyrë ose në një tjetër për këtë shtim, ka të drejtën të kërkojë kthimin e pjesës së shtuar nga kontributi i tij.

Neni 122
E drejta e parashikuar në nenin 121 i kalon trashëgimtarëve të bashkëshortit të vdekur, vetëm nëse njihet në kontratë ose për shkak të vazhdimit të një gjykimi të filluar.
Kjo e drejtë parashkruhet me kalimin e 2 vjetëve nga mbarimi ose shpallja e pavlefshme e martesës.

TITULLI IV
MBARIMI I MARTESËS

KREU I
RASTET E MBARIMIT TË MARTESËS

Neni 123
Martesa mbaron me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës së tyre.

Neni 124
Kur bashkëshorti që është shpallur i vdekur del se është gjallë, martesa e mbaruar me shpalljen e vdekjes bëhet përsëri e vlefshme, përveçse kur bashkëshorti tjetër ka lidhur martesë të re.

KREU II
RASTET E ZGJIDHJES SË MARTESËS

Neni 125
Pëlqimi reciprok i bashkëshortëve
Kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën, edhe një projektmarrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.
Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre respektivë.

Neni 126
Gjykata shqyrton kërkesën, dëgjon fillimisht veçmas secilin nga bashkëshortët, më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre dhe në fund thërret përfaqësuesit e bashkëshortëve, në qoftë se ata kanë të tillë.

Neni 127
Gjykata vendos zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e

tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.
Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore.

Neni 128
Refuzimi i miratimit
Në rast se gjykata konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve, pezullon gjykimin për 3 muaj dhe u kërkon bashkëshortëve të bëjnë rregullimet e duhura në marrëveshje.
Në qoftë se edhe pas afatit të parashikuar në paragrafin e parë nuk janë bërë rregullimet e duhura, gjykata refuzon miratimin dhe rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve.

Neni 129
Zgjidhja e martesës për ndërprerje të jetesës së përbashkët
Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.
Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër.

Neni 130
Gjykata mund të rrëzojë padinë për zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, kur bashkëshorti tjetër provon se zgjidhja e martesës do të ketë pasoja veçanërisht të rënda morale dhe materiale për fëmijët ose bashkëshortin tjetër. Padia mund të ringrihet për të njëjtat shkaqe nëse ekzistojnë rrethana të reja.

Neni 131

Ndërprerja e jetesës së përbashkët mund të paraqitet si shkak për zgjidhjen e martesës vetëm nga bashkëshorti që ka paraqitur kërkesëpadinë.

Bashkëshorti i paditur ka të drejtë të paraqesë kundërpadi. Në këtë rast, gjykata mund të rrëzojë padinë dhe të pranojë kundërpadinë, duke zgjidhur martesën.

Neni 132

Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort

Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.

Neni 133

Gjykata vendos për fajësinë, në zgjidhjen e martesës, vetëm kur kjo kërkohet prej njërit ose të dy bashkëshortëve.

Neni 134

Përpjekjet për pajtim

Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seancë pajtimi, në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët.

Gjyqtari mund t'i dëgjojë ata veçmas secilin dhe më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre.

Kur arrihet pajtimi, mbahet procesverbal dhe gjykimi pushohet për këtë shkak.

Neni 135

Në rast se në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Kur nuk paraqitet i padituri, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari shtyn seancën e pajtimit, duke i përsëritur njoftimin të padituri. Nëse edhe në këtë seancë i padituri nuk paraqitet pa ndonjë shkak të

arsyeshëm, gjyqtari, pasi dëgjon paditësin dhe krijon bindje se pajtimi i bashkëshortëve nuk mund të arrihet, cakton seancën gjyqësore, duke urdhëruar thirrjen e provave të nevojshme.

Neni 136

Gjykata mund të shtyjë shpalljen e vendimit deri në 1 vit, kur nuk ka krijuar bindje se përjashtohet çdo mundësi pajtimi e bashkëshortëve.

Neni 137

Pezullimi i gjykimit me kërkesën e gruas shtatzënë

Kur gruaja është shtatzënë, me kërkesën e saj, gjykata mund të pezullojë gjykimin e padisë së zgjidhjes së martesës, por jo më tepër se 1 vit nga çasti i lindjes së fëmijës.

Neni 138

Bashkimi i kërkimeve të tjera

Në kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës mund të kërkohet edhe detyrimi i bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, shpenzimet për jetesë të bashkëshortit nevojtar, në rastet e parashikuara në këtë Kod, si dhe likuidimin e regjimit pasuror martesor përkatës.

Gjykata veçon likuidimin e regjimit pasuror martesor në rast se vështirësohet shqyrtimi i çështjes, sipas kërkesave të paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 139

Marrja e masave të përkohshme

Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të marrë masa të përkohshme për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, për detyrimin për ushqim të bashkëshortit, kur shihet e arsyeshme, për sigurimin e banimit, si dhe administrimin dhe përdorimin e pasurisë së vënë gjatë martesës, nëse është rasti.

Vendimi për marrjen e një mase të përkohshme ka fuqi derisa të jepet vendimi përfundimtar, por ai mund të ndryshohet ose të shfuqizohet nga gjykata, kur çmon se kanë ndryshuar rrethanat ose kur vendimi është marrë mbi të dhëna jo të sakta.

Neni 140
Të drejtat e trashëgimtarëve
E drejta e padisë për zgjidhjen e martesës nuk u kalon trashëgimtarëve. Në rast se gjykimi ka filluar më parë, gjykata ndërpret procesin dhe pushon gjykimin.
Në këtë rast, bashkëshorti pasjetues gëzon të drejtën për të trashëguar bashkëshortin e vdekur.

Neni 141
E drejta e ngritjes së padisë nga kujdestari
Kur bashkëshortit i është hequr zotësia për të vepruar ose për arsye të tjera është vënë në kujdestari, padia për zgjidhjen e martesës mund të ngrihet nga kujdestari i tij.
Në rast se bashkëshorti, ndaj të cilit është bërë kërkesëpadi, është në kujdestari, në gjykimin e zgjidhjes së martesës përfaqësohet nga kujdestari i tij.
Në rastin kur bashkëshorti i pazotë për të vepruar ndodhet në kujdestarinë e bashkëshortit tjetër, gjykata i cakton atij një kujdestar të posaçëm, për ta përfaqësuar në procedurën e zgjidhjes së martesës.

Neni 142
Në rastin e burgimit të bashkëshortit, e drejta e ngritjes së padisë për zgjidhjen e martesës mund të ushtrohet nga kujdestari ose përfaqësuesi ligjor, vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e bashkëshortit që vuan dënimin me burgim.

Neni 143
Dërgimi i vendimit në zyrën e gjendjes civile
Pasi të ketë marrë formë të prerë, vendimi për zgjidhjen e martesës i dërgohet nga gjykata për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Neni 144
Efektet e vendimit të zgjidhjes së martesës

Vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës i fillon efektet e tij nga data që merr formë të prerë.
Vendimi i gjykatës për zgjidhjen e martesës i fillon efektet e tij për të tretët

nga data e regjistrimit të tij në zyrën e gjendjes civile, sipas legjislacionit përkatës.

KREU III
PASOJAT E ZGJIDHJES SË MARTESËS

Neni 145
Pasojat për ish-bashkëshortët
Në rast se ish-bashkëshortët që kanë zgjidhur martesën dëshirojnë ta rilidhin atë, duhet të zbatojnë të gjitha procedurat e nevojshme për lidhjen e një martese të re.

Neni 146
Përdorimi i mbiemrit
Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës.
Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.

Neni 147
Kontributi kompensues
Gjykata mund të detyrojë njërin nga ish-bashkëshortët të derdhë për llogari të tjetrit një kontribut të destinuar për të kompensuar sa të jetë e mundur pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim.
Gjykata përcakton nëse kontributi mund të jepet i menjëhershëm ose periodik dhe mënyrën e pagimit të tij.

Neni 148
Kontributi kompensues caktohet sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues dhe burimeve të tjetrit, duke marrë në konsideratë gjendjen në çastin e zgjidhjes së martesës dhe kohëzgjatjen e saj në një të ardhme të parashikueshme.

Kohëzgjatja e dhënies së kontributit kompensues caktohet nga gjykata, sipas nevojave të ish- bashkëshortit përfitues.
Nëse ish-bashkëshorti përfitues lidh martesë të re, kontributi kompensues ndërpritet.

Neni 149
Në përcaktimin e nevojave dhe të burimeve, gjykata merr në konsideratë:
a) moshën dhe gjendjen shëndetësore të ish-bashkëshortëve;
b) kohën e shpenzuar dhe atë që i duhet të shpenzojnë për edukimin e fëmijëve;
c) kualifikimin e tyre profesional;
ç) predispozitën e tyre për punë të reja;
d) të drejtat që ata gëzojnë dhe ato që parashikohen për të ardhmen;
dh) pasurinë e tyre, si kapital ose si e ardhur, pas likuidimit të regjimit pasuror martesor.

Neni 150
Ndryshimi i kontributit kompensues mund të kërkohet në gjykatë vetëm në rast se vazhdimi i njëjtë i tij sjell pasoja tepër të rënda për njërin nga ish-bashkëshortët.

Neni 151
Në rastin e kërkesës së përbashkët, ish-bashkëshortët caktojnë shumën dhe mënyrën e dhënies së kontributit kompensues me marrëveshje, e cila i paraqitet gjyqtarit për miratim.
Gjyqtari mund të refuzojë miratimin e marrëveshjes, nëse konstaton se të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve janë caktuar në mënyrë të padrejtë.

Neni 152
Marrëveshja e miratuar nga gjykata mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje të re, të miratuar nga gjykata, kur rrethanat kanë ndryshuar ose kur ato e imponojnë një gjë të tillë.
Bashkëshortët, në rast ndryshimi të papritur të burimeve dhe nevojave të tyre, mund t'i kërkojnë gjykatës të rishikojë kontributin kompensues.

Neni 153
E drejta e përdorimit të banesës
Në rast se banesa familjare është në pronësi të njërit ish-bashkëshort dhe bashkëshorti tjetër nuk ka në pronësi banesë tjetër të përshtatshme në vendbanimin e tyre, gjykata mund të lejojë përdorimin nga ish-bashkëshorti jopronar të banesës kur:
a) fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim këtij të fundit, derisa ata të arrijnë moshën madhore;
b) zgjidhja e martesës bëhet nga ish-bashkëshorti pronar për ndërprerje prej tij të jetesës së përbashkët. Në këtë rast e drejta e përdorimit të banesës është deri në 7 vjet, por në rast se ish-bashkëshorti jopronar rimartohet, e humbet këtë të drejtë;
c) kur ish-bashkëshorti jopronar ka instaluar në banesën e ish-bashkëshortit pronar një kabinet profesional me vlerë të madhe, lëvizja e të cilit do të kërkonte shpenzime të mëdha. Në këtë rast e drejta e përdorimit është deri në 3 vjet.
Në këto raste gjykata përcakton afatin e përdorimit dhe masën e qirasë që detyrohet të paguajë ish-bashkëshorti jopronar në përputhje me të ardhurat e tij.
Në çdo rast gjykata mund të zgjidhë kontratën e qirasë, në qoftë se kjo justifikohet nga rrethana të reja.

Neni 154
Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët
Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Kod.

Neni 155
Para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish- bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija.
Në rast se gjykata arrin në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t'i

besohet një personi të tretë ose një familjeje kujdestare, duhet të marrë mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi.

Neni 156
Gjykata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose për t'i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njërës prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurorit, në rast se ka shkaqe të rënda që janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore.

Neni 157
Gjyqtari, në këtë rast, merr në konsideratë:

a) marrëveshjen e bërë ndërmjet ish-bashkëshortëve;
b) mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij;
c) mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën.

Neni 158
Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. Ai kontribuon në raport me burimet e tij dhe ato të prindit tjetër.
E drejta e vizitës dhe e banimit, sipas kushteve të përcaktuara nga gjykata, nuk mund t'i refuzohen, veçse për arsye të rënda që dëmtojnë interesat e fëmijës.

Neni 159
Vendimi lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mund të ndryshohet në çdo çast nga gjykata, me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, një të afërmi ose të prokurorit.

Neni 160
Në rast të zgjidhjes së martesës me kërkesë të përbashkët, kushtet e marrëveshjes së miratuar nga gjyqtari, lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, mund të rishqyrtohen për shkaqe me rëndësi dhe sipas kërkesës së njërit prej ish-bashkëshortëve ose të prokurorit.

Neni 161
Në vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet dhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën dhe për ish-bashkëshortin, nëse është rasti, sipas parashikimeve të kreut "Detyrimi për ushqim" të këtij Kodi.

Neni 162
Çdonjëri prej ish-bashkëshortëve është i detyruar t'i japë tjetrit të dhëna të sakta për pasurinë dhe të ardhurat e tij, kur ato janë të nevojshme për të caktuar detyrimin për ushqim. Me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, punëdhënësi, organet financiare përkatëse, zyrat e tatimeve dhe çdo organ tjetër ku mund të merren prova, janë të detyruar të japin gjithë informacionin e nevojshëm për gjendjen pasurore të ish-bashkëshortit tjetër dhe për të gjitha të ardhurat e tjera të tij.

TITULLI V
BASHKËJETESA

Neni 163
Kuptimi i bashkëjetesës
Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Neni 164
Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.

PJESA E TRETË
FËMIJËT

TITULLI I
AMËSIA DHE ATËSIA

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 165
Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesa provohen nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Neni 166
Nuk mund të ngrihet padi për vërtetimin e amësisë ose atësisë për një fëmijë që nuk ka lindur i
gjallë.

Neni 167
Nga njohja e amësisë ose e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese nuk mund të hiqet dorë.

Neni 168
Në rastin e ngatërrimit ose zëvendësimit të fëmijës, në çdo rast, edhe kur bëhet në mënyrë të pavullnetshme, mund të kërkohet me padi njohjeje ose kundërshtimi një identitet i ndryshëm i fëmijës, nëse konstatimi është bërë përpara ose pas marrjes së aktit të lindjes.

Neni 169
Në mungesë të aktit të lindjes ose në qoftë se fëmija është regjistruar me emër të rremë, ose pa treguar emrin e nënës dhe të atit, amësia dhe atësia mund të vërtetohen me vendim gjyqësor.

Neni 170
Njohja e amësisë dhe atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese
Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martese mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon të drejta dhe detyrime të njëjta, në mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesa.

Neni 171
Mbiemri i fëmijës së lindur jashtë martese
Fëmija i lindur jashtë martese merr mbiemrin e prindit, amësia ose atësia e të cilit është vendosur më përpara. Në qoftë se amësia dhe atësia vendosen në të njëjtën kohë, prindërit vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë fëmija. Në rast mosmarrëveshjeje, fëmijës i vendoset mbiemri i të atit.

Neni 172
Njohja e një fëmije nuk mund të pasohet nga një njohje tjetër, e ndryshme nga e para, në rast se kjo e fundit nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore.

Neni 173
Kundërshtimi i njohjes
Njohja mund të kundërshtohet nga të gjithë personat që kanë një interes të ligjshëm dhe që kanë dijeni se njohja e bërë është e pavërtetë. Kundërshtimi mund të bëhet edhe nga personi që ka bërë njohjen, kur ajo është bërë në kushtet e mashtrimit ose kanosjes.
Të drejtën e kundërshtimit të njohjes e ka edhe prokurori, në rast se, nga të dhënat që figurojnë në aktet e gjendjes civile, rezulton pavërtetësia e amësisë dhe atësisë së deklaruar.

Neni 174
Efektet e vendimit
Vendimi i gjykatës që përcakton amësinë ose atësinë ka efekt që nga lindja e fëmijës.

KREU II

Neni 175
Amësia
Amësia e fëmijës vërtetohet me aktin e lindjes.

Neni 176
Njohja e amësisë
Kur fëmija është regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur, nëna mund ta njohë fëmijën. Njohjen e fëmijës mund ta bëjë edhe vetë nëna e mitur.
Njohja mund të bëhet para nëpunësit të gjendjes civile ose me testament. Njohja e bërë nuk mund të revokohet edhe sikur të jetë bërë me testament.

Neni 177
Fëmija i regjistruar në aktin e lindjes me prindër të panjohur mund të kërkojë nga gjykata vërtetimin e amësisë.
E drejta e padisë për vërtetimin e amësisë nuk u kalon trashëgimtarëve të fëmijës, por gjykimi i filluar që më parë mund të vazhdojë nga trashëgimtarët.
Padia për vërtetimin e amësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të gruas që kërkohet të vërtetohet se është nëna.
E drejta e padisë për vërtetimin e amësisë nuk parashkruhet gjatë gjithë kohës që fëmija jeton.

Neni 178
Kundërshtimi i amësisë
Amësia e treguar në aktin e lindjes mund të kundërshtohet nga gruaja e regjistruar si nënë e fëmijës ose nga gruaja që kërkon të njihet si nënë ose nga fëmija kur bëhet madhor.
E drejta e padisë nuk u kalon trashëgimtarëve, por gjykimi i filluar mund të vazhdojë prej tyre. Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të gruas së regjistruar si nënë.
E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.

Neni 179
Kundërshtimi i njohjes së amësisë
Njohja e amësisë mund të kundërshtohet në gjykatë nga gruaja që kërkon të njihet si nënë, nga fëmija kur bëhet madhor ose nga prokurori.
E drejta e padisë nuk u kalon trashëgimtarëve, por gjykimi i filluar më parë mund të vazhdojë nga trashëgimtarët e paditësit.
Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të nënës që ka njohur fëmijën. E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet.

KREU III
ATËSIA

Neni 180
Fëmija që ka lindur gjatë martesës prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës.
Fëmija që ka lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës ose nga shpallja e pavlefshmërisë së martesës prezumohet se ka për atë ish-bashkëshortin e nënës.
Kur fëmija ka lindur gjatë vazhdimit të martesës së dytë të nënës, prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës me martesë të dytë, edhe sikur fëmija të ketë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj.

Neni 181
Njohja e atësisë
Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njeh fëmijën si të tij.
Njohja e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës, të cilën e lajmëron nëpunësi i gjendjes civile. Kur nëna e kundërshton këtë njohje ose nuk përgjigjet brenda 1 muaji nga marrja e lajmërimit, burri që ka njohur fëmijën si të tij mund të ngrejë padi para gjykatës kompetente për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës.
E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga data e marrjes së lajmërimit nga nëpunësi i gjendjes civile, për mospranimin nga ana e nënës.

Neni 182

Ati që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç mund të njohë në çdo kohë fëmijën e tij të lindur jashtë martese para nëpunësit të gjendjes civile ose me testament.

Njohja e bërë nga i ati ka efekt vetëm ndaj tij, në rastin kur nuk tregohet emri i nënës dhe kur ajo nuk ka dhënë pëlqimin për njohjen e fëmijës.

Njohja e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese nuk mund të revokohet edhe sikur të jetë bërë me testament.

Neni 183

Padia për vërtetimin e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese mund të ngrihet nga nëna e fëmijës edhe kur ajo është e mitur ose nga kujdestari i saj, me pëlqimin e gjykatës.

E drejta e padisë së nënës parashkruhet me kalimin e 3 vjetëve nga lindja e fëmijës. Padia për vërtetimin e atësisë mund të ngrihet edhe nga vetë fëmija madhor.

E drejta e padisë nuk parashkruhet.

Padia për vërtetimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të atij që kërkohet të vërtetohet se ishte i ati i fëmijës.

Neni 184

Kundërshtimi i atësisë së prezumuar

Burri, që sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet se është atë i një fëmije, mund të kundërshtojë atësinë e këtij fëmije.

Padia për kundërshtimin e atësisë ngrihet kundër fëmijës, i cili përfaqësohet nga nëna. Kur nëna është në pamundësi dhe fëmija është i mitur, i caktohet një kujdestar i posaçëm nga gjykata.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti, nga data që burri ka marrë dijeni për lindjen e fëmijës.

Neni 185

Nëna mund të kundërshtojë që të jetë i ati i fëmijës së saj burri që, sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet i ati i këtij fëmije.

Padia për kundërshtimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit. E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e një 1 viti nga lindja e fëmijës.

Neni 186

Fëmija, kur bëhet madhor, mund të kundërshtojë që të jetë i ati i tij bashkëshorti i nënës. Padia për kundërshtimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të të atit. E drejta e padisë nuk parashkruhet.

Neni 187

Kundërshtimi i njohjes së atësisë

Fëmija, kur bëhet madhor, mund të kundërshtojë që të jetë i ati i tij burri që e ka njohur.

Padia për kundërshtimin e atësisë mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit që ka bërë njohjen.

E drejta e padisë nuk parashkruhet.

Neni 188

Burri që e quan veten si i ati i fëmijës së lindur jashtë martese, mund të kundërshtojë që një burrë tjetër, i cili e ka njohur fëmijën, të jetë i ati i tij.

Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit që ka njohur fëmijën si të tij.

E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga regjistrimi i atësisë në regjistrin e gjendjes civile.

Neni 189

Vërtetimi i atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese

Atësia e një fëmije të lindur jashtë martese mund të vërtetohet me vendim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë, ose nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martese, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të tijin.

Neni 190

Kur ka shkaqe të përligjura, gjykata mund të zgjasë afatet e mësipërme të parashkrimit, me kërkesën e personit të interesuar.

Neni 191

E drejta e padisë, e parashikuar në nenet 184, 185, 186, 187 dhe 188 të këtij Kodi, nuk u kalon trashëgimtarëve të paditësit, por gjykimi i filluar më parë mund të vazhdojë nga trashëgimtarët e tij.

Në rast se fëmija është zënë kur mungonte bashkëshorti i nënës dhe ky ka vdekur pa u plotësuar afati brenda të cilit mund të ngrihet padia për kundërshtimin e atësisë, të paralindurit ose të paslindurit e tij mund ta ngrenë padinë brenda 6 muajve nga data e vdekjes së tij.

TITULLI II
DETYRIMI PËR USHQIM

KREU I
PERSONAT E DETYRUAR

Neni 192

Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës:

a) bashkëshorti ndaj bashkëshortit tjetër dhe fëmijët ndaj prindërve të tyre;
b) prindërit ndaj fëmijëve të tyre;
c) të paslindurit ndaj të paralindurve të tyre, që nuk janë prindër, sipas radhës më të afërt;
ç) të paralindurit ndaj të paslindurve të tyre, që nuk janë fëmijë të tyre, sipas radhës më të afërt;
d) vëllezërit dhe motrat ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre, sipas radhës më të afërt;

Neni 193

Detyrimi i përfituesit të dhurimit

Përfituesi i dhurimit, në preferencë kundrejt çdo të detyruari tjetër, detyrohet t'i japë dhuruesit detyrimin për ushqim, përveçse kur bëhet fjalë për dhurim të bërë lidhur me një martesë ose për një dhurim me kusht.

Neni 194

Detyrimi midis njerkut, njerkës dhe thjeshtërve të tyre

Kanë detyrim për ushqim edhe njerku e njerka ndaj thjeshtërve të tyre të mitur, përveç rasteve kur këta kanë persona të tjerë që kanë detyrimin për ushqim ndaj tyre dhe janë në gjendje ta japin këtë detyrim.

Thjeshtërit kanë detyrimin për ushqim për njerkun dhe njerkën e tyre, kur këta ia kanë dhënë për një kohë të gjatë këtë detyrim dhe janë kujdesur për ta në mituri, jo më pak se 10 vjet. në këtë rast thjeshtërit ngarkohen me dhënien e detyrimit për ushqim njëlloj si ndaj prindërve të tyre.

Neni 195

Detyrimi për ushqim pushon në qoftë se martesa ndërmjet prindit dhe njerkës ose njerkut është zgjidhur.

Neni 196

Pamundësia e dhënies së detyrimit për ushqim

Kur personat e ngarkuar për dhënien e detyrimit për ushqim nuk janë në gjendje që ta japin këtë tërësisht ose pjesërisht, ky detyrim u kalon tërësisht ose pjesërisht personave që janë në radhë të mëpasme.

Prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t'u jetë hequr përgjegjësia prindërore.

Neni 197

Detyrimi për ushqim ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij.

Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç.

Neni 198

Detyrimi për ushqim lind vetëm kur personi që kërkon këtë detyrim është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Neni 199

Detyrimi ndërmjet bashkëshortëve

Bashkëshorti që është i paaftë për punë dhe pa mjete të mjaftueshme për të jetuar, ka të drejtë të kërkojë detyrimin për ushqim nga bashkëshorti tjetër.

Detyrimi për ushqim kërkohet në të njëjtën kohë me padinë për zgjidhjen e martesës.

Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe brenda 6 muajve, nga data që vendimi për zgjidhjen e martesës ka marrë formë të prerë, me kusht që paaftësia dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme për të jetuar të kenë ekzistuar gjatë martesës.

Neni 200

Mbarimi i detyrimit ndërmjet bashkëshortëve

Detyrimi për ushqim, sipas nenit 199 të këtij Kodi, caktohet për një kohë jo më të gjatë se 6 vjet pas zgjidhjes së martesës.

Ky detyrim pushon para këtij afati, kur bashkëshorti, që e gëzonte këtë të drejtë, lidh martesë të re ose bëhet i aftë për punë, ose siguron mjete të mjafueshme për të jetuar, ose kur gjykata, duke marrë parasysh rrethanat, çmon se nuk është i denjë për të përfituar nga kjo e drejtë.

Neni 201

Kufijtë e detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim mund të kërkohet vetëm nga ai që është nevojtar dhe nuk është në gjendje të sigurojë nevojat e domosdoshme të tij.

Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Ai nuk duhet të kapërcejë atë që është e nevojshme për jetën e personit që përfiton detyrimin për ushqim, duke pasur parasysh rrethanat e jetës së tij.

Neni 202

Në rastin e dhurimit, përfituesi i tij nuk mund të detyrohet më shumë sesa vlera e pasurisë së dhuruar që ekziston në pasurinë e tij.

Neni 203

Kufijtë e detyrimit midis vëllezërve dhe motrave

Detyrimi për ushqim midis vëllezërve dhe motrave kufizohet vetëm në nevojat e domosdoshme.

Këtu mund të përfshihen edhe shpenzimet e edukimit dhe arsimimit, kur bëhet fjalë për vëllezërit dhe motrat e mitura.

Neni 204

Konkurrimi i të detyruarve

Nëse për dhënien e detyrimit për ushqim ka shumë të detyruar të së njëjtës shkallë, të gjithë janë të detyruar solidarisht në dhënien e këtij detyrimi, secili në raport me mundësitë e tij ekonomike.

Nëse personat e thirrur në një shkallë të mëparshme nuk janë në gjendje që ta përballojnë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për ushqim, ky u kalon plotësisht ose pjesërisht personave të thirrur në një shkallë të mëpasme.

Neni 205

Nëse personat e detyruar nuk bien dakord për kufijtë e detyrimit për ushqim, për shpërndarjen dhe mënyrën e dhënies së tij, sipas rrethanave konkrete, vendos gjykata.

Neni 206

Konkurrimi i personave që marrin detyrimin për ushqim

Kur disa persona marrin detyrimin për ushqim nga i njëjti person i detyruar dhe kur ky i fundit nuk është në gjendje të përballojë nevojat e secilit prej tyre, gjykata vendos detyrimin për ushqim, duke marrë parasysh shkallën e afërsisë dhe nevojat që ka secili prej personave që merr këtë detyrim.

Neni 207

Heqja, pakësimi ose shtimi i detyrimit për ushqim

Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë, kur rrethanat në bazë të të cilave është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë.

Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë.

Nëse pas përcaktimit të detyrimit për ushqim konstatohet se një nga personat e detyruar në shkallë të mëparshme është në gjendje që ta japë atë, gjykata vendos zëvendësimin këtij detyrimi.

Në këtë rast, personi i detyruar në shkallën e mëpasme nuk çlirohet nga ky detyrim, pa u caktuar detyrimi për ushqim ndaj personit në shkallën e mëparshme.

Neni 208

Pagimi i shpenzimeve

Cilido që ka bërë shpenzime për ushqimin e një personi, pa qenë i detyruar, ka të drejtë të kërkojë me padi kthimin e asaj që ka paguar nga ai që ka qenë i detyruar për ushqim, në qoftë se shpenzimet e bëra kanë qenë të nevojshme.

Neni 209

Mënyra e përmbushjes së detyrimit për ushqim

Personi që ka detyrimin për ushqim ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht, ose duke e mbajtur në shtëpinë e tij atë që merr detyrimin për ushqim.

Gjykata, sipas rrethanave, përcakton mënyrën e dhënies së detyrimit për ushqim.

Në rast nevoje urgjente, gjykata vendos detyrimin për ushqim në ngarkim të njërit prej personave të detyruar. Në këtë rast, personi i detyruar ruan të drejtën e padisë së regresit ndaj personave të tjerë.

Neni 210

Fillimi i detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim fillon nga data e ngritjes së padisë.

Pakësimi ose heqja e detyrimit për ushqim, të caktuar me vendim të formës së prerë dhe të paekzekutuar, fillon nga data kur kanë ndryshuar rrethanat, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, kurse shtimi i tij fillon nga data e ngritjes së padisë.

Neni 211

Kur një vendim, që përmban një detyrim për ushqim, vihet në ekzekutim pas 6 muajve nga data që ka marrë formë të prerë, detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për 6 muajt e fundit.

Neni 212

Pushimi i detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim pushon me vdekjen e personit të detyruar, personit që e përfiton atë, edhe sikur ky detyrim, që përmbahet në një vendim të formës së prerë, të mos jetë ekzekutuar.

Ndalimi i kompensimit dhe i zëvendësimit të detyrimit për ushqim.

Neni 213

Ndalimi i kompensimit dhe i zëvendësimit të detyrimit për ushqim

E drejta për të kërkuar detyrimin për ushqim nuk mund t'i kalojë një personi tjetër.

Personi që ka detyrimin për ushqim nuk mund të kërkojë që ky detyrim të shlyhet me një kredi që ka ndaj personit që e përfiton atë, edhe sikur të ketë detyrime të prapambetura për ushqim.

Neni 214

Heqja dorë

Heqja dorë nga e drejta për të marrë detyrimin për ushqim për kohën e ardhshme është e pavlefshme.

TITULLI III
PËRGJEGJËSIA\PRINDËRORE

KREU I
KUPTIMI I PËRGJEGJËSISË PRINDËRORE

Neni 215

Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.

Neni 216

Kufijtë e përgjegjësisë prindërore

Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në arritjen e moshës madhore.

Neni 217
Detyrimi reciprok
Prindërit dhe fëmijët reciprokisht duhet të ndihmojnë, të duan dhe të respektojnë njëri-tjetrin.

Neni 218
Kthimi i fëmijës
Prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë.
Gjykata, për rrethana të rënda, mund të mos vendosë kthimin, në qoftë se ky vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës. Gjykata merr edhe mendimin e fëmijës kur ka mbushur moshën dhjetë vjeç.

Neni 219
Marrëdhëniet e fëmijës me gjyshërit
Prindërit nuk mund të ndalojnë fëmijën të ketë marrëdhënie vetjake me gjyshërit e tij, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë shkaqe të rënda. Në rast mosmarrëveshjeje midis palëve, gjykata mund të vendosë për mënyrën e rregullimit të këtyre marrëdhënieve.

KREU II
USHTRIMI I PËRGJEGJËSISË PRINDËRORE

Neni 220
Ushtrimi i përbashkët i përgjegjësisë prindërore
Përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijën e lindur gjatë martesës së tyre ose jashtë martese, nëse është njohur nga të dy prindërit.

Neni 221
Në qoftë se prindërit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës, ata mund t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos pasi është përpjekur ta zgjidhë çështjen me pajtim.

Neni 222
Kur njëri nga prindërit kryen një veprim të zakonshëm me të tretët, që lidhet me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ai prezumohet se ka marrë edhe pëlqimin e prindit tjetër.

Neni 223
Humbja e përgjegjësisë prindërore
Prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpunëtorë për një vepër penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkëpunëtorë në një vepër penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj.

Neni 224
Pamundësia e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore
Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtari të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes.
Në këtë rast merret mendimi i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë.

Neni 225
Në qoftë se njëri nga prindërit është para pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose kur njëri nga prindërit ka vdekur, përgjegjësia prindërore ushtrohet nga prindi tjetër.

Neni 226
Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës
Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë zgjidhur martesën, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore bëhet sipas Kreut III "Pasojat e zgjidhjes së martesës" të këtij Kodi.

Neni 227

Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës së lindur jashtë martese

Përgjegjësia prindërore ndaj fëmijës së lindur jashtë martese ushtrohet nga prindi që e ka njohur fëmijën si të tij. Në qoftë se ai është njohur nga të dy prindërit, përgjegjësinë prindërore e kanë të dy prindërit.

Me kërkesë të të atit, të nënës ose të prokurorit, gjykata mund të ndryshojë kushtet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe të vendosë që ai të ushtrohet nga njëri prind ose nga të dy bashkërisht. Gjykata në këtë rast vendos se me cilin prind do të banojë fëmija.

Gjykata vendos për të drejtën e vizitës dhe të mbikëqyrjes së prindit, me të cilin fëmija nuk
banon.

Neni 228

Heqja e përgjegjësisë prindërore

Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmve të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore.

Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje.

Neni 229

Gjykata vendos që heqja e përgjegjësisë prindërore të shtrihet mbi të gjithë ose mbi disa nga fëmijët e lindur para vendimit të gjykatës për heqjen e përgjegjësisë.

Heqja e përgjegjësisë prindërore e shkarkon fëmijën nga detyrimi për ushqim ndaj prindërve, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe.

Neni 230

Kthimi i përgjegjësisë prindërore

Përgjegjësia prindërore mund të kthehet me vendim të gjykatës, kur pushon shkaku për të cilin është hequr kjo përgjegjësi.

KREU III

PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE PËR PASURINË E FËMIJËS

Neni 231

Përfaqësimi dhe administrimi

Prindërit e fëmijës kanë të drejtën e administrimit dhe të përdorimit të pasurisë së fëmijës së tyre.

Neni 232

Prindërit përfaqësojnë fëmijën e tyre të mitur që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, i mituri mund t'i kryejë vetë.

I mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç i kryen vetë veprimet juridike, por kurdoherë me pëlqimin paraprak të prindërve, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, mund t'i kryejë vetë.

Neni 233

Pasuria e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës, kurse pasuria e të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve.

Neni 234

Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit.

Veprimi juridik, që është kryer pa u marrë autorizimi i gjykatës, mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e prokurorit, të prindit ose të kujdestarit të të miturit.

Në qoftë se gjykata jep pëlqimin më vonë, veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm.

Neni 235
Përdorimi i të ardhurave të fëmijës
Prindërit mund të përdorin të ardhurat nga pasuria e fëmijës, që ata administrojnë, për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e tij.
Ata mund t'i përdorin këto të ardhura, për të plotësuar nevojat e domosdoshme të familjes, kur nuk kanë pasuri të mjaftueshme për t'i plotësuar vetë ato. Të ardhurat e mbetura kthehen në pasurinë e fëmijës.

Neni 236
Administrimi i pasurisë
Administrimi i pasurisë së fëmijës bëhet nga të dy prindërit bashkërisht, në rastin kur ata e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkërisht dhe në rastet e tjera ose nga i ati apo nga nëna nën kontrollin e gjykatës, sipas neneve 234 dhe 235 të këtij Kodi.
E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës është e lidhur me të drejtën e administrimit ligjor. Kjo e drejtë u takon të dy prindërve bashkërisht ose atij që është i ngarkuar me administrimin e pasurisë së fëmijës.

Neni 237
E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës nga prindi pushon:
a) kur fëmija bëhet madhor;
b) për shkaqet për të cilat merr fund përgjegjësia prindërore ose administrimi ligjor;
c) për të gjitha shkaqet që lidhen me marrjen fund të uzufruktit.

Neni 238
Detyrimet që lidhen me të drejtën e përdorimit të pasurisë së fëmijës janë:
a) detyrimet që kanë personat që gëzojnë të drejtën e uzufruktit në një pasuri;
b) detyrimi për ushqim, mirërritje, edukim dhe arsimim të fëmijës, në bazë të pasurisë.

Neni 239
E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës nuk shtrihet mbi pasurinë që ai fiton nga puna e tij, as mbi pasurinë që i është dhuruar ose që i ka kaluar me trashëgimi, kur prindi është ndaluar shprehimisht të ketë të drejtën e përdorimit mbi këtë pasuri.

TITULLI IV
BIRËSIMI

Neni 240
Interesi i të miturit
Birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore.

Neni 241
Kushtet e birësimit
Birësohet vetëm i mituri.
Birësuesi duhet të ketë një diferencë moshe të paktën 18 vjet me të birësuarin.
Në qoftë se birësohet fëmija i bashkëshortit, diferenca e moshës duhet të jetë jo më pak se 15 vjet.

Neni 242
I mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë.
Birësimi i ri lejohet pas vdekjes së birësuesit ose të birësuesve apo pas vdekjes së njërit prej birësuesve, në qoftë se kërkesa është paraqitur nga bashkëshorti i ri i birësuesit.

Neni 243
Ndalimet e birësimit
Nuk mund të birësohet një person nga të paralindurit e tij, si edhe vëllai nga motra dhe anasjelltas.

Neni 244
Nuk mund të birësohet një person nga kujdestari i tij, pa u parë përpara nga gjykata administrimi i pasurisë së të miturit prej tij, dorëzimi i pasurisë së të miturit, si dhe vlerësimi i detyrimeve në ngarkim të kujdestarit ose dhënia e garancisë nga kujdestari për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Neni 245
Personi nuk mund të birësojë kur:

a) i është hequr nga gjykata përgjegjësia prindërore;
b) vuan nga një sëmundje psikike ose ka zhvillim mendor të metë, si dhe vuan nga një sëmundje, e cila mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e atij që do të birësohet;
c) nuk ka garancinë si person, se do të kryejë në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e atij që do të birësohet.

Neni 246
Pëlqimi për birësim

Për birësimin e të miturit kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të tij.
Në qoftë se njëri nga të dy prindërit ka vdekur, nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose i është hequr përgjegjësia prindërore, pëlqimi i prindit tjetër është i mjaftueshëm.
Kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre u është hequr zotësia për të vepruar ose janë të panjohur, gjykata vendos nëse fëmija duhet të birësohet.
Kur birësuesi është i martuar, duhet të merret pëlqimi i bashkëshortit të tij.
Kur i birësuari ka mbushur moshën dhjetë vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën dymbëdhjetë vjeç kërkohet pëlqimi i tij.

Neni 247

Pëlqimi për birësim jepet përpara gjykatës kompetente. Në rast se personi ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij në një shtet tjetër, mund të japë pëlqimin para agjentit diplomatik ose konsullor pranë ambasadës ose konsullatës shqiptare.

Neni 248

Pëlqimi për birësim mund të tërhiqet nga prindërit biologjikë, brenda 3 muajve nga çasti i dhënies së tij.
Kjo periudhë shërben edhe si periudhë provë për marrëdhëniet midis birësuesve dhe të birësuarit.
Periudha e provës shërben për të vendosur një marrëdhënie birësuese midis një fëmije dhe një familjeje.
Prindërit mund të tërheqin pëlqimin e tyre edhe pas kalimit të afatit tremujor, deri në çastin e marrjes së vendimit nga gjykata kompetente.

Gjykata, përpara se të vendosë, duhet të verifikojë nëse janë plotësuar afatet e mësipërme, nëse janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për kthimin e fëmijës pranë prindërve biologjikë dhe nëse gjatë bashkimit ka funksionuar marrëdhënia e të miturit me birësuesit.
Në qoftë se personi, që i është besuar fëmija gjatë periudhës së provës dhe më pas, refuzon ta kthejë atë, prindërit mund t'i drejtohen gjykatës, e cila mund të vendosë kthimin e fëmijës në rast se kjo është në interesin e tij.

Neni 249

Nëse birësuesi vdes pasi ka dhënë pëlqimin dhe para dhënies së vendimit, gjykata mund të vazhdojë procedurën e gjykimit për përfundimin e birësimit.
Trashëgimtarët e birësuesit mund të paraqesin në gjykatë pretendime për të kundërshtuar birësimin.
Nëse birësimi pranohet nga gjykata, ai sjell efekte që nga çasti i dhënies së pëlqimit nga birësuesi.

Neni 250
Deklarimi i braktisjes

Gjykata e rrethit mund të deklarojë të braktisur të miturin që ndodhet pranë një institucioni të përkujdesjes sociale, publik ose privat, ose te personi që e ka në përkujdesje, kur prindërit e tij, në mënyrë të dukshme, nuk janë interesuar për të gjatë një viti, përpara paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes.
Kur i mituri ka qenë strehuar që nga lindja e tij në një institucion, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj.
Konsiderohen në mënyrë të dukshme të painteresuar për fëmijën prindërit që vullnetarisht nuk kanë mbajtur marrëdhënie të përzemërta të nevojshme për rritjen e tij dhe që kanë treguar pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.
Gjykata i kërkon personit që ka paraqitur kërkesën shpjegime nëse ka bërë përpjekje për gjetjen e prindërve biologjikë të fëmijës dhe kthimin e fëmijës në familjen biologjike, nëse kjo është e mundur.
Braktisja nuk deklarohet kur, gjatë afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, një anëtar i familjes ka kërkuar të marrë përsipër rritjen e fëmijës dhe kjo kërkesë është konsideruar në përputhje me interesin e fëmijës.

Neni 251

Kërkesa për deklarimin e braktisjes bëhet nga drejtuesi i institucionit ku ndodhet fëmija ose nga personi që e ka në përkujdesje. Kërkesa i dërgohet gjykatës, nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni ose vendbanimi i personit që e ka marrë në përkujdesje të miturin.

Çdo person që ka një interes ligjshëm për mbrojtjen e fëmijës, mund të ndërhyjë në procesin e gjykimit.

Gjykata, që deklaron të braktisur të miturin, cakton në të njëjtin vendim edhe kujdestarin për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës, një institucion të përkujdesjes sociale ose një person të caktuar, nisur nga interesi më i lartë i të miturit.

Neni 252

Paraqitja e kërkesës

Personat që dëshirojnë të birësojnë të mitur shqiptarë mund të birësojnë vetëm të miturit që figurojnë në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Komiteti Shqiptar i Birësimit është autoritet qendror i pavarur, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë.

Shtetasit e huaj nuk mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Kërkesa e tyre i paraqitet Komitetit Shqiptar të Birësimit nëpërmjet autoriteteve publike kompetente ose organizmave privatë të parashikuar në ligj. Kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të legalizuara, sipas ligjit të vendit ku jeton birësuesi.

Shtetasit shqiptarë që kanë vendbanimin e tyre jashtë vendit dhe shtetasit e huaj rezidentë prej 2 vjetësh në Shqipëri, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Neni 253

Detyrimi i Komitetit Shqiptar të Birësimit

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve përkatëse, Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon gjykatës studimin për personin që kërkon të birësojë dhe atë të të miturit që mund të birësohet.

Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon gjykatës edhe pëlqimin me shkrim për këtë birësim dhe për birësimet ndërvendase, si dhe konfirmimin se i mituri nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri për një afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit në listat e këtij Komiteti.

Neni 254

Gjykata Kompetente

Kërkesa për birësim, e bërë nga një shtetas shqiptar, bëhet në gjykatën e vendbanimit të personit që kërkon të birësojë.

Kërkesa për birësim, e bërë nga një shtetas i huaj ose shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën nën juridiksionin e së cilës ndodhet vendbanimi i të miturit.

Kërkesa për birësimin e të miturit shqiptar që banon jashtë shtetit paraqitet në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 255

Ndërhyrja në proces

Çdo person që ka një interes të ligjshëm për mbrojtjen e të miturit si dhe prokurori mund të ndërhyjnë në procesin e birësimit, si dhe kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës.

Neni 256

Në rast se gjatë procedurës për birësimin e një fëmije rezulton se është paraqitur një kërkesë në gjykatë, për njohje atësie, procedura pezullohet deri në përfundim të gjykimit për njohjen e atësisë.

Neni 257

Ndalimet për birësimin ndërvendas

Kushtet dhe efektet e birësimit të shpallur në Shqipëri përcaktohen nga legjislacioni shqiptar. Birësimi ndërvendas nuk lejohet kur:

a) birësimi nuk njihet në shtetin ku banojnë birësuesit;
b) arrihet në përfundimin së birësimi është me pasoja të rënda për të miturin;
c) i mituri, në shtetin ku banojnë birësuesit, nuk gëzon të njëjtat të drejta që njihen në Shqipëri.

Birësimi ndërvendas lejohet pasi fëmija ka qëndruar në pritje për 6 muaj në listat e komitetit shqiptar të birësimit dhe, gjatë kësaj periudhe, janë ezauruar të gjitha mundësitë për të bërë birësimin brenda vendit.

Neni 258
Efektet e birësimit
Birësimi i prodhon efektet e tij nga data që vendimi merr formë të prerë. Birësimi është i parevokueshëm.
Gjykata i dërgon vendimin e formës së prerë për regjistrim zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar birësuesi.

Neni 259
Marrëdhëniet ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit
Me birësimin ndërmjet birësuesit dhe gjinisë së tij, nga njëra anë, dhe të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga ana tjetër, lindin të drejta dhe detyra të njëjta me ato që kanë ndërmjet tyre personat që janë gjini. Të drejtat dhe detyrat ndërmjet të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga njëra anë, dhe gjinisë së tij, nga ana tjetër, pushojnë.
Kur njëri nga prindërit e të birësuarit është bashkëshort i birësuesit, i birësuari nuk i shkëput lidhjet me këtë prind dhe gjininë e tij.

Neni 260
Atësia, mëmësia dhe mbiemri i të birësuarit
I birësuari merr mbiemrin e birësuesit dhe në rast të birësimit nga të dy bashkëshortët, mbiemrin e përbashkët të tyre; në qoftë se ata kanë mbiemra të ndryshëm vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë i birësuari; në rast mosmarrëveshjeje fëmija merr mbiemrin e të atit.
Me kërkesë të birësuesit ose të birësuesve, gjykata mund të ndryshojë emrin e të birësuarit. I birësuari merr për emër nëne dhe ati atë të birësuesit ose birësuesve të tij.

Neni 261
Për birësimin surrogativ, të parashikuar në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues", zbatohen të njëjtat kritere dhe procedura për birësimin, sipas këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës.

Neni 262
I mituri, prindërit biologjikë dhe birësuesit kanë të drejtën e mirëbesimit për procesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje të respektimit të jetës private.

Kur mosha dhe niveli i pjekurisë e lejojnë, i mituri ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur, me të dhënat për prindërit biologjikë.

TITULLI V
KUJDESTARIA

KREU I
KUJDESTARIA MBI TË MITURIT

Neni 263
Vendosja e kujdestarisë
Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.
Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.

Neni 264
E drejta për paraqitjen e kërkesës
Të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë:
a) të afërmit e fëmijës së mitur;
b) cilido që merr njoftim për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur;
c) vetë i mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç; ç) prokurori;
d) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari.

Neni 265
Gjykata vendos si kujdestar personin e caktuar nga prindi, që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, me testament ose deklaratë noteriale.

Kujdestari i caktuar, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nuk është i detyruar të pranojë kujdestarinë.
Në rastet kur kujdestari i caktuar sipas këtij neni nuk plotëson kushtet e kërkuara nga ky Kod, kujdestaria vendoset nga gjykata.

Neni 266
Familja kujdestare
Familja kujdestare është një familje alternative, e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale.
Evidentimi i familjeve kujdestare është përgjegjësi e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social pranë bashkisë ose komunës ku banon i mituri, e cila realizohet me firmosjen e një deklarate gatishmërie nga familja për të marrë fëmijë në kujdestari.
Numri i fëmijëve që i jepen në kujdestari një familjeje kujdestare duhet të jetë i kufizuar, duke u dhënë prioritet në këtë vendosje fëmijëve që janë vëllezër dhe motra me njëri-tjetrin.

Neni 267
Në rast se nuk është caktuar kujdestar nga prindi që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, gjykata i jep prioritet zgjedhjes së kujdestarit midis paraardhësve, personave të afërt të të miturit, një familjeje kujdestare dhe, si alternativë të fundit, institucionin publik ose privat.
Para se gjyqtari të caktojë kujdestarin, duhet të dëgjojë personin e zgjedhur si të tillë dhe të marrë mendimin e të miturit nëse ai ka mbushur moshën dhjetë vjeç.
Gjykata, në çdo rast, merr mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës së vendit ku zhvillohet gjykimi, i cili përmban ekzaminimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës në kontekstin familjar edukativ e social dhe ekzaminimin e kushteve dhe përshtatshmërisë së fëmijës me personin kujdestar të ardhshëm, të familjes kujdestare ose institucionit të përkujdesjes.
Caktimi i kujdestarit nga gjykata bëhet duke parë cilësitë e personit kujdestar, të familjes kujdestare të zgjedhur ose të institucionit të përkujdesjes, sipas paragrafit të tretë të këtij neni, si dhe pasi ka dëgjuar mendimin e një psikologu, që duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit.

Neni 268
Njoftimi i gjykatës
Nëpunësi i gjendjes civile, që merr njoftimin për vdekjen e të dy prindërve ose prindit të vetëm, që ka lënë fëmijë në moshë të mitur, ose të lindjes së një fëmije nga prindër të panjohur, dhe noteri që çel një testament, ku parashikohet caktimi i një kujdestari, duhet të njoftojnë gjykatën për faktin brenda 10 ditëve.
Njoftimi i gjykatës mund të bëhet edhe nga të afërmit e të miturit ose persona të tjerë të interesuar.
Gjykata, brenda 30 ditëve nga marrja njoftim ose nga paraqitja e kërkesës, vendos për caktimin e kujdestarit të të miturit.

Neni 269
Kujdestaria mbi disa të mitur
Për të miturit që janë vëllezër e motra caktohet një kujdestar i vetëm, përveç rastit kur rrethanat e veçanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të më shumë se një kujdestari.

Neni 270
Paaftësia dhe papajtueshmëria për të qenë kujdestar
Nuk mund të caktohet kujdestar personi që:
a) është vetë në kujdestari;
b) ka konflikt interesash me të miturin;
c) nuk ka administrimin e lirë të pasurisë së tij;
ç) është përjashtuar nga kujdestaria për shkak të deklarimit me shkrim të prindit që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore;
d) ka humbur ose i është hequr përgjegjësia prindërore, ose i është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;
dh) është i dënuar me burgim për një vepër penale dhe është gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe kur është dënuar për krime ndaj të miturve.
e) ka mbushur moshën 65 vjeç;
ë) për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nuk mund ta ushtrojë me lehtësi kujdestarinë;
f) ushtron përgjegjësinë prindërore në më shumë se tre fëmijë;
g) është i ngarkuar me më shumë se dy kujdestari;
gj) nuk jep pëlqimin për të qenë kujdestar.

Neni 271

Kujdestaria në Institucionet e Përkujdesjes

Kujdestaria mbi të miturin, i cili nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licencuar për përkujdesjen e fëmijëve.

Drejtuesi i institucionit i delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit.

Drejtuesi i institucionit, brenda 10 ditëve nga caktimi i personit që merr funksionet e kujdestarit, i dërgon gjykatës aktin përkatës, i cili depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë.

Neni 272

Funksionet e Kujdestarit

Kujdestari kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë në të gjitha veprimet juridike dhe administron pasurinë e tij, sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 273

Detyrat e të miturit

I mituri duhet ta respektojë dhe t'i bindet kujdestarit. Ai nuk mund të braktisë banesën ose institucionin ku është lënë pa lejen e kujdestarit.

Kur largohet pa leje, kujdestari ka të drejtë ta kërkojë të miturin dhe, nëse është e nevojshme, t'i drejtohet gjykatës për kthimin e tij.

Gjatë gjykimit duhet të dëgjohet dhe i mituri që ka mbushur moshën dhjetë vjeç, në praninë e psikologut.

Neni 274

Rastet e kujdestarisë së posaçme

Gjykata vendos caktimin e një kujdestari të posaçëm kur:

a) ka konflikt interesash midis të miturit dhe prindërve ose midis të miturit dhe kujdestarit të tij, si dhe kur midis tyre duhet të kryhet një veprim juridik;
b) ka konflikt interesash midis të miturve, vëllezër dhe motra, që kanë të njëjtin kujdestar ose kur duhet të kryhet një veprim juridik midis tyre;
c) për shkak sëmundjeje ose për shkaqe të tjera, kujdestari i caktuar pengohet të kryejë një veprim të caktuar ose të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi.

Neni 275

Caktimi i kujdestarit të posaçëm

Kujdestari i posaçëm caktohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës së prindit, të kujdestarit, së të afërmve të të miturit, të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe personave të interesuar.

Neni 276

Me caktimin e kujdestarit të posaçëm, gjykata cakton kufijtë e detyrave dhe të drejtave të kujdestarit, sipas rrethanave të çdo rasti të veçantë.

Neni 277

Gjykata kompetente

Gjykatë kompetente për caktimin e kujdestarit të posaçëm është ajo e vendbanimit ose e vendqëndrimit të të miturit, ose e vendit ku ndodhet pasuria e tij.

Neni 278

Funksionet e kujdestarit të posaçëm

Kujdestari i posaçëm përfaqëson të miturin në rastet kur interesi i tij është në konflikt me interesin e kujdestarit.

Kur kujdestari i posaçëm ndodhet në konflikt interesash me të miturin, gjyqtari emëron një kujdestar tjetër.

Kujdestari i posaçëm duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari të ri në rastin kur kujdestari nuk kryen ose braktis detyrën. Kujdestari i posaçëm kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e pasurisë në raste urgjente.

Neni 279

Dhurimi ose disponimi me testament

Dhuruesi ose personi që disponon me testament në favor të një të mituri, edhe pse ky i fundit është nën përgjegjësinë e prindërve të tij, mund t'i caktojë atij një kujdestar të posaçëm për pranimin dhe administrimin e pasurisë së dhuruar ose të lënë atij me testament.

Nëse dhuruesi ose testatori nuk ka vendosur ndryshe, kujdestari i posaçëm duhet të ushtrojë të drejtat dhe detyrat e tij, sipas dispozitave për administrimin të këtij Kodi.

Neni 280

Mbarimi i kujdestarisë së posaçme

Kujdestaria e posaçme mbaron kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur. Mbarimi i kujdestarisë së posaçme bëhet me kërkesën e personave, sipas nenit 275 të këtij Kodi.

Neni 281

Masa Urgjente

Përpara se kujdestari të marrë përsipër funksionet e tij, i takon gjyqtarit që, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të prokurorit, të një të afërmi ose të çdo personi të interesuar, të vendosë një kujdestar të përkohshëm ose të marrë masa të tjera urgjente që janë të nevojshme për mbrojtjen e të miturit ose për të ruajtur dhe administruar pasurinë e tij.

Neni 282

Inventari

Kujdestari, brenda 10 ditëve pasi ka marrë njoftimin ligjor për emërimin e tij, duhet të procedojë me inventarin e pasurisë së të miturit. Inventari duhet të bëhet brenda 30 ditëve.

Me kërkesën e kujdestarit, gjyqtari mund të zgjasë afatin e mësipërm, nëse rrethanat e kërkojnë atë.

Neni 283

Inventari bëhet në praninë e noterit, me pjesëmarrjen e kujdestarit dhe, nëse është e mundur, të të miturit që ka mbushur moshën dhjetë vjeç, si dhe në praninë e dy dëshmitarëve të zgjedhur nga gjykata, mundësisht midis të afërmve ose miqve të familjes. Gjyqtari mund të lejojë që inventari të bëhet pa praninë e noterit, nëse vlera e supozuar e pasurisë nuk e kalon shumën 50 mijë lekë.

Inventari depozitohet pranë gjykatës.

Neni 284

Përmbajtja e Inventarit

Në inventar përfshihen pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, kreditë dhe debitë dhe përshkruhen dokumentet, shënimet dhe shkresat e lidhura me gjendjen e aktivit dhe pasivit të pasurisë, duke iu përmbajtur formaliteteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 285

Nëse në pasurinë e të miturit ka ndërmarrje, shoqëri, shoqëri tregtare ose bujqësore, procedohet sipas legjislacionit përkatës për hartimin e inventarit të ndërmarrjes ose të shoqërisë dhe në përputhje me nenin 283 këtij Kodi. Ky inventar depozitohet pranë gjykatës dhe i shtohet inventarit të përmendur në nenin 284 të këtij Kodi.

Neni 286

Administrimi nga Kujdestari

Para se të bëhet inventari, administrimi i pasurisë nga kujdestari duhet të kufizohet në çështjet që, nga vetë natyra e tyre, janë të ngutshme.

Neni 287

Pas inventarit, gjykata, me propozim të kujdestarit, vendos për vazhdimin e veprimtarisë, tjetërsimin ose likuidimin e ndërmarrjes, shoqërisë, shoqërisë tregtare ose bujqësore, që janë pasuri e të miturit, si dhe për mënyrat përkatëse dhe masat paraprake.

Gjatë gjykimit, gjykata mund të lejojë funksionimin e përkohshëm të ndërmarrjes.

Neni 288

Pasuria e administruar nga kujdestari i posaçëm

Kujdestari duhet të përfshijë në inventarin e pasurisë së të miturit edhe pasuritë, administrimi i të cilave i është dhënë një kujdestari të posaçëm. Nëse ky ka bërë një inventar të veçantë për këto pasuri, duhet t'i japë kopje kujdestarit, i cili e bashkon me inventarin e përmendur në nenin 284 të këtij Kodi.

Kujdestari i posaçëm duhet t'i japë kujdestarit kopje të llogarive periodike të administrimit të pasurisë, përveçse kur disponuesi me testament ose dhuruesi e ka përjashtuar këtë.

Neni 289

Deklarimi i debive ose kredive të Kujdestarit

Kujdestari që ka debi, kredi ose deklarime të tjera kundrejt të miturit, duhet t'i bëjë të ditura para mbylljes së inventarit.

Kancelari i gjykatës ka detyrimin që ta pyesë lidhur me këto deklarime.

Në rast të inventarit të bërë pa pjesëmarrjen e kancelarit të gjykatës, kujdestari pyetet nga gjyqtari lidhur me aktin e depozitimit.
Në çdo rast, fakti i pyetjes ose deklarimit të kujdestarit duhet përmendur në inventar ose në procesverbalin e depozitimit.

Neni 290
Mungesa e deklarimit
Kujdestari humbet çdo të drejtë, në qoftë se, duke qenë në dijeni të kredisë ose të të drejtave të tij, nuk i ka deklaruar edhe pse është pyetur shprehimisht.
Kujdestari shkarkohet nga detyra kur, duke e ditur që është debitor, nuk ka deklaruar borxhin e tij.

Neni 291
Depozitimi i parave, titujve dhe objekteve
Kujdestari duhet të depozitojë paratë, titujt e kredive te prurësi dhe objektet me vlerë që ekzistojnë në pasurinë e të miturit pranë një banke ose instituti tjetër krediti, të përcaktuar nga gjykata, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe lidhur me ruajtjen e tyre.
Kujdestari nuk është i detyruar të depozitojë shumat që nevojiten për shpenzimet urgjente lidhur me të miturin.

Neni 292
Kapitalet e të miturit, me autorizim paraprak të gjykatës, mund të investohen nga kujdestari, në rastet që e shikon të përshtatshme dhe në interes të të miturit.

Neni 293
Autorizimi i gjykatës
Kujdestari, pa autorizim të gjykatës, nuk mund:

a) të blejë pasuri, përveç sendeve të luajtshme të nevojshme për përdorim nga i mituri, për ekonominë shtëpiake dhe për administrimin e pasurisë;
b) të marrë kapitale, të lejojë heqjen e hipotekave ose zgjidhjen e pengut, të marrë përsipër detyrime, me përjashtim të rastit kur këto lidhen me shpenzimet e nevojshme për mbajtjen e të miturit dhe për administrimin e zakonshëm të pasurisë të tij;
c) të pranojë trashëgimi ose të heqë dorë prej saj, të pranojë dhurime ose leg, që janë me barrë ose me kusht;
ç) të lidhë kontrata qiraje të pasurive të paluajtshme për një afat mbi 9 vjet ose që në çdo rast zgjasin më shumë se 1 vit pasi i mituri ka mbushur moshën madhore;
d) të ngrejë padi, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për kallëzim të një punimi të ri ose të dëmit të mundshëm, të padive të posedimit, ose për nxjerrjen nga shtëpia të qiramarrësit, dhe të padive për kërkimin e fryteve ose për marrjen e masave konservative;
dh) të tjetërsojë pasurinë e të miturit, përveç fryteve dhe të mirave të luajtshme që dëmtohen lehtësisht;
e) të krijojë pengje ose hipoteka;
ë) të fillojë procedurën e pjesëtimit të pasurisë ose të ngrejë padinë përkatëse;
f) të bëjë premtime dhe transaksione ose të pranojë marrëveshje.

Neni 294
Shitja e pasurisë
Në autorizimin për shitjen e pasurisë, gjykata vendos nëse shitja duhet bërë me ose pa ankand, duke përcaktuar në çdo rast çmimin minimal.
Kur në autorizim nuk është përcaktuar mënyra e shpërndarjes ose riinvestimit të të ardhurave të realizuara nga shitja, këtë e vendos gjykata në një autorizim të mëvonshëm.

Neni 295
Veprimet e kryera në kundërshtim me nenet paraardhëse
Çdo veprim që kujdestari kryen në kundërshtim me ligjin është i pavlefshëm.
Kujdestari, i mituri, trashëgimtarët e tij ose personat që kanë interes, mund të kërkojnë pavlefshmërinë e veprimeve të kryera në kundërshtim me Kreun I të Titullit V "Kujdestaria" të këtij Kodi.

Neni 296
Ndalimet për kujdestarin dhe kujdestarin e posaçëm

Kujdestari dhe kujdestari i posaçëm as me ankand nuk mund të bëhen blerës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave të tjerë, të pasurisë dhe të të drejtave të të miturit. Ata nuk mund të marrin me qira pasuritë e të miturit pa autorizimin dhe masat mbrojtëse të vendosura nga gjykata.
Personat e përcaktuar në nenin 295 të këtij Kodi mund të kërkojnë pavlefshmërinë e veprimeve të kryera në kundërshtim me ndalimet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, me përjashtim të kujdestarit dhe kujdestarit të posaçëm që i kanë kryer ato.

Neni 297
Shpërblimi i kujdestarit
Detyra e kujdestarit është pa pagesë.
Gjykata, duke pasur parasysh madhësinë e pasurisë dhe vështirësitë e administrimit ose shërbimit për të miturin, mund t'i caktojë kujdestarit një kompensim të arsyeshëm nga pasuria e të miturit.
Nëse e kërkojnë rrethanat e veçanta, gjykata, pasi ka dëgjuar kujdestarin e posaçëm, mund të autorizojë kujdestarin që të caktojë si zëvendës të tij në administrim, nën përgjegjësinë e tij vetjake, një ose më shumë persona me pagesë.

Neni 298
Mbajtja e kontabilitetit
Kujdestari duhet të mbajë kontabilitetin e rregullt të administrimit të pasurisë dhe t'i japë llogari një herë në vit gjyqtarit.
Gjyqtari mund t'ia nënshtrojë kontabilitetin e administrimit të pasurisë shqyrtimit vjetor nga ana e kujdestarit të posaçëm ndonjë të afërmi ose një personi në lidhje krushqie me të miturin.

Neni 299
Përgjegjësia e kujdestarit dhe kujdestarit të posaçëm
Kujdestari duhet ta administrojë pasurinë e të miturit me kujdesin e një prindi të mirë.
Kujdestari detyrohet të shpërblejë të miturin për të gjitha dëmet që i ka shkaktuar këtij në kryerjen e parregullt të detyrës, ose për shkak të lënies pa arsye të detyrës së kujdestarit.
Të njëjtën përgjegjësi ka edhe kujdestari i posaçëm, për aq sa lidhen me detyrat e tij.

Neni 300
Zëvendësimi i kujdestarit
Gjykata e heq kujdestarin dhe e zëvendëson atë me një tjetër kur vëren se ai shpërdoron të drejtat e tij, tregohet i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës ose, në mënyra të tjera, vë në rrezik interesat e të miturit, si dhe kur vetë kujdestari kërkon largimin e tij për shkaqe të arsyeshme. Kërkesa për zëvendësimin e kujdestarit mund të bëhet nga personat e interesuar ose prokurori.
Në këto raste gjykata dëgjon më parë pretendimet e kujdestarit.

Neni 301
Dorëzimi i pasurisë
Me mbarimin e kujdestarisë ose zëvendësimin e saj, kujdestari duhet të bëjë menjëherë dorëzimin e pasurisë së të miturit, sipas rastit, të miturit që është bërë madhor, trashëgimtarëve të tij ose kujdestarit të ri.
Brenda 2 muajve nga çasti i mbarimit ose zëvendësimit, kujdestari i paraqet gjykatës llogarinë
përfundimtare të administrimit të pasurisë.
Gjykata, kur ka shkaqe të arsyeshme, vendos shtyrjen e dorëzimit të llogarisë tej këtij afati.

Neni 302
Miratimi i llogarisë
Gjykata thërret kujdestarin e posaçëm, të miturin që ka mbushur moshën madhore, nëse është rasti kujdestarin e ri dhe, në rast të vdekjes së të miturit, trashëgimtarët e tij, për të shqyrtuar llogarinë dhe për të bërë vërejtjet përkatëse.
Nëse nuk ka vërejtje dhe parregullsi ose mangësi në llogari, gjykata e miraton atë.
Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim nga kujdestari ose nga personat e tjerë të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 303
Parashkrimi i padive për kujdestarinë
Paditë e të miturit kundër kujdestarit dhe ato të kujdestarit kundër të miturit, për kujdestarinë, parashkruhen brenda 5 vjetëve, pasi i mituri ka mbushur moshën madhore ose ka vdekur.

Nëse kujdestari ka paraqitur llogarinë përpara se i mituri të mbushë moshën madhore ose përpara vdekjes, afati fillon nga data kur gjyqtari ka marrë vendim mbi llogarinë.
Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për padinë e pagimit të diferencës që rezulton nga llogaria përfundimtare.

Neni 304
Ndalimi i marrëveshjes para miratimit të llogarisë
Midis kujdestarit dhe të miturit që ka arritur moshën madhore nuk mund të bëhet asnjë marrëveshje përpara miratimit të llogarisë së paraqitur nga kujdestari.
I mituri që ka arritur moshën madhore, trashëgimtarët e tij ose ata që kanë një interes të ligjshëm mund t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e marrëveshjes së bërë, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Neni 305
Regjistri i kujdestarisë
Në regjistrin e kujdestarisë, që ndodhet pranë gjykatës, nën përkujdesjen e kancelarit të gjykatës, regjistrohen vendosja dhe mbarimi i kujdestarisë, përjashtimi ose shkarkimi nga detyra i kujdestarit ose kujdestarit të posaçëm, rezultatet e inventarëve dhe të llogarive, raportet vjetore të përcaktuara në nenin 302 të këtij Kodi dhe të gjitha masat që sjellin ndryshime në statusin vetjak ose pasuror të të miturit.
Për vendosjen dhe mbarimin e kujdestarisë, kancelari i gjykatës njofton brenda 10 ditëve nëpunësin e gjendjes civile për të bërë shënimin në aktin e lindjes së të miturit.

Neni 306
Mbarimi i Kujdestarisë
Kujdestaria mbaron kur fëmija:
a) bëhet madhor;
b) vdes;
c) fiton zotësinë për të vepruar me martesë.

KREU II
KUJDESTARIA MBI PERSONAT QË U ËSHTË HEQUR OSE KUFIZUAR ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR

Neni 307
Gjykata, në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar.

Neni 308
Dispozitat e kujdestarisë për të miturit zbatohen edhe për kujdestarinë e personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

Neni 309
Kujdestari i personit, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, përfaqëson dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi përfaqëson dhe administron pasurinë e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.
Kujdestari i personit, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, jep pëlqimin dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi jep pëlqimin dhe administron pasurinë e të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.

Neni 310
Kujdestari i personit, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, detyrohet të kujdeset për personin dhe sidomos për mjekimin e tij.

Neni 311
Të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç dhe ndodhet nën përgjegjësinë prindërore, kur i hiqet zotësia për të vepruar, nuk i caktohet kujdestar, por vazhdon të jetë nën kujdesin e prindërve, si i mituri që nuk ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç.
Kur i mituri bëhet madhor dhe nuk i është kthyer zotësia për të vepruar, gjykata i cakton një kujdestar, që mund të jetë një nga prindërit ose një person tjetër.

Neni 312
Të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, kur ndodhet në kujdestari dhe gjatë kësaj kohe i hiqet zotësia për të vepruar, gjykata i cakton një kujdestar të ri ose vendos që kujdestari i tij të mbajë përsëri këtë detyrë.

Neni 313
Kujdestaria mbi personin, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, pushon kur kjo zotësi i është kthyer me vendim të gjykatës.

TITULLI VI
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 314
Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 315
Bashkëpronësia e bashkëshortëve, e krijuar para hyrjes në fuqi të Kodit të Familjes, mund të ndryshojë me marrëveshje të bashkëshortëve, sipas dispozitave të këtij Kodi.
Pasuria që fitohet nga bashkëshortët pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, rregullohet nga ky Kod edhe për bashkëshortët që kanë lidhur martesë para hyrjes në fuqi të tij.

Neni 316
Për afatet e parashkrimit të padisë, që kanë filluar të ecin para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk janë plotësuar sipas dispozitave të mëparshme, zbatohen dispozitat e këtij Kodi.

Neni 317
Çështjet që janë në gjykim në datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi gjykohen sipas Kodit të mëparshëm, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Neni 318
Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohen Kodi i Familjes, i miratuar me ligjin nr. 6599, datë 29.6.1982, dispozitat e ligjit nr. 7650, datë 17.12.1992 "Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes" që vijnë në kundërshtim me këtë Kod, nenet 86 e 87 të Kodit Civil, miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.6.1981, si dhe nenet 358-368 e 384 të Kodit të Procedurës Civile, të miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996.

Neni 319
Ky ligj hyn në fuqi gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr. 3837, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr. 18/2017

PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agjencia" nënkupton Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
2. "Autoritet përgjegjës" është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, kryen/jnë dhe mbulon/jnë shërbime të specializuara e profesionale për fëmijën.
3. "Dhunë ndaj fëmijës" është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.
4. **"Fëmijë" është çdo person nën moshën 18 vjeç**. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. "Fëmijë i pashoqëruar" është fëmija që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji.
6. "Fëmijë në nevojë për mbrojtje" është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.
7. "Këshilli" nënkupton Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
8. "Mbrojtje e fëmijës" është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.
9. "Ndëshkimi trupor" është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim te fëmija, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja, shtytja, djegia, goditja, pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, tërheqja e flokëve, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, si dhe çdo veprim i ngjashëm me të.
10. "Neglizhimi i fëmijës" është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës.
11. "Përmbajtje të dëmshme për fëmijën" janë çdo pamje, imazh dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cenon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.
12. "Përfaqësues procedural" është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

13. "Pjesëmarrje e fëmijës" është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes aktive të fëmijës dhe i respektimit të së drejtës së tij për t'u shprehur e për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me të.
14. "Prind" është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.
15. "Sistemi i integruar i mbrojtjes" është tërësia e akteve ligjore, politike dhe e shërbimeve të nevojshme, në të gjitha fushat, veçanërisht në ato të mirëqenies sociale, edukimit, shëndetit, sigurisë dhe drejtësisë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve që shfaqen gjatë zbatimit të tyre. Institucionet përgjegjëse marrin masa konkrete, me qëllim bashkëpunimin, ndarjen e përgjegjësive dhe koordinimin ndërmjet të gjitha agjencive qeveritare, organeve të vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve publike ose jopublike, grupeve të komunitetit, përfshirë sistemin e referimit të rasteve, si elemente përbërëse të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.
16. "Shërbimi psiko-social shkollor" është shërbimi që u ofron mbështetje nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore për identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të komunitetit shkollor, i cili sigurohet nga njësitë arsimore vendore.

Neni 4
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

a) fëmijën me shtetësi shqiptare, pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
b) fëmijën me shtetësi shqiptare, i cili ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Parime të përgjithshme

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.

2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. Barazia dhe mosdiskriminimi.
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuara me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Neni 6
Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.
2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.
3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:
   a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

   b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
   c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
   ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
   d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

KREU II
TË DREJTAT E FËMIJËS

Neni 7
E drejta e jetës

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.
2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.
3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues në situata emergjence, vetë ose nëpërmjet prindërve apo kujdestarit, ka të drejtë t'u drejtohet institucioneve të kujdesit shëndetësor ose social për këtë qëllim. Personi ose autoriteti përgjegjës, brenda fushës së kompetencave që ka, i ofron fëmijës ndihmën e menjëhershme dhe e referon atë në institucionin e kujdesit shëndetësor ose rehabilitues më të përshtatshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prindit ose kujdestarit.
4. Në raste përjashtimore, kur jeta e fëmijës rrezikohet ose ka një rrezik për pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e fëmijës, mjeku ka të drejtë të kryejë ekzaminimin dhe të japë ndihmën mjekësore, si

nevojë imediate për të shpëtuar jetën e fëmijës, edhe nëse prindërit ose kujdestari nuk japin pëlqimin.

Neni 8

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:
   a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
   b) të ketë një emër;
   c) të fitojë shtetësinë;
   ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.
2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.
3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:
   a) gjetjen e prindërve;
   b) gjetjen e të afërmve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar;
   c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.
4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.
5. Nëse nuk është i mundur përcaktimi i identitetit të një fëmije të gjetur ose të braktisur në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor ose identiteti i prindërve të fëmijës, punonjësi i strukturës së mbrojtjes së fëmijës, kryesisht ose pas marrjes së mendimit të strukturave përgjegjëse të shërbimeve sociale, cakton menjëherë një

ose disa punonjës të institucionit ku është gjetur ose braktisur fëmija, për t'u kujdesur për fëmijën deri në marrjen e masave të nevojshme, sipas këtij ligji.
6. Kur fëmija braktiset nga nëna në maternitet ose institucione të tjera të kujdesit shëndetësor, personeli social dhe mjekësor i tyre, brenda 24 orëve nga zhdukja e nënës, njofton me telefon dhe me shkrim njësinë e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe policinë, në të njëjtën kohë e mënyrë. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, në bashkëpunim me punonjësin e policisë, përgatisin raportin me shkrim mbi faktin e braktisjes së fëmijës, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.
   Nëse gjendja shëndetësore e fëmijës është e mirë, bazuar në raportin e hartuar, njësia e mbrojtjes së fëmijës, pranë pushtetit vendor, merr masa për vendosjen e fëmijës, përkujdesje alternative, sipas nenit 57 të këtij ligji.
7. Në rast se identifikohet njëri nga prindërit, njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor ofron këshillim, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e fëmijës pranë familjes biologjike dhe lëshimin e certifikatës së lindjes. Nëse nëna nuk identifikohet pas hetimit të policisë, punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ka lindur fëmija, përgatit dosjen që përmban aktin e lindjes, raportin e përgatitur, sipas pikës 6, të këtij neni, vendimin për masën e mbrojtjes së fëmijës dhe informacionin e dërguar nga policia për rezultatin e hetimeve të kryera.
8. Institucionet e kujdesit shëndetësor, të shërbimit social, shërbimet rezidenciale, si dhe të gjithë personat juridikë e fizikë që identifikojnë gra shtatzëna ose fëmijë që nuk kanë dokumente identifikimi, njoftojnë me shkrim punonjësin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë vendore ku ushtrojnë aktivitetin, i cili, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të pushtetit vendor, ndërmerr veprime konkrete për përcaktimin e identitetit të gruas shtatzënë ose të fëmijës.
9. Rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor, parashikohen me udhëzim të përbashkët të

ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 9

E drejta për të qëndruar me prindërit

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore.
2. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.
4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.
5. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditar të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast. Ky kriter ndiqet nga gjykata edhe në përcaktimin e kontakteve të fëmijës me persona të tjerë të afërt me të.
6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:
   a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;
   b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;
   c) banimit të përkohshëm të fëmijës te një i afërm ose person, i cili nuk jeton rregullisht me fëmijën;

   ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;
   d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;
   dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;
   e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.
7. Për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve personale të fëmijës me prindërit ose me persona të tjerë, me të cilët ai gëzon një jetë familjare, si dhe me qëllim kthimin e fëmijës në banesën e tij pas përfundimit të vizitës ose lejimin e fëmijës për t'u takuar me prindin tjetër, sipas vendimit të gjykatës, kjo e fundit, me kërkesë të prindit të interesuar ose të personit të ngarkuar me mirëmbajtjen e fëmijës, mund të vendosë marrjen e këtyre masave ose garancive:
   a) gjobë për vonesë ndaj personit që refuzon të zbatojë orarin e caktuar për mbajtjen e kontakteve me fëmijën;
   b) garanci pasurore ndaj prindit që nuk respekton vendimin e gjykatës, kur është e mundur, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.
8. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtari i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, arrestuar, burgosur, internuar, dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkaku, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.
9. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendqëndrimin e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë dëmton mirëqenien e fëmijës. Në rast të mosdhënies së informacionit, prindi ose anëtarë të tjerë të familjes kanë të drejtë t'i

drejtohen gjykatës, e cila vendos nëse mosdhënia e informacionit është e bazuar.

10. Në rast se prindërit nuk bien dakord për vendbanimin e fëmijës, gjykata vendos për vendbanimin e tij, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, si dhe mban në konsideratë:
    a) vullnetin e secilit prind për të përfshirë prindin tjetër në vendime që lidhen me fëmijën dhe të mbikëqyrë të drejtat prindërore të tjetrit;
    b) historikun e marrëdhënieve ndërmjet fëmijës dhe secilit prind, duke përfshirë masën dhe mënyrën se si i kanë plotësuar detyrimet prindërore secili prej tyre kundrejt fëmijës;
    c) vullnetin e secilit prind për të lejuar tjetrin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;
    ç) statusin e banesës të secilit prind në 3 vitet e fundit;
    d) historikun e veprimeve të dhunshme ndaj fëmijës ose ndaj personave të tjerë;
    dh) distancën ndërmjet banesës së secilit prind dhe institucioneve të edukimit që ndjek fëmija;
    e) mendimin e fëmijës;
    ë) vendbanimin e motrave dhe vëllezërve të fëmijës.
11. Këto aspekte mbahen parasysh edhe në rastet kur vendbanimi i fëmijës caktohet pranë institucioneve të tjera të rritjes dhe edukimit ose në rast të mbrojtjes që i ofrohet fëmijës në nevojë për mbrojtje.

Neni 10

E drejta për ribashkim familjar

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.
2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

Neni 11

E drejta për t'u zhvendosur nga vendbanimi ose për të siguruar kthimin në vendin e origjinës

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjykate, pasi të jetë marrë mendimi ose pëlqimi i fëmijës.
2. Mendimi ose pëlqimi i fëmijës merret në konsideratë për çështje që lidhen me kthimin e tij në vendin e origjinës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Me qëllim që fëmija të shprehë mendimin e tij, atij i ofrohet informacion i plotë lidhur me situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen në vendin e origjinës.
3. Fëmija i pashoqëruar nga prindi ose kujdestari ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë pranë tyre. Kthimi në vendin e origjinës bëhet vetëm nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, parim, i cili mbahet parasysh gjatë të gjithë procesit. Në këto raste vlerësohen aspektet që lidhen me sigurinë e fëmijës, integrimin e tij në vendin ku do të kthehet, si dhe mundësitë e tij për të ruajtur identitetin, kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare, duke marrë parasysh mendimin ose pëlqimin fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
4. Prindi, kujdestari i fëmijës, ose çdo person që merr dijeni për humbjen e tij, duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.
5. Për rastet që përfshijnë fëmijët e pashoqëruar, shërbimi diplomatik i Republikës së Shqipërisë jashtë vendit njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ndërsa, për rastet që përfshijnë fëmijët e shoqëruar vetëm nga njëri prind dhe pa pëlqimin e prindit tjetër, njoftohet Ministria e Drejtësisë. Këto organe marrin masa të menjëhershme për kthimin e fëmijës në Shqipëri, sipas rregullave të ligjit nr. 9446, datë 24.11.2005, "Për ratifikimin e Konventës mbi Aspekte Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës".
6. Procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 12

Liria e shprehjes

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti ose me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

Neni 13

E drejta për t'u dëgjuar

1. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit.
2. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin e zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.
3. Fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kur fëmija e ushtron vetë këtë të drejtë, punonjësit e administratës së shërbimit civil ose të administratës gjyqësore kanë detyrimin t'i japin këshillimin e nevojshëm.

Neni 14

E drejta e informimit

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Fëmija ka akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

Neni 15

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.
2. Prindi ose kujdestari i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në zgjedhjen e një besimi fetar, pasi ka marrë në konsideratë mendimin e tij dhe pa ushtruar forcë në zgjedhjen e fëmijës, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.
3. Nëse fëmija ndodhet në kushtet e mbrojtjes, personat që janë ligjërisht përgjegjës për të ndalohen të marrin masa të tilla, që ndikojnë në besimin fetar të fëmijës.

Neni 16

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij.
2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.
3. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin nëse kjo e drejtë garantohet nga institucionet përgjegjëse, sipas këtij ligji dhe, në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për marrjen e masave konkrete, sipas legjislacionit në fuqi, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.
4. Mosrespektimi i detyrimit të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.

Neni 17

Liria e jetës private

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.
2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institu-cioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e

të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.

3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.
4. Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës.
5. Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike.
6. Mosrespektimi i këtij ndalimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas nenit 69 të këtij ligji.
7. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.
8. Rastet përjashtimore nga mbrojtja e privatësisë bëhen vetëm nëse i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 18

E drejta për arsimim

1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.
2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.
3. Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:
   a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në

rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;

b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;
c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;
ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë institucioneve joshkollore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;
d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;
dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;
e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;
ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;
f) të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajoneve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;
g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);

gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.

h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.

4. Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.
6. Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.

.....
.....
.....
.....
.....
.....

LIGJ

Nr. 10 424, datë 2.6.2011

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR STATUSIN JURIDIK TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës".

Neni 2
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 7013, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Konventa Europiane
MBI STATUSIN LIGJOR TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të saj,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti sa më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, në veçanti me miratimin e rregullave të përbashkëta në fushën e ligjit;

duke vënë re se në një numër të madh të shteteve anëtare janë bërë ose po bëhen përpjekje për të përmirësuar statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë të cilat janë në disavantazh juridik ose social të të parëve;

duke njohur se ende ekzistojnë mospërputhje të mëdha në ligjet e shteteve anëtare në këtë fushë;
duke besuar se situata e fëmijëve të lindur jashtë martese duhet të përmirësohet dhe se hartimi i disa rregullave të përbashkëta në lidhje me statusin e tyre ligjor do të ndihmojë këtë objektiv dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë për një harmonizim të ligjeve të shteteve anëtare në këtë fushë;
megjithatë, *duke pasur* parasysh se është e nevojshme të pranohen etapa progresive për ato shtete të cilat nuk e konsiderojnë veten në gjendje të miratojnë menjëherë disa rregulla të kësaj konvente;
kanë rëndë dakord si më poshtë:

Neni 1
Çdo palë kontraktuese merr përsipër të sigurojë përputhshmërinë e ligjit të saj me dispozitat e kësaj konvente dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për masat e marra për këtë qëllim.

Neni 2
Njohja e mëmësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese do të bazohet vetëm në faktin e lindjes së fëmijës.

Neni 3
Njohja e atësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese mund të provohet ose përcaktohet nga njohja vullnetare ose me vendim gjykate.

Neni 4
Njohja vullnetare e atësisë nuk mund të kundërshtohet ose të kontestohet për aq sa parashikon ligji i brendshëm për këto procedura, përveç kur personi që kërkon të njohë ose që ka njohur fëmijën nuk është babai biologjik.

Neni 5
Veprimet që lidhen me provat shkencore të përkatësisë së atësisë, që mund të ndihmojnë për të vendosur ose kundërshtuar atësinë, janë të pranueshme.

Neni 6
1. Babai dhe nëna e një fëmije të lindur jashtë martese kanë të njëjtin detyrim për t'u kujdesur për fëmijën sikur të ishte lindur në martesë.

2. Kur detyrimi ligjor për t'u kujdesur për një fëmijë të lindur në martesë bie mbi anëtarë të caktuar të familjes së babait ose nënës, ky detyrim zbatohet gjithashtu në interes të fëmijës së lindur jashtë martese.

Neni 7
1. Kur njohja e një fëmije të lindur jashtë martese është përcaktuar për të dy prindërit, autoriteti prindëror nuk mund t'i atribuohet automatikisht vetëm babait.
2. Ekziston mundësia për të transferuar autoritetin prindëror, rastet e transferimit rregullohen me ligj të brendshëm.

Neni 8
Kur babai apo nëna e një fëmije të lindur jashtë martese nuk ka përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e fëmijës, ky prind mund të përfitojë të drejtën e aksesit te fëmija në rastet e duhura.

Neni 9
Një fëmijë i lindur jashtë martese ka të njëjtën të drejtë të trashëgimisë në pasurinë e babait dhe nënës së tij dhe të një anëtari të familjes së babait ose nënës të tij, sikur të kishte qenë i lindur në martesë.

Neni 10
Martesa ndërmjet babait dhe nënës së një fëmije të lindur jashtë martese i jep fëmijës statusin ligjor të fëmijës të lindur në martesë.

Neni 11
1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Kjo konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.
3. Në lidhje me një shtet nënshkrues që e ratifikon, e pranon ose e aprovon më pas, konventa hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 12

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë konventë.
2. Ky aderim bëhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të instrumentit të aderimit, i cili hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 13

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, specifikon territorin ose territoret, në të cilat zbatohet kjo konventë.
2. Çdo shtet, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në çdo datë të mëvonshme, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë këtë konventë në çdo territor ose territore të tjera të specifikuara në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilave është e autorizuar për të vepruar.
3. Çdo deklaratë e bërë në zbatim të paragrafit të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet në pajtim me procedurat e përcaktuara në nenin 15 të kësaj konvente.

Neni 14

1. Çdo shtet në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose kur bën një deklaratë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 të kësaj konvente, nuk mund të bëjë më shumë se tre rezerva në lidhje me parashikimet e neneve 2 deri 10 të konventës.
   Rezerva të natyrës së përgjithshme nuk do të lejohen; çdo rezervë nuk mund të veprojë në më shumë se një dispozitë.
2. Një rezervë do të jetë e vlefshme për pesë vjet nga hyrja në fuqi e kësaj konvente për palën kontraktuese në fjalë. Ajo mund të rinovohet për periudha pasuese për pesë vjet me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës përpara skadimit të çdo periudhe.
3. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë që ka bërë në pajtim me paragrafët e mësipërm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj.

Neni 15

1. Çdo palë kontraktuese, për aq sa është e interesuar, mund të denoncojë këtë konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Ky denoncim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes të këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet i cili ka aderuar në këtë konventë për:

a) çdo nënshkrim;
b) çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;
c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenin 11 të saj;
d) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 1;
e) çdo deklaratë të marrë në zbatim të parashikimeve të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 13;
f) çdo rezervë të bërë në zbatim të parashikimeve të paragrafit 1 të nenit 14;
g) rivendosja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 14;
h) tërheqja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 3 të nenit 14;
i) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 15 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 15 tetor 1975, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet kanë të njëjtën fuqi, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

LIGJ

Nr. 109/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR NJOHJEN E DIVORCEVE DHE NDARJEVE LIGJORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Republika e Shqipërisë aderon në Konventën për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore, bërë në Hagë më 1 qershor 1970.

Neni 2
Në kontekst të konventës, termi "divorc" ka të njëjtin kuptim me termin "zgjidhje e martesës", të parashikuar në ligjin shqiptar.

Neni 3
Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 19 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të refuzojë njohjen e një divorci ose të një ndarjeje ligjore ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët, në kohën e divorcit ose të ndarjes ligjore, kanë qenë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe të asnjë shteti tjetër, në rast se është aplikuar një ligj i ndryshëm nga ligji që referon legjislacioni shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private, përveçse kur rezultati i arritur është i njëjtë me atë që është arritur duke zbatuar ligjin e referuar prej tij.

Neni 4
Në përputhje me nenin 21 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar njohjen e një ndarjeje ligjore kur, në kohën që ajo është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas shqiptar ose i një shteti kontraktues, ligji i të cilit nuk e parashikonte ndarjen ligjore.

Neni 5
Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 24 të konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se do të zbatojë dispozitat e Konventës për Njohjen e Divorceve dhe Ndarjeve Ligjore për divorcet dhe ndarjet ligjore të bëra para datës së hyrjes në fuqi të saj dhe rezervon të drejtën të mos e zbatojë atë kur aplikimi i dispozitave nuk sjell pasoja mbi të drejtat e pronësisë, të fituara nga çdo person përpara hyrjes në fuqi të konventës.

Neni 6
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.11.2012 Shpallur me dekretin nr. 7843, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Konventa
MBI NJOHJEN E DIVORCEVE DHE NDARJES LIGJORE
(Lidhur më 1 qershor 1970)

Shtetet nënshkruese të kësaj konvente, Duke dëshiruar të lehtësojnë njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore të marra në territoret e tyre përkatëse; Kanë vendosur të lidhin një konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1
Kjo konventë zbatohet për njohjen në një shtet kontraktues të divorceve dhe ndarjeve ligjore të marra në një shtet tjetër kontraktues, të cilat ndjekin procedura gjyqësore ose të tjera, të njohura zyrtarisht dhe që janë ligjërisht në fuqi në këtë shtet. Konventa nuk zbatohet për përcaktimin e fajit apo disponimet plotësuese të shpallura gjatë marrjes së një vendimi divorci apo ndarjeje ligjore, në veçanti, ajo nuk zbatohet për disponimet e vendimit në lidhje me detyrimet ushqimore ose kujdestarinë e fëmijëve.

Neni 2
Vendimet e divorceve dhe të ndarjes ligjore njihen në të gjitha shtetet e tjera kontraktuese, sipas përcaktimeve të kësaj konvente, nëse, në datën e fillimit të procedimit në shtetin e divorcit ose ndarjes ligjore (më poshtë i quajtur "shteti i origjinës"):

1. I padituri ka pasur vendqëndrimin e tij të zakonshëm atje; ose
2. Paditësi ka pasur vendqëndrimin e tij të zakonshëm atje dhe përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:
   a) vendqëndrimi i zakonshëm ka vazhduar të jetë i tillë, por jo më pak se një vit që nga data e fillimit të procedimit;
   b) bashkëshortët kishin vendbanimin e tyre të përbashkët në këtë shtet.
3. Të dy bashkëshortët ishin shtetas të atij shteti; ose
4. Paditësi ka qenë shtetas i këtij shteti dhe përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:
   a) paditësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm atje; ose
   b) ai kishte banuar zakonisht atje për një periudhë të vazhdueshme prej një viti, qoftë dhe pjesërisht, brenda një periudhe dyvjeçare para fillimit të procedimit; ose
5. Paditësi që ka kërkuar divorcin, ishte një shtetas i atij shteti dhe përmbushen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) paditësi ishte i pranishëm në atë shtet në datën e fillimit të procedimit; dhe parashikonte divorcin.

Neni 3

Kur shteti i origjinës përdor konceptin e vendbanimit, si një provë të juridiksionit në çështjet e divorcit apo të ndarjes ligjore, shprehja "vendqëndrim i zakonshëm" në nenin 2 konsiderohet se përfshin vendbanimin sipas termit të përdorur në atë shtet. Megjithatë, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për vendbanimin e varësisë së një bashkëshorteje.

Neni 4

Në rastet e paraqitjes së një kundërpadie divorci ose ndarjeje ligjore, që vjen si pasojë e një padie apo kundërpadie, njihet nëse secila prej tyre përmbush kushtet e përcaktuara në nenet 2 ose 3 të kësaj konvente.

Neni 5

Kur një ndarje ligjore, që është në pajtim me kushtet e kësaj konvente është konvertuar në një divorc në shtetin e origjinës, njohja e divorcit nuk refuzohet me arsyetimin se kushtet e përcaktuara në nenin 2 ose 3 nuk ishin plotësuar në kohën e fillimit të procedimit të divorcit.

Neni 6

Kur i padituri është paraqitur në procedim, autoritetet e shtetit në të cilin kërkohet njohja e një divorci apo ndarjeje ligjore, janë të detyruar të paraqesin faktin mbi të cilin është pretenduar juridiksioni. Njohja e një divorci ose ndarjeje ligjore nuk refuzohet për shkak se: a
) ligji i brendshëm i shtetit në të cilin kërkohet një njohje e tillë, nuk lejon divorcin ose sipas rastit, ndarjen ligjore mbi të njëjtat fakte; ose
b) është zbatuar një ligj i ndryshëm nga ligji që zbatohet sipas rregullave të së drejtës private ndërkombëtare të këtij shteti. Pa cenuar këtë parashikim, kur është e nevojshme për zbatimin e dispozitave të tjera të kësaj konvente, autoritetet e shtetit, në të cilin kërkohet njohja e një divorci ose ndarjeje ligjore, nuk shqyrtojnë themelin e vendimit.

Neni 7

Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të njohin një divorc kur, në kohën që ai është marrë, të dyja palët ishin shtetas vetëm të shteteve të cilat nuk parashikonin divorcin.

Neni 8

Nëse, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, kur nuk janë marrë masat e duhura për të njoftuar të padituri, për procesin e divorcit ose ndarje ligjore, ose kur atij nuk i është dhënë një mundësi e mjaftueshme për të paraqitur çështjen e tij, mund të refuzohet njohja e divorcit apo ndarjes ligjore.

Neni 9

Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të njohim një divorc ose ndarje ligjore, nëse ajo është e papajtueshme me një vendim të mëparshëm që përcakton statusin martesor të bashkëshortëve dhe se vendimi ose është dhënë në shtetin në të cilin kërkohet njohja ose është njohur, ose i përmbush kushtet e kërkuara për njohje në atë shtet.

Neni 10

Shtetet kontraktuese **mund të refuzojnë të njohin një divorc ose ndarje ligjore nëse një njohje e tillë është haptazi e papajtueshme me politikën e tyre publike "ordre public".**

Neni 11
Një shtet, i cili është i detyruar të njohë një divorc në bazë të kësaj konvente, nuk mund të ndalojë asnjërin nga bashkëshortët nga rimartesa, me arsyen se ligji i një shteti tjetër nuk e njeh atë divorc.

Neni 12
Procedimi për divorc ose ndarje ligjore, i filluar në një shtet kontraktues, mund të pezullohet, kur procedimi në lidhje me statusin martesor të të dyja palëve është në pririe të zgjidhjes në një shtet tjetër kontraktues.

Neni 13
Në zbatim të kësaj konvente për divorcet ose ndarjet ligjore të marra apo që kërkohen të njihen në shtetet kontraktuese që kanë, në çështjet e divorcit apo ndarjes ligjore, dy ose më shumë sisteme ligjore që zbatohen në njësi të ndryshime territoriale:
1. Çdo referencë ndaj legjislacionit të shtetit të origjinës, interpretohet si referim ndaj ligjit të territorit në të cilin është marrë divorci ose ndarja;
2. Çdo referencë ndaj legjislacionit të shtetit në të cilin kërkohet njohja, interpretohet si referim ndaj ligjit të forumit; dhe
3. Çdo referencë ndaj vendbanimit ose vendqëndrimit në shtetin e origjinës, interpretohet si referim ndaj vendbanimit ose vendqëndrimit në territorin në të cilin është marrë ose ndarje ligjore.

Neni 14
Për qëllimet e neneve 2 dhe 3, kur shteti i origjinës ka në çështjet e divorcit ose ndarjes ligjore, dy ose më shumë sisteme ligjore, që zbatohen në njësi të ndryshme territoriale:
1. Neni 2 nënparagrafi 3 zbatohet kur të dy bashkëshortët ishin shtetas të shtetit në të cilin njësia territoriale, ku divorci ose ndarja ligjore ishte marrë, është pjesë e tij dhe pavarësisht nga vendqëndrimi i zakonshëm i bashkëshortëve.
2. Neni 2, nënparagrafët 4 dhe 5 zbatohen kur paditësi ishte një shtetas i shtetit në të cilin njësia territoriale, ku divorci ose ndarja ligjore ishte marrë, është pjesë e tij.

Neni 15
Në lidhje me një shtet kontraktues, që në çështjet e divorcit ose të ndarjes ligjore, që zbaton dy ose më shumë sisteme ligjore për kategori të ndryshme personash, çdo referencë ndaj ligjit të atij shteti interpretohet si referim ndaj sistemit ligjor të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

Neni 16
Kur për qëllimet e kësaj konvente, është e nevojshme për t'iu referuar ligjit të një shteti, nëse është apo jo një shtet kontraktues, të ndryshëm nga shteti i origjinës ose shteti në të cilin kërkohet njohja, dhe që në çështjet e divorcit ose të ndarjes ligjore kanë dy ose më shumë sisteme ligjore të zbatimit territorial ose personal, referimi bëhet ndaj sistemit të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

Neni 17
Kjo konventë nuk pengon zbatimin në një shtet kontraktues të rregullave më të favorshme të ligjit për njohjen e divorceve dhe ndarjeve ligjore.

Neni 18
Kjo konventë nuk ndikon në zbatimin e konventave të tjera, për të cilat një ose disa shtete kontraktuese janë ose mund të bëhen në të ardhmen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita që lidhen me objektin e kësaj konvente. Shtetet kontraktuese, megjithatë, duhet të evitojnë lidhjen e konventave të tjera për çështje të njëjta të papajtueshme me kushtet e kësaj konvente, përveç për arsye të veçanta në bazë të lidhjeve rajonale ose të tjera; dhe pavarësisht nga kushtet e këtyre konventave, ato marrin përsipër të njohin në përputhje me këtë konventë, divorcet dhe ndarje ligjore të dhëna në shtetet kontraktuese, që nuk janë palë të këtyre konventave të tjera.

Neni 19
Shtetet kontraktuese jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojnë të drejtën:
1. Të refuzojnë të njohin një divorc ose ndarje ligjore ndërmjet dy bashkëshortëve, të cilët në kohën e divorcit ose ndarjes ligjore, ishin shtetas të shtetit në të cilin kërkohet njohja, dhe e asnjë shteti tjetër, dhe një ligj tjetër përveç atij të treguar nga rregullat e së drejtës

private ndërkombëtare të shtetit të njohjes është aplikuar, përveç kur rezultati i arritur është i njëjtë me atë që do të ishte arritur duke zbatuar ligjin e treguar nga këto rregulla;

2. Të refuzojnë të njohin një divorc kur, në kohën që ai është marrë, të dyja palët kishin vendbanimin e zakonshëm në shtete, të cilat nuk e parashikojnë divorcin. Një shtet që përdor rezervën e përcaktuar në këtë paragraf, nuk mund të refuzojë njohjen me zbatimin e nenit 7.

Neni 20

Shtetet kontraktuese, ligji i të cilave nuk parashikon divorcin jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojnë të drejtën për të mos njohur divorc, nëse në datën që ai është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas i një shteti, ligji i të cilit nuk e parashikon divorcin. Kjo rezervë ka efekt vetëm për aq kohë sa ligji i shtetit që e përdor atë nuk e parashikon divorcin.

Neni 21

Shtetet kontraktuese, ligji i të cilave nuk parashikon ndarjen ligjore, jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojnë të drejtën për të refuzuar njohjen e një ndarjeje ligjore, kur në kohën që ajo është marrë, njëri nga bashkëshortët ishte shtetas i një shteti kontraktues, ligji i të cilit nuk e parashikonte ndarjen ligjore.

Neni 22

Shtetet kontraktuese mund, herë pas here, të mund deklarojnë se disa kategori personash, që kanë shtetësinë e tyre, nuk duhet të konsiderohen shtetas të tyre për qëllimet e kësaj konvente.

Neni 23

Nëse një shtet kontraktues ka më shumë se një sistem ligjor në çështjet e divorcit ose ndarjes ligjore, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë se kjo konventë shtrihet në të gjitha sistemet e saj ligjore ose vetëm në një ose më shumë prej tyre, dhe mund të ndryshojë deklaratën e tij, duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë pas kësaj. Këto deklarata do t'i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës dhe deklarojnë shprehimisht sistemet ligjore për të cilat zbatohet konventa. Shtetet kontraktuese mund të refuzojnë të

njohim një divorc ose ndarje ligjore nëse, në datën në të cilën kërkohet njohja, konventa nuk është e zbatueshme për sistemin ligjor, sipas të cilit është marrë divorci ose ndarja ligjore.

Neni 24

Kjo konventë zbatohet pavarësisht nga data në të cilën është marrë divorci ose ndarja ligjore. Megjithatë, një shtet kontraktues, jo më vonë se koha e ratifikimit ose aderimit, mund të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar këtë konventë për një divorc ose ndarje ligjore të marrë para datës në të cilën, në lidhje me atë shtet, konventa hyn në fuqi.

Neni 25

Çdo shtet, jo më vonë se momenti i ratifikimit ose aderimit, mund të bëjë një ose më shumë rezerva të përmendura në nenet 19, 20, 21 dhe 24 të kësaj konvente. Asnjë rezervë tjetër nuk lejohet. Secili shtet kontraktues, gjithashtu, kur njoftohet një shtrirje e konventës në përputhje me nenin 29, mund të bëjë një ose më shumë rezerva të tilla, me efektin e saj të kufizuar në të gjitha ose në disa nga territoret e përmendura në shtrirje. Secili shtet kontraktues në çdo kohë mund të tërheqë një rezervë që ka bërë. Një tërheqje e tillë i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës. Një rezervë e tillë pushon së pasuri fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 26

Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet e përfaqësuara në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private. Ajo ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 27

Kjo konventë hyn në fuqi në ditën e gjashtëmbëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit të përmendur në paragrafin e dytë të nenit 26.

Konventa hyn në fuqi për çdo shtet nënshkrues që e ratifikon më pas në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit.

Neni 28

Çdo shtet që nuk është përfaqësuar në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, i cili është anëtar i kësaj konference ose i Kombeve të Bashkuara, ose i një agjencie të specializuar të asaj organizate, ose i një pale të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mund të aderojë në këtë konventë, pasi ajo të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 27.

Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës. Konventa hyn në fuqi për një shtet që aderon në të në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të aderimit. Aderimi ka efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit aderues dhe atyre shteteve kontraktuese, pasi kanë deklaruar pranimin e tyre të aderimit. Një deklaratë e tillë depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës; kjo Ministri u përcjell, nëpërmjet kanaleve diplomatike, një kopje e vërtetuar secilit prej shteteve kontraktuese. Konventa hyn në fuqi ndërmjet shtetit aderues dhe shtetit që ka deklaruar pranimin e tij të aderimit në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të deklaratës së pranimit.

Neni 29

Çdo shtet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë se kjo konventë shtrihet në të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare, për të cilat ai është përgjegjës, ose në një ose më shumë prej tyre. Një deklaratë e tillë hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të konventës për shtetet në fjalë. Në çdo kohë pas kësaj, shtrirje të tilla i njoftohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës. Shtrirja ka efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet me këto shtete kontraktuese, pasi kanë deklaruar pranimin e tyre të shtrirjes. Një deklaratë e tillë depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës; kjo Ministri u përcjell, nëpërmjet kanaleve diplomatike, një kopje të vërtetuar secilit prej shteteve kontraktuese. Shtrirja hyn në fuqi në çdo rast gjashtëdhjetë ditë pas depozitimit të deklaratës së pranimit.

Neni 30

Kjo konventë mbetet në fuqi për pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 27, edhe për shtetet, të cilat e kanë ratifikuar atë ose kanë aderuar në të më pas. Nëse nuk ka

pasur asnjë denoncim, ajo rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet. Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të periudhës pesëvjeçare. Ajo mund të kufizohet në disa nga territoret për të cilat zbatohet konventa. Denoncimi ka efekt vetëm në lidhje me shtetin, i cili e ka njoftuar atë. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 31

Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës njofton shtetet e përmendura në nenin 26 dhe shtetet që kanë aderuar në përputhje me nenin 28, për sa më poshtë:

a) nënshkrimet dhe ratifikimet e përmendura në nenin 26;
b) datën në të cilën kjo konventë hyn në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 27;
c) aderimet e përmendura në nenin 28 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
d) shtrirjet e përmendura në nenin 29 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;
e) denoncimet e përmendura në nenin 30;
f) rezervat dhe tërheqjet e përmendura në nenet 19, 20, 21, 24 dhe 25;
g) deklarimet e përmendura në nenet 22, 23, 28 dhe 29.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullit për këtë, kanë nënshkruar këtë konventë. Bërë në Hagë, në ditën e parë të qershorit, 1970, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e qeverisë së Holandës dhe nga e cila, një kopje e vërtetuar i dërgohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit prej shteteve të përfaqësuara në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private

LIGJI

Nr. 9270, datë 29.7.2004

PËR SISTEMIN E ADRESAVE

(Nryshuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016; nr. 53/2024, datë 30.5.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 112 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(Ndryshuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016; shtuar togfjalësh dhe ndryshuar fjalë me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e krijimit e të administrimit të sistemit kombëtar të adresave, si dhe kriteret për vendosjen e adresës së saktë e unike për çdo ndërtesë, apartament dhe truall të lirë brenda juridiksionit të bashkisë në territorin e Republikës së Shqipërisë të integruar në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA).

Neni 1/1

(Shtuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008, ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3 me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 53, datë 30.5.2014; ndryshuar pika 1, 4 dhe fjalë në pikën 2, shtuar togfjalësh në pikën 2 dhe pikat 5, 6, 7 dhe 8 me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Adresa" është një seri informacioni i standardizuar, që përbëhet nga fjalë dhe numra, të renditura sipas një rregulli të caktuar, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti ose të një trualli të lirë. Ajo formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe numra arabë.
2. "Bulevardi", "rruga", "rrugica", "sheshi" dhe "parku" janë zona të qarkullimit civil pjesë të territorit publik, që shërbejnë si referencë për përshkrimin e vendndodhjes së saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti dhe të një trualli të lirë brenda juridiksionit të bashkisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Shfuqizuar.
4. Regjistri Kombëtar i Adresave (RKA)" është baza e vetme e të dhënave shtetërore në të cilin regjistrohen e përditësohen të dhënat për adresën, sipas elementeve të saj, për çdo ndërtesë, apartament dhe truall të lirë.
5. "Tabela e emërtimit" është treguesi fizik i emërtimit të zonës së qarkullimit civil.
6. "Tabela e numërtimit" është treguesi fizik i numërtimit të brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesës në zonën e qarkullimit civil.
7. "Kodi unik i adresës" është një vlerë unike, që përkon me elementet përbërëse të adresës, e cila shërben për të identifikuar në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese, hyrjeje dhe apartamenti në brendësi të saj në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA).
8. "Pika e interesit (PI)" është vendndodhja specifike me interes publik, e shprehur në RKA nëpërmjet adresës së saj.

Neni 2

(Ndryshuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008 me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; shtuar fjalë në pikën 1, hequr fjalë në shkronjën d) të pikës 1dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Adresa shërben për të identifikuar në mënyrë të saktë e unike vendndodhjen në terren e çdo ndërtese, apartamenti apo trualli të lirë, në shkallë vendi, dhe përbëhet nga këto elemente:
   a) emri i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në të cilën ndodhet ndërtesa;
   b) emri i njësisë administrative, në të cilën ndodhet ndërtesa;
   c) emri i qytetit ose fshatit ku ndodhet ndërtesa;
   ç) emri i bulevardit/rrugës/rrugicës/sheshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa dhe përcaktohet vetëm me njërin nga elementet e

mësipërme. Emri formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe numra arabë, por jo vetëm me numra;

d) numri rendor i ndërtesës. Ky numër rendor mund të jetë:

i) një numër natyror;

ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);

dh) numri i hyrjes, që shërben për identifikimin e hyrjes në të njëjtën ndërtesë. Ky numër rendor mund të jetë:

i) një numër natyror;

ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);

e) numri i apartamentit, që shërben për identifikimin e një banese/biznesi në një hyrje të ndërtesës. Ky numër rendor mund të jetë:

i) një numër natyror;

ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);

ë) kodi postar, i miratuar.

2. Radha e vendosjes së elementeve të adresës, algoritmi, struktura e kodit unik të adresës dhe përdorimi i tij përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008 dhe ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Emërtimi i bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit bashkiak, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen, ndërsa numërtimi i ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve bëhet nga strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore në bashkitë/njësitë administrative, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen.

Neni 4

Sistemi i adresave zbatohet për çdo lloj ndërtese, pavarësisht nga destinacioni i saj, për banim ose jo (hotel, zyrë, qendër tregtare ose komunikacioni, ndërtesë industriale, arsim, muzeum, spital etj.), si dhe pavarësisht nga vendndodhja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4/1

(Shtuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008; shfuqizuar pikat 1 dhe 3 me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Shfuqizuar.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Adresave.
3. Shfuqizuar.

Neni 4/2

Përmbajtja e RKA-së

(Shtuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. RKA-ja përmban informacion tekstual dhe gjeohapësinor për sistemin e adresave dhe për pikat e interesit për çdo bashki.
2. RKA-ja përbëhet nga të dhëna parësore e dytësore, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4/3

Dhënësit e informacionit në RKA

(Shtuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Dhënës informacioni janë strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore, të cilat kryejnë edhe përditësimin e RKA-së.
2. Strukturat përgjegjëse, sipas pikës 1 të këtij neni, japin e përditësojnë rregullisht të gjithë informacionin në RKA për pjesë të territorit publik dhe ndërtesat nën juridiksionin territorial të tyre, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4/4

Niveli i aksesit të RKA-së

(Shtuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Të dhënat publike aksesohen lirisht nga çdo person në faqen zyrtare të RKA-së.
2. Të dhënat parësore, të përcaktuara në nenin 4/2 të këtij ligji, konsumohen nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit nga bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

KREU II
KRITERET PËR EMËRTIMIN E ADRESËS

Neni 5

1. Çdo bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park ka vetëm një emër të caktuar.
2. Nuk lejohet që në të njëjtin qytet ose fshat të ketë më shumë se një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park me të njëjtin emër. Bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet ose parqet mbajnë emrin e caktuar në të gjithë gjatësinë e tyre.

Neni 6

1. Në rrugën me një dalje vendoset emër i veçantë, kur në të ka mbi 10 banesa ose kur në planin rregullues parashikohet dalje në një rrugë tjetër. Kërkesa, sipas kësaj pike, zbatohet edhe në fshatra.
2. Për rrugicat me një dalje ose me më pak se 10 banesa përdoret emri i rrugës ku ato kanë dalje.

Neni 7

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Standardet dhe rregullat për emërtimin e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve e parqeve, nga autoritetet përgjegjëse, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III
RREGULLAT PËR NUMËRTIMIN E ADRESËS

Neni 8

Ndërtesat e çdo bulevardi, rruge, rrugice, sheshi ose parku, që kanë një emër të caktuar, duhet të kenë një numër rendor të veçantë.

Neni 9

1. Për të bërë numërtimin e ndërtesave të një bulevardi, rruge, rrugice, sheshi ose parku më parë caktohen vendndodhja dhe kufijtë e tyre.
2. Për bulevardet ose rrugët kryesore, që takohen në qendrën e qytetit, si pikë e nisjes merret pikërisht qendra e qytetit.

Neni 10

Numërtimi i ndërtesave bëhet si më poshtë:

a) për rrugët kryesore, që nuk përfshihen në nenin e mësipërm, dhe për të gjitha rrugët dytësore, merret si pikë nisjeje, ekstremi lindor ose jugor i rrugës, në mënyrë që numrat të vazhdojnë nga Lindja në Perëndim, nga Jugu në Veri, nga Verilindja në Jugperëndim dhe nga Juglindja në Veriperëndim, por jo edhe në drejtim të kundërt;

b) në qytetet ose fshatrat, që përshkohen nga një lumë ose që ndodhen në buzë të detit a liqenit, mund të merret si pikë nisjeje lumi, deti ose liqeni;

c) duke u nisur nga pika e nisjes së bulevardit, rrugës, rrugicës, sheshit ose parkut, ndërtesave, në krahun e majtë të drejtimit të tyre, u vihen numra tek 1, 3, 5, 7, 9 etj., ndërsa atyre në krahun e djathtë numra çift 2, 4, 6, 8 e kështu me radhë;

ç) ndërtesave, që ndodhen në rrugica me një dalje dhe që vlerësohen si vazhdim i një rruge, u vihen numra rendorë që i përkasin krahut të majtë ose të djathtë të kësaj rruge, nga e cila fillon rrugica e verbër. Kur rrugica pa dalje ka një emër më vete, ndërtesat që ndodhen në të dyja anët e kësaj rrugice marrin numër rendor të veçantë.

Neni 11

Adresim numerik i jashtëm i një ndërtese është numri, që merr ajo kur ka vetëm një dalje në rrugë, pavarësisht se mund të jetë banesë e vetme ose kolektive.

Neni 12

Ndërtesat shumëkatëshe, me apartamente, zyra, hapësira dyqanesh duhet të kenë edhe adresim të brendshëm, pavarësisht nga numri i vendosur në hyrjen e përbashkët.

Neni 13

Çdo ndërtese, që ka një portë të vetme si dalje në rrugë ose në oborrin rrethues, i vihet një numër rendor i vetëm.

Neni 14

(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008 dhe nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

1. Në qoftë se një ndërtesë ka dy ose më shumë hyrje që dalin në një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, të cilat përdoren për hyrje dhe dalje, secilës hyrje i vihet një numër natyror ose dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit.
2. Hyrje e parë, quhet hyrja që ndodhet në krah të majtë nëse qëndrojmë me fytyrë nga ndërtesa në drejtim të hyrjes në ndërtesë.

Neni 15

Kur një ose më shumë ndërtesa janë brenda një muri rrethues dhe kanë një dalje të përbashkët në bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, secilës prej ndërtesave u vihet një numër rendor i veçantë.

Neni 16

Ndërtesës, që ka dalje në dy ose më shumë bulevarde, rrugë, rrugica, sheshe ose parqe të ndryshme, i vihet në çdo portë (hyrje) numri rendor i ndërtesës korresponduese të bulevardit, rrugës, rrugicës, sheshit ose parkut, në anë të së cilës gjendet fasada e ndërtesës.

Neni 17

1. Kur ndërsat kanë dyqane, punishte ose lokale të ndryshme, të cilat kanë hyrje të veçanta, që dalin në bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, çdo dyqani, lokali ose punishteje i vihet një numër i veçantë. Në rast se këto dyqane, punishte apo lokale kanë më tepër se një portë (hyrje), këtyre portave (hyrjeve), që janë të të njëjtit dyqan, lokal ose punishte dhe po në atë rrugë, u vihet secilës i njëjti numër.
2. Po në mënyrën e mësipërme u vihet nga një numër edhe të gjitha ndërtimeve të përkohshme (barrakave), qosheve, që gjenden gjatë drejtimit të një rruge, rrugice, sheshi ose parku, e kur këto janë të grumbulluara, në çdo 16 metra gjatësi rruge, marrin një numër të vetëm, por me fraksion.

Neni 18

Trojet, që ndodhen ndërmjet dy ndërtesave në rrugët e qytetit dhe që kanë fasadën në një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, u rezervohet nga

një numër rendor për 16 metra hapësirë të lirë ndërmjet dy ndërtesave. Në rrugët ku trojet janë të ndara në parcela, për çdo parcelë rezervohet nga një numër i veçantë.

Neni 19

Ndërtesave të mëdha, që janë të ndara brenda në formë apartamenti për daljet në bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, u vihet numër, njësoj si të gjitha ndërtesave të tjera.

Neni 20

1. Ndërtesës, që shërben si pjesë ndihmëse e ndërtesave (për banim ose jo) nuk u vihet numër i veçantë.
2. Objekteve industriale që janë të vendosura ngjitur me ndërtesat e banimit ose me zyrat dhe që kanë formën e ndërtesave më vete, u vihen numra.

Neni 21

(Ndryshuar pika 3, me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008)

1. Në ato fshatra ku nuk ka mundësi të bëhet emërtimi i rrugëve, numërtimi i ndërtesave bëhet sipas lagjeve, nëse këto janë larg njëra-tjetrës.

2. Kur fshati është i grumbulluar, numërtimi i banesave fillon dhe mbaron me një numër rendor të vetëm për të gjitha ndërtesat, që gjenden në atë fshat, duke filluar nga numri 1 dhe duke vazhduar deri në fund pa ndërprerje.

3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë aktet nënligjore për të përcaktuar rregulla të hollësishme për emërtimin dhe numërtimin e ndërtesave dhe të rrugëve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 22

Ndërtesat që ndodhen brenda kufijve të një qyteti, por jashtë pikave të shtrirjes së planit rregullues në fuqi dhe kur nuk ka një sistem rrugësh të rregullta, numërtohen duke filluar nga numri 1 dhe me radhë, deri në ndërtesën e fundit, në mënyrë të njëjtë, sipas sistemit të caktuar për fshatrat.

Nëse vende të tilla nuk kanë emra të caktuar, u vihet nga një emër, sipas mënyrës së treguar në këtë ligj.

Neni 23

1. Ndërtesave, që ngrihen pas përfundimit të numërtimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, u vihen numrat që u janë lënë rezervë trojeve, ku janë ngritur ndërtesat.
2. Ndërtesave, të cilat janë ngritur në trojet tek të cilat nuk janë parashikuar numra rezervë ose numrat rezervë janë të pamjaftueshëm, u vihen numrat e ndërtesave më të afërta me fraksione si, për shembull, 5/1, 5/2, 5/3 e me radhë.

Neni 24

Nëse dy ose më shumë ndërtesa, që kanë pasur numra të veçantë, transformohen në një ndërtesë të vetme, kësaj ndërtese i vihen të gjithë numrat që kishin ndërtesat e para si, për shembull, 120-126 ose 15-19.

Neni 25

(Ndryshuar me ligjin nr. 9951, datë 10.7.2008; numërtuar pika 1 dhe shtuar pika 2 me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Tabelat për emërtimin e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe numërtimin e ndërtesave, të hyrjeve dhe apartamenteve janë standarde brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Rregullat për vendosjen e tabelave të numërtimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të ministrit përgjegjës për çështjet vendore.

Neni 26

1. Tabelat me emërtimin që kanë marrë bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet ose parqet vendosen së paku në një largësi prej 2 metrash e gjysmë në qoshet e ndërtesave që ndodhen në fillim ose në mbarim të tyre.
2. Kur bulevardi ose rruga ndërpritet nga një bulevard ose rrugë tjetër kryesore, shesh apo park, ose kur bulevardi apo rrugët janë të gjata, tabelat mund të vendosen edhe në pika të tjera të dukshme përgjatë vazhdimit të bulevardit ose rrugës.

Neni 27

Lloji i materialit të tabelave, përmasat e tyre, si dhe formati i shkrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

(Ndryshuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Shpenzimet për vendosjen e tabelave të emërtimeve të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe të numërtimit të ndërtesave publike dhe private, sipas hyrjeve dhe apartamenteve në përbërje të tyre, përballohen nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 29

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; ; ndryshuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të bëjnë emërtimet e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve ekzistuese të paemërtuara, brenda datës 31 dhjetor 2016.
2. Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative duhet të bëjnë adresimin numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese, brenda datës 31 dhjetor 2016.
3. Nëse njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk përmbushin detyrimet ligjore të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, ato përmbushen nga prefekti i qarkut, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29/1

Procesi i emërtimit

(Shtuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore, identifikojnë zonat e qarkullimit civil të paemërtuara dhe informojnë kryetarin e bashkisë. Kryetari i bashkisë është i detyruar të sigurojë emërtimin e çdo zone të qarkullimit civil të paemërtuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Bashkia vendos tabelat e emërtimit për zonën e qarkullimit civil, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga miratimi i këtij ligji, sipas informacionit në RKA.
3. Kryetari i bashkisë kontrollon dhe raporton për ecurinë e procesit të emërtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 29/2
Procesi i numërtimit
(Shtuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Strukturat përgjegjëse në autoritetet për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore, identifikojnë ndërtesat, hyrjet dhe apartamentet e panumërtuara dhe informojnë kryetarin e bashkisë/njësisë administrative. Kryetari i bashkisë është i detyruar të sigurojë numërtimin e çdo ndërtese, hyrjeje ose apartamenti të panumërtuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.
2. Bashkia/njësia administrative vendos tabelat e numërtimit fizik të ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga miratimi i këtij ligji, sipas informacionit në RKA.
3. Kryetari i bashkisë/njësisë administrative kontrollon dhe raporton për ecurinë e procesit të numërtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 30
(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Vënia në shfrytëzim e bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve, që ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqërohet, detyrimisht, me emërtimin përkatës, të bërë nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me propozimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 31
(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore/

njësisë administrative përkatëse detyrohen të përcaktojnë adresë të plotë për objektin që në momentin e dhënies së lejes së ndërtimit.

Neni 32
(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; ndryshuar shkronja a) dhe b) dhe togfjalësh me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Shkelja ose mosrespektimi i detyrimit ligjor, nga personat përgjegjës në strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në bashki, si nivel i parë i vetëqeverisjes vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuar në:

a) nenet 29/1 dhe 29/2 të këtij ligji, shkelja ose mosrespektimi i detyrimit ligjor nga personat përgjegjës, sipas këtyre neneve, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park të paemërtuar, si dhe për çdo ndërtesë, hyrje ose apartament të panumërtuar;
b) nenin 31 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Neni 33
(Ndryshuar me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

Gjobat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të nenit 32, vendosen nga drejtori i përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe mund të ankimohen në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 33/1
Nxjerrja e akteve nënligjore
(Shtuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016; shtuar pikat 3, 4 dhe 5 me ligjin nr. 53/2024, datë 30.5.2024)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendim, në zbatim të neneve 5 dhe 7 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike të nxjerrë udhëzim, në zbatim të pikës 2, të nenit 3, të këtij ligji.

3. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 4/2, pika 2, dhe 4/3, pika 2, të këtij ligji brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore miratojnë aktin nënligjor, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 7, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
5. Ministri përgjegjës për gjendjen civile miraton aktin nënligjor, të përcaktuar në pikën 3, të nenit 3, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 34
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 4295, datë 2.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJI
Nr. 14/2016

PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E ADRESËS SË SHTETASVE SHQIPTARË QË JETOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi
Qëllimi i këtij ligji është identifikimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e veprimit
1. Ky ligj zbatohet për shtetasit shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj pa ndërprerje ose për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, në një vit kalendarik.
2. Nuk janë subjekte të këtij ligji personeli i ngarkuar me detyra shtetërore dhe familjarët e tyre.

Neni 3
Përkufizime
Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Programi i regjistrimit të adresës" është pjesë përbërëse e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, i cili përmban të dhëna për shtetasit

shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj pa ndërprerje ose për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, në një vit kalendarik.

2. "Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile" është dokumenti sipas përkufizimit të bërë në pikën 1, të nenit 2, të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar.
3. "Regjistrimi i adresës" është regjistrimi i adresës së banimit të shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

Neni 4

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti përgjegjës për krijimin dhe administrimin e programit të regjistrimit të adresës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile.
2. Autoritetet përgjegjëse për plotësimin e të dhënave në këtë program janë ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile, nëpërmjet nëpunësit të zyrës së gjendjes civile në bashki, dhe ministria që mbulon shërbimin konsullor, nëpërmjet nëpunësit të autorizuar të përfaqësisë diplomatike dhe konsullore.

KREU II

IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI

Neni 5

Identifikimi i adresës së shtetasve

1. Identifikimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet nëpërmjet vetëdeklarimit *on-line* dhe nga autoritetet përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.
2. Procesi i përpunimit të të dhënave personale i shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë identifikimin, vetëdeklarimin dhe regjistrimin e të dhënave

në programin e regjistrimit të adresës, kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Forma dhe përmbajtja e formularit tip të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe ministrit që mbulon shërbimin konsullor.

Neni 6

Identifikimi i adresës së shtetasve nëpërmjet vetëdeklarimit

1. Pas njoftimit të detyrimit ligjor të vetë-deklarimit të adresës, sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj, shtetasi plotëson formularin tip të vetëdeklarimit të publikuar në faqen zyrtare të autoriteteve përgjegjëse ose pranë zyrave përkatëse.
2. Shtetasi informohet, nëpërmjet faqes zyrtare të autoriteteve përgjegjëse dhe formularit tip të vetëdeklarimit, për qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale.
3. Në rast vetëdeklarimi të adresës nga shtetasi në mënyrë elektronike, autoriteti përgjegjës konfirmon adresën e deklaruar nga shtetasi, nëpërmjet shërbimit postar. Autoritetet përgjegjëse nuk kryejnë asnjë veprim për regjistrimin e adresës së vetëdeklaruar, deri në konfirmimin e saj, nga shërbimi postar.
4. Rregullat për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës, procedura e plotësimit dhe e dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit, dokumentet shoqëruese të tij, si dhe administrimi i tyre nga autoritetet përgjegjëse miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Identifikimi i adresës së shtetasve nga autoritetet përgjegjëse

Kur shtetasi paraqitet pranë zyrës së gjendjes civile në bashki ose në përfaqësinë diplomatike dhe konsullore për të përfituar shërbimet që ofrojnë këto zyra, nëpunësi përgjegjës ka detyrimin të verifikojë nëse është regjistruar adresa e këtij shtetasi në programin e regjistrimit të adresës.

Neni 8
Identifikimi dhe regjistrimi i adresës

1. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki ose nëpunësi i autorizuar i përfaqësisë diplomatike dhe konsullore, të cilit i është dorëzuar, në njërën prej dy mënyrave, formulari i vetëdeklarimit, i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, verifikon identitetin e shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim në legjislacionin për gjendjen civile.
2. Kur të dhënat e verifikuara përputhen me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, nëpunësi kryen menjëherë regjistrimin e adresës së shtetasit që jeton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në programin e regjistrimit të adresës.
3. Në rast se konstatohen mospërputhje të të dhënave të vetëdeklaruara nga shtetasi, me përbërësit e gjendjes civile të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, nëpunësi konstatues, sipas rastit, njofton shtetasin për saktësimin e të dhënave të kërkuara.
4. Veprimet për identifikimin dhe regjistrimin e adresës nga nëpunësit përgjegjës kryhen sipas manualit të miratuar për këtë qëllim nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 9
Njoftimi dhe afatet

1. Autoritetet përgjegjëse, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, njoftojnë shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për detyrimin e vetëdeklarimit të adresës pranë autoriteteve përgjegjëse.
2. Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë detyrimin e deklarimit fillestar të adresës pranë autoriteteve përgjegjëse, brenda 180 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Në rast ndryshimi të adresës, shtetasi deklaron adresën e re brenda 60 ditëve nga data e lidhjes së kontratës së qirasë apo shitblerjes së objektit të banimit, si dhe çdo dokument tjetër që provon ndryshimin e adresës.

KREU III
SHËRBIMET E AUTORITETEVE

Neni 10
Shërbimet e ofruara nga autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse i ofrojnë shtetasit shqiptar, në adresën e vetëdeklaruar dhe të konfirmuar, këto shërbime:
   a) shërbime të gjendjes civile;
   b) shërbime të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore.
2. Këshilli i Ministrave miraton shërbime të tjera që i ofrohen shtetasit shqiptar, që jeton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në adresën e vetëdeklaruar dhe të konfirmuar.

KREU IV
SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 11
Sanksionet administrative

1. Autoritetet përgjegjëse, brenda dhe jashtë territorit të Republikës Shqipërisë, në rast konstatimi të mospërmbushjes së detyrimit për deklarimin e adresës së shtetasit dhe të regjistrimit të saj, pezullojnë kryerjen e shërbimit të kërkuar, derisa shtetasi të përmbushë detyrimin ligjor të vetëdeklarimit të adresës, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.
2. Bëjnë përjashtim nga pika 1, e këtij neni, shërbimet me karakter humanitar që përfaqësitë diplomatike dhe konsullore u ofrojnë shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendim, në zbatim të pikës 4, të nenit 6, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe të pikës 2, të nenit 10, të këtij ligji.
2. Ngarkohen ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe ministri që mbulon shërbimin konsullor që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin urdhër, në zbatim të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji.
3. Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile, që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji.
4. Efektet financiare për zbatimin e këtij ligji përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.2.2016

Shpallur me dekretin nr. 9457, datë 8.3.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MANUAL

PËR VETËDEKLARIMIN E ADRESËS SË SHTETASVE SHQIPTARË TË CILËT JETOJNË JASHTË TERITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

1. HYRJE

Ky manual do të shërbejë si udhëzues për të gjithë përdoruesit që do të përdorin portalin e identifikimit dhe regjistrimit të adresës së shtetasve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Portali do të krijojë mundësinë e kryerjes së veprimeve nga ana e nëpunësve përgjegjës.
Pas deklarimit të të dhënave, nga ana e shtetasve objekt i detyrimit, në këtë portal, përdoruesi ka mundësinë të printojë direkt formularin për deklarimin e adresës, duke ia vënë në dispozicion shtetasit sipas kërkesës së tij.

Rolet në portal:

Në portal operon nëpunësi përgjegjës si operator *back office*:

- nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki
- nëpunësit e autorizuar të përfaqësive diplo-matike e konsullore të Shqipërisë.


Nëpunësit përgjegjës do të pajisen me kredenciale të posaçme për të përdorur portalin (emër dhe fjalëkalim).

2. PREZANTIM ME PORTALIN

Portali *online* që do të vijë në ndihmë të shtetasve shqiptarë për deklarimin e adresës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



Në faqen kryesore do t'iu jepet mundësia për të vijuar me deklarimin e adresës, duke plotësuar fushat ku deklaron me saktësi informacionet e tij personale lidhur me vendbanimin e tij aktual.




Në fund të formularit jepet mundësia për të **shtuar** anëtarët e tjerë të familjes, të cilët jetojnë në të njëjtin apartament me të njëjtat të dhëna rreth adresës së banimit.



Pas plotësimit me sukses të të gjitha të dhënave, qytetari duhet të shtypë te butoni "REGJISTRO" për të kryer deklarimin me sukses.




Për sa i përket ambientit të punës së punonjësit, ai duhet të logohet në sistem për të parë dhe për të konfirmuar deklarimet e realizuara nga qytetarë të ndryshëm. Për t'u loguar në sistem, mjafton të klikohet në menunë "HYR" në faqen kryesore të adresarit.




Më pas punonjësi duhet të plotësojë kredencialet përkatëse dhe të logohet në sistem me anë të butonit "LOGIN".



Ndërfaqja e parë që do t'ju shfaqet pas logimit është paraqitur më poshtë.




Në fushën e deklarimit të adresave do të paraqiten qartë deklarimet e adresave ndaj të cilave mund të ndërmerrni disa vendime.






Ky aplikim mund të refuzohet ose të vendoset në statusin "në proces" me anë të butonave në anën e djathtë të secilit aplikim.


Në momentin e vendosjes në proces ose të refuzimit të aplikimit, një dritare dialoguese shfaqet për të dhënë një shënim mbi veprimin e ndërmarrë.




Pas vendosjes me sukses "në proces", në ndërfaqe do të shfaqet statusi aktual i aplikimit.




Në momentin e vendosjes "në proces" të aplikimit, këtij aplikimi i gjenerohen dy kode unike automatikisht, të cilët mund të shihen në ndërfaqen INFO.




Ambasada i dërgon me **postë** qytetarit **kodin e verifikimit** dhe, në këtë mënyrë, i lë atij mundësinë e konfirmimit të adresës. Pas marrjes së kodit të verifikimit me anë të postës, qytetari drejtohet përsëri në faqen kryesore të adresarit dhe klikon në rubrikën **"KONFIRMO ADRESËN".**





Pasi plotësohen fushat përkatëse, klikohet në butonin "**KONFIRMO**" për të konfirmuar adresën. Pas konfirmimit në panelin e *admin*-it, ndryshohet automatikisht statusi i aplikimit.




3. VEPRIMET QË DO TË KRYHEN NGA PUNONJËSI PËRGJEGJËS NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE

3.1 Si mund të hyni në sistem dhe fushat e kërkimit


Vendosim emrin e përdoruesit, i cili është: emër.mbiemër@moi.gov.al
Poshtë tij vendosim fjalëkalimin që ju është caktuar. Më pas do t'ju shfaqet një tjetër tabelë që do t'ju kërkojë të ndryshoni fjalëkalimin. Te kutia e parë do të vendosni fjalëkalimin që ju ishte caktuar, kurse te dy kutitë e tjera një fjalëkalim që ju preferoni dhe që e mbani mend lehtë.



Pasi t'i plotësoni këto fusha, do t'ju shfaqet kjo pamje:




Këtu keni dy mënyra për t'u futur në sistem: mjedisi i testimit dhe mjedisi i *Production*-it. Nëse klikon te Regjistri Kombëtar i Shtetasve, kalon direkt në *Production*. Pra, këtu, të gjitha veprimet që ju kryeni ruhen në sistemin real të Regjistrit Kombëtar. Nëse klikoni te Regjistri Kombëtar i Shtetasve-Test, mund të kryeni çfarëdo veprim që dëshironi të provoni dhe nuk ruhet në sistemin real të regjistrit, pra, është mjedis thjesht për të testuar. Pasi klikojmë në njërin nga këto mjedise, na shfaqet kjo pamje:



Kjo është fusha e kërkimit. Siç shihet, mënyrat e kërkimit janë të shumta. Mirë është nëse do të kishit sa më shumë të dhëna për një person në mënyrë që të ngushtohet fusha e kërkimit dhe të dalin sa më pak shtetas me ato të dhëna. Nëse ju keni vetëm emrin dhe mbiemrin si të dhëna, mund të dalin më shumë se një person me ato të dhëna, varet sipas rastit. Në këtë mënyrë do të jetë procedurë më e gjatë deri në gjetjen e personit të kërkuar. Për këtë arsye, është mirë të kesh më shumë se 2 të dhëna.


Ekziston edhe një mënyrë, e cila përdoret në rastet kur emri ose mbiemri nuk është i qartë. Për këto raste veprohet si më poshtë:



Në rastin kur emri ose mbiemri nuk është i qartë ose i sigurt, mund të vendosni vetëm tri shkronjat e para dhe pastaj të vendosni simbolin*. Kjo do të thotë që, pas shkronjës së tretë, sistemi kërkon të gjithë emrat ose mbiemrat që fillojnë me ato tri shkronja. Por, për t'i shërbyer sa më shpejt qytetarit, është mirë të keni sa më shumë të dhëna për të kërkuar.


Një mënyrë unike dhe e shpejtë është nëse keni numrin personal të personit, sepse, nëse e kërkoni me numër personal, del menjëherë ai person që kërkoni - numri personal është unik dhe i përket vetëm një personi.


3.2 Si të plotësojmë adresën e shtetasve shqiptarë me banim jashtë Shqipërisë



Pasi kemi klikuar tek opsioni "Kërko", do të shfaqen 1 ose më shumë shtetas me ato të dhëna. Pasi kemi gjetur personin e duhur, do ta përzgjedhim dhe do të klikojmë te rubrika "Ndrysho vendbanim":

Pasi kemi klikuar "Ndrysho vendbanim", do të shfaqet pamja si më poshtë:





Te "Lloji i vendbanimit" do të përzgjedhim "Vendqëndrim jashtë shtetit", pasi shtetasi jeton jashtë Shqipërisë. Në çastin që klikojmë atë opsion, na aktivizohen fushat në të djathtë ku shkruhet "Adresa jashtë vendit":

- Pjesëtarët e familjes (nëse ka anëtare të tjerë në certefikatën familjare)
- Nr. Tel
- E-mail
- Deklaruesi

Fushat që duhet të plotesohen nga aplikanti janë:

- Shteti
- Kodi postar
- Qyteti
- Rruga
- Numri
- Elementë të tjerë të adresës

Ngarkoni dokumentin që dëshmon ekzistencën e adresës së deklaruar * *(Dokumenti zyrtar i shtetit ku jetoni në të cilin dallohet qartë emri i aplikuesit dhe adresa e plotësuar në këtë formular)*

Dokumenti duhet të jetë në formatin JPG, JPEG dhe jo më i madh se 500 KB.

Pranoni vërtetësinë e dokumentit dhe të dhënave të plotësuara për personin tuaj dhe anëtarët e familjes dhe klikoni butonin "***Dërgo***" për të përfunduar aplikimin.

VENDIM

Nr. 915, datë 4.11.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR NJOFTIMIN E DETYRIMIT PËR VETËDEKLARIM TË ADRESËS NGA SHTETASIT SHQIPTARË, QË JETOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PROCEDURËS SË PLOTËSIMIT E TË DORËZIMIT TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT DHE TË DOKUMENTEVE SHOQËRUESE TË TIJ, ADMINISTRIMIN E TYRE NGA AUTORITETET PËRGJEGJËSE, SI DHE TË SHËRBIMEVE TË TJERA QË OFROJNË KËTO AUTORITETE NDAJ SHTETASVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 4, e 10, pika 2, të ligjit nr. 14/2016, "Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe dokumenteve shoqëruese të tij, administrimin e tyre nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të shërbimeve të tjera që ofrojnë këto autoritete ndaj këtyre shtetasve.
2. Në kuptim të këtij vendimi, "deklarues" konsiderohet çdo shtetas shqiptar me vendbanim të përhershëm jashtë vendit, që aplikon për deklarimin e vendbanimit të tij dhe marrjen e shërbimeve të ofruara.
3. Shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë aplikojnë për plotësimin e formularit tip të vetëdeklarimit nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin *e-Albania*, sipas procedurës së përcaktuar në manualin që i bashkëlidhet këtij vendimi.
   Forma dhe përmbajtja e formularit tip të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Brendshëm e të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

4. Shtetasit shqiptarë mbajnë përgjegjësi administrative për mospërmbushje të detyrimit ligjor të vetëdeklarimit të adresës së tyre dhe autoritetet përgjegjëse, në rast konstatimi të mospërmbushjes së këtij detyrimi, pezullojnë kryerjen e shërbimit të kërkuar, derisa shtetasi të përmbushë detyrimin ligjor të vetëdeklarimit të adresës.
5. Deklaruesi identifikohet në mënyrë të sigurt në portalin *e-Albania*, duke përdorur numrin personal në pasaportë ose në letërnjoftimin elektronik, të lëshuara nga Republika e Shqipërisë.
6. Deklaruesi plotëson formularin e deklarimit të adresës me të dhënat e adresës së saktë në shtetin ku ka vendbanimin e përhershëm, për veten e tij dhe/ose edhe për anëtarët e së njëjtës certifikatë familjare, në rastin kur ata jetojnë me deklaruesin.
7. Deklaruesi, bashkë me formularin, paraqet çdo dokument zyrtar, i cili provon gjeneralitetet e shtetasit dhe adresën e plotësuar në formular, të njohur nga autoritetet e vendit ku jeton.
8. Të dhënat e formularëve të dërguar verifikohen nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile, nëse janë në përputhje me të dhënat e deklaruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
9. Autoritetet përgjegjëse i ofrojnë shtetasit shqiptar, në adresën e vetëdeklaruar e të konfirmuar, këto shërbime:
   a) shërbime të gjendjes civile;
   b) ushtrim të së drejtës së votës, në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
10. Në rast ndryshimi të adresës, shtetasi deklaron adresën e re brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës së qirasë apo e shitblerjes së objektit të banimit, si dhe çdo dokument tjetër që provon ndryshimin e adresës.
11. Njoftimi i detyrimit ligjor të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet përgjegjëse bëhet nëpërmjet:
    a) publikimit në portalin qeveritar *e-Albania*;
    b) publikimit në faqet zyrtare elektronike të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
    c) programeve, reklamave dhe spoteve për transmetim nga operatorë radiotelevizivë, fletëpalosjeve, takimeve me përfaqësues të shoqatave shqiptare jashtë vendit dhe të organizatave ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e emigrantëve.

12. Vendimi nr. 405, datë 4.7.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që do të ndiqen për këtë qëllim", shfuqizohet.
13. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Shërbimi elektronik "Vetëdeklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"

Manuali i përdorimit

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
2020

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Regjistrimi në portalin *e-Albania*
3. Përdorimi i shërbimit

1. Hyrje


Ky manual do të shërbejë si udhëzues për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kryejnë procedurën e regjistrimit/identifikimit në portalin qeveritar *e-Albania* dhe të përdorin shërbimin elektronik "Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", i cili iu mundëson kryerjen e deklarimit të adresës së banimit me të dhënat e sakta në shtetin ku ata jetojnë. Formulari i vetëdeklarimit elektronik mund të plotësohet nga shtetasit për deklarimin e adresës së tyre personale ose dhe për anëtarët e së njëjtës familje, në rastin kur ata jetojnë në të njëjtin vendbanim me deklaruesin.

2. Regjistrimi në portalin qeveritar *e-Albania*


Në mënyrë që të përftoni shërbimet elektronike të ofruara nga portali qeveritar *e-Albania* duhet të identifikoheni në llogarinë tuaj në portal. Nëse nuk dispononi një llogari në portalin *e-Albania*, duhet të ndiqni udhëzimet si në vijim:

Regjistrimi në portal kryhet sipas hapave të mëposhtëm:


- Aksesoni portalin *e-Albania,* sipas URL-së: https://e-albania.al/.
- Klikoni "Regjistrohu"



- Shkruani tekstin në CAPTCHA në mënyre që të verifikoni që jeni person real. Më pas klikoni butonin "Vazhdo" për të përfunduar procesin e regjistrimit.



Plotësoni të gjitha të dhënat e kërkuara:



- Kodi i përdoruesit është numri personal i kartës suaj të identitetit (NID).
- Fjalëkalimi: Sigurohuni që fjalëkalimi të ketë të paktën 7 karaktere.
- *Email:* Në këtë adresë do të vijnë të gjitha njoftimet që kanë të bëjnë me aplikimet tuaja.
- Numri i celularit.
- Të dhënat personale (Emër Mbiemër Atësi). Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile.

** Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë" ose "ç".*


Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civile do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni me helpdesk në login@e-albania.al .

3. Përdorimi i shërbimit


Shërbimi elektronik "Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë" iu mundëson shtetasve shqiptarë, të cilët janë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të kryejnë vetëdeklarimin e adresës së banimit me të dhënat e sakta në shtetin ku ata jetojnë. Formulari i vetëdeklarimit elektronik mund të plotësohet nga shtetasit për deklarimin e adresës së tyre personale ose dhe për anëtarët e së njëjtës familje, në rastin kur ata jetojnë në të njëjtin vendbanim me deklaruesin.


Për vetëdeklarimin e adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, qytetari duhet të ndjekë këta hapa:


- Aksesoni portalin *e-Albania,* sipas URL-së: https://e-albania.al/.



- Nëse nuk jeni i regjistruar në portal, ju duhet të regjistroheni duke ndjekur udhëzimet në seksionin 2 të këtij manuali.
- Nëse jeni aktualisht i regjistruar në portal identifikohuni si qytetar nëpërmjet NID/Fjalëkalim *(Password)*







- Pasi jeni identifikuar kërkoni shërbimin *"Deklarimi i adresës së shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"* dhe pasi të lexoni hapat e nevojshëm të procedurës, klikoni butonin *"PËRDOR"*.




Figura 1.2 Aksesimi i shërbimit online

Për të vijuar me kryerjen e aplikimit klikoni butonin *"Krijo aplikim të ri"*



Figura 1.3 Krijimi i një aplikimi të ri

- Pasi hapet formulari i aplikimit plotësoni të dhënat e detajuara të adresës së vendbanimit që jetoni aktualisht:




Figura 1.4 Formulari i aplikimit

- Të dhënat që do të plotësohen automatikisht nga ndërveprimi i sistemeve janë si më poshtë:

  - Emri/ Mbiemri
  - NID
  - Datëlindja

  - Pjesëtarët e familjes (nëse ka anëtare të tjerë në certefikatën familjare)
  - Nr. Tel
  - E-mail
  - Deklaruesi

- Fushat që duhet të plotesohen nga aplikanti janë:

  - Shteti
  - Kodi postar
  - Qyteti
  - Rruga
  - Numri
  - Elementë të tjerë të adresës

- Ngarkoni dokumentin që dëshmon ekzistencën e adresës së deklaruar * *(Dokumenti zyrtar i shtetit ku jetoni në të cilin dallohet qartë emri i aplikuesit dhe adresa e plotësuar në këtë formular)*

  Dokumenti duhet të jetë në formatin JPG, JPEG dhe jo më i madh se 500 KB.

- Pranoni vërtetësinë e dokumentit dhe të dhënave të plotësuara për personin tuaj dhe anëtarët e familjes dhe klikoni butonin "***Dërgo***" për të përfunduar aplikimin.

LIGJ

Nr. 113/2020

PËR SHTETËSINË

(Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2023, datë 2.5.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja "b", e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, procedurave dhe rregullave për fitimin, rifitimin e humbjen e shtetësisë shqiptare.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Fëmijë" është i njëjti kuptim sipas përkufizimit të bërë në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
b) "Ministri" është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
c) "Ministria" është ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
ç) "Natyralizim" është mënyra e fitimit të shtetësisë shqiptare nga çdo person i huaj apo pa shtetësi, që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe shpreh dëshirën për të qenë shtetas shqiptar.
d) "Origjinë" është lidhja familjare në vijë të drejtë deri në tri shkallë e kërkuesit me të paralindurin me shtetësi shqiptare.

dh) "Person pa shtetësi" ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 9057, datë 24.04.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Statusin e Personave pa Shtetësi".
e) "Refugjat dhe person në mbrojtje plotësuese" është i njëjti kuptim sipas përkufizimit në ligjin për azilin në Republikën e Shqipërisë.
ë) "Shtetësi shqiptare" është lidhja e qëndrueshme juridike ndërmjet një personi dhe shtetit shqiptar, që shprehet në të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e ndërsjella e që nuk tregon origjinën etnike të personit.

Neni 3
Parimet

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare bazohet në parimet e mëposhtme:

a) të drejtën e çdo personi për të gëzuar të paktën një shtetësi;
b) shmangien e pashtetësisë;
c) askujt nuk i mohohet apo hiqet në mënyrë arbitrare shtetësia shqiptare;
ç) mosdiskriminimin e shtetasve shqiptarë, pavarësisht nëse ata janë shtetas që nga lindja apo e kanë fituar shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

KREU II
FITIMI, RIFITIMI DHE HUMBJA E SHTETËSISË SHQIPTARE

Neni 4
Mënyrat e fitimit të shtetësisë

Shtetësia shqiptare fitohet me:

a) lindje;
b) origjinë;
c) lindje në territorin e Republikës së Shqipërisë;
ç) natyralizim;
d) birësim.

Neni 5

Fitimi i shtetësisë me lindje

Kushdo që lind, duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare dhe regjistrohet si shtetas shqiptar. E drejta për t'u regjistruar si shtetas shqiptar nuk parashkruhet edhe pasi ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

Neni 6

Fitimi i shtetësisë me origjinë

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë origjinën shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë deri në tri shkallë e kërkuesit me të paralindurin.
2. Në këtë rast shtetasi paraqet kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare në bazë të origjinës dhe plotëson kriteret e përcaktuara në shkronjat "dh" dhe "ë" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.
3. Dokumentacioni i nevojshëm që provon origjinën shqiptare të kërkuesit përcaktohet me udhëzim të ministrit[24].

Neni 7

Fitimi i shtetësisë me lindje në territorin e Republikës së Shqipërisë

(shtuar pika 3 me ligjin nr. nr. 77/2023, datë 2.5.2024)

1. Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që mund të mbetet pa shtetësi fiton shtetësinë shqiptare
2. Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur ligjërisht përpara se fëmija të ketë mbushur moshën 14 (katërmbëdhjetë) vjeç dhe janë shtetas të huaj, ata mund të kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare të fëmijës, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi si pasojë e këtij veprimi.
3. Një fëmijë i lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të marrë shtetësi shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve.

[24] Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

Neni 8

Fitimi i shtetësisë me natyralizim

(ndryshuar shkronja e) e pikës 1 dhe pika 3, shtuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. nr. 77/2023, datë 2.5.2024)

1. Shtetësia shqiptare fitohet me natyralizim nga i huaji që ka paraqitur kërkesë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:
   a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;
   b) ka zotësi juridike për të vepruar;
   c) qëndron në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka përfituar leje të përhershme qëndrimi, të vlefshme në momentin e paraqitjes së kërkesës, sipas ligjit për të huajt;
   ç) ka banesë në përputhje me standardet e miratuara të banimit në Republikën e Shqipërisë;
   d) disponon të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë, që përkojnë me standardin minimal të jetesës, të indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të parashikuar në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
   dh) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike;
   e) zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, si dhe njohuritë bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilave gjuha shqipe është gjuhë zyrtare;
   ë) nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.
2. Në rast se personi është pa shtetësi, ai mund ta fitojë shtetësinë shqiptare nëse plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat "c", "dh" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni.

3. I huaji, që është i martuar me shtetas shqiptar për një periudhë jo më pak se 3 (tre) vjet, mund të paraqesë kërkesë për të fituar shtetësinë me natyralizim edhe nëse nuk plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat "c" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni, nëse ka banuar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën për 1 (një) vit gjatë gjithë periudhës së martesës.
4. I huaji, fëmija i mitur i të cilit ka shtetësi shqiptare, mund të paraqesë kërkesë për të fituar shtetësinë me natyralizim, edhe nëse nuk plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën "c" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni, nëse ka banuar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën për tre vjet.
5. Në rast se të dy prindërit fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tyre, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, kur jeton me prindërit, fiton shtetësinë shqiptare me kërkesën e prindërve dhe me pëlqimin e fëmijës kur është në moshën 14-18 (katërmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë) vjeç.
6. Në rast se njëri prej prindërve fiton shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tij, nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, fiton shtetësinë shqiptare nëse kërkohet nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve dhe fëmija ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë e, në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin. Përjashtohen rastet kur vërtetohet pamundësia objektive e prindit tjetër për të dhënë pëlqimin.
7. Dokumentacioni i nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim, sipas parashikimeve të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të ministrit[25].

Neni 9

Rastet e veçanta të fitimit të shtetësisë shqiptare

(Hequr togfjalësh në pikën 1 dhe shtuar pikën 1/1 me ligjin nr. nr. 77/2023, datë 2.5.2024)

1. Shtetësia shqiptare mund të fitohet nga shtetasi i huaj kur nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës

[25] Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

së Shqipërisë, edhe në rastet kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit.

1/1. Për shtetasin e huaj që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, shtetësia shqiptare sipas pikës 1 të këtij neni mund të fitohet vetëm me pëlqimin e të dy prindërve ose kujdestarit ligjor, si dhe të fëmijës që ka moshën 14-18 vjeç.

2. Për hartimin e programeve të veçanta, përcaktimin e rregullave specifike të kontrollit të veçantë të sigurisë dhe pastërtisë së figurës në standardet më të larta dhe monitorimin e zbatimit të tyre, krijohet një agjenci shtetërore e posaçme në varësi të ministrit. Organizimi dhe funksionimi i agjencisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave[26].
3. Kriteret për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, procedurat e aplikimit, rregullat e kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit dhe ministrave përgjegjës sipas fushës së tyre të përgjegjësisë[27].
4. Parashikimet e neneve 17 dhe 18 të këtij ligji nuk zbatohen në rastet e fitimit të shtetësisë sipas këtij neni.

Neni 10

Fitimi i shtetësisë me birësim

1. Fëmija i birësuar fiton shtetësinë shqiptare nëse birësuesi ka shtetësinë shqiptare.
2. Në rast birësimi nga dy bashkëshortë me shtetësi shqiptare të një fëmije me shtetësi tjetër ose pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare. Fëmija i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur vetëm njëri prej bashkëshortëve është shtetas shqiptar, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi si rezultat i birësimit.
3. Dokumentacioni i nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare me

[26] Vendim nr. 1008, datë 25.11.2020 " Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë së hartimit të programeve të veçanta të shtetësisë".

[27] Vendim nr. 135, datë 6.3.2024 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur republika e shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit".

birësim, sipas parashikimeve të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të ministrit[28].

Neni 11

Fitimi i shtetësisë nga refugjatët apo personat në mbrojtje plotësuese

(ndryshuar shkronja "dh" dhe "e" e pikës 1 me ligjin nr. nr. 77/2023, datë 2.5.2024)

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga refugjati apo personi në mbrojtje plotësuese, që ka paraqitur kërkesë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:
   a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;
   b) ka zotësi juridike për të vepruar;
   c) ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë nga dita e komunikimit të vendimit për dhënien e statusit nga autoriteti përgjegjës për azilin e refugjatët, sipas ligjit për azilin në Republikën e Shqipërisë;
   ç) ka banesë në përputhje me standardet e miratuara të banimit në Republikën e Shqipërisë;
   d) disponon të ardhura ose burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë;
   dh) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për veprat penale për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike.
   e) zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur e të shkruar, njohuritë bazë të historisë e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor.
   ë) nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.
2. Dokumentacioni i nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare për këtë kategori përcaktohet me udhëzim të ministrit.

[28] Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

Neni 12

Humbja e shtetësisë

1. Shtetësia shqiptare humbet në këto raste:
   a) me heqjen dorë, me kërkesë dhe kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 13 të këtij ligji;
   b) me heqjen e shtetësisë, pa kërkesë të shtetasit, në rastet e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.

Neni 13

Heqja dorë nga shtetësia

1. Një person mund të heqë dorë nga shtetësia shqiptare kur ka paraqitur kërkesë dhe plotëson kushtet e mëposhtme:
   a) ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;
   b) nuk mbetet pa shtetësi si rezultat i heqjes dorë nga shtetësia shqiptare;
   c) është rezident në një shtet të huaj;
   ç) ndaj tij nuk ka filluar ndjekja penale për veprat penale për të cilat, sipas legjislacionit penal shqiptar, parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 (pesë) vjet;
   d) nuk ka detyrime ligjore ndaj institucioneve publike, personave fizikë dhe juridikë;
   dh) ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare që mund të ketë ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijëve apo personave nën kujdestari, të cilët kanë shtetësinë shqiptare.
2. Dokumentacioni i nevojshëm për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare përcaktohet me udhëzim të ministrit[29].

Neni 14

Heqja dorë për fëmijën

1. Një fëmijë nuk do të gëzojë më shtetësinë shqiptare kur të paktën njëri nga prindërit ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe është dhënë pëlqimi i të dy prindërve.
2. Fëmija nuk e gëzon më shtetësinë shqiptare kur birësohet nga prindër të huaj dhe fiton shtetësinë e tyre.

29 Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

3. Nëse prindërit janë të divorcuar, kërkesa për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet nga prindi, të cilit i është lënë përgjegjësia prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, duke marrë pëlqimin e prindit tjetër. Pëlqimi i prindit tjetër nuk do të jetë i nevojshëm nëse ai nuk ka një vendbanim të regjistruar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj, nuk mund të kontaktohet për shkak të vendndodhjes së panjohur ose kur i është hequr përgjegjësia prindërore me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 15
Heqja e shtetësisë

1. Shtetësia shqiptare hiqet pa kërkesë në rastet si më poshtë:
   a) kur vërtetohet se shtetasi ka paraqitur dokumente të falsifikuara për fitimin e shtetësisë;
   b) kur shtetasi përkrah, kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, aktiviteti i të cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare dhe të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë.
2. Në rastin e heqjes së shtetësisë, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, shtetësia hiqet në bazë të informacioneve të verifikuara nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese dhe brenda një afati 10-vjeçar nga bërja e betimit.
3. Në rastin e heqjes së shtetësisë, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, shtetësia hiqet në bazë të informacioneve të verifikuara nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese apo kur shtetasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, vetëm për shtetasit që e kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim dhe nëse personi nuk rrezikon të mbetet pa shtetësi.
4. Shtetësia shqiptare sipas këtij neni hiqet me dekret të Presidentit të Republikës. Në këtë rast personi pushon së qenuri shtetas shqiptar në momentin e komunikimit të dekretit dhe, përjashtimisht, nëse nuk mund t'i komunikohet dekreti, pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.
5. Kundër dekretit për heqjen e shtetësisë shqiptare, shtetasi ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.
6. Heqja e shtetësisë shqiptare sipas këtij neni nuk ka efekt për fëmijët e shtetasit, të cilit i hiqet shtetësia.

Neni 16
Rifitimi i shtetësisë

Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe dëshiron ta rimarrë atë paraqet kërkesë për rifitimin e shtetësisë shqiptare sipas procedurës për fitimin e shtetësisë, të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, personi duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "dh" dhe "ë" të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.

KREU III
PROCEDURA PËR FITIMIN, RIFITIMIN DHE HUMBJEN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Neni 17
Paraqitja e kërkesës

(ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. nr. 77/2023, datë 2.5.2024)

1. Kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare dhe dokumentacioni i kërkuar sipas këtij ligji depozitohen online nëpërmjet platformës elektronike "e-albania".
2. Rregullat e detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës sipas këtij neni, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme[30].
3. Tarifa për kërkesën për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat. Në çdo rast, tarifa nuk mund të tejkalojë koston e shërbimit[31].

Neni 18
Shqyrtimi i kërkesës

1. Pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 1 të nenit 17 të këtij ligji, struktura vendore e Policisë së Shtetit kryen verifikimet e nevojshme

30 Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

31 Udhëzim nr. 271, datë 1.7.2021 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit për aplikim përfitimin,rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare".

për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike dhe, brenda një afati 1-mujor nga paraqitja e kërkesës, e dërgon kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë strukturës përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të shtetësisë në ministri.

2. Pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, misioni diplomatik apo posti konsullor dërgon kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, e cila, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve i përcjell për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse në ministri.
3. Me paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, ministria brenda 6 (gjashtë) muajve shqyrton dokumentacionin e paraqitur, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për nxjerrjen e dekretit. Procedura për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse përcaktohet me udhëzim të ministrit[32].
4. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, ministria brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve ua kthen strukturave dhe institucioneve të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, të cilat njoftojnë personin e interesuar brenda një afati 15-ditor. Pas plotësimit të dokumentacionit zbatohet procedura sipas pikës 3 të këtij neni.
5. Në rast se pas verifikimeve të kryera rezulton se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj, ministria nëpërmjet strukturave dhe institucioneve të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni njofton personin e interesuar për refuzimin e kërkesës. Refuzimi bëhet me akt administrativ të ministrit. Kundër këtij akti, personi që ka paraqitur kërkesën mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 19

Procedura e heqjes së shtetësisë

1. Ministria, pasi vihet në dijeni se një shtetas shqiptar është subjekt i rasteve të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji, bashkëpunon me

32 Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

institucionet përgjegjëse ligjzbatuese për verifikimin e informacionit, sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të ministrit[33].

2. Në përfundim të kryerjes së verifikimeve, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, ministria i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për nxjerrjen e dekretit për heqjen e shtetësisë.

Neni 19/1

E drejta për rishikim

(shtuar me ligjin nr. nr. 77/2023, datë 2.5.2024)

Akti administrativ, i cili vendos mospranimin e kërkesës për fitimin, rifitimin apo heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, mund të ankimohet pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi."

Neni 20

Dekreti për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë

1. Presidenti i Republikës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e propozimit nga ministria nxjerr dekretin përkatës dhe ia komunikon personit që ka paraqitur kërkesën, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Në rast se kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk janë të plota, i kthehen për plotësim strukturës përgjegjëse për trajtimin e çështjeve të shtetësisë në Ministrinë e Brendshme brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes.
2. Kopje e dekretit për fitimin, rifitimin ose lënien e shtetësisë shqiptare i dërgohet edhe Ministrisë së Brendshme për të kryer veprimet e nevojshme administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjendjen civile.
3. Dekreti botohet në Fletoren zyrtare.
4. Dekreti për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare regjistrohet në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore, për administrimin e të cilit respektohen dispozitat e legjislacionit për

33 Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

mbrojtjen e të dhënave personale, formati i të cilit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 21
Betimi

Personi që fiton shtetësinë shqiptare sipas këtij ligji, betohet para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.
Në rastet e fitimit të shtetësisë sipas nenit 9 të këtij ligji, betimi mund të kryhet edhe pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.

Neni 22
Afati për kryerjen e betimit

1. Dekreti për fitimin e shtetësisë shqiptare nuk do të ketë efekt nëse brenda 6 (gjashtë) muajve nga njoftimi i tij personi nuk është betuar sipas nenit 21 të këtij ligji.
2. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet në rast se, për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, personi e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin. Në këtë rast personi paraqet kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues pranë ministrisë për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit, por, në çdo rast, jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Procedura dhe dokumentacioni për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit përcaktohet me udhëzim të ministrit.
3. Kryerja e betimit bëhet sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin për gjendjen civile[34].

34 Udhëzim i përbashkët Nr. 228, datë 20.11.2024 "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit".

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 23
Dispozitë kalimtare

1. Kërkesat për fitimin, rifitimin apo lënien e shtetësisë shqiptare, të cilat janë paraqitur pranë Ministrisë së Brendshme dhe/ose misionit diplomatik, apo postit konsullor, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të trajtohen sipas ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar.
2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk ka apo nuk ka fituar shtetësi tjetër, rifiton shtetësinë shqiptare mbi bazën e kërkesës së paraqitur dhe dokumentacionit shoqërues, nëse nuk përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare. Në këtë rast kërkesa trajtohet sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 24
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë akt nënligjor në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 9 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë akt nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 6; të pikës 6 të nenit 8; të pikës 3 të nenit 10; të pikës 2 të nenit 11; të pikës 2 të nenit 13; të pikës 1 të nenit 17; të pikës 3 të nenit 18; të pikës 1 të nenit 19; të pikës 4 të nenit 20 dhe të pikës 2, të nenit 22, të këtij ligji.
3. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin akt nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 25
Shfuqizimi
Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", i ndryshuar, vendimi nr. 554, datë 3.7.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës" dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 26
Hyrja në fuqi
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Fletore zyrtare nr. 174, datë publikimi 29.09.2020

VENDIM

Nr. 1008, datë 25.11.2020

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË HARTIMIT TË PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë (në vijim AHPVSH), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit (në vijim ministri), me seli në Tiranë.
2. AHPVSH-ja ka buxhetin e vet, burimet e financimit, të cilat janë:
   a) buxheti i shtetit;
   b) të ardhura e krijuara nga tarifat dhe shërbimet e parashikuara në zbatim të programeve të veçanta sipas misionit të saj;
   c) donacione dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
3. AHPVSH-ja ka si mision përgatitjen e programeve të veçanta, përcaktimin e rregullave specifike të kontrollit të veçantë dhe të pastërtisë së figurës në standardet më të larta, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AHPVSH-së

4. AHPVSH-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.
5. AHPVSH-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para ministrit.
6. Struktura dhe organika e AHPVSH-së miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
7. AHPVSH-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:
   a) përgatit kriteret teknike të programeve të veçanta me interes kombëtar apo me interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj që investojnë në Shqipëri ose kontribuojnë në zhvillimin arsimor, shkencor, artistik-kulturor, ekonomik e sportiv të vendit dhe ia propozon për miratim autoritetit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
   b) përgatit kriteret teknike për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të përcaktuara në shkronjën "a", të kësaj pike, procedurat e aplikimit, rregullat e kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme dhe ia propozon për miratim autoritetit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
   c) përgatit rregulla specifike të kontrollit të veçantë dhe të pastërtisë së figurës në standardet më të larta të kontrollit, ia propozon për miratim autoritetit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, dhe ndjek e monitoron zbatimin e tyre;
   d) harton, implementon dhe administron programet e veçanta. Në bazë të procedurave ligjore përkatëse, nënshkruan marrëveshje me entitete të specializuara për hartimin, implementimin, administrimin, promovimin ndërkombëtar të programeve, ndërmjetësimin e aplikimeve, verifikimin e pastërtisë së figurave, si dhe çdo shërbim tjetër në funksion të hartimit dhe implementimit të programeve, bazuar ne eksperiencat më të mira ndërkombëtare;
   dh) shqyrton aplikimet për përputhshmërinë e kritereve për fitimin e shtetësisë, realizon verifikimet e kontrollet në lidhje me pastërtinë e figurës dhe, në rast të plotësimit të kushteve të përcaktuara në programet e veçanta të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, u përcjell autoriteteve kompetente propozimin për vendimmarrje;
   e) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të fushës së arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë e sportit për hartimin e programeve të veçanta me interes kombëtar;
   ë) kryen çdo detyrë tjetër që nuk bie ndesh me kompetencat e institucioneve të tjera shtetërore në përmbushje të misionit të saj.
8. Drejtori i Përgjithshëm i AHPVSH-së emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit. Drejtori i Përgjithshëm duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë pune në organet e administratës shtetërore.
9. Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca dhe kryen këto detyra:
   a) drejton aktivitetin e AHPVSH-së sipas objektivave politikë të Këshillit të Ministrave, planeve strategjike dhe programeve të performancës;
   b) miraton urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të AHPVSH-së dhe të aktivitetit në zbatim të legjislacionit për çështjet e shtetësisë;
   c) i paraqet ministrit për miratim kriteret e veçanta që duhet të plotësohen nga personeli i AHPVSH-së, rregullat për testimin e aftësive profesionale, si dhe planet për trajnimin e burimeve njerëzore;
   ç) emëron e liron personelin e AHPVSH-së;
   d) i paraqet ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit raportin vjetor për veprimtarinë e institucionit, si dhe raporte periodike;
   dh) i propozon ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit miratimin e tarifave të shërbimit, si dhe ndërmarrjen e nismës për rishikimin apo ndryshimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga AHPVSH-ja, me qëllim mbulimin e kostove të shërbimit dhe menaxhimin me eficiencë të të ardhurave;

e) përfaqëson ligjërisht AHPVSH-në në marrëdhënie me të tretët;
ë) propozon rregulloret që miratohen nga ministri përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit;
f) i paraqet ministrit përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit projektaktet që propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave me karakter individual dhe normativ;
g) detyra të tjera të parashikuara në ligje apo në akte nënligjore.

10. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AHPVSH-së miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet e shtetësisë dhe azilit, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.
11. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, të nëpunësve dhe të punonjësve të AHPVSH-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
12. AHPVSH-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e AHPVSH-së është në përputhje me përcaktimet e vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.
13. Vula e AHPVSH-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

14. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Fletore zyrtare nr. 221, datë publikimi 17.12.2020

VENDIM
Nr. 135, datë 6.3.2024

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE TË KËRKESËS, TË RREGULLAVE TË KRYERJES SË VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE KUR REPUBLIKA E SHQIPËRISË KA INTERES KOMBËTAR APO INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
PËRKUFIZIME

1. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
   a) "Program i veçantë i shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit", tërësia e dispozitave normative, e kritereve teknike, mbi bazën e të cilave një kontribut i një shtetasi të huaj në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit do të vlerësohet si kontribut me interes kombëtar për shtetin shqiptar dhe me anë të të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare;
   b) "Program i veçantë i shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës", tërësia e dispozitave normative, e kritereve teknike, kulturore dhe artistike, mbi bazën e të cilave një kontribut i një shtetasi të huaj do të vlerësohet si kontribut me interes në fushën e artit e të kulturës për shtetin shqiptar dhe me anë të të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare;
   c) "Program i veçantë i shtetësisë në fushën e interesit kombëtar", tërësia e dispozitave normative, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet kontributi i një shtetasi të huaj me interes kombëtar për shtetin shqiptar dhe me anë të cilit mund të fitohet shtetësia shqiptare;

ç) "Kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare", kërkesa e paraqitur nga kërkuesi për fitimin e shtetësisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi me prokurë, në bazë të formatit sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) "Kërkues", çdo shtetas i huaj, i cili plotëson kriteret teknike dhe kërkon për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta në fushat e arsimit, shkencës, sportit, artit apo kulturës;

dh) "Vlerësim kontributi", shkresa e arsyetuar, me anë të së cilës ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin ose artin dhe kulturën vlerëson kontributin e kërkuesit për t'u bërë pjesë e programeve të veçanta të shtetësisë.

KREU II

KRITERET PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE NË BAZË TË PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË ME INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Ka të drejtë të kërkojë për t'u përfshirë në programin e veçantë shtetasi i huaj (në vijim kërkuesi), që plotëson këto kritere:

1. Ka mbushur moshën 18 vjeç;
2. Ka zotësi për të vepruar;
3. Nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e vet, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike;
4. Nuk përbën kërcënim për sigurinë kombëtare dhe rendin publik të Republikës së Shqipërisë;
5. Nuk rezulton i regjistruar si person me rekorde kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë;
6. Deklaron se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga miratimi i kërkesës;
7. Ka kontribut të veçantë në fushat e arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit;

8. Nuk është subjekt i masave shtrënguese ndërkombëtare, të pranuara nga Republika e Shqipërisë.

KREU III

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR FORMËN DHE PARAQITJEN E KËRKESËS PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE NË BAZË TË PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

1. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare, në bazë të programeve të veçanta të shtetësisë, bëhet në bazë të formatit të kërkesës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet të këtij vendimi.
2. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyera me deklaratën e nënshkruar të përkthyesit zyrtar ose me vërtetim nga noteri.
3. Kërkesa për përfshirjen në programet e veçanta të shtetësisë paraqitet në Agjencinë për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë (në vijim "AHPVSH") nga vetë kërkuesi ose përfaqësuesi me prokurë.
4. Në çdo rast, kërkesa për fitimin e shtetësisë në bazë të programeve të veçanta të shtetësisë shqiptare, e paraqitur prej përfaqësuesit me prokurë në emër të kërkuesit duhet të nënshkruhet nga vetë kërkuesi për sa i përket të dhënave, deklarimeve të lidhura ngushtësisht me kërkuesin, në emër të të cilit paraqitet kërkesa.
5. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare duhet të përmbajë:
   a) emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuesit;
   b) tregimin e fakteve dhe të rrethanave që mbështesin kontributin, në bazë të programeve të veçanta për fitimin e shtetësisë.
6. Në rast se rezulton që kërkesa për fitimin e shtetësisë nuk përmban elementet e mësipërme, kjo përbën shkak për mospranimin e saj.

KREU IV

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR FITIMIN E SHTETËSISË, SIPAS PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË ME INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

1. Për të provuar plotësimin e kritereve, duhet të paraqiten këto dokumente:
   a) kërkesë individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare drejtuar AHPVSH-së, nënshkruar personalisht nga kërkuesi, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
   b) kopje e njësuar me origjinalin e dokumentit të identifikimit;
   c) Certifikatë personale e kërkuesit ose dokumenti i barasvlershëm, i lëshuar sipas legjislacionit të shtetit përkatës;
   ç) 3 (tri) fotografi, format dokumenti pasaporte, me përmasa 5 cm x 4 cm, të cilat duhet të jenë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e kërkesës, të marrë në plan me sfond të bardhë, të fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm;
   d) vetëdeklarim se nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë në shtetin e origjinës, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
   dh) vetëdeklarim se disponon mjete financiare të mjaftueshme për jetesë në Republikën e Shqipërisë, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit;
   e) vetëdeklarim se do të banojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të paktën 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) vjetëve nga miratimi i kërkesës, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit;
   ë) dëshmi për arritje të shquara në fushën përkatëse që kërkuesi sjell për shtetin shqiptar, lëshuar nga autoritetet kompetente, si kopje të çmimit/eve ose vlerësimit/eve ose titullit/ujve, nëse është e zbatueshme;

   f) rekomandime për merita dhe arritje të veçanta në fushën ku kërkuesi ka kontribut, sipas programeve të veçanta të shtetësisë, lëshuar nga autoritete kompetente ose nga personalitete të fushës apo çdo vlerësim ose rekomandim tjetër, që shërben në mbështetje të kërkesës;
   g) deklaratë se informacionet e dhëna prej tij janë të vërteta dhe të sakta, sipas formatit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, dhënë në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit, si dhe deklarimin se kërkuesi është i vetëdijshëm që deklarimi i të dhënave të rreme e ngarkon deklaruesin me përgjegjësi penale, sipas Kodit Penal, dhe nëse ndodh kjo, përbën shkak ligjor për heqjen e shtetësisë së dhënë.
2. Dokumentet origjinale ose, sipas rastit, kopjet e njësuara të tyre, lëshuar nga organet shtetërore të vendit të origjinës së kërkuesit, duhet të jenë të vërtetuara dhe të legalizuara, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.
3. Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta të shtetësisë, duhet të jetë lëshuar brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, afat vlefshmërie ky i përllogaritur nga dita e regjistrimit të kërkesës pranë AHPVSH-së, me përjashtim të dokumenteve që janë të pandryshueshme në përmbajtjen e tyre.
4. Kërkesat për shtetësi pranohen e përpunohen me kusht që të jenë paraqitur sipas formës së kërkuar, të përmbajnë gjenealitetet dhe nënshkrimin e kërkuesit, si dhe të shoqërohen me dokumentet e nevojshme e mandatpagesën, sipas tarifave të miratuara.

KREU V

PROCESI I VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË KËRKESAVE PËR FITIMIN E SHTETËSISË, SIPAS PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË ME INTERES NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS, ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

1. Pas depozitimit të kërkesës dhe dokumentacionit, AHPVSH-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve bën verifikimin paraprak për plotësimin e kushteve formale, të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi, si dhe verifikon nëse kërkuesi plotëson kërkesat teknike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit të paraqitur.

2. Në rast se kërkesa nuk plotëson kushtet formale ose kërkesat teknike apo ka mangësi në vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit, AHPVSH-ja ia kthen atë kërkuesit për plotësimin e të metave, brenda një afati prej jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditësh.
3. Pasi AHPVSH-ja verifikon paraprakisht se kërkesa i përmbush kushtet formale, plotëson kërkesat teknike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e dokumentacionit, kryen veprimet, si më poshtë vijon:
   a) kryen verifikimet përkatëse për sigurinë kombëtare dhe rendin publik në mënyrë zyrtare nëpërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
   b) i kërkon në mënyrë shkresore ministrisë përgjegjëse për arsimin, shkencën, sportin ose për artin dhe kulturën, në varësi të kontributit të kërkuesit, të vlerësojë kontributin e tij, duke i bashkëlidhur kopje të dëshmive dhe akteve të tjera vlerësuese të arritjeve të depozituara nga kërkuesi;
   c) ministria përgjegjëse brenda 7 (shtatë) ditëve nga kërkesa për vlerësim kontributi, i përcjell AHPVSH-së në mënyrë zyrtare shkresën e arsyetuar, me të cilin vlerëson se kontributi i kërkuesit përbën interes për shtetin shqiptar, sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi).
4. Në rast se ministria përgjegjëse vlerëson se kontributi i shtetasit të huaj përbën interes për Republikën e Shqipërisë, AHPVSH-ja vazhdon me procesin e shqyrtimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta të shtetësisë.
5. AHPVSH-ja, pasi shqyrton kërkesën lidhur me përputhshmërinë e kritereve teknike për fitimin e shtetësisë, vlefshmërinë dhe formën e rregullt ligjore të dokumentacionit, merr konfirmimet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente, si dhe vlerësimin pozitiv të kontributit të kërkuesit nga ana e ministrisë përgjegjëse, përgatit një relacion drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për plotësimin e kritereve ligjore nga ana e kërkuesit.
6. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit për plotësimin e kritereve ligjore, i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta.

7. Në rast se përgjigjet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente vlerësojnë se kërkuesi përbën kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare ose në rast se ministria përgjegjëse vlerëson se kontributi i kërkuesit nuk përbën interes në fushat e përcaktuara në këtë vendim për Republikën e Shqipërisë, AHPVSH-ja përgatit një relacion informues drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për mosplotësimin e kritereve teknike nga kërkuesi.
8. Ministri përgjegjës për rendin e sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit dhe konstatimit të mosplotësimit të kritereve teknike, refuzon kërkesën për fitimin e shtetësisë.
9. AHPVSH-ja njofton kërkuesin në adresën e deklaruar në formularin e kërkesës për refuzimin e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

KREU VI

RREGULLAT E KRYERJES SË VERIFIKIMEVE DHE KONTROLLEVE TË NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE KUR REPUBLIKA E SHQIPËRISË KA INTERES KOMBËTAR

1. Në rastet kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar, institucioni i Presidentit ose Kryeministria apo ente të autorizuara prej tyre paraqesin kërkesën për fitim shtetësie, sipas programeve të veçanta të shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme (AHPVSH), e cila duhet të përmbajë gjenealitetet e individit.
2. AHPVSH-ja kryen procedurën e përshpejtuar të verifikimeve përkatëse për sigurinë kombëtare dhe rendin publik në mënyrë zyrtare nëpërmjet Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. AHPVSH-ja, pasi merr konfirmimet zyrtare të verifikimeve të sigurisë dhe të pastërtisë së figurës nga autoritetet kompetente, përgatit një relacion drejtuar ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike për plotësimin e kritereve ligjore nga ana e kërkuesit.
4. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, pas vlerësimit të relacionit për plotësimin e kritereve ligjore, i përcjell Presidentit të Republikës propozimin për fitimin e shtetësisë shqiptare, sipas programeve të veçanta.

5. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë, sipas programeve të veçanta kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar, përfundon brenda 7 (shtatë) ditëve.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 6.4.2022, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit", të ndryshuar, dhe nr. 151, datë 11.3.2022, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e artit e të kulturës", shfuqizohen.
2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për arsimin dhe sportin, ministri përgjegjës për kulturën dhe Agjencia për Hartimin e Programeve të Veçanta të Shtetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E HARTIMIT TË PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË

KËRKESË PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, SIPAS PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË

ALBANIAN CITIZENSHIP APPLICATION THROUGH SPECIAL CITIZENSHIP PROGRAMS

Informacion i përgjithshëm Informacioni dhe dokumentacioni jo i plotë ose i rremë do të vonojë procesimin e kërkesës dhe mund të çojë në refuzimin e saj. Plotësoni me kujdes dhe nënshkruani kërkesën. Formulari i kërkesës së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet në Agjencinë e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë nga vetë kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor, dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. **Mbrojtja e të dhënave personale** Kontrolli, verifikimi dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuesit do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të shtetit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale. Kontrolli i të dhënave përfshin verifikimin e identitetit të kërkuesit dhe bashkëpunimin me organet kompetente lidhur me verifikimin e të dhënave ndaj kërkuesit. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat e njeriut dhe në veçanti të drejtën e respektimit të jetës private. **Ky formular do të pranohet nëse:** 1. Është plotësuar nga vetë kërkuesi, në dorëshkrim, me shkronja kapitale dhe pa korrigjime. 2. Nuk ka rubrika të paplotësuara. 3. Kërkuesi vendos emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin në fund të çdo faqeje	***General information:*** *Incomplete or false information and documentation will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Fill out the application carefully and sign it.* *The application form together with the accompanying documentation will be submitted to the Agency for Drafting Special Citizenship Programs by the applicant himself or his legal representative, by hand or through the postal service.* ***Protection of personal data:*** *The control, verification and processing of the applicant's personal data will be done in accordance with the legislation in force of the Albanian state for the protection of personal data.* *The control of the data includes the verification of the identity of the applicant and the cooperation with the competent bodies related to the verification of the data on the applicant.* *The legal processing of personal data is done respecting and guaranteeing human rights and in particular the right to respect for private life* ***This form will be accepted if:*** *1. It was completed by the applicant himself, in handwriting, with capital letters and without corrections.* *2. There are no unfilled columns.* *3. The applicant puts his name, surname and signature at the bottom of each page*

Seksioni I / Section 1	
Unë po paraqes kërkesën për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë për kontribut të veçantë në fushën e: *I am applying for Albanian citizenship through special citizenship programs for special contribution in the field of:* *a) arsim / education* □ *b) shkencë / science* □ *c) sport / sport* □ *d) art dhe kulturë / art and culture* □	
Seksioni II / Section 2	
Emri/ *Name:*	
Mbiemri/ *Surname:*	
Atësia/ *father's name*:	
Amësia/ *mothers name:*	
Datëlindja/ *date of birth*:	___/___/_____
Gjinia/ *Sex*:	M □ / F □
Gjendja civile/ *marital status*:	
Gjuha amtare/ *native language*:	
Dokument identifikimi / *ID*	Nr./No._____Datë/Date: ___/___/____
Shtetësia e vendit të origjinës/ *Nationality of country of origin*:	
Vendlindja/ Birthplace:	
Vendbanimi/ Residency:	
Email/ *e-mail:*	
Telefon/ *phone:*	
Shtetësi të tjera të fituara/ *Other citizenships acquired*:	
Shteti ku keni pasur qëndrim të ligjshëm 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e aplikimit/ *The country where you have had legal residence for the last 6 (six) months from the date of application:*	
Shtete të tjera ku keni pasur qëndrim të ligjshëm jo më pak se 6 (gjashtë) muaj brenda 3 (tre) viteve të fundit nga data e aplikimit/ *Other countries where you have had legal residence for no less than 6 (six) months within the last 3 (three) years from the date of application*:	

Seksioni III/ Section 3
Arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare/ *Reasons for applying for Albanian citizenship* Përshkruaj arsyet e aplikimit, faktet dhe rrethanat që mbështesin kërkimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë/ *Describe the reasons for the application, the facts and circumstances that support the search for the acquisition of Albanian citizenship through special citizenship programs:* _____ _____ _____ _____ _____

Seksioni IV / *Section 4* **Deklarime/** *Statements*
1. Deklarimi i prezencës në territorin e Republikës së Shqipërisë/ *Statement of presence in the territory of the Republic of Albania:*
Unë/ *I*_____ deklaroj se në zbatim të legjislacionit në fuqi të shtetit shqiptar, për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë për kontribut të veçantë, pas fitimit të shtetësisë shqiptare do të banoj në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë më të gjatë se 3 (tre) muaj gjatë 5 (pesë) viteve, në një banesë (pasuri të paluajtshme në shtetin shqiptar), të cilën do e disponoj/ *declare that in compliance with the legislation in force of Albania, for obtaining Albanian citizenship through Special Programs for a special contribution, I will reside in the territory of the Republic of Albania, for a period longer than 3 (three) months during 5 (five) years, in an apartment (real estate in the Albanian state) as stated below:* a) me kontratë qiraje/ *rent* □ b) me titull pronësie/ *own a property* □ c) tjetër/*other*. _____ □ Unë/ *I*_____ deklaroj se kam të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën në Shqipëri/ *declare that I have sufficent income to afford the living cost in Albania.*
2. Deklarim i gjendjes gjyqësore/ *Statement of Judicial Status*
Unë/ *I* _____ deklaroj që/ *Declare that:* Kam qenë/ *have been* □ / nuk kam qenë/ *have not been* □ i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë në shtetin e origjinës, në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie përveçse kur dënimi është dhënë për motive politike/ *Convicted by a final court decision in the country of origin, in the Republic of Albania or in any third country for criminal offenses for which Albanian law provides punishments of not less than 3 (three) years of imprisonment, except when the punishment it was given for political reasons.* Në rast dënimi ju lutem specifikoni/ *In case of convition please indicate*: Shtetin ku jeni dënuar/ *The state where you were convicted*: _____ Veprën penale/ *The criminal offense*: _____ Lloji i dënimit/ *type of conviction*: _____ Vendim/et gjyqësor i formës së prerë / *Final judicial decision/s* (Numër dhe data e vendimit/ *Number and date of the judicial decision*): _____ _____ (bashkëlidhni një kopje të vendimit/ *attach a copy of judicial decision*)
3. Deklarim për rekordet kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë/ *Statement on beoing registered as a person with a criminal record in the lists of international organizations, security partners*
Unë deklaroj që */ I declare that:* □ Kam qenë/ *I have been* □ Nuk kam qenë/ *I have not been* i regjistruar si person me rekorde kriminale në listat e organizatave ndërkombëtare, partnere të sigurisë/ *registered as a person with a criminal record in the lists of international organizations, security partners;*

4. Deklarime përfundimtare/ *Final declarations*:

Unë (emër, mbiemër) / *I (name, name)* _____

po paraqes kërkesën për fitimin e shtetësisë shqiptare sipas programeve të veçanta të shtetësisë dhe me anë të kësaj deklarate konfirmoj me nënshkrimin tim se:

i. pranoj me vullnetin tim të lirë dhe jap pëlqimin për mbledhjen, kontrollin, verifikimin, përpunimin e të dhënave të mia personale në kuadër të kërkesës time për fitimin e shtetësisë shqiptare.

ii. jam i vetëdijshëm që Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë rezervon të drejtën për të verifikuar çdo informacion personal lidhur me mua dhe mund të kryejë verifikime në bashkëpunim me organet ligjzbatuese për të marrë të dhëna për mua si kërkues.

iii. informacioni i paraqitur në këtë kërkese dhe dokumentacioni bashkëlidhur janë të vërteta dhe të sakta.

iv. jam i vetëdijshëm se dorëzimi i dokumentacionit të rremë dhe dhënia e informacionit personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e kërkesës time për fitimin e shtetësisë shqiptare në zbatim të legjislacionit në fuqi për shtetësinë shqiptare.

I am applying for Albanian citizenship according to the special citizenship programs and by means of this statement I confirm with my signature that:

i. *I accept of my own free will and give my consent to the collection, control, verification, processing of my personal data in the context of my request to obtain Albanian citizenship.*

ii. *I am aware that the Special Citizenship Programs Designation Agency reserves the right to verify any personal information about me and may conduct verifications in cooperation with law enforcement agencies to obtain data on me as an applicant.*

iii. *the information presented in this application and the accompanying documentation are true and correct.*

iv. *I am aware that submitting false documentation and providing false personal information in writing is a punishable offense under the Criminal Code in Albania and that false information may lead to the rejection of my application for Albanian citizenship pursuant to legislation in force for Albanian citizenship.*

Seksioni V / Section V
Dorëzimi i formularit të aplikimit dhe dokumentacionit /
Submission of application form and documentation

Ky formular dhe dokumentacioni bashkëlidhur do dorëzohet pranë Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë / *This application form and related documentation will be submitted to the Agency for Drafting Special Citizenship Programs:*

a) nga vetë aplikuesi / *by the applicant himself* □
b) nga përfaqësuesi me prokurë / *by the representative with power of attorney* □

Në rast të pikës b) specifikoni / *In case of point b) specify:*

Emër i përfaqësuesit / *Name of representative:* _____

Mbiemër i përfaqësuesit / *Surname of representative:* _____

Dokument identifikimi i përfaqësuesit / *Identification document of the representative:*

Nr. /*No* ___, datë/ *date* ___/___/_____

Nr. Akti i përfaqësimit / *No. Act of representation:* ___

Datë Akti i përfaqësimit / *Date of Act of representation:* ___/___/_____

Së bashku me këtë formular depozitohen dokumentet përmbledhëse sipas listës bashkëlidhur. ***/Along with this form, the summary documents are filed according to the attached list.***

ANEKS 2

Vlerësimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe sportin ose ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën do të përmbajë formatin e tekstit, si më poshtë vijon:

"Lënda: Mendim/vlerësim mbi kontributin për fitimin e shtetësisë Shqiptare, sipas programeve të veçanta të shtetësisë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. _____ datë_____, me lëndë "Mbi vlerësimin e kontributit në fushën e ____ për z./Znj. _____, i cili ka kërkuar të fitojë shtetësinë shqiptare nëpërmjet programeve të veçanta të shtetësisë", regjistruar në Ministrinë e _____ me nr. _____, datë_____ , ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:

Në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësisë", dhe të shkronjës "c", të pikës 3, të kreut V, të vendimit nr. ... të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të kërkesës, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare kur Republika e Shqipërisë ka interes kombëtar apo interes në fushën ë arsimit, shkencës, artit, kulturës dhe sportit", Ministria _____, pasi shqyrtoi dokumentacionin bashkëlidhur dhe duke vlerësuar ___ (P.sh.: CV, dëshminë, rekomandimin nga federata etj.) vlerëson së z/znj._____ përbën interes në fushën e _____, pasi kontributi i tij/saj në fushën e _____vlerësohet me interes për Republikën e Shqipërisë."

Fletore zyrtare nr. 221, datë publikimi 17.12.2020

UDHËZIM

Nr. 66, datë 04.02.2021

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË REGJISTRIT PËR REGJISTRIMIN E DEKRETIT PËR FITIMIN, RIFITIMIN DHE LËNIEN E SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 20, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë",

UDHËZOJ:

1. Dekretet për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare regjistrohen në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore.
2. Regjistri administrohet nga struktura përkatëse që trajton çështjet e shtetësisë.
3. Për qëllim të njohjes dhe të vijimit të procedurave për regjistrim/çregjistrim pranë zyrave të gjendjes civile, në këtë regjistër ka akses edhe zyra përkatëse në Drejtorinë e Gjendjes Civile. Zyra përkatëse ka akses me këtë regjistër, duke pasur statusin e njohjes.
4. Regjistri duhet të përmbajë:
   - numër dhe datë dekreti;
   - emër, atësi dhe mbiemër të personit;
   - për rastet e fitimit, shtetësinë e aplikuesit.
5. Të gjitha dekretet duhet të regjistrohen në regjistër nga struktura përgjegjëse, jo më vonë se 15 ditë pas ardhjes në Ministrinë e Brendshme.
6. Formati i regjistrit përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Ngarkohet struktura përkatëse në fushën e shtetësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

SHTOJCA 1

REGJISTËR I DEKRETEVE PËR FITIMIN, RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE					
Nr. dhe data e dekretit		Emër, atësi, mbiemër	Lloji i aplikimit	Shtetësia e aplikuesit	ZGJC e regjistrimit

REGJISTËR I DEKRETEVE PËR LËNIEN E SHTETËSISË SHQIPTARE				
Nr. dhe data e dekretit		Emër, atësi, Mbiemër	Lloji i aplikimit	ZGJC e çregjistrimit

Fletore zyrtare nr. 22, datë publikimi 11.02.2021

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 45, datë 12.04.2023

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR APLIKIM PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE NËPËRMJET PROGRAMIT TË VEÇANTË TË SHTETËSISË NË FUSHËN E ARTIT, KULTURËS, ARSIMIT, SHKENCËS DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", vendimit nr. 1008, datë 25.11.2020 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë" dhe të shkronjës "c" të pikës 1, të vendimit të nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZOJNË:

1. Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë janë si më poshtë:
   a) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës;
   b) tarifë për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës e sportit.
2. Tarifat e shërbimit (pagesat) për shërbimet e pikës 1 të këtij udhëzimi përcaktohen në shtojcën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve administrative.
4. Tarifa paguhet në emër të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë dhe derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.
5. Ngarkohen Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

SHTOJCË Nr. 1

Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë janë përkatësisht:

a) tarifa për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e artit dhe kulturës: 7 500 lekë;
b) tarifa për aplikimin për fitimin e shtetësisë shqiptare nëpërmjet programit të veçantë të shtetësisë në fushën e arsimit, shkencës e sportit: 7 500 lekë.

Fletore zyrtare nr. 66, date publikimi 19.04.2023

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 228, datë 20.11.2024

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR FITIMIN, HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS, TË PROCEDURËS PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, SI DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

I. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME ORIGJINË

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë origjinë shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, e kërkuesit me të paralindurit.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
b) certifikatë lindjeje/ekstrakt lindjeje/personale;
c) certifikatë familjare (për vendet që nuk e lëshojnë, të shoqërohet me dokument zyrtar justifikues);
ç) certifikatë apo çdo dokument tjetër mbi bazën e të cilit vërtetohet origjina shqiptare e kërkuesit, në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, qoftë edhe nga njëri prind;
d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër të aplikuesit dhe/ose të shtetit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;
dh) mandatpagesa.

1.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike.

II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE ME NATYRALIZIM

1. Shtetësia shqiptare fitohet me natyralizim nga i huaji mbi 18 vjeç me qëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;
c) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor (bëjnë përjashtim vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilëve gjuha shqipe është gjuhë zyrtare);
ç) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë (bëjnë përjashtim vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilëve gjuha shqipe është gjuhë zyrtare);
d) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);
dh) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);
e) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër të aplikuesit dhe/ose të shtetit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;
ë) mandatpagesa.

1.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë";

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Personi pa shtetësi mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim.

2.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të vet, të shtetit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;

c) mandatpagesa.

2.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë";

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

3. I huaji mbi 18 vjeç, i martuar me shtetas shqiptar mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë shqiptare, me natyralizim.

3.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

c) certifikatë martese;

ç) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale lidhur me banimin ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);

d) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);

dh) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

e) mandatpagesa.

3.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) lejeqëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (të paktën për një vit, gjatë të gjithë periudhës së martesës);

b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

c) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë";

ç) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

4. I huaji mbi 18 vjeç, fëmija i mitur i të cilit ka shtetësi shqiptare, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim.

4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;
c) certifikatë familjare (për vendet që nuk e lëshojnë, të shoqërohet me dokument zyrtar justifikues);
ç) certifikatë lindjeje të fëmijës me shtetësi shqiptare;
d) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin, ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);
dh) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);
e) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;
ë) mandatpagesa.

4.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
a) lejeqëndrimi të vlefshme në momentin e aplikimit, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit "Për shtetësinë", i ndryshuar;
b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 (tre) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;
c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;
ç) mendimi me shkrim i formuluar nga komisariati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, precedentin e tij penal (nëse ka);
d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

5. Fëmija i mitur, i dy prindërve që kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim, duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:
a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga të dy prindërit ku shprehet dhe pëlqimi i fëmijës kur është në moshën 14–18 vjeç, drejtuar strukturës vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit të vendbanimit të tij;
b) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
c) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë;
ç) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;
d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
dh) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur.
e) mandatpagesa.

5.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
a) dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet shqiptare, ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga të dy prindërit;
b) lejeqëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
c) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
ç) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
d) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç.

6. Fëmija i mitur i një prindi që ka fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim, duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:
   a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve (në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin me shkrim) dhe pëlqimi i fëmijës, kur është në moshën 14–18 vjeç, drejtuar strukturës vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit të vendbanimit të tij;
   b) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
   c) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë;
   ç) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;
   d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
   dh) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur;
   e) mandatpagesa.

6.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
   a) dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet shqiptare, ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga njëri prind;
   b) lejeqëndrimi të vlefshme në momentin e aplikimit, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
   c) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
   ç) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;
   d) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME BIRËSIM:

1. Në rast birësimi nga dy bashkëshortë me shtetësi shqiptare të një fëmije me shtetësi tjetër ose pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare. Fëmija i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur vetëm njëri prej bashkëshortëve është shtetas shqiptar, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi si rezultat i birësimit.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:
   a) kërkesë e bashkëshortëve drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
   b) akti i lindjes së fëmijës/certifikatë nga akti i lindjes;
   c) dokumenti, akti administrativ, mbi bazën e të cilit është vendosur për birësimin e fëmijës;
   ç) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur;
   d) mandatpagesa.

IV. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR FITIMIN E SHTETËSISË NGA REFUGJATËT APO PERSONA NË MBROJTJE PLOTËSUESE

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga refugjati, apo personi në mbrojte plotësuese mbi 18 vjeç, që ka paraqitur kërkesë, duke plotësuar dokumentacionin e mëposhtëm:
   a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
   b) dokument i cili vërteton se zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, njohuritë bazë të historisë e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor;
   c) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin, ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);
   ç) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

dh) Vendimi për njohjen e statusit (lëshuar nga autoriteti përgjegjës për Azilin, kopje e njësuar me origjinalin);

e) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) leje qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë nga data e marrjes së statusit;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

d) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë.

V. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare, kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) premtim nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument, ku konfirmohet shtetësia e një vendi tjetër;

c) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;

ç) certifikatë familjare e aplikuesit;

d) vërtetim i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

dh) vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

e) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka detyrime ndaj personave fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë;

ë) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare për bashkëshortin/bashkëshorten/fëmijën apo personat nën kujdestari;

f) dokument që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili i është premtuar shtetësia tjetër ose në vendin e shtetësisë tjetër;

g) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i formuluar nga komisariati i policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, precedentin e tij penal (nëse ka);

2. Për fëmijët e moshës 0–14 vjeç të paraqitet:

a) kërkesë e prindërve/kujdestarit ligjor, drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë ;

b) certifikatë lindjeje/personale e fëmijës me shtetësi shqiptare;

c) deklarata noteriale e të dy prindërve/kujdestarit ligjor (ose vetëm e njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie, ose shtetësi tjetër));

ç) mandatpagesa.

3. Për fëmijët e moshës 14–18 vjeç, kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë:

b) dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 1, të paragrafit V, të këtij udhëzimi;

c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve apo kujdestarit ligjor sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar), ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare i fëmijës së tyre.

VI. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:
   a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
   b) certifikatë lindjeje nga akti/personale dhe familjare;
   c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe nëse aktualisht është person pa shtetësi;
   ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;
   d) vërtetim banimi i lëshuar nga njësia administrative përkatëse;
   dh) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare;
   e) certifikatë lindjeje/vdekje e prindërve të aplikuesit;
   ë) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
   a) vërtetim i gjendjes gjyqësore, i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
   b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:
   a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
   b) certifikatë lindjeje nga akti/personale (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së fituar);
   c) certifikatë familjare (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së fituar);
   ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër që ka aplikanti dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;
   d) dokumentin i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;
   dh) dokumentin i cili vërteton shtetësinë e huaj;

   e) mandatpagesa.

2.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
   a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
   b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

VII. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, PËR PERSONAT QË BANOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Aplikimi për rifitimin dhe heqjen dore nga shtetësia shqiptare për shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë, ku ka vendbanim aplikuesi, ose në përfaqësinë diplomatike, e cila mbulon shtetin ku ka vendbanim aplikuesi, në rastet kur nuk ka përfaqësi diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë, të hapur aty.

VIII. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR HEQJE DORË TË SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare, kërkohen këto dokumente:
   a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
   b) premtimi nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument origjinal, ku konfirmohet shtetësia e një vendi tjetër. Në rast se personi ka fituar shtetësi tjetër, duhet të paraqesë kopje të njësuar të mjetit të identifikimit, që e vërteton atë;
   c) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;
   ç) certifikatë familjare e aplikuesit;
   d) vërtetim i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

dh) vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
e) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka detyrime ndaj personave fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë;
ë) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare për bashkëshortin/bashkëshorten/fëmijën apo personat nën kujdestari.
f) dokument që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili i është premtuar shtetësia tjetër ose në vendin e shtetësisë tjetër;
g) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
a) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;
b) certifikatë familjare e aplikuesit;
c) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

2. Për fëmijët 0–14 vjeç kërkohen këto dokumente:
a) kërkesa e prindërve ose kujdestarit/eve ligjorë për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
b) certifikatë lindjeje ose personale e fëmijës me shtetësi shqiptare;
c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie të shtetit të huaj));
ç) mandatpagesa.

3. Për fëmijët 14–18 vjeç kërkohen këto dokumente:
a) kërkesë individuale për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
b) dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 1, të paragrafit II, të këtij udhëzimi, për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;
c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njëri prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre).

IX. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:
a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
b) certifikatë lindjeje nga akti/personale dhe familjare;
c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe nëse aktualisht është person pa shtetësi;
ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;
d) vërtetim banimi i lëshuar nga njësia administrative përkatëse;
dh) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë aktuale personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia);
e) certifikatë lindjeje/vdekje e prindërve të aplikuesit;
ë) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
a) certifikatë lindjeje nga akti/personale dhe familjare;
b) vërtetim banimi i lëshuar nga njësia administrative përkatëse;
c) certifikatë lindjeje/vdekjeje e prindërve të aplikuesit;
d) vërtetim i gjendjes gjyqësore, i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
e) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;
f) mendimi me shkrim i formuluar nga komisariati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:
a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
b) certifikatë lindjeje nga akti/personale (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së huaj);

c) certifikatë familjare (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së huaj);
ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër që ka aplikanti dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;
d) dokumentin i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë aktuale personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia);
dh) dokumentin i cili vërteton shtetësinë e huaj (pasaportë, kartë identiteti, certifikatë natyralizimi/personale ose vërtetim nga bashkia/komuna);
e) mandatpagesa.

2.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:
a) certifikatë lindjeje nga akti/personale në Republikën e Shqipërisë;
b) certifikatë familjare në Republikën e Shqipërisë;
c) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;
d) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;
e) mendimi me shkrim i formuluar nga komisariati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në territorin e Republikës së Shqipërisë.

X. FORMA DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

1. Aplikimi për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt *online*, duke plotësuar të dhënat e kërkuara dhe duke ngarkuar *online* kërkesën individuale.
2. Aplikimi për heqje dorë nga shtetësia shqiptare në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore mund të kryhet nga vetë aplikuesi, nga prindi për fëmijën deri në moshën 18 vjeç, ndërsa për aplikimet brenda Republikës së Shqipërisë edhe nga përfaqësuesi me prokurë të posaçme.

3. Kërkesa individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, periudhën e ardhjes në Shqipëri, profesionin e ushtruar në shtetin e huaj dhe në Shqipëri. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.
4. Kërkesa individuale për rifitimin e shtetësisë shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, si dhe numrin dhe datën e dekretit me të cilin ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Gjithashtu, në kërkesë duhet të bëhet e qartë nëse kërkuesi ka fituar apo jo një shtetësi tjetër. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.
5. Kërkesa individuale për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.
6. Aplikimi për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj, bëhet nga vetë kërkuesi (për rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare nuk aplikohet nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme). Aplikimi për shtetësinë shqiptare është individual, përveç të miturve nën moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prindërit apo kujdestari ligjor i tyre.
7. Dokumentet për shtetësinë shqiptare pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin, pa gabime e pa korrigjime në përmbajtjen e tyre. Dokumentet e lëshuara nga shteti shqiptar, duhet të mos kapërcejnë gjashtë muajt e fundit nga data e lëshimit të tyre. Dokumentet pranohen në formën e tyre origjinale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë, pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit që i lëshon ato. Këto dokumente nuk kanë nevojë për vulë apostile apo legalizim nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme.
8. Në rastet e ndryshimit të gjeneraliteteve për personat që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe kanë fituar një shtetësi të huaj, të paraqitet dokument zyrtar i cili vërteton ndryshimin e gjeneraliteteve në shtetin e shtetësisë së huaj, i legalizuar/apostiluar, përkthyer dhe noterizuar.
9. Dokumentet të cilat gjenerohen nga sistemi *e-albania*, paraqiten të printuara dhe pranohen me vulë digjitale. Në rastet e aplikimit për heqje dorë dhe rifitim të kryera jashtë territorit të Republikës së

Shqipërisë, pranohen të printuara dhe të firmosura nga konsulli në Misionin Diplomatik dhe Postin Konsullor të Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara me procesverbalin e dokumenteve që përmban dosja e aplikuesit.

10. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë duhet të depozitojnë procesverbalin dhe dosjen e dokumenteve të aplikimit, brenda 1 (një) muaji nga data e dorëzimit pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila duhet të kalojë praktikën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Ministrinë e Brendshme.
11. Dokumentet e lëshuara nga administrata e shtetit të huaj duhet të jenë të legalizuara/ apostiluara sipas regjimit me shtetin përkatës.
    a) pranohen direkt dokumentet e përkthyera dhe noterizuara në Republikën e Shqipërisë;
    b) kur përkthimi i dokumenteve kryhet në shtetin e huaj, përkthimi vërtetohet në misionin diplomatik apo postin konsullor.
12. Data e lëshimit të tyre të mos kapërcejë gjashtë muajt e fundit, me përjashtim të dokumentit premtimi i shtetësisë dhe vërtetim banimi/ qëndrimi, të cilat kanë vlefshmëri 2 vjet. Në rastet kur për dokumentet e ardhura nga jashtë është i pamundur lëshimi i dokumentit origjinal, për shkak të legjislacionit, atëherë pranohen dokumentet e njësuara me akt noterial.
13. Afatet e vlefshmërisë së shqyrtimit të dokumenteve llogariten mbi bazën e datës së pranimit të tyre, nga drejtoria vendore e policisë ose misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë i akreditуar në shtetin ku ka vendbanimin deri në dekretim (përllogaritja e afateve të vlefshmërisë së dokumenteve fillon nga data e kryerjes së pagesës nga aplikuesi).

XI. PROCEDURA PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

1. Pas aplikimit për fitim, rifitim dhe heqje dorë nga shtetësia shqiptare nëpërmjet platformës elektronike *online*, struktura vendore e policisë së shtetit, verifikon saktësinë dhe rregullsinë e dokumentacionit të dorëzuar pranë saj.
2. Nëse dokumentacioni është i plotë dhe i saktë, struktura vendore e policisë së shtetit njofton aplikuesin nëpërmjet adresës elektronike mbi pranimin e aplikimit, si dhe i bashkëlidh faturën e arkëtimit mbi tarifën e shërbimit, të cilën pas kryerjes së pagesës në bankë, duhet

ta dërgojë nëpërmjet shërbimit postar së bashku me ato dokumente origjinale dhe/ose të noterizuara sipas kërkesave të këtij udhëzimi.
3. Në zbatim të këtij udhëzimi, procedurat e pranimit të kërkesave nga strukturat vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit, si dhe dhëniet e mendimit nga specialistët e policisë kriminale, përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
4. Për aplikimet për fitim dhe rifitim të shtetësisë shqiptare, struktura përgjegjëse për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, vijon me verifikimin e tyre pranë Shërbimit Informativ të Shtetit.
5. Për aplikimet për heqje dorë nga shtetësia shqiptare, struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, vijon me verifikimin e tyre, vetëm në rastet kur aplikimet përcillen nga misionet diplomatike apo postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Në këto raste, punonjësi përgjegjës, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, harton shkresën për çdo aplikues dhe e përcjell atë pranë drejtorisë vendore të policisë, sektori i rendit dhe i sigurisë publike.
6. Për heqjen e shtetësisë pa kërkesë, në rastet e përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, pas marrjes së informacionit, struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, përgatit shkresën së bashku me materialet përkatëse dhe përcjell për verifikime informacionet e marra në organet ligjzbatuese.

XII. PROCEDURA PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Personi që fiton shtetësinë shqiptare, pas botimit të dekretit të Presidentit në Fletoren Zyrtare, brenda gjashtë muajve, kryen betimin për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij.
2. Betimi për fitimin e shtetësisë shqiptare kryhet nga të gjithë personat, të cilëve u është miratuar fitimi i shtetësisë shqiptare, me përjashtim të atyre personave, të cilët janë në kushte të pamundësisë për t'u paraqitur në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësinë për arsye të justifikuara shëndetësore.

3. Me marrjen e njoftimit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga Institucioni i Presidentit të Republikës, personat që u është miratuar shtetësia shqiptare paraqesin në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative dokumentacionin e nevojshëm, të lëshuar nga vendi i origjinës, siç janë dokumentet: certifikatë personale, certifikatë familjare dhe certifikatë martese, të përkthyera në gjuhën shqipe, me vulën apostile ose të legalizuara.
4. Pas dërgimit të dekretit për fitim të shtetësisë shqiptare, zyrës respektive të gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, paracaktohet në shpallje të lirë publike, data dhe ora e betimit, e cila i korrespondon çdo dite të hënë.
5. Njoftimi për datën e kryerjes së betimit dërgohet në adresën e personit, të cilit i është dekretuar fitimi i shtetësisë shqiptare.
6. Në rastet e fitimit të shtetësisë, sipas nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, betimi mund të kryhet edhe pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.
7. Në përfundim të procedurës së betimit, zyra e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative kryen procedurat e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 dhe më pas personi që ka kryer betimin, efektivisht shtetas shqiptar, aplikon për pajisje me dokumentin e identifikimit, letërnjoftim dhe pasaportë.

XIII. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Në rast të moszbatimit të afatit 6-mujor (gjashtëmujor) për kryerjen e betimit në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, për shkaqe të justifikuara objektive dhe të arsyeshme, personi, i cili e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin, duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në Ministrinë e Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa parashikohet se mund të zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.
2. Në çdo rast, ky afat duhet t'i korrespondojë një periudhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar.

3. Me paraqitjen e këtyre dokumenteve, të cilat shqyrtohen nga struktura për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, lëshohet konfirmimi për pranimin/mospranimin e kërkesës, i cili më pas i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila e adreson për ndjekje të mëtejshme në zyrën respektive të gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, për vijimin e procedurës së betimit për fitimin e shtetësisë shqiptare.

XIV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit.
2. Për sa më sipër, në zbatim të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. 64, datë 4.2.2021, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, për personat që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", kërkohet plotësimi i dokumentacionit dhe ridërgimi i praktikës së plotë pranë Ministrisë së Brendshme, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 65, datë 4.2.2021, "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të procedurës dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

Fletore zyrtare nr. 203, datë publikimi 03.12.2024

LIGJ

Nr. 79/2021

PËR TË HUAJT[35]

35 Ky ligj është përafruar pjesërisht me:
- Direktivën 2011/98/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, "Mbi një procedurë të vetme aplikimi për një leje të vetme për shtetasit e vendeve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një shteti anëtar dhe për një grup të përbashkët të të drejtave për punëtorët e vendeve të treta me qëndrim të ligjshëm në një shtet anëtar". Numri CELEX 32011L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 23.12.2011, f. 1–9.
- Direktivën (BE) 2016/801 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 maj 2016, "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime kërkimi, studimesh, trajnimesh, shërbimi vullnetar, skemash të shkëmbimit të nxënësve ose projekteve arsimore dhe au pairing". Numri CELEX 32016L0801, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 132, datë 21.5.2016, f. 21–57.
- Direktivën e Këshillit 2003/110/KE, datë 25 nëntor 2003, "Për ndihmën në rastet e transitit për qëllimet e largimit në rrugë ajrore". Numri CELEX 32003L0110, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 321, datë 6.12.2013, f. 26–31.
- Vendimin e Këshillit 2004/573/KE, datë 29 prill 2004, "Mbi organizimin e fluturimeve të përbashkëta për largime nga territori i dy ose më shumë shteteve anëtare, të shtetasve të vendeve të treta që janë objekt i urdhrave individualë të largimit". Numri CELEX 32004D0573, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, f. 28–35.
- Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonalë". Numri CELEX 32014L0036, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 375–390.
- Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadrin e një transferimi brenda korporatës". Numri CELEX 32014L0066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 27.5.2014, f. 1–22.
- Direktivën 2009/52/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 qershor 2009, "Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme". Numri CELEX 32009L0052, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 168, datë 30.6.2009, f. 24–32.
- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, "Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim pune shumë të kualifikuar". Numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 155, datë 18.6.2009, f. 17–29.
- Direktivën 2008/115/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, "Mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt". Numri CELEX 32008L0115, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 348, datë 24.12.2008, f. 98–107.
- Direktivën e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004, "Mbi detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët". Numri CELEX 32004L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, f. 24–27.
- Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004, "Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara për shtetasit e vendeve të treta që janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për të lehtësuar imigracionin e paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente". Numri CELEX 32004L0081, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, f. 19–23.
- Direktivën e Këshillit 2003/109/KE, datë 25 nëntor 2003 në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë, e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0109,

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë. Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit kryejnë aktivitete në Republikën e

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 16, datë 23.1.2004, f. 44–53.
- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, "Mbi të drejtën e bashkimit familjar". Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, faqe 12–18.
- Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, "Për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion". Numri CELEX 32000L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 303, datë 2.12.2000, faqe 16–22.
- Direktivën 96/71/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 1996, në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve, e ndryshuar. Numri CELEX 31996L0071, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 18, datë 21.1.1997, faqe 1–6.
- Direktivën 2004/38/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 29 prill 2004, "Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare, që ndryshon Rregulloren (KEE) nr. 1612/68 dhe që shfuqizon direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE", e ndryshuar". Numri CELEX 32004L0038, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 168, datë 30.4.2004, f. 77–123.
- Rregulloren (KE) nr. 810/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Për krijimin e Kodit të Komunitetit për Vizat (Kodi i Vizave)", e ndryshuar. Numri CELEX 32009R0810, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 243, datë 15.9.2009, f. 1–58.
- Vendimin kuadër të Këshillit, 2002/946/DÇB, datë 28 nëntor 2002, "Mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar ndihmën e hyrjes, transitit dhe qëndrimit të paautorizuar". Numri CELEX 32002F0946, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 328, datë 5.12.2002, f. 1–3.

Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin, si dhe në rastet kur dalin nga Republika e Shqipërisë.
2. Dispozitat e këtij ligji lidhur me punësimin e të huajve nuk zbatohen për personelin e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, për anëtarët e misioneve të organizatave të Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve të tjera të specializuara të Kombeve të Bashkuara, për anëtarët e misioneve e organizatave ndërkombëtare, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, ose për anëtarët e familjeve të tyre.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Anëtarë të familjes së të huajit" janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/ bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë edhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykate apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, ose që duhet të njihet në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk munden objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij ose bashkëshortes/ bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës, dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.
2. "*Au pair*" është i huaji, i cili pranohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për t'u pritur përkohësisht nga një familje, në mënyrë që të përmirësojë aftësitë e tij gjuhësore dhe njohuritë për Republikën e Shqipërisë, në këmbim të punëve të lehta shtëpiake dhe të ofrimit të kujdesit për fëmijët.

3. " Autoritete shtetërore përgjegjëse" janë organet shtetërore, si dhe çdo strukturë tjetër në varësi të tyre, të cilat ushtrojnë funksione në fushën e legjislacionit për të huajt, sipas kompetencave që u njeh ky ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.
4. "Bashkim familjar" është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë i anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të huajit që banon ligjërisht në Republikën e Shqipërisë, sipas rregullave të posaçme që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për të huajt, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.
5. "Dëbimi" është zbatimi i detyrimit për kthim i të huajit, subjekt i urdhrit të dëbimit, të personit të shpallur si i padëshiruar, si dhe ai i largimit të detyruar të të huajit nga autoritetet e përcaktuara në këtë ligj.
6. "Dokument i vlefshëm i udhëtimit i të huajit" është dokumenti që përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.
7. "Dokumenti zyrtar i kualifikimit të lartë profesional" është diploma e arsimit të lartë ose diploma profesionale/certifikata profesionale, e cila jep akses në profesionin përkatës në vendin ku është fituar, është e njohur dhe e njësuar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. "Fluturim i përbashkët" është transporti i shtetasve të vendeve të treta i kryer nga një transportues ajror i zgjedhur për këtë qëllim.
9. "I huaj" është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.
10. "I mitur i pashoqëruar" është i mituri i huaj, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës sipas ligjit dhe për sa kohë që nuk merret efektivisht në përkujdesje prej tij, ose i mituri që lihet i pashoqëruar pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.
11. "Institucion arsimor" është një institucion i arsimit të mesëm të lartë publik ose privat i njohur nga Republika e Shqipërisë, programet mësimore të të cilit njihen në përputhje me ligjin kombëtar ose praktikën administrative mbi bazën e kritereve transparente dhe që merr pjesë në një skemë shkëmbimi nxënësish ose në një projekt arsimor për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj.

12. "Kërkesë për azil" është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdolloj mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.
13. "Kërkues shkencor" është i huaji, që zotëron një diplomë të gradës shkencore "Doktor" ose një kualifikim të përshtatshëm të arsimit të lartë, që i jep akses në programin e studimeve "Doktoratë" atij shtetasi të huaj, i cili është zgjedhur nga një institut kërkimor dhe i pranuar në territorin e Republikës së Shqipërisë për të kryer një veprimtari kërkimore, që kërkon kualifikimet e parashikuara më lart.
14 "Kthim" është procesi në të cilin i huaji me qëndrim të parregullt kthehet në mënyrë vullnetare, në zbatim të një detyrimi për kthim, ose forcërisht:
    a) në vendin e saj/tij të origjinës;
    b) në një vend transiti, mbështetur në marrëveshje ndërkombëtare ripranimi, ose detyrime të tjera;
    c) në një vend tjetër, në të cilin shtetasi me qëndrim të parregullt vullnetarisht dëshiron të kthehet dhe në të cilin ai/ajo do të pranohet.
15. "Largim vullnetar" është zbatimi i detyrimit për t'u kthyer brenda afatit kohor, të përcaktuar për këtë qëllim në vendimin e kthimit.
16. "Leje qëndrimi" është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.
17. "Leje unike" është leja e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, që lejon shtetasin e huaj të qëndrojë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime pune.
18. "Leje unike për kategori të veçanta" është dokumenti i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës për disa kategori të veçanta që pajisen me leje unike.
19. "Mbrojtja e përkohshme" i jepet të huajit sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara sipas legjislacionit për azilin në Republikën e Shqipërisë.
20. "Ministri" është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
21. "Miratimi për punësim" është autorizimi i lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për kategoritë, të cilat, sipas përcaktimeve në këtë ligj, marrin miratimin paraprak të agjencisë.

22. "Ndalim hyrjeje" është masa administrative kufizuese ndaj një të huaji, të shprehur në një vendim administrativ ose gjyqësor, me anë të së cilës të huajit i ndalohet hyrja dhe qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të caktuar kohore.
23. "Nxënës" është i huaji i pranuar në territorin e Republikës së Shqipërisë për të ndjekur një program arsimimi të njohur, të nivelit të dytë, shtetëror ose rajonal, ekuivalent me nivelin 2, 3 ose 4 të klasifikimit standard të arsimit ndërkombëtar, brenda kornizës së një programi shkëmbimi nxënësish ose një projekti arsimor, të zbatuar nga një institucion arsimor në përputhje me ligjin ose praktikën administrative të Republikës së Shqipërisë.
24. "Ofrues shërbimesh biznesi" janë personat fizikë, përfaqësues të një ofruesi shërbimesh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim negocimin e shitjes së shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve, për llogari të ofruesit të shërbimeve. Ata nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
25. "Ofrues shërbimesh kontraktuale" janë personat fizikë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë për të ofruar shërbime me një konsumator në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kërkon praninë e punonjësve të tij në një degë të përkohshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të përmbushë kontratën e ofrimit të shërbimeve.
26. "Operacione të kthimit" dhe "kthime të përbashkëta në rrugë ajrore" janë të gjitha aktivitetet e nevojshme për kthimin e shtetasve të vendeve të treta të interesuara, përfshirë transportin në fluturimet e përbashkëta.
27. "Pasaportë grupi" është çdo dokument i vlefshëm udhëtimi, i cili përmban emrat dhe datëlindjet e të paktën dy të huajve që në çdo rast hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga territori i Republikës së Shqipëri bashkërisht.
28. "Personeli kyç" janë të huajt sipas kategorive të mëposhtme:
    a) "vizitorë biznesi" janë personat fizikë, të cilët punojnë në një pozicion drejtues brenda një personi juridik dhe janë përgjegjës

për ngritjen e një aktiviteti tregtar. Ata nuk angazhohen në transaksione të drejtpërdrejta me publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që ndodhet brenda palës pritëse;

b) "të transferuar brenda ndërmarrjes/shoqërisë" janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose kanë qenë ortakë të tij për gjashtë muaj të pandërprerë, që paraprijnë menjëherë këtë transferim dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të ndërmarrjes/shoqërisë (duke përfshirë departamentet ose sektorët) në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas këtyre nënkategorive:

i. "menaxher" nënkupton një person, i cili mban një pozicion të lartë dhe drejton menaxhimin e subjektit pritës, merr mbikëqyrje të përgjithshme ose udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionarëve të biznesit. Ky pozicion përfshin: drejtimin e subjektit pritës, të një departamenti ose nënndarjeje të tij; mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së punonjësve të tjerë, specialistëve apo menaxherëve; autoritetin për të rekomanduar punësimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin;

ii. "specialist" nënkupton një person, i cili punon për grupin e ndërmarrjeve/shoqërive, zotëron njohuri të specializuara, thelbësore për fushat e aktivitetit të njësisë pritëse, teknikave apo menaxhimit. Në vlerësimin e njohurive të tilla duhet të merren parasysh jo vetëm njohuritë specifike për njësinë pritëse, por edhe nëse personi ka një nivel të lartë të kualifikimit, duke përfshirë përvojën e duhur profesionale, referuar një lloji pune ose aktiviteti që kërkon njohuri të veçanta teknike, duke përfshirë edhe mundësinë e pasjes së një profesioni të njohur;

iii. "praktikantët e diplomuar" janë personat fizikë, të cilët kanë qenë të punësuar nga një person juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për të paktën gjashtë muaj të pandërprerë, që paraprijnë menjëherë këtë transferim, zotërojnë një diplomë të lëshuar nga institucioni/et e arsimit të lartë dhe janë transferuar përkohësisht në një degë të tij në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime të zhvillimit të karrierës ose për t'u trajnuar në metodat/teknikat e biznesit dhe që paguhen gjatë periudhës së transferimit.

29. "Person me statusin e mbrojtjes plotësuese" ka kuptimin sipas përkufizimit të bërë në legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë.
30. "Person pa shtetësi" është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.
31. "Persona vulnerabël" janë të miturit e huaj, të miturit e pashoqëruar, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, femra shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, si dhe persona, të cilët kanë qenë objekt i torturës, përdhunimit ose formave të tjera të dhunimeve të rënda psikologjike, fizike e seksuale, migrantët që për shkak të situatës së tyre specifike nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre dhe janë në kushte veçanërisht delikate, si punëtorët e shtëpisë, migrantët me orientim seksual të caktuar, migrantët në gjendje shëndetësore të rëndë dhe ata me aftësi të kufizuara.
32. "Procedurë e vetme aplikimi" është procedura e cila në bazë të një aplikimi të vetëm të bërë nga shtetasi i huaj ose nga punëdhënësi i tij ose i saj për leje qëndrimi dhe pune në territorin e Republikës së Shqipërisë çon në marrjen e një vendimi për atë aplikim.
33. "Punëdhënës" është personi fizik ose juridik, nën drejtimin e të cilit i huaji kryen një punë ose një shërbim kundrejt shpërblimit.
34. "Punësim i paligjshëm" është punësimi i një të huaji me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë.
35. "Punëtor stinor" është i huaji i cili e ka vendbanimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por përkohësisht qëndron ligjërisht në territorin e saj për të kryer një aktivitet të punës stinore, në bazë të një ose më shumë kontratave të punës me kohë të përcaktuar, të lidhura ndërmjet të huajit dhe punëdhënësit, i cili ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
36. "Punonjës me kualifikim të lartë" është i huaji i punësuar në Republikën e Shqipërisë sipas rregullave të posaçme që parashikohen nga legjislacioni që rregullon punësimin, që përfiton shpërblim për punën për të cilën kërkohet përvojë përkatëse e veçantë, e provuar me dëshmi të kualifikimit të lartë profesional.
37. "Punëtor ndërkufitar" është i huaji, që lëviz nga territori i zonave në afërsi të kufirit ndërmjet dy vendeve për/në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive të punësimit, me kusht që të rikthehet në vendbanimin e tij të përhershëm çdo ditë ose të paktën një ditë në javë.

38. "Profesionistë të pavarur" janë personat fizikë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi, të cilët janë të regjistruar si të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kanë një kontratë për ofrimin e shërbimeve me një përfitues në Republikën e Shqipërisë.
39. "Punonjës lëvizës digjital" janë shtetasit e huaj që punojnë në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të institucionit dhe puna e tyre kryesisht është puna lëvizëse, ku mjet kryesor pune kanë mjetet e teknologjisë së informacionit.
40. "Qëndrim i parregullt" është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.
41. "Refugjat" është çdo person, i cilësuar i tillë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.
42. "Ripranim" është detyrimi ndërkombëtar i Republikës së Shqipërisë të ripranojë të huajt e kthyer nga shteti me të cilin ka një marrëveshje ndërkombëtare, sipas detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje.
43. "Student" është i huaji, i cili është pranuar nga një institucion i arsimit të lartë dhe që është pranuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllimin kryesor për të ndjekur një program studimi të plotë, që çon në arritjen e një kualifikimi të arsimit të lartë, duke përfshirë diploma, certifikata ose diplomë të gradës shkencore "Doktor" nga një institucion i arsimit të lartë, i cili mund të përfshijë edhe një kurs përgatitje paraprak, në përputhje me legjislacionin kombëtar ose një trajnim të detyrueshëm.
44. "Studiues dhe specialistë" janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.
45. "Shërbimi vullnetar" është një program aktivitetesh solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.
46. "Shoqërues" është personeli i sigurisë, përgjegjës për shoqërimin e shtetasve të vendeve të treta në një fluturim të përbashkët dhe personat përgjegjës për kujdesin mjekësor dhe përkthyesit
47. "Shtetas i një vendi të tretë" është çdo person që nuk është shtetas i shteteve (palë) kontraktuese.

48. "Shtet kontraktues kërkues" është shteti (palë) kontraktues, që zbaton një vendim kthimi në lidhje me një shtetas të palëve kontraktuese ose të një shtetasi të vendit të tretë.
49. "Shtet kontraktues i kërkuar" është shteti (palë) kontraktues në të cilin ndodhet aeroporti i destinacionit final ku do të kryhet dorëzimi.
50. "Shtet i transitit" është shteti në territorin e të cilit do të kryhet kalimi transit.
51. "Shtet organizator" është shteti përgjegjës për organizimin e fluturimeve të përbashkëta.
52. "Shtet pjesëmarrës" është shteti që merr pjesë në fluturimet e përbashkëta të organizuara nga shteti organizator.
53. "Transit ajror" është kalimi i shtetasit të vendit të tretë dhe, sipas nevojës, kalimi i shoqëruesve përmes zonës së aeroportit të shtetit të kërkuar për qëllimet e largimit në rrugë ajrore.
54. "Transportues" është personi fizik ose juridik, i regjistruar për ofrimin e shërbimit të transportit të personave.
55. "Vendimi i kthimit" është një akt administrativ ose vendim gjyqësor i autoriteteve shqiptare, i cili deklaron se qëndrimi i një të huaji në territorin e Republikës së Shqipërisë është i paligjshëm dhe që vendos ose deklaron detyrimin për kthimin e të huajit.
56. "Vizë" është autorizimi në formën e një vize pullë në një dokument të vlefshëm udhëtimi ose vizë elektronike, e printuar nga format elektronik, lëshuar nga autoritetet përgjegjëse, sipas procedurave të këtij ligji, që lejon të huajin të hyjë, të qëndrojë ose të kalojë transit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve

Sipas kuptimit të këtij ligji:

1. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet në Republikën e Shqipërisë është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin.
2. Autoriteti kombëtar përgjegjës për kthimet është struktura përgjegjëse që merret me organizimin dhe/ose pjesëmarrjen në fluturimet e kthimit ose me fluturimet e përbashkëta të kthimit dhe shërben si pikë kontakti me shtetet (palë) kontraktuese.

3. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, që kërkojnë mbrojtje (azil) dhe për refugjatët apo për personat, të cilët janë nën mbrojtje plotësuese, është autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
4. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal/vendor për trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë është struktura rajonale që mbulon çështjet e kufirit dhe migracionit.
5. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për monitorimin periodik të lëshimit të lejeve të qëndrimit është struktura përgjegjëse për të huajt në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
6. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e kërkesave për vizë është struktura përgjegjëse për çështjet konsullore.
7. Autoriteti përgjegjës për pranimin e kërkesave për vizë dhe lëshimin e vizave janë përfaqësitë diplomatike, zyrat konsullore jashtë vendit, zyrat konsullore të nderit të Republikës së Shqipërisë, si dhe agjentë të tjerë të kontraktuar në shtete të huaja, si dhe autoriteti përgjegjës vendor për çështjet e kufirit dhe migracionit në pikat e kalimit kufitar për rastet e përcaktuara në këtë ligj.
8. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e marrëdhënieve të punësimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për çështjet e migracionit në ministrinë që mbulon çështjet e punësimit.
9. Autoriteti shtetëror përgjegjës për çështjet e punësimit të të huajve është struktura përgjegjëse për punësimin dhe aftësitë.
10. Autoriteti shtetëror bashkërendues në përcaktimin e kuotave vjetore të punësimit për të huajt është ministria përgjegjëse për ekonominë.
11. Autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e sigurisë kombëtare është struktura që mbulon shërbimin informativ shtetëror në nivel qendror.
12. Autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike është struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.
13. Autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e rrezikut për shëndetin publik është ministria përgjegjëse për shëndetësinë.
14. Autoriteti shtetëror përgjegjës për regjistrimin dhe ndryshimin e të dhënave personale dhe të vendbanimit të të huajve, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë është zyra e gjendjes civile.

15. Autoritetet shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e të huajve janë strukturat përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, strukturat e rendit e të sigurisë publike në Policinë e Shtetit, si dhe zyrat përgjegjëse për gjendjen civile.
16. Autoritetet shtetërore qendrore përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të integrimit social të të huajve janë: ministria përgjegjëse për punën, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministria përgjegjëse për arsimin, sportin, rininë dhe kërkimin shkencor, ministria përgjegjëse për turizmin dhe ministria përgjegjëse për kulturën.

Neni 5
Të drejta dhe detyrime për të huajt

1. Të huajt në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtat e parashikuara në Kushtetutë dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara.
2. Autoritetet përgjegjëse gjatë vendimmarrjes në lidhje me të huajt zbatojnë dispozitat e këtij ligji në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe konventat, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.
3. I huaji zbaton Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe vendimet e autoriteteve shtetërore gjatë hyrjes, qëndrimit dhe largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë.
4. I huaji, lëvizja e të cilit kufizohet brenda një zone të caktuar, është i detyruar të lëvizë vetëm brenda kësaj zone.

KREU II
HYRJA DHE DALJA E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SEKSIONI I
KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Neni 6
Kritere të përgjithshme për hyrjen, daljen dhe kalimin transit

1. I huaji, i cili ka për qëllim të hyjë, të qëndrojë, të dalë ose të kalojë transit në/nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të azilkërkimit, si dhe kur me marrëveshje dy ose shumëpalëshe është

përcaktuar ndryshe, duhet të paraqitet në pikën e kalimit kufitar duke plotësuar kushtet, si më poshtë:

a) të ketë një dokument udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë, me një afat vlefshmërie të paktën 3 muaj para datës së përfundimit të qëndrimit të lejuar të ligjshëm në territor.
b) të jetë i pajisur me vizë hyrëse të vlefshme, nëse kërkohet, ose të jetë i pajisur me leje të vlefshme qëndrimi, të lëshuar nga autoriteti kompetent shqiptar ose të lëshuar nga vende të tjera dhe të njohur nga Republika e Shqipërisë;
c) të mos përbëjë kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, për sigurinë kombëtare, si dhe të mos cenojë marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë me shtete të tjera;
ç) të mos ketë shënime në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt që kufizojnë hyrjen e tij;
d) të mos përbëjë rrezik për shëndetin publik në Republikën e Shqipërisë;
dh) të mos ketë masa administrative që përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes, lloji i të cilave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
e) mbi bazën e vlerësimit, rast pas rasti, të huajit mund t'i kërkohet paraqitja e dokumenteve të tjera shtesë, lloji i të cilave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Hyrja në dhe dalja nga Republika e Shqipërisë e të huajit brenda ditës llogaritet një ditë qëndrimi.
3. Në rast transiti në Republikën e Shqipërisë, i huaji duhet të dokumentojë se i lejohet hyrja në vendin e destinacionit dhe se do të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë.
4. I mituri, nëse nuk është i martuar, duhet të shoqërohet nga persona madhorë. Në rastet kur ai nuk shoqërohet nga persona madhorë, kalimi në pikat e kalimit kufitar bëhet duke qenë i pajisur me autorizim nga prindi ose nga kujdestari ligjor. Në rastet kur i mituri, fëmijë/nxënës i sistemit arsimor parauniversitar hyn i organizuar në grupe, duhet të shoqërohet së paku nga një përfaqësues i autorizuar i institucionit arsimor, të cilit i përket, i cili duhet të disponojë listën emërore kolektive të nënshkruar nga titullari i institucionit arsimor parauniversitar.

5. I huaji, i cili është regjistruar në dokumentin e udhëtimit të një personi tjetër, mund të hyjë dhe të dalë nga Republika e Shqipërisë vetëm nëse është i shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit ai/ajo është i/e regjistruar.
6. I huaji, që mban më shumë se një shtetësi, gjatë qëndrimit dhe largimit nga Republika e Shqipërisë përdor dokumentin e udhëtimit me të cilin ka hyrë në Republikën e Shqipërisë.
7. Anëtarët e ekuipazheve të mjeteve lundruese shqiptare apo të huaja, mbajtës të një dokumenti identifikimi me fotografi, të lëshuar nga autoritetet portuale të vendit të origjinës, kanë të drejtë të hyjnë dhe të kalojnë transit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë nga një pikë kalimi kufitar në një port, të qëndrojnë deri në 90 ditë për 180 ditë në territorin ku ndodhet porti pa u pajisur me leje qëndrimi. Për qëndrim mbi 90 ditë për 180 ditë, anëtarët e ekuipazhit të mjeteve lundruese pajisen me leje qëndrimi sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
8. Anëtarët e ekuipazhit të një avioni, mbajtës të një dokumenti identifikimi me fotografi, të lëshuar nga autoriteti i aviacionit civil të vendit të origjinës, kanë të drejtë të hyjnë dhe të dalin në territorin e Republikës së Shqipërisë, në funksion të fluturimeve që janë pjesë e angazhimit normal të punës së tyre, pa u pajisur me vizë në dokumentin e tyre të udhëtimit. Anëtarët e ekuipazhit të avionit dalin nga Republika e Shqipërisë në fluturimin pasardhës të planifikuar në itinerarin e tyre.
9. Punonjësit e stafit të trenave të mallrave apo të pasagjerëve mund të udhëtojnë me tren dhe mund të qëndrojnë në një pikë kalimi kufiri hekurudhor nëse ata disponojnë një dokument identifikimi me fotografi, të miratuar specifikisht me marrëveshje të trafikut hekurudhor ndërmjet vendeve kufitare.
10. Banorët e zonave kufitare të përcaktuara në marrëveshje dypalëshe, të njohura nga Republika e Shqipërisë, mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë duke përdorur një dokument kufitar, të lëshuar në zbatim të këtyre marrëveshjeve për qarkullim të vogël ndërkufitar.
11. Personeli i organizatave ndërkombëtare, në kuadër të kryerjes së detyrave dhe misioneve të ngarkuara prej tyre, mund të hyjnë, të qëndrojnë, të kalojnë transit dhe të dalin nga Republika e

Shqipërisë duke përdorur leje kalimi të lëshuar prej tyre ose ndonjë dokument tjetër, që është i vlefshëm në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

12. Lista e dokumenteve të udhëtimit të lejuara përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Hyrja e parregullt

1. I huaji hyn në mënyrë të parregullt në Republikën e Shqipërisë nëse:
   a) kalon kufirin shtetëror jashtë pikave dhe orarit të përcaktuar për kalimin e kufirit;
   b) shmang kontrollin kufitar;
   c) hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës për të cilën ekziston ndalimi i hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
   ç) hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë duke përdorur një dokument të një personi tjetër ose dokument të falsifikuar apo një dokument të paautorizuar për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. I huaji vlerësohet se hyn në mënyrë të parregullt në Republikën e Shqipërisë kur nuk ka shënime zyrtare të bëra sipas procedurave ligjore në fuqi në dokumentin e tij të udhëtimit apo shënime në sistemet elektronike të kontrollit kufitar.

Neni 8

Dalja e të huajve nga territori

1. Të huajt mund të dalin lirisht nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. I huaji konsiderohet se ka dalë apo ka plotësuar detyrimin për të dalë nga Republika e Shqipërisë kur ka shënime zyrtare të bëra sipas procedurave ligjore në fuqi në dokumentin e tij të udhëtimit apo shënime në sistemet elektronike të kontrollit kufitar.
3. Të huajit i ndalohet dalja nga Republika e Shqipërisë nëse vepron në kundërshtim me legjislacionin shqiptar duke kryer veprimet e mëposhtme:
   a) gjatë largimit nga Republika e Shqipërisë ai/ajo përdor dokumentin e udhëtimit të një personi tjetër apo një dokument të falsifikuar ose dokument të pavlefshëm për të udhëtuar;

   b) është regjistruar në dokumentin e udhëtimit të një personi tjetër dhe në dalje nga Republika e Shqipërisë nuk është i shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit ai/ajo është i regjistruar;
   c) kur synon t'i shmanget ndjekjes për një vepër penale, ndalimit, arrestimit ose ekzekutimit të një vendimi që përmban dënim me burgim.

Neni 9

Refuzimi i hyrjes në kufi

1. Përveç rasteve të mosplotësimit të njërit prej kushteve të përgjithshme të kërkuara, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin refuzon hyrjen e të huajit në kufi, të pajisur ose jo me vizë, në rast se:
   a) kanë ndryshuar kushtet konkrete, në bazë të të cilave është bërë i mundur lëshimi i vizës;
   b) kanë ndryshuar kushtet konkrete, në bazë të të cilave është bërë i mundur lëshimi i lejes së qëndrimit apo leja e qëndrimit është anuluar sipas përcaktimeve në këtë ligj;
   c) përdor në hyrje një dokument të një personi tjetër ose dokument/vizë të falsifikuar apo një dokument të paautorizuar për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Bëjnë përjashtim nga kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji, të huajt të cilët:
   a) j anë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, të pajisur me leje qëndrimi;
   b) janë shtetas të huaj që kërkojnë azil apo mbrojtje të përkohshme;
   c) janë të pajisur me vizë të tipit "D";
   ç) janë të pajisur me pasaportë diplomatike.
3. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në rast të refuzimit të hyrjes në kufi, e pajis të huajin me urdhër të refuzimit të hyrjes, në të cilin, përveç të tjerash, shënon edhe arsyet e refuzimit të hyrjes dhe mundësitë e ankimit.

   Procedura e refuzimit të hyrjes, si dhe formati i urdhrit të refuzimit të hyrjes miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
4. Kundër urdhrit të refuzimit të hyrjes, i huaji ka të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI II
DOKUMENTET E UDHËTIMIT

Neni 10
Dokumenti i huaj i udhëtimit

1. Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit i të huajit përmban emrin e mbajtësit, datën e lindjes, seksin, shtetësinë, vlefshmërinë, autoritetin lëshues dhe vendin ku është lëshuar dokumenti, si dhe një fotografi ku mbajtësi i saj është lehtësisht i dallueshëm. Dokumenti duhet të jetë lëshuar në 10 vitet e fundit dhe të paktën të ketë dy faqe bosh.
2. Nëse dokumenti i udhëtimit nuk përcakton një të dhënë specifike vlefshmërie sipas pikës 1, ai konsiderohet se është një dokument udhëtimi i pavlefshëm për të hyrë dhe qëndruar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Pasaporta e grupit

1. Një dokument i vlefshëm udhëtimi që përmban emrat dhe datëlindjet e një grupi të huajsh, të cilët udhëtojnë së bashku, njihet si pasaportë grupi.
2. Pasaporta e grupit përmban vetëm shtetas të vendit që e ka lëshuar atë ose shtetas të huaj me leje qëndrimi në atë shtet.
3. Drejtuesi i grupit mban një dokument tjetër personal të vlefshëm udhëtimi.
4. Çdo person, i cili përfshihet në pasaportën e grupit, duhet të ketë një dokument tjetër të vlefshëm identifikimi të lëshuar nga autoritetet e vendit të tij të lindjes, nëse pasaporta e grupit nuk përmban fotografinë/të e anëtarëve të grupit.
5. Me hyrjen dhe largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë, drejtuesi i grupit, sipas kërkesës, duhet t'u paraqesë autoriteteve të kontrollit kufitar listën e të gjithë personave që udhëtojnë me pasaportën e grupit.

Neni 12
Lëshimi i letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëtimit për të huajt

1. Autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin lëshon me kërkesën e të interesuarit, kur dokumenti i tij i udhëtimit ka humbur

ose është shkatërruar dhe nuk mund të zëvendësohet, dokument udhëtimi për të huajin, i cili është banor në Republikën e Shqipërisë dhe do të udhëtojë jashtë vendit, për një afat deri në 2 vjet, duke i dhënë atij të drejtë të kthehet në vend, edhe pse nuk ka një dokument të vlefshëm udhëtimi të vendit të origjinës e nuk mund ta zëvendësojë atë për arsye që nuk varen prej tij.
2. Për qëllime udhëtimi jashtë, autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, sipas kushteve të përcaktuara në konventa ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë, i lëshon një dokument udhëtimi të huajit pa shtetësi, i cili është banor në Republikën e Shqipërisë, duke i dhënë të drejtën të rikthehet në Republikën e Shqipërisë brenda periudhës së vlefshmërisë. Ky dokument është i vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare nga data e lëshimit.
3. Dokumentet e udhëtimit për të huajt lëshohen pavarësisht nga mosha e tyre.
4. Letërnjoftimi për të huajt lëshohet për të gjithë të huajt, banorë në Republikën e Shqipërisë që kanë mbushur moshën 16 vjeç.
5. Dokumenti i udhëtimit për personat pa shtetësi lëshohet sipas kushteve të përcaktuara në konventa ndërkombëtare**.**
6. Zyra vendore e gjendjes civile, ku i huaji është banor, pajis të huajin me letërnjoftim për të huajt.
7. Forma dhe përmbajtja e dokumentit të udhëtimit, letërnjoftimit për të huajt, si dhe lejes së kalimit për të huajt miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13
Lëshimi i lejekalimit për të huajt

1. Lejekalimi për të huajt i lëshohet me afat deri në 30 ditë një të huaji që nuk ka një dokument udhëtimi nëse:
   a) i revokohet statusi i refugjatit dhe/ose është subjekt i largimit/ dëbimit nga territori Republikës së Shqipërisë;
   b) shteti i tij nuk ka përfaqësi diplomatike apo zyrë konsullore në Republikën e Shqipërisë dhe interesat e tij për të shkuar jashtë vendit nuk përfaqësohen nga një shtet tjetër;
   c) ka humbur dokumentin e udhëtimit për refugjatët ose dokumentin e udhëtimit për personat pa shtetësi jashtë vendit, të lëshuar nga policia për t'u kthyer në Republikën e Shqipërisë.

2. Lëshimi i lejes së kalimit për të huajt, të cilët do të kthehen në vendin ku pranohen, në vendin e rezidencës apo të origjinës, bëhet nga autoritetet rajonale për kufirin dhe migracionin, në juridiksionin territorial ku i huaji ka pasur së fundi vendqëndrimin e tij dhe nga autoritetet konsullore të Republikës së Shqipërisë, kur i huaji ndodhet jashtë shtetit.
3. Formati i lejes së kalimit për të huajt miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Refuzimi i lëshimit të dokumentit të udhëtimit dhe lejekalimit

Dokumenti i udhëtimit për të huajin dhe leja e kalimit nuk i lëshohet të huajit:

a) të cilit i atribuohet vepra penale;
b) i cili është dënuar me burgim dhe nuk ka përfunduar vuajtjen e dënimit.

Neni 15

Humbja e dokumenteve të udhëtimit

1. I huaji raporton menjëherë humbjen ose dëmtimin e letërnjoftimit, dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit ose të lejes së qëndrimit tek autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, ku ka vendqëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm. Në këtë rast, të huajit i lëshohet një dokument i përkohshëm.
2. Dokumenti i lëshuar sipas pikës 1 të këtij neni është i vlefshëm deri në marrjen e letërnjoftimit, dokumentit të ri të udhëtimit ose të lejes së qëndrimit të humbur, dokument i cili i kthehet në këtë rast nga autoriteti përgjegjës lëshues. Formati i dokumentit të lëshuar, sipas kësaj pike, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për shpalljen në kërkim të dokumentit të udhëtimit ose lejes së qëndrimit të të huajit miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 16

Dokumenti i udhëtimit i personave që kanë më shumë se një shtetësi

1. I huaji, i cili ka dy shtetësi dhe hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, konsiderohet shtetas i shtetit që i ka lëshuar dokumentin e udhëtimit me të cilin ai ka hyrë.
2. Gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Shqipërisë, i huaj i referuar në pikën 1 të këtij neni, është i detyruar të përdorë dokumentin e udhëtimit me të cilin ka hyrë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Ftesa e të huajit

1. Ftuesi është shtetasi shqiptar ose i huaji, banor në Republikën e Shqipërisë, ose personi juridik shqiptar apo i huaj që ushtron veprimtari sipas legjislacionit shqiptar, i cili deklaron me shkrim se merr përsipër përgjegjësitë për qëndrimin dhe largimin e të huajit në/nga Republika e Shqipërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Një person fizik ose juridik, shqiptar ose i huaj, banor në Republikën e Shqipërisë, mund t'i bëjë ftesë një të huaji të hyjë në vend me vizë nëse plotëson kushtet dhe angazhohet si më poshtë:
   a) t'i sigurojë të huajit pritje, akomodimin gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe kthimin e tij në vendin e origjinës apo vendin nga ka ardhur i huaji;
   b) të mbulojë shpenzimet e kthimit në vendin e destinacionit, në rast se për të huajin është nxjerrë një urdhër largimi ose dëbimi dhe kur ky nuk ka mjete financiare.
3. Ftesa i dërgohet të huajit dhe domosdoshmërish një kopje e saj depozitohet nga ftuesi në autoritetin rajonal përgjegjës për kufirin dhe migracionin, ku ftuesi ka vendbanimin ose vendqëndrimin.
4. Autoriteti qendror përgjegjës për çështjet e kufirit dhe migracionit, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, për periudha të caktuara kohe, për aq kohë sa vlerësohet e nevojshme në interes të parandalimit të migracionit të paligjshëm, mund të kërkojë pajisjen me ftesë para se të hyjnë në Republikën e Shqipërisë edhe të shtetasve të vendeve, të cilët hyjnë pa vizë në vend. Procedura e marrjes së një vendimi të tillë miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.
5. Forma dhe përmbajtja e ftesës miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

6. Në rast se ftuesi nuk përmbush detyrimet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për shkaqe të pajustifikuara, është në kushtet e shkeljes administrative dhe sanksionohet me gjobë.

Neni 18
Garancia financiare

1. I huaji, i cili aplikon për vizë, depoziton një shumë të caktuar të hollash në llogari bankare, me qëllim garancie financiare.
2. Garanci financiare është shuma e nevojshme financiare, që depozitohet nga vetë i huaji ose nga garanti për llogari të të huajit, me qëllim që të mbulohen shpenzimet e jetesës dhe pasojat e një dëmi, që mund të shkaktohet nga një veprim ose mosveprim i të huajit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për një periudhë të caktuar të qëndrimit të tij në Republikën e Shqipërisë.
3. Garancia financiare për llogari të të huajit mund të depozitohet edhe nga ftuesi i tij në Republikën e Shqipërisë.
4. Kufiri i garancisë financiare, tipi i vizës, si dhe procedurat e depozitimit dhe kthimit të garancisë financiare caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme, sipas standardeve mesatare të jetesës, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin shqiptar.

KREU III
VIZAT

SEKSIONI I
LLOJET E VIZAVE

Neni 19
Vizë e tipit "A"

1. Viza e tipit "A" është viza transit në aeroport, që i jep të drejtën mbajtësit të hyjë dhe të qëndrojë në zonën për qarkullim ndërkombëtar të aeroportit deri në nisjen e fluturimit për në vendin e destinacionit. Vlefshmëria e kësaj vize jepet në përputhje me kohën dhe rezervimet e biletave për udhëtimin/et, në të cilin/at aplikuesi parashikon të kalojë transit.

2. Viza e tipit "A" mund të jepet me shumë hyrje-dalje dhe me vlefshmëri maksimumi deri në gjashtë muaj në rastet kur:
   a) aplikuesi dokumenton se e ka të nevojshme të kalojë transit shpesh ose rregullisht;
   b) aplikuesi është i besueshëm apo ka përdorur me korrektesë vizat e mëparshme që ka pasur, përfshirë edhe ato jo transit, si dhe situata e tij ekonomike garanton udhëtimin në vendin e destinacionit.
3. Vendet për të cilat aplikohet viza e tipit "A" përjashtohen nga detyrimi për pajisjen me këtë vizë të këtyre kategorive:
   a) ato kategori që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me vizë për t'u futur në territorin e Republikës së Shqipërisë;
   b) mbajtësve të pasaportave diplomatike;
   c) anëtarëve të ekuipazheve të mjeteve të transportit ajror, të cilët janë shtetas të një pale kontraktuese të Konventës së Çikagos mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, si dhe Konventës së Detit Montego Bay;
   ç) mbajtësit të një vize apo lejeje qëndrimi të vlefshme shqiptare.
4. Vendet për të cilat mund të aplikohet kjo vizë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20
Vizë e tipit "C"

1. Viza e tipit "C" është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik, e cila i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë brenda 180 ditëve, duke filluar nga data e hyrjes së parë.
2. Viza e tipit "C" mund të lëshohet me një, dy ose shumë hyrje. Periudha e vlefshmërisë nuk mund t'i kalojë 5 vjet.
3. Viza e tipit "C" mund të lëshohet me shumë hyrje dhe vlefshmëri, me afat 6 muaj, 1 vit, 2 vjet dhe 5 vjet, kur përmbushen kushtet e mëposhtme:
   a) aplikuesi provon nevojën dhe justifikon qëllimin për të udhëtuar rregullisht, për shkak të detyrimeve familjare, të biznesit, të shërbimit civil, angazhimeve në organizata të shoqërisë civile, udhëton për qëllime trajnimesh, edukimi apo vjen rregullisht të

kontribuojë pranë organizatave ndërkombëtare të vendosura në Republikën e Shqipërisë;

b) aplikuesi provon integritetin e tij dhe ka krijuar besueshmëri, duke përdorur me korrektesë vizat e lëshuara më parë, si dhe situata e tij ekonomike në vendin e origjinës garanton kryerjen e udhëtimeve dhe kthimin brenda afateve të parashikuara (90 ditë në 180 ditë).

4. Në rastet e dhënies së kësaj vize për të kaluar transit në territorin e Republikës së Shqipërisë, koha e qëndrimit dhe vlefshmëria e saj duhet të përputhen me kohën e nevojshme për të kryer kalimin/et transit në territor, por nuk mund të kalojë 5 ditë.
5. Viza e tipit "C" me një hyrje mund të jepet edhe si vizë grupi e hedhur në një pasaportë grupi, me qëllim transiti ose qëndrimi maksimalisht deri 30 ditë dhe për 5 deri në 50 persona, të cilët kanë për qëllim të marrin pjesë në aktivitete artistike, shkencore ose sportive, apo kur hyjnë dhe dalin nga territori së bashku si turistë. Kjo vizë grupi u lëshohet me kufizime rajonale ekuipazheve të mjeteve të lundrimit, të cilat transferohen në ose nga një anije së bashku.

Neni 21
Vizë e tipit "D"

1. Viza e tipit "D" është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik për shtetasit e huaj që synojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve, dhe kur, për t'u pajisur me leje qëndrimi, për këta shtetas kërkohet vizë.
2. Viza e tipit "D" jepet edhe me vlefshmëri njëvjeçare, kohë qëndrimi 90 ditë, por jo për më shumë se 180 ditë, llogaritur që nga dita e hyrjes së parë, me një, dy apo më shumë hyrje-dalje, e cila i jep të drejtë mbajtësit të aplikojë për t'u pajisur me leje qëndrimi pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë.
3. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë, sipas motiveve të qëndrimit, përcaktuar në këtë ligji, si dhe formati i vizës pullë dhe vizës elektronike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

SEKSIONI II
LËSHIMI I VIZAVE

Neni 22
Autoritetet për lëshimin e vizave

1. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme është institucioni përgjegjës për pajisjen me vizë të të huajit për të cilin kërkohet vizë për të hyrë, qëndruar ose transituar në Republikën e Shqipërisë.
2. Përfaqësitë e vendeve të treta, në bazë të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, pajisin të huajt me vizë për të hyrë, për të qëndruar ose për të kaluar transit në Republikën e Shqipërisë.
3. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, për raste përjashtimore dhe të përcaktuara në këtë ligj, pajis të huajt me vizë në kufi për të hyrë, për të qëndruar ose për të kaluar transit në Republikën e Shqipërisë sipas kritereve të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji, si dhe mund të zgjasë afatet e vlefshmërisë, të përcaktuara në vizat e lëshuara, sipas përcaktimeve në nenin 26 të këtij ligji.
4. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për rendin e sigurinë publike dhe Shërbimin Informativ të Shtetit në procedurën e lëshimit të vizave.
5. Bashkëpunimi ndërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, ministrisë përgjegjëse për rendin e sigurinë publike dhe Shërbimit Informativ të Shtetit përcaktohet me udhëzim të përbashkët të këtyre institucioneve.

Neni 23
Kërkesa për vizë

1. Aplikimi për vizë nga i huaji bëhet jo më shumë se 90 ditë përpara datës së planifikuar për të ardhur në Republikën e Shqipërisë, pranë përfaqësive diplomatike dhe/ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit nëpërmjet sistemit elektronik të vizave ose, në rastet e marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe me vende të tjera, në përfaqësitë përkatëse të këtyre vendeve. Formati i aplikimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Aplikimi për të miturit firmoset nga një/dy prej prindërve ose nga personi që e ka në ngarkim ose në kujdestari ligjore të miturin.

3. Të miturit pajisen me vizë në pasaportën personale të tyre. Të miturit, të cilit për arsye të ndryshme ligjore, në vendin e tij të origjinës, nuk i mundësohet pajisja e tij me pasaportë, viza i shënohet në vizën e prindit ose të kujdestarit ligjor, në pasaportën e të cilit i/të mituri/t është regjistruar.
4. Për të aplikuar për vizë, shtetasi i huaj paraqitet personalisht në konsullatë ose aplikon *online* në sistemin elektronik të vizave.
5. Në rast se nuk ka përfaqësi diplomatike/konsullore shqiptare në shtetin e aplikuesit ose në vendin ku ai është banor, i huaji bën kërkesë *online* ose me postë në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e parashikuar, sipas një liste të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, e cila publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Një vizë mund të lëshohet nëse dokumenti i udhëtimit të të huajit:
   a) është i vlefshëm për të paktën tre muaj pas datës së parashikuar për largim nga Shqipëria ose, në rast të hyrjeve të shumta, pas datës së fundit të parashikuar për largimin nga Shqipëria;
   b) përmban së paku dy faqe bosh;
   c) është lëshuar brenda dhjetëvjeçarit të fundit.

Neni 24
Lëshimi i vizës nga autoritetet kompetente

1. I huaji, i cili kërkon të hyjë në Republikën e Shqipërisë, pajiset me vizë nga përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit ose nga përfaqësitë e vendeve të treta sipas marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, duke e stampuar vizën në dokumentin e udhëtimit ose duke printuar vizën elektronike të miratuar.
2. Lëshimi i vizës pullë dhe vizës elektronike bëhet vetëm pasi ka përfunduar procedura e vlerësimit të kërkesës për vizë nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, sipas përcaktimeve me udhëzim të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, ministrisë përgjegjëse për rendin e sigurinë publike dhe drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.
3. Procedura totale e vlerësimit të kërkesës për vizë zgjat jo më shumë se 15 ditë nga data e pranimit të aplikimit për vizë. Në raste përjashtimore, ky afat mund të shtyhet me vendim të arsyetuar deri në 30 ditë.

4. Pajisja me vizë nuk është garanci që të huajit do t'i lejohet hyrja në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25
Lëshimi i vizës në kufi

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, përjashtimisht, mund të pajisë të huajin me vizë në pikën e kalimit kufitar për rastet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse ai përmbush kushtet e mëposhtme:
   a) përmbush kushtet e përgjithshme për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në nenin 6, të këtij ligji;
   b) nuk ka pasur mundësi reale të aplikojë për vizë paraprakisht, sipas dispozitave të përcaktuara në këtë ligj, duke provuar arsyen e paparashikuar dhe të menjëhershme të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë;
   c) kthimi i tij në vendin e origjinës apo vendin transit nga ka ardhur është i sigurt.
2. Viza e lëshuar në kufi është e njëjtë për nga forma dhe përmbajtja e vizës së zakonshme dhe lëshohet për një afat qëndrimi deri në 15 ditë, në varësi të qëllimit të kërkuar dhe kushteve të plotësuara në pikën 1 të këtij neni, për rastet si më poshtë:
   a) në kushte emergjence, shkaktuar nga fatkeqësi natyrore, përmbytjeje apo aksidenti;
   b) në raste vdekjeje, sëmundjesh të rënda të anëtarëve të familjes të të huajit me qëndrim në Republikën e Shqipërisë, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës;
   c) në rast fatkeqësie, kur për shkak të një defekti teknik, moti të keq apo rreziku nga ndonjë sulm terrorist, ekuipazhi i anijeve ose avionëve duhet të futet në territorin e Republikës së Shqipërisë;
   ç) për ekuipazhet e mjeteve të lundrimit, shqiptare apo të huaja, të cilat kërkojnë leje për t'u imbarkuar apo riimbarkuar, për t'u kthyer në vendin e tyre pas mbarimit të kontratës së punës, si dhe në rastet e ndryshimit të ekuipazhit;
   d) sipas kërkesës së ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, për rastet e interesave shtetërorë dhe të detyrimeve ndërkombëtare.
3. Të huajit, për të cilin gjykohet se procedura e aplikimit dhe verifikimit për t'u pajisur me vizë është e domosdoshme, mund t'i refuzohet pajisja me vizë në kufi.

4. Në rastet e aplikimit për vizë në kufi, i huaji përjashtohet nga detyrimi për t'u pajisur me siguracion shëndetësor në udhëtim, në rast se lëshimi i këtij siguracioni në kufi është i pamundur, si dhe në rastet kur viza lëshohet për motive humanitare. Në këto raste i huaji duhet të pranojë t'u nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore dhe masave të shëndetit publik.
5. Vendimi për refuzimin e lëshimit të vizës i komunikohet të huajit me shkrim, sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Kundër vendimit për refuzimin e lëshimit të vizës i huaji mund të ankohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Procedura e lëshimit të vizës në kufi miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike, ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror.

Neni 26

Zgjatja e afatit të qëndrimit

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin zgjat afatin e qëndrimit të përcaktuar në vizën e lëshuar apo afatin e lejuar të qëndrimit pa vizë, nëse i huaji kërkon zgjatjen e qëndrimit para përfundimit të afatit të vlefshëm të qëndrimit, vetëm për arsye serioze personale, motive që vlerësohen të një rëndësie të veçantë, një force madhore ose humanitare, kur i huaji nuk ka pasur mundësi të largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë para përfundimit të afatit të lejuar.
2. Zgjatja e afatit të qëndrimit bëhet falas dhe në kohëzgjatje të lidhur rreptësisht me nevojën për t'iu përgjigjur forcës madhore apo arsyes humanitare.
3. Procedura e zgjatjes, afatet e zgjatjes së qëndrimit, rastet e rëndësisë së veçantë, si dhe dokumenti me të cilin pajiset i huaji miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.
4. Vendimi lidhur me kërkesën për zgjatjen e afatit të qëndrimit merret brenda 3 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Deri në marrjen e vendimit, i huaji mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27

Anulimi i vizës pullë dhe elektronike

1. Viza pullë dhe elektronike mund të anulohet nga ambasadat apo postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit ose nga zyra konsullore e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme në territorin e Republikës së Shqipërisë për shkaqet e mëposhtme:
   a) viza pullë dhe elektronike është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi;
   b) i huaji ka paraqitur të dhëna të rreme ose dokumente të falsifikuara për marrjen e vizës pullë dhe elektronike;
   c) viza pullë dhe elektronike i është lëshuar gabimisht personit;
   ç) i huaji është shpallur "person i padëshiruar" më vonë nga data e lëshimit të vizës pullë dhe elektronike;
   d) në mënyrë të përsëritur, i huaji nuk respekton rregullat e vendosura nga autoritetet doganore dhe nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin për kalim të kufirit shtetëror.
2. Anulimi i vizës pullë dhe elektronike i komunikohet të huajit menjëherë nëpërmjet sistemit elektronik ose në dokumentin e tij të udhëtimit ku është stampuar viza pullë ose mbi vizën elektronike duke vendosur mbishkrimin "ANULUAR".
3. Viza mund të anulohet edhe nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin në rastet kur ajo është lëshuar sipas nenit 24 të këtij ligji.
4. Viza pullë dhe elektronike anulohet në rastet kur konstatohet se në çastin e hyrjes dhe gjatë qëndrimit i huaji nuk përmbush më kushtet për të cilat është lëshuar viza pullë dhe elektronike, ose qëllimi për të cilin është lëshuar ajo ka ndryshuar apo nuk ekziston më. Anulimi i vizës pullë dhe elektronike mund të bëhet edhe me kërkesën e mbajtësit të vizës pullë dhe elektronike ose të ftuesit të tij në Republikën e Shqipërisë.
5. Akti administrativ për anulimin e vizës pullë dhe elektronike, si dhe arsyet e nxjerrjes së këtij akti i njoftohen të huajit me shkrim. Kundër aktit administrativ për anulimin e vizës pullë dhe elektronike i huaji ka të drejtën të ankohet në rrugë administrative në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.

Neni 28

Refuzimi i vizës pullë dhe elektronike

1. Lëshimi i vizës pullë dhe elektronike mund të refuzohet nëse aplikuesi:
   a) paraqet një dokument udhëtimi të falsifikuar;
   b) nuk justifikon qëllimin dhe nuk plotëson kushtet e ardhjes dhe qëndrimit;
   c) nuk zotëron burime të mjaftueshme financiare për kohën e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë dhe për udhëtimin e kthimit në vendin e tij;
   ç) ka tejkaluar më parë afatet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
   d) ka plotësuar qëndrimin 90 ditë për 180 ditë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas vizës pullë dhe elektronike së lëshuar;
   dh) rezulton të ketë ndalim hyrjeje;
   e) konsiderohet se përbën kërcënim për sigurinë ose shëndetin publik;
   ë) nuk vërteton besueshmëri në deklaratat e paraqitura apo nuk garanton daljen e tij nga territori i Republikës së Shqipërisë brenda afatit të vizës pullë dhe elektronike për të cilën ka aplikuar.
2. Akti administrativ për refuzimin e vizës pullë dhe elektronike i njoftohet aplikuesit sipas formatit të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror.
3. Të huajit, të cilit i refuzohet viza pullë dhe elektronike, i njihet e drejta e ankimit pranë strukturës përkatëse në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.
4. Pas refuzimit të vizës pullë dhe elektronike, i huaji ka të drejtë të riaplikojë vetëm pasi të ketë mbyllur procedurat e ankimit, në rast se e ka ushtruar këtë të drejtë ose, në të kundërt, pasi të kenë kaluar tre muaj nga data e marrjes së vendimit për refuzim.
5. Pagesa për vizën pullë e elektronike dhe shërbimin nuk kthehet në rastet e refuzimit të lëshimit të vizës pullë dhe elektronike.

Neni 29

Hyrja pa vizë

1. Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Të huajt e përjashtuar nga detyrimi i pajisjes me vizë kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për një afat deri në 90 ditë brenda 180 ditëve nga hyrja, përveç rasteve kur në marrëveshje ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe në fuqi ose bazuar në parimin e reciprocitetit apo qëndrimin e njëanshëm, të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave, parashikohet ndryshe.
3. I huaji, i përmendur në pikën 2 të këtij neni, i cili përpara mbarimit të periudhës 180-ditëshe përdor periudhën e qëndrimit 90 ditë për 180 ditë, mund të rihyjë dhe të qëndrojë pasi të ketë mbaruar periudha prej 180 ditësh. Procedura e përllogaritjes së afateve të qëndrimit përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror.
4. I huaji, i përmendur në pikën 2, të këtij neni, i cili ka qëndruar në territorin e Republikës se Shqipërisë, i pajisur me leje qëndrimi të përkohshme pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit dhe largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë, gëzon të drejtën e qëndrimit 90 ditë për 180 ditë, duke filluar numërimin nga hyrja e parë pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit.
5. Pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, si rregull, të huajt regjistrohen në autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku kanë vendqëndrimin brenda 10 ditëve nga dita e hyrjes.
6. Lista e vendeve që bëjnë përjashtim nga përcaktimet e pikës 5 të këtij neni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Procedura e regjistrimit të të huajit në autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

Neni 30
Vizat diplomatike dhe të shërbimit

1. Anëtarët e trupit diplomatik dhe konsullor, të akreditуar në Republikën e Shqipërisë, aplikojnë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, sipas listave të miratuara të vendeve, për vizë të tipit "D", me afat qëndrimi 90 ditë për 180 ditë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje dypalëshe është vendosur ndryshe.
2. Familjarët e stafit diplomatik dhe teknik, si bashkëshortja/i, bashkëjetuesi/ja fëmijët deri në moshën 18 vjeç të pamartuar dhe që bashkëjetojnë me prindërit, përfitojnë të drejtën e pajisjes me vizë dhe të akreditimit. Në rast se janë të regjistruar në shkollë në Republikën e Shqipërisë, fëmijët që përmbushin kushtet e mësipërme përfitojnë këtë të drejtë deri në moshën 21 vjeç.
3. Protokolli i Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme pajis me leje qëndrimi diplomatike anëtarët e trupit diplomatik dhe konsullor, të akreditуar në Republikën e Shqipërisë, me vlefshmëri gjatë gjithë kohës së akreditimit.
4. Të njëjtin regjim vizash dhe pajisje me leje qëndrimi diplomatike përfitojnë edhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, që kanë marrëveshje të veçanta me Republikën e Shqipërisë.

KREU IV
QËNDRIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

SEKSIONI I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 31
Qëndrimi në Republikën e Shqipërisë

1. I huaji mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë afatshkurtër, për një periudhë të përkohshme, si dhe të përhershme.
2. Qëndrimi për një periudhë afatshkurtër nuk mund të kalojë afatin 90 ditë për 180 ditë, në bazë të vizës së lëshuar apo hyrjes pa vizë, përjashtuar kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj ose në marrëveshje të njohura nga Republika e Shqipërisë.

3. Qëndrimi për një periudhë të përkohshme dhe të përhershme mund të realizohet vetëm nëpërmjet pajisjes të të huajit me leje qëndrimi.

Neni 32
Llojet e lejeve të qëndrimit

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me njërën nga llojet e lejeve të qëndrimit të mëposhtme të huajt, të cilët kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për një afat më shumë se 90 ditë në 180 ditë dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj:
   a) leje qëndrimi e tipit "A", e cila i jep të drejtën mbajtësit vetëm të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë brenda afatit kohor për të cilën ajo lëshohet;
   b) leje qëndrimi ose leje unike e tipit "B", e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;
   c) leje qëndrimi ose leje unike e tipit "C", e cila lëshohet me afat të përhershëm dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë;
   ç) leje qëndrimi unike "Kartë blu AL", e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;
   d) leje qëndrimi "Kartë blu AL-C", e cila lëshohet me afat të përhershëm vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë.
2. Forma dhe përmbajtja e lejeve të qëndrimit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33
Lëshimi i lejeve të qëndrimit

1. I huaji, i cili ka hyrë dhe qëndron në Republikën e Shqipërisë me një vizë qëndrimi afatgjatë të tipit "D", ose ai që hyn pa vizë, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj ose në marrëveshje ndërkombëtare, i bën një kërkesë *online* autoritetit vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin për t'u pajisur me leje qëndrimi. Për personat që hyjnë

me vizë, motivi i lejes së qëndrimit duhet të përputhet me motivin e vizës, me të cilën i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë.

2. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pas konsultimit me Shërbimin Informativ të Shtetit dhe shërbimet e rendit dhe sigurisë, miraton leje qëndrimi, ndërsa autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal/vendor për trajtimin e të huajve i lëshon të huajit lejen e qëndrimit.
3. Bashkëpunimi për procedurat e lëshimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe ministrisë përgjegjëse për financat e ekonominë përcaktohet me udhëzim të përbashkët të këtyre institucioneve.
4. Leja e qëndrimit, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, jepet me një afat:
   a) 3 muaj, 6 muaj ose 1 vit, ku leja 1-vjeçare mund të ripërtërihet jo më shumë se 5 herë radhazi;
   b) 2 vjet, e cila mund të ripërtërihet jo më shumë se një herë,
   c) 5 vjet, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
   ç) e përhershme, në rast se i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm për 5 vjet radhazi në Shqipëri dhe ka lidhje ose veprimtari të qëndrueshme në vend.
5. Shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetasit e Republikës së Kosovës, kur aplikojnë për herë të parë dhe plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji, përfitojnë leje qëndrimi me afat 5-vjeçar.
6. Kërkesa për leje qëndrimi bëhet nga i huaji sipas kritereve dhe dokumentacionit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 34

Refuzimi i lëshimit, ripërtëritjes apo anulimit të lejes së qëndrimit

1. Lëshimi ose ripërtëritja e lejes së qëndrimit mund të refuzohet ose mund të anulohet nëse:
   a) i huaji nuk ka arritur ta dorëzojë kërkesën apo të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të përcaktuar dhe nuk paraqet arsye të besueshme që të justifikojë moskryerjen e këtij veprimi;

   b) i huaji nuk është në gjendje të vërtetojë se plotëson ose nuk plotëson më kushtet e kërkuara për qëndrim, sipas kritereve të kërkuara;
   c) i huaji përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe është bërë subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë;
   ç) është zgjidhur martesa, në rast se i huaji ka përfituar lejen e qëndrimit për shkak të bashkimit familjar;
   d) arsyet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit nuk ekzistojnë më, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;
   dh) kur leja është marrë duke përdorur dokumentacion të rremë ose në kushte mashtrimi.
   e) kur ka qëndruar më shumë se 180 ditë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë brenda 1 viti të lejes së qëndrimit.
2. Në rrethana të jashtëzakonshme, leja e qëndrimit mund të lëshohet ose të ripërtërihet edhe nëse qëllimi i qëndrimit nuk ekziston më ose ka ndryshuar për shkak të:
   a) trajtimit mjekësor, ndërprerja e të cilit kërcënon humbjen e jetës,
   b) mosrinovimi apo anulimi i lejes së qëndrimit cenon të drejtën për jetë familjare dhe interesin më të lartë të fëmijës ose;
   c) për arsye humanitare.
3. Refuzimi i lëshimit, ripërtëritjes apo anulimit të lejes së qëndrimit i njoftohet kërkuesit/mbajtësit me shkrim, sipas formatit të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe duhet të përmbajë, ndër të tjera, arsyen e refuzimit, detyrimet që rrjedhin për të huajin si pasojë e refuzimit të lëshimit, ripërtëritjes apo anulimit të lejes së qëndrimit, si dhe të drejtën e ankimit, afatet dhe autoritetin ku drejtohet ankimi administrativ.
4. Procedura e lëshimit, e refuzimit të lëshimit, e ripërtëritjes apo e anulimit të lejes së qëndrimit miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 35

Ankimi kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit

1. Kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes apo të anulimit të lejes së qëndrimit, i huaji ka të drejtën e ankimit administrativ tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të organit epror bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI II
LEJA E PËRKOHSHME E QËNDRIMIT

Neni 36

Kritere për lëshimin e lejeve të përkohshme të qëndrimit

1. I huaji pajiset me leje të përkohshme qëndrimi, e cila është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në aplikim, por jo më shumë se një vit kur aplikohet për herë të parë, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe në këtë ligj apo marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.
2. I huaji, i pajisur me leje të përkohshme qëndrimi, për arsye të justifikuara mund të qëndrojë jashtë Shqipërisë deri në 180 ditë, me kusht që ai ose ajo të ketë njoftuar më parë policinë për arsyet e largimit nga Shqipëria.
3. I huaji, i pajisur me leje të përkohshme të qëndrimit me afat të paktën 1-vjeçar, quhet banor i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë vetëm pasi regjistrohet në zyrat e gjendjes civile të njësisë së qeverisjes vendore, ku ka vendqëndrimin e përkohshëm, si dhe duhet të njoftojë autoritetet përgjegjëse sa herë ndryshon vendqëndrimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Procedura dhe formulari i regjistrimit të të huajit në gjendjen civile miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
4. Prindi ose kujdestari ligjor apo institucioni i ngarkuar me trajtimin e të miturve të pashoqëruar ka të drejtë të aplikojë për leje të përkohshme qëndrimi për të miturit.

Neni 37

Kërkesa për lëshimin dhe ripërtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit

1. I huaji brenda 30 ditëve pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe brenda afatit të qëndrimit të ligjshëm në territor për të huajt që hyjnë pa vizë bën kërkesë për lëshimin e lejes së përkohshme të qëndrimit dhe brenda 60 ditëve përpara përfundimit të afatit të lejes ekzistuese të qëndrimit bën kërkesë për ripërtëritjen e saj, duke plotësuar formularin standard dhe listën e dokumenteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Formulari i kërkesës përmban të dhënat personale të të huajit, shtetësinë e tij, të dhëna të tjera të pasaportës, kualifikimet arsimore, profesionin, gjendjen civile, qëllimin, vendin dhe mjetet financiare, arsyet për qëndrimin e tij të planifikuar, të dhënat e regjistrimit të automjetit, kur gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë ka në përdorim një automjet të regjistruar në një vend jashtë Republikës së Shqipërisë.
3. Autoritetet përgjegjëse të kufirit dhe migracionit shqyrtojnë kërkesën për pajisjen ose ripërtëritjen e lejes së qëndrimit. Nëse gjatë pranimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga i huaji rezulton se nuk përmbushen kushtet e kërkuara për pajisjen apo ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, autoriteti rajonal për kufirin dhe migracionin, ku është depozituar kërkesa, njofton të huajin për mangësitë e konstatuara dhe i kërkon atij plotësimin e mangësive brenda 30 ditëve. Koha e shtyrjes për plotësimin e dokumentacionit shtyn afatin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të lejes së qëndrimit.
4. Pas pranimit të kërkesës, i huaji pajiset me një leje provizore, e cila zëvendëson krejtësisht vlefshmërinë e lejes për të cilën ka aplikuar i huaji dhe dorëzohet në çastin e marrjes së lejes së qëndrimit. Formati i lejes provizore të qëndrimit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Dokumenti zëvendësues i lejes së qëndrimit

1. Nëse leja e qëndrimit dhe leja unike humbet, dëmtohet apo bëhet e pavlefshme, sipas përcaktimeve të këtij ligji, i huaji duhet të njoftojë menjëherë me shkrim autoritetin shtetëror përgjegjës të kufirit dhe

migracionit, i cili ka lëshuar lejen e qëndrimit dhe lejen unike.

2. Autoriteti shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me dublikatë të lejes së qëndrimit dhe lejes unike, formati i së cilës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Lejet e qëndrimit sipas motivit

Leja e qëndrimit lëshohet sipas motiveve të mëposhtme:

a) për motive të bashkimit familjar;
b) për motive studimi (student dhe nxënës);
c) për të trajnuarin pa pagesë;
ç) për *au pairs*;
d) për shkëmbime rinore;
dh) për kërkim shkencor;
e) për kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët;
ë) për raste humanitare;
f) për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;
g) për personat pa shtetësi;
gj) për leje unike qëndrimi për motive pune, si:
   i. leje unike si punëmarrës;
   ii. leje unike për punësim stinor;
   iii. leje unike për të transferuar brenda ndërmarrjes;
   iv. leje unike si punëtor ndërkufitar;
   v. leje unike për formim profesional;
   vi. leje unike për sportistë;
   vii. leje unike për shërbim vullnetar;
   viii. leje unike për punonjës me kualifikim të lartë;
   ix. leje unike për persona të vetëpunësuar;
   x. leje unike për punonjës lëvizës digjital;
   xi. leje unike për investitorë;
   xii. leje unike për shërbime kontraktuese;
   xiii. leje unike për kategori të veçanta.
h) për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit;
i) për leje qëndrimit për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi;
j) për leje qëndrimit për pensionistët.

SEKSIONI III

LEJA E QËNDRIMIT PËR MOTIVE TË BASHKIMIT FAMILJAR

Neni 40

Bashkimi familjar i të huajit me një shtetas/e shqiptar/e

1. I huaji, i cili është anëtar i familjes së një shtetasi/e shqiptar/e, pajiset me leje qëndrimi me afat jo më shumë se një vit për herë të parë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshje apo në këtë ligj. Leja e qëndrimit ripërtërihet më pas për një periudhë dyvjeçare. Ky përcaktim për bashkëshortin/en e një shtetasi/e shqiptar/e vlen edhe për të miturin, i cili nuk është i martuar dhe për të cilin i huaji është kujdestar ligjor.
2. I huaji nuk pajiset me leje qëndrimi ose i anulohet leja e qëndrimit nëse provohet se martesa është fiktive, sipas nenit 44 të këtij ligji.

Neni 41

Bashkimi familjar i të huajit me anëtarët e familjes

1. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, mund të bëjë kërkesë pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për bashkim familjar nëse plotëson kushtet e mëposhtme:
   a) anëtarët e familjes së tij ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Përjashtimisht, për arsye humanitare, sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe procedurave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, kërkesa mund të bëhet edhe kur anëtari/ët e familjes ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
   b) është i pajisur me leje qëndrimi me afat së paku 1-vjeçar në Republikën e Shqipërisë dhe ka mundësi ta ripërtërijë lejen në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji;
   c) siguron strehim në kushte normale jetese sipas standardeve të përgjithshme për shëndetin dhe sigurinë;
   ç) ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij për të cilën kërkon bashkimin familjar;
   d) garanton burime të qëndrueshme të të ardhurave financiare

për të mbajtur veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike;

dh) paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave.

2. Leja e qëndrimit për bashkim familjar jepet për herë të parë për një periudhë kohe 1-vjeçare, e ripërtëritshme, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshje apo në këtë ligj.
3. Leja e qëndrimit për bashkim familjar, në rast se plotësohen kushtet e kërkuara në këtë ligj dhe kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ripërtërihet sipas përcaktimeve në nenin 37 të këtij ligji.
4. Fëmijët e pamartuar, si dhe paraardhësit e kërkuesit (ftuesit), që janë objektivisht të pamundur të plotësojnë nevojat e tyre për arsye të gjendjes shëndetësore, mund të pajisen me leje qëndrimi si raste përjashtimore.
5. Fëmijët e pamartuar mund të aplikojnë për leje qëndrimi për bashkim familjar deri në moshën 30 vjeç, me kusht që i huaji kërkues (ftuesi) të garantojë mbulimin e të gjitha shpenzimeve të jetesës për ta.
6. Në rast se refuzohet dhënia e lejes së qëndrimit për bashkim familjar, i huaji ose familjarët e tij kanë të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.
7. I huaji i pajisur me leje qëndrimi për bashkim familjar mund të ndjekë një aktivitet ekonomik, përveç rastit kur ka një ligj që e ndalon atë dhe pa marrë më parë miratimin e AKPA-së. Kjo e drejtë shënohet në lejen e qëndrimit për bashkim familjar.
8. Leja e qëndrimit për qëllime të bashkimit familjar nuk i jepet një anëtari familjeje të një të huaji, të cilit i është lëshuar një leje qëndrimi dhe pune për qëllime të punës sezonale.

Neni 42

Leja e qëndrimit autonome

1. Bashkëshorti/ja apo bashkëjetuesi/ja, si dhe fëmijët që kanë arritur moshën madhore, të pajisur me leje qëndrimi për bashkim familjar, pasi kanë qëndruar në mënyrë të vazhdueshme së paku 5 vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë me leje qëndrimi për bashkim familjar dhe me kusht që të mos kenë marrë leje qëndrimi për arsye të ndryshme nga ajo e bashkimit familjar, gjatë kësaj periudhe qëndrimi gëzojnë të drejtën e përfitimit të lejes së qëndrimit autonome.

2. Në rast të zgjidhjes së marrëdhënies familjare të bashkëshortit/es, ose të partnerit/es së pamartuar, brenda periudhës 5-vjeçare nga përfitimi i lejes së parë të qëndrimit, për efekt të bashkimit familjar, kjo e drejtë humbet. Përjashtimisht, kur zgjidhja e marrëdhënies familjare me bashkëshortin/ bashkëjetuesin bëhet për shkak të dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, viktimave të dhunës me bazë gjinore u jepet, me kërkesë, një leje qëndrimi autonome, pavarësisht nga kohëzgjatja e martesës ose marrëdhënies.
3. Në rast të vdekjes të të huajit kërkues (ftuesit), bashkëshorti/ja apo paraardhësit dhe pasardhësit, të cilët kanë qëndruar në Republikën e Shqipërisë me leje qëndrimi për motiv të bashkimit familjar së paku 3 vjet, gëzojnë të drejtën e aplikimit për leje qëndrimi në mënyrë të pavarur, nëse ata plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj, si dhe duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës.
4. Në rast se fëmijët që mbushin moshën madhore janë të pajisur me leje qëndrimi të përhershme, aplikimi për herë të parë për leje qëndrimi autonome bëhet për leje qëndrimi të përhershme, duke plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 87 të këtij ligji.

Neni 43

Bashkimi familjar i refugjatëve

1. Për anëtarët e familjes së refugjatit, që gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për azilin.
2. Autoriteti përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin, mbi bazën e kërkesës nga autoriteti shtetëror për shtetësinë dhe refugjatët, pajis anëtarin e familjes së refugjatit me leje qëndrimi.

Neni 44

Martesa fiktive

1. Martesa fiktive, sipas këtij ligji, është martesa e lidhur me qëllim për të shmangur përmbushjen e kushteve për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë.
2. Martesa mund të konsiderohet fiktive nëse provohet një nga rrethanat e mëposhtme:

a) bashkëshortët pas bashkimit familjar nuk jetojnë së bashku pa ndonjë arsye;

b) bashkëshortët pas bashkimit familjar nuk përmbushin detyrimet martesore ndaj njëri-tjetrit;
c) bashkëshortët nuk janë takuar përpara se ata të lidhnin martesën;
ç) bashkëshortët nuk janë në gjendje të japin të dhëna personale të njëri-tjetrit që përputhen në mes tyre;
d) bashkëshortët nuk flasin një gjuhë apo formë komunikimi të kuptueshme nga të dy;
dh) për lidhjen e martesës ose bashkimin familjar janë paguar shuma financiare ose janë shkëmbyer pasuritë martesore, përveç rastit kur këto pasuri janë pjesë e pajës dhe bashkëshortët vijnë nga vende ku shkëmbimi i pajës është traditë;
e) ka prova të një martese fiktive të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër.

3. I huaji nuk pajiset me leje qëndrimi për bashkim familjar në rast të martesave fiktive.

Neni 45

Anulimi i lejes së qëndrimit të marrë për shkak të bashkimit familjar

Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin anulon lejen e qëndrimit për të huajin, i cili e ka marrë atë për shkak të bashkimit familjar, në rast se provohet se:

a) i huaji kërkues (ftues) dhe përfituesi kanë lidhur një martesë fiktive për përfitimin e lejes së qëndrimit;
b) i huaji kërkues (ftues) ose përfituesi ka mashtruar në paraqitjen e të dhënave ose ka paraqitur të dhëna të rreme;
c) leja është lëshuar:
   i. për shkak të bashkimit familjar dhe martesa është zgjidhur brenda 5 vjetëve nga marrja e lejes;
   ii. për shkak të vdekjes së bashkëshortit, brenda 3 vjetëve nga marrja e lejes;
   iii. kanë pushuar të drejtat për kujdestari prindërore, me përjashtim të rastit kur i huaji ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë me leje qëndrimi për të paktën 5 vjet;
   iv. kur martesa është zgjidhur për shkak të dhunës në familje.
ç) të dy prindërve ose njërit nga prindërit apo kujdestarit/ve ligjorë i është hequr leja e qëndrimit dhe të miturit nuk i garantohet qëndrimi nga prindi tjetër apo kujdestari ligjor.

SEKSIONI IV

LEJET E QËNDRIMIT PËR MOTIVE ARSIMI, TRAJNIMI DHE KËRKIMI SHKENCOR

Neni 46

Leja e qëndrimit për studentë dhe nxënës

1. I huaji, i cili ka hyrë dhe qëndron në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi pranë një institucioni arsimor publik apo privat të njohur nga shteti shqiptar, ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi sipas kritereve të përgjithshme të përcaktuara në nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.
2. I huaji, i pranuar në një institucion arsimor ose që merr pjesë në trajnime ose praktika profesionale, pajiset me leje qëndrimi, me afat jo më shumë se një vit kur lëshohet për herë të parë dhe mund të shtyhet çdo herë me një vit deri në përfundimin e shkollës, të studimeve ose të praktikës. Në rast se kohëzgjatja e kursit është më e vogël se një vit, afati i lejes së qëndrimit është i barabartë me kohëzgjatjen e kursit.
3. I huaji duhet të provojë se është pranuar nga institucioni arsimor, se ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës së shkollimit ose trajnimit, si dhe disponon mjete financiare të mjaftueshme për jetesën në Republikën e Shqipërisë gjatë studimeve. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit, përveç të tjerash, i huaji duhet të provojë mbi progresin e bërë në drejtim të studimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
4. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi si student, pas vitit të parë të studimeve, jashtë kohës së tij të studimit, në bazë të lejes përkatëse të punës, ka të drejtë të punësohet dhe mund t'i jepet e drejta e ushtrimit të aktivitetit të vetëpunësimit, duke respektuar limitin maksimal 15 orë në javë, ose ekuivalenti me ditë ose muaj në vit, pa miratimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Punëdhënësi i tij njofton autoritetet shtetërore përgjegjëse për punësimin, për fillimin dhe përfundimin e punësimit.
5. Gjatë periudhës së studimeve, leja e qëndrimit për studentin nuk mund të zëvendësohet në leje qëndrimi për motiv punësimi. Pas përfundimit të studimeve, i huaji, nëse plotëson kushtet për punësim sipas kritereve të këtij ligji, mund të aplikojë për leje unike.

Neni 47

Leja e qëndrimit për të trajnuarin pa pagesë

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të pajisë të huajin, që ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është trajnuar pa pagesë, në zbatim të legjislacionit në fuqi, me "leje qëndrimi për të trajnuarin pa pagesë", me afat jo më shumë se 1 vit, kur vlerësohet se dokumentacioni i paraqitur plotëson kërkesat për marrjen e një lejeje qëndrimi dhe vetëm kur rezulton se aktiviteti i synuar është i lidhur ngushtësisht me rritjen e aftësive, kualifikimin e të huajit dhe i kufizuar në kohëzgjatje.
2. Leja e qëndrimit, përjashtimisht, mund të zgjatet për të përfituar një kualifikim profesional të njohur nga Republika e Shqipërisë në fushën e aktivitetit të të trajnuarit.

Neni 48

Leja e qëndrimit *au pairs*

1. Autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me "leje qëndrimi *au pairs*", me afat për aq kohë sa zgjat marrëveshja midis *au pairs* dhe familjes pritëse, gjithmonë kur kjo është më pak se një vit ose për një periudhë maksimale prej një viti.
2. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të ripërtërijë lejen e qëndrimit edhe një herë tjetër, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, pas një kërkese të justifikuar nga familja pritëse, përjashtuar rastet e mospërmbushjes së kritereve të parashikuara në këtë ligj apo nëse familja pritëse ose organizata që ndërmjetëson *au pair* nuk ka arritur të përmbushë detyrimet e saj ligjore në lidhje me sigurimet shoqërore, taksat, të drejtat e punës ose kushtet e punës.
3. I huaji për t'u pajisur me leje qëndrimi *au pairs* duhet:
   a) të sigurojë një marrëveshje midis tij dhe familjes pritëse, që përcakton të drejtat dhe detyrimet si një *au pair*, duke përfshirë specifikimet në lidhje me vlerën monetare që do të marrë me vete, rregullimet e përshtatshme që lejojnë *au pair* të marrë pjesë në kurse dhe orët maksimale të detyrave familjare;
   b) të jetë midis moshës 18 dhe 30 vjeç.
   c) të sigurojë dëshmi se familja pritëse ose organizata ndërmjetësuese për *au pairs*, për aq sa parashikohet nga legjislacioni kombëtar, pranon përgjegjësinë për shtetasin e huaj gjatë gjithë qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në veçanti në lidhje me shpenzimet e jetesës, akomodimin dhe rreziqet nga aksidentet;
   ç) të mos ketë pasur asnjëherë rekorde kriminale;
   d) të mos ketë qenë asnjëherë nën trajtim psikoterapik dhe psikologjik në të shkuarën.
4. I huaji, që aplikon të pranohet si *au pair*, të sigurojë prova në lidhje me:
   a) njohuritë e gjuhës shqipe; ose
   b) përfundimin e arsimit të mesëm, të lartë/kualifikimeve profesionale ose që plotëson kushtet për të ushtruar një profesion të rregulluar, siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar në fuqi.
5. Anëtarët e familjes pritëse të jenë me kombësi të ndryshme nga i huaji që aplikon për t'u pranuar me qëllim të *au pairs* dhe të mos kenë pasur ndonjë lidhje familjare me shtetasin e huaj në fjalë.
6. Numri maksimal i orëve të detyrave të *au pair*-it nuk duhet të kalojë 25 orë në javë. *Au pair* do të ketë të paktën një ditë në javë pa detyra të lidhura me *au pair*-in.

Neni 49

Leja e qëndrimit për shkëmbime rinore

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me "leje qëndrimi për shkëmbime rinore", me afat jo më shumë se 1 vit, vetëm kur aktiviteti i synuar është i lidhur ngushtësisht me shkëmbimin rinor apo skemën e lëvizshmërisë rinore, të parashikuar në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe në fuqi në Republikën e Shqipërisë, dhe i kufizuar me kohëzgjatje, si dhe kur plotëson kërkesat për marrjen e "lejes së qëndrimit për shkëmbime rinore".
2. Leja e qëndrimit mund të zgjatet përjashtimisht nëse një gjë e tillë është e parashikuar në marrëveshjet e lidhura për këtë qëllim dhe të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Neni 50

Leja e qëndrimit për kërkim shkencor

Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me "leje qëndrimi për kërkim shkencor", me afat jo më shumë se 1 vit, të huajin i cili ka lidhur një marrëveshje me një institucion shqiptar për këtë qëllim dhe plotëson kushtet e përgjithshme për pajisje me leje qëndrimi, sipas nenit 36 të këtij ligji.

Neni 51

Leje qëndrimi me qëllim kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët

1. Pas përfundimit të kërkimeve ose studimeve, të huajt kërkues shkencorë dhe studentë kanë mundësinë të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të një lejeje qëndrimi sipas përcaktimeve të bëra në nenin 36 të këtij ligji, për një periudhë prej të paktën nëntë muajsh, në mënyrë që të kërkojnë punë ose të zhvillojnë një biznes.
2. Me qëllim që studentët të përfitojnë nga zbatimi i këtij neni, duhet të kenë një nivel arsimimi që nuk duhet të jetë më i lartë se niveli 7 i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.
3. Për qëllimet e qëndrimit, pas një kërkese nga kërkuesi shkencor ose studenti i huaj, autoriteti për kufirin dhe migracionin do të lëshojë një leje qëndrimi në përputhje me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji.

   Autoriteti për kufirin dhe migracionin mund të kërkojë për kërkuesit shkencorë një konfirmim nga organizata kërkimore për përfundimin e veprimtarisë kërkimore ose për studentët dëshmi se zotërojnë një diplomë të arsimit të lartë, certifikatë ose prova të tjera të kualifikimeve zyrtare.
4. Autoriteti për kufirin dhe migracionin mund të refuzojë një kërkesë, sipas këtij neni, kur:
   a) kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, nuk plotësohen;
   b) dokumentet e paraqitura janë fituar me mashtrim ose janë falsifikuar apo manipuluar.
5. Pas një minimumi prej tre muajsh nga lëshimi i lejes së qëndrimit sipas këtij neni, autoriteti për kufirin dhe migracionin mund t'u kërkojë

shtetasve të huaj që të provojnë se kanë një shans të mirëfilltë për t'u angazhuar në aktivitet pune ose për të filluar një biznes.
6. Autoriteti për kufirin dhe migracionin mund të kërkojë që punësimi që kërkon i huaji ose biznesi që ai ose ajo është në procesin e krijimit, korrespondon me nivelin e hulumtimit ose të studimeve të përfunduara.
7. Nëse kushtet e parashikuara në pikat 3 ose 5 nuk plotësohen më, autoriteti për kufirin dhe migracionin mund të anulojë lejen e qëndrimit të të huajit në përputhje me parashikimet e nenit 34 të këtij ligji.

Neni 52

Leje e qëndrimit për raste humanitare

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, për raste humanitare, pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit "A" të huajin edhe nëse kushtet e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji apo kriteret e tjera të përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj nuk plotësohen, në rast se i huaji:
   a) ka paraqitur përpara autoriteteve të azilit një kërkesë për t'u njohur si refugjat;
   b) ka qenë subjekt i kushteve të punës shfrytëzuese në Republikën e Shqipërisë dhe bashkëpunon në një proces penal kundër punëdhënësit deri në përfundimin e procesit dhe i huaji të këtë marrë shumën e dëmshpërblimit të tij që përcaktohen nga procesi;
   c) ka bashkëpunuar ose pranon të bashkëpunojë me organet e drejtësisë, me propozim të organeve shtetërore ose të atyre të sigurisë kombëtare;
   ç) është përcaktuar nga autoritetet përgjegjëse se është person pa shtetësi;
   d) është i mitur i braktisur ose ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqërues për arsye të tjera;
   dh) është grua shtatzënë mbi 6 muaj;
   e) personat e sëmurë rëndë që nuk mund të trajtohen në vendin e kthimit, personat që kërkojnë të qëndrojnë sepse janë larguar nga vendi i tyre për shkak të katastrofave/ngjarjeve natyrore;

ë) në raste të tjera, të përcaktuara si të tilla në marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Leja e qëndrimit, e lëshuar për këtë motiv, shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë në rast se i huaji del nga territori. Leja e qëndrimit për këtë motiv lëshohet me afat 1-vjeçar dhe rinovohet vetëm në rastet kur:
   a) vlerësohet se qëndrimi i saj/i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë publike dhe atë kombëtare;
   b) vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;
   c) është në pritje të vlerësimit të statusit nga autoritetet kompetente.
3. I huaji, të cilit i jepet leje e përkohshme qëndrimi sipas pikës 1 të këtij neni, gëzon të drejtat për të qëndruar dhe lëvizur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të garantuara si për të huajt që kanë leje qëndrimi të përkohshme, sipas procedurave normale. Ai bashkëpunon me organet përgjegjëse për përcaktimin e identitetit të vet, por mungesa e provës, që vërteton identitetin, nuk mjafton si bazë për refuzimin e lëshimit të lejes së përkohshme të qëndrimit. I huaji gëzon të drejtën për kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, ndihmë ligjore falas, të drejtën për përkthim dhe mbështetje psikologjike, si dhe të drejtën për të punuar nëse i përfiton sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 53

Lëshimi i lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit "A" të huajin që është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit edhe nëse kushtet e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji ose kriteret e tjera të përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj nuk plotësohen.
2. Leja e qëndrimit, e lëshuar për këtë motiv, shërben vetëm për qëndrimin e të huajit dhe nuk mundëson rihyrjen në territorin e

Republikës së Shqipërisë në rast se i huaji del nga territori. Leja e qëndrimit për këtë motiv lëshohet me afat 1-vjeçar dhe rinovohet vetëm në rastet kur:
   a) vlerësohet se qëndrimi i saj/i tij nuk përbën kërcënim për sigurinë publike dhe atë kombëtare;
   b) vlerësohet se ekziston një vullnet i qartë i personit për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;
   c) është në pritje të vlerësimit të statusit nga autoritetet kompetente.
3. I huaji, të cilit i jepet leje e përkohshme qëndrimi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, gëzon të drejtat për të qëndruar dhe lëvizur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të garantuara si për të huajt që kanë leje qëndrimi të përkohshme, sipas procedurave normale. Ai bashkëpunon me organet përgjegjëse për përcaktimin e identitetit të vet, por mungesa e provës, që vërteton identitetin, nuk mjafton si bazë për refuzimin e lëshimit të lejes së përkohshme të qëndrimit. I huaji përfiton kujdes shëndetësor, ndihmë financiare, mbështetje, si dhe të drejtën për të punuar nëse i përfiton sipas dispozitave ligjore në fuqi.
4. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përkohshme qëndrimi të tipit "A", për një afat 3-mujor, të huajin, pavarësisht nga vullneti i tij/saj për të bashkëpunuar me drejtësinë, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se i huaji është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit, e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit. Kjo leje qëndrimi me afat 3-mujor i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.
5. Gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit, viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit gëzojnë të gjitha të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë viktimat e trafikimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
6. Leja e qëndrimit, e lëshuar për periudhën e rikuperimit dhe reflektimit, mund të revokohet nëse provohet se viktima ose viktima e mundshme e trafikimit e ka fituar apo pretenduar këtë status në mënyrë të padrejtë, ka rivendosur aktivisht, vullnetarisht dhe/apo

me iniciativën e saj/të tij marrëdhënie me personat e dyshuar për trafikimin e qenieve njerëzore ose konsiderohet se qëndrimi i saj/tij në territor përbën rrezik për sigurinë kombëtare. Revokimi i lejes së qëndrimit për periudhën e rikuperimit dhe reflektimit i komunikohet viktimës apo viktimës së mundshme të trafikimit në formë të shkruar, në gjuhën që ajo/ai kupton, duke e informuar atë për arsyet e revokimit, me përjashtim të rastit kur leja e qëndrimit ndërpritet për arsye të sigurisë kombëtare.

7. I huaji me statusin e viktimës së mundshme të trafikimit ka të drejtën e punësimit pa marrë më parë miratim nga AKPA-ja dhe duhet të njoftohet nga punëdhënësi lidhja e marrëdhënieve të punësimit.
8. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin rinovon lejen e qëndrimit të tipit "A" për të huajin, viktimë e trafikimit në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar si të tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit, në njërën ose tjetrën prej dy situatave të mëposhtme ose në të dyja këto situata:
   a) vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për shkak të situatës sociale dhe personale;
   b) vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për qëllim të bashkëpunimit me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal.
9. Dhënia e lejes së qëndrimit nuk kushtëzohet me ekzistencën e mjeteve të mjaftueshme financiare të viktimës për të mbuluar shpenzimet për kohën e qëndrimit apo nga mungesa e dokumenteve identifikuese të viktimës apo viktimës së mundshme të trafikimit.

Neni 54

Përcaktimi i statusit dhe lëshimi i dokumentit një personi pa shtetësi

1. Kërkesa për të vërtetuar nëse aplikanti është person pa shtetësi i paraqitet autoritetit përgjegjës në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
2. Kërkesa e përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk mund të paraqitet nga një shtetas i huaj:
   a) i cili ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;
   b) të cilit i është njohur statusi i refugjatit në Republikën e Shqipërisë;
   c) të cilit i është dhënë azili, mbrojtja plotësuese ose mbrojtje shtesë në përputhje me ligjin për azilin.
3. Procedura për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 55

Leje qëndrimi për personat pa shtetësi

1. Personit pa shtetësi mund t'i lëshohet leja e qëndrimit të përkohshëm me kusht që ai ose ajo të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji, të ketë qëndruar 1 vit në Shqipëri para se të paraqesë kërkesën, si dhe nëse ai/ajo synon të vazhdojë qëndrimin e tij/të saj në Republikën e Shqipërisë.
2. Një person pa shtetësi mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë bazuar në një dokument udhëtimi për një person pa shtetësi ose leje qëndrimi të përkohshme.

SEKSIONI V
LEJE UNIKE

Neni 56

Parime të përgjithshme për punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë

1. I huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë duke u pajisur me leje unike, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë apo qëndrim të njëanshëm të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Veprimet paraprake për hapjen e një aktiviteti biznesi apo shërbimesh nuk konsiderohen si punë.
3. Kërkesa për leje unike qëndrimi për një të huaj mund të bëhet nga vetë i huaji, me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë.
4. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes unike të qëndrimit, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhen nga 4 deri në 12 javë nga dita e aplikimit. Në momentin e aplikimit i jepet një vërtetim për pranimin e aplikimit.

5. Punëdhënësi nuk mund të punësojë një të huaj që qëndron në mënyrë të parregullt në Republikën e Shqipërisë.
6. Kur punëdhënësi punëson një të huaj, duhet të njoftojë autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin brenda 8 ditëve nga fillimi i punës të të huajit.
7. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen e të huajve me leje unike sipas motiveve, në përputhje me këtë ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57

Leje unike si punëmarrës

1. Leja unike si punëmarrës për një shtetas të huaj jepet në rast se një shtetas i huaj plotëson kriteret për qëndrimin e përkohshëm, kriteret e posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Leja unike si punëmarrës jepet sipas afateve të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.
3. Leja unike si punëmarrës jepet për kohëzgjatjen e kontratës/ofertës së punës, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 58

Leje unike për punësim stinor

1. Leja unike si punëtor stinor i jepet të huajit në rast se plotëson kriteret për qëndrimin e përkohshëm, kriteret e posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji dhe pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Leja unike si punëtor stinor jepet me afat deri në gjashtë muaj, për çdo vit kalendarik, për rajone, punëdhënës, profesione dhe kontratë pune, me afat kohor të përcaktuar.
3. Në rast se kontrata/oferta e punës e të huajit përcakton se aktiviteti që do të ushtrojë është një profesion i rregulluar, i huaji duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në përputhje me të drejtën kombëtare të ushtrimit të profesioneve të rregulluara.
4. Në vitin pasardhës kalendarik, punëdhënësi mund të paraqesë kërkesë për leje unike si punëtor stinor për të njëjtin të huaj, me

kusht që të jetë përmbushur një ndërprerje e detyrueshme kohore prej 6 muajsh.
5. Pas përfundimit të kontratës së punës, i huaji duhet të rikthehet në vendin e tij të origjinës, me përjashtim të rasteve kur plotëson kriteret sipas legjislacionit në fuqi për t'u pajisur me leje qëndrimi.
6. Ky nen nuk zbatohet për shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen, si dhe për rastet kur zbatohet një regjim i posaçëm, i parashikuar me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 59

Leje unike për të transferuar brenda ndërmarrjes (TBN)

1. Leja unike (TBN) lëshohet për qëllim të transferimit brenda ndërmarrjes së një të huaji. Një transferim brenda ndërmarrjes është dërgimi i përkohshëm i një të huaji:
   a) te një njësi kombëtare, që i përket ndërmarrjes në të cilën i huaji është i punësuar, nëse ndërmarrja ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; ose
   b) te një njësi kombëtare e një ndërmarrjeje tjetër të grupit të ndërmarrjeve të cilit i përket ndërmarrja e vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nga i cili është punësuar i huaji.
2. Një i huaj pajiset me një leje unike (TBN), nëse:
   a) i huaji do të punojë si menaxher ose specialist në njësinë pritëse;
   b) i huaji ka qenë i punësuar nga ndërmarrja ose grupi i ndërmarrjeve për të paktën gjashtë muaj menjëherë para transferimit dhe do të punësohet pa ndërprerje nga ndërmarrja ose grupi i ndërmarrjeve gjatë periudhës së transferimit;
   c) transferimi brenda korporatës do të kalojë 90 ditë;
   ç) i huaji siguron një kontratë pune të vlefshme për kohëzgjatjen e transferimit brenda korporatës dhe një letër detyre/marrëveshje ku citohet:
      i. informacioni specifik në lidhje me vendin dhe llojin e punës, shpërblimin dhe kushtet e tjera të punësimit gjatë transferimit brenda ndërmarrjes;
      ii. i huaji do të jetë në gjendje të kthehet në një njësi ekonomike që i përket së njëjtës ndërmarrje ose grup ndërmarrjesh të

krijuara jashtë Republikës së Shqipërisë, pas përfundimit të transferimit brenda ndërmarrjes; dhe

d) i huaji siguron prova për kualifikimet e veta profesionale.

3. I huaji gjithashtu do të pajiset me leje unike (TBN), nëse:
   a) i huaji do të punojë si punonjës praktikant në kontekstin e një transferimi brenda ndërmarrjes; dhe
   b) plotësohen kushtet e referuara në pikën 2, shkronjat "b", "c" dhe "ç".
4. Leja unike (TBN) jepet:
   a) për kohëzgjatjen e transferimit, por jo më shumë se tre vjet, për menaxherët dhe specialistët;
   b) për kohëzgjatjen e transferimit, por jo më shumë se një vit, për punonjësit praktikantë.

   Periudhat maksimale të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike nuk mund të tejkalohen duke zgjatur lejen e qëndrimit (TBN).
5. Leja unike (TBN) nuk u jepet të huajve që janë duke përfunduar një program trajnimi si pjesë e studimeve të tyre.
6. Për llogaritjen e periudhës së punës për të njëjtin vend pune, llogaritet gjithë periudha e kryer për atë vend pune nga punonjës të ndryshëm të huaj, për llogari të punëdhënësit.
7. Në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe, i huaji që pajiset me leje unike (TBN) i nënshtrohet legjislacionit vendas të mbrojtjes sociale.

Neni 60

Deklarata e transferimit brenda ndërmarrjes

1. Punëdhënësi i huaj, që bën transferimin sipas nenit 59 të këtij ligji, duhet të dorëzojë një deklaratë transferimi jo më vonë se 7 ditë përpara fillimit të punës të të transferuarit, ku duhet të përfshihen:
   a) emri dhe subjekti i regjistruar, emri, mbiemri dhe adresa e punëdhënësit të huaj dhe detajet e kontaktit telefonik dhe elektronik të tij;
   b) emri dhe mbiemri i punëtorit të transferuar dhe informacioni për punën e punëtorit të transferuar;
   c) fillimi dhe kohëzgjatja e parashikuar e transferimit;
   ç) emri dhe selia e subjektit ose emri, mbiemri dhe adresa e përfituesit, vendi i ofrimit të shërbimeve dhe një përshkrim i shkurtër i shërbimit;
   d) i nformacioni për datën e lëshimit, afati i vlefshmërisë, numri dhe organi kompetent që ka lëshuar lejen unike të punëtorit të transferuar.
   dh) në rastin e "Praktikantëve të diplomuar", punëdhënësi paraqet një marrëveshje trajnimi, e cila përmban programin e trajnimit, kohëzgjatjen e tij, si dhe kushtet në të cilat praktikanti do të mbikëqyret.
2. Punëdhënësi i huaj, që bën transferimin sipas nenit 59 të këtij ligji, raporton çdo ndryshim të të dhënave të referuara në pikën 1 të këtij neni gjatë periudhës së transferimit.
3. Deklarata e përmendur në pikën 1 të këtij neni dorëzohet në formë të shkruar ose elektronike pranë autoritetit shtetëror përgjegjës për punësimin dhe ruhet në dosjen e aplikimit për transferimin e të huajit.

Neni 61

Leje unike si punëtor ndërkufitar

1. Leja unike si punëtor ndërkufitar për një të huaj jepet në rast se i huaji plotëson kriteret për qëndrimin e përkohshëm, kriteret e posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. I huaji nga një vend fqinj me Republikën e Shqipërisë pajiset me leje unike për punësim ndërkufitar si punëmarrës, punëdhënës ose i vetëpunësuar, në një zonë gjeografike kufitare të territorit të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara nga marrëveshje dypalëshe në fuqi për qarkullimin ndërkufitar, me kusht që të rikthehet në vendbanimin e tij të përhershëm çdo ditë ose të paktën një ditë në javë, duke ruajtur vendbanimin dhe vendqëndrimin në vendin e origjinës.
3. Në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe, punëtori i huaj, që pajiset me leje unike si punëtor ndërkufitar i nënshtrohet legjislacionit vendas të mbrojtjes shoqërore.

Neni 62

Leje unike për formim profesional

1. Leja unike për formim profesional për një shtetas të huaj jepet në rast se i huaji plotëson kriteret për qëndrimin e përkohshëm, kriteret e posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Të huajit i jepet leje unike për kryerjen e një kursi të formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, që kufizohet në kohëzgjatje dhe lidhet ngushtë me zgjerimin e aftësive e të kualifikimeve në profesion, pas pranimit paraprak në kurs nga një subjekt i formimit profesional, i licencuar nga autoritetet përkatëse në vend.
3. Leja unike për formim profesional jepet me vlefshmëri kohore të njëjtë me atë të veprimtarisë së formimit profesional të tij, me kusht që të provojë se ky formim është i lidhur ngushtë me rritjen e aftësive dhe të kualifikimit të tij.

Neni 63

Leje unike për sportistë

1. Leja unike për sportistë për një shtetas të huaj jepet në rast se i huaji plotëson kriteret për qëndrimin e përkohshëm, kriteret e posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. I huaji me profesion sportist pajiset me leje unike mbi bazën e një kontrate me një punëdhënës/organizatë sportive (shoqatë, shoqëri apo klub sportiv), në përputhje me profesionin e tij, nëse për punësimin e tij është marrë federimi nga federata përkatëse sportive.
3. Të huajit i ripërtërihet leja unike si sportist nëse ka një kontratë pune të vlefshme në përputhje me profesionin e tij si sportist, por jo domosdoshmërish me punëdhënësin/organizatën sportive (shoqatë, shoqëri apo klub sportiv), që ka përfituar lejen e mëparshme unike të qëndrimit.

Neni 64

Leja unike për shërbime vullnetare

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me "leje qëndrimi për shërbime vullnetare" me afat jo më shumë se 1 vit, herën e parë vetëm kur aktiviteti i synuar është i lidhur ngushtësisht me skemën e shërbimit vullnetar, ligjërisht të njohur në Republikën e Shqipërisë dhe i kufizuar në kohëzgjatje, si dhe kur plotëson kërkesat për marrjen e "lejes së qëndrimit për shërbime vullnetare", nëse Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka dhënë më parë miratimin e saj në përputhje me nenin përkatës të miratimit për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.
2. Vlefshmëria e lejes së qëndrimit nuk mund të tejkalojë afatet e programit përkatës vullnetar për të cilin kërkohet të lëshohet leja e qëndrimit.
3. Nëse afati i kohëzgjatjes së programit përkatës vullnetar është më shumë se 1 vit, leja e qëndrimit ripërtërihet sipas parashikimeve të nenit 37 të ligjit.

Neni 65

Leja unike për punonjës me kualifikim të lartë "Karta blu AL"

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me leje unike "Kartë blu AL" për punë me kualifikim të lartë vetëm nëse ka marrë më parë miratimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për punonjës të kualifikuar dhe kur përmbush kushtet për marrjen e një lejeje qëndrimi "Kartë blu AL"
2. Leja unike "Kartë blu AL" për punë me kualifikim të lartë lëshohet për një afat 2-vjeçar dhe mund të ripërtërihet për një periudhë 3-vjeçare. Në rast se miratimi për punësim për punonjësin me kualifikim të lartë është lëshuar për një kohëzgjatje më pak se 2 vjet, leja e qëndrimit "Kartë blu AL" lëshohet për afatin e miratimit të punësimit plus 3 muaj.
3. Mbajtësi i lejes unike "Kartë blu AL" njofton autoritetet përgjegjëse për ndryshimet në marrëdhëniet e tij/saj të punësimit.

Neni 66

I huaji që nuk përfiton leje unike "Kartë blu AL"

Nuk përfitojnë leje unike për punë me kualifikim të lartë "Kartë blu AL" të huajt, të cilët:

a) qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare apo sipas skemave të mbrojtjes së përkohshme;
b) janë refugjatë ose kanë paraqitur kërkesë për të marrë statusin e refugjatit dhe kjo kërkesë e tyre ende nuk ka marrë formën e një vendimi përfundimtar;
c) kanë paraqitur kërkesë pranë autoriteteve të kufirit dhe migracionit në Republikën e Shqipërisë për t'u pajisur ose janë pajisur me leje qëndrimi si kërkues/studiues, me qëllim kryerjen e një projekti studimor/kërkimor;
ç) gëzojnë statusin e banorit afatgjatë dhe ushtrojnë të drejtën e tyre për të qëndruar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, si punëmarrës ose i vetëpunësuar;
d) hyjnë në Republikën e Shqipërisë sipas angazhimeve të parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë, që lehtësojnë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm të disa kategorive tregtare dhe personave fizikë të lidhur me investime;
dh) për arsye ligjore u është pezulluar dëbimi.

Neni 67

Leja unike për të vetëpunësuar

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me "leje unike si i vetëpunësuar" kur vlerësohet se dokumentacioni i paraqitur plotëson kërkesat për marrjen e një "lejeje unike si i vetëpunësuar".
2. "Leja unike si i vetëpunësuar" jepet, nëse:
   a) ka një interes ekonomik;
   b) aktiviteti që do të kryhet pritet të ketë një ndikim pozitiv mbi ekonominë;
   c) kur i huaji ka një kapital për të realizuar idenë e biznesit.
3. Vlerësimi i plotësimit të kushteve të pikës 2 të këtij neni bëhet nga institucionet kompetente, përfshirë ato të vendndodhjes së

planifikuar të biznesit. Ngritja, përbërja dhe funksionimi i komisionit vlerësues bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë.
4. Periudha e vlefshmërisë së lejes unike si i vetëpunësuar është në përputhje me kohëzgjatjen e biznesit të planifikuar, por jo më shumë se 3 vjet. Pas 3 vjetësh të huajit mund t'i lëshohet leja e përhershme e qëndrimit nëse ai ka kryer në mënyrë të suksesshme aktivitetin e planifikuar dhe ka të ardhura të përshtatshme për veten dhe personat në varësi të tij ose të saj dhe nëse përmbushen kushtet e tjera për leje të përhershme qëndrimi.
5. Leja unike si i vetëpunësuar mund të jepet e kufizuar në ushtrimin e aktivitetit, rajon dhe profesion, sipas përcaktimeve në lejen e përfituar për ushtrim të aktivitetit.
6. Pas lëshimit të "lejes unike si i vetëpunësuar", mbajtësi i saj është i detyruar të njoftojë autoritetet kompetente për çdo ndryshim të kushteve mbi të cilat është lëshuar leja dhe të kërkojë miratimin e saj në rast se ndryshimi lidhet me:
   a) emrin dhe adresën e tij të punës e të banimit;
   b) aktivitetet e autorizuara si person i vetëpunësuar.

Neni 68

Leje unike qëndrimi për punonjës lëvizës digjital

Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin e pajis të huajin me "leje unike qëndrimi për punonjës lëvizës" me afat deri në 1 vit, për herë të parë, në rastet kur shtetasi i huaj është me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe:

a) provon me kontratë të vlefshme punësimi me punëdhënësin jashtë shtetit apo kontratë shërbimi me kontraktuesin ose porositësin jashtë shtetit se do të punojë pa një seli konkrete për punë specifike, të cilat lejojnë punën me mjete të teknologjisë së informacionit;
b) provon se ka të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
c) zotëron dëshmi të akomodimit dhe adresës në Republikën e Shqipërisë;
ç) ka një policë të sigurimit shëndetësor të vlefshme për të paktën 1 vit;
d) zotëron një certifikatë/dëshmi penaliteti nga vendi i tij i origjinës, ku detajohet nëse ka apo jo një rekord penal.

Neni 69

Leja unike për investitorë

1. I huaji pajiset me leje unike si investitor me një afat kohor dyvjeçar kur:
   a) bën një investim;
   b) raporti i të punësuarve në aktivitetin ekonomik të jetë për çdo të huaj pesë shtetas shqiptarë dhe ky raport të ruhet edhe në bordin drejtues dhe organet e tjera drejtuese ose kontrolluese;
   c) paga e tyre të jetë të paktën sa mesatarja e pagës së paguar në Republikën e Shqipërisë për këto poste të vitit pararendës;
   ç) subjekti të zotërojë dokumente të rregullta, me të cilat të provojë se aktiviteti i tij nuk është me humbje, dhe dokumente të rregullta të regjistrimit dhe shlyerjes së detyrimeve në organet tatimore.
2. Vlerësimi i plotësimit të kushteve të pikës 1 të këtij neni bëhet në institucionet kompetente, përfshirë ato të vendndodhjes së investimit të planifikuar. Ngritja, përbërja dhe funksionimi i komisionit vlerësues bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës.
3. Leja unike si investitor jepet pas vlerësimit të kushteve të përmendura në pikën 1 nga komisioni i vlerësimit dhe është e ripërtëritshme me afat kohor trevjeçar nëse nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është dhënë leja unike e mëparshme.
4. I huaji pajiset me leje të përhershme qëndrimi pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së lejes së dytë me afat trevjeçar nëse nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është lëshuar leja e fundit e qëndrimit.
5. Në rastet kur investitori i huaj nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin për lejet e përhershme të qëndrimit dhe nëse nuk kanë ndryshuar kushtet e punës për të cilat është lëshuar leja e fundit e punës, i huaji pajiset me leje unike me afat dyvjeçar, e ripërtëritshme me afat trevjeçar.
6. Vlera e investimit përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.

Neni 70

Leje unike për shërbime kontraktuese

1. I huaji pajiset me leje unike për shërbime kontraktuese kur ai kryen një veprimtari apo ofron një shërbim bazuar në një kontratë të

nënshkruar me përfituesin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë.
2. I huaji, që nuk është i regjistruar për kryerjen e një aktiviteti dhe që ka qëndrim të vazhdueshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mund të marrë leje unike për ofrimin e shërbimeve kontraktuese vetëm në raste të justifikuara kur ofruesi i shërbimeve zotëron njohuri të veçanta, të cilat nuk mund të gjenden në ofertën e fuqisë punëtore vendase.
3. I huaji pajiset me leje unike për shërbime kontraktuese nëse:
   a) është i angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë. Gjatë periudhës së shkëputjes duhet të ekzistojë një marrëdhënie pune ndërmjet punonjësit dhe personit juridik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka një kontratë shërbimi me subjektin e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
   b) ka të paktën dy vjet eksperiencë në fushën e veçantë, objekt i kontratës së shërbimit;
   c) ka kualifikimet përkatëse profesionale që lidhen me ofrimin e shërbimit sipas legjislacionit në fuqi.
   ç) nuk merr shpërblim për ofrimin e shërbimeve të tjera, përveç shpërblimit të dhënë nga klienti, me të cilin punëdhënësi i tij/saj ka një kontratë për ofrimin e shërbimit.
4. "Profesionistët e pavarur", të cilëve iu lejohet hyrja për ofrimin e shërbimeve, do t'u nënshtrohen këtyre kushteve:
   a) të jenë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi në një bazë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, kur ata janë të regjistruar si të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, të kenë një kontratë shërbimi për një periudhë që nuk i kalon dymbëdhjetë muaj;
   b) të zotërojnë së paku tre vjet përvojë profesionale në fushën e aktivitetit që është objekt i kontratës;
   c) të kenë kualifikimet profesionale kur kjo është e nevojshme për të ushtruar një veprimtari në bazë të ligjit, rregulloreve ose kërkesave të palës që e merr këtë shërbim.
5. Hyrja e përkohshme dhe qëndrimi i profesionistëve të pavarur në shërbim të palës së interesuar do të jetë për një periudhë të përgjithshme jo më shumë se dymbëdhjetë muaj ose për kohëzgjatjen

e kontratës, cilado qoftë ajo, por gjithmonë kur qëndrimi nuk e kalon periudhën dymbëdhjetëmujore.

6. Procedura e lëshimit të lejes unike kryhet nga autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
7. Leja unike mund të lëshohet disa herë brenda një viti kalendarik, por me një kohëzgjatje totale jo më shumë se 90 ditë. I huaji, që ofron shërbime në fushat e shkencës, kulturës, sporteve, shëndetësisë dhe arsimit, mund të pajiset me leje unike deri në 1 vit nëse nuk ekzistojnë kushtet për lidhje të marrëdhënieve të punësimit.
8. Nëse lidhet një kontratë për punë të kryer nga i huaji për një periudhë më të gjatë se një vit, leja unike mund të ripërtërihet në bazë njëvjeçare deri në përfundimin e kontratës.
9. Hyrja dhe punësimi për shërbime kontraktuese mund të lidhet vetëm me ushtrimin e kualifikuar të punëmarrësit, që i referohet zbatimit të veprave apo ofrimit të shërbimeve të veçanta për të cilat duhet përvojë specifike.

Neni 71
Pavlefshmëria e lejes unike

Leja unike bëhet e pavlefshme, kur:

a) nuk mund të ripërtërihet periudha e vlefshmërisë së saj, për çfarëdolloj arsyeje;
b) vlefshmëria kohore e pasaportës apo e dokumentit të identifikimit të të huajit nuk mund të shtyhet;
c) i huaji qëndron jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 6 muaj pa ndërprerje, duke përjashtuar rastet e forcës madhore për këtë mungesë;
ç) i huaji nuk fillon veprimtarinë brenda 3 muajve nga data e lëshimit të lejes unike, duke përjashtuar rastet e forcës madhore për këtë mungesë;
d) i huaji dorëzon para afatit lejen unike të qëndrimit.

Neni 72
Refuzimi dhe anulimi i lejes unike

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës për kufirin dhe migracionin ka të drejtë të anulojë lejen unike përpara afatit kohor të vlefshmërisë së saj kur:

a) është marrë me mashtrim ose duke paraqitur informacion të rremë;
b) pas lëshimit të lejes unike, provohet se dokumentacioni që shoqëron kërkesën nuk është i saktë;
c) i huaji vepron ose propagandon kundër sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, sigurisë kombëtare, rendit kushtetues dhe rendit publik;
ç) është anuluar leja unike;
d) i huaji nuk është i pranishëm në Republikën e Shqipërisë për një periudhë të pandërprerë me shumë se 180 ditë brenda 1 viti qëndrimi, përveç rasteve kur dërgohet nga punëdhënësi në një vend tjetër ose nuk është i pranishëm për shkak arsimimi dhe formimi profesional, sëmundjeje, përkujdesjeje për fëmijët apo për shkak të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
dh) i huaji kryen punë tjetër nga ajo për të cilën është lëshuar leja unike, me përjashtim të të huajve, të cilët kanë një leje të përhershme qëndrimi;
e) i huaji ndërpret kontratën e punës për arsye të ndryshme dhe largohet nga vendi i punës për të cilin ka marrë lejen.

Në këtë rast, punëdhënësi informon brenda 2 javëve autoritetet përgjegjëse ku i huaji është pajisur me lejen unike.

2. Papunësia nuk përbën arsye të mjaftueshme për anulimin e lejes unike, përveçse kur periudha e papunësisë vazhdon më shumë se:
   a) tre muaj brenda periudhës 12-mujore në rastin e mbajtësit të lejes unike për punëmarrësin, i cili ka ushtruar ligjërisht veprimtari si punëmarrës ose i vetëpunësuar në Republikën e Shqipërisë për më pak se tre vjet;
   b) gjashtë muaj brenda periudhës 12-mujore në rastin e mbajtësit të lejes unike për punëmarrësin, i cili ka ushtruar ligjërisht veprimtari si punëmarrës ose i vetëpunësuar në Republikën e Shqipërisë për tre vjet dhe më shumë.
3. Vështirësitë financiare nuk përbëjnë arsye të mjaftueshme për anulimin e lejes unike si person i vetëpunësuar, përveç rastit kur mbajtësi nuk është në gjendje të përballojë koston e jetesës.
4. Procedura e lëshimit, e refuzimit të lëshimit, e ripërtëritjes ose e anulimit të lejes së qëndrimit miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 73

Ankimi kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes ose të anulimit të lejes unike

1. Kundër urdhrit të refuzimit të lëshimit, të ripërtëritjes ose të anulimit të lejes unike, i huaji ka të drejtën e ankimit administrativ tek autoriteti epror i drejtpërdrejtë i autoritetit që ka nxjerrë urdhrin, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të organit epror bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative sipas legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI VI
PUNËSIMI I TË HUAJVE
PËRFSHIRJA E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Neni 74

Miratimi i punësimit të një të huaji

1. Leja unike për të huajin, brenda kuotave të caktuara, lëshohet duke mbajtur parasysh zhvillimet dhe nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë.
2. Aplikimi për leje unike bëhet në drejtoritë e kufirit dhe migracionit në rajonin ku kryhet aktiviteti.
3. Autoritetet e kufirit dhe migracionit lëshojnë lejen unike pasi është marrë miratimi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, marrëveshje ndërqeveritare ose me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Kërkesa për miratimin e punësimit për një të huaj mund të bëhet nga vetë i huaji me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë ose nga punëdhënësi.
5. Kategoritë që përjashtohen nga detyrimi për të marrë miratimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive sipas këtij neni janë: i huaji, anëtar familjeje i një shtetasi të huaj me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, studentët, i huaji që sipas neneve të posaçme të këtij ligji përjashtohet nga detyrimi për miratim për punësim, të vetëpunësuarit, investitorët, *au pairs*, i huaji me statusin

e viktimës së mundshme të trafikimit, refugjatët, i huaji me mbrojtje të përkohshme dhe i huaji me statusin e mbrojtjes plotësuese.

6. Kategoritë që marrin miratim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në marrëveshje ndërshtetërore apo akte të tjera ligjore, janë punëmarrësit, punonjësit stinorë të transferuar brenda ndërmarrjes, punonjësit me kualifikim të lartë, vullnetarët, sportistët dhe shërbimet kontraktuale.
7. Agjencia Kombëtar e Punësimit dhe Aftësive jep miratimin e saj nëse:
   a) aplikimi është brenda kuotave vjetore të miratuara, në zbatim të këtij ligji;
   b) punonjësit e huaj nuk janë punësuar në kushte më pak të favorshme se punonjësit shqiptarë në të njëjtin pozicion. Nga shqyrtimi i informacionit lidhur me pagat, orët e punës dhe kushtet e tjera të punësimit, ato janë në përputhje me legjislacionin shqiptar të punës;
   c) plotësohen kërkesat e neneve të posaçme që lidhen me punësimin;
   ç) asnjë punonjës nga kategoritë e përcaktuara në pikën 9 të këtij neni nuk është i disponueshëm për atë vend pune.
8. Miratimi për punësim për të huajin e transferuar brenda ndërmarrjes, për punonjës me kualifikim të lartë, punonjës për shërbime kontraktuale, vullnetarë dhe sportistë jepet vetëm për plotësimin e kritereve të vendosura në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 7 të këtij neni.
9. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, përpara miratimit të kërkesës për punësimin e një të huaji, propozon brenda afatit kohor të publikimit të vendit të lirë të punës kandidatë të përshtatshëm, sipas profilit të kërkuar, të gatshëm të punojnë në vendin vakant të punës si më poshtë:
   a) punëkërkues të papunë shqiptarë;
   b) të huaj, anëtarë të familjes së shtetasve shqiptarë;
   c) shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjes së tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;
   ç) shtetas të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut;

d) anëtarë të familjes së të huajit me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;

dh) shtetas të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje punësimi dy apo shumëpalëshe;

e) të huaj që gëzojnë përparësi për përfshirje në tregun shqiptar të punës, sipas dispozitave të këtij ligji.

10. Kërkesa për plotësimin e një vendi të lirë pune bëhet publike nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për një periudhë kohore prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike që nga dita e regjistrimit të kërkesës për miratimin e punësimit për një shtetas të huaj pranë këtij autoriteti.
11. Për të marrë miratimin, punëdhënësi duhet të dërgojë në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive informacion për pagën, orët e punës, kriteret dhe kushtet e tjera të punësimit. Punëdhënësit që dëshirojnë të punësojnë ose kanë punësuar një të huaj duhet ta dërgojnë këtë informacion brenda një periudhe 2-javore nga kërkesa e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
12. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive jep miratimin për punësim brenda 2 javëve (10 ditë pune) nga marrja e kërkesës për miratim për punësim kur janë plotësuar të gjitha kriteret e tjera ligjore ose nga momenti i plotësimit të tyre.
13. Punëdhënësi, para se të paraqesë një kërkesë për miratim për punësim për një të huaj, mund të kontrollojë kushtet e tregut të punës për dhënien e këtij miratimi. Ai mund ta dërgojë informacionin e përmendur në pikat 10 dhe 11 të këtij neni në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Punëdhënësi mund ta përdorë këtë mundësi në rast se ai do të qartësojë më parë nëse i lejohet punësimi i një të huaji dhe të përshpejtojë procesin e miratimit për punësim.
14. Miratimi për punësim mund të jetë i kufizuar në kohë, llojin e punësimit, punësim, rajon specifik dhe shpërndarje të orëve të punës. Këto kufizime duhet të vendosen në lejen unike ose të qëndrimit.
15. Bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e këtij neni përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 75

Refuzimi i miratimit të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për punësimin e një të huaji

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive refuzon të japë miratimin për punësimin e një të huaji kur:

a) punëdhënësi 6 muaj para se të paraqesë kërkesë për leje unike për një të huaj ka larguar punëmarrësin për një periudhë të pacaktuar kohore;

b) marrëdhëniet dhe kushtet e shprehura në kontratë nuk përmbushin kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe të konventave ndërkombëtare për kushtet e punës e të punësimit;

c) informacionet në dokumentet e kërkuara nuk janë të plota ose pasqyrojnë të dhëna apo fakte të rreme;

ç) punëmarrësi i huaj nuk e paraqet kërkesën brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj dhe nuk paraqet arsye të besueshme që të justifikojë moskryerjen e këtij veprimi;

d) punëdhënësi ka refuzuar të punësojë një punëkërkues të papunë, ofruar nga zyra përkatëse e punësimit, i cili plotësonte kushtet e përcaktuara nga autoritetet shtetërore përgjegjëse sipas dispozitave të këtij ligji;

dh) punëdhënësi paraqet kërkesën për miratim për punësim për një të huaj brenda periudhës kohore prej 12 muajsh nga data e ndështkimit për shkelje, të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, si dhe për shkelje të legjislacionit të punës në fuqi;

e) pagat e marra nga punëtorët kanë qenë nën nivelin e përcaktuar nga marrëveshjet kolektive;

ë) punëdhënësi ose punëmarrësi i huaj nuk ka shlyer detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore;

f) punësimi është kryer në vijim të një vendosjeje apo rekrutimi të parregullt;

g) punëdhënësi ose entiteti pritës është prekur nga procedura e falimentimit;

gj) punëdhënësi ose entiteti pritës nuk zhvillon asnjë aktivitet ekonomik;

h) biznesi dhe entiteti pritës janë ngritur për qëllimin kryesor lehtësimin e hyrjes dhe qëndrimit të të huajve për qëllime

punësimi. E njëjta gjë zbatohet nëse marrëdhënia e punës është vendosur kryesisht për këtë qëllim;

i) ka arsye të besueshme se i huaji përbën rrezik për rendin, sigurinë dhe shëndetin publik në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur gjendja shëndetësore e të huajit nuk ka ndikim në punën për të cilën ai rekrutohet.

Neni 76

Revokimi i miratimit për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Miratimi për punësimin e një të huaji mund të revokohet në rast se i huaji është punësuar në kushte më pak të favorshme se shtetasit shqiptarë, si dhe në rastin kur nuk plotësohen më kërkesat e përcaktuara në nenet 74 dhe 75 të këtij ligji.

Neni 77

Përparësia në lëshimin e lejes unike

Leja unike e qëndrimit lëshohet pa marrë parasysh gjendjen dhe zhvillimet e tregut të punës dhe pa kufizime të tjera, sipas dispozitave të këtij ligji, nëse i huaji:

a) është bashkëshort/e i/e një shtetasi/e shqiptar/e dhe zotëron një leje qëndrimi;

b) është punësuar në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare ose ndërqeveritare, përveçse kur marrëveshjet parashikojnë ndryshe;

c) ka përfunduar një shkollë të mesme profesionale ose ka përfunduar një program studimi pranë një institucioni të arsimit të lartë, të njohur në Republikën e Shqipërisë;

ç) ka ardhur në Republikën e Shqipërisë për formim profesional;

d) ka statusin e të transferuarit brenda ndërmarrjes;

dh) cilësohet si punonjës "me kualifikim të lartë";

e) është punonjës lëvizës digjital.

Neni 78

Tregu i punës dhe kuotat vjetore të punësimit të të huajve

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë brenda datës 1 tetor të çdo viti cakton kuota vjetore për punësimin e të huajve për vitin pasardhës.

2. Kuotat vjetore për punësimin e të huajve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e migracionit të punës dhe të ministrit përgjegjës të sektorit përkatës.
3. Në rastin kur në një sektor të caktuar nevojat për punëtorë të huaj tejkalojnë numrin e përcaktuar në kuotën vjetore, ministri përgjegjës për çështjet e migracionit të punës i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e kuotave të reja për atë sektor.
4. Kuotat vjetore për punësimin e të huajve përcaktohen duke marrë parasysh analizën e nevojave për aftësi në tregun shqiptar të punës, projeksionet për zhvillimin ekonomik në sektorë të caktuar dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ata sektorë.
5. Kuota vjetore për punësimin e të huajve përcakton aktivitetet dhe profesionet në të cilën puna është e lejuar, si dhe numrin e miratimeve për punësim sipas aktiviteteve dhe profesioneve.
6. Kuota vjetore për punësimin e të huajve mund të përcaktojë edhe kuotën për punësim sezonal, sipas rastit.
7. Procedurat e bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitucional për përcaktimin e kuotave vjetore për punësim miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e migracionit të punës.

Neni 79

Përjashtimi nga kuotat vjetore të punësimit

1. Leja unike mund të lëshohet jashtë kuotave vjetore për të huajt në rastet kur janë:

a) punëtorë imigrantë ditorë mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe;

b) personel që mbajnë poste kryesore në kompani, degët dhe zyrat përfaqësuese të tyre;

c) të transferuar brenda ndërmarrjeve apo kompanive, si pjesë e transferimeve të brendshme brenda stafit të tyre, në kuadër të marrëveshjeve apo bashkëpunimeve të bazuara në programe bashkëpunimi;

ç) të vetëpunësuar në një kompani që ata vetë drejtojnë ose që zotërojnë më shumë se 51 për qind të aksioneve;

d) ofrues të shërbimeve kontraktuese në Republikën e Shqipërisë për llogari të një punëdhënësi të huaj;

dh) mësues dhe pedagogë në institucionet arsimore, që ushtrojnë mësimdhënie në lëndët e mësimit të gjuhës për pakicat kombëtare;
e) sportistë që punojnë në Republikën e Shqipërisë;
ë) artistë të huaj që punojnë në Republikën e Shqipërisë;
f) punonjës në bazë kontratash dhe që shpërblehen për punën e tyre në një organizatë të huaj, të regjistruar si një organizatë jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;
g) anëtarë të bordit drejtues të një fondacioni fetar apo humanitar, të njohur dhe të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që punojnë në bazë kontratash dhe që shpërblehen për punën e tyre;
gj) punonjës në kuadrin e aktiviteteve të shkëmbimeve rinore në Republikën e Shqipërisë në bashkëpunim me shtete të tjera;
h) punonjës kërkimorë shkencorë në institucione kërkimore-shkencore, arsimore apo në subjekte juridike, me objekt pune kërkimin shkencor dhe mësimdhënien në specialitete të munguara në Republikën e Shqipërisë;
i) personel akademik në institucionet e arsimit të lartë, personel akademik i ftuar nga institucione të arsimit të lartë apo mësues në institucionet arsimore parauniversitare shqiptare për gjuhët e huaja;
j) të huaj që punojnë në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare.

2. Kategoritë e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të këtij neni, marrin miratim nga AKPA-ja vetëm për kushtet e punës.

Neni 80

Përjashtimi nga detyrimi për miratimin për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Nuk kanë nevojë për miratim për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të huajt:

a) shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, anëtarët e familjes së shtetasve të SHBA-ve, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjeve të tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së

Veriut, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë të drejtën e punësimit sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare sipas legjislacionit shqiptar. Deklarimi për punësimin e tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor pranë zyrës së punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti;
b) për qëndrim deri në 1 muaj brenda 1 viti si:
   i. persona që negociojnë për një marrëveshje apo përkujdesen për një pavijon në një panair;
   ii. vizitorë biznesi;
   iii. pjesëtarë të ekuipazheve të avionëve;
   iv. personeli i institucioneve të arsimit të lartë, studiues apo specialistë të huaj në fushën e kërkimit shkencor, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe qeveritare apo të vetë institucioneve arsimore;
   v. trajnues që vijnë në kuadër të bashkëpunimit midis institucioneve qeveritare apo të vetë institucioneve arsimore;
   vi. personel i organizatave humanitare, që veprojnë sipas programeve ndërkombëtare të bashkëpunimit.
c) për qëndrim deri në 2 muaj brenda 1 viti të pjesëtarëve të ekuipazheve të anijeve;
ç) që punësohen në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore. Deklarimi për punësimin e tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose vetë i huaji pranë zyrës së punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti.

Neni 81

Pajisja me leje unike për kategori të veçanta

1. Pajisen me leje unike për raste të veçanta për një periudhë qëndrimi deri në 60 ditë brenda 1 viti të huajt:
   a) ofrues shërbimesh auditimi dhe konsulence;
   b) personeli i institucioneve të arsimit të lartë që marrin pjesë në seminare të përbashkëta;

c) artistë dhe staf teknik që marrin pjesë në aktivitete kulturore, si: opera, balet, teatër, koncerte, autorë apo aktorë të filmave ose shfaqjeve televizive;
ç) të huaj që punojnë në cirk apo aktivitete të tjera argëtuese për publikun;
d) të huaj që punojnë në panaire apo ekspozita;
dh) persona që instalojnë makineritë apo konstruksionet, që dorëzohen nga një shoqëri e huaj dhe bëjnë shërbimin e riparimin e makinerive, si dhe trajnimin e punonjësve shqiptarë ose të huaj, për shfrytëzimin e tyre.

2. Pajisen me leje unike për kategori të veçanta, për një periudhë qëndrimi deri në 90 ditë brenda 1 viti, të huajt që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, si:
a) personeli i transportit ndërkufitar të mallrave dhe njerëzve në territorin shqiptar, selitë e të cilëve janë regjistruar jashtë vendit;
b) ofrues shërbimesh biznesi, të cilët nuk angazhohen në shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë dhe nuk marrin shpërblim nga një burim që gjendet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
c) punonjës shkencorë, përfaqësues të institucioneve shkencore dhe shkencëtarë, që marrin pjesë në zbatimin e projekteve të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë mbi bazën e marrëveshjeve qeveritare apo programeve të bashkëpunimit midis institucioneve;
ç) personeli i institucioneve të arsimit të lartë, mësues, studiues, specialistë të huaj, staf administrativ, që vijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si pjesë e një programi mësimor bashkëpunimi apo që janë pjesë e stafit të institucionit arsimor qendror, nëse ky institucion ka degë në Republikën e Shqipërisë;
d) pjesëtarë të ekuipazheve të anijeve apo të avionëve;
dh) personel që kryejnë shërbime humanitare pa shpërblim në organizata jofitimprurëse apo institucione, në bazë të rregulloreve të veçanta apo të programeve ndërkombëtare të bashkëpunimit;
e) trajnues që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga kompani të huaja ose degë të tyre në vende të tjera për aktivitet trajnimi për formim profesional, në bazë programesh bashkëpunimi midis institucioneve;

ë) ekspertë në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, bibliotekave apo arkivave;
f) nxënës ose studentë që vijnë në kuadër të marrëdhënieve të bashkëpunimit, trajnimit apo të shkëmbimit të eksperiencës.

3. Pajisen me leje unike për kategori të veçanta, për një qëndrim më shumë se 90 ditë sipas kohëzgjatjes së kontratës së punës, të huajt:
a) e misioneve e të asistencës teknike pranë institucioneve qendrore, institucioneve të pavarura ose institucioneve me varësi të drejtpërdrejtë nga këto institucione;
b) konsulentët ose këshilltarët pranë institucioneve qendrore shtetërore, institucioneve të pavarura apo institucioneve me varësi të drejtpërdrejtë nga këto institucione, në kuadër të marrëveshjeve qeveritare apo projekteve të organizatave ndërkombëtare;
c) përfaqësuesit dhe stafi i organizatave jofitimprurëse, të njohura dhe të regjistruara në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk shpërblehen për punën e tyre;
ç) zyrtarët civilë dhe ushtarakë që vijnë të punojnë në Republikën e Shqipërisë në kuadrin e një marrëveshjeje me qeverinë e vendit nga vijnë;
d) përfaqësuesit e masmedies, reporterët apo korrespondentët e huaj, të akreditуar në Republikën e Shqipërisë, që punojnë për një punëdhënës të huaj;
dh) personeli i institucioneve të arsimit të lartë, studiuesit apo specialistët e huaj, që vijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe, qeveritare/ndërinstitucionale apo vetë institucioneve arsimore.
e) përfaqësuesit dhe stafi i bashkësive fetare, të njohura dhe të regjistruara në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë, të cilët kryejnë aktivitete të lidhura ekskluzivisht me shërbimin fetar apo bamirës dhe nuk shpërblehen për punën e tyre;
ë) kategoritë e përcaktuara në pikën 1, shkronja "dh", dhe pikën 2, shkronjat "a", "d", "f".

4. Kriteret, dokumentacioni dhe procedurat për pajisjen me leje unike për kategori të veçanta caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Formati dhe përmbajtja e lejes unike për kategori të veçanta miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 82

Detyrimi për t'iu përmbajtur motivit të punësimit

1. I huaji në Republikën e Shqipërisë ka detyrimin t'i përmbahet motivit të lëshimit të lejes unike sipas motivit të punës.
2. I huaji i pajisur me leje unike është i detyruar të njoftojë autoritetet përgjegjëse për çdo ndryshim të kushteve mbi të cilat është lëshuar leja unike dhe të kërkojë miratimin e saj në rast se ndryshimi lidhet me:
   a) emrin dhe adresën e punëdhënësit;
   b) kontratën e vlefshme të punës që mbulon kohën për të cilën është lëshuar leja unike;
   c) aktivitetet e autorizuara si person i punësuar.

SEKSIONI VII
LEJE QËNDRIMI PËR MOTIVE TË TJERA

Neni 83

Leja e qëndrimit për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit

Ekuipazhi i mjeteve të lundrimit, i punësuar në një mjet lundrimi detar të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili kryen aktivitetin si i punësuar më shumë se 90 ditë për 180 ditë, si dhe ekuipazhi që kryen aktivitetin si i punësuar në një mjet lundrimi detar të huaj, por që për specifika të natyrës së aktivitetit qëndron më shumë se 90 ditë për 180 ditë në portet shqiptare, pajiset me leje unike.

Neni 84

Leje qëndrimi e përkohshme për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi

1. Një leje qëndrimi e përkohshme për përdorimin dhe disponimin e pasurisë së paluajtshme në Republikën e Shqipërisë mund t'i lëshohet një shtetasi të huaj sipas këtij ligji dhe që dëshmon pronësinë e një pasurie të tillë të paluajtshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të cilën është pronar gjatë kohës së lejes së qëndrimit.
2. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin e pajis të huajin me "leje qëndrimi për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi" me afat deri në 1 vit për herë të parë dhe e ripërtërtishme çdo vit nëse i huaji vazhdon të përmbushë kriteret e përcaktuara në ligj.

3. Leja e përmendur në pikën 1 mund t'i lëshohet një shtetasi të huaj, i cili është bashkëpronar i 1/2 së pasurisë së paluajtshme.
4. Procedurat dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 85

Leje qëndrimi për pensionistë

1. Shtetasit e huaj, që janë në pension në vendin e tyre, mund të aplikojnë për një leje qëndrimi për pensionistë pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin në Republikën e Shqipërisë.
2. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin e pajis të huajin me "leje qëndrimi për pensionistë" me afat deri në 1 vit për herë të parë në rastet kur shtetasi i huaj është me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe:
   a) provon se ka të drejtë për të ardhura vjetore nga pensioni deri në vlerën 1 200 000 lekë nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga vendi i origjinës dhe të legalizuara nga një noter publik;
   b) provon se ka të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
   c) vërteton nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga një bankë në Republikën e Shqipërisë që ka një llogari të vlefshme bankare, në të cilën do të bëhen transferime të rregullta të pensionit të tij/saj;
   ç) zotëron dëshmi të akomodimit dhe adresës në Republikën e Shqipërisë;
   d) ka një policë të sigurimit shëndetësor të vlefshme për të paktën 1 vit;
   dh) zotëron një certifikatë/dëshmi penaliteti nga vendi i tij i origjinës, ku detajohet nëse ka apo jo një rekord penal.
3. Leja e qëndrimit për shtetasin e huaj në pension mund të ripërtërihet çdo vit në rast se i huaji vazhdon t'i përmbushë kriteret e pikës 2 të këtij neni.
4. Mbajtësi i një lejeje qëndrimi të dhënë në bazë të pensionit jashtë vendit mund të kërkojë bashkim familjar në Republikën e Shqipërisë për bashkëshortin/bashkëshorten ose partnerin/partneren e tij/saj jo në pension.
5. Leja e qëndrimit për pensionistë nuk i jep të drejtën të huajit të kryejë asnjë lloj aktiviteti ekonomik ose profesional në Republikën e Shqipërisë.

Neni 86

Monitorimi i lejeve të qëndrimit

1. Mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi periodik i procedurave të lëshimit të lejeve të qëndrimit bëhen nga struktura përgjegjëse për të huajt në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
2. Procedurat e monitorimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

SEKSIONI VIII
LEJA E PËRHERSHME E QËNDRIMIT

Neni 87

Lëshimi i lejes së përhershme të qëndrimit

1. I huaji bën kërkesë për pajisje me leje të përhershme qëndrimi të tipit "C" pranë autoritetit përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin ku ka vendqëndrimin 60 ditë para mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit. Shqyrtimi i kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, si dhe pajisja e të huajit me leje qëndrimi të përhershme bëhet brenda 60 ditëve në rast se rezulton të jenë përmbushur kushtet e mëposhtme:
   a) ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme si banor në Republikën e Shqipërisë për të paktën 5 vjet nga paraqitja e parë e kërkesës për leje qëndrimi, përjashtuar rastet kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë apo vendim të Këshillit të Ministrave. Periudha e mungesës në territor deri në 6 muaj, kur në total nuk i kalojnë 10 muaj brenda 5 vjetëve të qëndrimit me leje qëndrimi, nuk konsiderohet pengesë për lëshimin e lejes së qëndrimit të përhershme. Për arsye specifike të argumentuara ose të jashtëzakonshme, si dhe kur i huaji dërgohet jashtë territorit për motive punësimi, në kuadër të shërbimeve ndërkufitare, pranohet një periudhë më e gjatë e mungesës se ajo e përmendur në këtë paragraf, me kusht që autoriteti përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin të jetë njoftuar më parë për ekzistencën e këtyre kushteve nga mbajtësi i lejes së qëndrimit, punëdhënësi i tij apo i huaji kërkues;
   b) provon se zotëron të ardhura dhe burime financiare të ligjshme, të cilat janë të mjaftueshme dhe garantojnë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi për jetesën e tij/saj, si dhe anëtarëve të familjes së tij/saj, pa pasur nevojë t'i drejtohen sistemit të asistencës sociale;
   c) provon se ka të mbuluar sigurimin shëndetësor sipas sistemit të sigurimit shëndetësor për shtetasit shqiptarë në Republikën e Shqipërisë;
   ç) ka të garantuar strehim të përshtatshëm për vete dhe anëtarët e familjes së tij në Republikën e Shqipërisë;
   d) provon se ka paguar rregullisht të gjitha taksat dhe detyrimet në Republikën e Shqipërisë gjatë kohës së qëndrimit;
   dh) gëzon statusin ligjor të refugjatit në Republikën e Shqipërisë, të fituar në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin.
2. Afatet e qëndrimit, për efekt të marrjes së lejes së qëndrimit afatgjatë për të huajin që ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë për motiv studimi apo formimi profesional, përllogariten sa gjysma e periudhave të qëndrimit.
3. Nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga i huaji rezulton se nuk përmbushen kushtet e kërkuara në pikën 1 të këtij neni, atëherë autoriteti përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin ku është depozituar kërkesa njofton të huajin për mangësitë e konstatuara dhe i kërkon atij plotësimin e mangësive brenda afatit 1-mujor.
4. Leja e përhershme e qëndrimit për punëtorë me kualifikim të lartë jepet e veçantë nga leja e qëndrimit afatgjatë e zakonshme dhe përmban shënimin "Kartë blu AL-C".
5. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin kontrollon të paktën një herë në dy vjet kushtet e qëndrimit të të huajit, të pajisur me leje qëndrimi të përhershme.
6. Dokumenti "leje e përhershme qëndrimi" zëvendësohet çdo 10 vjet me një procedurë automatike aprovimi.
7. Kalimi i afatit 10-vjeçar të dokumentit "leje e përhershme qëndrimi" asnjëherë nuk sjell anulimin apo humbjen e statusit të banorit afatgjatë.

Neni 88

Përjashtimi nga e drejta e pajisjes me leje qëndrimi të përhershme

Nuk përfitojnë nga rrethanat e përmendura në nenin 87 të këtij ligji, për të përfituar vendbanimin e përhershëm të huajt, që:

a) qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për motiv të vazhdimit të studimeve apo formimit profesional;
b) qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë në bazë të mbrojtjes së përkohshme apo kanë paraqitur kërkesë për të qëndruar në këtë bazë dhe janë në pritje të një vendimi lidhur me statusin e tyre;
c) kanë paraqitur kërkesë për të qëndruar në bazë të një forme ndihmëse (shtesë) mbrojtjeje dhe janë në pritje të një vendimi lidhur me statusin e tyre;
ç) janë azilkërkues, ndërkohë që kjo kërkesë e tyre ende nuk ka marrë vendim përfundimtar;
d) qëndrojnë vetëm për motive të përkohshme si punëtorë stinorë ose si ofrues të shërbimeve ndërkufitare apo në rastet kur leja e tyre e qëndrimit është kufizuar zyrtarisht.

Neni 89
Refuzimi i lëshimit të lejes së përhershme të qëndrimit

1. Të huajit i refuzohet lëshimi i lejes së përhershme të qëndrimit, në rast se:
   a) nuk plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 87 të këtij ligji, si dhe përfshihet në kategoritë e përcaktuara në nenin 88 të këtij ligji;
   b) ndaj tij ka filluar dhe nuk ka përfunduar një procedim gjyqësor penal për krime në Republikën e Shqipërisë;
   c) qëndrimi i tij në vend përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare.
2. Në rast se refuzimi i lëshimit të lejes së qëndrimit nuk shoqërohet me një urdhër largimi, i huaji ka të drejtë të kërkojë leje qëndrimi të përkohshme nëse vazhdon të plotësojë kushtet e përcaktuara në këtë ligj për t'u pajisur me leje të tillë qëndrimi.

Neni 90
Humbja e statusit të banorit afatgjatë

1. I huaji humbet statusin e banorit afatgjatë, në rast se:
   a) provohet se ka paraqitur të dhëna ose fakte të rreme për marrjen e këtij statusi;
   b) është subjekt dëbimi;

   c) përbën rrezik serioz për rendin dhe sigurinë publike, por ky rrezik nuk është arsye për dëbim, siç përcaktohet në nenin 105 të këtij ligji;
   ç) është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë për një periudhë, pa ndërprerje, më shumë se 12 muaj;
   d) k a pushuar ose i është hequr statusi i tij i refugjatit.
2. Të huajit, i cili sëmuret ose bëhet i paaftë pas pajisjes me leje qëndrimi të përhershme, nuk mund t'i anulohet leja e qëndrimit të dhënë apo t'i refuzohet ripërtëritja e lejes së përkohshme të qëndrimit në leje të përhershme, si dhe nuk i hiqet leja e përhershme e qëndrimit për këtë shkak.

Neni 91
Lëshimi i lejes së përhershme të qëndrimit për raste të veçanta

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me leje të përhershme qëndrimi të huajin nëse:
   a) provohet se ka prindërit ose gjyshërit me shtetësi shqiptare;
   b) fëmija ka lindur në Republikën e Shqipërisë, me prindër që kanë leje të përhershme qëndrimi, pa marrë parasysh kriteret që duhet të plotësohen për t'u pajisur me leje qëndrimi të përhershme.
2. Pajiset me leje të përhershme qëndrimi i huaji, familjarët e tij dhe personeli i tij kyç, por jo më shumë se 5 persona me kontratë pune pa afat, nëse ka kryer një investim në Republikën e Shqipërisë në sektorë strategjikë, në vlerë dhe në punësim sipas parashikimeve të legjislacionit për investimet strategjike.
3. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisje me leje të përhershme qëndrimi për raste të veçanta miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 92
Leja e qëndrimit për banorin afatgjatë të një shteti tjetër

1. Banori afatgjatë i një shteti tjetër, në kushtet e reciprocitetit të mundësuar nga një marrëveshje dy apo shumëpalëshe në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mund të paraqesë kërkesën për leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë nëse plotëson kushtet e nenit 36 të këtij ligji dhe për arsyet e mëposhtme:

a) ushtrimin e aktiviteteve, në cilësinë e punëmarrësit apo të vetëpunësuarit;
b) vazhdimin e studimeve apo formimin profesional;
c) motive të tjera.

2. Kushtet dhe kriteret e hyrjes dhe qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të banorit afatgjatë të një shteti tjetër, të mundësuar nga marrëveshje dy apo shumëpalëshe në fuqi në Republikën e Shqipërisë, zbatohen në bazë reciprociteti për banorët afatgjatë në Republikën e Shqipërisë, për të qëndruar në një territor tjetër respektiv.

Neni 93

Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për banorin afatgjatë të një shteti tjetër

1. Banori afatgjatë i një shteti tjetër mund të hyjë dhe të qëndrojë deri në 90 ditë në 180 ditë në Republikën e Shqipërisë pa pasur nevojë për vizë dhe të aplikojë për leje qëndrimi brenda 60 ditëve nga dita e hyrjes nëse plotëson kushtet e mëposhtme:
   a) disponon një dokument të vlefshëm udhëtimi, si dhe një leje qëndrimi afatgjatë në shtetin me të cilin Republika e Shqipërisë ka marrëveshje për lëvizjen e ndërsjellë të banorëve afatgjatë:
   b) disponon dokumentacion që provon se ka siguruar strehimin e rregullt në Republikën e Shqipërisë;
   c) provon se disponon burime të qëndrueshme financiare, që janë të mjaftueshme për mbajtjen e tij dhe të pjesëtarëve të familjes së tij;
   ç) disponon sigurimin shëndetësor, që mbulon të gjitha rreziqet sipas legjislacionit në fuqi;
   d) në rastin e ushtrimit të një aktiviteti ekonomik, disponon një leje unike të vlefshme;
   dh) në rast se është i vetëpunësuar, përveç lejes së nevojshme për të ushtruar këtë aktivitet, nëse disponon mjete të mjaftueshme financiare për ta ushtruar këtë aktivitet;
   e) në rast studimesh apo formimi profesional, prova të regjistrimit në një institucion arsimor apo të formimit profesional të njohur në Republikën e Shqipërisë.
2. Pas përfitimit të lejes së qëndrimit, i huaji ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me anëtarët e familjes së tij nëse janë të pajisur me leje qëndrimi në vendin ku ai ishte banor afatgjatë.

3. Për t'u pajisur me leje qëndrimi për bashkim familjar, familjarët e të huajit, që ka përfituar leje qëndrimi në kushtet e këtij neni, duhet të paraqesin:
   a) një dokument të vlefshëm udhëtimi, si dhe fotokopjen e faqes së parë të tij;
   b) fotokopjen e lejes së qëndrimit të të huajit kërkues (ftuesi) në Republikën e Shqipërisë;
   c) fotokopje të noterizuar të lejes së qëndrimit të banorëve afatgjatë në vendin ku kishin vendbanimin më parë;
   ç) nëse është e nevojshme, prova se kanë qëndruar si anëtarë të familjes së banorit afatgjatë në vendin tjetër para se të vinin në Republikën e Shqipërisë;
   d) sigurimin shëndetësor, që mbulon të gjitha rreziqet, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe dëshmi të vaksinimit, sipas sëmundjeve që mbulon kalendari i vaksinimit shqiptar;
   dh) prova se zotërojnë burime të qëndrueshme financiare, të mjaftueshme për mbajtjen e tyre pa iu drejtuar ndihmës ekonomike ose që banori afatgjatë kërkues ka burime të tilla të mjaftueshme për to.
4. Nëse familja e të huajit, që ka përfituar leje qëndrimi në kushtet e këtij neni, nuk ndodhet në shtetin ku i huaji ishte banor afatgjatë, atëherë për bashkimin familjar zbatohen përcaktimet e nenit 41 të këtij ligji.
5. Në rast të pajisjes me leje qëndrimi afatgjatë të një të huaji, që ka ardhur në Republikën e Shqipërisë si banor afatgjatë, sipas kushteve të këtij neni, atëherë lind detyrimi për njoftimin për këtë vendim të shtetit të parë nga i huaji ka ardhur.

Neni 94

Anulimi i lejes së qëndrimit dhe detyrimi i ripranimit

1. Leja e qëndrimit e lëshuar për të huajin, banorët afatgjatë të një vendi tjetër, sipas nenit 92 të këtij ligji, si dhe për familjarët e tyre mund të anulohet, t'u refuzohet ripërtëritja, si dhe të kërkohet largimi i tyre nga territori në rastet e mëposhtme:
   a) kur personi në fjalë paraqet kërcënim për shëndetin dhe sigurinë publike;

b) kur provohet se leja e qëndrimit është marrë me mashtrim dhe duke përdorur dokumente të falsifikuara;
c) kur mbajtësi i lejes së qëndrimit nuk qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve në këtë ligj.

2. Në rast anulimi apo refuzimi të ripërtëritjes së lejes së qëndrimit, i huaji bëhet subjekt ripranimi në shtetin prej nga ka ardhur në Republikën e Shqipërisë dhe ku kishte statusin e banorit afatgjatë.

Neni 95
Rregulla të përgjithshme për anëtarët e familjes së të huajit

1. I mituri, i cili ka hyrë në Republikën e Shqipërisë për shkak të bashkimit familjar, kur mbush moshën madhore, ka të drejtë të aplikojë në mënyrë të pavarur nga anëtarët e familjes për t'u pajisur me leje qëndrimi.
2. Bashkëjetuesit trajtohen njëlloj për aq sa është e zbatueshme si bashkëshortët lidhur me bashkimin familjar.
3. I huaji, në rast të martesave poligame, ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me njërën nga bashkëshortet, si dhe fëmijët e lindur nga kjo bashkëshorte.
4. Të huajt e pajisur me leje qëndrimi, të cilëve u ka lindur një fëmijë në Republikën e Shqipërisë, njoftojnë autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për aktin e lindjes brenda 30 ditëve dhe ky i fundit u lëshon leje të përkohshme qëndrimi për fëmijën.

Neni 96
Të drejtat e banorëve afatgjatë

1. I huaji i pajisur me leje të përhershme qëndrimi quhet banor afatgjatë dhe duhet të regjistrohet në zyrën përkatëse të gjendjes civile. I huaji, nëse plotëson kriteret, pajiset me letërnjoftim për të huajt, mund të punësohet, të vetëpunësohet ose të merret me veprimtari biznesi të drejtpërdrejtë, pa pasur nevojë të pajiset me leje punësimi.
2. Banorët afatgjatë gëzojnë të drejtat ekonomike, shëndetësore dhe sociale, të njëjta me shtetasit shqiptarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Formati i letërnjoftimit për banorët e huaj në Republikën e Shqipërisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

SEKSIONI IX
INTEGRIMI I TË HUAJVE NË JETËN EKONOMIKE, KULTURORE DHE SHOQËRORE

Neni 97
Asistenca për integrimin e të huajve

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit duhet të sigurojnë kushtet për integrim në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore të të huajve, që kanë të drejtën e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për integrimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë.

Neni 98
Institucionet dhe organizatat e përfshira

1. Institucionet publike bashkëpunojnë, sipas kompetencave, me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin dhe zbatimin e programeve të integrimit të të huajve në shoqëri.
2. Në të gjitha veprimtaritë e ushtruara, institucionet publike dhe organizatat jofitimprurëse u ofrojnë të huajve mbrojtje kundër çdolloj forme diskriminimi.
3. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë nga personat juridikë, publikë dhe privatë, gjatë gjithë procesit të imigrimit për punësim.

KREU V
KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR LARGIMIN E TË HUAJVE

SEKSIONI I
LARGIMI I TË HUAJIT

Neni 99
Urdhri i largimit dhe afati i ekzekutimit

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin lëshon urdhrin e largimit për të huajin kur:

a) nuk plotëson më kushtet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në këtë ligj;
b) ka vuajtur një dënim të dhënë nga gjykatat shqiptare për një krim të kryer me dashje për të cilin Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon dënim minimal jo më pak se 2 vjet burg;
c) megjithëse plotëson kushtet e qëndrimit, i huaji punon në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Afati i ndalimit të hyrjes së të huajit në territor bazohet në gjykimet, rast pas rasti, dhe mund të jetë nga 3 muaj deri në 5 vjet.
3. Afati për ekzekutimin vullnetar të urdhrit të largimit është jo më pak se 7 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë nga data e njoftimit.
4. Ekzekutimi i urdhrit të largimit për kategori të ndryshme të të huajve me qëndrim të parregullt kryhet si më poshtë:
   a) për të huajin, i cili ka hyrë dhe qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve në këtë ligj, ose gjendet duke punuar në mënyrë të paligjshme, ose ka vuajtur një dënim të dhënë nga gjykatat shqiptare për një vepër penale për të cilën Kodi Penal i Republikës se Shqipërisë parashikon një dënim minimal 2 vjet burg, për një afat jo më shumë se 10 ditë nga data e njoftimit;
   b) për të huajin që i është anuluar apo revokuar viza, ose i është refuzuar rinovimi i lejes së qëndrimit, ose i është anuluar ose revokuar leja e qëndrimit për një afat jo më shumë se 30 ditë nga data e njoftimit.
5. Ekzekutimi vullnetar i urdhrit të largimit mund të shtyhet për një periudhë të përshtatshme (më shumë se 30 ditë), duke marrë në konsideratë rrethanat specifike të çdo rasti të veçantë, referuar kategorive të mëposhtme:
   a) fëmijët të cilët frekuentojnë shkollat dhe afati i përfundimit të vitit shkollor është më pak se 3 muaj, deri në përfundimin e vitit shkollor të fëmijës/ve;
   b) të huajit që ka një detyrim financiar dhe duhet të likuidojë këtë detyrim deri në 3 muaj nga data e njoftimit;
   c) të huajve me probleme shëndetësore deri në aftësimin shëndetësor të tyre për të udhëtuar apo përfundimin e qëndrimit në izolim ose karantinë, sipas një vendimi të autoriteteve shtetërore.

6. Shtetasit e huaj, me qëndrim të parregullt, që u është miratuar kohëzgjatja e afatit të ekzekutimit vullnetar të urdhrit të largimit, çdo 10 ditë duhet të paraqiten pranë autoritetit rajonal përgjegjës për kufirin dhe migracionin ku kanë vendqëndrimin.
7. I huaji të cilit i është miratuar zgjatja e periudhës së zbatimit të urdhrit vullnetar të largimit ka të drejtë:
   a) të qëndrojë së bashku me familjarët e tij që janë në territor;
   b) të përdorë shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, të përfitojë trajtim për sëmundje specifike, si dhe shërbimet e shëndetit publik;
   c) i huaji i mitur të ketë akses të garantuar në sistemin shkollor, bazuar në periudhën e tij të qëndrimit;
   ç) për shërbime të veçanta për personat me aftësi të kufizuara.
8. Në kohën e ekzekutimit të urdhrit të largimit të të huajit nga territori merret në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës, personave vulnerabël, jeta familjare, si dhe gjendja shëndetësore e të huajit, subjekt i urdhrit të largimit nga territori.
9. Të huajit i njoftohet në formë të shkruar, sipas procedurave të Kodit të Procedurës Administrative, në gjuhën që kupton, ose së paku në gjuhën angleze, urdhri i largimit, duke e njohur me procedurat e ankimit, sipas nenit 100 të këtij ligji. Formati dhe përmbajtja e urdhrit të largimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 100
Ankimi kundër urdhrit të largimit

I huaji, subjekt i një urdhri largimi, ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 101
Ekzekutimi vullnetar i urdhrit të largimit

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin nuk ekzekuton urdhrin e largimit në rast se i huaji deklaron se do të largohet vullnetarisht nga territori. Deklarimi i të huajit për t'u larguar vullnetarisht mund të merret në konsideratë nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin me qëllim mosvendosjen e ndalimit të hyrjes, heqjes apo pezullimit të tij, në raste të veçanta për arsye humanitare apo për arsye të tjera të

argumentuara, përjashtuar rastet kur për interesa të rendit dhe sigurisë publike ky deklarim nuk mund të merret në konsideratë.

2. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin i jep përparësi ekzekutimit të kthimit vullnetar, sidomos për këtë kategori personash:
   a) të huajin, i cili ka qëndruar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, por që nuk ka sjellë pasoja të dëmshme për rendin dhe sigurinë publike dhe që deklaron se do të largohet vullnetarisht nga territori;
   b) të miturit e pashoqëruar;
   c) personat e sëmurë, invalidë ose me aftësi të kufizuara;
   ç) prindërit me fëmijë të vegjël;
   d) viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, që duan të kthehen në vendin e tyre të origjinës;
   dh) azilkërkuesit, të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil ose që kanë tërhequr kërkesën për azil dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për kthim;
   e) të huajin e pajisur me dokumente të rregullta udhëtimi, por që nuk ka mjetet financiare të nevojshme për qëndrim.
   ë) të huajt, të cilët kapen duke punuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.
   f) përpara se të vendoset për të lëshuar një vendim kthimi për një të mitur të pashoqëruar, do të jepet ndihma e duhur nga organet shtetërore të ngarkuara me ligj, të ndryshme nga ato që ekzekutojnë kthimin, duke i kushtuar rëndësinë e duhur interesit më të lartë të fëmijës.
   g) përpara largimit të një të mituri të pashoqëruar nga territori i Republikës së Shqipërisë, autoritetet kërkuese garantohen që ai do të kthehet te një anëtar i familjes së tij, te një kujdestar i emëruar ose në institucione të përshtatshme pritëse në shtetin e kthimit.
3. Urdhri i largimit nuk ekzekutohet deri në përfundimin e procesit të ankimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në këtë ligj.
4. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, që janë të angazhuara në çështje për të huajt, ndërmerr programe të përbashkëta për sigurimin e mjeteve financiare për të mundësuar kthimin e të huajve të përmendur në këtë nen në vendin e origjinës.

SEKSIONI II
DËBIMI I TË HUAJIT

Neni 102
Dëbimi i të huajit nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin

1. Dëbimi i të huajit nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin është një masë administrative, e cila ndërmerret për largimin e të huajit nga territori shqiptar në bazë të vlerësimeve, rast pas rasti, kur rezulton se i huaji:
   a) ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka të dhëna se do të përdorë territorin e saj për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera;
   b) nuk është larguar nga Republika e Shqipërisë brenda afateve kohore, të parashikuara në urdhrin e largimit, pa ndonjë arsye objektive, apo pas largimit nga territori dhe brenda afateve të ndalimit të hyrjes rihyn në territorin e Republikës së Shqipërisë;
   c) nuk është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë deri në 60 ditë pas përfundimit të afatit të qëndrimit të vizës, të lejes së qëndrimit ose afatit të qëndrimit, të parashikuar në këtë ligj për shtetasit që hyjnë pa vizë dhe ka të dhëna se kërkon t'u fshihet autoriteteve të policisë përgjegjëse për kufirin dhe migracionin;
   ç) është ripranuar nga një vend tjetër në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
   d) është shpallur person i padëshiruar sipas përcaktimeve në nenin 104 të këtij ligji dhe prania e tij në territor konsiderohet si kërcënim serioz për rendin dhe sigurinë publike;
   dh) është dënuar për një krim të kryer me dashje për të cilin legjislacioni shqiptar parashikon një dënim minimal 3 vjet burg.
2. Në rast se i huaji bëhet subjekt i dëbimit nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin sipas këtij neni, ai mbahet i ndaluar në një qendër të mbyllur sipas nenit 115 të këtij ligji derisa të ekzekutohet urdhri i dëbimit. Në rast të gjetjes së mundësive të tjera alternative të zbatimit të masave të përkohshme, siç përcaktohen në seksionin IV të këtij kreu, këto të fundit kanë përparësi ndaj ndalimit.
3. I huaji, i cili nuk disponon një dokument udhëtimi, duhet të paraqitet vetë ose i shoqëruar nga autoritetet kompetente pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore të akredituara në Republikën e Shqipërisë për t'u pajisur me një dokument të tillë.

4. Nëse në Republikën e Shqipërisë nuk ka përfaqësi diplomatike dhe poste konsullore të vendit të shtetasit të huaj, autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin kërkon pajisjen me dokument udhëtimi në vendin e origjinës ose në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të vendit të shtetasit të huaj në ndonjë vend tjetër nëpërmjet autoritetit përgjegjës për çështjet konsullore në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.
5. Në rast se përfaqësia diplomatike nuk pranon të lëshojë dokument udhëtimi, autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me dokument standard udhëtimi, të përcaktuar me marrëveshje ripranimi, i cili ka për qëllim zbatimin e largimit të të huajit.
6. Në zbatim të këtij ligji, autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të nxjerrë leje kalimi nëse i huaji nuk pajiset me dokument udhëtimi sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni dhe nenit 13 të këtij ligji.
7. Të huajit i komunikohet në formë të shkruar, në gjuhën që kupton ose, së paku, në gjuhën angleze se ndaj tij do të ekzekutohet masa administrative e dëbimit të marrë nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, duke i shpjeguar shkakun e nxjerrjes së urdhrit, datën dhe vendin ku do të ekzekutohet, mënyrën e transportimit të tij për në vendin e destinacionit dhe afatin e ndalimit të hyrjes. Formati i urdhrit të dëbimit, që nxjerr autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
8. Largimi është urdhër që i drejtohet çdo të huaji me qëndrim të paligjshëm në Shqipëri, kurse dëbimi është masa ndaj të huajit që:
   a) nuk është larguar në përputhje me urdhrin e largimit;
   b) është me qëndrim të ligjshëm, por ndaj tij është marrë një vendim dëbimi nga gjykata, si shtojcë e vendimit të dënimit për një vepër penale të kryer prej tij, ose të huajin për të cilin autoritetet e migracionit vlerësojnë se qëndrimi i tij në territor për shkak të natyrës së veprës penale që ka kryer përbën rrezik për rendin dhe sigurinë publike, edhe në rast se nuk ka vendim dëbimi nga gjykata.
   c) shpallet i padëshiruar.

Neni 103
Ankimi ndaj urdhrit të dëbimit të autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin

1. I huaji ka të drejtë të ankimojë urdhrin e dëbimit të autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin sipas legjislacionit në fuqi.
2. Deri në përfundimin e procedurës së ankimit, i huaji mbahet në kushtet e masave alternative të mbikëqyrjes ose në qendrën e mbyllur, në pritje të largimit të menjëhershëm, sipas urdhrit të nxjerrë për këtë qëllim.

SEKSIONI III
DËBIMI I TË HUAJIT SI PERSON I PADËSHIRUAR

Neni 104
Personat e padëshiruar

1. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, për interesa të rëndësishme të shtetit, të rendit kushtetues dhe atij juridik, të sigurisë kombëtare e të rendit publik, me urdhër të argumentuar shpall person të padëshiruar një të huaj në rast se:
   a) vepron ose propagandon kundër sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, sigurisë kombëtare, rendit kushtetues dhe rendit e sigurisë publike;
   b) është anëtar i organizatave terroriste ose përkrah e kryen veprime anarkiste kundër shtetit ligjor;
   c) përbën kërcënim për vendin ose cenon marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me shtete të tjera;
   ç) ekzistojnë dyshime se do të hyjë ose do të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë për të kryer një vepër penale ose veprime që përbëjnë kërcënim për Republikën e Shqipërisë;
   d) është i përfshirë në krimin e organizuar, në trafikimin e qenieve njerëzore, drogë, si dhe në çdo trafik tjetër të paligjshëm, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse të sigurisë kombëtare.
2. I huaji shpallet "person i padëshiruar" për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e shpalljes dhe i refuzohet hyrja ose qëndrimi në Republikën e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe.
3. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, me kërkesë të të huajit, mund ta rishikojë kërkesën për hyrje, vizë ose leje qëndrimi

në rast se i huaji madhor ka kryer njërin nga aktet e përmendura më sipër në moshë të mitur.

4. Procedura e shpalljes së të huajit person i padëshiruar nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe modeli i urdhrit të ministrit për shpalljen e një të huaji person i padëshiruar miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror.

Neni 105

Urdhri i dëbimit të personit të padëshiruar

1. I huaji i shpallur person i padëshiruar dëbohet nga territori i Republikës së Shqipërisë me urdhër dëbimi, të nxjerrë nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
2. Urdhri i dëbimit si person i padëshiruar i njoftohet në formë të shkruar të huajit në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze dhe përmban:
   a) të dhënat personale të personit të dëbuar;
   b) arsyet për të cilat është nxjerrë urdhri i dëbimit;
   c) periudhën e ndalimit të hyrjes në Shqipëri;
   ç) në rast ripranimi, shtetin ku do të kryhet ky ripranim;
   d) datën e largimit;
   dh) mënyrën e ekzekutimit;
   e) pikën e kalimit kufitar nga do të largohet.
3. Informacionet për arsyet e detajuara të lëshimit të urdhrit të dëbimit si person i padëshiruar, që cilësohen si informacione të klasifikuara/të kufizuara, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, rendin publik dhe ato që lidhen me parandalimin, investigimin, zbulimin dhe dënimin e aktiviteteve kriminale nuk i komunikohen të huajit.
4. Formati i urdhrit të dëbimit si person i padëshiruar miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 106

Procedurat dhe ekzekutimi i urdhrit të dëbimit

1. Urdhri i dëbimit ekzekutohet nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, i cili:

   a) merr masa për ndalimin e të huajit në qendrën e mbyllur ose aplikimin e masave të përkohshme, sipas përcaktimeve në seksionin IV të këtij kreu, derisa të ekzekutohet urdhri i dëbimit, sipas përcaktimit në urdhrin e dëbimit;
   b) merr shenjat e gishtërinjve dhe të pëllëmbës së të huajit, si dhe fotografinë;
   c) regjistron urdhrin e dëbimit në evidenca të veçanta, ku shënon, ndër të tjera, edhe periudhën e ndalimit të hyrjes në Republikën e Shqipërisë;
   ç) anulon lejen e qëndrimit në rast se ekziston një e tillë;
   d) merr masa që i huaji të pajiset me dokument udhëtimi, me vizë dhe me biletë udhëtimi.
2. Urdhri i dëbimit ekzekutohet menjëherë në rast se prania e të huajit përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare.
3. Në rast se as i huaji dhe as ftuesi nuk kanë mundësi financiare për të përballuar shpenzimet e kthimit të të huajit në vendin e destinacionit, kostoja e udhëtimit jepet si hua në paradhënie nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin dhe kthehet nga i huaji në rast se ai kërkon të vijë në Republikën e Shqipërisë pas përfundimit të afatit të ndalimit të hyrjes.

Neni 107

Kategoria e personave që nuk dëbohen

1. Nuk është subjekt i një urdhri dëbimi i huaji, i cili plotëson njërën nga kushtet e mëposhtme:
   a) është i pajisur me leje të përhershme qëndrimi;
   b) ka lindur në Republikën e Shqipërisë;
   c) ka hyrë në Republikën e Shqipërisë si i mitur, i pashoqëruar dhe është pajisur me leje të përhershme qëndrimi;
   ç) është i pajisur me leje të përkohshme qëndrimi dhe është martuar me një të huaj, i cili ka leje të përhershme qëndrimi ose me një shtetas shqiptar;
   d) ka arsye të bazuara për të dyshuar se i huaji në vendin e origjinës apo në një vend tjetër do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues ose dënimeve për shkaqe diskriminuese;

dh) i mituri i pashoqëruar, nëse nga vendi i origjinës, nga një vend tjetër ose nga institucione të tjera nuk garantohet ribashkimi familjar ose kujdesi i duhur shëndetësor;

e) është anëtar i familjes së të huajit, të cilit i njihet statusi i refugjatit në Republikën e Shqipërisë.

2. Përjashtimisht, i huaji mund të dëbohet, megjithëse plotësohen kushtet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, në qoftë se qëndrimi i tij rrezikon rendin dhe sigurinë publike, si dhe përbën kërcënim për sigurinë kombëtare sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

Neni 108

Rishikimi i urdhrit të shpalljes së personit të padëshiruar dhe urdhrit të dëbimit

Ndaj urdhrit të shpalljes së personit të padëshiruar, si dhe urdhrit të dëbimit si person i padëshiruar, i huaji ose familjarët e tij mund të kërkojnë vetëm rishikimin administrativ tek autoriteti që ka nxjerrë urdhrin.

SEKSIONI IV
MASAT E PËRKOHSHME

Neni 109

Ekzekutimi i masave të përkohshme

1. Masat e përkohshme ndërmerren nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për të përgatitur apo siguruar zbatimin e një urdhri për dëbimin e të huajit nga territori ose për të mbikëqyrur largimin e tij.
2. Masat e përkohshme ndërmerren si masa alternative të ndalimit në qendër të mbyllur të të huajit, subjekt i dëbimit, bazuar në shqyrtimin rast pas rasti, pa ndikuar në garantimin e ekzekutimit të urdhrit të dëbimit.
3. Masat e përkohshme mund të merren pas daljes së urdhrit të dëbimit, si dhe, nëse është e nevojshme, mund të zëvendësojnë masën e ndalimit në qendër të mbyllur, pasi kjo e fundit është ekzekutuar.
4. Kriteret, procedurat dhe forma e urdhrit të masës së përkohshme miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 110

Detyrimi për t'u paraqitur

1. Të huajit mund t'i kërkohet të paraqitet në intervale të rregullta kohore pranë autoriteteve përgjegjëse rajonale për kufirin dhe migracionin, kur:
   a) ndaj tij është nxjerrë një urdhër largimi apo një urdhër dëbimi dhe kërkohet siguri për zbatimin e këtij urdhri apo nevojitet të mbikëqyret largimi i të huajit nga territori;
   b) i huaji para largimit ka pasur një adresë të saktë dhe të njohur nga autoritetet vendore të kufirit dhe migracionit dhe ka të dhëna se i huaji mund t'i fshihet ekzekutimit të largimit;
   c) vlerësohet interesi më i lartë i familjes së të huajit.
2. I huaji duhet të informohet për arsyet e këtij detyrimi.
3. Detyrimi për t'u paraqitur mbetet në fuqi deri kur i huaji largohet nga territori.

Neni 111

Bllokimi i biletës ose i dokumentit të udhëtimit

1. Në rast se i huaji është subjekt i një urdhri dëbimi, struktura përgjegjëse vendore për kufirin dhe migracionin mund të bllokojë biletën e udhëtimit dhe dokumentin e udhëtimit për garantimin e kthimit të të huajit. Procedurat e bllokimit miratohen më urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
2. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin bllokon dokumentet e udhëtimit të të huajit deri në përfundimin e procedurës së ankimit.
3. Gjatë kohës së bllokimit të dokumenteve të udhëtimit, të huajit i lëshohet një dokument, me cilësinë e një dokumenti identifikimi.
4. Formati i dokumentit të identifikimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 112

Bllokimi i mjeteve financiare ose vendosja e garancisë

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin i bllokon të huajit mjetet financiare që ai disponon deri në shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e kthimit të tij, nëse një shpenzim i tillë është i nevojshëm të kryhet. Pjesa e mbetur nga mjetet financiare të

bllokuara i kthehet të huajit menjëherë në momentin e largimit të tij.

2. Në vend të masave të tjera të përkohshme ose në mënyrë të kombinuar me to, sipas vlerësimit rast pas rasti, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund t'i kërkojë të huajit të vendosë një garanci financiare me anë të së cilës të garantojë kthimin e tij/saj.
3. Garancia financiare i kthehet të huajit menjëherë kur kjo vlerësohet se nuk është më e nevojshme ose kur realizohet kthimi i të huajit.

Neni 113
Qëndrimi i detyrueshëm në një territor të caktuar

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin vendos kufizimin e lirisë personale të të huajit, duke e urdhëruar atë të qëndrojë në një territor të caktuar në rastet kur:
   a) rikthimi ose dëbimi nuk mund të urdhërohet apo të zbatohet për arsye objektive ose për shkak të një detyrimi të marrë përsipër nga Republika e Shqipërisë në kuadër të një marrëveshjeje ndërkombëtare në fuqi;
   b) ka një leje qëndrimi për motive humanitare;
   c) ka përfunduar afati i ndalimit në qendër të mbyllur dhe nuk është bërë i mundur largimi i të huajit ose për arsye humanitare i huaji nuk mund të mbahet i ndaluar në qendër të mbyllur;
   ç) autoritetet e shëndetit publik, në bazë të një vlerësimi dhe sipas Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit, rekomandojnë izolimin e personit apo personave për një periudhë kohe të vlefshme për inkubacionin e sëmundjes së dyshuar.
2. I huaji ka të drejtë të ankimojë urdhrin e qëndrimit në një territor të caktuar në gjykatën kompetente për çështjet administrative.
3. Gjatë qëndrimit në një territor të caktuar, me miratimin e autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, i huaji mund të hyjë në marrëdhënie pune me kontraktues shqiptarë ose të huaj sipas kushteve të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
4. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin përcakton në urdhrin e qëndrimit në një territor të caktuar rregullat e përgjithshme të qëndrimit, vendin dhe kohëzgjatjen e qëndrimit, si dhe njofton të huajin të paraqitet përpara autoriteteve çdo muaj. Formati i urdhrit të qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

5. Fondet për qëndrimin në një territor të caktuar mbulohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Mënyra e administrimit të fondeve dhe qëndrimit në një territor të caktuar përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

SEKSIONI V
NDALIMI NË QENDËR TË MBYLLUR

Neni 114
Qendra e mbyllur

1. Qendra e mbyllur është një institucion administrativ, me nivel të caktuar sigurie dhe kufizim lirie, në të cilin mund të vendosen vetëm të huajt që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë.
2. Qendra e mbyllur duhet të plotësojë të gjitha kushtet e trajtimit njerëzor e human dhe të mundësojë ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe garantimin e të drejtave themelore të personit.
3. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, në rast të ndalimit të të huajit në qendër të mbyllur, me kërkesën e këtij të fundit, merr masa të menjëhershme për kujdesin ndaj anëtarëve të familjes së të huajit të ndaluar, të cilët kanë mbetur pa mbështetje dhe përkrahje.

Neni 115
Ndalimi në qendër të mbyllur

1. Ndalimi në qendrën e mbyllur është masa e fundit administrative që merret dhe ekzekutohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve ndaj të huajit për të cilin është nxjerrë një urdhër dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti, kur janë ekzekutuar të gjitha masat e mundshme alternative, ose kur nga vlerësimi konsiderohet se këto masa nuk mund të zbatohen për të huajin, ose për të huajin e ripranuar, në bazë të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me qëllim të vetëm sigurimin e kushteve për kthimin/ripranimin e tij.
2. I huaji mbahet i ndaluar në qendër të mbyllur, të ngritur posaçërisht për këtë qëllim, në afate sa më të shkurtra kohore, derisa të kryhen procedurat ligjore, për të mundësuar largimin e tij nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal për trajtimin e të huajve mund ta ndalojë në qendër të mbyllur për arsye të sigurisë publike të huajin, identiteti apo arsyet e qëndrimit të të cilit nuk janë të qarta.
4. I huaji njoftohet në formë të shkruar, në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze, për urdhrin e ndalimit në qendër të mbyllur, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën që të sigurojë mbrojtje ligjore me një avokat të zgjedhur prej tij ose kryesisht, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet.

Neni 116
Ankimi ndaj urdhrit të ndalimit

1. I huaji, ndaj të cilit është nxjerrë një urdhër ndalimi në qendër të mbyllur, ka të drejtë të ankohet në gjykatën e rrethit gjyqësor për këtë masë në çdo kohë pas njoftimit me shkrim për ndalimin ose zgjatjen e ndalimit.
2. Gjykata e rrethit gjyqësor shqyrton me përparësi ligjshmërinë e masës së ndalimit të të huajit në qendër të mbyllur dhe vendos mbajtjen e tij në qendrën e mbyllur ose lënien e tij të lirë.
3. Ankimi ndaj vendimit të gjykatës bëhet brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 117
Periudha e ndalimit në qendër të mbyllur

1. I huaji mbahet në qendër të mbyllur për një periudhë maksimale deri në 6 muaj.
2. Autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, me propozim të autoritetit të qendrës së mbyllur, zgjat periudhën e ndalimit në qendër të të huajit deri në 6 muaj të tjerë nëse brenda periudhës 6-mujore të ndalimit, largimi i të huajit ka qenë i pamundur për arsye se:
   a) i huaji refuzon të japë të dhëna apo informacione personale, si dhe dokumente udhëtimi të nevojshme për kthimin e tij ose jep informacione të rreme;
   b) i huaji ka penguar apo bllokuar kthimin e tij në forma të ndryshme;
   c) vonesa në lëshimin e dokumentit të udhëtimit apo ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për kthim, kërkuar autoritetit të një vendi tjetër, është e justifikuar.

3. Kërkesa për shtyrjen e afatit të qëndrimit nga autoriteti i qendrës së mbyllur bëhet së paku 15 ditë përpara mbarimit të afatit 6-mujor të ndalimit në qendër. Autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin shqyrton kërkesën dhe njofton autoritetin e qendrës së mbyllur për vendimin e marrë brenda afatit 10-ditor.
4. Gjatë kohës së ndalimit në qendrën e mbyllur, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në bashkëpunim me autoritetin e qendrës së mbyllur, shqyrton ekzistencën e kushteve për të mbajtur të mbyllur në qendër të huajin e ndaluar. Në varësi të vlerësimit të situatës, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të vendosë për zëvendësimin e masës së ndalimit në qendër me masa të përshtatshme të përkohshme të përcaktuara në këtë ligj.
5. Në rast se i huaji kryen një vepër penale gjatë kohës së qëndrimit në qendrën e mbyllur, ndaj tij fillon ndjekja penale sipas dispozitave të legjislacionit penal në fuqi dhe i huaji transferohet menjëherë në një institucion tjetër të ngritur për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 118
Përfundimi i mbajtjes në qendër

1. Mbajtja e të huajit në qendër përfundon:
   a) me largimin e të huajit nga territori;
   b) me përfundimin e afatit të ndalimit, të përcaktuar në urdhrin e ndalimit;
   c) nëse qëndrimi i të huajit bëhet i paligjshëm;
   ç) me anulimin e vendimit të ndalimit në qendër;
   d) me zëvendësimin e masës së ndalimit në qendër me një masë tjetër të përkohshme, të përcaktuar në këtë ligj.
2. I huaji lirohet nga qendra në rast se:

a) rezulton qartë nga rrethanat se largimi i të huajit nuk mund të bëhet forcërisht;
b) gjykata urdhëron lirimin e tij nga qendra.

Neni 119
Ndalimi i të miturve të pashoqëruar

1. Përjashtimisht, i mituri i pashoqëruar, ndaj të cilit është nxjerrë një urdhër ndalimi, mbahet në një qendër sociale shtetërore, të hapur posaçërisht për këtë qëllim, nga ose në një qendër tjetër, në kuadër

të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, që kryejnë misione për fëmijët, viktimat e trafikimit ose kategori të tjera individësh në nevojë.
2. I mituri mund të mbahet në qendër të mbyllur vetëm në rast të interesit më të lartë të tij apo të familjes, në mjedise të posaçme të ndara nga ato për të rritur.
3. Para ndalimit të një të mituri në qendër të mbyllur kërkohet mendimi i një punonjësi social dhe psikologu.
4. Në rast të dyshimit të moshës së të huajit të ndaluar, autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin mund të kërkojë në institucionet shtetërore të specializuara kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të të ndaluarit, vetëm me qëllim verifikimin e moshës. Në rast se edhe pas verifikimeve dhe ekspertimeve mbeten dyshime për moshën e të ndaluarit, prezumohet se ai është i mitur.

Neni 120
Vënia në dijeni e përfaqësuesit diplomatik

1. Me kërkesën e të huajit ose kur përcaktohet nga një marrëveshje dypalëshe, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme njoftohet menjëherë misioni diplomatik ose konsullor i shtetit të të huajit të ndaluar në qendër për ndalimin e tij, si dhe për zgjatjen e periudhës së ndalimit.
2. Në rast se i huaji ka kërkuar azil ose gëzon statusin e refugjatit apo një mbrojtje tjetër nga Republika e Shqipërisë, ky informacion nuk i bëhet i ditur përfaqësuesit diplomatik ose konsullor të vendit të tij.

Neni 121
Të drejtat e të huajit të ndaluar në qendrën e mbyllur

1. I huaji, i cili qëndron në një qendër të mbyllur, sipas dispozitave të këtij kreu, njihet në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze me çdo veprim, i cili kryhet nga autoritetet përgjegjëse për mbajtjen e tij në qendër.
2. I huaji gëzon të drejtën për trajtim njerëzor me ushqim të mjaftueshëm, asistencë ligjore në çdo çast dhe përkujdesje shëndetësore.
3. I huaji gëzon të drejtën për të informuar përfaqësuesin konsullor për ndalimin e tij.

4. I huaji gëzon të drejtën për t'u ankuar në gjykatën e rrethit gjyqësor për shkeljen në qendër të të drejtave të tij themelore.
5. Në rast se ripranohet, i huaji informohet për të drejtat dhe detyrimet që ka në bazë të legjislacionit shqiptar në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze.

Neni 122
Kompensimi i shpenzimeve të largimit/dëbimit

1. I huaji përballon koston e qëndrimit në qendër dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara gjatë largimit/dëbimit të tij.
2. Të gjitha mjetet financiare në vlerë monetare që i merren të huajit, subjekt dëbimi, në formë depozite, bëhen kundrejt lëshimit të një procesverbali.
3. Mjetet financiare të të huajit përdoren vetëm për të mbuluar kostot për sa është përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
4. Nëse i huaji nuk ka mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve të përmendura në pikën 3 të këtij neni, shpenzimet përballohen nga personi fizik ose juridik, i cili ka mundësuar hyrjen, qëndrimin ose kalimin e paligjshëm transit të të huajit në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose personi fizik apo juridik, i cili ka marrë përsipër mbulimin e kostos së qëndrimit dhe kthimit të të huajit në/dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë, ose transportuesi sipas përcaktimeve të nenit 131 të këtij ligji, ose punëdhënësi, i cili ka punësuar një të huaj në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
5. Depozitimi dhe përdorimi i mjeteve financiare, sipas përcaktimeve në këtë nen, bëhen në bazë të një urdhri të autoritetit, i cili realizon dëbimin e të huajit sipas një procedure të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

SEKSIONI VI
TRANSITI AJROR DHE OPERACIONET E KTHIMIT NË RRUGË AJRORE

Neni 123
Asistenca në transit për qëllim kthimin në rrugë ajrore

1. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet siguron masa për ndihmën midis autoriteteve kompetente në aeroportet e shteteve (palë) kontraktuese të transitit në lidhje me

kthimet e shoqëruara ose të pashoqëruara në rrugë ajrore.

2. Procedurat për të siguruar asistencën në transit, me qëllim kthimin në rrugë ajrore, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 124

Operacionet e kthimit dhe operacionet e përbashkëta të kthimit në rrugë ajrore

1. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet, në bazë të marrëveshjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mund të bashkëpunojë me vende të tjera në operacionet e kthimeve apo kthimeve të përbashkëta në rrugë ajrore.
2. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet koordinon dhe organizon pjesëmarrjen në operacionet e kthimit dhe operacionet e përbashkëta të kthimit në rrugë ajrore.
3. Procedurat për organizimin e operacioneve të kthimit dhe operacioneve të përbashkëta të kthimit në rrugë ajrore miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

KREU VI
PËRDORIMI I UNIFORMËS DHE AUTOMJETEVE USHTARAKE

Neni 125

Përdorimi i uniformës dhe automjeteve ushtarake

1. I huaji gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Shqipërisë mund të mbajë uniformën e tij ushtarake dhe të përdorë automjetet me targa dhe simbole ushtarake të huaja në rast se:
   a) qëndron në Republikën e Shqipërisë si anëtar i një misioni diplomatik apo konsullor i një vendi tjetër ose i misioneve të huaja me status diplomatik;
   b) është në vizitë zyrtare në përbërje të një misioni apo delegacioni ushtarak të huaj;
   c) kalon transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë si anëtar i një misioni ose delegacioni ushtarak të huaj me pasaportë diplomatike apo shërbimi;
   ç) është pjesëmarrës në një ushtrim ushtarak ose trajnim të kësaj natyre.
2. I huaji me statusin e studentit nuk mund të përdorë automjetet me targa dhe simbole ushtarake të huaja gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Shqipërisë, por mund të mbajë uniformën e tij ushtarake në rast se studion në një institucion të arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtarë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 126

Përdorimi i uniformës dhe automjeteve policore e doganore

I huaji gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Shqipërisë mund të mbajë uniformën e tij policore ose doganore, si dhe të përdorë automjetet me targa dhe simbole policore të huaja në rast se:

a) është në një vizitë zyrtare si anëtar delegacioni i një autoriteti të huaj policor apo doganor;
b) është duke kryer një detyrë funksionale në kuadër të një marrëveshjeje dy apo shumëpalëshe në Republikën e Shqipërisë;
c) ndjek studimet në një institucion të arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike;
ç) kalon transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë si anëtar i një misioni apo delegacioni policor ose doganor të huaj me pasaportë diplomatike ose shërbimi.

KREU VII
MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI I TË HUAJVE

Neni 127

Kontrolli i të huajve

Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në zbatim të legjislacionit në fuqi, kryen këto detyra:

a) mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin nga të huajt të rregullave të hyrjes dhe qëndrimit, të vendosura sipas këtij ligji;
b) kërkon dokumentet e udhëtimit, lejen e qëndrimit ose dokumentin e identifikimit;

c) shoqëron në rajonin e policisë të huajin, i cili nuk disponon dokument identifikimi, leje qëndrimi, dokument udhëtimi ose ndonjë dokument tjetër që provon identitetin e tij;
ç) transporton të huajin për të cilin ka një urdhër dëbimi për në pikën e kalimit kufitar ose në vendin e origjinës;
d) transporton të huajin e ndaluar, kur është e nevojshme, në institucionin shëndetësor, për të marrë trajtim mjekësor ose, për arsye të shëndetit publik, për të siguruar izolimin apo karantinën;
dh) shoqëron dhe merr masa për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në vendin e origjinës ose në vendin transit, të cilin i huaji ka përdorur për të hyrë në Republikën e Shqipërisë;
e) merr masa që i huaji i ndaluar dhe i mbajtur në qendër të mbyllur të paraqitet përpara autoriteteve gjyqësore;
ë) shoqëron të huajin në përfaqësinë diplomatike ose konsullore, me synim zhvillimin e intervistës së kërkuar, për të siguruar dokumente udhëtimi dhe e kthen atë në institucionin ku zbatohet ndalimi;
f) bashkëpunon me strukturat e tjera për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë nga të huajt gjatë hyrjes dhe qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë;
g) vendos gjoba ndaj të huajit dhe merr masa për ekzekutimin e tyre për të gjitha rastet e përcaktuara në nenin 139 të këtij ligji.

Neni 128
Detyrimi i të huajit për provimin e identitetit të tij

1. I huaji provon identitetin e tij me anë të:
   a) dokumentit të udhëtimit;
   b) kartës së identitetit personal për të huaj;
   c) dokumentit të lëshuar nga kompanitë e udhëtimit të mjeteve të lundrimit detar, i cili përmban fotografinë;
   ç) dokumenteve të tjera publike, të cilat përmbajnë fotografinë.
2. I huaji është i detyruar të mbajë dokument, me anë të cilit të provojë identitetin e tij dhe ta paraqesë atë në rast se i kërkohet nga një person zyrtar, përgjegjës për kontrollin.
3. I huaji është i detyruar të paraqesë dokumentin e tij të udhëtimit gjatë kalimit të kufirit kur i kërkohet nga një person zyrtar i ngarkuar për këtë qëllim.

4. I huaji, i cili nuk disponon dokument identifikimi, është i detyruar t'ia paraqesë të dhënat e tij personale të sakta një punonjësi zyrtar, përgjegjës për kontrollin e të huajve në territor.
5. I huaji nuk mund t'u japë të tjerëve të përdorin dokumentet e tij të udhëtimit, si dhe nuk mund të përdorë dokumente identifikimi të falsifikuara ose dokumentet e udhëtimit të dikujt tjetër.

Neni 129
Kthimi i dokumentit të udhëtimit, letërnjoftimit dhe lejes së qëndrimit

I huaji është i detyruar të kthejë dokumentin e udhëtimit, letërnjoftimin, si dhe lejen e qëndrimit, të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, në rast se:
   a) largohet përfundimisht nga territori i Republikës së Shqipërisë;
   b) mbaron afati i dokumentit;
   c) merr shtetësinë shqiptare.

Neni 130
Detyrimi i të huajit për njoftimin e adresës

1. I huaji, vetë apo nëpërmjet punëdhënësit, ftuesit ose akomoduesit, në një nga format e përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, njofton brenda 10 ditëve nga hyrja në Republikën e Shqipërisë ose nga dita e ndryshimit të vendqëndrimit autoritetin përgjegjës për kufirin dhe migracionin për vendqëndrimin e tij, duke paraqitur të dhënat e mëposhtme:
   a) emrin, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, numrin e dokumentit të udhëtimit, shtetësinë dhe adresën e vendbanimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
   b) adresën e plotë të vendqëndrimit në Republikën e Shqipërisë;
   c) datën e lëshimit dhe numrin serial të vizës, nëse është i pajisur me vizë;
   ç) vendin dhe datën e hyrjes në Republikën e Shqipërisë, si dhe datën e pritshme të përfundimit të qëndrimit në vendqëndrimin në fjalë.
2. Mospërmbushja e detyrimit të njoftimit të adresës nga i huaji përbën shkelje administrative dhe sanksionohet me gjobë.

Neni 131

Detyrimi i të huajit me leje qëndrimi për regjistrimin e adresës

1. I huaji i pajisur me leje qëndrimi është i detyruar të regjistrojë adresën e vendbanimit pranë zyrës përgjegjëse të gjendjes civile.
2. Mospërmbushja e detyrimit për regjistrimin e adresës brenda afateve përbën shkelje administrative dhe sanksionohet me gjobë.
3. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja në dorëzim e lejes së qëndrimit, i huaji nuk kryen procedurën e regjistrimit të adresës, leja e qëndrimit anulohet. Për anulimin e lejes së qëndrimit mjafton konfirmimi i moskryerjes së regjistrimit nga zyra përgjegjëse e gjendjes civile tek autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

Neni 132

Detyrimet e transportuesit

1. Transportuesi, përpara nisjes, duhet të verifikojë nëse të huajt që udhëtojnë në/dhe nga Republika e Shqipërisë në rrugë ajrore, tokësore ose ujore, kanë dokumente të vlefshme udhëtimi dhe vizë, në rast se kërkohet, si dhe të dërgojë në rrugë elektronike pranë autoritetit të pikës së kalimit kufitar, ku ata synojnë të hyjnë/nisen, jo më vonë se para nisjes në udhëtim, listën e saktë të udhëtarëve dhe personelit. Pas mbërritjes, transportuesi duhet t'i dorëzojë personelit të pikës së kalimit kufitar listën e plotë të udhëtarëve dhe të personelit.
2. Drejtuesi i një automjeti, kapiteni i një mjeti lundrimi ose piloti i një mjeti fluturimi dhe përfaqësues të transportuesit në bord janë të detyruar të sigurojnë që personat, të cilët udhëtojnë në mjetin e tyre të udhëtimit, nuk kanë të drejtë të hyjnë në vend pa lejen e autoriteteve të kontrollit kufitar. Në rast se gjatë udhëtimit konstatojnë një person të fshehur në mjetin e tyre, janë të detyruar të njoftojnë autoritetet e kontrollit kufitar para se të mbërrijnë ose me të mbërritur në pikën e kalimit kufitar.
3. Transportuesi ka përgjegjësinë që të huajin, të cilit i refuzohet hyrja, ta kthejë në vendin e nisjes së udhëtimit ose në vendin që ka lëshuar dokumentin e udhëtimit të të huajit, ose në një vend tjetër ku është e sigurt që i huaji do të pranohet.
4. Detyrimet e kthimit për të huajin zbatohen për transportuesin nëse të huajit transit në Republikën e Shqipërisë i refuzohet hyrja dhe nëse një tjetër transportues që do të transportojë të huajin në vendin e

destinacionit refuzon ta pranojë atë në bord, ose autoritetet e vendit të destinacionit kanë refuzuar hyrjen e të huajit dhe ai/ajo është kthyer në Republikën e Shqipërisë.

5. Nëse autoritetet e kontrollit kufitar kanë lejuar hyrjen e të huajit në vend, transportuesi nuk është më i detyruar ta kthejë atë sipas këtij neni, përveçse kur i huaji ka kërkuar azil në kufi.
6. Nëse i huaji, të cilit i është refuzuar hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për të përballuar kthimin tij, atëherë transportuesi është i detyruar ta kthejë atë me shpenzimet e veta.
7. Kur kthimi nuk mund të realizohet menjëherë, transportuesi përballon koston e qëndrimit të të huajit deri në çastin e kthimit.
8. Për ekzekutimin e urdhrit të largimit nga vendi, autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe migracionin mund të urdhërojnë, për shkak të sigurisë se mjetit ose për ekzekutimin e urdhrit të largimit të të huajit, shoqërimin me eskortë. Transportuesi, gjithashtu, mund të paraqesë kërkesë pranë autoriteteve përgjegjëse për kufirin dhe migracionin për të mundësuar shoqërimin me eskortë të të huajit, subjekt kthimi.
9. Nëse një të huaji i refuzohet hyrja në kufi dhe refuzimi bëhet për shkak se ai nuk disponon dokumentin e nevojshëm të udhëtimit, vizën apo lejen e qëndrimit dhe i huaji kthehet me eskortë të kërkuar nga transportuesi, transportuesi është i detyruar të paguajë kostot që lindin nga shoqërimi me eskortë. Nëse shoqërimi kërkohet nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, atëherë kostot e shoqërimit mbulohen nga ky i fundit.
10. Transportuesi nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim nga shteti për kostot që lindin gjatë transportit të të huajve në mënyrë të parregullt.
11. Transportuesi është i detyruar të kthejë azilkërkuesin në kufi, të transportuar nga ai, për të cilin është marrë një vendim refuzimi i kërkesës për azil brenda një periudhe prej 3 muajsh nga hyrja në vend.
12. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, i cili refuzon hyrjen, vendos gjobë ndaj agjencisë që transporton të huajin, të cilit i është refuzuar hyrja, përveç kur hyrja është refuzuar për shkak të mosplotësimit të kushteve shtesë të hyrjes dhe qëndrimit të të huajit në Republikën e Shqipërisë apo të pavlefshmërisë së vizës ose lejes së qëndrimit, si dhe kur gabimet në të dhënat e listës së pasagjerëve konsiderohen të justifikueshme.

13. Para se të vihet një gjobë ndaj transportuesit, transportuesit ose përfaqësuesit të tij i jepet e drejta të japë shpjegime me shkrim.

Neni 133
Detyrime për shërbimet publike

1. Të huajve, të cilët nuk janë të pajisur me një dokument të vlefshëm udhëtimi të njohur nga ky ligj, vizë ose leje qëndrimi të vlefshme dhe që nuk vërtetojnë që kanë hyrë dhe qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territor, nuk u ofrohen shërbimet publike nga organizatat dhe administrata vendore, kompanitë e interesit publik dhe institucionet e sigurimeve shoqërore.
2. Spitalet dhe qendrat shëndetësore janë të përjashtuara nga detyrimi i mësipërm, në rast se të huajt duhet të marrin shërbim mjekësor në situata të emergjencave mjekësore.

Neni 134
Detyrimet për punëdhënësin

1. Punëdhënësit, që punësojnë një të huaj në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar që:
   a) para punësimit të tij t'i kërkojnë të paraqesë një leje apo autorizim tjetër qëndrimi, të vlefshëm për periudhën e punësimit në fjalë;
   b) para se të fillojë punësimi, të kopjojnë ose të regjistrojnë përmbajtjen e lejes së qëndrimit ose të një autorizimi tjetër qëndrimi;
   c) të ruajnë, të paktën për kohëzgjatjen e punësimit, kopjet ose regjistrat, të gatshëm për inspektim nga autoritetet përgjegjëse shtetërore për kontrollin e të huajve në territor, si dhe të inspektoratit përgjegjës për punësimin;
   ç) të njoftojnë autoritetet përgjegjëse si për fillimin, ashtu edhe për përfundimin e punësimit të të huajit brenda një jave;
   d) të mbulojnë shpenzimet e rikthimit për çdo të huaj të punësuar në mënyrë të paligjshme prej tyre në rastet kur zbatohen procedurat e rikthimit;
   dh) të paguajnë çdo shpërblim të prapambetur të të huajit të punësuar në mënyrë të paligjshme prej tyre;
   e) të paguajnë çdo taksë dhe kontribut shoqëror të prapambetur, përfshirë edhe gjobat administrative përkatëse të të huajit, të punësuar në mënyrë të paligjshme prej tyre.

2. Punëdhënësit quhen se e kanë përmbushur detyrimin e tyre, në zbatim të pikës 1, shkronja "a", të këtij neni, duke përjashtuar rastin kur dokumenti i paraqitur si leje apo autorizim tjetër qëndrimi dukshëm nuk është korrekt.
3. Autoriteti përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin, në rastet e konstatimit të punësimit të paligjshëm, prezumon një marrëdhënie punësimi të paktën me kohëzgjatje 6-mujore, duke përjashtuar rastin kur punëdhënësi mund të provojë ndryshe.
4. Autoriteti përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin, në rast të konstatimit të punësimit të të huajve me qëndrim të paligjshëm në territor, mund t'u propozojë institucioneve shtetërore përgjegjëse për punëdhënësin masa shtesë si më poshtë:
   a) përjashtimin nga e drejta e përfitimeve publike, ndihmave ose financimeve deri në 5 vjet;
   b) përjashtimin nga pjesëmarrja në kontrata publike deri në 5 vjet;
   c) mbylljen e përkohshme apo të vazhdueshme të subjekteve, që u përdorën në kryerjen e shkeljes.

Neni 135
Detyrimet për noterët

1. Noterët gjatë kryerjes së veprimeve noteriale që kanë të bëjnë me të huajt, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose deklarojnë adresën e tyre, janë të detyruar t'u kërkojnë dokumentin përkatës nëse ata janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe ta evidentojnë këtë fakt në aktet noteriale të përpiluara.
2. Noterët përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni në rastet e përfaqësimit të të huajve me avokat para gjykatës.

Neni 136
Detyrime për individë dhe subjekte

1. Për të huajt, të cilët nuk janë të pajisur me një dokument të vlefshëm udhëtimi, të njohur nga ky ligj, apo nuk kanë vizë ose leje qëndrimi të vlefshme, është e ndaluar dhënia me qira e pasurive të paluajtshme.
2. Menaxherët/pronarët e hoteleve dhe qendrave të pushimit duhet të informojnë autoritetin shtetëror përgjegjës në nivel rajonal/vendor për trajtimin e të huajve, për mbërritjen dhe largimin e të huajve, të

cilët ata presin në mjediset e tyre. Hotelet dhe qendrat e pushimit e kanë të ndaluar të pranojnë të huaj, të cilët nuk provojnë se janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rast se i huaji qëndron në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të paligjshme dhe nuk disponon mjete të mjaftueshme financiare për kthim, ftuesi i tij apo organizuesi i transportit të tij në Republikën e Shqipërisë është i detyruar të mbulojë koston e kthimit.
4. Struktura shtetërore apo subjekte private ose individë janë të detyruar të njoftojnë menjëherë strukturat përgjegjëse të policisë kufitare dhe migracionit nëse marrin dijeni për të huaj që qëndrojnë ose punojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur janë të detyruar të ruajnë një sekret sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
5. Gjykata, e cila merr një vendim të formës së prerë, me të cilin shpall një të huaj fajtor për një vepër penale, njofton autoritetin rajonal përgjegjës për kufirin dhe migracionin për vendimin e marrë.
6. Institucionet e vuajtjes së dënimit duhet të njoftojnë autoritetet përgjegjëse rajonale për kufirin dhe migracionin 24 orë para lirimit të të huajit nga ky institucion.

KREU VIII
PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 137
Mbledhja e të dhënave dhe evidencat

1. Autoritetet përgjegjëse shtetërore për trajtimin e të huajve mbledhin dhe administrojnë të dhënat personale për të huajt nga organet shtetërore, subjektet private, shtetas shqiptarë apo të huaj, banorë në Republikën e Shqipërisë, si dhe nga vetë i huaji. Këto të dhëna regjistrohen në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt, si dhe në evidencat e posaçme kur:
   a) është e parashikuar në ligj ose në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;
   b) është në interes të të huajit dhe i huaji nuk e kundërshton atë;
   c) është e nevojshme për qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, sigurisë kombëtare dhe shëndetit publik.

2. Mbledhja, përpunimi, evidentimi dhe fshirja e të dhënave personale për të huajt, pas përfundimit të afatit, sipas përcaktimeve në nenin 139 të këtij ligji, rregullohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.
3. Ngritja dhe funksionimi i regjistrit elektronik për të huajt miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përbëhet nga:
   a) moduli i kontrollit kufitar;
   b) moduli i vizave;
   c) moduli i lejeve unike dhe të qëndrimit;
   ç) moduli i trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territor;
   d) moduli i dokumenteve të identifikimit dhe të udhëtimit për të huajt.

Neni 138
Përdorimi i të dhënave

1. Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve administrojnë dhe përdorin të dhënat e grumbulluara për të huajt në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave, si dhe i vënë ato në dispozicion të organeve të drejtësisë, organeve të sigurisë kombëtare, autoriteteve për refugjatët dhe autoriteteve rajonale, që kanë të bëjnë me të huajt dhe që janë të interesuara në këtë fushë.
2. Të dhënat e mbledhura dhe të administruara sipas këtij ligji dhe në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ruhen dhe përdoren nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin për një afat të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.
3. Për shkaqe të ligjshme, kanë të drejtë të mbledhin, të administrojnë, të shkëmbejnë dhe të kërkojnë vënie në disponim të të dhënave për të huajt:
   a) autoritetet shtetërore përgjegjëse për çështjet e shtetësisë;
   b) autoritetet shtetërore përgjegjëse për punësimin e të huajve;
   c) autoritetet shtetërore përgjegjëse financiare dhe doganore;
   ç) autoritetet përgjegjëse të gjendjes civile në zonën administrative ku jeton i huaji;
   d) autoritetet përgjegjëse të shëndetit publik;
   dh) autoritetet përgjegjëse të arsimit dhe shkencës.

4. Profili vjetor i migracionit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës.
5. Profili i zgjeruar i migracionit përgatitet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave statistikore për migracionin një herë në katër vjet brenda 9-mujorit të vitit pasardhës dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 139
Ruajtja e të dhënave

1. Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve, të cilat mbledhin dhe administrojnë të dhënat për të huajt sipas neneve 138 dhe 139 të këtij ligji, i ruajnë ato për një periudhë 5-vjeçare pas skadimit të vlefshmërisë së vizës ose të lejes së përkohshme të qëndrimit, apo dhjetëvjeçare nga përfundimi i procedurës ndëshkuese administrative ose penale. Për rastet e personave të shpallur si të padëshiruar për një periudhë më shumë se dhjetë vjet, afat i ruajtjes së të dhënave është i njëjtë me atë të përcaktuar në urdhrin me të cilin i huaji është shpallur person i padëshiruar.
2. Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve, të cilët mbledhin dhe administrojnë të dhëna personale për të huajt, marrin masat e duhura organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, humbja aksidentale, aksesi ose përhapja te persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi të jashtëligjshëm.
3. Cilido, që ka akses në të dhënat personale të mbledhura, të ruajtura dhe të përpunuara nga autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve, si gjatë ushtrimit të funksionit, ashtu dhe pas përfundimit, i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mospërhapjes së asnjë të dhëne personale, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

KREU IX
TARIFAT SHTETËRORE PËR LËSHIMIN E VIZËS, LEJES SË QËNDRIMIT DHE LEJES UNIKE DHE SANKSIONET

Neni 140
Tarifat shtetërore për lëshimin e vizës, lejes së qëndrimit dhe lejes unike

1. Punëtori i huaj paguan tarifën shtetërore para marrjes së vizës, lejes së qëndrimit dhe lejes unike. Tarifa përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Përjashtohen nga tarifa shtetërore për pajisjen me leje qëndrimi shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e përkatësive etnike shqiptare të republikave të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, që qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi.
3. Të ardhurat nga tarifat shtetërore transferohen në buxhetin e shtetit.

Neni 141
Masat ndëshkimore dhe ekzekutimi i tyre

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale sipas legjislacionit shqiptar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga autoritetet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.
   a) dënohet me gjobë nga 20 000 (njëzetë mijë) deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë i huaji, i cili:
      i. gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë pa dokumentin e kërkuar të udhëtimit, vizën, ose lejen e qëndrimit apo nuk përmbush detyrimin për t'u regjistruar apo për të aplikuar për leje qëndrimi;
      ii. punësohet me pagesë ose praktikon një zanat pa të drejtë për punësim fitimprurës;
      iii. nuk përmbush, nëse i kërkohet, detyrimin për të raportuar ose kërkesën për t'u paraqitur para autoriteteve për të dhënë informacion.
   b) i huaji, i cili hyn në vend, ndërkohë që ndaj tij ekziston një urdhër për ndalimin e hyrjes, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000(njëqind mijë) lekë.

c) i huaji, i cili kundërshton ose nuk përmbush kërkesat për verifikim identiteti, shtetësie ose lidhur me çështje të tjera në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij, dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzetë mijë) lekë.

ç) i huaji, i cili shkel afatet e qëndrimit, të përcaktuara në këtë ligj, por largohet me dëshirë para se autoritetet e kufirit dhe migracionit të kenë urdhëruar largimin e tij, dënohet me gjobë 50 000(pesëdhjetë mijë) lekë. Nëse tejkalimi i afatit të lejuar të qëndrimit është më shumë se 1 muaj, i huaji gjobitet me 100 000 (njëqind mijë) lekë.

d) personat shqiptarë ose të huaj, të cilët pranojnë të strehojnë ose të ofrojnë shërbime për të huaj, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, pa raportuar tek autoritetet përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, dënohen me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për person.

dh) personat shqiptarë ose të huaj, të cilët nuk mbajnë regjistër të dhënash për të huajt sipas këtij ligji e akteve në zbatim të tij, dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000(njëqind mijë) lekë për person.

e) i huaji, i cili humb pasaportën për të huajt ose dokumentet e lëshuara nga autoritetet e migracionit dhe nuk njofton për këtë brenda afatit të parashikuar, dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

ë) i huaji, i cili nuk paraqitet për ekzaminim tek inspektori sanitar shtetëror brenda 10 ditëve pas njoftimit të kësaj kërkese të organeve përgjegjëse, dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzetë mijë) lekë.

f) i huaji, i cili ndryshon destinacionin e veprimtarisë nga ajo për të cilën ka marrë lejen nga organet përgjegjëse, ose qëndron në Republikën e Shqipërisë për një motiv të ndryshëm nga ai për të cilin i është lëshuar leja e qëndrimit, leja unike apo viza, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

g) i huaji, i cili nuk përmbush detyrimin e njoftimit të adresës sipas afateve të përcaktuara, përbën shkelje administrative dhe sanksionohet me gjobë 3000 (tre mijë) lekë.

gj) i huaji, i cili nuk regjistron adresën e vendbanimit pranë zyrës të gjendjes civile sipas afateve në fuqi, dënohet me gjobë 3000 (tre mijë) lekë.

h) i huaji ose shtetasi shqiptar, i cili është ftues për një të huaj dhe nuk respekton detyrimet e marra përsipër për shkaqe të pajustifikuara, dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

i) organet shtetërore, personat publikë, juridikë ose fizikë, të cilët nuk zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtij ligji, dënohen me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

j) transportuesit, të cilët nuk raportojnë ose nuk dërgojnë paraprakisht apo nuk paraqesin në mënyrë të plotë e të saktë listën e personelit dhe të udhëtarëve, dënohen me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për person.

k) transportuesit që transportojnë të huaj, të cilët dukshëm nuk plotësojnë kushtet për të hyrë apo kaluar transit në Republikën e Shqipërisë, sipas detyrimit të përcaktuar në pikat 1 dhe 12 të nenit 131 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 300 000 (treqind mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për person.

l) prindërit ose kujdestarët ligjorë, të cilët nuk përmbushin përgjegjësitë ligjore për të miturit sipas dispozitave të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

ll) punëdhënësi ose punëmarrësi, i cili hyn në marrëdhënie pune në mënyrë të paligjshme, duke shkelur dispozitat e përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për punësimin e të huajve, dënohet me gjobë nga 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë për person.

m) i huaji ose shtetasi shqiptar, i cili lidh një martesë fiktive për të përfituar leje qëndrimi pa pasur qëllime serioze martesore, dënohet me gjobë nga 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë.

2. Gjobat ndaj të huajve, sipas përcaktimeve në këtë nen, vendosen pavarësisht nëse ndaj tyre është marrë ndonjë masë tjetër administrative, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Formati i aktit administrativ që vendos masën administrative miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 142
Ekzekutimi i masave ndëshkimore

1. Gjobat e vëna ndaj të huajit, sipas përcaktimeve në nenin 141 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutohen nga autoriteti që i ka vënë ato në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.
2. Kundër vendimit për vënien e gjobës mund të bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.
3. I huaji mund ta paguajë gjobën edhe në valutë sipas kursit ditor të këmbimit me lekun shqiptar.

KREU X
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 143
Marrëveshjet ndërkombëtare

Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura me qeveritë e shteteve të tjera, të ratifikuara me ligj, mund të parashikojnë dispozita të veçanta e më të favorshme për shtetasit e këtyre vendeve, që zbatohen reciprokisht.

Neni 144
Dispozitë kalimtare për lejet e qëndrimit

1. I huaji, të cilit i është lëshuar leje qëndrimi njëvjeçare sipas ligjit nr. 108, datë 28.3.2013, "Për të huajt", i ndryshuar, afati i së cilës përfundon pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse kushtet për të cilat është dhënë kjo leje mbeten të njëjta, vazhdon të përdorë lejen e qëndrimit të dhënë, pavarësisht se ky ligj përcakton emërtim të ndryshëm të lejes së qëndrimit.
2. I huaji, të cilit i është lëshuar leje qëndrimi 2-vjeçare, sipas ligjit nr. 108, datë 28.3.2013, "Për të huajt", i ndryshuar, afati i së cilës përfundon deri në një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse kushtet për të cilat është dhënë kjo leje mbeten të njëjta, vazhdon të përdorë lejen e qëndrimit të dhënë, pavarësisht se ky ligj përcakton emërtim të ndryshëm të lejes së qëndrimit.
3. I huaji, të cilit i është lëshuar leje qëndrimi 2-vjeçare, sipas ligjit nr. 108, datë 28.3.2013, "Për të huajt", i ndryshuar, afati i përfundimit të së cilës është më shumë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse kushtet për të cilat është dhënë kjo leje mbeten të njëjta, duhet të paraqitet pranë autoritetit rajonal për kufirin dhe migracionin për të zëvendësuar lejen e qëndrimit të dhënë brenda afatit 1-vjeçar të hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Të huajt, të cilëve u është lëshuar leje qëndrimi 5-vjeçare sipas ligjit nr. 108, datë 28.3.2013, "Për të huajt", i ndryshuar, nëse kushtet për të cilat është dhënë kjo leje mbeten të njëjta, vazhdojnë të përdorin lejen e qëndrimit të dhënë, pavarësisht se ky ligj përcakton emërtim të ndryshëm të lejes së qëndrimit.
5. Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për zëvendësimin e lejes së qëndrimit sipas pikës 3 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
6. Lejet e qëndrimit, lëshuar të huajve, në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në përfundim të datës së përfundimit të tyre, sa kohë që nuk anulohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nuk bëhen të pavlefshme, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 145
Dispozita kalimtare për lejet e punës

Lejet e punës, lëshuar punëmarrësve apo të vetëpunësuarve, ose përjashtimet nga detyrimi për pajisje me leje pune, në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, janë të vlefshme deri në përfundim të datës së përfundimit të tyre, sa kohë që nuk anulohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nuk bëhen të pavlefshme, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

Neni 146
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 1, shkronjat "dh" dhe "e"; 6, pika 12; 12, pika 7; 13, pika 3; 15, pika 2; 19, pika 4; 21, pika 3; 23, pika 1; 29, pikat 1 e 6; 32, pika 2; 33, pika 6; 37, pikat 1 e 4; 38, pika 2; 56, pika 7; 78, pika 2; 81, pika 4; 84, pika 4;

91, pika 3; 96, pika 3; 113, pika 5; 137, pika 3; 138, pika 5; 140, pika 1, dhe 141, pika 3, të ligjit.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimet në zbatim të neneve 9, pika 3; 15, pika 3; 25, pika 5; 34, pikat 3 dhe 4; 36, pika 3; 54, pika 3; 72, pika 4; 99, pika 9; 102, pika 7; 105, pika 4; 109, pika 4; 122, pika 5, dhe 123, pika 2, të ligjit.
3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë urdhrat në zbatim të neneve 81, pika 5; 86, pika 2; 111, pikat 1 dhe 4; 113, pika 4, dhe 138, pika 4, të ligjit.
4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe Shërbimi Informativ Shtetëror që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimet e përbashkëta në zbatim të neneve 22, pika 5; 24, pika 2; 25, pika 6; 28, pika 2; 29, pika 3; 33, pika 3, dhe 104, pika 4, të ligjit.
5. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe ministria përgjegjëse për ekonominë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 18, pika 4, të ligjit.
6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe ministria përgjegjëse për ekonominë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin urdhrin e përbashkët në zbatim të nenit 137, pika 2, të ligjit.
7. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të neneve 17, pikat 4 e 5; 26, pika 3; 29, pika 7, dhe 124, pika 3, të ligjit.
8. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet e migracionit dhe punës që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimin në zbatim të nenit 78, pika 7, të ligjit.
9. Ngarkohen ministria përgjegjëse për ekonominë dhe ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të neneve 69, pika 6 dhe 74, pika 15, të ligjit.

10. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin urdhrin në zbatim të nenit 69, pika 2, të ligjit.
11. Ngarkohet ministria përgjegjëse për ekonominë që brenda, 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë urdhrin në zbatim të neneve 67, pika 3, dhe 69, pika 2, të ligjit.

Neni 147
Shfuqizime

1. Ligji nr. 108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Aktet nënligjore, të cilat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji do të zbatohen deri në miratimin e akteve nënligjore të këtij ligji.

Neni 148
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar më datë 24.6.2021.

LIGJI

Nr. 10/2021

PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[36]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kushteve dhe procedurave për:

a) dhënien e statusit të refugjatit;

b) mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme në Republikën e Shqipërisë;

[36] Ky projektligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001, "Mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet Shteteve Anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përballimin e pasojave". Numri CELEX 32001L0055, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 212, datë 7.8.2001, f. 12–23.
- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003 "Mbi të drejtën e bashkimit familjar". Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, f. 12–18.
- Direktivën 2011/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 "Mbi standardet për kualifikimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që kanë të drejtë për mbrojtje plotësuese, dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë". Numri CELEX 32011L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 337, datë 20.12.2011, f. 9–26.
- Direktivën 2013/32/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Mbi procedurat e zakonshme për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare". Numri CELEX 32013L0032, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 80, datë 29.6.2013, f. 60–95.
- Direktivën 2013/33/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013, "Për përcaktimin e standardeve për pranimin e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare". Numri CELEX 32013L0033, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 180, datë 29.6.2013, f. 96–116.

c) humbjen, pushimin ose shfuqizimin e mbrojtjes ndërkombëtare;

ç) të drejtat dhe detyrimet e refugjatëve, të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese;

d) përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese;

dh) të drejtën për bashkim familjar;

e) përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve dhe të personave me mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa atyre u lejohet të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për anëtarët e familjes së tyre.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. "Azil" është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.
2. "Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët" është struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët.
3. "Anëtarë të familjes" janë të afërmit e kërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese, sipas përkufizimit të përcaktuar në ligjin për të huajt.
4. "Bashkim familjar" është hyrja dhe qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë e anëtarëve të familjes së një shtetasi të huaj, i cili qëndron në mënyrë të ligjshme në atë shtet, me qëllim që të ruhet njësia familjare, qoftë kur marrëdhënia familjare ka lindur para ose pas hyrjes së personit rezident.
5. "Fëmijë" është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë në kuptim të këtij ligji derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

6. "Fëmijë i pashoqëruar" është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi nën 18 vjeç, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për të, sipas ligjit ose sipas traditës, ose është lënë i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për sa kohë ai nuk është efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë.
7. "Fluksi masiv" është hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e një mase të madhe të personave të shpërngulur, të cilët vijnë nga një shtet apo zonë gjeografike e caktuar, qoftë edhe nëse ardhja e tyre ka qenë spontane apo e ndihmuar nga një program evakuimi.
8. "Kërkues" është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë.
9. "Kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare" është kërkesa për mbrojtje e paraqitur nga shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi, që kërkon ose kuptohet se kërkon të përfitojë statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese dhe nuk kërkon shprehimisht një lloj tjetër mbrojtjeje jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji, për të cilën aplikohet veçmas.
10. "Kërkesë e mëvonshme" është një kërkesë e re për mbrojtje ndërkombëtare, e paraqitur nga i huaji pas vendimit përfundimtar për kërkesën e mëparshme, duke përfshirë edhe rastet kur e ka tërhequr qartazi kërkesën e tij ose në rastet kur Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët e ka refuzuar atë për shkak të heqjes dorë të kërkesës.
11. "Konventa e Gjenevës" është Konventa për Statusin e Refugjatit, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju Jorkut, të datës 31 janar 1967, e ratifikuar.
12. "Kujdestar ligjor" është personi i caktuar nga gjykata për kërkuesin fëmijë i pashoqëruar, i cili vepron në emër dhe për llogari të këtij të fundit gjatë gjithë procedurës së përcaktimit të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare apo vetëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, përveç rastit kur me ligj kërkohet që vetë kërkuesi të kryejë personalisht një veprim të caktuar procedural.
13. "Kushtet materiale të pritjes" janë kushtet e pritjes që përfshijnë strehimin, ushqimin dhe veshmbathjet e dhëna në natyrë ose në formën e ndihmës financiare, si dhe shpenzimet e përditshme.

14. "Leje qëndrimi" është dokumenti i lëshuar nga autoritetet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit për të huajt, i cili lejon kërkuesin, refugjatin ose personin në mbrojtje plotësuese të qëndrojë në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë.
15. "Moskthim" është detyrimi i ndalimit për të dëbuar apo kthyer shtetasin e huaj ose personin pa shtetësi në çfarëdolloj mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria e tij, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve të tij politike.
16. "Ministria" është ministria përgjegjëse për çështjet e azilit.
17. "Ministri" është ministri përgjegjës për çështjet e azilit.
18. "Mbrojtja ndërkombëtare" përfshin statusin e refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese.
19. "Mbrojtja plotësuese" është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai rrezikon realisht të përballet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi, apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi.
20. "Mbrojtje e përkohshme" është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku që sistemi i azilit të jetë i paaftë të procedojë me këtë fluks, pa krijuar efekte të pafavorshme në funksionimin e tij efektiv, në interes të këtyre personave.
21. "Ndalim" nënkupton mbylljen e një kërkuesi të mbrojtjes ndërkombëtare në një vend të caktuar, kur kërkuesi është i privuar nga liria e lëvizjes së tij.
22. "Persona të shpërngulur" janë shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë lënë vendin e tyre të origjinës ose janë evakuuar në përgjigje të një kërkese nga organizatat ndërkombëtare dhe nuk janë në gjendje për t'u kthyer në kushte të sigurta dhe të qëndrueshme për shkak të gjendjes mbizotëruese në atë vend, i cili është brenda fushës së zbatimit të nenit 1 (A) të Konventës

së Gjenevës apo akteve të tjera ndërkombëtare ose kombëtare për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare, në veçanti:

a) personat që kanë ikur nga zonat e konfliktit të armatosur ose dhuna endemike (rajonale);
b) personat në rrezik të rëndë ose që kanë qenë viktima të shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

23. "Përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare" është personi të cilit i është njohur statusi i refugjatit ose mbrojtjes plotësuese.
24. "Person pa shtetësi" është personi që nuk gëzon shtetësinë e asnjë shteti për shkak të mungesës së një lidhjeje të qëndrueshme juridike ndërmjet tij dhe një shteti.
25. "Persona që i përkasin kategorisë së veçantë" janë fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjymtimit gjenital, LGBTI, personat me sëmundje të rënda, personat me probleme/çrregullime të shëndetit mendor ose personat, të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale.
26. "Përfaqësues i autorizuar" është përfaqësuesi, i cili vepron në emër dhe për llogari të kërkuesit gjatë gjithë procedurës së përcaktimit të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare apo vetëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, përveç rastit kur me ligj kërkohet që vetë kërkuesi të kryejë personalisht një veprim të caktuar procedural.
27. "Qendra e Pritjes për Azil" është struktura e caktuar për pranimin dhe akomodimin kolektiv të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare.
28. "Refugjat" është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës.
29. "Statusi i refugjatit" është njohja në Republikën e Shqipërisë e shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.

30. "Statusi i mbrojtjes plotësuese" është njohja në Republikën e Shqipërisë e të huajit ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese.
31. "Shtetas i huaj" është personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe ka shtetësi të huaj.
32. "Shtet apo vend i origjinës" është shteti, shtetësinë e të cilit mban kërkuesi ose në rastin e personave pa shtetësi, vendbanimi i zakonshëm i mëparshëm.
33. "UNHCR" është Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vijim UNHCR.
34. "Vendim përfundimtar" është vendimi i dhënë nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët për njohjen apo refuzimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare ose vendimi i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët kur është ushtruar e drejta e ankimit ndaj vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët ose vendimi i gjykatës kompetente kur është ushtruar e drejta e ankimit ndaj vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

Neni 4

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti përgjegjës në kufi dhe në territor për trajtimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe për pajisjen me leje qëndrimi është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, sipas ligjit për të huajt.
2. Autoriteti përgjegjës për trajtimin, shqyrtimin dhe dhënien e vendimit përfundimtar për kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare është struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët.
3. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është organi administrativ epror për shqyrtimin e ankimit administrativ të paraqitur ndaj vendimit të dhënë nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët.
4. Autoriteti përgjegjës për pajisjen me leje pune dhe trajtimin e marrëdhënieve të punës të personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare sipas këtij ligji, është struktura përgjegjëse për punësimin dhe aftësitë.

5. Autoriteti përgjegjës për trajtimin shëndetësor dhe përkujdesjen sociale të personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare sipas këtij ligji, është ministria përgjegjëse për përkrahjen sociale dhe shëndetësinë.
6. Autoriteti përgjegjës për ofrimin e arsimit të personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare sipas këtij ligji, është ministria përgjegjëse për arsimin.
7. Autoritetet përgjegjëse sipas këtij neni, ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë në përputhje me fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore menjëherë pas plotësimit të formularit përkatës në kufi ose brenda në territor.

Neni 5
E drejta për azil

Republika e Shqipërisë garanton të drejtën për azil të shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, i cili ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi për shkak të frikës së bazuar për të qenë i persekutuar për arsye të racës, të besimit fetar, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose të bindjes politike.

Neni 6
Roli i UNHCR-së

1. Autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji bashkëpunojnë me UNHCR-në gjatë gjithë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët.
2. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët i dërgon UNHCR-së listën e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare që shqyrtohen nga ky autoritet dhe të ankimeve që janë paraqitur, si dhe çdo informacion tjetër që kërkohet për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendase me UNHCR-në, në përputhje me nenin 35 të Konventës së Gjenevës.
3. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët mund t'i kërkojë UNHCR-së mendime ose rekomandime me karakter të përgjithshëm, si dhe rekomandime për raste të veçanta apo gjatë flukseve masive.

4. Autoritetet përgjegjëse e lejojnë UNHCR-në, kur ajo e kërkon:
   a) të ketë kontakt me kërkuesit, duke përfshirë edhe ata në paraburgim, kufi dhe në zona tranziti;
   b) të njihet me informacionin për kërkesat individuale, ecurinë e procedurës dhe vendimet e marra në përfundim të tyre, duke siguruar më parë pëlqimin e kërkuesit;
   c) të paraqesë opinionet e veta ndaj autoriteteve përgjegjëse për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare në çdo fazë të procedurës së parashikuar në këtë ligj.
5. Shkëmbimi i informacionit, si dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe UNCHR-së përcaktohen në marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet ministrisë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe UNCHR-së.

Neni 7
Vendi i parë i azilit

1. Një shtet mund të konsiderohet si vend i parë i azilit për një kërkues të veçantë nëse:
   a) kërkuesi në atë shtet është njohur si refugjat dhe mund të përfitojë akoma nga mbrojtja e atij shteti; ose
   b) kërkuesi gëzon mbrojtje të mjaftueshme në atë shtet, duke përfshirë përfitimet nga parimi i moskthimit.
2. Kërkuesit do të lejohen të kundërshtojnë zbatimin e konceptit të vendit të parë të azilit në rrethanat e tij të veçanta.

Neni 8
Shteti i tretë i sigurt

1. Një shtet i tretë i sigurt është shteti ku kërkuesi ka qëndruar para se të arrijë në Republikën e Shqipërisë dhe në të cilin prezumohet se ai do të kthehet i sigurt kur autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji krijojnë bindjen se kërkuesi që kërkon mbrojtje ndërkombëtare do të trajtohet në përputhje me parimet e mëposhtme në shtetin e tretë:
   a) j eta dhe liria nuk kërcënohen në bazë të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup social të caktuar ose përfaqësimit të ndonjë qëndrimi politik;
   b) nuk ka rrezik të cenimit të rëndë;

c) respektohet parimi i moskthimit në përputhje me Konventën e Gjenevës;
ç) respektohet ndalimi i dëbimit, në shkelje të së drejtës për lirinë nga tortura dhe trajtimi mizor, çnjerëzor dhe degradues, sipas së drejtës ndërkombëtare; dhe
d) ekziston mundësia për të kërkuar statusin e refugjatit dhe, nëse personi është refugjat, përfiton mbrojtje në përputhje me Konventën e Gjenevës.

2. Koncepti i shtetit të tretë të sigurt zbatohet, nëse plotësohen parimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për çdo kërkesë individualisht dhe nëse ekziston një lidhje ndërmjet këtij shteti dhe kërkuesit në bazë të së cilës në mënyrë të arsyeshme mund të pritet që kërkuesi të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare.
3. Koncepti i shtetit të tretë të sigurt sipas pikës 1 të këtij neni, nuk do të zbatohet nëse bashkëshorti/ja, fëmijët ose prindërit e kërkuesit qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë.
4. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët i lëshon kërkuesit, kërkesa e të cilit është konsideruar e papranueshme sipas këtij ligji, një dokument, me qëllim informimin e autoriteteve përgjegjëse të atij shteti, që kërkesa e tij nuk është shqyrtuar në Republikën e Shqipërisë. Formati tip i këtij dokumenti përcaktohet me urdhër të ministrit.
5. Në rast se shteti i tretë i sigurt nuk ripranon kërkuesin, atij i sigurohet aksesi në procedurat e azilit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9

Shteti i sigurt i origjinës

1. Një shtet i tretë konsiderohet shtet i sigurt i origjinës pas shqyrtimit individual të kërkesës për kërkuesin e veçantë, nëse:
   a) kërkuesi ka shtetësinë e atij vendi;
   b) kërkuesi është person pa shtetësi dhe ka pasur vendbanimin e zakonshëm të mëparshëm në atë shtet;
   c) nuk ka paraqitur informacion të mjaftueshëm për ta konsideruar shtetin në fjalë si shtet të pasigurt të origjinës për rrethanat e veçanta personale për të qenë përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare sipas këtij ligji.

2. Gjatë vlerësimit nëse një shtet konsiderohet shtet i sigurt i origjinës, autoritetet përgjegjëse sigurohen që kërkuesit t'i garantohet mbrojtje nga persekutimi dhe cenimi i rëndë nëpërmjet:
   a) legjislacionit në fuqi dhe mënyrës së zbatimit të tij;
   b) respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të sanksionuara në konventat ndërkombëtare;
   c) respektimit të parimit të moskthimit;
   ç) ekzistencës së një sistemi ligjor mbrojtjeje kundër shkeljes së të drejtave dhe lirive.
3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon në kohë kërkuesin për zbatimin e konceptit të vendit të sigurt të origjinës, në mënyrë që t'i mundësohet e drejta për të kundërshtuar zbatimin e konceptit të vendit të sigurt të origjinës, në kuadër të natyrës dhe të rrethanave të tij personale, për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare sipas këtij ligji.

Neni 10

Përcaktimi i vendeve të treta si shtete të treta të sigurta

1. Lista e vendeve të treta si shtete të treta të sigurta miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
2. Këshilli i Ministrave vlerëson rregullisht situatën në lidhje me shtetet e përcaktuara si shtete të treta të sigurta dhe për këtë qëllim përditëson listën e miratuar.
3. Vlerësimi nëse një shtet është shtet i tretë i sigurt, sipas këtij neni, bazohet në burime të tjera informacioni, përfshirë në veçanti informacionin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, EASO-ja (Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin), UNHCR-ja, Këshilli i Evropës dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

KREU II
PARIMET BAZË DHE GARANCITË

Neni 11
Parimi i moskthimit

1. Kërkuesi, refugjati, personi me statusin e mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtje të përkohshme nuk dëbohet, kthehet apo ekstradohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:
   a) në një shtet ku jeta ose liria e tij kërcënohet për shkak të racës, të besimit, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;
   b) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane apo në marrëveshjet/ konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;
   c) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë;
   ç) në shtetin e tij të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
   d) në një shtet të tretë, i cili mund ta kthejë ose ta dërgojë personin në një nga shtetet, sipas përcaktimeve të shkronjave "a" , "b" dhe "c" të kësaj pike.
2. I huaji, kërkesa e të cilit është refuzuar nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, nuk dëbohet ose nuk nxirret jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përpara ushtrimit apo dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.
3. Përjashtimisht, kërkuesi mund të kthehet, kur:
   a) ka arsye të bazuara për ta konsideruar atë si një rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;
   b) është dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për një krim i cili përbën rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 12
Persekutimi

1. Për t'u konsideruar persekutim, në kuptim të nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës, akti duhet:
   a) të jetë mjaftueshëm i rëndë nga natyra ose i kryer më shumë se një herë ose veprimi paraqet shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut, posaçërisht të të drejtave të cilat nuk mund të kufizohen sipas paragrafit 2 të nenit 15 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore; ose
   b) të jetë akumulimi i masave të ndryshme, përfshirë edhe shkeljen e të drejtave të njeriut, e cila është mjaftueshëm e rëndë për një individ në mënyrë të ngjashme me parashikimin e bërë në shkronjën "a" të kësaj pike.
2. Akti i persekutimit në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ndër të tjera, ka formën e:
   a) aktit të dhunës fizike ose psikologjike, duke përfshirë dhunën seksuale;
   b) masës ligjore, administrative, të policisë dhe/ose aktit gjyqësor, të cilat janë diskriminuese ose janë zbatuar në mënyrë diskriminuese;
   c) ndjekjes penale ose dënimit penal, që është joproporcional ose diskriminues;
   ç) mohimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për rishikim të tyre dhe që rezulton në dënim joproporcional ose diskriminues;
   d) ndjekjes penale ose dënimit penal për shkak të refuzimit për të kryer shërbimin ushtarak në një konflikt, kur kryerja e shërbimit ushtarak përfshin krime ose akte që janë brenda fushës së veprimit për përjashtim nga e drejta e mbrojtjes ndërkombëtare sipas këtij ligji;
   dh) aktit të kryer në mënyrë të veçantë të lidhur me dhunën me bazë gjinore ose me fëmijët.
3. Në përputhje me përkufizimin e refugjatit, duhet të ekzistojë një lidhje ndërmjet aktit të persekutimit dhe arsyeve të këtij persekutimi, në rast të mosgarantimit të mbrojtjes ndaj këtyre akteve.

Neni 13

Vlerësimi i arsyeve të persekutimit

1. Në vlerësimin e arsyeve të persekutimit mbahet parasysh:
   a) koncepti i racës, që në mënyrë të veçantë përfshin elementet e ngjyrës, prejardhjen ose përkatësinë në një grup të veçantë etnik;
   b) koncepti i besimit, që në mënyrë të veçantë përfshin mbajtjen e bindjeve fetare, jofetare ose ateiste, pjesëmarrjen apo abstenimin nga lutjet formale në publik ose në mjedise private, qoftë vetëm ose në komunitet me të tjerët, akte të tjera besimi ose shprehjen e mendimeve me natyrë fetare ose forma të sjelljes personale ose të përbashkët, të bazuara ose të ndikuara nga çdo besim fetar;
   c) kombësia, e cila nuk nënkupton shtetësinë ose mungesën e saj, por në mënyrë të veçantë duhet të përfshijë përkatësinë në një grup të përcaktuar nga identiteti i tij kulturor, etnik ose gjuhësor, origjinën e përbashkët gjeografike ose politike ose marrëdhëniet e tij me popullsinë e një shteti tjetër;
   ç) grupi, i cili konsiderohet formë e veçantë e një grupi shoqëror, ku në veçanti:
      i. anëtarët e atij grupi ndajnë një karakteristikë të lindur ose një mjedis kulturor të përbashkët që nuk mund të ndryshohet, ose ndajnë një karakteristikë ose besim që është kaq thelbësor për identitetin ose ndërgjegjen, saqë një person nuk duhet të detyrohet ta refuzojë atë;
      ii. grupi ka një identitet të dallueshëm në vendin përkatës, sepse ai perceptohet si i ndryshëm nga shoqëria përreth.
   d) bindja politike, e cila në veçanti përfshin pasjen e një opinioni, bindjeje ose besimi në një çështje që lidhet me aktorët e mundshëm të persekutimit, të përmendur në nenin 15 të këtij ligji, dhe me politikat ose metodat e tyre, pavarësisht nëse ai opinion, bindje ose besim ka ndikuar mbi kërkuesin ose jo.
2. Gjatë vlerësimit nëse një kërkues ka frikë të bazuar për përndjekje, nuk ka rëndësi nëse ai zotëron karakteristikat racore, fetare, të kombësisë, sociale apo politike, që tërheqin përndjekjen, por kushti është që këto karakteristika t'i atribuohen kërkuesit nga aktorët e përndjekjes.

Neni 14

Cenimi i rëndë

Me cenim të rëndë, për qëllim të dhënies së statusit të mbrojtjes plotësuese, kuptohet:

   a) dënimi me vdekje ose ekzekutimi;
   b) tortura ose trajtimi johuman dhe degradues, si dhe zhdukja me forcë e kërkuesit në vendin e origjinës;
   c) kërcënimi i rëndë dhe individual ndaj jetës së një personi për shkak të dhunës, pa dallim në situatat e konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm.

Neni 15

Aktorët e persekutimit ose cenimit të rëndë

Aktorë të persekutimit ose cenimit të rëndë mund të jenë:

   a) shteti;
   b) palët ose organizatat që kontrollojnë shtetin ose pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit;
   c) aktorë joshtetërorë, nëse mund të provohet se aktorët e përmendur në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare, nuk kanë mundësi ose nuk kanë vullnet të ofrojnë mbrojtje kundër persekutimit ose cenimit të rëndë.

Neni 16

Aktorët e mbrojtjes

1. Mbrojtja nga persekutimi ose cenimi i rëndë mund të sigurohet vetëm nga:
   a) shteti;
   b) palët ose organizatat, përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare që kontrollojnë shtetin ose pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit, kur dëshirojnë ose janë në gjendje të ofrojnë mbrojtje në përputhje me pikën 2 të këtij neni.
2. Mbrojtja nga persekutimi ose cenimi i rëndë duhet të jetë efektive dhe jo me natyrë të përkohshme. Një mbrojtje e tillë ofrohet në përgjithësi kur aktorët e përmendur në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni marrin masa të arsyeshme për të parandaluar persekutimin ose

vuajtjen e cenimit të rëndë, ndër të tjera, duke siguruar veprimin e një sistemi ligjor efektiv për zbulimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e akteve, që përbëjnë persekutim ose cenim të rëndë dhe kur kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare ka akses në një mbrojtje të tillë.

Neni 17

Lindja e mbrojtjes ndërkombëtare në vend

1. Shtetasit të huaj, i cili ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund t'i jepet mbrojtje ndërkombëtare në përputhje me nenet 18 dhe 20 të këtij ligji, mbështetur në frikën e bazuar për persekutim apo rrezikun real të cenimit të rëndë, bazuar në ngjarje të cilat kanë ndodhur që nga koha kur kërkuesi është larguar nga vendi i origjinës.
2. Frika e bazuar për persekutim apo rreziku real i cenimit të rëndë mund të bazohet në aktivitete në të cilat kërkuesi ka qenë i angazhuar që nga koha e largimit nga vendi i origjinës, në veçanti kur konstatohet se këto aktivitete paraqesin shprehje dhe vazhdimësi të bindjeve ose të orientimeve të shprehura në vendin e origjinës.

Neni 18

Njohja e statusit të refugjatit

Statusi i refugjatit i njihet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, i cili ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë dhe plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 19

Përjashtimi nga statusi i refugjatit

1. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi përjashtohet nga e drejta për njohjen e statusit të refugjatit në Republikën e Shqipërisë nëse ka dyshime të bazuara për:
   a) kryerjen e një krimi kundër paqes, krime lufte apo kundër njerëzimit, kryerjen e një akti terrorist, sipas përcaktimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare;
   b) kërcënimin e rendit publik dhe sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, për shkak të kryerjes së një krimi të rëndë jopolitik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, para hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

   c) fajësinë për veprime që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.
2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe ndaj personave që nxisin ose marrin pjesë në forma të tjera në kryerjen e krimeve ose akteve të përcaktuara në këtë pikë.
3. Statusi i refugjatit nuk i jepet një të huaji të marrë nën mbrojtje apo asistencë nga organet e OKB-së, me përjashtim të rasteve kur mbrojtja i garantohet nga UNHCR-ja.
4. Nëse mbrojtja ose asistenca, sipas pikës 3 të këtij neni, ka pushuar për ndonjë arsye, i huaji përfiton mbrojtje ndërkombëtare nëse plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj.
5. Statusi i refugjatit nuk i jepet një të huaji që ka të drejta dhe detyrime të barabarta me shtetasit e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur të drejtat dhe detyrimet lidhen specifikisht me shtetësinë shqiptare.

Neni 20

Njohja e statusit të mbrojtjes plotësuese

Statusi i mbrojtjes plotësuese i njihet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, i cili nuk përmbush kriteret për të përfituar statusin e refugjatit, por i garantohet e drejta për azil për të qëndruar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kur ekzistojnë rrethanat e përballjes së një rreziku real të cenimit të rëndë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 14 të këtij ligji.

Neni 21

Përjashtimi nga statusi i mbrojtjes plotësuese

1. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi përjashtohet nga e drejta për njohjen e statusit të mbrojtjes plotësuese për të cilin ka dyshime të bazuara se:
   a) ka kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit, në kuptim të dispozitave ndërkombëtare që përcaktojnë këto krime;
   b) ka kryer krime jopolitike të rënda;
   c) është deklaruar fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, të parashikuara në preambulën dhe nenet 1 e 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

ç) paraqet rrezik për rendin publik ose për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe ndaj personave të cilët nxisin ose marrin pjesë në forma të tjera në kryerjen e krimeve ose akteve të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni.
3. Statusi i mbrojtjes plotësuese nuk i njihet personit që ka kryer një apo më shumë vepra penale para se të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë, jashtë përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, por që do të ishin të dënueshme me burgim nëse do të kryheshin në Republikën e Shqipërisë dhe nëse i huaji është larguar nga vendi i origjinës me qëllim për t'iu shmangur dënimeve që rezultojnë nga këto krime.

Neni 22
Ndihma ligjore

1. Kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare i garantohet ndihma ligjore dhe informacion për kriteret dhe procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe të drejtën për ndihmë ligjore falas, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Kërkuesi ka të drejtë që në çdo fazë të procedurës të kontaktojë me personat që sigurojnë këshillim ligjor dhe përfaqësuesit e UNHCR-së.

Neni 23
Gjuha e procedurës dhe e drejta për përkthyes

1. Në rastet kur kërkuesi nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, i sigurohet shërbimi i përkthimit në gjuhën e shtetit të origjinës ose në një gjuhë që ai e kupton.
2. Përkthyesi detyrohet të trajtojë të dhënat me të cilat njihet gjatë procedurës si të dhëna konfidenciale dhe duke respektuar sekretin profesional.
3. Kërkuesit, në bazë të kërkesës së tij të justifikuar dhe nëse është e mundur, i sigurohet një përkthyes i së njëjtës gjini.
4. Kërkuesi ka të drejtë të angazhojë një përkthyes sipas zgjedhjes të vet, me kusht që ky i fundit të mos jetë kërkues.

Neni 24
Interesi më i lartë i fëmijës

Gjatë zbatimit të këtij ligji, mbizotëron interesi më i lartë i fëmijës, në përputhje me Konventën e OKB-së "Mbi të drejtat e fëmijës".

Neni 25
Informimi dhe këshillimi në pikat e kalimit kufitar dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në lidhje me kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare

1. Kur ka të dhëna se shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, që mbahen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ose paraqiten në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë zonat e tranzitit në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, mund të paraqesin kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare, autoritetet përgjegjëse u sigurojnë atyre informacion për mundësinë për ta bërë këtë kërkesë. Në vendet e cituara në këtë pikë dhe në pikat e kalimit kufitar, organi kompetent shtetëror duhet të mundësojë përkthimin, sipas nevojës, për ta lehtësuar mundësinë e aksesit në procedurat për përcaktimin e statusit të mbrojtjes.
2. Autoritetet përgjegjëse shtetërore sigurohen që organizatat dhe personat që ofrojnë këshilla për kërkuesit kanë akses efektiv tek ata në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë zonat e tranzitit në kufi. Ministria përcakton rregulla për praninë e organizatave dhe personave të tillë në pikat e kalimit kufitar dhe, në veçanti, kur aksesi është subjekt i marrëveshjes me organin kompetent. Kufizimet për këtë akses mund të vendosen vetëm nëse sipas legjislacionit përkatës ato janë objektivisht të nevojshme për sigurinë kombëtare, rendin publik ose menaxhimin administrativ të pikave të kalimit në fjalë, me kushtin që aksesi nuk kufizohet rëndë ose nuk bëhet i pamundur.

KREU III
PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Neni 26
Regjistrimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

1. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi mund të shprehë qëllimin për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, verbalisht ose në formë të shkruar, në momentin e hyrjes në territorin e Republikën e Shqipërisë, në një pikë të kalimit kufitar, në një stacion të Policisë së Shtetit, pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

2. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili ka shprehur qëllimin për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, regjistrohet pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin, i cili e referon rastin brenda 72 orëve pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
3. Regjistrimi sipas pikës 2 të këtij neni shërben si dëshmi që shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi është kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare dhe i lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm për qëllim të procedurës deri në dhënien e vendimit të formës së prerë.
4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët siguron që i huaji, i cili ka shprehur qëllimin sipas pikës 1 të këtij neni, të ketë mundësi efektive që të vijojë procedurat për mbrojtje ndërkombëtare sa më shpejt të jetë e mundur. Kërkesa nuk refuzohet për arsyen e vetme se nuk është paraqitur sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Në rastet kur shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi paraqet kërkesë tek autoritetet përgjegjëse për trajtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, regjistrimi do të bëhet jo më vonë se 3 (tri) ditë pas paraqitjes së kërkesës.
6. Nëse parashtrohen kërkesa të shumta të njëkohshme për mbrojtje ndërkombëtare nga një numër i madh i shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi dhe që e bëjnë të vështirë në praktikë respektimin e afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, afati për regjistrim zgjatet deri në 10 (dhjetë) ditë.
7. Kërkuesi, në momentin e paraqitjes së kërkesës, plotëson formularin, ku përfshihen marrja e gjurmëve daktiloskopike, e fotografisë, dëshmive të tjera në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin sigurohet për hedhjen e të dhënave në regjistrin elektronik.
8. Procedura dhe rregullat e dërgimit të rastit nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 27

Paraqitja e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

1. Kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare plotësohet me shkrim. Nëse kërkuesi nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, atij i sigurohet përkthyes në gjuhën që ai kupton. Kërkesa, përveç

identitetit, përmban edhe shkaqet për të cilat kërkuesi kërkon mbrojtje në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Kërkuesi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, informohet në një gjuhë të cilën e kupton ose në mënyrë të arsyeshme supozohet se e kupton për procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes, të drejtat dhe detyrimet në një procedurë të tillë, kushtet e pritjes, të drejtën për të kontaktuar me përfaqësues të UNHCR-së në çdo fazë të procedurës, me pasojat e mundshme në rast të mospërmbushjes së detyrimeve dhe mosbashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse si dhe të drejtën për ndihmë ligjore. Ky informacion jepet në mënyrë verbale dhe, nëse është e nevojshme, sigurohet edhe në formë të shkruar.
3. Në kohën e plotësimit të formularit të përcaktimit të statusit për mbrojtje ndërkombëtare, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon kërkuesin dhe me pëlqimin e tij mundëson kontaktin me një specialist në çështjet e azilit, për shërbime ligjore falas.
4. Kërkuesi me shpenzimet e tij ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues, i cili do ta ndihmojë dhe do ta përfaqësojë atë gjatë procedurës për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.
5. Përfaqësuesi i autorizuar ka të drejtë të njihet me informacionin në dosjen e kërkuesit, për aq sa informacioni është i rëndësishëm për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. Përfaqësuesit të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare mund t'i mohohet aksesi në dosjen e kërkuesit, kur zbulimi i informatave ose burimeve rrezikon sigurinë kombëtare, sigurinë e organizatave apo personave që ofrojnë informacionin, sigurinë e personit të cilit i referohet informacioni, kur cenohen interesat e hetimit në lidhje me shqyrtimin e kërkesës nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët ose rrezikohen marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

5/1. Përjashtimisht, aksesi në informacione ose burime të tilla të përcaktuara sipas pikës 6 të këtij neni, mund t'i lejohet një përfaqësuesi ligjor i cili është i pajisur me certifikatë të sigurisë për njohjen e informacionit të klasifikuar, përderisa informacioni është i rëndësishëm për shqyrtimin e kërkesës ose për marrjen e një vendimi për heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

6. Për periudhën deri në dhënien e vendimit përfundimtar ose të

formës së prerë nga gjykata, kërkuesi lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk mund të kërkojë leje qëndrimi me motiv tjetër në bazë të ligjit për të huajt.

Neni 28

Afati për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

1. Procedura për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, si rregull, zgjat 6 (gjashtë) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.
2. Afati, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej 3 (tre) muajsh në rastet kur:
   a) kemi të bëjmë me çështje komplekse, faktike ose ligjore;
   b) një numër i madh i shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi kanë paraqitur njëherësh kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, duke e bërë të vështirë në praktikë përfundimin e procedurës brenda afatit 6 (gjashtë) -mujor.
3. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët mund të shtyjë afatin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit në rastet kur nuk mund të merret vendim brenda afateve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, për arsye të situatës së paqartë në shtetin e origjinës, e cila pritet të jetë e përkohshme. Në këto raste autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët:
   a) shqyrton situatën në shtetin e origjinës çdo 6 (gjashtë) muaj;
   b) informon kërkuesin për arsyet e shtyrjes dhe afatet kohore brenda të cilave pritet të merret vendimi për kërkesën e tij.
4. Në çdo rast, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët përfundon shqyrtimin brenda afatit maksimal kohor prej 21 (njëzet e një) muajsh nga paraqitja e kërkesës.

Neni 29

Pjesëmarrja në procedurë

1. Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare mund të jenë të pranishëm vetëm personat e mëposhtëm:
   a) përfaqësuesi i autorizuar;
   b) kujdestari ligjor i një fëmije të pashoqëruar apo të rrituri me aftësi të kufizuara;

   c) përkthyesi;
   ç) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ose në njësitë administrative, në rastet kur nuk është caktuar një kujdestar për fëmijën e pashoqëruar;
   d) përfaqësuesi i UNHCR-së, kur aprovohet nga kërkuesi.
2. Në rastet kur vlerësohet nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare të një fëmije të pashoqëruar apo të një personi tjetër që i përket kategorisë së veçantë sipas këtij ligji, mund të marrë pjesë edhe psikologu.

Neni 30

Intervista personale

1. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët fillon procedurën e intervistimit me kërkuesin brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur nga paraqitja e kërkesës.
2. Intervista me kërkuesin nuk është publike dhe atij i garantohet konfidencialiteti.
3. Kërkuesi intervistohet personalisht pa praninë e anëtarëve të familjes, përveç rastit kur struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët e konsideron të nevojshme praninë e tyre për të zhvilluar shqyrtimin e duhur të kërkesës.
4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të kryeje regjistrim audio ose audiovizual të intervistës personale, kur çmohet e arsyeshme, me kusht që kërkuesi të jetë i informuar paraprakisht lidhur me të. Kjo strukturë përgjegjëse sigurohet që kërkuesi të jetë plotësisht i informuar për përmbajtjen e procesverbalit të transkriptuar me ndihmën e një përkthyesi, ku i garantohet e drejta që të bëjë komente ose të japë shpjegime në lidhje me ndonjë keqkuptim të paraqitur në të në fund të intervistës ose brenda një kohe të arsyeshme para se Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët të marrë vendim. Kur procesverbali i transkriptuar regjistrohet në përputhje me këtë pikë, ai mund të shërbejë si provë në procedurat e ankimit.
5. Në çdo rast, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët mban një procesverbal gjatë intervistës personale me kërkuesin, i cili

nënshkruhet nga kërkuesi për të konfirmuar vërtetësinë e tij, pasi i është komunikuar më parë përmbajtja e tij në gjuhën që ai kupton.

6. Nëse kërkuesi refuzon të nënshkruajë procesverbalin, arsyet për këtë refuzim pasqyrohen në dosjen e kërkuesit. Refuzimi për të nënshkruar procesverbalin nuk ndikon në marrjen e vendimit nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët.
7. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët garanton që intervistat personale të kryhen në kushte të cilat i lejojnë kërkuesit t'i paraqesë arsyet për kërkesën e bërë, në mënyrë gjithëpërfshirëse. Për këtë qëllim, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët sigurohet që:
   a) nëpunësi, i cili kryen intervistën, të jetë i trajnuar për të marrë parasysh rrethanat personale dhe të përgjithshme lidhur me kërkesën, duke përfshirë origjinën kulturore të kërkuesit, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor apo cenueshmërinë;
   b) kur është e mundur, të sigurojë që intervista me kërkuesin të kryhet nga një person i gjinisë së njëjtë, nëse kërkuesi e kërkon një gjë të tillë, përveç rastit kur Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët ka arsye të besojë se kjo gjë është e bazuar në arsye të cilat nuk kanë lidhje me vështirësitë e kërkuesit për t'i paraqitur arsyet e kërkesës së tij në mënyrë gjithëpërfshirëse;
   c) të zgjedhë një përkthyes, i cili është në gjendje të sigurojë komunikim të duhur ndërmjet kërkuesit dhe nëpunësit që zhvillon intervistën. Komunikimi zhvillohet në gjuhën e zgjedhur nga kërkuesi. Kur është e mundur, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët siguron një përkthyes të gjinisë së njëjtë nëse kërkuesi e kërkon këtë, përveç rastit kur ka arsye të besojë se kjo gjë është e bazuar në arsye të cilat nuk janë të lidhura me vështirësitë nga ana e kërkuesit për t'i paraqitur arsyet e kërkesës së tij në mënyrë gjithëpërfshirëse;
   ç) nëpunësi që kryen intervistën nuk ka veshur uniformë ushtarake ose të zbatimit të ligjit;
   d) intervista me fëmijë të kryhet në mënyrë të përshtatshme për fëmijë.
8. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vlerëson rastet kur kërkuesi është i papërshtatshëm ose nuk mund të intervistohet për shkak të rrethanave të paqëndrueshme jashtë kontrollit të tij. Kur ka dyshime, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, në

bashkëpunim me stafin e qendrës ku kërkuesi është akomoduar, kërkon një mendim të specializuar dhe të certifikuar nga institucionet mjekësore kompetente për të përcaktuar nëse gjendja që e bën kërkuesin të papërshtatshëm ose të paaftë për t'u intervistuar është e një natyre të përkohshme ose të qëndrueshme. Mungesa e intervistës personale nuk do të ndikojë negativisht në vendimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
9. Në rastet kur gjatë intervistimit konstatohen dëshmi kontradiktore, ose kur autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët e vlerëson të nevojshme për një shqyrtim të gjithanshëm të rrethanave, për të cilat kërkuesi ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, ky autoritet përgjegjës mund të vendosë të kryejë intervista të tjera me kërkuesin.
10. Nëse një person ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në emër të anëtarëve madhorë të familjes së tij, çdo anëtari të familjes i jepet mundësia e intervistës personale.

Neni 31

Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

1. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare fillon në momentin e plotësimit të formularit për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët nga kërkuesi.
2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, gjatë shqyrtimit të kërkesës, vlerëson nëse kërkuesi plotëson kushtet për statusin e refugjatit apo të mbrojtjes plotësuese dhe i mundëson kërkuesit të paraqesë, të shpjegojë e të dëshmojë të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me kërkesën e tij, si dhe të gjitha dokumentet e nevojshme që lidhen me përcaktimin e mbrojtjes ndërkombëtare.
3. Kërkuesi është i detyruar të paraqesë dokumentacionin e plotë sa më shpejt që të jetë e mundur, si dhe të paraqesë informacion për moshën, lidhjet familjare, identitetin, shtetësinë, shtetet apo vendet e mëparshme të qëndrimit, kërkesat e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare, itineraret e udhëtimit, dokumentin e udhëtimit e të identifikimit dhe arsyet për paraqitjen e kërkesës.
4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, gjatë shqyrtimit të kërkesës, merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që ndihmojnë në marrjen e vendimit, ku përfshihen:

a) informacioni i saktë dhe i përditësuar nga burime të ndryshme, të tilla si EASO-ja (Zyra Mbështetëse Evropiane për Azilin), UNHCR-ja dhe organizatat e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për gjendjen e përgjithshme që mbizotëron në vendet e origjinës së kërkuesve dhe, kur është e nevojshme, edhe për vendet përmes së cilave ata kanë kaluar tranzit;

b) deklarata dhe dokumente të paraqitura nga kërkuesi, duke përfshirë informacionin nëse kërkuesi ka qenë subjekt i persekutimit apo cenimit të rëndë;

c) r rethanat personale të kërkuesit, ku përfshihen faktorë të tillë, si: origjina, orientimi seksual dhe mosha, me qëllim për të vlerësuar nëse është persekutuar apo cenuar në bazë të këtyre faktorëve;

ç) informacion nëse aktivitetet e kryera nga kërkuesi, për shkak të të cilave është larguar nga vendi i origjinës, janë kryer me qëllimin e vetëm për të krijuar kushte për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare.

5. Në rast se kërkuesi nuk mbështet me dokumentacion dhe dëshmi të tjera aspekte të caktuara të deklaratave të tij dhe nuk justifikon fakte dhe rrethana të caktuara të lidhura me kërkesën, deklarata e kërkuesit do të konsiderohet e besueshme nëse:
   a) ka bërë përpjekje të sinqerta për të justifikuar si të bazuar kërkesën e tij;
   b) të gjitha elementet relevante që ka pasur në dispozicion, janë parashtruar dhe është dhënë shpjegim i kënaqshëm, qoftë edhe me mungesën e elementeve të tjera mbështetëse;
   c) është koherente dhe e besueshme dhe nuk është në kundërshtim me informacionet e veçanta dhe të përgjithshme në dispozicion të strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët për rastin e kërkuesit;
   ç) ka kërkuar mbrojtje ndërkombëtare në kohën më të hershme të mundshme, përveç rastit nëse ai mund të demonstrojë arsye të forta për vonesën në paraqitjen e kërkesës dhe konstatohet në përgjithësi besueshmëri e kërkuesit.
6. Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët mund të marrë në konsideratë dëshmi shtesë për të vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 32

Ndërprerja e procedurës

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vendos ndërprerjen e procedurës për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare në rastet e mëposhtme:
   a) kur kërkuesi tërheq kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare;
   b) kur kërkuesi largohet nga vendqëndrimi i fundit për më shumë se 3 (tri) ditë pa njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët, përveç rasteve kur kërkuesi vërteton brenda një kohe të arsyeshme se largimi i tij dhe moslajmërimi kanë ndodhur "për shkaqe të justifikueshme" ose "për shkaqe që nuk varen prej tij";
   c) nuk është paraqitur në intervistë në datën e komunikuar për zhvillimin e intervistës dhe nuk ka njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për arsyet e mosparaqitjes, brenda 3 (tri) ditëve;
   ç) është larguar nga Republika e Shqipërisë gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës, pa dijeninë e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët
2. Vendimi i ndërprerjes së procedurës është vendim i ndërmjetëm.
3. Kërkuesi mund të kërkojë që të rihapet procedura për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare. Kërkesa për të rihapur procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes pengon dëbimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa për rihapjen e procedurës mund të bëhet vetëm një herë.
4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, pas ndërprerjes së procedurës sipas pikës 1 të këtij neni, merr vendim për pushimin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.
5. Kërkuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesën për rihapje të procedurës jo më vonë se 9 (nëntë) muaj nga data kur autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.
6. Procedura dhe afati për marrjen e vendimit për pushimin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 33

Vendimi për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare

1. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të kërkesës, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët merr vendim nëpërmjet të cilit:
   a) njeh statusin e refugjatit;
   b) refuzon statusin e refugjatit dhe njeh statusin e mbrojtjes plotësuese;
   c) refuzon kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare;
   ç) ndërpret procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare;
   d) pushon shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.
2. Vendimi, sipas pikës 1 të këtij neni, jepet në formë të shkruar dhe përmban:
   a) pjesën hyrëse, që përmban:
      i. emrin e organit publik që nxjerr aktin;
      ii. palët të cilave u drejtohet akti;
      iii. datën e miratimit;
      iv. bazën ligjore.
   b) pjesën arsyetuese;
   c) dispozitivin, që përmban:
      i. pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;
      ii. kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
      iii. të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet dhe afatet ligjore për paraqitjen e ankimit.
3. Vendimi i autoritetit përgjegjës në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët merret në një mbledhje të posaçme me shumicë votash. Procedura e marrjes së vendimit u nënshtrohet parimeve dhe legjislacionit në fuqi për marrjen e vendimeve nga organet kolegjiale. Vendimi përpilohet me shkrim dhe arsyetohet. Punonjësit e autoritetit përgjegjës në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, të cilët janë në pakicë, mund ta shprehin me shkrim mendimin e tyre kundër, i cili i bashkëlidhet vendimit përfundimtar.
4. Një kopje e vendimit të autoritetit përgjegjës në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët i komunikohet kërkuesit dhe UNHCR-së brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të vendimit.

Neni 34

Procedura e përshpejtuar

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të marrë vendim për zbatimin e procedurës së përshpejtuar, në përputhje me parimet dhe garancitë themelore të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me rastet kur:
   a) vendimi pozitiv është i bazuar në dëshmitë në dispozicion; ose
   b) vendimi negativ merret sipas neneve 35 dhe 36 të këtij ligji.
2. Në rastet kur kërkesa konsiderohet e papranueshme ose dukshëm e pabazuar, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me vendim të arsyetuar, vendos refuzimin e kërkesës, brenda 15 ditëve nga paraqitja e saj.
3. Kundër këtij vendimi, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit. Ankimi pezullon ekzekutimin e vendimit.
4. Kundër vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë ankim pranë gjykatës kompetente administrative, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi.
5. Kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurës së përshpejtuar do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

Kërkesa e papranueshme

1. Kërkesa nuk shqyrtohet dhe konsiderohet e papranueshme vetëm nëse:
   a) një shtet anëtar i Bashkimit Evropian i ka ofruar kërkuesit mbrojtje ndërkombëtare;
   b) shteti që nuk është shtet anëtar i Bashkimit Evropian konsiderohet si vend i parë i azilit për kërkuesin sipas këtij ligji;
   c) shteti që nuk është shtet anëtar i Bashkimit Evropian konsiderohet shtet i tretë i sigurt për kërkuesin sipas këtij ligji;
   ç) kërkesa është paraqitje e një kërkese të re, që nuk ka elemente apo gjetje të reja nëse kërkuesi kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare në bazë të këtij ligji.

2. Në rastet kur vendimi është i bazuar vetëm në konceptin e shtetit të sigurt të origjinës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët sigurohet që:
   a) kërkuesi të informohet në kohë për zbatimin e konceptit të shtetit të sigurt të origjinës, në mënyrë që t'i mundësohet e drejta për të kundërshtuar zbatimin e konceptit të shtetit të sigurt të origjinës, në kuadër të natyrës dhe të rrethanave të tij personale;
   b) t'i japë kërkuesit, të cilit i është refuzuar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare, një dokument në gjuhën e vendit të tretë të sigurt, sipas të cilit të informohen autoritetet përgjegjëse të vendit përkatës që kërkesa e tij është apo nuk është shqyrtuar në thelb në Republikën e Shqipërisë;
   c) vendi i tretë nuk i lejon kërkuesit hyrjen në territorin e vet, në përputhje me procedurat e ligjit për të huajt dhe nga autoriteti përgjegjës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i siguron atij akses në procedurën e azilit, të parashikuar në këtë ligj.

Neni 36
Kërkesa dukshëm e pabazuar

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vlerësojë një kërkesë si "dukshëm të pabazuar" kur pretendimi i bërë nga kërkuesi nuk ka lidhje, në asnjë mënyrë, me kriteret për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare, të parashikuara sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare do të konsiderohet dukshëm e pabazuar në rastet kur kërkuesi:
   a) në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe të fakteve përkatëse ka ngritur vetëm çështje që nuk janë të lidhura me shqyrtimin nëse ai kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare në përputhje me këtë ligj;
   b) vjen nga një shtet i sigurt i origjinës, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj;
   c) ka mashtruar duke paraqitur informacion apo dokumente të rreme ose duke fshehur informacion ose dokumente që vërtetojnë identitetin apo shtetësinë e tij, në rast se kjo do të kishte ndikim negativ në vendim;
   ç) ka mundësi që me dashje të ketë shkatërruar ose zhdukur dokumentet e identitetit apo të udhëtimit, të cilat do të ndihmonin në përcaktimin e identitetit apo të shtetësisë;

   d) ka bërë deklarata të paqëndrueshme dhe kontradiktore, qartazi të rreme ose dukshëm të paqëndrueshme, të cilat bien ndesh me informacionet e vërtetuara që janë për shtetin e origjinës, duke rezultuar qartë në pretendime jobindëse në lidhje me faktin nëse kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare në kuptim të këtij ligji;
   dh) ka paraqitur një kërkesë tjetër për mbrojtje ndërkombëtare, që nuk është e pranueshme sipas nenit 35 të këtij ligji;
   e) ka paraqitur kërkesë vetëm për të vonuar apo penguar një vendim të hershëm që do të rezultonte në largimin e tij;
   ë) ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të paligjshme dhe nuk është paraqitur përpara autoriteteve përgjegjëse brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e hyrjes, ose ka shtyrë qëndrimin në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të paligjshme dhe pa arsye të bazuara, ose nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare sa më shpejt që ka qenë e mundur, duke marrë parasysh rrethanat e hyrjes së tij;
   f) refuzon të japë shenjat e gishtërinjve;
   g) për arsye të rënda mund të konsiderohet rrezik për sigurinë kombëtare ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë.

Neni 37
Refuzimi i kërkesës

Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët refuzon kërkesën e paraqitur për mbrojtje ndërkombëtare në rastet kur:

   a) kërkuesi nuk i përmbush kriteret për statusin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;
   b) konsideron se kërkuesi nuk ka të drejtë për mbrojtje, sipas neneve 12 dhe 14 të këtij ligji;
   c) kërkesa është e papranueshme sipas nenit 35 të këtij ligji;
   ç) kërkesa është e pabazuar sipas nenit 36 të këtij ligji.

Neni 38
Kërkesë e re për mbrojtje ndërkombëtare

1. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, kërkesa e të cilit është refuzuar me vendim përfundimtar, i cili ka marrë formë të prerë, mund të paraqesë kërkesë të re për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

2. Kërkesa e re, sipas pikës 1 të këtij neni, shqyrtohet vetëm nëse kërkuesi paraqet fakte dhe të dhëna të reja nëse ai mund të kualifikohet për mbrojtje ndërkombëtare. Nëse gjatë shqyrtimit konstatohen fakte dhe të dhëna të reja, të cilat në masë të konsiderueshme mundësojnë që kërkuesi të kualifikohet për mbrojtje ndërkombëtare, atëherë kërkesa e re shqyrtohet sipas procedurës të rregullt të parashikuar në kreun III të këtij ligji.

KREU IV
PUSHIMI, SHFUQIZIMI, HUMBJA E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Neni 39
Humbja e statusit të refugjatit

1. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi humbet statusin e refugjatit nëse:
   a) në mënyrë vullnetare kthehet në vendin e tij të shtetësisë;
   b) ka fituar shtetësinë dhe gëzon mbrojtjen e vendit të shtetësisë së fituar;
   c) ka fituar një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e vendit të shtetësisë të re;
   ç) në mënyrë vullnetare rikthehet në vendin nga i cili ishte larguar apo jashtë të cilit ka mbetur me frikën e të qenit i persekutuar;
   d) rrethanat me të cilat i ishte njohur statusi i refugjatit, kanë pushuar së ekzistuari dhe nuk mundet më tej të vazhdojë të refuzojë të përfitojë nga mbrojtja e vendit të tij të shtetësisë.
   dh) rrethanat me të cilat i ishte njohur statusi i refugjatit kanë pushuar së ekzistuari dhe personi pa shtetësi mund të kthehet në vendin e mëparshëm të banimit të zakonshëm;
   e) është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë pa njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
2. Në rastin e shqyrtimit të shkronjave "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mban parasysh faktin nëse ndryshimi i rrethanave është me natyrë të rëndësishme dhe jo të përkohshme dhe, për rrjedhojë, frika e refugjatit për persekutim nuk mund të konsiderohet më si e bazuar.

3. Shkronjat "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni nuk zbatohen për refugjatin, i cili mund të paraqesë arsye bindëse që rrjedhin nga persekutimi i mëparshëm për refuzimin e përfitimit nga mbrojtja e vendit të shtetësisë, ose duke qenë person pa shtetësi, të vendbanimit të mëparshëm.

Neni 40
Shfuqizimi i statusit të refugjatit

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët shfuqizon statusin e refugjatit në rastet kur:
   a) ka humbur statusin e refugjatit, sipas nenit 39 të këtij ligji;
   b) është përjashtuar nga statusi i refugjatit në përputhje me nenin 19 të këtij ligji;
   c) ka shtrembërim ose mosparaqitje të fakteve nga ana e tij, përfshirë përdorimin e dokumenteve false dhe kjo gjë ka qenë vendimtare për njohjen e statusit të refugjatit;
   ç) ka dyshime të arsyeshme që ai të konsiderohet i rrezikshëm për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;
   d) është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi të rëndë, i cili paraqet rrezik për rendin dhe sigurinë publike.
2. Para se të merret vendimi i shfuqizimit të statusit të refugjatit, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton me shkrim përfituesin e mbrojtjes ndërkombëtare lidhur me arsyet e rishqyrtimit të statusit të tij, si dhe i ofron mundësinë për të paraqitur në formë të shkruar apo verbale pretendimet e tij lidhur me shfuqizimin e statusit. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mban procesverbal.

Neni 41
Pushimi i statusit të mbrojtjes plotësuese

1. Personat me statusin e mbrojtjes plotësuese nuk konsiderohen më të tillë nga momenti kur rrethanat që justifikonin dhënien e kësaj mbrojtjeje pushojnë së ekzistuari ose kur këto rrethana kanë ndryshuar në mënyrë të tillë që kjo mbrojtje nuk është më e nevojshme.
2. Në rastin e zbatimit të pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr në konsideratë faktin nëse ndryshimi i rrethanave është i rëndësisë së tillë dhe i natyrës jo të përkohshme

dhe, për pasojë, personi që gëzon statusin e mbrojtjes plotësuese nuk përballet më tej me rrezik real të cenimit të rëndë.

3. Mbrojtja plotësuese pushon edhe në rastin kur personi heq dorë vullnetarisht prej saj apo është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë pa njoftuar autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
4. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet ndaj personit me statusin e mbrojtjes plotësuese, i cili është në gjendje të dëshmojë arsye bindëse që rrjedhin nga përndjekja e mëparshme, se nuk mund të gëzojë mbrojtje nga shteti i tij ose nga shteti i banimit të mëparshëm të zakonshëm, në rastin e personave pa shtetësi.

Neni 42

Shfuqizimi i statusit të mbrojtjes plotësuese

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët shfuqizon statusin e mbrojtjes plotësuese në rastet e mëposhtme:
   a) nuk është më përfitues i statusit të mbrojtjes plotësuese sipas nenit 20 të këtij ligji.
   b) është përjashtuar nga dhënia e statusit të mbrojtjes plotësuese sipas nenit 21 të këtij ligji;
   c) shtrembërimi ose mosparaqitja e fakteve, përfshirë përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, ka qenë vendimtare për dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese;
   ç) ka dyshime të arsyeshme që përbën rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;
2. Para se të merret vendimi i shfuqizimit të statusit të mbrojtjes plotësuese, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton me shkrim personin me statusin e mbrojtjes plotësuese për arsyet e rishqyrtimit të statusit, si dhe i ofron mundësinë për të paraqitur në formë të shkruar ose verbale pretendimet e tij për shfuqizimin e statusit. Në rast të deklaratave verbale, struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët mban procesverbal.

KREU V
QËNDRIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 43

Pranimi i kërkuesit në Qendrën e Pritjes për Azil

1. Kërkuesi, i cili deklaron qëllimin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, transferohet në Qendrën e Pritjes për Azil, ku ka të drejtë të qëndrojë deri në momentin kur merret vendimi përfundimtar.
2. Kërkuesi mund të akomodohet në Qendrën e Pritjes për Azil, në vendin e përcaktuar nga ministria ose në një vend tjetër sipas dëshirës së tij.
3. Kërkuesi informohet menjëherë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga akomodimi për të drejtat dhe detyrimet të cilat duhet t'i përmbushë në lidhje me kushtet e pritjes. Atij i sigurohet informacion për organizatat ose personat që ofrojnë ndihmë të specializuar ligjore, si dhe këshillim për kushtet e pritjes, duke përfshirë edhe kujdesin shëndetësor.
4. Gjatë qëndrimit në Qendër kërkuesi mund të paraqesë një kërkesë pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët për të qëndruar jashtë saj me shpenzimet e tij, duke evidentuar paraprakisht adresën e re të banimit, si dhe numrin e kontaktit, para miratimit të kësaj kërkese nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
5. Pas akomodimit në Qendër, kërkuesi i nënshtrohet vizitës së nevojshme mjekësore.

Neni 44

Qendra e Pritjes për Azil

1. Qendra e Pritjes për Azil është person juridik publik, në varësi administrative të ministrit.
2. Organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Pritjes për Azil rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Qendra informon autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për procedurat e hyrjes, të daljes apo të qëndrimit të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, të kryera sipas nenit 43 të këtij ligji.
4. Qendra duhet të sigurojë kushtet minimale të jetesës, përfshirë:

a) akomodimin;
b) ushqimin;
c) sigurimin shëndetësor;
ç) kushtet minimale të higjienës.

5. Në bashkëpunim me subjekte të tjera, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, në përputhje me të drejtat e kërkuesve e të refugjatëve, zhvillohen programe pedagogjike e edukuese, si dhe këshillim ligjor falas.

Neni 45
Ndalimi

1. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, që hyn në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të ndiqet penalisht për kalim të paligjshëm të kufirit, me kusht që të paraqitet përpara autoriteteve përgjegjëse brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Kërkuesit, të cilët paraqiten brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të ndalohen vetëm për arsyet e mëposhtme:
   a) për verifikimin e identitetit të tyre;
   b) kur nuk kanë dokumente identifikimi;
   c) kur janë kapur me dokumente të falsifikuara, me përjashtim të rastit kur ata i kanë përdorur këto dokumente për t'u larguar nga vendi për shkak të frikës dhe e kanë deklaruar këtë fakt vetë në kufi ose kur paraqesin kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare;
   ç) kur ndaj tyre është lëshuar një mandat arresti ndërkombëtar;
   d) për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe të rendit publik.
3. Masat shtrënguese ndaj një kërkuesi merren në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin penal dhe procedural në fuqi.
4. Në rast ndalimi ose arrestimi, kërkuesi mbahet në ambiente të veçuara nga personat e tjerë, përveç kur këto masa shtrënguese merren në bazë të shkronjës "c" të pikës 2 të këtij neni.
5. Në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, në rastin e kërkuesve fëmijë të pashoqëruar, nën moshën 18 vjeç, ata nuk mund të vendosen në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

Neni 46
Kufizimi i lirisë së lëvizjes

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vendosë që kërkuesi të mbahet në Qendër nëse e konsideron të nevojshme bazuar në vlerësimin individual të secilit rast dhe, në qoftë se me masa të tjera alternative më pak shtrënguese nuk mund të arrihet qëllimi i kufizimit të lirisë së lëvizjes, në rastet e mëposhtme:
   a) për të përcaktuar ose verifikuar identitetin dhe shtetësinë e tij;
   b) për të përcaktuar faktet në të cilat është bazuar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare dhe që nuk mund të siguroheshin pa kufizimin e lirisë së lëvizjes, sidomos kur ekziston rreziku i ikjes së kërkuesit;
   c) kur është e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik dhe të shëndetit publik;
   ç) kur kërkuesi mbahet për qëllime të procedurës së kthimit për të përgatitur kthimin dhe/ose kryer procedurën e largimit dhe kur organi kompetent mund të dëshmojë në bazë të kritereve objektive, përfshirë edhe faktin se kërkuesi ka pasur tashmë mundësinë për të filluar procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare, se ka baza të arsyeshme për të besuar se personi po paraqet kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vetëm për ta shtyrë ose penguar ekzekutimin e vendimit të kthimit të tij.
2. Kërkuesi nuk duhet të kërkojë leje për t'u paraqitur pranë autoriteteve shtetërore ose në gjykatë kur paraqitja e tij është e nevojshme.

Neni 47
Masat për kufizimin e lirisë së lëvizjes

1. Liria e lëvizjes së kërkuesit, sipas përcaktimit të nenit 46 të këtij ligji, mund të kufizohet me masat e mëposhtme:
   a) ndalimi i lëvizjes jashtë Qendrës së Pritjes për Azil;
   b) ndalimi i lëvizjes jashtë hapësirës së caktuar nga autoriteti përgjegjës;
   c) detyrimi për paraqitje pranë organit kompetent në kohën e caktuar;
   ç) dorëzimi i dokumenteve të udhëtimit tek organi kompetent;
   d) akomodimi në Qendrën e Mbyllur për të Huaj.

2. Në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr vendim në formë të shkruar duke vendosur:
   a) masat alternative të kufizimit të lirisë së lëvizjes së kërkuesit;
   b) mbajtjen e kërkuesit në Qendrën e Pritjes për Azil;
   c) kohëzgjatjen e kufizimit në raport me qëllimin e vendimit.
3. Në rastet kur sipas pikës 1 të këtij neni ekzistojnë kushtet për kufizimin e lirisë së lëvizjes së kërkuesit duke e mbajtur atë në Qendrën e Pritjes për Azil, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr vendim për mbajtjen në Qendër të kërkuesit deri në 8 (tetë) ditë dhe ky vendim i njoftohet kërkuesit. Kërkuesi mund të mbahet në këtë Qendër për më shumë se 8 (tetë) ditë vetëm me vendim të gjykatës administrative kompetente. Kërkesa në këtë gjykatë paraqitet nga ministria.
4. Ndaj vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët kërkuesi mund të paraqesë ankim në gjykatën administrative kompetente. Ankimi në gjykatë sipas kësaj pike pezullon ekzekutimin e vendimit.
5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë brenda 72 orëve nga data e paraqitjes së ankimit, pasi dëgjon përfaqësuesin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët për të mbajtur kërkuesin në Qendrën e Pritjes për Azil për më shumë se 8 (tetë) ditë, mendimin e kërkuesit dhe të përfaqësuesit të tij, nëse ka, dhe, duke vlerësuar arsyet për zbatimin e masave kufizuese dhe kushtet për ndalimin e lëvizjes vendos:
   a) të rrëzojë kërkesën për mbajtjen e kërkuesit për më shumë se 8 (tetë) ditë në Qendrën e Pritjes për Azil;
   b) të pranojë kërkesën për mbajtjen e kërkuesit në Qendrën e Pritjes për Azil, duke i ndaluar lëvizjen jashtë Qendrës dhe duke përcaktuar njëkohësisht edhe periudhën e mbajtjes në këtë Qendër.
6. Kërkuesit fëmijë mund të mbahen në Qendrën e Pritjes për Azil vetëm si masë e fundit dhe pasi është përcaktuar se masat e tjera alternative të kufizimit të lirisë së lëvizjes nuk mund të zbatohen në mënyrë efektive. Kufizimi i lirisë së lëvizjes duhet të jetë për një periudhë sa më të shkurtër kohore dhe duhet të sigurohet se janë bërë të gjitha përpjekjet për mbajtjen dhe vendosjen e tyre në një akomodim të përshtatshëm për fëmijë, nëse vlerësohet si interesi i tij më i lartë.

Neni 48
Vizita mjekësore

1. Nëse autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët e konsideron të rëndësishme për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, me pëlqimin e kërkuesit, ai mund t'i nënshtrohet vizitës mjekësore për shenjat që mund të dëshmojnë persekutimin e ushtruar ose cenimin e rëndë.
2. Vizita mjekësore e parashikuar në pikën 1 të këtij neni koordinohet dhe ndiqet nga personeli i Qendrës së Azilit ku kërkuesi është i akomoduar dhe rezultatet e saj të certifikuara nga mjeku specialist i dorëzohen autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët sa më shpejt që të jetë e mundur. Refuzimi i kërkuesit për t'iu nënshtruar një vizite të tillë mjekësore nuk e pengon autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët në marrjen e vendimit lidhur me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.
   Vizitat mjekësore të kryera në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni do të paguhen nga fondet publike.
3. Nëse nuk kryhet vizita mjekësore sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon kërkuesin se me iniciativën dhe shpenzimet e tij mund të kryejë vizita mjekësore për shenjat që mund të japin indicie të persekutimit të kaluar ose të cenimeve të rënda.
4. Rezultatet e vizitave mjekësore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, vlerësohen nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët së bashku me elementet e tjera të kërkesës.

Neni 49
Largimi i kërkuesit

1. Kërkuesi, të cilit i është refuzuar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare ose i është shfuqizuar vendimi i statusit të refugjatit ose i mbrojtjes plotësuese, është subjekt i largimit nga territori sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt.
2. Familjarët, të cilët kanë përfituar bashkim familjar me të huajin sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni, janë gjithashtu në të njëjtën kohë subjekt largimi.
3. Në këto raste autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton autoritetin përgjegjës për kufirin dhe migracionin për zbatimin e legjislacionit për të huajt.

KREU VI
KATEGORITË E VEÇANTA TË KËRKUESVE TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Neni 50
Personat që i përkasin kategorisë së veçantë

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe çdo autoritet tjetër shtetëror, në zbatim të përcaktimeve të bëra në këtë ligj, u kushtojnë vëmendje, trajtim dhe kujdes të veçantë personave që i përkasin kategorisë së veçantë.
2. Nevojat e veçanta të këtyre personave përcaktohen në bazë të vlerësimit individual të secilit kërkues, refugjat, person nën mbrojtje plotësuese ose person nën mbrojtje të përkohshme sipas këtij ligji.
3. Kërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese ose personat nën mbrojtje të përkohshme, që i përkasin kategorisë së veçantë, përfitojnë trajtim të ndryshëm në përputhje me nevojat e tyre specifike për akomodimin, ofrimin e kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin e nevojshëm mjekësor, si dhe këshillimin e nevojshëm psikosocial.
4. Kërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese ose personat nën mbrojtje të përkohshme, të cilët kanë qenë subjekt i ushtrimit të torturës, të përdhunimit apo të akteve të tjera të rënda të dhunës, marrin trajtimin e plotë dhe të duhur për dëmin e shkaktuar nga akte të tilla, në veçanti mundësinë për të pasur trajtimin dhe kujdesin e duhur mjekësor dhe psikologjik.
5. Personat, të cilët punojnë me viktimat e torturës, të përdhunimit apo të akteve të tjera të rënda të dhunës, duhet të kenë marrë ose marrin trajnimin e duhur në lidhje me nevojat e tyre dhe duhet t'u përmbahen rregullave të konfidencialitetit për informacionin që marrin gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

Neni 51
Procedurat e veçanta dhe garancitë e pranimit

1. Nëpërmjet procedurave të veçanta dhe garancive të pranimit, kërkuesve iu jepet mbështetja e duhur duke u bazuar në rrethanat e tyre personale, si: mosha, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësi të kufizuara, sëmundje e rëndë, çrregullim mendor, ose si rezultat i torturës, përdhunimit apo formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, në mënyrë që të ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.
2. Procedura e njohjes së rrethanave personale të kërkuesve, siç është përmendur në pikën 1 të këtij neni, kryhet në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësit e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, të trajnuar posaçërisht, që nga momenti i shprehjes së qëllimit për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare deri në marrjen e vendimit përfundimtar.
3. Procedura e përshpejtuar, sipas nenit 34 të këtij ligji, nuk zbatohet për kërkuesit të cilët kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale, në veçanti për viktimat e torturës, të përdhunimit ose të formave të tjera të dhunës së rëndë psikologjike, dhunës fizike apo seksuale, në qoftë se sipas kësaj procedure nuk mund të sigurohet mbështetje e duhur.
4. Kërkuesit me probleme të shëndetit mendor i caktohet përfaqësues në rastet kur shpreh qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare dhe para fillimit të procedurës për shqyrtimin e saj.

Neni 52
Fëmijët e pashoqëruar

1. Kërkuesi fëmijë i pashoqëruar merret në mbrojtje dhe i caktohet një kujdestar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në momentin që shpreh qëllimin për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim, autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin njofton menjëherë strukturën e shërbimeve shoqërore në bashki. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative së bashku me kërkesën për kujdestari.
2. Në asnjë rrethanë fëmija i pashoqëruar nuk mund të merret në pyetje pa qenë i shoqëruar nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, si përfaqësues i tij. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës kryen detyrat duke zbatuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, i emëruar si përfaqësues i fëmijës së pashoqëruar, mund të ndryshohet vetëm nëse është e domosdoshme.

3. Kujdestari informon fëmijën e pashoqëruar për kuptimin dhe pasojat eventuale të intervistës personale dhe, kur është e nevojshme, si të përgatitet për intervistë personale. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ose në njësitë administrative lejohet të marrë pjesë në intervistë dhe ka të drejtë të paraqesë pyetje ose komente brenda kornizës së përcaktuar nga nëpunësi intervistues.
4. Në rastet kur fëmija i pashoqëruar intervistohet për kërkesën e paraqitur për mbrojtje ndërkombëtare, kjo intervistë zhvillohet nga nëpunësi i cili ka njohuri të domosdoshme për nevojat e veçanta të fëmijës.
5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bën të gjitha përpjekjet që në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse kombëtare ose organizatat ndërkombëtare, të marrë të gjitha masat për të gjurmuar/gjetur sa më shpejt prindërit apo të afërmit e tjerë të ngushtë të fëmijës së pashoqëruar.
6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët koordinon punën me strukturat përgjegjëse që fëmija i pashoqëruar që nga momenti i hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të vendoset:
   a) me të afërmit e rritur;
   b) me ndonjë familje kujdestare;
   c) në qendra të specializuara për akomodim të fëmijëve; ose
   ç) në akomodim tjetër të përshtatshëm për fëmijët.
7. Përjashtimisht, kërkuesi fëmijë i pashoqëruar që ka mbushur moshën 16 vjeç mund të vendoset në qendra akomodimi për kërkues të rritur, nëse për një gjë të tillë ai ka dhënë pëlqimin dhe është në interesin e tij dhe vendoset në kujdestari të të afërmit të rritur, i cili rri bashkë me të në Qendër.
8. Në rastet kur mund të ketë kërcënim për jetën ose integritetin e fëmijës së pashoqëruar apo të anëtarëve të ngushtë të familjes së tij, veçanërisht nëse ata kanë mbetur në vendin e origjinës, autoritetet përgjegjëse sigurohen që mbledhja, shkëmbimi dhe përpunimi i informacionit përkatës me ata persona të bëhet mbi baza konfidenciale.
9. Për aq sa është e mundur, vëllezërit e motrat duhet të mbahen së bashku duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijëve dhe në veçanti moshën e tyre dhe shkallën e pjekurisë. Ndryshimet e vendqëndrimit të fëmijëve të pashoqëruar duhet të kufizohen sa më shumë që të jetë e mundur.

Neni 53

Vizitat mjekësore për fëmijët e pashoqëruar

1. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, fëmija i pashoqëruar mund t'i nënshtrohet vizitës mjekësore për të përcaktuar moshën e tij, brenda kuadrit të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, në rastet kur pas deklarimeve të përgjithshme apo indicieve të tjera të dobishme, ky autoritet ka dyshime lidhur me moshën e kërkuesit. Nëse edhe pas kësaj vizite autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vazhdon të ketë dyshime, kërkuesi do të konsiderohet se është fëmijë.
2. Vizita mjekësore kryhet duke respektuar në tërësi dinjitetin individual, duhet të jetë me natyrë sa më pak ndërhyrëse, si dhe të kryhet nga profesionistë të kualifikuar të mjekësisë, për të mundësuar, për aq sa është e mundur, një rezultat të besueshëm. Vizita mjekësore koordinohet dhe ndiqet nga punonjësit e Qendrës së Azilit në prani të psikologut, ku fëmija i pashoqëruar është akomoduar, dhe rezultatet e saj të certifikuara nga mjeku specialist i dorëzohen autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
3. Në rastet kur kryhen vizita mjekësore, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët sigurohet që:
   a) fëmija i pashoqëruar të informohet para shqyrtimit të kërkesës në një gjuhë të cilën e kupton apo të cilën supozohet se e kupton, për mundësinë e përcaktimit të moshës së tij nëpërmjet vizitës mjekësore.
      Informacioni përfshin edhe informatat për metodën e vizitës dhe pasojat e mundshme që rrjedhin nga vizita mjekësore, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për pasojat e refuzimit të vizitës mjekësore prej tij;
   b) fëmija i pashoqëruar dhe/ose kujdestari i tij jep pëlqimin për kryerjen e vizitës mjekësore, me qëllim përcaktimin e moshës;
   c) vendimi për të refuzuar kërkesën e bërë nga fëmija i pashoqëruar, që ka kundërshtuar kryerjen e vizitës mjekësore, nuk do të bazohet vetëm në këtë kundërshtim;
   ç) fakti që fëmija i pashoqëruar ka refuzuar kryerjen e vizitës mjekësore nuk do të pengojë autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët në marrjen e vendimit për kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

4. Në zbatimin e këtij neni, mendimi i fëmijës do të merret parasysh në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.
5. Të gjithë personat që punojnë me fëmijët e pashoqëruar duhet të kenë marrë ose duhet të marrin trajnim të përshtatshëm për nevojat specifike të tyre dhe respektojnë parimin e konfidencialitetit në lidhje me çdo informacion që marrin gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre.

KREU VII
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KËRKUESIT PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Neni 54
Të drejtat e kërkuesit

Kërkuesi deri në përfundimin e procedurave për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare ka të drejtë:

a) të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë;
b) të përfitojë kushtet minimale të jetesës;
c) të ketë kujdesin shëndetësor;
ç) të përfitojë shërbimet e kujdesit shoqëror;
d) të përfitojë ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
dh) të ketë arsimim për kërkuesit fëmijë;
e) të ushtrojë lirinë e mendimit dhe të besimit fetar;
ë) për punësim dhe për trajnime profesionale.

Neni 55
E drejta e kërkuesit për qëndrim në Republikën e Shqipërisë

1. Kërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në territorin e Republikës e Shqipërisë që nga momenti i paraqitjes së kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare deri kur vendimi për përcaktimin e statusit ka marrë formë të prerë dhe i është komunikuar kërkuesit.
2. Përjashtim mund të bëhet vetëm kur një person bën një kërkesë të mëvonshme, sipas përkufizimit të bërë në pikën 10 të nenit 3 të këtij ligji, ose kur ai do të ekstradohet, sipas rastit, në një shtet anëtar të BE-së në përputhje me detyrimet sipas urdhërarrestit evropian, ose në një vend të tretë, sipas detyrimeve të përcaktuara nga gjykatat penale ndërkombëtare.

3. Ekstradimi i një kërkuesi në një vend të tretë sipas pikës 2 të këtij neni, lejohet vetëm kur autoritetet përgjegjëse janë të bindura se vendimi i ekstradimit nuk do të rezultojë në kthimin direkt ose indirekt në shkelje të detyrimeve ndërkombëtare.
4. Anëtarët e familjes, të cilët kanë mbërritur në Republikën e Shqipërisë së bashku me kërkuesin, kanë të drejtë të qëndrojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët ndërmerr masat e nevojshme që të ruajë, aq sa është e mundur, unitetin e familjes, siç është brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 56
E drejta për kushtet minimale të jetesës dhe kushte sociale

1. Kërkuesit kanë të drejtë për strehim, ushqim dhe veshmbathje, të ofruara në formë mallrash ose në formën e ndihmës financiare, kuponë ose një kombinim i tyre, si dhe një ndihmë financiare për shpenzimet e përditshme.
2. Kushtet minimale të jetesës dhe kushtet sociale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57
Kujdesi shëndetësor

1. Kërkuesit kanë të drejtën për kujdes shëndetësor, i cili përfshin kujdesin e urgjencës shëndetësore, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve të rënda të shëndetit mendor.
2. Kërkuesve që kanë qenë subjekte të përdhunimit, të ushtrimit të torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues apo formave të tjera të rënda të dhunës, si dhe kërkuesve që i përkasin kategorisë së veçantë u ofrohet trajtim i nevojshëm shëndetësor sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara.

Neni 58
Ndihma juridike e garantuar nga shteti

1. Kërkuesit i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti në lidhje me:
   a) informacionin për të drejtat dhe detyrimet e tyre;

b) hartimin e ankimeve për vendimet që merren gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës;
c) hartimin e akteve dhe përfaqësimin në procedurat administrative para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe para gjykatës për ankimin e vendimeve të marra gjatë shqyrtimit të kërkesës.

2. Ndihma juridike, sipas pikës 1 të këtij neni, i ofrohet kërkuesit i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet përkatëse.
3. Ndihmën juridike, sipas pikës 1 të këtij neni, mund ta japin ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
4. Ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë dhe ministri përcaktojnë me udhëzim të përbashkët modalitetet e nevojshme organizative dhe teknike për zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen.

Neni 59

E drejta për arsim e kërkuesve fëmijë

1. Kërkuesit fëmijë kanë të drejtë për ndjekjen e arsimit parauniversitar me të njëjtat kushte si edhe për fëmijët me shtetësi shqiptare.
2. Ndjekja e arsimit parauniversitar nga kërkuesit fëmijë, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet brenda 3 (tre) muajve nga data kur është paraqitur kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 60

Liria e mendimit dhe e besimit feta

Kërkuesit i garantohet liria e mendimit dhe e besimit fetar sipas bindjeve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 61

E drejta për punësim dhe trajnime profesionale

1. Kërkuesit kanë të drejtë të punësohen jo më vonë se 9 (nëntë) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, nëse autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk ka marrë akoma vendim dhe kjo vonesë nuk mund t'i atribuohet kërkuesit.
2. Republika e Shqipërisë, për arsye të politikave të tregut të punës, mund t'u japë përparësi në tregun e punës shtetasve të saj.

3. Kërkuesit kanë të drejtë për trajnime profesionale, pavarësisht nëse kanë akses në tregun e punës.

Neni 62

Detyrimet e kërkuesit

1. Kërkuesi është i detyruar:
   a) të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, si dhe me udhëzimet e dhëna ose masat e ndërmarra nga autoritetet përgjegjëse sipas këtij ligji;
   b) të bashkëpunojë me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe me autoritetet e tjera shtetërore ligjzbatuese;
   c) t'u përgjigjet ftesave të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe/ose organeve të tjera shtetërore përgjegjëse, si dhe të bashkëpunojë në çdo fazë të procedurës;
   ç) të dorëzojë dokumentet e udhëtimit, dokumentet e identitetit dhe/ose prova të tjera që ka në dispozicion;
   d) të njoftojë autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për çdo ndryshim të adresës së banimit brenda 3 (tri) ditësh;
   dh) të veprojë në përputhje me urdhrat e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe të gjithë urdhrat e autoriteteve të tjera shtetërore përgjegjëse lidhur me kufizimet e lëvizjes;
   e) të mos largohet nga Qendra e Pritjes për Azil ose nga vendi i caktuar nga ministria pa lejen e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët derisa të përfundojë procedura e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare;
   ë) të bashkëpunojë për marrjen e gjurmëve daktiloskopike dhe të fotografisë, për kontrollin fizik dhe të bagazheve, si dhe të sigurojë të dhëna për të ardhurat apo pasuritë që disponon;
   f) t'i nënshtrohet ekzaminimit apo trajtimit mjekësor, me kërkesën e autoritetit përgjegjës në fushën e kujdesit shëndetësor, në rast rreziku të shëndetit publik.
2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të kontrollojë kërkuesin dhe sendet të cilat ai i disponon. Pa paragjykuar kontrollet e kryera për arsye sigurie, kontrollet e kërkuesit në kuadër të këtij ligji kryhen nga persona të së njëjtës gjini, në respektim të plotë të parimeve të dinjitetit njerëzor dhe të integritetit fizik e psikologjik.

3. Nëse gjatë qëndrimit në Qendrën e Pritjes për Azil kërkuesi nuk respekton detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e Qendrës, shfaq sjellje të dhunshme dhe shkakton dëme materiale, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vendosë largimin e kërkuesit nga Qendra dhe e detyron atë për të kompensuar dëmet e shkaktuara. Kundër vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

KREU VIII

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E REFUGJATIT DHE TË PERSONIT ME STATUS TË MBROJTJES PLOTËSUESE

Neni 63
Të drejtat e përfituesve të mbrojtjes ndërkombëtare

1. Personi me status refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese ka të drejtën:
   a) për qëndrim në Republikën e Shqipërisë për aq kohë sa zgjat statusi i refugjatit ose i mbrojtjes plotësuese;
   b) për shërbime të kujdesit shoqëror, në kushte të njëjta me shtetasit shqiptarë;
   c) për kujdes shëndetësor në kushte të njëjta me shtetasit shqiptarë;
   ç) për strehim;
   d) për arsim parauniversitar dhe arsim të lartë në kushte të njëjta me shtetasit shqiptarë;
   dh) për ndihmën për integrim në shoqëri;
   e) e ushtrimit të mendimit e të besimit fetar dhe të lirisë së fesë sipas bindjeve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi;
   ë) për punësim dhe për trajnime profesionale;
   f) e bashkimit familjar sipas përcaktimeve të kreut IX të këtij ligji;
   g) për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të përfituar ndihmën juridike falas, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
   gj) për të poseduar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

2. Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese gëzon të drejtat sipas pikës 1 të këtij neni deri në nivelin e mbrojtjes të cilën e gëzon shtetasi shqiptar.
3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët informon personin me status të refugjatit ose personin me status të mbrojtjes plotësuese brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e njohjes së statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese, në një gjuhë të cilën ai e kupton apo në mënyrë të arsyeshme supozohet se e kupton, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga njohja e statusit përkatës.

Neni 64
E drejta për strehim

1. Personit me status refugjati ose personit me status të mbrojtjes plotësuese i sigurohet strehim për një periudhë deri 2 (dy) vjet, afat i cili fillon nga data e vendimit për njohjen e statusit të refugjatit ose mbrojtjes plotësuese.
2. Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese humbet të drejtën për strehim nëse refuzon strehimin e ofruar sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese, i cili ka mjete të nevojshme për përballimin e shpenzimeve për strehimin, nuk përfiton nga parashikimi i bërë në pikën 1 të këtij neni.

Neni 65
Integrimi në shoqëri

Me qëllim integrimin në shoqërinë shqiptare, personave me status refugjati dhe personave me status të mbrojtjes plotësuese iu mundësohet mësimi i historisë, i gjuhës dhe i kulturës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 66
E drejta për punësim dhe e drejta në trajnime profesionale

1. Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese ka të drejtë për punësim në Republikën e Shqipërisë dhe pajiset me leje pune në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt.
2. Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese ka të drejtë për trajnime profesionale, të praktikës për përvojë pune në të njëjtat kushte si për shtetasit shqiptarë.

3. Autoriteti përgjegjës për pajisjen me leje pune dhe trajtimin e marrëdhënieve të punës merr masat e nevojshme për të siguruar akses të plotë të personit me status refugjati ose personit me status të mbrojtjes plotësuese në tregun e punës.

Neni 67
Ndihma juridike e garantuar nga shteti

1. Personit me status refugjati ose personit me status të mbrojtjes plotësuese i ofrohet ndihma juridike falas e garantuar nga shteti për:
   a) informacionin lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga njohja e statusit të refugjatit ose statusi i mbrojtjes plotësuese;
   b) hartimin e ankimeve dhe përfaqësimin para autoritetit për azilin dhe refugjatët, në rast të ndërprerjes, të shfuqizimit apo të refuzimit të statusit të refugjatit apo të statusit të mbrojtjes plotësuese, si dhe hartimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët;
   c) hartimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën, ofrimin e këshillimit, përfaqësimin dhe mbrojtjen para gjykatës në lidhje me refuzimin e dhënies së mbrojtjes ndërkombëtare.
2. Ndihma juridike sipas pikës 1 të këtij neni i ofrohet personit me status refugjati ose status të mbrojtjes plotësuese, i cili nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet përkatëse.
3. Ndihma juridike sipas pikës 1 të këtij neni ofrohet sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Neni 68
E drejta për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme

Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese ka të drejtën e posedimit të pasurisë së luajtshme dhe/ose të pasurisë së paluajtshme në kushte të njëjta me personat e huaj.

Neni 69
Natyralizimi

Personi me status refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese ka të drejtë për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim, në përputhje me parashikimet e ligjit për shtetësinë shqiptare.

Neni 70
Detyrimet e personave me status refugjati dhe personave me status të mbrojtjes plotësuese

1. Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese është i detyruar:
   a) të respektojë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë;
   b) të njoftojë autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët për ndryshimin e adresës së banimit jo më vonë se 3 (tri) ditë nga ndryshimi i saj.
2. Personi me status refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese nuk mund të krijojë, të bashkohet ose të mbështesë e të veprojë në grupime politike ose organizata të tjera, që cenojnë rendin dhe sigurinë publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe nuk ka të drejtën e votës.

KREU IX
BASHKIMI FAMILJAR I REFUGJATIT DHE PERSONIT ME STATUS TË MBROJTJES PLOTËSUESE

Neni 71
Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për bashkim familjar

1. Kërkesa për bashkim familjar paraqitet pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët nga refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese.
2. Refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese paraqet kërkesën për bashkim familjar pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, duke plotësuar formularin e veçantë të kërkesës, vetëm nëse ka qëndruar në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë që nuk i kalon 2 (dy) vjet, përpara se anëtarët e familjes së tij të bashkohen me të.
3. Në rastin e paraqitjes së kërkesës për bashkim familjar, kërkuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
   a) të sigurojë strehim në kushte normale jetese, sipas standardeve për shëndetin dhe sigurinë;

b) të garantojë sigurimin shëndetësor për vete dhe familjen e tij;
c) të garantojë burime të qëndrueshme të ardhurash financiare për të siguruar veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar skemës së sigurimeve shoqërore apo pa qenë në ngarkim të buxhetit të shtetit.

4. Përjashtimisht, refugjatit nuk i kërkohet të plotësojë kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni kur kërkesa për bashkim familjar dorëzohet brenda një periudhe prej 3 (tre) muajsh pas marrjes së statusit vetëm për anëtarët e mëposhtëm të familjes:
   a) bashkëshortit të refugjatit;
   b) fëmijët e refugjatit dhe të bashkëshortit të tij, duke përfshirë fëmijët e birësuar;
   c) fëmijët, duke përfshirë fëmijët e birësuar të tij, kur refugjati ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur prej tij. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të autorizojë bashkimin e fëmijëve, kujdestaria e të cilëve është e përbashkët, me kusht që pala tjetër që ndan kujdestarinë të ketë dhënë pëlqimin e saj;
   ç) fëmijët, duke përfshirë fëmijët e birësuar të bashkëshortit, kur ai ka kujdestarinë dhe fëmijët janë të varur prej tij. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të autorizojë bashkimin e fëmijëve, kujdestaria e të cilëve është e përbashkët, me kusht që pala tjetër që ndan kujdestarinë të ketë dhënë pëlqimin e saj.
5. Formulari i kërkesës shoqërohet me një kopje të noterizuar të dokumenteve të udhëtimit të anëtarëve të familjes dhe me prova të dokumentuara të lidhjes familjare të kërkuesit me personin ose personat me të cilin/të cilët kërkohet bashkimi familjar. Në formular përfshihen të dhënat biografike të personit me të cilin kërkohet bashkimi familjar dhe të dhëna për lidhjen familjare me kërkuesin. Nëse është e mundur, në mënyrë që të marrë dëshmi se ekziston një marrëdhënie familjare, organi përgjegjës mund të zhvillojë intervista ose hetime të tjera që janë të nevojshme.
6. Nëse refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese nuk mund të paraqesë prova të dokumentuara zyrtarisht të marrëdhënies familjare, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët merr në konsideratë prova të tjera apo indicie, të cilat vlerësohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm, lidhur me ekzistencën e kësaj marrëdhënieje. Vendimi për refuzimin e kërkesës nuk mund të bazohet vetëm në faktin e mungesës së provave të dokumentuara.

7. Shqyrtimi i kërkesës për bashkim familjar fillon brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës dhe në përfundim të procedurës autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët shprehet me vendim të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, për të cilin njofton me shkrim kërkuesin brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së tij. Formulari i kërkesës miratohet me urdhër të ministrit.
8. Në rastin kur kërkesa për bashkimin familjar ka lidhje me një fëmijë të pashoqëruar, vendimi merret brenda 20 (njëzet) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 72
E drejta e bashkimit familjar

1. Anëtarët e familjes së refugjatit ose të personit me statusin e mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtën e bashkimit familjar.
2. Refugjati fëmijë i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me prindërit, motrat, vëllezërit, anëtarë të tjerë të familjes, të cilët bashkëjetojnë me të ligjërisht ose që janë fëmijë dhe të pamartuar. Kur këta persona të familjes, të shkallës së parë, në linjë të drejtë, nuk mund të gjenden, fëmija i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me kujdestarin ligjor ose me ndonjë të afërm tjetër, jo në linjë të drejtë.
3. Në rast të një martese poligame, kur një nga bashkëshortët e refugjatit jeton me të në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të autorizohet hyrja, qëndrimi dhe dhënia e bashkimit familjar të bashkëshortit dhe as të fëmijëve të këtij bashkëshorti, pa paragjykuar dispozitat e konventës "Mbi të drejtat e fëmijës" të vitit 1989.
4. Në rast të një martese poligame, kur bashkëshortët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kërkuesi ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me njërin nga bashkëshortët dhe me fëmijët e këtij bashkëshorti, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.
5. Refugjati ose personi me statusin e mbrojtjes plotësuese ka të drejtë të aplikojë për bashkim familjar vetëm pas dhënies së vendimit përfundimtar për përcaktimin e statusit.

6. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për bashkimin familjar të partnerit, bashkëjetues të kërkuesit, merren si provë e marrëdhënies familjare faktorë, si: fëmijë i përbashkët, banim i përbashkët, regjistrim i partneritetit dhe çdo mjet tjetër prove i besueshëm.
7. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të kryejë intervista me kërkuesin dhe anëtarët e tij të familjes, si dhe regjistron të gjitha të dhënat e përfituara gjatë shqyrtimit të kërkesës.

Neni 73
Refuzimi i kërkesës për bashkim familjar dhe e drejta e ankimit

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët refuzon kërkesën për bashkim familjar nëse vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:
   a) për arsye të cenimit të sigurisë publike, të sigurisë kombëtare dhe shëndetit publik;
   b) kur nuk përmbushen kushtet e përcaktuara nga ky ligj;
   c) kur kërkuesi për bashkim familjar ose anëtarët e familjes së tij në vendin pritës, gjatë qëndrimit në vendin e origjinës nuk kanë jetuar në marrëdhënie martesore ose familjare;
   ç) kur vërtetohet se janë paraqitur të dhëna të pavërteta, dokumente të falsifikuara ose janë përdorur mashtrime;
   d) kur provohet se martesa ose birësimi janë bërë me qëllimin e vetëm për t'i mundësuar personit të interesuar hyrjen dhe qëndrimin në Republikën e Shqipërisë;
   dh) kur konstatohet se kërkuesi ose partneri i pamartuar është i martuar ose është në një marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë me një person tjetër.
2. Gjatë vlerësimit të raportit sipas shkronjës "d" të pikës 1 të këtij neni, mbahet parasysh në veçanti fakti nëse martesa, marrëdhënia ose birësimi janë lidhur pasi kërkuesit i është dhënë leja e qëndrimit.
3. Vendimi i refuzimit të kërkesës për bashkim familjar arsyetohet.
4. Kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për bashkim familjar mund të bëhet ankim pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
5. Kundër vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 74
Të drejtat e anëtarëve të familjes së refugjatit për bashkim familjar

Anëtarët e familjes së refugjatit, që kanë përfituar nga vendimi për bashkim familjar, kanë të njëjtat të drejta sikurse edhe kërkuesi për:

a) arsimim në institucionet arsimore;
b) punësim dhe vetëpunësim;
c) këshillim profesional dhe trajnim.
ç) kujdes shëndetësor;
d) leje qëndrimi.

Neni 75
Hyrja dhe qëndrimi i anëtarëve të familjes

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për çështjet e punëve të jashtme për vendimin për pranimin e kërkesës për bashkim familjar.
2. Personat, që përfitojnë nga vendimi për bashkimin familjar, pajisen me vizë hyrjeje në kufi, në rast se kërkohet një e tillë. Ata pajisen me leje qëndrimi mbi bazën e kërkesës së autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, drejtuar autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin për të huajt.

KREU X
PROCEDURA E ANKIMIT

Neni 76
Ankimimi

1. Kërkuesi, personi me status refugjati, personi nën mbrojtje plotësuese ose personi nën mbrojtje të përkohshme ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.
2. Përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe, për shqyrtimin e ankimit në Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
3. Kundër vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Ankimi në gjykatën administrative, sipas kësaj pike, pezullon ekzekutimin e vendimit të Komisionit.

Neni 77
Afatet për paraqitjen e ankimit

1. Afati për paraqitjen e ankimit në Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët kundër vendimit administrativ të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë që nga dita e njoftimit të vendimit, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj.
2. Për depozitimin e ankimit në Komision zbatohen përcaktimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 78
Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët

1. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është organi administrativ epror që shqyrton ankimet e bëra ndaj vendimeve administrative të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
2. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët ka në përbërje kryetarin dhe 4 (katër) anëtarë, të cilët emërohen në detyrë për një afat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
3. Anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit ose të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të Komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj.
5. Në mbledhjen e tij të parë Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe të funksionimit të tij.

Neni 79
Procedura e shqyrtimit në organin administrativ epror

1. Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët vendos mbi bazën e provave të mbledhura gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe mbi bazën e provave të tjera të paraqitura nga kërkuesi.

2. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioni vendos:
   a) lënien në fuqi të vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët;
   b) shfuqizimin e vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim te kjo strukturë përgjegjëse;
   c) ndryshimin e vendimit të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe gjykimin në themel të çështjes.
3. Si rregull i përgjithshëm, Komisioni vendos për ankimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së ankimit, përveç rasteve të ankesave të paraqitura kundër vendimeve të marra në mbështetje të neneve 35 dhe 36 të këtij ligji.
4. Në rastet kur ankesa është parashtruar kundër vendimeve të marra, në mbështetje të neneve 35 dhe 36 të këtij ligji, afati për të vendosur për ankesën është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së ankimit.

Neni 80
Rivendosja në afat

1. Nëse kërkuesi, për shkaqe të arsyeshme, nuk mund të dorëzojë ankimin brenda afatit ligjor, mund të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit.
2. Për kërkesat për rivendosje në afat zbatohen përcaktimet e bëra në Kodin e Procedurave Administrative.
3. Kërkesa për rivendosje në afat pezullon ekzekutimin e vendimit për largimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë.

KREU XI
MBROJTJA E PËRKOHSHME

Neni 81
Kushtet për dhënien e mbrojtjes së përkohshëm

1. Mbrojtja e përkohshme u jepet shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi, të cilët masivisht hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga një vend, ku për arsye të luftës ose situatës së ngjashme, të dhunës së përgjithshme ose konfliktit të brendshëm, të karakterizuara nga

shkelje të të drejtave të njeriut, kur shteti, nga i cili kanë ardhur, nuk mund të garantojë mbrojtjen e tyre.

2. Mbrojtja e përkohshme jepet kur:
   a) i huaji ka vendqëndrimin e tij të përkohshëm ose të përhershëm në shtetin nga i cili vjen dhe për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ka ardhur në Republikën e Shqipërisë;
   b) i huaji, i cili qëndron në Republikën e Shqipërisë, edhe pse i ka përfunduar afati i qëndrimit, nuk mund të kthehet në shtetin ku ka pasur vendqëndrimin apo vendbanimin për shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. I huaji, i cili gëzon mbrojtje të përkohshme, mund të paraqesë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në çdo kohë. Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare fillon vetëm pas përfundimit të afatit të mbrojtjes së përkohshme.

Neni 82

Dhënia e mbrojtjes së përkohshme

1. Mbrojtja e përkohshme jepet me vendim të Këshillit të Ministrave për një afat 1-vjeçar kur ekzistojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 81 të këtij ligji.
2. Vendimi për dhënien e mbrojtjes së përkohshme përcakton grupet e personave për të cilët zbatohet dhënia e mbrojtjes së përkohshme, datën për të cilën mbrojtja do të ketë efekt, si dhe vlerësimin lidhur me shkallën e lëvizjes së personave të shpërngulur.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për dhënien e mbrojtjes së përkohshme merret duke pasur parasysh kapacitetet ekonomike, sigurinë kombëtare, mbrojtjen e rendit dhe të qetësisë publike, si dhe informacionet përkatëse të dhëna nga UNHCR-ja dhe organizatat tjera në ndihmë të refugjatëve.
4. Mbrojtja e përkohshme mund të zgjatet edhe për 6 (gjashtë) muaj, por jo më shumë se 3 (tre) vjet, nëse vazhdojnë kushtet në vendin nga kanë ardhur personat e mbrojtur, të cilat përbënin bazën e vendimit për dhënien e mbrojtjes.
5. Para afatit të përfundimit të mbrojtjes së përkohshme, Këshilli i Ministrave rivlerëson ekzistencën e kushteve dhe të rrethanave, në bazë të të cilave është dhënë mbrojtja e përkohshme dhe, në varësi

të rivlerësimit, vendos zgjatjen e afatit ose pushimin e mbrojtjes së përkohshme.

6. Ministria i jep personit, i cili gëzon mbrojtjen e përkohshme, informacion në gjuhën të cilën ai e kupton për të drejtat edhe detyrimet e tij gjatë kohëzgjatjes së mbrojtjes.

Neni 83

Përjashtimi nga mbrojtja e përkohshme

1. E drejta për mbrojtje të përkohshme nuk i njihet personit për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se:
   a) ka kryer krim kundër paqes, krim lufte ose krim kundër njerëzimit, të përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për krime të tilla;
   b) ka kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Republikës së Shqipërisë para pranimit të tij si person që gëzon mbrojtje të përkohshme. Ky përcaktim zbatohet edhe për pjesëmarrësit në krim dhe/ose për nxitësit e tij;
   c) është shpallur fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara;
   ç) paraqet rrezik për sigurinë kombëtare dhe rendin publik të Republikës së Shqipërisë.

Neni 84

Përfundimi i mbrojtjes së përkohshme

Mbrojtja e përkohshme përfundon:

   a) me mbarimin e afatit të caktuar nga Këshilli i Ministrave;
   b) kur arsyet për mbrojtje të përkohshme nuk ekzistojnë më;
   c) kur i huaji largohet nga Republika e Shqipërisë;
   ç) kur të huajit i është dhënë një lloj tjetër mbrojtjeje, sipas një ligji të caktuar ose një marrëveshjeje ndërkombëtare;
   d) nëse i huaji i nënshtrohet masës së dëbimit.

Neni 85

Kthimi

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin merr masat e nevojshme, sipas ligjit për të huajt, për të bërë të mundur kthimin vullnetar të personave në mbrojtje të përkohshme ose të atyre që

u ka përfunduar afati i mbrojtjes së përkohshme, si dhe siguron që aktet që rregullojnë kthimin vullnetar të personave në mbrojtje të përkohshme të lehtësojnë kthimin e tyre duke respektuar dinjitetin njerëzor.

2. Në rastet e kthimit me forcë, mbahen në konsideratë edhe arsyet bindëse humanitare, të cilat në raste të veçanta mund ta bëjnë të pamundur kthimin ose të paarsyeshëm për t'u kryer.
3. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin merr masat e nevojshme, në mënyrë që kthimi me forcë i personave, të cilëve u ka përfunduar afati i mbrojtjes së përkohshme, të jetë në përputhje me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe se vendimi për kthimin e tyre është marrë në bazë të njohurive faktike.
4. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin merr masat e nevojshme për sigurimin e kushteve të qëndrimit të personave, të cilët kanë gëzuar mbrojtje të përkohshme dhe që nuk mund të udhëtojnë, duke pasur parasysh gjendjen e tyre shëndetësore. Këtu përfshihet edhe kategoria e personave të cilët vuajnë nga pasoja të rënda negative, nëse trajtimi i tyre ndërpritet, të cilët nuk mund të dëbohen për aq kohë sa vazhdon kjo situatë.
5. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin vlerëson në mënyrë sa më të favorshme kërkesat nga personat, të cilët kanë gëzuar mbrojtje të përkohshme dhe kërkojnë të kthehen në mënyrë vullnetare në shtetin pritës, në bazë të rrethanave që mbizotërojnë në vendin e origjinës, për aq kohë sa mbrojtja e përkohshme nuk ka përfunduar.

Neni 86

Të drejtat dhe detyrimet e personave nën mbrojtjen e përkohshme

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë:
   a) të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë sipas kohëzgjatjes së mbrojtjes së përkohshme;
   b) të kenë kushtet themelore të jetesës dhe të strehimit, në përputhje me mundësitë ekonomike të Republikës së Shqipërisë;
   c) të përfitojnë kujdes shëndetësor;
   ç) për arsim parauniversitar në të njëjtat kushte me shtetasit shqiptarë;

   d) për ushtrimin e mendimit, besimit fetar dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi;
   dh) për punë dhe trajnime profesionale;
   e) për ndihmë juridike të garantuar nga shteti.
2. Përjashtimisht, një i huaj nën mbrojtje të përkohshme gëzon të drejtën për të kërkuar bashkim familjar vetëm nëse kjo e drejtë nuk mund të realizohet në asnjë vend tjetër, përveçse në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Personat, të cilëve iu është dhënë mbrojtja e përkohshme, janë të detyruar të zbatojnë përcaktimet e bëra në nenin 70 të këtij ligji.

Neni 87

E drejta për kujdes shëndetësor

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtën për kujdes shëndetësor, i cili përfshin kujdesin e urgjencës shëndetësore, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjeve e të çrregullimeve të rënda mendore.
2. Personave nën mbrojtje të përkohshme, të cilët kanë qenë subjekte të përdhunimit, ushtrimit të torturës, trajtimit çnjerëzor apo degradues ose formave të tjera të rënda të dhunës, si dhe personave që i përkasin kategorisë të veçantë u ofrohet trajtim i nevojshëm shëndetësor, sipas nevojave specifike dhe pasojave të shkaktuara.

Neni 88

E drejta për kushte themelore të jetesës

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë për kushte themelore të jetesës, ku përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në: strehimin, ushqimin, veshmbathjet dhe sende të tjera të nevojshme. Personave nën mbrojtje të përkohshme me nevoja të veçanta iu sigurohen standardet e jetesës në përputhje me nevojat e tyre specifike.
2. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë shoqërore në përputhje me parashikimet e ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe të ligjit për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë.

3. Në përcaktimin e nivelit të ndihmës për të përmbushur nevojat e personave nën mbrojtje të përkohshme merret parasysh fakti nëse ata janë të punësuar ose të vetëpunësuar.

Neni 89

E drejta për punësim dhe trajnime profesionale

1. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë për punësim në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin për të huajt.
2. Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë për trajnime profesionale, praktikë për përvojë pune në të njëjtat kushte me shtetasit shqiptarë.

KREU XII
DOKUMENTET

Neni 90

Pajisja me dokumente

1. Ministria e pajis kërkuesin me dokumentet e mëposhtme:
   a) vërtetimin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare;
   b) leje të përkohshme qëndrimi, të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për të huajt, sipas procedurave të parashikuara nga ligji për të huajt, e cila shërben edhe si dokument identifikimi;
   c) dokument udhëtimi, kur ka arsye serioze humanitare që kërkojnë praninë e tij në një shtet tjetër, me përjashtim të shtetit të origjinës.
2. Vërtetimi sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni lëshohet nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët brenda 3 (tri) ditëve nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. Ky dokument nuk vërteton identitetin e kërkuesit. Formati i vërtetimit të dorëzimit të kërkesës miratohet me urdhër të ministrit.
3. Personi me status refugjati pajiset me dokumentet e mëposhtme:
   a) leje qëndrimi sipas ligjit për të huajt;
   b) letërnjoftim elektronik;
   c) dokument udhëtimi.
4. Personi nën mbrojtje plotësuese pajiset me dokumentet e mëposhtme:

   a) leje qëndrimi sipas ligjit për të huajt;
   b) letërnjoftim elektronik;
   c) dokument udhëtimi.
5. Personi nën mbrojtje të përkohshme pajiset me leje qëndrimi sipas ligjit për të huajt.
6. Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese, me kërkesën e tij pajiset me vizë nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme sipas ligjit për të huajt.
7. Republika e Shqipërisë, nëse është e nevojshme, personave që pranohen në territorin e saj për qëllim të mbrojtjes së përkohshme, u ofron të gjitha lehtësirat për marrjen e vizave të nevojshme, duke përfshirë edhe vizat tranzit.

Neni 91

Dokumenti i udhëtimit dhe letërnjoftimi elektronik

1. Refugjatit ose personit nën mbrojtje plotësuese, me kërkesën e tij, i lëshohet letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi.
2. Për fëmijën refugjat ose nën mbrojtje plotësuese, kërkesa për pajisje me dokument udhëtimi paraqitet nga të paktën njëri prej prindërve dhe në prani të tij, të kujdestarit ose të përfaqësuesit ligjor me prokurë të posaçme.
3. Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese nën 16 vjeç pajiset vetëm me dokument udhëtimi, me vlefshmëri 5 (pesë) vjet.
4. Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese mbi 16 vjeç pajiset me letërnjoftim elektronik dhe me dokument udhëtimi, me vlefshmëri 10 (dhjetë) vjet për secilin dokument.
5. Kriteret dhe procedura për pajisjen me letërnjoftim elektronik dhe dokument udhëtimi për këtë kategori personash përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

Neni 92

Regjistrimi

Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të ministrit.

Neni 93
Kthimi i dokumenteve

1. Dokumentet e mbajtura sipas nenit 62 të këtij ligji, i kthehen të huajit pas përfundimit të procedurave të përcaktimit të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.
2. Kthimi i dokumenteve të përcaktuara në nenin 90 të këtij ligji, bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt.

KREU XIII
TRAJTIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 94
Trajtimi i të dhënave personale

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, për qëllime të zbatimit të këtij ligji, mbledh dhe përpunon të dhënat personale të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, të refugjatëve, të personave me statusin e mbrojtjes plotësuese apo mbrojtje të përkohshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe të shërbimeve inteligjente për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave.
3. Rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatin miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 95
Komunikimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale të kërkuesve mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk mund t'u japë asnjë informacion aktorëve të pohuar të persekutimit ose cenimit të rëndë ndaj kërkuesit për kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare ose për faktin që një kërkesë e tillë është paraqitur, si dhe çdo informacion tjetër që do të rrezikonte integritetin fizik të kërkuesit, anëtarëve të familjes së tij ose lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët ende jetojnë në shtetin e origjinës.

3. Me qëllim ekzekutimin e vendimit të kthimit në vendin e origjinës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund t'u komunikojë autoriteteve të huaja të dhënat e mëposhtme:
   a) të dhënat personale (emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, shtetësinë, adresën e fundit të njohur në vendin e origjinës apo të tranzitit) të personit në fjalë dhe, nëse është e nevojshme, të dhënat personale të të afërmve të tij;
   b) të dhënat lidhur me pasaportën ose një dokument tjetër identiteti;
   c) gjurmët daktiloskopike, fotografitë dhe të dhënat biometrike;
   ç) të dhënat për dokumente të tjera që mundësojnë identifikimin e personit;
   d) të dhënat për gjendjen shëndetësore të personit, me kusht që kjo të jetë në përputhje me interesin e tij;
   dh) çdo të dhënë tjetër të domosdoshme për të garantuar hyrjen e personit në shtetin e destinuar dhe për të ruajtur sigurinë e personave që e shoqërojnë;
   e) të dhënat për procedurat penale të filluara për të, për aq sa kjo është e rëndësishme për procedurën e kthimit të personit në fjalë, për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në vendin e origjinës ose të tranzitit dhe për aq sa personi në fjalë nuk rrezikohet.

Neni 96
Gjurmët daktiloskopike dhe fotografitë

1. Për çdo kërkues, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët verifikon gjurmët daktiloskopike dhe fotografinë e secilit prej tyre. Përjashtim nga ky rregull bëjnë fëmijët nën moshën 12 vjeç.
2. Gjurmët daktiloskopike dhe fotografia regjistrohen nga Policia e Shtetit në bazën e të dhënave për të huajt.
3. Nëse Policia e Shtetit konstaton se gjurmët e reja daktiloskopike janë të njëjta me ato të regjistruara paraprakisht, ajo informon autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët, duke regjistruar të dhënat personale të personit (emrin, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, numrin e referencës, numrin personal, shtetësinë dhe vendin në të cilin ndodhet). Nëse bëhet fjalë për të dhënat e mbledhura nga vetë Policia e Shtetit, ajo informon autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët duke treguar datën, vendin dhe arsyen e marrjes së gjurmëve daktiloskopike.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i përdor këto të dhëna me qëllim që:
   a) të verifikojë identitetin e personit në fjalë;
   b) të verifikojë nëse personi ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare;
   c) të verifikojë nëse ka të dhëna që konfirmojnë apo kundërshtojnë deklaratat e personit;
   ç) të verifikojë nëse ekzistojnë të dhëna që vënë në dyshim mundësinë e personit për të fituar statusin e refugjatit apo të mbrojtjes plotësuese;
   d) të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, Policisë së Shtetit dhe institucioneve ligjzbatuese, të cilat ushtrojnë kompetencat në këtë fushë.
5. Ndalohet transferimi jashtë vendit i të dhënave personale të mbledhura për kërkuesin, pa konfirmimin me shkrim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
6. Të dhënat personale të mbledhura për qëllime të këtij ligji asgjësohen ose shkatërrohen pas përmbushjes së qëllimit të grumbullimit, sipas parimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 97
Mbajtja e regjistrit elektronik

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët administron dhe mirëmban regjistrin elektronik të kërkuesve dhe personave në mbrojtje ndërkombëtare, të cilët paraqiten dhe trajtohen në përputhje me këtë ligj, vendimet e marra nga autoritetet përgjegjëse dhe çdo të dhënë tjetër e nevojshme që përcaktohet nga ministri.
2. Përmbajtja dhe mënyra e administrimit të këtij regjistri përcaktohet me urdhër të ministrit.

KREU XIV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 98
Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, si dhe institucionet e tjera që në bazë të këtij ligji ose të ligjeve përkatëse të organizimit dhe funksionimit të tyre kanë detyrime në ofrimin e shërbimeve, ndihmesës, marrjes së masave dhe asistencës së nevojshme ndaj personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe kanë përfituar një mbrojtje të tillë.
2. Në ushtrimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, ministria dhe autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që ushtrojnë aktivitet në fushën e të drejtave të njeriut dhe posaçërisht për të drejtat e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 99
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 1 të nenit 10, pikës 5 të nenit 34, të pikës 2 të nenit 44, të pikës 2 të nenit 56 dhe të pikës 3 të nenit 78 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri që brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 4 të nenit 8, të pikës 8 të nenit 26, të pikës 6 të nenit 32, të pikës 7 të nenit 71, të pikës 2 të nenit 90, të pikës 5 të nenit 91, të nenit 92, të pikës 3 të nenit 94, të pikës 2 të nenit 97 të këtij ligji.
3. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë dhe ministri që brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 58 të këtij ligji.

Neni 100
Dispozitë kalimtare

1. Kërkesat e depozituara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji trajtohen në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë."

2. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në tekstin e tyre.

Neni 101
Shfuqizime
Ligji nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", dhe çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 102
Hyrja në fuqi
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 1.2.2021.

Shpallur me dekretin nr. 11972, datë 19.2.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

VENDIM

Nr. 450, datë 29.06.2022

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT[37]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejeve të qëndrimit për të huajt, sipas anekseve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një format standard i aprovimit për qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohet formati i parashikuar në marrëveshjen qeveritare.
3. Vendimi nr. 441, datë 15.6.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt", shfuqizohet.
4. Në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pika 1, e këtij vendimi, dhe anekset 1 e 2, bashkëlidhur vendimit si pjesë përbërëse të tij, shfuqizohen.
5. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

37 Ky vendim është përafruar pjesërisht me:
- rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1030/2002, e datës 13 qershor 2002, e ndryshuar, që përcakton një format uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Numri CELEX 32002R1030, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 15.6.2002, faqe 1–7;
- rregulloren e Këshillit (KE) nr. 380/2008, e datës 18 prill 2008, që ndryshon rregulloren (KE) nr. 1030/2002, që përcakton një format uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Numri CELEX 32008R0380, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 115, datë 29.4.2008, faqe 1–7;
- rregulloren (BE) 2017/1954, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 25 tetor 2017, që ndryshon rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1030/2002, që përcakton një format uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Numri CELEX 32017R1954, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 286, datë 1.11.2017, faqe 9–14.

ANEKS 1

ELEMENTET E SIGURISË SË LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

I. PËRSHKRIMI I KARTËS

Lejet e qëndrimit për të huajt, duke përfshirë të dhënat biometrike të mbajtësit, prodhohen si një kartë "*smart*" hibride, me dy *chip*-e të ndryshme: me kontakt dhe pa kontakt.

Përmbajtja elektronike e *chip*-eve përfshin këto aplikime:

- *chip*-i me kontakt *(contact chip*);
- aplikimi Java;
- aplikimi ID;
- aplikimi PKI;
- aplikimi Krahasim në Kartë;
- *chip*-i pa kontakt (*contactless chip)*;
- aplikimi ICAO.

II. ELEMENTET E SIGURISË SË KARTËS

1. Materiali

Materiali i Kartës, në përputhje me standardet ICAO 9303 dhe me specifikimet teknike të ISO 7810, plotëson minimalisht këto kërkesa:

- *polycarbonate*;
- jetëgjatësi *max*. 10 vjet;
- trupi i kartës të jetë UV Dull.

2. Teknika të printimit

Gjatë procesit të printimit aplikohen këto teknika:

- OVI *Printing*;
- *Microtext*;
- *Kinegram*;
- *Line Structures*;
- *Guilloches*.

Të gjitha elementet e sigurisë, që përdoren në printimin e kartës në zona të caktuara, kanë një pamje uniforme.

3. Mbrojtja kundër kopjimit

Një element OVD (*kinegrame*) aplikohet në faqen e parme të kartës, duke u trupëzuar në strukturën e saj, duke na dhënë kështu një nivel të lartë sigurie kundër kopjimit.

4. Teknika e personalizimit

Për t'u siguruar që të dhënat e personalizuara në kartën e lejes së qëndrimit janë të sigurta kundër orvatjeve për ta falsifikuar, të dhënat biografike, përfshirë dhe fotografinë e mbajtësit, si dhe të dhënat e tjera të lejeve të qëndrimit, integrohen më tej në materialin bazë të kartës, nëpërmjet procesit të personalizimit (lëshimit). Teknika që përdoret për këtë qëllim është "*laser engraving"*.

ANEKS 2

FORMA DHE MODELI I LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

I. TRUPI I LEJEVE TË QËNDRIMIT

Leja e qëndrimit në formatin D1 përbëhet nga shtresa të ndryshme prej materiali *policarbonat*. Procesi i laminimit e bën trupin e kartës njësh e të pandashëm.

Dimensionet e lejes së qëndrimit janë në përputhje me specifikimet teknike të standardit ISO 7810, me dimensione, si vijon:

- Gjerësi:
  min. 85.47 mm;
  max. 85.72 mm;
- Lartësi:
  min. 53.93 mm;
  max. 54.04 mm;
- Të katër qoshet të harkuara me rreze:
  r = 2.88;
  r =3.48 mm (ISO 7813).

II. PËRMBAJTJA E LEJEVE TË QËNDRIMIT

Trupi i lejeve të qëndrimit është i përbërë nga material *policarbonat* dhe pamja e dy faqeve është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Të gjitha të dhënat si: portreti (1), nënshkrimi (2), imazhi *ghost* (3) dhe të dhënat alfanumerike (4) printohen me teknologji "*laser engraving"*.

Informacioni (6) - Titulli i dokumentit në shqip dhe në anglisht:

LEJE QËNDRIMI

RESIDENCE PERMIT

Informacioni (7) - Kodi në 1–3 shkronja, që përfaqëson tipin e lejes së qëndrimit sipas motivit:

A, B, C, UNB, CBB, CBC.

Informacioni (8) – Numri personal për shtetasit e huaj (FID).

Në faqen e prapme të lejes së qëndrimit printohet shiriti MRZ (në format 3 rreshta) sipas standardeve ICAO (5).

Fig. 1: Faqja e përparme




Fig. 2: Faqja e prapme



VENDIM

Nr. 159, datë 17.2023

PËR MIRATIMIN E FORMËS E TË PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT PËR TË HUAJT PA SHTETËSI, TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT, LEJES SË KALIMIT, TË DOKUMENTIT TË PËRKOHSHËM, DUBLIKATËS SË LEJES SË QËNDRIMIT E TË LEJES UNIKE, SI DHE TË LETËRNJOFTIMIT PËR TË HUAJT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 7, 13, pika 3, 15, pika 2, 38, pika 2, e 96, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për të huajt pa shtetësi sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për shtetasit e huaj sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Miratimin e formës e të përmbajtjes së lejes së kalimit për të huajt sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dokumentit të përkohshëm pas humbjes ose dëmtimit të dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit, lejes së qëndrimit dhe letërnjoftimit për të huajt, lëshuar nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Miratimin e formës e të përmbajtjes së dublikatës së lejes së qëndrimit dhe lejes unike për të huajt, sipas aneksit nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
6. Miratimin e formës e të përmbajtjes së letërnjoftimit për të huajt sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Vendimi nr. 442, datë 15.6.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për

miratimin e formës dhe të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për personat pa shtetësi dhe lejes së kalimit për të huajt", shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI Nr. 1

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

"PASAPORTË PËR TË HUAJT PA SHTETËSI"

- Dokumenti i udhëtimit "pasaportë për të huajt pa shtetësi" është me përmasa 125x88 mm, me qoshe të rrumbullakëta dhe ka 50 faqe (përjashto kapakët).
- Kapaku i dokumentit të udhëtimit për të huaj pa shtetësi është në ngjyrën blu.
- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e sipërme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe anglisht "REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA".
- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e mesit vendoset emblema e Republikës së Shqipërisë.
- Në faqen ballore të kapakut, në pjesën e poshtme dhe në faqen e parë të fletës së personalizuar shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: "DOKUMENT UDHËTIMI PËR TË HUAJT PA SHTETËSI (Konventa 28 shtator 1954) / TRAVEL DOCUMENT (*Convention of 28 September*, 1954)".
- Në faqen e përparme të të dhënave shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: "REBUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA"; në mes të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: "DOKUMENT UDHËTIMI (Konventa e shtator 1954) / TRAVEL DOCUMENT (*28 September 1954 Convention*)"; në pjesën e poshtme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: "KY DOKUMENT PËRMBAN 50 FAQE/ THIS DOCUMENT CONTAINS 50 PAGES.

- Në faqen e të dhënave mbi fotografinë e aplikuesit shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe sfond blu, në gjuhën shqipe dhe angleze: "DOKUMENT UDHËTIMI/TRAVEL DOCUMENT".
- Në faqen e të dhënave tipi i dokumentit do të jetë 'PT'. Autoriteti lëshues është MB (Ministria e Brendshme) dhe fillimi i zonës së lexueshme nga makina (MRZ) fillon me 'PT' në vend të 'P' që vendoset në pasaportat normale shqiptare.
- Kodi 3-shifror zëvendësohet me kodin kombëtar të transmetuar nga RKGJC-ja për të huajt pa shtetësi.

Shënim.

- Specifikimet teknike dhe elementet e sigurisë së dokumentit të udhëtimit për të huajt janë të njëjta me ato të dokumentit për refugjatët dhe shtetasit shqiptarë.

ANEKSI Nr. 2

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

"PASAPORTË PËR SHTETASIT E HUAJT"

- Dokumenti i udhëtimit "pasaportë për të huajt" është me përmasa 125x88 mm, me qoshe të rrumbullakëta dhe ka 50 faqe (përjashto kapakët).
- Kapaku i dokumentit të udhëtimit për të huaj është në ngjyrën blu.
- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e sipërme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe anglisht "REPUBLIKA E SHQIPËRISË / *REPUBLIC OF ALBANIA*".
- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e mesit vendoset emblema e Republikës së Shqipërisë.
- Në faqen ballore të kapakut, në pjesën e poshtme dhe në faqen e pare të fletës së personalizuar shkruhet në gjuhen shqipe dhe angleze: "DOKUMENT UDHËTIMI PËR TË HUAJT / *TRAVEL DOCUMENT FOR FOREIGNERS*.
- Në faqen e përparme të të dhënave shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: "REBUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA"; në mes të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: "DOKUMENT UDHËTIMI PËR TË HUAJT/ *TRAVEL DOCUMENT FOR FOREIGNERS* në pjesën e poshtme të saj shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze:

"KY DOKUMENT PËRMBAN 50 FAQE/ *THIS DOCUMENT CONTAINS 50 PAGES*.


- Në faqen e të dhënave mbi fotografinë e aplikuesit shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe sfond blu, në gjuhën shqipe dhe angleze: "DOKUMENT UDHËTIMI/*TRAVEL DOCUMENT*".
- Në faqen e të dhënave tipi i dokumentit do të jetë 'PT'. Autoriteti lëshues është MB (Ministria e Brendshme) dhe fillimi i zonës së lexueshme nga makina (MRZ) fillon me 'PT' në vend të 'P' që vendoset në pasaportat normale shqiptare.
- Kodi 3-shifror zëvendësohet me kodin kombëtar të transmetuar nga RKGJC-ja për të huajt.

ANEKSI Nr. 3

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

"LEJE KALIMI PËR TË HUAJT"

- Leja e kalimit për të huaj është letër në përmasat 210X297 (format A4)
- Pesha specifike e letrës që përdoret për leje kalimi është 100-120 gr/m^2
- Dokumenti "Leje kalimi për të huajt" përmban këto elemente sigurie:
- Shtyp me bojë të padukshme (të dukshme vetëm nën veprimin e dritës UV);
- Numri i serisë 7-shifror me bojë fluoreshente.
- Leja e kalimit për të huajt ka përmbajtjen si formati në vijim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

LEJE KALIMI PËR TË HUAJT
VETËM PËR NJË UDHËTIM

LAISSEZ PASSER FOR FOREIGNERS
FOR A SINGLE JOURNEY ONLY

No. XXXXXXX

Autoriteti lëshues
Issuing authority

Fotografia
Photograph

Mbiemri
Family name

Emri(at)
Given Names

Shtetësia e Mbajtësit
Citizenship of bearer

Datëlindja
Date of Birth

Gjinia
Sex

Vendlindja
Place of Birth

Nënshkrimi i mbajtësit / Signature of bearer

Ky dokumenti është i vlefshëm vetëm për një udhëtim nga:
në:
This document is valid for a single journey only as from: (Shtetit /State) to (Shtetit /State)

Rezervuar për VIZE / Reserved for VISA

Lëshuar në_____, (Vendi), më _____(Data)
Issued at_____, (Place), on____ (Date)

E vlefshme deri më____ (Data)
Valid until _____(Date)

Nënshkrimi i Nëpunësit Lëshues
Signature of issuing Officer

SHËNIME / OBSERVATIONS

Ky dokument është pronë e Shtetit Shqiptar
Autoritetet aeroportuale të vendeve transite janë të lutur të asistojnë personin e interesuar gjatë procedurave të kalimit transitit, nëse është e nevojshme.

This document is property of Albanian State
The transit airport authorities are pleased to assist , if necessary, the interested person during the transit procedures.

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË PËRKOHSHËM PËR TË HUAJT

- Dokumenti i përkohshëm për të huajt është letër në përmasat 210x297 (format A4);
- Dokumenti i përkohshëm për të huajt ka përmbajtjen si në vijim:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PER KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

DOKUMENT I PËRKOHSHËM
Temporary document

PËR ZËVENDËSIMIN E: **Dokumentit të udhëtimit për të huajt** ☐
For the replacement of *Travel document for foreigners*
Lejes së kalimit për të huajt ☐
Laissez passer for foreigners
Letërnjoftimit për të huajt ☐
Identification card for foreigners
Lejes së qëndrimit për të huajt ☐
Residence permit for foreigners

TE DHENAT E PERSONIT:
Personal data

Foto
Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____
First name (s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA **dd.mm.yyyy**
Place of birth *Date of birth*

NUMRI IDENTITETIT PER TE HUAJT (FID) _____
Foreigner Identity Number FID

SHTETËSIA _____ GJINIA _____ GJENJA CIVILE _____
Nationality *Sex* *Civil Status*

TË DHËNAT E DOKUMENTIT TË HUMBUR/DËMTUAR:
Nr. Dokumentit_____, Data e lëshimit_____, Data e skadimit_____
No. of Document_____, Date of issue_____, Expire date_____

Autoriteti lëshues _____
Issuing authority _____

Ky dokument është i vlefshëm nga data _____ deri më datë _____
This document is valid from date _____ *until date* _____

DREJTORI
DIRECTOR
Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
Signature, Stamp of Authority

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT DUBLIKATË LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT DHE DUBLIKATË LEJE UNIKE PËR TË HUAJT

- Dokumenti dublikatë leje qëndrimi / leje unike për të huajt është letër në përmasat 210x297 (format A4);
- Dokumenti i përkohshëm për shtetasit të huajt ka përmbajtjen si në vijim:

Nr. _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PER KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

DUBLIKATE LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT
DUBLICATE RESIDENCE PERMIT OF FOREIGNERS

TIPI _____
Type

Foto
Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____
First name (s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA **dd.mm.yyyy**
Place of birth *Date of birth*


NUMRI IDENTITETIT PER TE HUAJT (FID) _____
Foreigner Identity Number FID

SHTETËSIA _____ GJINIA ___ GJENJA CIVILE
Nationality *Sex* *Civil Status*
MOTIVI I QËNDRIMIT _____
Purpose of Stay

ADRESA NË SHQIPËRI _____
Address in Albania

Kjo dublikatë leje qëndrimi është e vlefshme nga data **dd.mm.yyyy**, deri më datë **dd.mm.yyyy**
This Dublicate of Residence Permit is valid from **dd.mm.yyyy**,
until **dd.mm.yyyy**

DREJTORI
DIRECTOR
Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
Signature, Stamp of Authority



Nr. _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PER KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

DUBLIKATË LEJE UNIKE PËR TË HUAJT
DUBLICATE SINGLE PERMIT OF FOREIGNERS

TIPI _____
Type

Foto
Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____
First name (s), Family name

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA **dd.mm.yyyy**
Place of birth *Date of birth*

NUMRI IDENTITETIT PER TE HUAJT (FID) _____
Foreigner Identity Number FID

SHTETËSIA _____ GJINIA ___ GJENJA CIVILE
Nationality *Sex* *Civil Status*

MOTIVI I QËNDRIMIT _____
Purpose of Stay

ADRESA NË SHQIPËRI _____
Address in Albania

Kjo dublikatë leje unike është e vlefshme nga data **dd.mm.yyyy** deri më datë **dd.mm.yyyy**
This Dublicate of Single Permit is valid from **dd.mm.yyyy** *until* **dd.mm.yyyy**

DREJTORI
DIRECTOR
.....
Nënshkrimi, Vula e Autoritetit
Signature, Stamp of Authority

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT

I. TRUPI I LETËRNJOFTIMIT PËR TË HUAJT

Letërnjoftimi për të huajt në formatin D1 përbëhet nga shtresa të ndryshme prej materiali *policarbonat*. Procesi i laminimit e bën trupin e kartës njësh e të pandashëm.

Dimensionet e letërnjoftimit për të huajt janë në përputhje me specifikimet teknike të standardit ISO 7810, me dimensione, si vijon:

- Gjerësi:
  min. 85.47 mm;
  max. 85.72 mm;
- Lartësi:
  min. 53.93 mm;
  max. 54.04 mm;
- Të katër qoshet të harkuara me rreze:
  r = 2.88;
  r =3.48 mm (ISO 7813).

II. PËRMBAJTJA E LETËRNJOFTIMIT PËR TË HUAJT

Trupi i letërnjoftimit për të huajt është i përbërë nga material *policarbonat* dhe pamja e dy faqeve është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Të gjitha të dhënat printohen me teknologji "*laser engraving*".

Informacioni - Titulli i dokumentit në shqip dhe në anglisht:

LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT

Fig. 1: Faqja e përparme

LETËRNJOFTIM PËR TË HUAJT	
REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA	
The identity document for foreigners	
	Mbiemri/ surname
Foto	Emri / given name
	Vendlindja / place of birth
	Ditëlindja / date of birth
	Gjinia
	Data e lëshimit
	Data e skadimit
	Autoriteti lëshues
	Nr. personal
	Nr. i letërnjoftimit
	Firma / signature

Fig. 2: Faqja e prapme

Motivi i qëndrimit / Purpose of Stay
Adresa / address

UDHËZIM

Nr. 245, datë 3.6.2021

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN E INFORMACIONIT DHE VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE E TË DEKLARIMEVE NGA VENDI I ORIGJINËS PËR AZILKËRKUESIN DHE REFUGJATIN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 94, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me qëllim të zhvillimit të intervistave dhe marrjen e një vendimi përfundimtar, mbledh dhe përpunon të dhënat personale të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare.
2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, bën verifikimin e të dhënave që mblidhen gjatë aplikimit dhe intervistimit për mbrojtje ndërkombëtare, në institucionet shtetërore, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me gjendjen e përgjithshme që mbizotëron në vendin e origjinës së kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare dhe kur është e nevojshme, edhe në vendet përmes të cilave ka qenë tranzit.
3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkon informacion pranë Drejtorisë për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të kërkuesit dhe/ose përfituesit të mbrojtjes ndërkombëtare. Drejtoria për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkon informacion, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin në

Drejtorinë e Policisë së Shtetit, brenda fushës së kompetencës së kësaj drejtorie, me qëllim verifikimin e deklarimeve të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, për vendet përmes të cilave ka qenë tranzit. Kjo drejtori, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 10 ditëve pune, nga marrja e kërkesës.

5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkon informacion pranë Shërbimit Informativ të Shtetit, me qëllim mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave dhe deklarimeve të kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatit dhe personit nën mbrojtje plotësuese. Shërbimit Informativ i Shtetit, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune, për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
6. Bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit mund të kryhet edhe me autoritetet homologe të cilat shprehin dakordësinë për çështje specifike ose të përgjithshme.
7. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk mund t'u japë asnjë informacion aktorëve të mundshëm të persekutimit apo cenimit të rëndë ndaj kërkuesit, në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare, apo për faktin që një kërkesë e tillë është paraqitur, si dhe çdo informacion tjetër që do të rrezikonte integritetin fizik të kërkuesit, anëtarëve të familjes së tij ose lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët ende jetojnë në shtetin e origjinës.
8. Në përjashtim nga përcaktimi i bërë në pikën 7 mund të konsiderohet kërkim apo ndarje informacioni për personat në kërkim të mbrojtjes ndërkombëtare apo të përkohshme, me vendin ku kërkuesi ka aplikuar ose ka kaluar tranzit para se të hynte në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim sigurimin e informacionit për të verifikuar dhe saktësuar, se:
   a) kërkuesi ka vënë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse të dhëna të vërteta;
   b) kërkuesit i rrezikohet seriozisht jeta në vendin e origjinës;
   c) kërkuesi nuk përbën rrezik për rendin publik dhe sigurinë kombëtare.
9. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të shkëmbejë me autoritetet ligjzbatuese të huaja të dhënat e mëposhtme:

   a) të dhënat personale (emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, shtetësinë, adresën e fundit të njohur në vendin e origjinës apo të tranzitit) të personit në fjalë dhe, nëse është e nevojshme, të dhënat personale të të afërmve të tij të cilat janë deklaruar vetë nga kërkuesi;
   b) të dhënat lidhur me dokumentet e identitetit të paraqitur nga vetë kërkuesi;
   c) gjurmët daktiloskopike dhe fotografitë;
   d) dokumente të tjera që janë paraqitur nga kërkuesi;
   e) të dhënat lidhur mbi gjendjen gjyqësore, për aq sa kjo është e rëndësishme për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe për aq sa personi në fjalë nuk rrezikohet. Përjashtim nga ky verifikim për çdo aplikues, bëjnë fëmijët nën moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç.
10. Gjurmët daktiloskopike dhe fotografia, të cilat administrohen nga Policia e Shtetit në bazën e të dhënave për të huajt, vihen në dispozicion të Autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët me kërkesën e këtij të fundit.
11. Informacioni në përputhje me klasifikimin e tij, mund të kërkohet apo të jepet me shkresë zyrtare.
12. Informacioni i mbledhur administrohet në dosjen personale të kërkuesit apo përfituesit të mbrojtjes ndërkombëtare.
13. Rregullat dhe procedura për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave dhe të deklarimeve nga vendi i origjinës për kërkuesin apo përfituesit të mbrojtjes ndërkombëtare, të parashikuara në këtë udhëzim, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për personat që kanë përfituar statusin e mbrojtjes së përkohshme.
14. Udhëzimi i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 645, datë 14.12.2015, "Për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatin", shfuqizohet.
15. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

Fletore zyrtare nr. 98, datë publikimi 22.06.2021

UDHËZIM

Nr. 28, datë 16.01.2017

PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE (RKGJC) TË VITIT 2010, TË PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI OSE MBROJTJE PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", nenit 21 dhe nenit 59 të ligjit nr. 10129, "Për gjendjen civile", të ndryshuar,

UDHËZOJ:


1. Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 të personit me status refugjati apo mbrojtje plotësuese, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët paraqet, sa më shpejt të jetë e mundur, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit, kërkesë për regjistrimin pranë zyrave të gjendjes civile në njësitë administrative përkatëse.
2. Kërkesa për regjistrim, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, përmban të dhënat personale të personit me status refugjati apo mbrojtje plotësuese, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile të njësive administrative përkatëse, pas marrjes së kërkesës dhe pas paraqitjes së personit me status refugjati apo mbrojtje plotësuese pranë njësisë së tyre, e regjistrojnë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 5 ditëve pune, në regjistrin përkatës.
4. Pas regjistrimit, zyrat e gjendjes civile përkatëse i përcjellin, me postë elektronike dhe me shkresë, brenda 10 ditëve pune, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, listën e plotë me numrat e identitetit të personave, sipas tabelës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
5. Për regjistrimin e vendbanimit, personi me status refugjati apo mbrojtje plotësuese, paraqet pranë zyrave të gjendjes civile përkatëse, një kopje të lejes e qëndrimit të shoqëruar me një nga dokumentet e mëposhtme:
   a) vërtetim të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues, nëse personi është me qëndrim pranë kësaj qendre;
   b) dokument që vërteton pronësinë e pasurisë së paluajtshme apo kontratë qiradhënie/ huadhënie/përdorimi, nëse e ka një të tillë;
   c) vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton zyrat e gjendjes civile të njësive administrative përkatëse nëse ka ndryshime në dijeninë e tij, të përbërësve të gjendjes civile, statusit apo vendbanimit në lidhje me këta persona, duke vënë njëkohësisht në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
8. Urdhri nr. 220, datë 7.7.2010, "Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve të huaj që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

TË DHËNAT PERSONALE PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE TË PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI APO MBROJTJE PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

692




FORMULARI I RAPORTIMIT TË ZYRAVE E GJENDJES CIVILE PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE DHE AUTORITETIT PERGJEGJËS PE AZILIN DHE REF...

Nr.	Numri i identitetit	Emri	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia	Vendlindja		Shtetësia	Data e regjistrimit
						Vendi	Shteti		

Emër, Mbiemër, Datë, Firmë (Përgjegjësi i Zyrës Gjendjes Civile)

FORMULARI I RAPORTIMIT TË ZYRAVE E GJENDJES CIVILE PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE DHE AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR AZILIN DHE REFUGJATËT

693



TË DHËNAT PERSONALE PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE TË PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI APO MBROJTJE PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQ...

Nr.	Emri	Mbiemri	Atësia	Amësia	Gjinia	Datëlindja	Vendlindja		Shtetësia	Leje Qëndrimi dhe vlefshmëria			Nr., data dhe lloji i vendimit të Drejtorisë së Azilit
							Vendi	Shteti		Nr. i lejes	Nga data	Deri në	

Emër, Mbiemër, Datë, Firmë (specialist në Drejtorinë e Azilit)

UDHËZIM

Nr. 114, datë 9.7.2024

PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT, E REFUZIMIT TË LËSHIMIT, E RIPËRTËRITJES APO E ANULIMIT TË LEJES SË QËNDRIMIT DHE LEJES UNIKE PËR TË HUAJIN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 34, të pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt",

UDHËZOJ:

I. VERIFIKIMI I TË DHËNAVE, REGJISTRIMI NË SISTEM, LËSHIMI I LEJES PROVIZORE TË QËNDRIMIT DHE ARKIVIMI I DOSJES

1. Struktura e migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, pas dorëzimit të dokumentacionit fizik nga i huaji, kryen verifikimin dhe plotësimin e mangësive të konstatuara në aplikim, dhe regjistron në sistemin FER, "Moduli e-leje qëndrimi". Nëse gjatë regjistrimit evidenton mospërputhje të dhënash (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendlindje, shtetësi, gjini etj.) ndërmjet të dhënave të deklaruara në portal, dokumentit identifikues dhe atyre ekzistuese në sistemin TIMS, apo më shumë se një rekord për të njëjtin person, merr masa për korrigjimin e këtyre të dhënave në FER-TIMS.
2. Pas regjistrimit të aplikimit në sistemin FER-TIMS, gjenerohen akti i arkivimit të dosjes së aplikimit të të huajit dhe leja provizore e qëndrimit me vulë elektronike i përcillet të huajit në format elektronik, në adresën e emailit të dhënë nga aplikuesi.

II. DHËNIA E AUTORIZIMIT PËR LËSHIM TË LEJES SË QËNDRIMIT / LEJES UNIKE OSE REFUZIMIN E SAJ

1. Miratimi ose refuzimi i aplikimit për leje qëndrimi ose leje unike dhe dhënia e autorizimit për lëshimin apo refuzimin e tyre, bëhet nga struktura përgjegjëse pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, mbi bazën e vlerësimeve të bëra nga të gjitha strukturat që marrin pjesë në vlerësimin e aplikimit, në formën e një akti të miratuar dhe nëpërmjet shënimit në modulin e-leje qëndrimi.

2. Struktura përgjegjëse pranë autoritetit për kufirin dhe migracionin, sipas aktit të miratuar, autorizon për çdo aplikim autoritetin vendor të kufirit dhe migracionit përkatës për të vijuar me lëshimin ose refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike.

III. LËSHIMI I LEJES SË QËNDRIMIT OSE LEJES UNIKE

1. Pas marrjes së autorizimit për lëshimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, struktura përgjegjëse pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, bën shënimin në rubrikën përkatëse për çdo aplikim të regjistruar në modulin e-leje qëndrimi dhe i përcjell të huajit në adresën e email-it të deklaruar në aplikim, njoftimin për miratimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku e informon, për:
   a) miratimin e lejes së qëndrimit/lejes unike dhe pajisjen me nr. personal FID;
   b) detyrimin për regjistrim pranë zyrës së gjendjes civile për regjistrimin e adresës së banimit;
   c) kryerjen e pagesës së vlerës së kartës biometrike, nëpërmjet mandatit të arkëtimit.
2. Procedura e aplikimit për dokument biometrik leje qëndrimi/leje unike për të huajt, bëhet në zyrën e migracionit, pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, nga vetë i huaji, ku dhe tërhiqet ky dokument pas prodhimit dhe aktivizimit të CHIP-it të trupëzuar në të.
3. Në momentin kur i huaji pajiset me dokumentin leje qëndrimi/leje unike, ai dorëzon pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin lejen provizore ose lejen e qëndrimit/lejen unike ekzistuese (në rast të kërkesës për ripërtëritjen e saj), e cila më pas ruhet në dosjen e të huajit.
4. Të huajt që janë pjesë e kategorive të përcaktuara në nenet 52, 53 dhe shkronjës "dh", të pikës 1, nenit 87, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", pajisen me leje qëndrimi sipas pjesës A, pika 8, shkronja "c", të kreut III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e cila gjenerohet nga moduli e-leje qëndrimi dhe i dorëzohet të huajit fizikisht.

5. Miratimi dhe lëshimi i lejes së qëndrimit/lejes unike, nga autoriteti për kufirin dhe migracionin u njoftohet automatikisht Sistemit e-Visa (VISA) dhe Sistemit të Shërbimeve të Punësimit (SSHP).

IV. ANULIMI/REFUZIMI I LËSHIMIT APO RIPËRTËRITJES TË LEJES SË QËNDRIMIT OSE LEJES UNIKE

1. Për rastet e refuzimit të lëshimit apo ripërtëritjes së lejes së qëndrimit/lejes unike, të parashikuara në nenin 34, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", kur konstatimi bëhet në fazën e aplikimit, strukturat përgjegjëse të autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin marrin masa për njoftimin e të huajit mbi refuzimin, si dhe vazhdimin e procedurave ligjore sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 89 dhe nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt".
2. Për rastet kur konstatimi bëhet në fazën e vlerësimit të aplikimit për leje qëndrimi/leje unike, autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin merr vendimin përfundimtar për refuzimin e lëshimit ose ripërtëritjes së lejes së qëndrimit/lejes unike dhe njofton autoritetin vendor me shkresë zyrtare dhe nëpërmjet shënimit në modulin e-leje qëndrimi mbi këtë refuzim, për të vijuar me procedurat ligjore, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 89 dhe nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt".
3. Në rast se autoritetet e përfshira në bashkëpunim për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit/lejes unike, konstatojnë një nga rastet për të cilat bëhet anulimi i lejes së qëndrimit/lejes unike, i kërkojnë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, anulimin e autorizimit, për të cilën më parë mund të kenë dhënë aprovimin.
4. Kur autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin merr vendim për anulimin dhe bërjen të pavlefshme të lejes së qëndrimit/lejes unike të lëshuar, ky vendim i përcillet për zbatim autoritetit shtetëror përgjegjës në nivel vendor me shkresë zyrtare, duke u pasqyruar i plotë në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt – FER.
5. Autoriteti përgjegjës në nivel vendor njofton të huajin për refuzimin/anulimin, si dhe për arsyen e këtij vendimi, sipas formatit të refuzimit/anulimit të modelit në aneksin nr. 2 të këtij udhëzimi. Refuzimi/anulimi i lejes së qëndrimit/lejes unike shënohet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt – FER, së bashku me arsyetimin përkatës.
6. Për të huajt që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një

format standard i refuzimit për qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohet formati i parashikuar në këtë marrëveshjen.
7. Pas refuzimit të aplikimit ose anulimit të lejes së qëndrimit/lejes unike, referuar parashikimeve të neneve 34, 45, pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 72, neni 89 dhe 94, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", kur i huaji ndodhet në territor autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin merr masa për largimin e të huajit nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 99, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 107.
8. Në rastet kur i huaji nuk ndodhet në Republikën e Shqipërisë, autoriteti qendror për kufirin dhe migracionin njofton të gjitha pikat e kalimit kufitar (PKK) nëpërmjet sistemit TIMS, mbi anulimin ose refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, ndërsa autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin bën njoftimin në adresën e tij të punës apo të qëndrimit të deklaruar, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Administrative. I huaji njoftohet në PKK nga shërbimet e Policisë së Kufirit dhe Migracionit, në momentin e parë të paraqitjes së tij në hyrje në Republikën e Shqipërisë për refuzimin ose anulimin e lejes së qëndrimit/lejes unike dhe në të njëjtën kohë dhe për refuzimin e hyrjes për rastet e parashikuara në ligj.
9. Refuzimi i aplikimeve për leje qëndrimi/leje unike, si dhe anulimi i lejeve të lëshuara u njoftohet automatikisht sistemeve VISA dhe SSHP.

V. LËSHIMI I LEJES UNIKE PËR KATEGORI TË VEÇANTA

Për kategoritë e shtetasve të huaj që trajtohen me leje unike për kategori të veçanta, të parashikuara në nenin 81, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", aplikimi së bashku me dokumentacionin ligjor depozitohet pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin.

1. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin e përcjell aplikimin, brenda 24 orëve nga depozitimi, pranë autoritetit qendror të kufirit dhe migracionit, i cili e shqyrton në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave pranë këtij autoriteti.
2. Komisioni vendos miratimin ose refuzimin e aplikimit për leje unike për kategori të veçanta dhe njofton autoritetin vendor mbi vendimin e marrë, brenda 3 (tri) ditë pune nga depozitimi i kërkesës pranë këtij institucioni.

3. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në bazë të vlerësimeve rast pas rasti, kërkon nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin verifikimin e përmbushjes së kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, "Për të huajt". Në këtë rast, vendimi i Komisionit mund të vonohet në varësi të përgjigjes së autoritetit vendor apo plotësimit të dokumentacionit nga i huaji.
4. Pas miratimit të aplikimit, autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin ku i huaji ka vendqëndrimin e përkohshëm, pajis të huajin me dokumentin "Leje unike për kategori të veçanta" në formatin e miratuar me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 234, datë 13.12.2022.

VI. PËRLLOGARITJA E FILLIMIT TË AFATEVE TË LEJEVE TË QËNDRIMIT

1. Me qëllim unifikimin e procedurës për mënyrën e përllogaritjes së fillimit të afatit të lejes së qëndrimit/lejes unike, si datë fillimi, pas miratimit nga të gjitha strukturat përgjegjëse, do të jetë data e regjistrimit online të kërkesës në portalin qeveritar.
2. Për shtetasit e huaj që duhet të aplikojnë me vizë, si datë e fillimit të lejes së qëndrimit/lejes unike do të jetë data e hyrjes në territorin e RSH, pas pajisjes me vizën përkatëse.
3. Për procedurën e ripërtëritjes, afati i lejes së rinovuar do të fillojë një ditë pas skadimit të lejes së mëparshme të qëndrimit/lejes unike.
4. Lejet e përhershme të qëndrimit, të tipit C, në mbështetje të pikës 6, të nenit 86, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", do të lëshohen me afat 10-vjeçar (dhjetëvjeçar).

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për ripërtëritjen e lejes së qëndrimit/lejes unike, ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e kërkesës për pajisje për herë të parë, përjashtuar aplikimin për vizë për kategorinë e shtetasve të huaj që kërkojnë pajisjen me vizë të tipit D, kur aplikojnë për herë të parë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

Fletore zyrtare nr. 121, datë publikimi 17.07.2024

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se Leja e Qëndrimit/Leja Unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr._____, FID_____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të banimit në Zyrën e Gjendjes Civile (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe kontratën e qeras së banesës).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike duke blerë kuponin në zyrat e Postës Shqiptare

Hapi 3: Paraqiteni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisariatin e Policisë Kufitar dhe Migracionit_____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!
Specialist i Migracionit_____
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin /Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit_____

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizen _____, Travel Document no._____, FID_____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:

Step 1: *Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office (submitting this printed notice, travel document and apartment rental contract within 30 days).*

Step 2: *Make the payment by buying the coupon at the Post Office.*

Step 3: *Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

IdCode/20220105/2534510

Migration Specialist _____*Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat* _____

ANEKSI NR. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA RAJONALE E KUFIRIT DHE MIGRACIONIT

REFUZIMI / ANULIMI I LEJES SË QËNDRIMIT / LEJES UNIKE
REFUSAL / WITHDRAWAL OF RESIDENT PERMIT / UNIQUE PERMIT

Më , në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin
On *at the Regional Directorate for Border and Migration*

☐ I refuzohet leja e qëndrimit shtetasit: ☐ I hiqet leja e qëndrimit shtetasit:
The citizen's residence permit is refused: *The citizen's residence permit is revoked:*

Mbiemri *Family name*	Emri *First name*	
Datëlindja *Date of birth*	Vendlindja *Place of birth*	Gjinia *Sex*
Shtetësia *Nationality*	Banues në *Resident in*	
Dokumenti udhëtimit Nr. *Travel document no.*	Lëshuar në *Issued in*	Më *on*

në mbështetje të Ligjit Nr. 79/2021 "Për të huajt", për arsyet në vijim:
based on Law No. 79/2021 "On Foreigners" for the following reasons:

☐**(A)** Ka shkelur afatet e aplikimit për leje qëndrimi pa motiv (Neni 34/1(a) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
Groundless violation of the time limit for residence permit application (Article 34/1(a) of Law No. 79/2021 "On Foreigners").

☐**(B)** Nuk plotëson kushtet e nevojshme për qëndrim (Neni 34/1(b) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt") referuar:
Does not meet the necessary conditions for residence (Article 34/1(b) of Law No. 79/2021 "On Foreigners").

☐**(C)** Përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike dhe është subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë (Nenet 34/1(c), 72/1(c) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
The applicant is a threat to public order and security and he is subject to removal from the territory of the Republic of Albania (Articles 34/1(c), 72/1(c) of the Law No. 79/2021 "On Foreigners").

☐**(Ç)** Nuk ekzistojnë me arsyet për të cilat është lëshuar leja e qëndrimit/leja unike (Neni 34/1(d), 72/1 (dh) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
The reasons for which the residence permit/unique permit is issued no longer exit (Article 34/1(d), 72/1(dh) of Law No. 79/2021 "On Foreigners").

☐**(D)** Ka qëndruar mbi 180 ditë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (Nenet 34/1(e), 72/1(d) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
The foreigner has stayed more than 180 days outside the territory of the Republic of Albania (Articles 34/1(e), 72/1(d) of Law No. 79/2021 "On Foreigners").

☐**(DH)** Në rast se i huaji ka përfituar lejen e qëndrimit për shkak të bashkimit familjar dhe është zgjidhur martesa (Neni 34/1 (ç) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
In case the foreigner has obtained a residence permit due to family reunification and the marriage has been dissolved (Article 34/1 (ç) Law No. 79/2021 "For foreigners").

☐**(E)** Kur leja e qëndrimit/leja unike është marrë duke përdorur dokumentacion të rremë ose në kushte mashtrimi (Nenet 34/1 (dh), 72/1 (a) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").

When the resident permit/unique permit was obtained using false documentation or under fraudulent conditions (Articles 34/1 (dh), 72/1 (a) Law No. 79/2021 "For foreigners").

☐**(Ë)** Pas lëshimit të lejes unike, provohet se dokumentacioni që shoqëron kërkesën nuk është i saktë (Neni 72/1 (b) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
After the issuance of the unique permit, it is proved that the documentation accompanying the request is not correct (Article 72/1 (b) Law No. 79/2021 "For foreigners").

☐**(F)** Leja unike është anuluar (Neni 72/1 (ç) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
The unique permit has been canceled (Article 72/1 (ç) Law No. 79/2021 "For foreigners").

☐**(G)** I huaji ndërpret kontratën e punës për arsye të ndryshme dhe largohet nga vendi i punës për të cilin ka marrë lejen (Neni 72/1 (e) Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt").
The foreigner terminates the employment contract for various reasons and leaves the workplace for which he received the permit (Article 72/1 (e) Law No. 79/2021 "On Foreigners").

Komente/Comments

Personi i interesuar mund të ankohet ndaj vendimit për refuzimin e lejes së qëndrimit/lejes unike, sipas parashikimeve të Ligji nr. 79/2021 "Për të huajt" dhe parashikimeve të legjislacionit Shqiptar.

The person concerned may appeal against the decision refusing the resident permit/unique permit as provided for in the law No. 79/2021 "On Foreigners") and in the provisions of the Albanian legislation.

Personi i interesuar *Person concerned*	**Autoriteti** *Authority*

UDHËZIM

Nr. 116, datë 11.07.2024

PËR PROCEDURAT DHE FORMULARIN E REGJISTRIMIT E TË HUAJIT NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 36, të ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt",

UDHËZOJ:

1. I huaji, i cili ka marrë njoftimin për miratimin e Lejes së Qëndrimit ose Unike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ka detyrimin të paraqitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile ku ka vendosur vendbanimin e tij të përkohshëm, duke paraqitur dokumentacionin, si vijon:
   a) njoftimin sipas modelit në aneksin 1, të këtij udhëzimi;
   b) dokumentin e udhëtimit me të cilin ka hyrë dhe qëndron në Shqipëri;
   c) fotokopje e noterizuar e kontratës së qirasë, apo të një dokumenti që tregon që ka në pronësi një banesë.
2. Me paraqitjen në zyrën e Gjendjes Civile, të dhënat e të huajit aktivizohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), duke mundësuar fillimin e procesit të aplikimit për dokument biometrik, leje qëndrimi/leje unike për të huajt.
3. Në rast të ndryshimit të vendbanimit të të huajit, deklarimi për ndryshimin e vendbanimit duhet të bëhet nëpërmjet portalit *e-Albania*, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga ardhja në vendbanimin e ri.
4. Kur të huajit i përfundon afati i lejes së qëndrimit apo lejes unike, të dhënat e tij automatikisht çaktivizohen në RKGJC, brenda një muaji nga përfundimi i lejes së qëndrimit/lejes unike.
5. Në rastin kur i huaji largohet nga territori i Republika e Shqipërisë, apo i anulohet leja e qëndrimit për arsye të ndryshme, strukturat përgjegjëse të migracionit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin, njoftojnë strukturat përgjegjëse të migracionit pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, të cilat marrin masa për anulimin e lejes së qëndrimit në sistemin FER. Ky njoftim i shkon automatikisht Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ndryshimi i statusit të shtetasit të huaj në RKGJC ndodh automatikisht, duke u ndryshuar nga "aktiv" në "i bllokuar".
6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet pasi të pasqyrohen zhvillimet përkatëse teknike në portalin *e-Albania*.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

ANEKSI Nr. 1

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se leja e qëndrimit/leja unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr. _____, FID_____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/unike, ju duhet të:

Hapi 1: Konfirmoni adresën e saktë të banimit në Zyrën e Gjendjes Civile (duke paraqitur brenda 30 ditëve këtë njoftim të printuar, dokumentin e udhëtimit dhe kontratën e qirasë së banesës).

Hapi 2: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike, duke blerë kuponin në zyrat e Postës Shqiptare

Hapi 3: Paraqiteni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin ose Komisariatin e Policisë Kufitar dhe Migracionit_____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Specialist i Migracionit_____

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin/Komisariati i Policisë Kufitare dhe Migracionit_____

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizen _____, Travel Document no._____, FID_____ has been approved.
To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:
Step 1: *Confirm the correct residential address at the Civil Registry Office (submitting this printed notice, travel document and apartment rental contract within 30 days).*
Step 2: *Make the payment by buying the coupon at the Post Office*
Step 3: *Be present at the Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*
Thank you for understanding!
Id Code/20220105/2534510

Migration Specialist _____*Local Director for Border and Migration or Border and Migration Commissariat _____*

Fletore zyrtare nr. 121, datë publikimi 17.07.2024

ORIENTIME
TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE

LIDHUR ME MËNYRËN DHE RENDIN E VEPRIMEVE PËR SAKTËSIMIN E TË DHËNAVE PËR SHTETASIT E HUAJ, PËR TË CILËT ËSHTË LËSHUAR LEJE QËNDRIMI (DOKUMENT NË VLEFSHMËRI TË TIJ), SI DHE PËR REGJISTRIMIN E PERSONAVE TË CILËVE U ËSHTË MIRATUAR FITIMI I SHTETËSISË SHQIPTARE, ETJ.

I. HYRJE

Për çdo veprim që do të kryhet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për shtetasit e huaj, siç mund të jetë për krijimi i këtyre personave:

1) për shpallje martese;
2) për njohje atësie;
3) për leje qëndrimi, përpara importimit të të dhënave nga FER;
4) për kategorinë e personave të regjistruar në RKGJC por, që kanë lënë shtetësinë shqiptare dhe që më pas janë pajisur me leje qëndrimi, si shtetas të huaj;
5) etj,

nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative duhet të kryhen verifikimet paraprake në Regjistrin Kombëtar, për të shmangur raste të krijimit të rekordeve të reja.
Për çdo rast të evidentimit të një regjistrimi të krijuar më parë, duhet të vijohet me përditësimin e të dhënave, kryerjen e veprimeve në rekordin ekzistues, duke përjashtuar në çdo rast krijimin e një rekordi të ri të panevojshëm.

II. LIDHUR ME MËNYRËN DHE RENDIN E VEPRIMEVE PËR SAKTËSIMIN E TË DHËNAVE PËR SHTETASIT E HUAJ, PËR TË CILËT ËSHTË LËSHUAR LEJE QËNDRIMI (DOKUMENT NË VLEFSHMËRI TË TIJ).

Për kryerjen e veprimeve të përditësimit në RKGJC, për deklarimin / ndryshimin e adresës për shtetasit e huaj, punonjësi i ZGJC-së paraprakisht duhet të kërkojë në sistem, duke iu referuar të dhënës për numrin personal për të huajt (FID). Kjo e dhënë identifikohet në përmbajtje të njoftimit zyrtar, që i është dërguar shtetasit të huaj nga Drejtoritë Vendore të Kufirit dhe Migracionit (DVKM), nëpërmjet komunikimit elektronik, dokument i cili paraqitet nga këta persona në

zyrën e gjendjes civile. Nëpërmjet kërkimit sipas FID, shfaqet rekordi për të cilin është importuar FID dhe leje qëndrimi për shtetasin nga sistemi FER.

Në vijim të procesit, nëpunësi i gjendjes civile duhet të verifikojë përputhshmërinë e të dhënave në përmbajtje të dokumentit të udhëtimit, me ato të importuara nga FER në RKGJC.

Në rast të konstatimit të mospërputhshmërisë së të dhënave, nëpunësi i gjendjes civile adreson shtetasin e huaj, për t'u paraqitur pranë DVKM-së që ka lëshuar lejen e qëndrimit, për të bërë saktësimin e të dhënave në sistemin FER. Pas saktësimit të këtyre të dhënave, shtetasi duhet të paraqitet pranë ZGJC-së.

Përveç veprimtarisë së përshkruar më sipër, nëpunësi i gjendjes civile, pas saktësimit të të dhënave të kryera në DVKM, duhet të kryejë një verifikim tjetër, që ka të bëjë me regjistrimin e mëparshëm që mund të rezultojë për shtetasin e huaj në RKGJC. I referohemi këtu, rasteve kur shtetasit e huaj, të importuar nga FER, mund të jenë njëkohësisht të krijuar më parë në RKGJC, si për shembull për procedura të:

1) shpalljes së martesës;
2) njohjes së atësisë;
3) leje qëndrimi, përpara importimit të të dhënave nga FER;
4) për kategorinë e personave të regjistruar në RKGJC por, që kanë lënë shtetësinë shqiptare dhe që më pas janë pajisur me leje qëndrimi, si shtetas të huaj;

Për rastet e listuara më lartë, rekorde të krijuara nga veprimtari të mëparshme të nëpunësve të gjendjes civile në RKGJC dhe njëkohësisht të importuar nga FER, për të cilët, në përmbajtje të njoftimit të DVKM-së, rezulton numri personal për shtetasit e huaj (FID), veprohet si më poshtë:

Nëpunësit e gjendjes civile duhet të kontrollojnë paraprakisht nëse rezultojnë me status të bllokuar, kategoritë e listuara me sipër, sipas rastit, duke vijuar me veprimtarinë e ndryshimit të statusit nga i bllokuar në aktiv.

Në rast të konstatimit të rekordeve të dyfishta, i referohemi këtu, rekordit të importuar nga FER në RKGJC dhe një rekordi të mëparshëm, nëpunësi i gjendjes civile vijon me veprimtarinë e pastrimit të dublimit të rekordit të dyfishtë. Gjatë këtyre veprimeve,

nëpunësi respekton parimin bazë, duke lënë aktiv rekordin me të vjetër të krijuar në Regjistrin Kombëtar. Në vazhdimësi të këtij procesi, nëpunësi i gjendjes civile duhet të vijojë me aksesimin e funksionit "FER Përditësim", duke mundësuar shtimin e lejes së qëndrimit në rubrikën "Dokumente Identiteti".

Lutemi t'i referoheni këtu manualit bashkëlidhur, i cili është publikuar dhe në modulin "Dokumenta dhe Mesazhe" të Regjistrit Kombëtar.

Kujdes!

Për raste si për shembull kur janë kryer veprime të njohjes së atësisë nga një shtetas i huaj, sipas rekordit të krijuar për leje qëndrimi dhe jo sipas rekordit të krijuar për shpallje martese, nëpunësi i gjendjes civile plotëson të dhënat e vendbanimit në rekordin që është krijuar për leje qëndrimi, pavarësisht faktit së rekordi për shpallje martese është krijuar në një kohë të mëpërparme. Kjo rrugë ndiqet për arsye se shtetasi i huaj i cili ka kryer njohjen e atësisë, më vonë mund të fitojë shtetësinë shqiptare dhe bashkohet në familje me fëmijën e tij.

Për rastet e shtetasve të huaj, rekordet e të cilëve nuk shfaqen nga ezaurimi i dy opsioneve të kërkimit në RKGJC, sipas kërkimit me FID, apo në bazë të përbërësve të tjerë, që rezultojnë në përmbajtje të dokumentit të udhëtimit, nëpunësi i gjendjes civile vijon si më poshtë:

Zgjedh funksionin e ri "FER Importi", në mënyrë që të mundësohet importimi i rekordit të ri në RKGJC, sipas të dhënave që rezultojnë në FER, duke përfshirë dhe lejen e qëndrimit, e cila regjistrohet në rubrikën "Dokumente Identiteti".

Lutemi t'i referoheni këtu manualit bashkëlidhur, i cili është publikuar dhe në modulin "Dokumenta dhe Mesazhe".

Pas përfundimit të procesit të importimit, për të cilin nëpunësi i gjendjes civile sigurohet me shfaqjen e mesazhit, për importimin me sukses të rekordit, nëpunësi duhet të vijojë me shtimin e elementëve të adresës, sipas dokumentit që vërteton vendbanimin e shtetasit të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rast të mos realizimit me sukses të importimit të të dhënave që vijnë nga FER për në RKGJC, nëpunësi duhet të adresojë shtetasin e huaj, për

t'u paraqitur pranë DVKM-së që ka dërguar njoftimin zyrtar të konfirmimit të lejes së qëndrimit, për kontrollin e statusit të regjistrimit të tij në FER. Për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie personash, në përmbushje të nevojave të tyre administrative, siç janë për shembull lëshimi i konfirmimeve, vërtetimeve për regjistrimin e vendbanimit, pasqyrohet e dhëna për FID-in dhe jo numri personal që këtij rekordi i atribuohet nga RKGJC.

FID-i është e dhëna, në bazë të të cilës institucionet e tjera plotësojnë nevojat e kësaj kategorie, në ofrimin e shërbimeve të tjera publike, siç janë për shembull:

- pajisje me leje qëndrimi biometrike;
- regjistrimi në portalin e-Albania;
- sigurimet shoqërore dhe ose shëndetësore;
- etj.

E rëndësishme!

Për të vijuar me deklarimin / ndryshimin e adresës së shtetasve të huaj, ju lutem referojuni:

- njoftimit zyrtar të DVKM-së, të lëshuar për shtetasin e huaj dhe refuzoni të jepni shërbim për shtetasit e huaj, të cilët paraqesin vetëm leje qëndrimi të vjetër - të printuar, duke i adresuar që të paraqiten pranë Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM), për t'u pajisur me njoftimin zyrtar lidhur me lejen e qëndrimit, i cili përmban FID-in e saktë për shtetasin e huaj. Në përmbajtje të këtij njoftimi, në anën e djathtë të faqes, rezulton e plotësuar elektronikisht *Idcode* dhe data e dorëzimit të lejes së qëndrimit.

  Nëpunësi i gjendjes civile duhet të bëjë verifikimet lidhur me afatin 30 ditor të paraqitjes pranë zgjc-së për deklarimin e vendbanimit, duke ju referuar datës së përcaktuar në përmbajtje të njoftimit, si më lart të përshkruar.

  Sqarim: Në fund të përmbajtjes së njoftimit zyrtar, në krah të djathtë është koduar data e miratimit, shembull: IdCode/20220111/254347, ilustruar sipas modelit bashkëlidhur. Data e miratimit të aplikimit sipas këtij rasti është 11.01.2022. Në zbatim të nenit 21, pika 2 të ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009, duhet t'i referoheni kësaj date, të shënjuar me ngjyrë gri. E

dhëna 254347 është ID e aplikimit, plotësuar për "maskim".

- fotokopjes së dokumentit të udhëtimit;
- dokumenti që vërteton vendbanimin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkëlidhur këtij udhëzimi do të gjeni modelin e miratuar të njoftimit zyrtar, të vënë në dispozicion nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

III. LIDHUR ME MËNYRËN DHE RENDIN E VEPRIMEVE PËR REGJISTRIMIN E PERSONAVE, TË CILËVE U ËSHTË MIRATUAR FITIMI I SHTETËSISË.

Për çdo veprim regjistrimi të personave, të cilëve u është miratuar fitimi i shtetësisë shqiptare, nëpunësi i gjendjes civile, paraprakisht kryen verifikimet e regjistrimit të mëparshëm, që mund të rezultojë i krijuar:

1) për shpallje martese;
2) për njohje atësie;
3) për leje qëndrimi, përpara importimit të të dhënave nga FER;
4) për kategorinë e personave të regjistruar në RKGJC, të cilët kanë lënë shtetësinë shqiptare dhe që më pas janë pajisur me leje qëndrimi, si shtetas të huaj;

Veprimet e regjistrimit të shtetësisë shqiptare kryhen mbi rekordin më të hershem të krijuar në Regjistrin Kombëtar, duke plotësuar gjithashtu dhe rubrikat që ruajnë informacionin e nevojshëm dhe që janë të detyrueshme për t'u pasqyruar për një shtetas shqiptar.

Në rast të konstatimit të rekordeve të dyfishta, i referohemi këtu, rekordit të importuar nga FER në Regjistrin Kombëtar dhe ose një rekordi të mëparshëm të listuar në një prej kategorive të mësipërme, detyrimisht nëpunësi i gjendjes civile duhet të vijojë me veprimtarinë e pastrimit të dublimit. Gjatë këtyre veprimeve, nëpunësi i gjendjes civile duhet të veprojë duke respektuar parimin bazë, të lënies aktiv të rekordit me të hershëm, të krijuar më parë në Regjistrin Kombëtar, ku do të kryhen veprimet e regjistrimit të shtetësisë shqiptare.

Nëpunësi i gjendjes civile, vepron duke krijuar rekord të ri, vetëm për rastet e miratimit të fitimit të shtetësisë shqiptare për merita të veçanta, si raste për të cilët nga kërkimi rezulton se nuk rezultojnë të regjistruar më parë si shtetas të huaj në Regjistrin Kombëtar.

IV. LIDHUR ME MËNYRËN DHE RENDIN E VEPRIMEVE PËR SHPALLJE MARTESE, PËR NJOHJE ATËSIE, ETJ, PËR SHTETASIT E HUAJ, TË REGJISTRUAR NË REGJISTRIN KOMBËTAR.

Për çdo rast të procedurave për shpallje martese, njohje të atësisë, etj, me shtetas të huaj, të cilët rezultojnë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar, apo të ish shtetasve shqiptarë, të cilët kanë lënë shtetësinë shqiptare, nëpunësi i gjendjes civile, paraprakisht kryen verifikimet e nevojshme të statusit të rekordit. Nëse rekordi rezulton i bllokuar në Regjistrin Kombëtar, punonjësi i gjendjes civile kryen procedurat e zhbllokimit, për të vijuar më tej me plotësimin e rubrikave që ruajnë informacionin e nevojshëm dhe që janë të detyrueshme për t'u pasqyruar për një shtetas të huaj, për të cilin do të vijohet me shpalljen e martesës, apo njohjen e atësisë.

Theksojmë se në rast të konstatimit të rekordeve të dyfishta, i referohemi këtu, rekordit të importuar nga FER në Regjistrin Kombëtar dhe ose një rekordi të mëparshëm, detyrimisht nëpunësi i gjendjes civile duhet të vijojë me veprimtarinë e pastrimit të dublimit. Gjatë këtyre veprimeve, nëpunësi respekton parimin bazë, duke lënë aktiv rekordin me të hershëm të krijuar në Regjistrin Kombëtar.

VENDIM

Nr. 134, datë 07.03.2003

PËR VËRTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR PËRDORIM JASHTË VENDIT DHE TË DOKUMENTEVE TË HUAJA PËR PËRDORIM BRENDA VENDIT

(*Shtuar pika 2.1 me vendimin e KM nr. 727, datë 30.10.2003)*

I përditësuar

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr. 8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore" dhe të shkronjës "d" të nenit 6 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vërtetimi i dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit, të bëhet:
   a) në institucionet e administratës publike, të nivelit qendror, që më poshtë do të quhen "institucione qendrore", si për dokumentet e lëshuara nga vetë ato, dhe nga institucionet e varësisë ose institucionet e linjës;
   b) në institucionet e pavarura për dokumentet e lëshuara nga administrata e tyre;
   c) nga prefektët për dokumentet e lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore. "Institucionet qendrore" dhe "institucione të pavarura", në kuptim të këtij vendimi, janë institucionet e parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
2. Dokumentet e vërtetuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, të lëshuara nga institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët, legalizohen nga nëpunësit konsullorë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

2.1. Nëpunësit konsullorë të përfaqësisë së Republikës të Shqipërisë, të akreditуar në Greqi, të legalizojnë, deri më 30 dhjetor 2003, dokumentet e lëshuara për përdorim jashtë vendit pa i vërtetuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Aktet e lëshuara nga noteri legalizohen drejtpërdrejt nga nëpunësit civilë.
4. Dokumentet e autoriteteve të huaja, që do të përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
5. Në vendet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi të akredituar, legalizimi i dokumenteve të huaja, të legalizuara më parë nga Ministria e Jashtme e vendit të origjinës, kryhet në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
6. Modeli i vërtetimit dhe legalizimit të dokumentit është sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Ndryshimet e modeleve bëhen nga Ministri i Punëve të Jashtme, i cili njofton menjëherë institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët.
7. Titullarët e institucioneve qendrore, të institucioneve të pavarura dhe prefektët, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme emrat e personave të ngarkuar, për vërtetimin dhe lëshimin e dokumenteve, si dhe depozitojnë specimenet e nënshkrimeve të tyre dhe gjurmët e vulave zyrtare.
8. Në rast largimi të personave të përcaktuar sipas pikës së mësipërme, titullarët e institucioneve qendrore, të institucioneve të pavarura dhe prefektët njoftojnë menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe depozitojnë pranë saj nënshkrimet e personave zëvendësues.
9. Ministria e Drejtësisë njofton menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme për emërimin ose largimin nga detyra të noterit dhe depoziton nënshkrimin dhe gjurmët e vulave të tij.
10. Ngarkohen institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe prefektët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA Nr. 1

(Institucioni i administratës publike/prefekti)

Nr. _____
Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z
(Emri,mbiemri i nëpunësit lëshues)
me funksion
(funksioni zyrtar)
dhe vula zyrtare
(Emri,mbiemri i nëpunësit vërtetues)
(Nënshkrimi)
(Vendi), më (Data)
(Vula zyrtare e institucionit qendror)

Lidhja 2
Modeli i legalizimit

(Ministria e Punëve të Jashtme/Përfaqësia)
No._____

Hereby is certified the authenticity of signing of
Mrs/Mr./
Vërtetohet autenticiteti i nënshkrimit të znj./z
(Emri,mbiemri i nëpunësit vërtetues)
in the capacity / me funksion
(funskioni zyrtar)
and the official seal / dhe vula zyrtare
(Emri,mbiemri i nëpunësit konsullor)
(Nënshkrimi)
(Vendi), (Data)
(Vula zyrtare)

Vendimi i KM nr. 134, datë 7.3.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, faqe 527.
Vendimi i KM nr. 727, datë 7.3.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 91, faqe 3961.

I. PRANIMI I DREJTËPËRDREJTË I DOKUMENTAVE:

Me marrëveshje reciproke vendet e listës si më poshtë janë të përjashtuara nga detyrimi i legalizimit ose apostilimit paraprak të dokumenteve. Autoritetet shqiptare pranojnë dokumentet e këtyre vendeve pa formalitete të tjera:

1. HUNGARI
2. REPUBLIKA ÇEKE
3. RUMANI
4. SLLOVAKI
5. BULLGARI
6. KOSOVË (hyre ne fuqi me 30.06.2022)

II. LEGALIZIMI I THJESHTË I DOKUMENTAVE

AFGANISTAN, ALGJERI , ANGOLA,
BANGLADESH, BENIN, BHUTAN, BURKINA FASO, BIRMANIA;
CAD;
EGJIPT, EMIRATET E BASHKUARA ARABE, ERITREA, ETIOPI;
GABONI, GAMBIA, GANA, GUINEA -BISAU, GUINEA EKUADORIALE;
HAITI
INDONEZIA, IRAN, IRAK ;
JORDANIA;
KAMBOXHIA, KANADA, KONGO, KUBA, REPUBLIKA DEMOKRATIKE E KONGOS,
KAMERUN, KOMORET, KRIBATI, KATAR, KUVAJT, KENIA, KOREA E VERIUT ;
LAOS, LIBI, LIBANI ;
MADAGASKAR, MALAJZIA , MALDIVE, MALI, MAURITANIA ;
NIGERI , NEPAL, NAURU
PAKISTAN , PAPUA GUINEJA E RE ;
RUANDA, REPUBLIKA E AFRIKES QENDRORE;
SIERRA LEONE, SIRIA, SOMALI, SRI LANKA, SENEGALI, SUDAN, SUDAN I JUGUT;
TAILANDA, TANZANI, TOGOJA, TIMORI LINDOR, TUVALU, TURKMENISTAN,
UGANDA, VIETNAM, XHIBUTI , ZAMBIA, ZIMBABVE ;

III. APOSTILLE

"APOSTILLE" është një lloj legalizimi që autoriteti kompetent i një shteti i bën dokumentit publik duke e kthyer dokumentin në të vlefshëm edhe për shtetet e tjera që kanë nënshkruar konventën.
Pra Apostille është një legalizim i mundshëm i parashikuar vetëm për shtetas që vijnë nga vendet që kanë nënshkruar Konventën e Hagës së 5 tetorit 1961 lidhur me heqjen e legalizimit të akteve publike të huaja.
Gjatë viteve konventa është ratifikuar dhe zbatuar nga shumë e shumë vende dhe parashikon që të mos kërkohet më legalizimi i certifikatave pranë autoriteteve konsullore, por të njihen si të vlefshme të gjitha ato certifikata që kanë të ashtuquajturën apostille të vënë nga autoritetet e vendit që kanë lëshuar dokumentin.
Në bazë të Konventes se Hages, dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren direkt në institucionin përkatës (Gjendje civile, gjykatë, institucion arsimor, etj.) të vendit prites.
Në Shqipëri është në përdorim nga viti 2004
Bazuar në marrëveshjet me autoritetet e vendeve respektive Itali, Belgjikë, Austri, Kuvajt përkthimi/noterizimi i dokumentave në vend, në gjuhën e shtetit ku do të përdoret merret i mirëqenë pas legalizim/ apostilimit nga MEPJ.

LIGJ

Nr. 9095, datë 3.7.2003

PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit të jashtëm, i organizimit, bashkërendimit dhe funksionimit të organeve, që ushtrojnë shërbimin e jashtëm dhe i statusit të diplomatëve.

Neni 2
Baza juridike e veprimtarisë së organeve të shërbimit të jashtëm

Organet që ushtrojnë shërbimin e jashtëm janë:
Ministria e Punëve të Jashtme dhe strukturat e tjera në varësi të saj, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionet e shërbimit të jashtëm në përputhje me Kushtetutën, me këtë ligj dhe me aktet normative të nxjerra në zbatim të tij, bazuar në programin e Qeverisë dhe orientimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

1. Ministria e Punëve të Jashtme, brenda detyrave dhe përgjegjësive të veta, njofton Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme.
2. Ministria e Punëve të Jashtme i propozon Këshillit të Ministrave të paraqesë përpara Kuvendit çështje të rëndësishme të politikës së jashtme, për të cilat është e nevojshme që të mbahet qëndrim nga Kuvendi.

Neni 4
Bashkëpunimi me Presidentin e Republikës

Ministria e Punëve të Jashtme, brenda detyrave dhe përgjegjësive të veta, njofton Presidentin e Republikës për çështjet e rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe, me kërkesë të Presidentit të Republikës ose me nismën e vet, jep mendime dhe bën propozime për veprimtaritë ndërkombëtare, që kryhen nga Presidenti i Republikës.

Neni 5
Bashkëpunimi me institucionet e tjera

1. Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor ushtrojnë funksione të marrëdhënieve me jashtë brenda fushës së veprimtarisë së tyre. Në ushtrimin e këtyre funksioneve ato veprojnë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe e njoftojnë atë për çdo veprimtari.
2. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet përkatëse, që përcaktojnë rregullat për ushtrimin e funksioneve të marrëdhënieve me jashtë të institucioneve të tjera dhe marrëdhëniet e tyre me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

PJESA E DYTË
INSTITUCIONET E SHËRBIMIT TË JASHTËM

KREU I
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Neni 6
Funksionet e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar. Veçanërisht, Ministria e Punëve të Jashtme realizon:

a) shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;
b) përgatitjen e të dhënave, raporteve ose rekomandimeve për Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Presidentin e Republikës,

si dhe për institucionet e tjera shtetërore, për përcaktimin e qëndrimeve dhe marrjen e masave të nevojshme për çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë;

c) mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, me banim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë vendit dhe të të drejtave të njohura ndërkombëtare, të komuniteteve shqiptare në vende të ndryshme, në bashkëpunim me organet e tjera përgjegjëse;

ç) komunikimin me përfaqësitë diplomatike e konsullore të shteteve të tjera, si dhe me misionet e organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me praktikën diplomatike;

d) depozitimin e marrëveshjeve origjinale ndërkombëtare, të lidhura në emër të shtetit dhe të Qeverisë Shqiptare;

dh) përpunimin, ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë së shërbimit të jashtëm;

e) të gjitha detyrat e tjera që rrjedhin nga përcaktimet e këtij ligji ose aktet e tjera normative.

Neni 7

Drejtimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme drejtohet nga Ministri i Punëve të Jashtme, i cili, në ushtrimin e funksioneve, ndihmohet nga zëvendësministri/at i/e Punëve të Jashtme dhe Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Ministrie.

Neni 8

Ministri i Punëve të Jashtme

1. Ministri i Punëve të Jashtme drejton dhe përfaqëson shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.
2. Në përmbushjen e funksioneve, Ministri i Punëve të Jashtme siguron zbatimin e programit të Këshillit të Ministrave për politikën e jashtme dhe, në bazë të këtij programi, harton dhe përpunon objektivat politikë të Ministrisë që ai drejton.

Neni 9

Zëvendësministri/at i/e Punëve të Jashtme

1. Zëvendësministri/at e Punëve të Jashtme ndihmojnë Ministrin e Punëve të Jashtme në drejtimin e Ministrisë dhe zbatimin e programit të Këshillit të Ministrave.
2. Qëllimi i punës së tij/tyre është t'i sigurojë/sigurojnë Ministrit bashkëpunim e këshillim politik për çështje të caktuara të politikës së jashtme, sipas detyrave të ngarkuara prej tij.

Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i shërbimit të jashtëm.
2. Sekretari i Përgjithshëm ndihmon Ministrin në hartimin dhe përpunimin e objektivave diplomatikë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, bashkërendon punën e njësive të brendshme të Ministrisë dhe të përfaqësive diplomatike jashtë vendit, si dhe siguron vazhdimësinë e veprimtarisë në Ministri.
3. Ai caktohet në këtë post nga radhët e diplomatëve me gradën ambasador, me konkurrim të hapur.

Neni 11

Struktura e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Veprimtaria e shërbimit me jashtë në Ministrinë e Punëve të Jashtme kryhet nëpërmjet strukturave të saj, të cilat krijohen dhe funksionojnë sipas drejtimeve dhe objektivave të caktuar për realizimin e politikës së jashtme.

Neni 12

Protokolli i Shtetit

1. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme funksionon zyra e Protokollit të Shtetit, e cila ka për detyrë:
   a) organizimin dhe realizimin e të gjithë veprimtarisë kryesore protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme për të gjithë veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë vendit;

b) bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të larta qendrore;
c) bashkërendimin dhe zbatimin e programit të vizitave të delegacioneve të huaja të nivelit të lartë.

2. Veprimtaria e zyrës së Protokollit të Shtetit rregullohet me akte të veçanta ligjore ose nënligjore.

Neni 13
Edukimi dhe formimi profesional

Për edukimin dhe formimin profesional të diplomatëve, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme ngrihet Akademia Diplomatike, funksionimi i së cilës rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II
PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE JASHTË VENDIT

Neni 14
Kategoritë e përfaqësive diplomatike

1. Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit janë:
   a) misionet diplomatike;
   b) postet konsullore.
2. Në misionet diplomatike bëjnë pjesë ambasadat dhe misionet e përhershme në organizatat ndërkombëtare, ndërsa në postet konsullore bëjnë pjesë konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore.

Neni 15
Hapja dhe mbyllja e përfaqësive diplomatike

1. Përfaqësitë diplomatike hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të Ministrit të Punëve të Jashtme.
2. Mënyra e funksionimit, struktura dhe numri i punonjësve të përfaqësive diplomatike përcaktohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Neni 16
Funksionet e misionit diplomatik

1. Misioni diplomatik i Republikës së Shqipërisë ushtron funksionet në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, me këtë ligj dhe me akte të tjera në zbatim të tij. Misioni diplomatik ka këto funksione kryesore:
   a) të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në shtetin pritës ose në organizatat ndërkombëtare;
   b) të mbrojë në shtetin pritës interesat e Republikës së Shqipërisë dhe të shtetasve ose personave juridikë të saj, brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare;
   c) të nxisë zhvillimin e marrëdhënieve politike, ekonomike, kulturore, arsimore, shkencore, teknologjike, të informacionit, diplomatiko-konsullore dhe në çdo fushë tjetër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit pritës, në një frymë miqësore e bashkëpunimi;
   ç) t'i japë të dhëna Ministrisë së Punëve të Jashtme për zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale të shtetit pritës dhe për veprimtarinë e organizatave ndërkombëtare, pranë të cilave është akredituar;
   d) të bashkëpunojë me delegacionet e Republikës së Shqipërisë në bisedimet që zhvillohen në shtetin pritës dhe të marrë pjesë në bisedime me qeverinë e shtetit pritës në përgatitjen për nënshkrim të marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe në veprimtarinë e konferencave ndërkombëtare.
2. Misioni diplomatik kryen edhe funksione ose veprimtari të tjera, për të cilat autorizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera normative.

Neni 17
Kryerja e funksioneve konsullore

Misioni diplomatik kryen edhe funksione konsullore në shtetin pritës. Nëse ka poste konsullore të Republikës së Shqipërisë në të njëjtin shtet, misioni kryen funksione konsullore në atë pjesë të territorit që nuk përfshihet në juridiksionin e postit konsullor. Funksionet konsullore ushtrohen nga një diplomat i misionit diplomatik, i ngarkuar për veprimtarinë konsullore, me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, në përputhje me ligjin

nr. 8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore" dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 18

Funksionet e postit konsullor

1. Posti konsullor ushtron funksionet në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, me këtë ligj, me ligjin nr. 8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore", si dhe me akte të tjera normative.
2. Funksionet kryesore të postit konsullor janë:
   a) të mbrojë interesat e Republikës së Shqipërisë, të shtetasve ose personave juridikë të saj, të cilët ndodhen në zonën e tij të juridiksionit konsullor, brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare në shtetin pritës;
   b) të punojë për zhvillimin e marrëdhënieve me shtetin pritës në fushat e ekonomisë, tregtisë, kulturës, shkencës dhe informacionit;
   c) t'i japë të dhëna Ministrisë së Punëve të Jashtme për zhvillimet ekonomike, tregtare, kulturore e shkencore në shtetin pritës;
   ç) të njoftojë organet përkatëse të shtetit pritës, në zonën e tij konsullore, për kushtet dhe gjendjen ekonomike, tregtare, kulturore e shkencore në Republikën e Shqipërisë.
3. Posti konsullor kryen edhe funksione ose veprimtari të tjera, për të cilat autorizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, në mbështetje të akteve normative, të cilat:
   a) nuk janë të ndaluara me ligj ose me ndonjë akt tjetër në shtetin pritës;
   b) shteti pritës nuk i kundërshton;
   c) parashikohen në marrëveshjet ndërkombëtare, në fuqi, ndërmjet shtetit tonë dhe shtetit pritës.

Neni 19

Misioni special

1. Misioni special është një mision i përkohshëm, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë në një shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare, me pëlqimin e tyre, për të negociuar ose kryer detyra të posaçme.

2. Mënyra e krijimit, përbërja dhe funksionet e misionit special përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 20

Personeli i përfaqësive diplomatike

1. Personeli i përfaqësive diplomatike përbëhet nga diplomatët dhe nga stafi administrativ e teknik.
2. Në personelin e përfaqësive diplomatike mund të përfshihen edhe nëpunës, të emëruar nga Ministri i Punëve të Jashtme, në bazë të një marrëveshjeje me shkrim, të arritur me institucionet e tjera, për të kryer detyra në fushën ekonomike, kulturore, shkencore e të mbrojtjes dhe në çdo fushë tjetër për një kohë të përcaktuar. Gjatë kohës së shërbimit në përfaqësinë diplomatike, këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me diplomatët dhe pas përfundimit të këtij shërbimi rikthehen në pozicionin e mëparshëm, duke rifituar statusin që kanë pasur ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Neni 21

Shefi i përfaqësisë diplomatike

1. Misioni diplomatik drejtohet nga ambasadori ose i ngarkuari me punë.
2. Ambasadorët emërohen dhe lirohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryeministrit. Ministri i Punëve të Jashtme i paraqet Kryeministrit propozimet përkatëse për emërimin dhe lirimin e ambasadorëve.
   Përpara emërimit të ambasadorit nga Presidenti i Republikës, Komisioni i Kuvendit që mbulon politikën e jashtme, organizon seancë dëgjimore me kandidatin për t'u emëruar ambasador.
3. Ministri i Punëve të Jashtme mund t'i besojë drejtimin e misionit diplomatik të ngarkuarit me punë, kur kjo çmohet e nevojshme për shkak të rrethanave.
4. Posti konsullor drejtohet nga konsulli i përgjithshëm, konsulli, zëvendëskonsulli ose agjenti konsullor.
5. Konsulli i përgjithshëm emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 22

Përzgjedhja e shefave të përfaqësive diplomatike

1. Shefat e përfaqësive diplomatike përzgjidhen ndërmjet diplomatëve të karrierës.
2. Në këto poste mund të emërohen edhe ish-anëtarë të Këshillit të Ministrave, ish-deputetë, personalitete të fushave të ndryshme, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
3. Numri i personave të emëruar, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk duhet të jetë më i lartë se 20 për qind e numrit të diplomatëve, që punojnë në përfaqësitë diplomatike me të njëjtin funksion. Këta persona bëjnë pjesë në shërbimin e jashtëm për aq kohë sa ushtrojnë funksionet në të cilat janë emëruar.

Neni 23

Funksionet e shefit të misionit diplomatik

1. Shefi i misionit diplomatik, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, ushtron këto funksione kryesore:
   a) përfaqëson dhe vepron në emër të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës ose organizatat ndërkombëtare;
   b) inicion dhe nënshkruan instrumente diplomatike;
   c) jep deklarata dhe mban qëndrime në emër të Republikës së Shqipërisë.
2. Shefi i misionit ka autoritet mbi të gjitha shërbimet, civile dhe ushtarake, që ushtrojnë veprimtarinë në misionin diplomatik. Ai drejton, udhëzon, kontrollon dhe vlerëson të gjithë veprimtarinë zyrtare të personelit të misionit diplomatik, si dhe kryen veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.
3. Shefi i misionit përgjigjet drejtpërdrejt përpara Ministrit të Punëve të Jashtme për zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës dhe vepron në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e dhëna nga ky ligj, si dhe me drejtimet e udhëzimet e dhëna nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
4. Shefi i misionit bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës.

Neni 24

Akreditimi në disa vende

1. Një ambasador në një shtet mund të akreditohet edhe në një ose disa shtete të tjera, pavarësisht nëse ka mision diplomatik ose post konsullor në këto shtete.
2. Shefi i misionit diplomatik dhe diplomatët e tjerë, të akredituar në disa shtete në të njëjtën kohë, kryejnë në shtetet e tjera të njëjtat funksione, që kryejnë në shtetin ku janë rezidentë.
3. Në shtetet ku nuk ka përfaqësi diplomatike, mund të emërohen si ambasadorë jorezidentë diplomatët me gradën ambasador, që punojnë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ata kryejnë të njëjtat funksione përfaqësimi si ambasadorët rezidentë.

PJESA E TRETË
NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË JASHTËM

KREU I
STATUSI I NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 25

Kategorizimi i nëpunësve

1. Veprimtaria diplomatike në shërbimin e jashtëm kryhet nga diplomatët e karrierës dhe personat e tjerë të barazuar me ta, të cilët marrin funksione diplomatike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Në ushtrimin e funksioneve, ata ndihmohen nga personeli administrativ dhe teknik.

Neni 26

Diplomatët

Diplomati merr funksione dhe kryen detyra në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën, me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 27

Kërkesat për pranimin në shërbimin e jashtëm

Në shërbimin e jashtëm pranohen personat, të cilët plotësojnë, veçanërisht, këto kërkesa:

a) të kenë shtetësi shqiptare dhe banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
b) të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
c) të mos jenë dënuar për kryerjen e një vepre penale;
ç) të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna nga administrata publike;
d) të jenë në kushte të mira shëndetësore për të kryer detyrën;
dh) të kenë përfunduar studimet e larta në një institucion arsimor, brenda ose jashtë vendit, të njohur nga shteti;
e) të zotërojnë gjuhë të huaj të pranueshme dhe të përshtatshme për punën në shërbimin e jashtëm.

Neni 28
Pranimi

Pranimi në shërbimin e jashtëm bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Gjithashtu, periudha e provës së nëpunësit u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 29
Transferimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë

1. Transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë e nëpunësit, brenda shërbimit të jashtëm, bëhen me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe njoftimit të Departamentit të Administratës Publike. Në çdo rast, propozimi shoqërohet dhe mbështetet në vlerësimin e punës, të paraqitur nga eprori direkt i nëpunësit.
2. Procedurat e kryerjes së transferimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 30
Emërimi në përfaqësitë diplomatike

1. Diplomatët emërohen në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në shtete të tjera, të paktën dy vjet pasi kanë marrë gradën e parë diplomatike (atashe). Ata qëndrojnë me shërbim në të njëjtën përfaqësi diplomatike, si rregull, për një periudhe 4-vjeçare.
2. Procedurat e emërimit në përfaqësitë diplomatike përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 31
Kthimi ose tërheqja e parakohshme nga përfaqësitë diplomatike

1. Ministri i Punëve të Jashtme urdhëron kthimin ose tërheqjen e një diplomati nga përfaqësia diplomatike, përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsyet e mëposhtme:
   për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme;
   b) në bazë të kërkesës së vetë diplomatit;
   c) për arsye të vlerësimit negativ të punës së diplomatit;
   ç) për shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera në fuqi;
   d) kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pritës.
2. Tërheqja e parakohshme e shefit të përfaqësisë diplomatike kryhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji.

Neni 32
Pezullimi i nëpunësit të shërbimit të jashtëm

1. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm pezullohet nga ushtrimi i funksioneve të tij:
   a) kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar;
   b) për periudha studimi, më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë nëpunësit, por me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, të cilat kanë lidhje me profesionin që ai ushtron.
2. Gjatë periudhës së pezullimit, nëpunësi i shërbimit të jashtëm nuk paguhet.
3. Në rastin e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, nëpunësi rikthehet në shërbimin e jashtëm dhe, njëkohësisht, rifiton statusin, pagën dhe çdo të drejtë tjetër, që nga çasti i pezullimit.
4. Për rastin e parashikuar në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, periudha e pezullimit merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor, të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike.

Neni 33
Humbja e statusit në shërbimin e jashtëm

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm humbet statusin në këtë shërbim kur:
a) largohet në mënyrë vullnetare nga shërbimi i jashtëm;

b) për shkak të vdekjes së vetë nëpunësit;
c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
ç) kryen shkelje të rënda, të parashikuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për të cilat ndaj tij merret masa e largimit nga puna.

Neni 34
Punësimi jashtë Ministrisë së Punëve të Jashtme

1. Një diplomat mund të punësohet në institucione të tjera të administratës shtetërore, për të kryer detyra drejtuese ose këshilluese në fushën e marrëdhënieve me jashtë, me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme. Periudha e punësimit në këtë detyrë merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor, të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike.
2. Me mbarimin e detyrës në institucionin përkatës ose me kërkesë të tij, diplomati ka të drejtë të kthehet në shërbimin e jashtëm.

KREU II
GRADAT

Neni 35
Gradat diplomatike dhe konsullore

1. Diplomatët e karrierës, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësitë diplomatike, marrin grada diplomatike ose konsullore.
2. Gradat diplomatike në shërbimin e jashtëm janë:
   a) ambasador;
   b) ministër fuqiplotë;
   c) ministër këshilltar;
   ç) këshilltar;
   d) sekretar i parë ;
   dh) sekretar i dytë;
   e) sekretar i tretë;
   ë) atashe.

3. Gradat konsullore në shërbimin e jashtëm janë:
   a) konsull i përgjithshëm;
   b) konsull;
   c) zëvendëskonsull;
   ç) agjent konsullor.

Neni 36
Barasvlera e gradave

Diplomatët mund të kalojnë nga një gradë diplomatike në një gradë konsullore, në përputhje me funksionet dhe detyrat e ngarkuara. Në çdo rast, kalimi bëhet duke respektuar barazvlerën e gradave, e cila është:

konsull i përgjithshëm	ministër këshilltar;
konsull	sekretar i parë ose i dytë;
zëvendëskonsullsekretar i dytë ose i tretë;	agjent konsullorsekretar i tretë ose atashe.

Neni 37
Dhënia e gradave

1. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, sipas sistemit të karrierës, gradohen duke i ngjitur shkallët një nga një. Elementet kryesore në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës.
2. Gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.
3. Grada diplomatike ambasador propozohet nga Ministri i Punëve të Jashtme, miratohet nga Kryeministri dhe dekretohet nga Presidenti i Republikës.
4. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, që përfitojnë gradën ambasador, duhet të jenë diplomatë karriere, të cilët kanë kaluar të gjitha shkallët e gradave, të përcaktuara sipas këtij ligji dhe që kanë qenë të emëruar në detyrën e shefit të misionit të paktën për një mandat.

Neni 38
Periudha për kalimin nga një gradë në tjetrën

1. Periudha minimale për kalimin e diplomatit nga një gradë në një tjetër më të lartë, pas përfundimit të periudhës së provës, është:

a) nga atashe në sekretar i tretë, 2 vjet;
b) nga sekretar i tretë në sekretar i dytë, 3 vjet;
c) nga sekretar i dytë në sekretar i parë, 3 vjet;
ç) nga sekretar i parë në këshilltar, 4 vjet;

2. Kriteret për përfitimin e gradës ministër këshilltar dhe ministër fuqiplotë përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

PJESA E KATËRT
TË DREJTAT DHE DETYRAT E NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 39
Të drejtat

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka të drejtë:

a) të gëzojë statusin e diplomatit;
b) të përfitojë gradë në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë;
c) të mbajë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme ose në përfaqësitë diplomatike, në përputhje me nivelin profesional dhe gradën që gëzon;
ç) të përfitojë nga imunitetet dhe lehtësitë, që i jep statusi i diplomatit, në përputhje me aktet dhe të drejtën ndërkombëtare në periudhën kur ndodhet me shërbim jashtë shtetit;
d) të përfitojë nga kualifikimet dhe trajnimet e kryera nga Ministria e Punëve të Jashtme;
dh) të përfitojë trajtim financiar të posaçëm, në përputhje me statusin e tij;
e) të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera, të njohura në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 40
Detyrat

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka për detyrë:

a) të ushtrojë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me urdhrat, udhëzimet e rregulloret e

Ministrit të Punëve të Jashtme, aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionin shqiptar;
b) të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe të vendimeve që zbaton, të njoftojë nivelet urdhërdhënëse dhe nivelet eprore të këtyre të fundit;
c) të mbrojë interesat e shtetit dhe të shtetasve ose personave juridikë shqiptarë në shtetin ose shtetet, ku është akredituar dhe kryen funksionet e tij;
ç) të zbatojë rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të sigurojë ruajtjen e të dhënave dhe të informatave që i janë besuar;
d) të mos bëjë pjesë në asnjë parti, organizatë ose shoqatë politike;
dh) të mbajë, në të gjitha rrethanat, një qëndrim moral të denjë dhe të paqortueshëm;
e) të mos bëjë deklarata që mund të vënë në pozitë të vështirë shtetin shqiptar në marrëdhënie me shtetet e tjera ose organizatat ndërkombëtare dhe që mund të krijojnë probleme në realizimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë;
ë) të respektojë ligjet e shtetit ose të shteteve, ku është akredituar, dhe të mos përfshihet në veprimtari, të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku zhvillon veprimtarinë;
f) të ushtrojë veprimtarinë e vet në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i trupit diplomatik;
g) të mos ushtrojë në shtetin ose shtetet, ku është akredituar, veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të të afërmve të tij.

Neni 41
Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës

1. Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë:
   a) dhënien e gradave diplomatike për nëpunësit e shërbimit të jashtëm;
   b) shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm, ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori direkt i tyre;

c) shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda, të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin te Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit, që kanë kryer këto shkelje.

2. Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe tre diplomatë me gradën më të lartë.
3. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e Komisionit të Gradave dhe të Disiplinës përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

KREU II
SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 42
Përgjegjësia disiplinore

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm përgjigjet për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit dhe realizimit të detyrave të ngarkuara. Shkalla e përgjegjësisë lidhet me llojin e shkeljes së kryer dhe pasojat e ardhura.

Neni 43
Llojet e shkeljeve

1. Për nëpunësin e shërbimit të jashtëm vlerësohen, veçanërisht, si shkelje:
   a) veprimet ose mosveprimet, të cilat cenojnë imazhin e Republikës së Shqipërisë dhe të shërbimit të jashtëm;
   b) moskryrerja e detyrave të ngarkuara pa shkaqe të arsyeshme;
   c) veprimet që cenojnë figurën etiko-morale të nëpunësit të shërbimit të jashtëm;
   ç) dëmtimi i pasurisë shtetërore ose krijimi i mundësive për një dëmtim të tillë;
   d) shkelja e akteve ligjore e nënligjore në tërësi dhe atyre që rregullojnë veprimtarinë e shërbimit të jashtëm, në veçanti.
2. Kategorizimi i shkeljeve të kryera nga nëpunësi i shërbimit të jashtëm përcaktohet në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 44
Masat disiplinore

1. Për shkeljet e kryera nga nëpunësi i shërbimit të jashtëm, gjatë ushtrimit ose në funksion të detyrës, ndaj tij merren masa disiplinore. Procedura e shqyrtimit të shkeljes dhe e dhënies së masës disiplinore garanton të drejtën e informimit, dëgjimit dhe të mbrojtjes.
2. Për shkeljet e lehta të kryera nga nëpunësi i shërbimit të jashtëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, masa disiplinore jepet nga eprori direkt, kurse për nëpunësin e përfaqësisë diplomatike masa disiplinore jepet nga shefi i përfaqësisë diplomatike. Për shkeljet e rënda, masa disiplinore jepet nga Ministri i Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Komisionit të Gradave dhe të Disiplinës.
3. Për masat disiplinore të marra ndaj tij, nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Shërbimit Civil, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999 «Statusi i nëpunësit civil».
4. Llojet e masave disiplinore dhe procedura për dhënien e tyre përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

PJESA E PESTË
TRAJTIMI FINANCIAR I PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 45
Pagat e punonjësve të shërbimit të jashtëm

1. Pagat e punonjësve të shërbimit të jashtëm caktohen në bazë të funksionit, gradave dhe vjetërsisë në punë.
2. Pagat caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46
Trajtimi i familjeve të personelit të përfaqësive diplomatike

1. Për personelin e përfaqësive diplomatike, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë dhe të pagesës së kontributit të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, edhe bashkëshortit/es, i/e cili/a shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike.
   Fëmijët e personelit të përfaqësive diplomatike përfitojnë sigurimet shëndetësore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Bashkeshorti/ja, që në kohën e emërimit të diplomatit jashtë shtetit ka punuar në një institucion shtetëror, ka të drejtë të kthehet në këtë vend pune pas kthimit të bashkëshortit/es në atdhe. Institucioni shtetëror ku bashkëshorti/ja ka qenë i/e punësuar, ka detyrimin ta rimarrë në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion të barasvlefshëm.
3. Ministria e Punëve të Jashtme garanton arsimimin tetëvjeçar dhe të mesëm të fëmijëve të personelit, të emëruar në përfaqësinë diplomatike dhe kur është e nevojshme, siguron financimin e këtij arsimimi. Mënyra, kriteret dhe kushtet e financimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA E GJASHTË
NËPUNËSIT ADMINISTRATIVË DHE PERSONELI NDIHMËS

Neni 47

Statusi i nëpunësve administrativë dhe i personelit ndihmës

1. Nëpunës administrativë në shërbimin e jashtëm quhen nëpunësit, të cilët kryejnë detyra në sektorët e llogarisë dhe të financës, në fushën e përpunimit të të dhënave dhe në çështje administrative. Për këta nëpunës zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.
2. Personel ndihmës në shërbimin e jashtëm quhet ajo kategori punonjësish, të cilët kryejnë detyra në sektorët ndihmës, të mirëmbajtjes dhe të shërbimit. Për këtë kategori punonjësish zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

Neni 48
Rekrutimi i stafit vendor

Përfaqësitë diplomatike mund të punësojnë shtetas të shtetit pritës, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për kryerjen e punëve administrativo-teknike dhe të shërbimit.

PJESA E SHTATË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 2, 12 pika 2, 13, 45 pika 2 dhe 46 pika 3 të këtij ligji.
2. Ministria e Punëve të Jashtme, brenda 3 muajve nga miratimi i këtij ligji, përgatit Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Rregullorja miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50
Shfuqizime

Ligji nr. 8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 51
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr. 3909, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ

Nr. 8372, datë 9.7.1998

PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE KONSULLORE NGA PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE OSE KONSULLORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", bazuar në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, datë 10.4.1961; në Konventen e Vjenës për marrëdhëniet konsullore, datë 24.4.1963; në normat e tjera përkatëse ndërkombëtare dhe të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. VEPRIMTARIA KONSULLORE E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE OSE KONSULLORE

Neni 1
Detyrat e përgjithshme të përfaqësisë diplomatike ose konsullore në veprimtarinë e tyre konsullore

1. Përfaqësitë diplomatike a konsullore në veprimtarinë e tyre konsullore mbështetin bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit pritës, duke synuar zgjerimin e lidhjeve në fushën e ekonomisë, përparimit, transportit, kulturës, shkencës dhe të së drejtës.
2. Përfaqësitë diplomatike a konsullore në veprimtarinë e tyre konsullore mbrojnë interesat dhe të drejtat e shtetasve shqiptarë në vendin pritës, të cilat burojnë nga normat e ligjet ndërkombëtare e të shtetit pritës dhe i ofrojnë atyre ndihmë këshillimore e juridike, kur kërkohet dhe për sa është e mundur.
3. Përfaqësitë diplomatike a konsullore, në veprimtarinë e tyre konsullore, për sa lejojnë kompetencat, kontrollojnë zbatimin e konventave, të traktateve e marrëveshjeve dy a shumëpalëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë dhe shteti pritës.
4. Përfaqësitë diplomatike a konsullore, në veprimtarinë e tyre konsullore mbështesin forcimin e lidhjeve dhe të bashkëpunimit ndërmjet diasporës shqiptare dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufime

Me "post konsullor" nënkuptohet përfaqësia ose zyra konsullore, pra sipas rastit konsullata e përgjithshme, konsullata, nënkonsullata, agjencia konsullore a sektori konsullor (konsullorja) në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Me "drejtues të postit konsullor" nënkuptohet titullari i përfaqësisë a zyrës konsullore, pra sipas rastit konsulli i përgjithshëm, konsulli, nenkonsulli, drejtuesi i agjencisë konsullore ose i sektorit konsullor në përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë.

Me "nëpunës konsullor" nënkuptohet nëpunësi i emëruar në një post konsullor, i ngarkuar me funksione konsullore.

Me "vend/shtet pritës" nënkuptohet vendi/shteti ku është akreditуar drejtuesi i postit konsullor.

Me "rreth juridiksioni" nënkuptohet territori në vendin/shtetin pritës ku drejtuesi i postit konsullor është i autorizuar të kryeje veprimtarinë konsullore.

II. NORMA TË PËRGJITHSHME, KOMPETENCAT DHE DETYRAT KONSULLORE

Neni 3
Ushtrimi i kompetencave konsullore

1. Funksionet konsullore në postin konsullor i ushtron drejtuesi i postit konsullor, i cili mund të jetë konsulli i përgjithshëm (drejtuesi i konsullatës së përgjithshme), konsulli (drejtuesi i konsullatës), nënkonsulli (drejtuesi i nënkonsullatës), drejtuesi i agjencisë konsullore ose drejtuesi i sektorit konsullor (konsullorës) të përfaqësisë diplomatike. Drejtuesi i postit konsullor i ushtron funksionet konsullore në rrethin e juridiksionit, i cili mund të përfshij të gjithë territorin e shtetit pritës ose një pjesë të tij.
2. Funksionet konsullore, që ushtron drejtuesi i postit konsullor, rrjedhin nga kompetencat konsullore, me të cilat është pajisur posti konsullor me këtë ligj.

3. Drejtuesi i postit konsullor mund t'ia delegojë kompetencat e tij nëpunësve konsullorë me kualifikimin e nevojshëm në postin konsullor, duke marrë për këtë miratimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në përfaqësitë diplomatike, në të cilat nuk funksionon ende sektori konsullor (konsullorja), me miratimin paraprak të Ministrit të Punëve të Jashtme, funksionet konsullore mund t'i ushtrojë një anëtar i shërbimit diplomatik.
4. Me urdher të veçantë të Ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuesi i postit konsullor mund të ushtrojë funksionet konsullore që i janë ngarkuar edhe jashtë rrethit të juridiksionit.
   Për këtë ai duhet të marrë më parë pëlqimin e shtetit pritës.
5. Drejtuesi i postit konsullor, në ushtrimin e funksioneve konsullore që i janë ngarkuar, varet nga Ministri i Punëve të Jashtme, nga i cili merr dhe udhëzimet e drejtpërdrejta. Mbi veprimtarinë e tij ushtron kontroll të drejtpërdrejtë titullari i përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin pritës.
6. Organizimi i posteve konsullore, si dhe të drejtat e detyrat e nëpunësve konsullorë përcaktohen nga normat dhe rregulloret përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
7. Në të gjitha rastet, kur në këtë ligj përmendet termi "shtetas shqiptar", rregulli përkatës ka vlerë dhe për personat juridikë shqiptarë, autoritetet a institucionet e tjera shqiptare, veç rasteve kur kjo përjashtohet shprehimisht.

Neni 4

Dhënia e ndihmës shtetasve shqiptarë, kur ata janë në vështirësi në vendin pritës

1. Drejtuesi i postit konsullor i ofron ndihmën e nevojshme shtetasve shqiptarë, që gjenden në rrethin e juridiksionit, nëse vështirësitë nuk mund të mënjanohen në një mënyrë tjetër. Kjo nuk vlen për shtetasit shqiptarë, të cilët njëkohësisht janë në zotërim dhe të shtetësisë së shtetit pritës; drejtuesi i postit konsullor mund t'i ofrojë ndihmë rrethit të personave të fundit, nëse për rastin konkret rrethanat e mundësojnë dhënien e ndihmës.
2. Lloji, forma dhe masa e ndihmës gjykohet nga drejtuesi i postit konsullor, duke pasur parasysh raportet e veçanta në shtetin pritës dhe nevojën për ndihmë nga shtetasi shqiptar. Në kuadrin e ndihmës përfshihet edhe sigurimi i këshillimit dhe i mbrojtjes ligjore.

3. Në raste ekstreme, kur është e domosdoshme ndihma financiare, ajo u bëhet e mundur shtetasve shqiptarë për udhëtimin për në një vend tjetër ose për t'u riatdhesuar, duke marrë paraprakisht miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në këto raste rikthimi i shpenzimeve të kryera është i domosdoshëm. Ky detyrim shtrihet deri tek familjarët, të afërmit ose prek trashëgiminë e personit që ka kërkuar ndihmë.

Neni 5

Dhënia e ndihmës shtetasve shqiptarë në raste katastrofash apo zhvillimesh politike të dhunshme në vendin pritës

1. Në rastet kur në vendin pritës ndodhin katastrofa natyrore, zhvillime politike, luftarake e revolucionare ose ngjarje të tilla të tjera që rrezikojnë ose dëmtojnë popullsinë në vendin pritës apo pjesë të saj, drejtuesi i postit konsullor duhet të marrë masat e nevojshme për t'i ardhur në ndihmë e për të marrë në mbrojtje shtetasit shqiptarë të rrezikuar a të dëmtuar. Kjo vlen edhe për familjarët e shtetasve shqiptarë që nuk janë shtetas shqiptarë.
2. Drejtuesi i postit konsullor disponon një listë, ku përmbahen të dhënat e nevojshme për shtetasit shqiptarë me banim në rrethin e juridiksionit dhe të autoriteteve ose institucioneve vendase, që ofrojnë ndihmë në raste katastrofash.

Neni 6

Ndihma për të burgosurit, përfaqësimi i shtetasve shqiptarë në organet gjyqësore të shtetit pritës

1. Drejtuesi i postit konsullor jep ndihmë dhe kujdeset për shtetasit shqiptarë të burgosur, në hetime ose të dënuar me heqje lirie në vendin pritës, nëse kjo nuk është kundër dëshirës së tyre. Drejtuesi i postit konsullor ndërhyn pranë autoriteteve përkatëse të shtetit pritës, kur vihet re se këtij rrethi të shtetasve shqiptarë nuk i janë garantuar të drejtat që u takojnë në përputhje me normat e ligjet ndërkombëtare dhe të shtetit pritës. Në veçanti shtetasve shqiptarë të burgosur drejtuesi i postit konsullor u siguron ndihmë në aspektin e mbrojtjes ligjore. Këtu përfshihet edhe rekomandimi i avokatëve mbrojtës të licencuar në vendin pritës për përfaqësimin e interesave të shtetasve shqiptarë në organet gjyqësore të shtetit pritës.

2. Drejtuesi i postit konsullor, pa shkelur normat e ligjet ndërkombëtare dhe ato të vendit pritës, u drejtohet organeve gjyqësore dhe autoriteteve të tjera të shtetit pritës për të marrë informacion për arsyet e ndalimit ose të arrestimit të shtetasve shqiptarë në rrethin e juridiksionit, veçanërisht për akuzat që u janë ngritur atyre. Nëse është e nevojshme, drejtuesi i postit konsullor mund të vizitojë shtetasit shqiptarë të ndaluar ose të arrestuar në rrethin e juridiksionit.
3. Drejtuesi i postit konsullor përfaqëson ose merr masat e nevojshme për garantimin e përfaqësimit të shtetasve shqiptarë para organeve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të shtetit pritës në rrethin e juridiksionit, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e atyre shtetasve shqiptarë që e kanë të pamundur të jenë të pranishëm a të ngarkojnë persona të tjerë. Drejtuesi i postit konsullor e merr përsipër këtë përfaqësim me dëshirën e shtetasve shqiptarë të interesuar dhe u bën të ditur këtyre të fundit rezultatet e përfaqësimit.

Neni 7

Ndihma për transportin e shtetasve shqiptarë që kanë vdekur në vendin pritës

1. Nëse nuk ekzistojnë mundësi të tjera, drejtuesi i postit konsullor merr masat e nevojshme për kryerjen e identifikimit, kur është e nevojshme, dhe për të lajmëruar familjarët e shtetasve shqiptarë që kanë vdekur në vendin pritës. Në qoftë se, në përputhje me dëshirën e të ndjerit/ndjerës apo dhe të familjarëve, do të kryhet transporti i trupit të shtetasve shqiptarë për në atdhe, drejtuesi i postit konsullor ndihmon familjarët në problemet e mundshme me dokumentacionin dhe planifikimin e transportit.
2. Kur familjarët e shtetasve shqiptarë ende nuk janë paraqitur dhe nuk ka mundësi të tjera, drejtuesi i postit konsullor merr masat e nevojshme për sigurimin e pasurisë ose sendeve të tjera që kanë lënë shtetasit shqiptarë të vdekur.
3. Në qoftë se trashëgimtarët e të ndjerit nuk mund të gjenden dhe kur ka kaluar një periudhë kohore e gjatë pas sigurimit të pasurisë së lënë nga shtetasit shqiptarë, drejtuesi i postit konsullor merr masat e nevojshme për t'ua përcjellë këtë pasuri organeve përkatëse shqiptare.

Neni 8

Ndihma për mbrojtjen e interesave pasurore dhe trashëgimore të shtetasve shqiptarë

1. Drejtuesi i postit konsullor ndihmon dhe interesohet për mbrojtjen e interesave pasurore të shtetasve shqiptarë, që banojnë në rrethin e juridiksionit. Ai u siguron atyre përkrahje dhe ndihmë këshillmore, kur u shkelen interesat e kësaj natyre.
2. Drejtuesi i postit konsullor ndihmon dhe interesohet për kthimin e pasurive e trashëgimive, për marrjen e pensioneve, të sigurimeve etj. shtetasve shqiptarë që nuk banojnë në rrethin e juridiksionit. Ai përfaqëson shtetasit shqiptarë, kur ata nuk e kanë të mundur të jenë vetë të pranishëm ose të ngarkojnë persona të tjerë pranë të gjitha autoriteteve të vendit pritës për mbrojtjen e interesave pasurore të tyre, kur ata e kërkojnë këtë dhe ndihmon për sigurimin e ndihmës së nevojshme këshillimore ose juridike.
3. Drejtuesi i postit konsullor ndihmon dhe interesohet në çështjet e trashëgimive dhe pronësive të tjera që u përkasin pasardhësve të shtetasve shqiptarë. Në qoftë se nuk ka mundësi të tjera, drejtuesi i postit konsullor, në interes dhe në emër të pasardhësve të shtetasve shqiptarë, për sa i kërkohet nga të interesuarit, ndërmerr veprimet vijuese:
   a) Ua bën të njohura organeve gjyqësore ose autoriteteve të tjera të vendit pritës kërkesat dhe pretendimet në lidhje me trashëgimitë e pasardhësve të shtetasve shqiptarë.
   b) U kërkon organeve kompetente të shtetit pritës të informohet për testamentet, trashëgimitë e lëna dhe aspektet juridike në lidhje me trashëgimitë.
   c) U kërkon organeve kompetente të shtetit pritës sigurimin e trashëgimive, kur lind dyshimi i shpërdorimit të tyre apo humbjes së të drejtave të trashëgimisë.
   ç) U kërkon organeve gjyqësore, po të jetë e nevojshme, duke u paraqitur vetë në gjyq, që të pajiset me vendimin e gjykimit.
   d) Pranon në ruajtje dokumente të rëndësishme, mjete financiare e sende me vlerë për t'i përcjellë te trashëgimtarët e shtetasve shqiptarë.

III. DETYRA TË TJERA ADMINISTRATIVE, TË PËRPUNIMIT TË AKTEVE TË GJENDJES CIVILE E TË DOKUMENTACIONIT

Neni 9

Përpunimi i dokumentacionit në çështjet e shtetësisë

Drejtuesi i postit konsullor përpunon dokumentacionin në çështjet e marrjes e të lënies së nënshtetësisë shqiptarë.

Neni 10

Përpunimi i dokumentacionit për lëshimin e pasaportave e të vizave

1. Drejtuesi i postit konsullor përpunon dokumentacionin për lëshimin dhe veprimet me pasaportat dhe dokumentet e tjera, që garantojnë lëvizjen në kufi të shtetasve shqiptarë.
2. Drejtuesi i postit konsullor përpunon dokumentacionin për lëshimin dhe veprimet me vizat e llojeve të ndryshme për lëvizjen e qytetarëve të huaj në kufijtë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Kryerja e akteve të gjendjes civile. Regjistrimi i lindjeve, martesave dhe vdekjeve të shtetasve shqiptarë

1. Në postet konsullore të lejuara më parë me urdhrin përkatës të Ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuesi i postit konsullor merr përsipër funksione të nëpunësve të gjendjeve civile në mbajtjen dhe regjistrimin e akteve të gjendjes civile. Për të përmbushur këtë detyrë ai mban regjistrat përkatës të martesave, lindjeve dhe vdekjeve.
2. Drejtuesi i postit konsullor si në paragrafin 1:
   a) Lidh martesa, për sa të paktën njëri nga bashkëshortët është shtetas shqiptar dhe lëshon certifikata martesash. Lidhja e martesave nga drejtuesi i postit konsullor regjistrohet në regjistrin përkatës për martesat dhe njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme për të kryer veprimet e mëtejshme.
   b) Regjistron në regjistrin e martesave edhe martesat e shtetasve shqiptarë të lidhura nga autoritetet përkatëse të shtetit pritës, sipas ligjeve në fuqi, në bazë të certifikatave zyrtare.
   c) Lëshon lejen e marteses për shtetasit shqiptare, të parashikuar nga ligji përkatës i Republikës së Shqipërisë, për sa martesa do

   të lidhet në zyrat e gjendjes civile të shtetit pritës në rrethin e juridiksionit dhe njëri nga bashkëshortët është i huaj.
3. Drejtuesi i postit konsullor, si në paragrafin 1, bën regjistrimin e shtetasve shqiptarë të lindur në rrethin e juridiksionit në regjistrin e lindjeve, në bazë të certifikatave zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse vendase.
4. Në afate të caktuara aktet përkatëse të gjendjes civile të lindjeve, vdekjeve dhe martesave dërgohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme për t'ua përcjellë autoriteteve kompetente shqiptare.

Neni 12

Dokumentimi në përgjithësi

1. Drejtuesi i postit konsullor dokumenton fakte dhe procese që ndesh gjatë kryerjes së veprimtarisë konsullore, si dhe përpilon protokolle ose procesverbale.
2. Në veçanti drejtuesi i postit konsullor, me kërkesën e shtetasve shqiptarë:
   a) përpilon deklarata, autorizime, testamente, kontrata, garanci dhe prokura të thjeshta;
   b) vërteton zyrtarisht nënshkrime dhe shenja gishtërinjsh (duarsh);
   c) vërteton zyrtarisht ekstrakte, fragmente, dublikata dhe kopje dokumentesh.
3. Dokumentet e përpiluara nga drejtuesi i postit konsullor jane të barasvlefshme me ato të një noteri të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
4. Dokumentet, sipas kërkesës së të interesuarve, drejtuesi i postit konsullor mund t'i lëshojë edhe në një gjuhë të huaj. Në këtë rast ato nuk kanë nevojë të noterizohen.

Neni 13

Përkthimi i dokumenteve

1. Drejtuesi i postit konsullor bën përkthimin e dokumenteve dhe të akteve të tjera zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën e vendit pritës, ose në një gjuhë tjetër, dhe nga gjuha e vendit pritës, ose nga një gjuhë tjetër, në gjuhën shqipe.
2. Përkthimet e dokumenteve nga drejtuesi i postit konsullor janë të barasvlefshme me ato të një përkthyesi të regjistruar te një noter

në Republikën e Shqipërisë dhe për pasojë nuk kanë nevojë të noterizohen.

Neni 14

Lëshimi i vërtetimeve për vërtetësinë e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare

1. Drejtuesi i postit konsullor lëshon vërtetime për autenticitetin e dokumenteve, rregullsinë e tyre për sa i përket ekstremiteteve dhe lëshimin nga organi kompetent shqiptar për t'u përdorur me tej në rrethin e juridiksionit. Vërtetimet mund të lëshohen dhe në një gjuhe tjetër, veç gjuhës shqipe, duke përfshirë atë të vendit pritës.
2. Vërtetimet si në paragrafin më lart lëshohen nga drejtuesi i postit konsullor vetëm kur ai nuk ka asnjë lloj dyshimi për vërtetësinë e dokumentit të paraqitur. Në të kundërtën drejtuesi i postit konsullor e verifikon dokumentin e paraqitur pranë autoritetit që e ka lëshuar.

Neni 15

Legalizimi i dokumenteve zyrtare të lëshuara nga autoritetet shqiptare dhe autoritetet e vendit pritës në rrethin e juridiksionit

1. Legalizimi vërteton në një dokument zyrtar vërtetësinë, e nënshkrimit të nëpunësit nënshkrues, cilësinë në të cilën nëpunësi nënshkrues ka proceduar dhe vërtetësinë e vulës me të cilën është pajisur dokumenti.
2. Dokumenti i paraqitur për legalizim vuloset me vulën e legalizimit. Përveç emrit, mbiemrit dhe cilësisë së nëpunësit nënshkrues të dokumentit, shënohet data dhe vendi i legalizimit, emri dhe mbiemri i drejtuesit të postit konsullor, nënshkrimi i drejtuesit të postit konsullor dhe vuloset me vulën zyrtare të postit konsullor.
3. Dokumentet që janë çliruar nga legalizimi në bazë të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë dhe shteti pritës, nuk lejohet të legalizohen.
4. Drejtuesi i postit konsullor legalizon dokumente zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë për t'u përdorur me tej në rrethin e juridiksionit.
5. Drejtuesi i postit konsullor legalizon dokumente zyrtare të lëshuara nga autoritetet përkatëse të vendit pritës në rrethin e juridiksionit, për t'u përdorur më tej në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Dorëzimi i postës zyrtare

Drejtuesi i postit konsullor merr masat për dorëzimin e dokumenteve dhe të postës zyrtare shtetasve shqiptarë a të huaj që qëndrojnë në rrethin e juridiksionit, ose autoriteteve të shtetit pritës, po në rrethin e juridiksionit, me kërkesën e gjykatave dhe autoriteteve zyrtare shqiptare. Dorëzimi i dokumentacionit u konfirmohet me shkrim gjykatës ose autoritetit që ka bërë kërkesën.

Neni 17

Çështjet e lundrimit

1. Drejtuesi i postit konsullor merr masat për zgjidhjen e problemeve të anijeve që lundrojnë në brigjet e vendit pritës me flamurin shqiptar.
2. Drejtuesi i postit konsullor merr masat për zgjidhjen e problemeve që kanë lindur në bordin e anijeve, të cilat lundrojnë në brigjet e vendit pritës me flamurin shqiptar.
3. Në rast se anëtarët e ekuipazheve të anijeve si më lart kanë mbetur në tokë, për shkak të sëmundjeve, ose arsye të tjera, drejtuesi i postit konsullor merr masat e duhura për kthimin e tyre në atdhe.

IV. EMËRIMI DHE MARRJA E DETYRËS

Neni 18

1. Drejtuesi i postit konsullor dhe nëpunësit e tjerë konsullorë emërohen në bazë të ligjit të shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë.
2. Transmetimi i funksioneve konsullore te drejtuesi i postit konsullor bëhet sipas nenit 3, paragrafi 2. Pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe autoriteteve përkatëse zyrtare të vendit pritës depozitohet nënshkrimi i drejtuesit të postit konsullor dhe nëpunësve konsullorë, për sa ata do të jenë të autorizuar të ushtrojnë funksionet konsullore.

V. KUFIZIMET E USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË DREJTUESIT TË POSTIT KONSULLOR

Neni 19

Në veprimtarinë e tyre drejtuesi i postit konsullor dhe nëpunësit konsullorë janë të detyruar të respektojnë normat ndërkombëtare,

Konventën e Vjenës për marrëdhëniet konsullore, datë 24 prill 1963, traktatet dhe marrëveshjet e Republikës së Shqipërisë me vendin pritës, ligjet ekzistuese në rrethin e juridiksionit dhe normat ligjore të Republikës së Shqipërisë.

VI. RRETHI I NËPUNËSVE KONSULLORË

Neni 20
Nëpunësit konsullorë të karrierës

1. Në rrethin e nëpunësve konsullorë të karrierës hyjnë nëpunësit e Republikës së Shqipërisë të emëruar në postet konsullore jashtë shtetit, të ngarkuar me funksione konsullore sipas nenit 18 paragrafi 1.
2. Me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme, nëpunës konsullorë mund të emërohen edhe në konsullatat e nderit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 21
Konsujt e nderit

1. Për përfaqësimin sa më të mirë të interesave të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve të Jashtme emëron konsuj të përgjithshëm nderi dhe konsuj nderi. Më poshtë me termin "konsull nderi" do të kihet parasysh edhe konsulli i përgjithshëm i nderit.
2. Konsulli i nderit është pjesë përbërëse e strukturës së shërbimit konsullor të Republikës së Shqipërisë. Kompetencat e konsullit të nderit përcaktohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Punëve të Jashtme.
3. Emërimi ka të bëjë me dhënien e titullit konsull nderi qytetarit shqiptar a të huaj me qëndrim të përhershëm në vendin pritës, me anë të certifikatës përkatëse që lëshon Ministri i Punëve të Jashtme. Procedura e emërimit të konsullit të nderit përfshin:
   a) argumentimin e hollësishëm të nevojës së përfaqësimit të interesave të Republikës së Shqipërisë me konsull nderi në rrethin e juridiksionit të propozuar, shqyrtimin e kujdesshëm të përshtatshmërisë së figurës të kandidatit për konsullin e nderit;
   b) marrjen e pëlqimit paraprak prej SHIK-ut për emërimin e kandidatit, që shqyrtohet për konsull nderi;

   c) pas dhënies së titullit konsull nderi, ndërhyrjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme ose përfaqësisë diplomatike apo konsullore që mbulon rrethin e juridiksionit ku do të ushtrojë veprimtarinë konsulli i nderit, pranë ministrisë së punëve të jashtme të shtetit pritës, për lëshimin e ekzekuaturës.
4. Konsulli i nderit merr përsipër përfaqësimin e interesave të Republikës së Shqipërisë menjëherë pas dhënies së ekzekuaturës nga shteti pritës dhe për aq kohë sa është e nevojshme. Në qoftë se gjykohet se për arsye të ndryshme përfaqësimi i interesave të Republikës së Shqipërisë nuk është më i nevojshëm, me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme mund të kërkohet mbarimi i mandatit të konsullit të nderit. Konsulli i nderit mund të kërkojë në çdo kohë të heqë dorë nga titulli i tij. Titulli konsull nderi nuk është i trashëgueshëm.
5. Konsulli i nderit nuk mund të largohet nga posti i tij për një kohë të gjatë, përndryshe konsulli i nderit duhet të marrë në kohën e duhur miratimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme.
6. Konsulli i nderit duhet të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme nëse punësohet nga një shtet tjetër, përveç shtetit pritës, nga një organizatë ndërkombëtare ose kur ka bërë kërkesë për një nënshtetësi tjetër.
7. Republika e Shqipërisë pranon përfaqësimin në territorin e saj të interesave të një shteti të huaj, me të cilin ajo ka marrëdhënie diplomatike a konsullore me anë të konsujve të nderit. Paraprakisht shteti dërgues duhet të marrë miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për emërimin e konsujve të nderit të tij. Ministria e Punëve të Jashtme, pasi të jetë konsultuar më parë me autoritetet ose institucionet e tjera të interesuara dhe duke pasur parasysh, në radhë të parë, parimin e reciprocitetit, gjykon për dhënien e miratimit.
8. Për lejimin e fillimit të veprimtarisë së përfaqësimit të interesave të shtetit dërgues, konsulli i nderit pajiset nga Ministria e Punëve të Jashtme me ekzekuaturën përkatëse, pasi të ketë paraqitur certifikatën e emërimit të tij.

VII. VJELJA TAKSAVE NGA VEPRIMTARIA KONSULLORE

Neni 22
Taksat konsullore
Në veprimtarinë e tyre konsullore drejtuesi i postit konsullor kryen vjeljen e taksave në përputhje me normat ligjore përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

VIII. HYRJA NË FUQI

Neni 23
Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerre aktet nënligjore përkatëse në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Neni 24
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2162, datë 21.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Fletore zyrtare nr. 18, datë publikimi 07.08.1998

VENDIM

Nr. 816, Datë 07.10.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHËRBIMIT TË JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, të ligjit nr. 23/2015, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj rregulloreje, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.
3. Vendimi nr. 839, datë 17.12.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit "Rregullorja e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", shfuqizohet.
4. Ngarkohet ministri i Punëve të Jashtme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 23/2015, "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe legjislacionin për nëpunësin civil.
2. Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), si dhe misionet diplomatike e postet konsullore jashtë vendit.
3. Diplomatët e karrierës kryejnë veprimtari diplomatike dhe konsullore në strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe në misionet diplomatike e postet konsullore. Këtu nuk përfshihen strukturat e Ministrisë, veprimtaria e të cilave përcaktohet në nenin 56, të ligjit nr. 23/2015.
4. Diplomatët e karrierës rekrutohen në Shërbimin e Jashtëm në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil dhe ligjin nr. 23/2015.

KREU II
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

1. Sekretari i Përgjithshëm përzgjidhet në këtë detyrë nga ministri i Punëve të Jashtme, pas konkurrimit të hapur në radhët e diplomatëve me gradën diplomatike personale "Ministër Këshilltar", "Ministër Fuqiplotë" ose "Ambasador".
2. Çdo diplomat i interesuar, brenda 15 ditëve pas shpalljes së konkursit, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, të shoqëruar me një platformë të detajuar për vizionin e tij për zhvillimin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm dhe për rolin e funksionin që ai do të luajë si sekretar i Përgjithshëm në këtë shërbim.
3. Kandidaturat për postin e sekretarit të Përgjithshëm shqyrtohen nga një komision i posaçëm, i cili ngrihet me urdhër të ministrit të Punëve

të Jashtme dhe përbëhet nga pesë anëtarë, nga radhët e diplomatëve me gradën personale "Ministër Këshilltar", "Ministër Fuqiplotë" ose "Ambasador".
4. Konstituimi, mbledhja dhe detyrat e komisionit përcaktohen në urdhrin e ministrit për ngritjen e tij.

KREU III
KOMISIONI I KARRIERËS DIPLOMATIKE

1. Komisioni i Karrierës Diplomatike ngrihet me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme dhe përbëhet nga 5 anëtarë. Komisioni drejtohet nga sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së dhe në përbërje të tij janë drejtori i Burimeve Njerëzore dhe tre diplomatë karriere, me gradën diplomatike personale "Ministër Këshilltar", "Ministër Fuqiplotë" ose "Ambasador", të cilët përzgjidhen vetëm për një sesion pune të Komisionit.
2. Komisioni i Karrierës Diplomatike kryen funksionet, si më poshtë vijon:
   a) shqyrton kërkesat e diplomatëve për marrjen e gradave diplomatike dhe merr vendim për pranimin ose refuzimin e tyre;
   b) shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera nga diplomatët;
   c) kryen testimin për nëpunësit gjatë periudhës së provës, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr. 23/2015, dhe parashikimet e kësaj rregulloreje;
   ç) kryen testimin për diplomatët, të cilët paraqesin kërkesën për marrjen e gradës diplomatike personale "Këshilltar";
   d) organizon ceremoninë e betimit, sipas pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 23/2015.
3. Konstituimi, mbledhja dhe detyrat e Komisionit të Karrierës Diplomatike përcaktohen në urdhrin e ministrit për ngritjen e Komisionit. Mbledhja e Komisionit zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtën e një vote. Procesi i votimit është i hapur dhe nuk lejohet vota abstenuese.
4. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni ndihmohet nga një sekretari teknike, e cila, me aktin e ministrit për krijimit të Komisionit,

caktohet dhe operon pranë tij. Sekretaria teknike ka për detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve, përgatitjen e materialeve që shqyrtohen në mbledhjen e Komisionit të Karrierës Diplomatike, si dhe të mbajtjes dhe administrimit të procesverbaleve të mbledhjes.

KREU IV
REKRUTIMI NË SHËRBIMIN E JASHTËM

SEKSIONI 1
PROCEDURA E REKRUTIMIT

1. MPJ-ja i paraqet DAP-it pozicionet e lira të institucionit, sipas afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil. Njoftimi për shpalljen e vendeve të lira shoqërohet nga kriteret e veçanta për pozicionet përkatëse.
2. Kriteret e veçanta për vendin e lirë hartohen nga drejtori i drejtorisë ku është hapur vendi vakant dhe i paraqiten Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.
3. Kandidati për t'u rekrutuar në sistemin e karrierës diplomatike duhet të paraqesë, krahas dokumentacionit për pranim në Shërbimin e Jashtëm, një deklaratë personale me anën e së cilës të deklarojë se nuk bën pjesë në asnjë parti apo shoqatë politike si dhe faktin që nuk ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit.

SEKSIONI 2
PROCEDURA E TESTIMIT GJATË PERIUDHËS SË PROVËS

1. Nëpunësi i përzgjedhur nga DAP-i, që emërohet për herë të parë në Shërbimin e Jashtëm, përveç detyrimeve të parashikuara për ndjekjen e ciklit të detyrueshëm pranë ASPA-s, i nënshtrohet, gjatë periudhës së provës, edhe një procedure trajnimi dhe testimi pranë MPJ-së, e cila përbëhet nga dy faza:
   a) Faza e parë përfshin:
      i) Trajnimin e detyrueshëm pranë strukturave të MPJ-së për një periudhë tremujore.
      ii) Vlerësimin e njohurive të përfituara gjatë trajnimit për çdo

sesion trajnimi. Vlerësimi kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në programin trajnues nga struktura përkatëse në MPJ.

   b) Faza e dytë përfshin:
      i) Vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet nga eprori direkt, në përputhje me parashikimet e ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore të dala në varësi të tij.
      ii) Vlerësimin etiko-profesional, i cili kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike.
2. Vlerësimi etiko-profesional kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike, sipas kësaj procedure:
   a) Në përfundim të tremujorit të tretë të periudhës së provës nëpunësi i nënshtrohet testimit me shkrim, i cili zhvillohet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Karrierës Diplomatike. Pyetjet e testimit hartohen nga struktura trajnuese në MPJ, në përputhje me njohuritë dhe aftësitë e posaçme që duhet të zotërojë nëpunësi, të cilat janë të lidhura me pozicionin e punës në të cilin është emëruar. Struktura trajnuese në MPJ përgatit një paketë me, të paktën, 100 pyetje. Një orë përpara testimit, Komisioni i Karrierës Diplomatike përzgjedh 10 pyetje nga kjo paketë. Secila nga pyetjet vlerësohet me 10 pikë. Nëpunësi duhet të grumbullojë, të paktën, 50 pikë për t'u klasifikuar se e ka kaluar testimin me shkrim. Kohëzgjatja e testimit është tre orë.
   b) Pas përfundimit të testimit me shkrim, nëpunësi i nënshtrohet testimit me gojë. Testimi me gojë kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë t'i drejtojë dy pyetje nëpunësit që testohet dhe, për çdo pyetje, ka në dispozicion 10 pikë. Në fund të testimit nëpunësi duhet të grumbullojë, të paktën 50 pikë, për t'u klasifikuar se ka kaluar testimin me gojë.
   c) Në përfundim të dy testimeve Komisioni i Karrierës Diplomatike bën vlerësimin e nëpunësit dhe shprehet me vendim për rezultatin e testimit. Në rast se nëpunësi, në përfundim të dy testimeve, pavarësisht se mund të mos ketë grumbulluar pikët minimale në njërin testim, grumbullon, në total, të paktën, 100 pikë, kualifikimi i tij vendoset me votim nga Komisioni, ku vota e kryetarit është vendimtare. Komisioni i Karrierës Diplomatike, në

këtë rast, nëse e kualifikon nëpunësin, urdhëron që nëpunësi t'i nënshtrohet një trajnimi të thelluar pranë strukturës trajnuese në MPJ, në fushën ku janë vërejtur mangësitë.

ç) Në përfundim të testimit Komisioni i Karrierës Diplomatike shprehet me vendim për kualifikimin ose jo të nëpunësit.

d) Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike i përcillet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila e administron këtë vendim së bashku me vlerësimet e tjera. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike, vlerësimi i eprorit direkt dhe vlerësimi i strukturës trajnuese në MPJ i përcillen, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ministrit, jo me vonë se një muaj përpara përfundimit të periudhës së provës. Ministri shprehet me vendim për pranimin ose mospranimin e nëpunësit në sistemin e karrierës.Vendimi i ministrit u njoftohet, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nëpunësit dhe strukturave përkatëse në MPJ dhe DAP, brenda afateve të parashikuara në ligj.

KREU V
GRADAT DIPLOMATIKE

SEKSIONI 1
SISTEMI I GRADAVE DIPLOMATIKE

1. Sistemi i gradave diplomatike mbështetet në kriteret e përcaktuara në nenet 46, 47 e 48, të ligjit nr. 23/2015.
2. Diplomati e fiton gradën diplomatike personale me firmosjen e urdhrit nga ministri, ndërsa efektet financiare nisin nga data 1 e muajit pasardhës.
3. Grada diplomatike nga "Atashe" në "Këshilltar" përfitohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 23/2015.
4. Grada diplomatike personale "Këshilltar" përfitohet pas kalimit me sukses të testimit, i cili zhvillohet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike.
5. Grada diplomatike personale "Ministër Këshilltar" dhe "Ministër Fuqiplotë", përveç kushteve të pikës 1, të nenit 47, përfitohet nga diplomati, i cili ka pasur, të paktën, dy vjet eksperiencë në poste drejtuese, për secilën gradë, si dhe ka shërbyer në misionet diplomatike apo postet konsullore.

6. Për qëllimet e interpretimit të pikës 5, të nenit 47, "post drejtues" nënkupton:
   a) drejtor i Drejtorisë, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme, sekretar i Përgjithshëm;
   b) Kre i misionit diplomatik ose postit konsullor, i ngarkuar me punë.
7. Përvoja në poste drejtuese nënkupton, për gradën "Ministër Këshilltar", një periudhë minimale dyvjeçare akumulimi përvoje, dhe katërvjeçare akumulimi për gradën "Ministër Fuqiplotë".
8. Grada diplomatike personale "Ambasador" përfitohet nga diplomati, i cili ka fituar njëra pas tjetrës të gjitha gradat diplomatike, sipas ligjit nr. 23/2015, dhe ka qenë në detyrën e kreut të misionit diplomatik, të paktën, dy funksione, por jo më pak se gjashtë vjet gjithsej.
9. Numri i diplomatëve të karrierës që përfitojnë gradat diplomatike "Ministër Këshilltar", "Ministër Fuqiplotë" ose "Ambasador" është jo më i lartë se 80, të ndarë, sipas gradave diplomatike, si më poshtë vijon:
   i) Ambasadorë – 5
   ii) Ministra Fuqiplotë – 35
   iii) Ministra Këshilltarë – 40

SEKSIONI 2
PROCEDURA E DHËNIES SË GRADAVE DIPLOMATIKE

1. Komisioni i Karrierës Diplomatike mblidhet për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e gradave diplomatike, si rregull, dy herë në vit, në varësi të paraqitjes së kërkesave të diplomatëve të karrierës.
2. Komisioni i Karrierës Diplomatike merr në shqyrtim të gjitha kërkesat për përfitimin e gradave diplomatike personale, që plotësojnë kriteret, në përputhje me përcaktimet e nenit 47, të ligjit nr. 23/2015, dhe të kësaj rregulloreje, për gradat diplomatike personale "Atashe" deri në "Ministër Fuqiplotë".
3. Diplomati i karrierës, për marrjen e gradës diplomatike personale, i drejtohet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ditën që i lind e drejta për të përfituar ngritjen në gradë.
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pas marrjes së kërkesës së diplomatit për ngritjen në gradë, përgatit dosjen personale të tij. Dosja personale përgatitet mbi bazën e të dhënave personale, që ndodhen të administruara në kartotekën e institucionit. Përmbajtja e

dosjes i bëhet me dije diplomatit, i cili, në rast se ka të dhëna shtesë, të cilat nuk gjenden të administruara në dosje, i përcjell ato, brenda afateve të cilat përcaktohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Dosja e diplomatit, i cili kërkon shqyrtimin e kërkesës për marrjen e gradës diplomatike, duhet të përmbajë:

a) formularin e kërkesës, të nënshkruar nga diplomati;
b) të dhënat mbi kualifikimet profesionale;
c) formularin e vlerësimeve vjetore të dy viteve të fundit;
ç) formularin e vlerësimeve periodike të vitit kur paraqitet kërkesa;
d) vendimin e Komisionit të Karrierës Diplomatike për kalimin me sukses ose jo të testimit, për diplomatët që kërkojnë marrjen e gradës diplomatike "Këshilltar";
dh) gradën që diplomati kërkues mban dhe datën e dhënies së saj.

5. Formulari i kërkesës hartohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm.
6. Kërkesa e diplomatit, së bashku me dosjen e formuar sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij seksioni, pas dhënies së pëlqimit për përmbajtjen e saj nga diplomati, i përcillet Komisionit të Karrierës Diplomatike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në sesionin më të afërt që vijon pas paraqitjes së kërkesës. Diplomati njoftohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për përgatitjen e dosjes personale dhe përcjelljen e saj pranë Komisionit të Karrierës Diplomatike.
7. Sekretaria teknike e Komisionit të Karrierës Diplomatike administron materialet e përcjella nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe përgatit një relacion përmbledhës për Komisionin e Karrierës Diplomatike, në të cilin përshkruhen emrat e diplomatëve që kanë aplikuar për secilin rang të gradave diplomatike.
8. Relacioni, së bashku me rendin e ditës, vendin dhe orën e mbledhjes së Komisionit të Karrierës Diplomatike, i njoftohet anëtarëve nga sekretaria teknike, pasi të jetë nënshkruar nga kryetari i Komisionit.
9. Komisioni i Karrierës Diplomatike merr në shqyrtim kërkesat e diplomatëve të interesuar për marrjen e gradës diplomatike, duke shqyrtuar secilën kërkesë, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe dokumentacionin e administruar në dosje.
10. Vlerësimi i kërkesës bëhet sipas formularit të vlerësimit. Formulari i vlerësimit hartohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, miratohet nga ministri dhe i bashkëlidhet urdhrit të ministrit për ngritjen e Komisionit të Karrierës Diplomatike.

11. Formularët e vlerësimit plotësohen me shkrim dore. Pas përfundimit të vlerësimit, formularët administrohen nga sekretaria teknike, e cila mbledh vlerësimet pro dhe kundër të secilit anëtar.
12. Rezultati i vlerësimit lexohet nga kryetari i Komisionit të Karrierës Diplomatike dhe, pasi vlerësohet saktësia e tij, shpallet vendimi përfundimtar për secilin aplikues.
13. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike merret me shumicë të thjeshtë dhe duhet të përmbajë:
    a) pjesën hyrëse;
    b) pjesën arsyetuese;
    c) vlerësimin e detajuar për çdo aplikues, vlerësimet e marra pro dhe kundër;
    ç) dispozitivin.
14. Në mbarim të seancës së punës të Komisionit, sekretaria teknike administron aktet e mbledhjes dhe harton procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, me datën e zhvillimit të seancës, përbërjen dhe drejtimin e Komisionit.
15. Kryetari i Komisionit të Karrierës Diplomatike i dorëzon ministrit, brenda ditës, dokumentacionin e plotë të seancës së Komisionit. Ministri vendos për propozimet e Komisionit të Karrierës Diplomatike brenda tre ditëve, nga marrja e tyre.

SEKSIONI 3
PROCEDURA E DHËNIES SË GRADËS DIPLOMATIKE "KËSHILLTAR"

1. Për të përfituar gradën diplomatike "Këshilltar", diplomati i karrierës duhet t'u nënshtrohet procedurave të testimit, në të cilat përfshihen kriteret bazë për vlerësimin e kandidatit, që janë:
    a) vlerësimi i eprorit direkt;
    b) testimi me shkrim;
    c) testimi me gojë;
    ç) mungesa e masës disiplinore "të rëndë" në tre vitet e fundit.
2. Pyetjet e testimit me shkrim hartohen nga struktura trajnuese në MPJ, në përputhje me njohuritë dhe aftësitë e posaçme që duhet të zotërojë diplomati për të përfituar gradën diplomatike "Këshilltar". Struktura trajnuese në MPJ përgatit një paketë me, të paktën, 100 pyetje. Një orë përpara testimit, Komisioni i Karrierës Diplomatike përzgjedh 10 pyetje nga kjo paketë. Secila nga pyetjet vlerësohet me

10 pikë. Diplomati duhet të grumbullojë, të paktën, 50 pikë për tu klasifikuar se e ka kaluar testimin me shkrim. Kohëzgjatja e testimit është tre orë.

3. Pas përfundimit të testimit me shkrim, diplomati i nënshtrohet testimit me gojë. Testimi me gojë kryhet nga Komisioni i Karrierës Diplomatike. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë t'i drejtojë dy pyetje diplomatit që testohet dhe, për çdo pyetje, ka në dispozicion 10 pikë. Në fund të testimit diplomati duhet të grumbullojë, të paktën, 50 pikë për t'u klasifikuar se e ka kaluar testimin me gojë.
4. Në përfundim të dy testimeve, Komisioni i Karrierës Diplomatike bën vlerësimin e diplomatit dhe shprehet me vendim për rezultatin e testimit. Në rast se diplomati, në përfundim të dy testimeve, pavarësisht se mund të mos ketë grumbulluar pikët minimale në njërin testim, grumbullon, në total, të paktën, 100 pikë, kualifikimi i tij vendoset me votim nga Komisioni, ku vota e kryetarit është vendimtare. Komisioni i Karrierës Diplomatike, në këtë rast, nëse e kualifikon diplomatin, urdhëron që diplomati t'i nënshtrohet një trajnimi të thelluar, pranë strukturës trajnuese në MPJ, në fushën ku janë vërejtur mangësitë.
5. Në përfundim të testimit, Komisioni i Karrierës Diplomatike shprehet me vendim për kalimin me sukses ose jo të testimit nga diplomati që kërkon marrjen e gradës diplomatike "Këshilltar".
6. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike i përcillet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila administron këtë vendim.
7. Për rastet e pamundësisë së pjesëmarrjes fizike, të diplomatit që aplikon për gradën personale "Këshilltar", për shkak të emërimit të tij në një mision diplomatik ose post konsullor, procedura e testimit përcaktohet me një udhëzim të veçantë të ministrit të Punëve të Jashtme.

KREU VI
TRANSFERIMI, LËVIZJA PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË

SEKSIONI 1
PUNËSIMI NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

1. Transferim nënkupton punësimin e përkohshëm të diplomatit të karrierës në institucionet e administratës shtetërore, në pozicione që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë.

2. Periudha e transferimit jashtë Shërbimit të Jashtëm merret në konsideratë në përllogaritjen e afatit kohor të nevojshëm për përfitimin vetëm të një grade diplomatike.
3. Marrëveshja, ndërmjet MPJ-së dhe institucionit tjetër, parashikon:
   a) pozicionin në fushën e marrëdhënieve me jashtë, që do të ketë diplomati i karrierës në institucionin ku transferohet;
   b) afatin e punësimit, sipas nevojave të të dy institucioneve;
   c) të drejtat dhe detyrimet e diplomatit të karrierës;
   ç) detyrimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për rikthimin e diplomatit në Shërbimin e Jashtëm.

SEKSIONI 2
PUNËSIMI NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshja e punësimit të diplomatit të karrierës pranë organizatave ndërkombëtare, ndërmjet MPJ-së dhe këtij diplomati, duhet të përmbajë:
   a) pozicionin e punës pranë kësaj organizate, i cili nuk duhet të jetë teknik apo administrativ;
   b) afatin e punësimit;
   c) të drejtat dhe detyrimet e diplomatit;
   ç) detyrimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për rikthimin e diplomatit në Shërbimin e Jashtëm.
2. Periudha e punësimit në organizatat ndërkombëtare merret në konsideratë në përllogaritjen e afatit kohor të nevojshëm për përfitimin vetëm të një grade diplomatike personale.
3. Në rastin e aplikimit për gradën "Këshilltar", diplomati është i detyruar të kalojë me sukses testimin, sipas pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 23/2015.

SEKSIONI 3
LËVIZJA PARALELE DHE NGRITJA NË DETYRË

1. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë, për diplomatin e karrierës, brenda strukturave të MPJ-së, bëhet për plotësimin e vendeve të lira dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së punës. Ky proces bazohet në përzgjedhjen, sipas aplikimeve të paraqitura nga diplomatët e karrierës.
2. Procedura e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë të diplomatit të karrierës mbështetet në:

a) aftësitë profesionale;
b) përvojën individuale të diplomatit aplikues;
c) përputhshmërinë e gradës diplomatike të kandidatit me kërkesat e vendit të lirë;
ç) nivelin e vlerësimit vjetor të punës, të paktën "mirë", nga eprori direkt;
d) specifikën e vendit të lirë;
dh) të mos ketë masë disiplinore në fuqi, në momentin e aplikimit.

3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall vendin e lirë, duke përcaktuar një afat pesëditor për paraqitjen e aplikimeve individuale të diplomatëve të karrierës.
4. Aplikimet mblidhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila studion të dhënat vetjake, që ndodhen në dosjet e diplomatëve aplikues, dhe bën përzgjedhjen e tyre, në bazë të parimeve dhe kritereve të përcaktuara në pikën 2, të këtij seksioni.
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, brenda tre ditëve nga marrja e aplikimeve, i paraqet eprorit direkt dhe sekretarit të Përgjithshëm listën e aplikuesve, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij seksioni, shoqëruar nga një relacion për secilën kandidaturë.
6. Sekretari i Përgjithshëm dhe eprori direkt, brenda tre ditëve kalendarike, i paraqesin ministrit listën e kandidaturave, me propozimin për kandidaturën e vlerësuar si më të përshtatshme për plotësimin e vendit të lirë.

SEKSIONI 4

LËVIZJET PARALELE NË STRUKTURAT E MPJ-së PA GRADA DIPLOMATIKE DHE ANASJELLTAS

1. Diplomatët e karrierës mund të aplikojnë për emërim në një vend të lirë, në strukturat e MPJ-së që nuk përfitojnë gradë diplomatike. Koha e emërimit në këtë pozicion nuk llogaritet për efekt të vijimësisë së karrierës diplomatike.
2. Nëpunësit civilë që punojnë në strukturat e MPJ-së që nuk përfitojnë gradë diplomatike mund të aplikojnë për pozicionet e lira në strukturat e MPJ që përfitojnë gradë diplomatike nëse plotësojnë kriteret e pikës 2 të seksionit 3 dhe nëse kalojnë me sukses testimin e pranimit në sistemin e karrierës diplomatike. Në rastin e emërimit në këtë pozicion nëpunësi përfiton gradën diplomatike "Atashe".

KREU VII

EMËRIMI DHE MBARIMI I DETYRËS NË MISIONE DIPLOMATIKE DHE POSTE KONSULLORE

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si rregull, bën planin njëvjeçar të emërimeve /mbarimit të detyrës në misione diplomatike dhe poste konsullore dhe ia paraqet për vlerësim sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se data 15 dhjetor e çdo viti.
2. Sekretari i Përgjithshëm i paraqet për miratim ministrit, jo më vonë se data 10 janar e çdo viti, planin e emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike/postet konsullore.
3. Ministri miraton, brenda muajit janar, planin e emërimeve/mbarimit të detyrës në misionet diplomatike/postet konsullore.
4. Pas miratimit të planit nga ministri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në konsultim me drejtorinë që mbulon misionin diplomatik/postin konsullor ku krijohet vendi i lirë, përgatit të dhënat dhe kushtet specifike për plotësimin e tij dhe, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, bën shpalljen për plotësimin e vendeve të lira.
5. Brenda 15 ditëve, nga shpallja e vendeve të lira, Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit listën e kandidaturave dhe ia paraqet, për vlerësim, sekretarit të Përgjithshëm.
6. Sekretari i Përgjithshëm bën përzgjedhjen e kandidaturave për vendet e lira dhe, brenda datës 15 mars të çdo viti, ia paraqet për miratim ministrit.
7. Urdhri i Ministrit për emërimet/mbarimin e detyrës së diplomatëve në misione diplomatike /poste konsullore del brenda muajit mars të çdo viti. Efektet e zbatimit të urdhrit të emërimit /mbarimit të detyrës fillojnë, të paktën, tre muaj, por jo më shumë se katër muaj, nga data e nxjerrjes së tij.

KREU VIII

KOMISIONI I POSAÇËM PËR SHQYRTIMIN E KANDIDATURAVE PËR KRE TË MISIONIT DIPLOMATIK, QË NUK ËSHTË DIPLOMAT I KARRIERËS

1. Komisioni i Posaçëm, i parashikuar në nenin 27, të ligjit nr. 23/2015, ngrihet me urdhër të ministrit të Punëve të Jashtme dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Ai drejtohet nga sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së.

2. Përbërja e Komisionit është *ad hoc*, si vijon:
   a) Sekretari i Përgjithshëm *ex officio*;
   b) dy diplomatë të karrierës, me gradën diplomatike personale "Ministër Këshilltar", "Ministër Fuqiplotë" ose "Ambasador";
   c) Dy ekspertë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.
3. Konstituimi dhe detyrat e Komisionit përcaktohen në urdhrin e ministrit për ngritjen e Komisionit.
4. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni ndihmohet nga një sekretari teknike. Kjo sekretari, në aktin e krijimit të Komisionit nga ministri, caktohet dhe operon pranë Komisionit. Sekretaria teknike ka për detyrë të kujdeset për shkëmbimin e informacionit, dërgimin e njoftimeve, përgatitjen e materialeve që shqyrtohen nga Komisioni si dhe të mbajtjes dhe administrimit të procesverbaleve të mbledhjes.
5. Mbledhja e Komisionit zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve. Komisioni shqyrton kandidaturat për kreun e misionit diplomatik që nuk vjen nga radhët e diplomatëve të karrierës.
6. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni shprehet me vendim për përshtatshmërinë e kandidaturave. Vendimi i Komisionit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe i përcillet ministrit.

KREU IX
VERIFIKIMI I SIGURISË DHE PASTËRTISË SË FIGURËS

1. Personeli diplomatik, teknik, administrativ dhe i shërbimit, në Shërbimin e Jashtëm, i nënshtrohet verifikimit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Në kuptimin e nenit 38, të ligjit nr. 23/2015, me verifikim të sigurisë kuptohet lëshimi i certifikatës së sigurisë, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe me verifikim të pastërtisë kuptohet lëshimi i vërtetimit nga institucionet përkatëse, se personi nuk ka qenë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit.
3. Në rastin e mosmarrjes së certifikatës së sigurisë dhe vërtetimit të pastërtisë së figurës së personelit diplomatik, teknik, administrativ dhe të shërbimit, punonjësi përjashtohet nga Shërbimi i Jashtëm.
4. Dispozitat e këtij kreu zbatohen dhe ndaj kandidatëve për t'u rekrutuar në Shërbimin e Jashtëm, para emërimit të tyre në këtë shërbim.

KREU X
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

SEKSIONI 1
PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E DIPLOMATIT TË KARRIERËS

Diplomati i karrierës përgjigjet për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit dhe realizimit të detyrave të ngarkuara, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligji për Shërbimin e Jashtëm dhe aktet nënligjore të dala në varësi të tij, kjo rregullore, urdhrat dhe udhëzimet e ministrit të Punëve të Jashtme, që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

SEKSIONI 1/1
PËRGJEGJËSIA PËR MASAT DISIPLINORE

1. Diplomati i karrierës është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil, sipas ligjit për nëpunësin civil, dhe detyrimeve specifike të diplomatit, sipas ligjit për Shërbimin e Jashtëm. Shkeljet disiplinore në Shërbimin e Jashtëm ndahen në:
   a) shkelje shumë të rënda;
   b) shkelje të rënda;
   c) shkelje të lehta.
2. Janë shkelje shumë të rënda:
   a) mospërmbushja e rëndë e detyrave;
   b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;
   c) moszbatimi, haptazi, i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;
   ç) braktisja e punës ose mungesa e pajustifikuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit;
   d) përfitimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës;
   dh) kryerja e veprimeve apo mosveprimeve që cenojnë imazhin e vendit;
   e) mosmarrja e masave për ndalimin e veprimeve apo

mosveprimeve, që cenojnë imazhin e vendit, për familjarët që e shoqërojnë diplomatin në shërbim;

ë) publikimi, deklarimi i qëndrimeve mbi politikën e jashtme në shtypin e shkruar apo atë elektronik, brenda dhe jashtë vendit, pa autorizimin e strukturave përkatëse të MPJ-së;

f) shkelja e detyrimeve të përcaktuara në nenin 51, të ligjit 23/2015.

3. Janë shkelje të rënda:

a) mospërmbushja e detyrave;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustifikuar dhe e vijueshme për 3 ditë pune apo më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja të rënda;

c) shkelje e përsëritur e rregullave të etikës në shërbimin civil;

ç) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;

d) dëmtimi i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore;

dh) kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, e veprimeve që cenojnë figurën e diplomatit, institucionin apo Shërbimin e Jashtëm në tërësi;

e) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit, për të dhënat e klasifikuara si të tilla;

ë) shkelja e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 23/2015.

4. Janë shkelje të lehta:

a) mungesa e pajustifikuar në punë deri në 3 ditë pune;

b) shkelja e rregullave të etikës;

c) sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;

ç) kryerja, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë figurën e diplomatit, institucionin apo Shërbimin e Jashtëm në tërësi;

d) mosrealizimi i detyrave saktë dhe në kohën e parashikuar në urdhrat dhe udhëzimet e eprorëve, kur ato nuk kanë sjellë pasoja të rënda.

5. Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj diplomatit të karrierës janë:

a) për shkelje shumë të rënda:

i) largim nga Shërbimi i Jashtëm dhe Shërbimi Civil.

b) për shkeljet e rënda:

i) mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë deri në gjashtë muaj;

ii) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet;

iii) pezullim nga e drejta e ngritjes në gradë, për një periudhë dyvjeçare;

iv) rënie në gradë.

c) për shkelje të lehta:

i) "vërejtje", me të drejtë vlefshmërie gjashtë muaj;

ii) "vërejtje me paralajmërim", me afat vlefshmërie deri në një vit.

SEKSIONI 1/2
KOMPETENCA PËR MASAT DISIPLINORE NË NGARKIM TË DIPLOMATIT TË KARRIERËS

1. Masat disiplinore në ngarkim të diplomatit të karrierës i nënshtrohen, fillimisht, procedimit disiplinor, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe, më tej, procedimit disiplinor sipas parashikimeve të ligjit 152/2013, të ndryshuar.
2. Kompetenca për dhënien e masës disiplinore, të parashikuar në kreu X, seksioni 1/1, pika 1.a) dhe b), është e Komisionit të Karrierës Diplomatike. Masat disiplinore, të parashikuara në këtë seksion, jepen nga Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe hyjnë në fuqi pasi miratohen me urdhër të ministrit.
3. Kompetenca për dhënien e masës disiplinore, të parashikuar në kreu X, seksioni 1/1, pika 1.c) është e eprorit direkt. Masat disiplinore, të parashikuara në këtë seksion, hyjnë në fuqi pas miratimit nga sekretari i Përgjithshëm.
4. Kompetenca për fillimin e ecurisë disiplinore, në ngarkim të diplomatit të karrierës, është e eprorit direkt.
5. Eprori direkt i kreut të misionit diplomatik, për fillimin e ecurisë disiplinore, është sekretari i Përgjithshëm.
6. Eprori direkt i diplomatit të karrierës, i cili është liruar nga detyra në misionin diplomatik deri në emërimin e tij në MPJ, për fillimin e ecurisë disiplinore, është drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

7. Eprori direkt i diplomatit të emëruar në mision, për fillimin e ecurisë disiplinore, është kreu i misionit.
8. Eprori direkt i diplomatit të emëruar në MPJ, për fillimin e ecurisë disiplinore, është drejtori i Drejtorisë.

SEKSIONI 1/3

ORGANET DISIPLINORE DHE PROCEDURAT PËR MASAT DISIPLINORE NË NGARKIM TË DIPLOMATIT TË KARRIERËS

1. Organet disiplinore, që shqyrtojnë masat disiplinore në ngarkim të diplomatit të karrierës, janë eprori direkt, Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe ministri i Punëve të Jashtme.
2. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre për shqyrtimin e ecurisë disiplinore eprori direkt dhe Komisioni i Karrierës Diplomatike ndihmohen nga një sekretari teknike. Si sekretari teknike, për eprorin direkt, shërben një nga nëpunësit në varësi të eprorit direkt, ndërsa sekretaria teknike e Komisionit të Karrierës Diplomatike përcaktohet në urdhrin e ngritjes së Komisionit.

A. Eprori direkt

1. Eprori direkt, kryesisht ose nëpërmjet ankesave/rekomandimeve, bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara, përkundrejt diplomatit dhe, pas shqyrtimit administrativ, i klasifikon ato, në përputhje me parashikimet ligjore.
2. Eprori direkt ka kompetencë për:
   a) fillimin e procedimit disiplinor;
   b) mosfillimin e procedimit disiplinor, kur vlerëson se shkelja e pretenduar nuk parashikohet në kategorinë e shkeljeve të parashikuara në ligjin 23/2015 dhe në kreun X, të kësaj rregulloreje;
   c) ndërprerjen e procedimit disiplinor, në rastet kur vlerëson se:
      i) veprimi që merret në shqyrtim nuk përbën shkelje disiplinore, siç ishte menduar;
      ii) veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga diplomati, të cilit i është adresuar.
   ç) kalimin e procedimit disiplinor për shqyrtim në Komisionin e Karrierës Diplomatike, kur, pas shqyrtimit administrativ të saj, vlerëson se shkelja klasifikohet e rëndë apo shumë e rëndë;

   d) marrjen e masës disiplinore të klasifikuar për shkeljet e lehta.
3. Detyrat e eprorit direkt, gjatë procedimit disiplinor, janë, si vijon:
   a) Nis procedimin disiplinor.
   b) Në rast të ekzistencës së konfliktit të interesit me subjektin që procedohet, kërkon, pranë sekretarit të Përgjithshëm, dorëheqjen nga zhvillimi i procedimit. Në këtë rast, eprori direkt është drejtori i Burimeve Njerëzore. Në rast se drejtori i Burimeve Njerëzore është në cilësinë e eprorit direkt dhe ka konflikt interesi në shqyrtimin e çështjes, eprori direkt është diplomati me gradën më të lartë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
   c) Nis procedimin disiplinor, mbi bazën e ankesave/rekomandimeve, në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar nga:
      i) nëpunësit e institucionit, kur kanë dijeni ose dyshojnë për shkelje disiplinore të kryera nga nëpunës të tjerë, të të njëjtit institucion;
      ii) nëpunës të institucioneve të tjera, të cilët, për shkak të funksioneve, kanë dijeni ose dyshojnë për shkelje disiplinore të kryera nga nëpunës të një tjetër institucioni;
      iii) çdo organ tjetër publik ose njësi me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose çdo zyrtar tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi diplomatin;
      iv) çdo shtetas.
   ç) Ankesa e paraqitur nga subjektet e parashikuara në ligjin për nëpunësin civil dhe këtë rregullore, që të jetë e vlefshme, duhet:
      i) të jetë me shkrim;
      ii) të identifikojë diplomatin, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;
      iii) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.
   d) Në rast se ankesa e paraqitur nuk përmbush kriteret e parashikuar më sipër, ajo konsiderohet e pavlefshme dhe eprori direkt merr vendim për pavlefshmërinë e saj, duke njoftuar me këtë vendim Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ankuesin dhe sekretarin e Përgjithshëm.
4. Eprori direkt, me marrjen e ankesës, bën vlerësimin paraprak, nëse shkelja e pretenduar plotëson kushtet e një shkeljeje disiplinore. Për hartimin e dokumentacionit të ecurisë disiplinore, eprori direkt

asistohet nga një nëpunës i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, i cili kryen, në këtë rast, funksionet e sekretarisë teknike.

5. Për të gjitha rastet e klasifikuara si shkelje, eprori direkt fillon, pa vonesë, procedimin disiplinor, duke njoftuar, menjëherë, diplomatin për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij. Ky njoftim bëhet jo më vonë se 2 ditë pune nga marrja e vendimit për fillimin e ecurisë dhe përmban:
   a) shkeljen disiplinore të pretenduar;
   b) të drejtën, që nëpunësi ka për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar;
   c) të drejtën për paraqitjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve, inspektimin e dosjes;
   ç) të drejtën për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor;
   d) të drejtën për të paraqitur dëshmitarë;
   dh) datën e vendin kur dhe ku do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Data dhe vendi i shqyrtimit të shkeljes disiplinore nuk mund të caktohet më shpejt se 4 ditë, dhe jo më vonë se 16 ditë, nga marrja e njoftimit nga nëpunësi, për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj tij.
6. Në rast se diplomati nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, në seancën dëgjimore të shqyrtimit të shkeljes disiplinore në ngarkim të tij, pas dy njoftimeve të njëpasnjëshme, personalisht apo i përfaqësuar nga përfaqësuesi i tij, eprori direkt vazhdon procedimin disiplinor në mungesë.
7. Shqyrtimi i shkeljes disiplinore në mungesë shqyrtohet jo më vonë se 7 ditë, nga dita në të cilën ishte caktuar data e dytë e këtij shqyrtimi. Njoftimi i diplomatit, për të cilin është vendosur fillimi i ecurisë disiplinore, bëhet nëpërmjet mjeteve të njohura nga Kodi i Procedurave Administrative, si personalisht, me postë apo me telegram, telefon, teleks ose faks, në rastet e urgjencës, me kusht që të vërtetohet marrja dijeni nga diplomati. Në rastet kur masat e mësipërme nuk rezultojnë efikase, atëherë mund të bëhet njoftimi nëpërmjet postës elektronike. Kopja, në letër, e dokumentit elektronik (njoftimit), pasi vërtetohet sipas legjislacionit të fushës, bëhet pjesë e dosjes së procedimit administrativ.
8. Eprori direkt, me nisjen e procedurës disiplinore, kryen një hetim të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, sipas parashikimeve të Kodit

të Procedurave Administrative dhe parashikimeve të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, udhëzimeve të DAP-it, parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe ligjit nr. 23/2015. Detyrat e eprorit direkt, gjatë shqyrtimit administrativ të ecurisë disiplinore, janë, si vijon:

a) Çel seancën dëgjimore, duke verifikuar, fillimisht, prezencën e palëve.
b) Verifikon pjesëmarrjen e diplomatit ndaj të cilit atribuohet procedimi disiplinor. Në rast se diplomati dhe/apo përfaqësuesi i tij nuk është i pranishëm, eprori direkt heton shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, eprori direkt vendos shtyrjen e saj në një datë tjetër më të afërt, jo më vonë se 3 ditë pune. Në çdo rast, edhe nëse nuk ka paraqitur shkaqe të arsyeshme apo shkaqe të cilat nuk vlerësohen si të tilla, eprori është i detyruar që të bëjë edhe një njoftim të dytë, për një datë tjetër, sa më të afërt. Nëse, edhe në këtë rast, nëpunësi dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten apo nuk paraqesin shkaqe të arsyeshme, atëherë vendoset vazhdimi i ecurisë disiplinore në mungesë. Shtyrja e veprimeve administrative, për shkaqet e paraqitura nga nëpunësi dhe/apo përfaqësuesi i tij, sjellin edhe pezullimin e afateve të procedimit.
c) Pas verifikimit të prezencës së palëve, eprori direkt prezanton aktet mbi të cilat ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore. Diplomati ftohet të prezantojë kërkesat paraprake, nëse ka të tilla.
ç) Pas verifikimit të kërkesave paraprake, eprori direkt vendos për pranimin ose refuzimin e tyre, duke u shprehur me vendim të ndërmjetëm.
d) Pas vlerësimit të kërkesave paraprake fton diplomatin të prezantojë kundërshtitë e tij, në lidhje me procedimin disiplinor.
dh) Urdhëron sekretarinë teknike që të administrojë të gjitha provat, dëshmitë dhe çdo akt tjetër që ka lidhje me procedimin, në fashikullin e procedimit disiplinor.
e) Nënshkruan të gjithë aktet edhe vendimet që merr gjatë shqyrtimit të çështjes;

ë) Në fund të seancës dëgjimore, shpall vendimin e tij.

9. Gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, sekretaria teknike kryen këto detyra:
   a) përgatit njoftimet për seancën e shqyrtimit të çështjes;
   b) krijon kushte të përshtatshme pune për mbarëvajtjen e shqyrtimit të çështjes;
   c) mban procesverbalin e seancës;
   ç) administron fashikullin e dosjes së procedimit disiplinor, në të cilin përfshihet rendi i ditës së seancës, njoftimet, procesverbalet e seancës, relacioni për shkeljen e pretenduar, faktet dhe provat lidhur me çështjen, prapësimet, provat, kundërshtitë e diplomatit të proceduar, dëshmitë, provat e tjera që kanë lidhje me procedimin, vendimet e ndërmjetme të eprorit direkt, vendimin përfundimtar të eprorit direkt.
10. Procesverbali i seancave përmban:
   a) përmbledhje të gjithë çka trajtohet dhe ndodh në seancë;
   b) datën dhe vendin e seancës;
   c) çështjet që u diskutuan në seancë;
   ç) vendimet që u morën në seancë.
11. Pas ballafaqimit të fakteve dhe dëgjimit të palëve, eprori direkt deklaron mbylljen e seancës dhe tërhiqet për të marrë vendim. Eprori direkt, në fund të seancës, vendos:
   a) shpalljen e mbylljes së hetimit administrativ dhe përcaktimin e datës së seancës për të dhënë vendim në një ditë tjetër, por jo më vonë se 3 ditë pune nga data e zhvillimit të seancës, nëse i duhet më shumë kohë për të vlerësuar dokumentet e administruara në fashikullin e dosjes;
   b) shpalljen e vendimit të tij për dhënien e masës disiplinore, shuarjen e procedimit disiplinor apo kalimin e akteve pranë Komisionit të Karrierës Diplomatike.
12. Vendimi i eprorit direkt, në cilësinë e organit disiplinor, përmban:
   a) organin që ka marrë vendimin;
   b) identifikimin e diplomatit, ndaj të cilit është marrë masa;
   c) masën e marrë;
   ç) shkeljen/shkeljet faktike;
   d) bazën ligjore;
   dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;

   e) të drejtën që ka nëpunësi që ka marrë masën disiplinore për t'u ankuar dhe afatet e ankimimit.
13. Afati ankimor i vendimit të eprorit direkt është 45 ditë dhe ky afat shënohet qartësisht në pjesën e dispozitivit të vendimit. Në këtë pjesë përcaktohet se organi kompetent për shqyrtimin e vendimit për dhënien e masës disiplinore nga eprori direkt është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.
14. Vendimi zbardhet brenda 4 ditësh, nga data e shpalljes së tij, dhe hartohet në 3 (tre) ekzemplarë; një ekzemplar i jepet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe bëhet pjesë e dosjes personale të diplomatit të proceduar; një ekzemplar i jepet diplomatit të proceduar; një ekzemplar i përcillet DAP-it, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

B. Komisioni i Karrierës Diplomatike

1. Komisioni i Karrierës Diplomatike shqyrton dhe zgjidh ankesat për shkelje të pretenduara, të klasifikuara të rënda dhe shumë të rënda, të kryera me faj, nga diplomati, dhe merr vendime për:
   a) fillimin e procedimit disiplinor;
   b) kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore, me qëllim realizimin e një hetimi të plotë administrativ dhe të gjithanshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe kësaj rregulloreje;
   c) ndërprerjen e procedimit disiplinor, në rastet kur vlerëson se:
      i) nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;
      ii) veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga nëpunësi përkatës;
      iii) veprimi i shqyrtuar nuk përbën shkelje.
   ç) mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë deri në gjashtë muaj;
   d) pezullimin nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë ngritjen në gradë, deri në dy vjet;
   dh) rënien në gradë;
   e) largimin nga Shërbimi i Jashtëm dhe propozimin për largimin nga Shërbimi Civil, për diplomatët e karrierës;
   ë) vendime të ndërmjetme, me qëllim që t'u jepet përgjigje kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi normal i procedurës administrative.

Nëse diplomati dorëhiqet pasi ka filluar procedimi disiplinor ndaj tij, procedimi disiplinor vazhdon.

2. Kryetari i Komisionit të Karrierës Diplomatike:
   a) pranon kërkesat e eprorit direkt për fillimin e procedimit disiplinor, për procedimet e nisura, kryesisht, prej tij, ashtu edhe për procedimet e nisura mbi bazën e rekomandimeve të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi diplomatin, për të cilin kërkohet shqyrtimi i masës disiplinore për shkelje të rënda ose shumë të rënda;
   b) pranon kërkesat e anëtarëve të Komisionit për dorëheqje nga funksionet, në rast të konfliktit të interesit;
   c) i propozon ministrit, kryesisht bazuar edhe në kërkesën e anëtarit të Komisionit, zëvendësimin e anëtarit të Komisionit, në rastet e ekzistencës së pengesave ligjore për pjesëmarrjen në procedimin disiplinor;
   ç) urdhëron, menjëherë, sekretarinë teknike për përgatitjen e akteve të njoftimit për diplomatin ndaj të cilit zhvillohet procedimi dhe për anëtarët e Komisionit;
   d) çel dhe drejton mbledhjet e Komisionit;
   dh) nënshkruan të gjitha aktet e nxjerra nga Komisioni;
   e) siguron zbatimin e ligjit procedural dhe material të aplikueshëm për organet kolegjiale me kompetenca të një organi disiplinor.
3. Anëtari i Komisionit të Karrierës Diplomatike, me cilësinë e eprori direkt:
   a) bën relatimin e çështjes në Komision, bazuar në aktet e procedimit, të cilat kanë nisur me iniciativën e tij ose me iniciativën e subjekteve të tjera, të parashikuara në këtë rregullore dhe në ligjin 23/2015;
   b) prezanton provat dhe faktet e grumbulluara gjatë fazës së parë të shqyrtimit të ecurisë disiplinore, për të cilat ai ka vendosur shpalljen e moskompetencës;
4. Çdo anëtar i Komisionit të Karrierës Diplomatike:
   a) ka të drejtë të njihet me materialet e fashikullit të dosjes dhe të shprehë mendimin e tij mbi vlefshmërinë e tyre;
   b) ka të drejtë të votojë pro ose kundër, në të gjitha vendimet e Komisionit;

   c) vota abstenim është e papranueshme;
   ç) ka të drejtë të kërkojë dorëheqjen e tij nga procedimi disiplinor, pranë kryetarit të Komisionit, në rastet e konfliktit të interesit;
   d) ka të drejtë të kërkojë dorëheqjen e çdo anëtari të Komisionit dhe pranë kryetarit, në rast se ka dijeni të konfliktit të interesit;
   dh) nënshkruan të gjithë vendimet e Komisionit. Në rast të votës kundër, brenda afateve të përcaktuara nga kryetari i Komisionit, paraqet argumentet e tij me shkrim, të cilat i bashkëlidhen vendimit dhe bëhen pjesë përbërëse e tij.
5. Zëvendësimi i anëtarëve të Komisionit të Karrierës Diplomatike bëhet, si më poshtë vijon:
   a) Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit, i cili paraqet kërkesën për dorëheqje, bëhet nga ministri mbi bazën e propozimit të kryetarit të Komisionit;
   b) Në rast të zëvendësimit të kryetarit të Komisionit, pozicioni i kryetarit të Komisionit do të zëvendësohet nga personi që mbulon pozicionin që vjen direkt, në hierarki, pas pozicionit të kryetarit të Komisionit, mundësisht në përputhje me linjën profesionale të diplomatit, subjekt i procedimit disiplinor.
6. Seanca e shqyrtimit të çështjes në procedim zhvillohet, si më poshtë vijon:
   a) Komisioni i Karrierës Diplomatike mblidhet në seancë dëgjimore në ditën dhe vendin e përcaktuar në aktin e njoftimit, i cili përcaktohet nga kryetari i Komisionit dhe u njoftohet anëtarëve dhe diplomatit të proceduar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe këtë rregullore;
   b) Seanca dëgjimore çelet nga kryetari i Komisionit, i cili verifikon praninë e anëtarëve të Komisionit dhe, kur është rasti, shkaqet e mosparaqitjes së tyre. Në rast se këto shkaqe janë të bazuara, kryetari shtyn mbledhjen për një datë sa më të afërt. Në rast se edhe në mbledhjen e dytë ka mungesa të anëtarëve të Komisionit, por janë të pranishëm më tepër se gjysma e tyre, deklarohet zhvillimi i mbledhjes së Komisionit;
   c) Kryetari verifikon nëse ndonjë nga anëtarët e Komisionit është në kushtet e pengesave ligjore për të marrë pjesë në procedim;
   ç) Për rastet e procedimit disiplinor, në ngarkim të diplomatit, i cili është i emëruar në MPJ, kryetari verifikon praninë e diplomatit

apo të përfaqësuesit të tij, subjekt procedimi. Në rast se diplomati dhe/apo përfaqësuesi i tij nuk është i pranishëm, kryetari heton shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, kryetari vendos shtyrjen e seancës në një datë tjetër, e cila nuk mund të jetë më shumë se tre ditë pune nga e nesërmja e datës së seancës që shtyhet.

d) Nëse diplomati dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten, apo nuk paraqesin shkaqe të arsyeshme, në seancën e radhës, atëherë vendoset vazhdimi i ecurisë disiplinore në mungesë.

dh) Shtyrja e veprimeve administrative, për shkaqet e paraqitura nga diplomati dhe/apo përfaqësuesi i tij, sjell dhe pezullimin e afateve të procedimit.

e) Për shqyrtimin e masës disiplinore në ngarkim të diplomatit të emëruar në misione diplomatike jashtë vendit, Komisioni i Karrierës Diplomatike merr masat e organizimit të seancës dëgjimore në distancë (*conference call*), duke vënë në dispozicion të diplomatit të proceduar mjetet përkatëse për realizimin e saj në kushtet më optimale. Për realizimin e konferencës në distancë urdhërohet, nga sekretari i Përgjithshëm, Sektori i IT-së në MPJ, që, në bashkëpunim me nëpunësit e misionit ku ushtron detyrën diplomati, të bëhet i mundur realizimi i konferencës. Edhe në këtë rast bëhet dokumentimi i paraqitjes së diplomatit apo përfaqësuesit të tij me apo pa shkaqe të arsyeshme, si dhe dokumentimi i gjendjes fizike të pajisjeve që mundësojnë realizimin e konferencës. Në rast se konferenca nuk realizohet për shkaqe teknike, Komisioni vendos shtyrjen e seancës për ditën e nesërme.

ë) Pas verifikimit të prezencës, kryetari pyet nëse ka kërkesa paraprake nga palët në procedim. Kërkesat paraprake vlerësohen nga Komisioni, i cili shprehet me vendim të ndërmjetëm, të argumentuar dhe të përcaktuar në afat kohor, vendim i cili pasqyrohet në procesverbal.

f) Pas vlerësimit të kërkesave paraprake kryetari i jep fjalën, për relatimin e çështjes, eprorit direkt, që ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor. Relatori parashtron me shkrim shkeljen/shkeljet e pretenduara dhe rrethanat e shkeljes/shkeljeve, bazuar mbi fakte dhe prova.

g) Pas relatimit të çështjes, kryetari i jep të drejtën e fjalës diplomatit ose përfaqësuesit të tij ligjor, për t'u dëgjuar mbi argumentet për çështjen në fjalë. Pretendimet e diplomatit paraqiten dhe depozitohen me shkrim.

gj) Kryetari lejon thirrjen për dëgjesë të dëshmitarëve, thirrje, e cila bëhet me kërkesë të çdo anëtari të Komisionit ose me kërkesë të diplomatit të proceduar.

h) Kryetari u jep fjalën anëtarëve të Komisionit, në çdo rast kur ata vlerësojnë për të drejtuar pyetje ose për të kërkuar sqarime.

i) Pas ballafaqimit të fakteve e provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve, me vendim të ndërmjetëm të Komisionit, duke marrë edhe mendimin paraprak të diplomatit në procedim, Komisioni kalon në administrimin e provave të paraqitura.

j) Në rastet e procedimit të diplomatëve, të cilët në kohën e shqyrtimit të ecurisë disiplinore janë me shërbim pranë misioneve diplomatike, Komisioni shprehet me vendim për caktimin e një date të dytë për administrimin e provave, të cilat dërgohen të skanuara nga diplomati, nëpërmjet postës elektronike, në adresën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Në rast se këto prova përbëjnë sekret shtetëror, atëherë ato administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

k) Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i Karrierës Diplomatike merr vendim vetëm në prani të anëtarëve të tij, konform përcaktimeve të bëra në ligjin 23/2015 dhe në këtë rregullore.

l) Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, anëtarët e Komisionit të Karrierës Diplomatike shprehen me votim, i cili organizohet nga kryetari i Komisionit. Pasi ka përfunduar votimi, kryetari i Komisionit bën numërimin e votave dhe rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal. Anëtarët që janë në pakicë kanë të drejtë të deklarojnë votën e tyre dhe të japin shpjegimet përkatëse, nëse e konsiderojnë të nevojshme.

ll) Komisioni nuk mund të vendosë dy masa disiplinore për të njëjtën shkelje në procedim; ai vendos vetëm për një masë disiplinore.

m) Arsyetimi i vendimit bëhet nga anëtari i Komisionit që ka kërkuar procedimin disiplinor të diplomatit dhe nënshkruhet prej të gjithë anëtarëve.

n) Vendimi shpallet menjëherë dhe, në pamundësi, jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i shqyrtimit të çështjes.

7. Vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike përmban:
   a) organin që ka marrë vendimin;
   b) identifikimin e nëpunësit, ndaj të cilit është marrë masa;
   c) masën e marrë;
   ç) shkeljen/shkeljet faktike;
   d) bazën ligjore;
   dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;
   e) rastet e mëparshme të shkeljeve të ngjashme dhe të masave disiplinore të marra;
   ë) të drejtën e diplomatit që ka marrë masën disiplinore për t'u ankuar dhe afatet e ankimimit;
   f) nënshkrimet e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në vendimmarrje;
   g) anëtari që ka votuar kundër duhet të zbardhë mendimin e tij në të njëjtën datë që caktohet për zbardhjen e vendimit kryesor. Vendimi i shumicës dhe vendimi i pakicës depozitohen në sekretariatin teknik, maksimumi brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit.
   gj) vendimi i Komisionit të Karrierës Diplomatike i përcillet, nga sekretaria teknike, Komisionit të Disiplinës, i cili ngrihet dhe shqyrton këtë vendim në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar.
   a) veprimet e eprorit direkt, për shqyrtimin e ecurisë disiplinore të diplomatit të proceduar, bëhen pjesë e dosjes së shqyrtimit disiplinor të Komisionit të Disiplinës.

SEKSIONI 2

KOMPETENCA DHE PROCEDURA PËR MASAT DISIPLINORE NË NGARKIM TË DIPLOMATIT TË EMËRUAR SIPAS NENIT 27/2 DHE DIPLOMATËVE TË EMËRUAR SIPAS NENIT 31/3, TË LIGJIT Nr. 23/2015

1. Procedura për trajtimin e përgjegjësisë disiplinore, për diplomatët që nuk gëzojnë statusin e diplomatit të karrierës, por që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, i nënshtrohet parashikimeve të ligjit për nëpunësit civil dhe akteve nënligjore të dala në varësi të tij. Përgjegjësia disiplinore e tyre, për periudhën që ata shërbejnë në Shërbimin e

Jashtëm, është e njëjtë me përgjegjësinë disiplinore të diplomatit të karrierës, parashikuar në kreun X, seksioni 1, të kësaj rregulloreje.

2. Diplomatët e emëruar në misionet diplomatike, që nuk gëzojnë statusin e diplomatit të karrierës dhe nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, për periudhën që shërbejnë në Shërbimin e Jashtëm, u nënshtrohen të gjitha detyrimeve që përcaktohen në ligjin për nëpunësit civil, ligjin për Shërbimin e Jashtëm dhe parashikimeve të përgjegjësisë disiplinore, të përcaktuara në këtë rregullore, urdhrave dhe udhëzimeve të ministrit të Punëve të Jashtme, që rregullojnë veprimtarinë e Shërbimit me Jashtë.
3. Përgjegjësia disiplinore, për diplomatët që nuk gëzojnë statusin e diplomatit të karrierës dhe nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, për periudhën që ata shërbejnë në Shërbimin e Jashtëm, është e njëjtë me përgjegjësinë disiplinore të diplomatit të karrierës, parashikuar në kreun X, seksioni 1, të kësaj rregulloreje.
4. Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj diplomatit jashtë shërbimit të karrierës dhe jashtë shërbimit civil, janë:
   a) për shkelje të lehta:
      i) "vërejtje", me të drejtë vlefshmërie gjashtë muaj;
      ii) "vërejtje me paralajmërim", me afat vlefshmërie deri në një vit.
   b) për shkeljet e rënda:
      i) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë deri në gjashtë muaj;
      ii) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë deri në një vit.
   c) për shkelje shumë të rënda:
      i) largim nga Shërbimi i Jashtëm.

SEKSIONI 2/1

ORGANET DISIPLINORE PËR MASAT DISIPLINORE NË NGARKIM TË DIPLOMATIT TË EMËRUAR SIPAS NENIT 27/2 DHE DIPLOMATËVE TË EMËRUAR SIPAS NENIT 31/3, TË LIGJIT Nr. 23/2015

1. Organet disiplinore, që shqyrtojnë masat disiplinore në ngarkim të diplomatit jashtë shërbimit të karrierës, janë eprori direkt dhe Komisioni i Karrierës Diplomatike.

2. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre për shqyrtimin e ecurisë disiplinore eprori direkt dhe Komisioni i Karrierës Diplomatike ndihmohen nga një sekretari teknike. Si sekretari teknike, për eprorin direkt, shërben një nga nëpunësit në varësi të eprorit direkt, ndërsa sekretaria teknike e Komisionit të Karrierës Diplomatike përcaktohet në urdhrin e ngritjes së Komisionit.
3. Ecuria disiplinore, në çdo rast, fillon nga eprori direkt, i cili mund ta fillojë këtë ecuri kryesisht me iniciativën e tij ose mbi bazën e një ankese të ardhur nga subjektet e parashikuara në ligjin për Shërbimin e Jashtëm dhe ligjin për Nëpunësin Civil.
4. Masa disiplinore për shkelje të lehta jepet nga eprori direkt, ndërsa masat disiplinore për shkelje të rënda dhe shkelje shumë të rënda jepen nga Komisioni i Karrierës Diplomatike.
5. Organet disiplinore, të përcaktuara në këtë seksion, kryejnë të njëjtat veprime procedurale si organet disiplinore të parashikuara për diplomatin e karrierës.
6. Vendimet e organeve disiplinore, të përcaktuara në këtë seksion, administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
7. Diplomati, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore "largim nga Shërbimi i Jashtëm", kur kjo masë nuk është ankimuar ose kur është lënë në fuqi me vendim gjykate, nuk ka të drejtë të aplikojë për të punuar në Shërbimin e Jashtëm.

LIGJ

Nr. 9220, datë 15.04.2004

PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË VARRIMIT

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

(Hequr fjalë me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave e afateve për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Vdekje" është pushimi në mënyrë të parikthyeshme i aktivitetit të të gjitha sistemeve jetësore të organizmit të njeriut.
2. "Kufomë" është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore.
3. "Varr" është vendi i vendosjes së kufomës dhe/ose mbetjeve mortore.
4. "Varrezë" është një parcelë e përcaktuar territori, ku varrosen të vdekurit.
5. "Varrim" është procesi i vendosjes në varr të kufomës dhe/ose mbetjeve mortore, që i bëhet të vdekurit.

6. "Varrezë publike" është vendi ku ndodhen varrezat e një rajoni, të cilat janë pronë e njësisë bazë të qeverisjes vendore.
7. "Varrezë monumentale" është varreza ku prehen personalitete historike, fetare, kulturore, dëshmorë të kombit a njerëz të shquar dhe që mbahet për qëllime historike, përkujtimore, nderimi a vetëdijësimi kombëtar.
8. "Varrezë historike" është varreza ku prehen njerëz, të cilët kanë humbur jetën në kontekstin e ngjarjeve të caktuara historike, e cila mbahet për qëllime historike dhe përkujtimore.
9. "Varrezë fetare" është varreza që ngrihet nga komuniteti fetar dhe shërben për varrimin, si rregull, të besimtarëve të vet.
10. "Varrezë private" është varreza që ngrihet dhe administrohet nga subjekte private të licencuara, sipas kushteve dhe kritereve të këtij ligji.
11. "Mineralizim natyror i kufomës" është dekompozimi i indeve të buta të kufomës.
12. "Mineralizim artificial i kufomës" është transformimi në hi i indeve të buta dhe të forta të kufomës përmes kremimit.
13. "Kremim" është procesi i transformimit të kufomës nëpërmjet trajtimit industrial me nxehtësi të lartë.
14. "Mbetje mortore" janë mbetjet pas mineralizimit natyror të kufomës (eshtrat) dhe/ose pas mineralizimit artificial të kufomës (hiri).
15. "Shërbim i varrimit" është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës.
16. "Morg" është mjedisi ku kryhen autopsitë anatomo-patologjike dhe mjeko-ligjore të kufomave, si dhe të konservimit të përkohshëm frigoriferik të tyre.
17. "Morg civil" është ambienti ku trajtohen kufomat përpara se të kryhet ceremonia e varrimit.
18. "Zhvarrim" është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri.
19. "Zhvarrim i zakonshëm" është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes.
20. "Zhvarrim i jashtëzakonshëm" është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik.

21. "Periudhë e observimit" është koha e mbikëqyrjes së kufomës para varrimit.
22. "Shenjë funebre" është çdo lloj simboli ose mbishkrimi i vendosur mbi varr nga familjarët.
23. "E drejtë për përdorimin e varrit" është e drejta që buron nga marrëdhënia kontraktore, me të cilën lidhet disponimi mbi varrin konkret.
24. "Kohë e prehjes" është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.
25. "Zonë e rezervuar" është zona që nga banesa e fundit e periferisë së qytetit ose fshatit deri te fillimi i varrezave.

KREU II
PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË VARRIMIT

Neni 3
Varrezat publike të njësive bazë të qeverisjes vendore

(Ndryshuar titulli dhe togfjalësh në pikën 1,4, 5 e 6, shtuar fjali në fund të pikës 1 dhe pika 4/1 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Çdo njësi bazë e qeverisjes vendore duhet të ketë të paktën një varrezë. Toka e caktuar për ndërtimin e varrezave është pronë publike. Njësitë bazë të qeverisjes vendore garantojnë shërbimin publik të varrimit në njësitë e tyre administrative, duke ndërtuar dhe administruar varreza publike të mjaftueshme.
2. Komunat, që përfshijnë disa fshatra, në të cilat transporti i kufomave deri në qendër të komunës nuk është i lehtë, për shkak të vështirësive të komunikacionit, duhet të kenë varreza të veçanta për këto fshatra.
3. Komunat e vogla mund të kenë një varrezë të përbashkët vetëm në qoftë se janë fqinje me njëra – tjetrën. Në këtë rast, me marrëveshje të përbashkët, shpenzimet për shërbimin dhe mirëmbajtjen e varrezave shpërndahen ndërmjet komunave, në bazë të të dhënave të popullsisë së tyre.
4. Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit vendor" njësia bazë e qeverisjes vendore siguron mirëmbajtjen, rregullin dhe ruajtjen e

varrezave dhe kur varreza është e përbashkët këtë detyrë e kryen komuna ku ndodhet varreza. Këto veprime kryhen nga shërbimi i varrezave publike vendore ose nga një shoqëri private e licencuar, sipas kritereve të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

4/1. Varrimi në varrezat e njësive bazë të qeverisjes vendore bëhet pavarësisht nga besimi fetar i të vdekurit, duke garantuar kushtet për kryerjen e riteve fetare, sa herë kjo kërkohet.

5. Zyrat përgjegjëse të njësisë bazë të qeverisjes vendore duhet të jenë të pajisura me një planimetri me shkallë 1: 5000 të varrezave ekzistuese, e shtrirë në zonën rrethuese të tyre. Planimetria duhet të azhurnohet çdo vit, duke pasqyruar në të të gjitha ndryshimet e kryera.
6. Njësia bazë e qeverisjes vendore, për administrimin e varrezave, bashkëpunon edhe me komunitetet fetare.

Neni 3/a
Varrezat fetare

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat fetare ngrihen nga bashkësitë fetare mbi troje në pronësi të tyre, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
2. Ngritja e varrezave fetare bëhet me miratimin e këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore.
3. Administrimi i varrezave fetare bëhet nga bashkësia përkatëse fetare ose nga subjekte private, me të cilat organet drejtuese të komunitetit fetar lidhin kontratë për administrimin e varrezës.
4. Varrimi i personave që nuk i përkasin të njëjtit besim në varrezat fetare është në tagrin e bashkësisë fetare që administron varrezën.

Neni 3/b
Varrezat private

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat private ngrihen nga subjekte private mbi troje në pronësi të tyre ose në troje në pronësi shtetërore a të njësisë bazë të qeverisjes vendore, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

2. Ngritja e varrezave private bëhet me miratim të këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe/ose të Këshillit të Ministrave. Për njësitë bazë të qeverisjes vendore mund të ngrihet vetëm një varrezë private për 100 mijë banorë dhe me sipërfaqe jo më pak se 10 ha.
3. Subjekti privat ushtron veprimtarinë e tij në bazë të marrëveshjes së lidhur, sipas rastit, me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore ose ministrin përgjegjës për çështjet e planifikimit urban, në përputhje me rregullat për funksionimin dhe administrimin e varrezave, që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave. Marrëveshja nuk u nënshtrohet rregullave të legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat.
4. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e varrezave private përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Varrimi në varrezat private bëhet pavarësisht nga besimi fetar i të vdekurit, duke garantuar kryerjen e riteve fetare, sa herë kjo kërkohet.

Neni 3/c
Varrezat monumentale

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Statusin e varrezave monumentale e mbajnë Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, vendvarrimet e veçanta mbisipërfaqësore, sipas nenit 11, të ligjit, si dhe vendvarrimet e personaliteteve të shquara kombëtare historike, kulturore a fetare.
2. Varrezat monumentale ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave, në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohjeje kolektive për personalitetet që prehen në to, me elemente funksionale dhe organizative të dallueshme qartë dhe të përshtatura sipas nevojave të ceremonialit zyrtar dhe pelegrinazhit kolektiv.
3. Rregullat për statusin "Varrezë monumentale", për personat ose rrethin e personaliteteve që gëzojnë të drejtën e prehjes në to, për administrimin, financimin, kujdesin dhe mirëmbajtjen e tyre, përcaktohen në aktet me të cilin krijohen varrezat monumentale.
4. Administrimi, financimi, ruajtja, përdorimi dhe mirëmbajtja e varrezave monumentale, që kanë statusin monument kulture, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
5. Me përjashtim të Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut, varrezat monumentale nuk shërbejnë për varrime të reja.

Neni 3/ç

Varrezat historike

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat historike ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave, në shenjë përkujtimi për ngjarje të veçanta historike, me elemente funksionale dhe organizative të dallueshme qartë dhe të përshtatura sipas nevojave të ceremonialit zyrtar dhe pelegrinazhit kolektiv.
2. Në varrezat historike prehen persona që kanë humbur jetën gjatë/ dhe për shkak të ngjarjeve që përkujtohen. Varrezat historike nuk shërbejnë për varrime të reja.
3. Rregullat për administrimin, financimin, kujdesin dhe mirëmbajtjen e tyre përcaktohen në aktet me të cilin krijohen varrezat historike.

Neni 3/d

Rregullat teknike, të administrimit dhe mbikëqyrja

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Rregullat teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave përcaktohen me rregullore të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Rregullat për administrimin dhe funksionimin e varrezave publike, fetare dhe private, përcaktohen me rregullore të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Përveç sa përcaktohet në këtë rregullore, njësitë e qeverisjes vendore mund të përcaktojnë rregulla plotësuese në zbatim të saj.
3. Për varrezat fetare, rregullat e ritualit fetar që aplikohen, miratohen nga organet e bashkësisë fetare. Publiku duhet të ketë akses mbi këto rregulla.
4. Kontrolli për mënyrën e administrimit dhe funksionimit të varrezave publike, fetare dhe private, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore.

Neni 3/dh

Tarifat

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat publike, fetare dhe private ofrojnë shërbimet e tyre në bazë të tarifave të shërbimit. Tarifat e shërbimit publikohen. Administrata e varrezës është e detyruar të garantojë aksesin e plotë dhe në çdo kohë të publikut mbi informacionin përkatës.

2. Tarifat e shërbimit për varrezat publike miratohen nga këshilli i njësisë bazë përkatëse të qeverisjes vendore.

Neni 4

Zona e rezervuar

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat duhet të jenë të izoluara nga zonat e banimit nëpërmjet zonës së rezervuar. Ndalohet të bëhen ndërtime brenda zonës së rezervuar.
2. Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10 000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 m nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi më të vogël se 10 000 banorë, duhet të jetë më e madhe se 50 m.
3. Këshilli I njësisë bazë të qeverisjes vendore ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e zonës së rezervuar. Kjo bëhet vetëm me vendim të motivuar të organeve të mësipërme, duke marrë mendimin e inspektoratit sanitar.

Neni 5

Ndalimi i varrimit në një vend të ndryshëm nga varrezat

(Hequr fjalia e dytë e pikës 1 dhe shfuqizohet pika 2 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrosja e kufomave bëhet vetëm në varreza. Me kërkesë të komuniteteve fetare lejohet varrosja në mjediset brenda selive fetare.
2. Shfuqizuar.

Neni 6

Pranimi i kufomave në varreza

(Hequr togfjalësh në fjalinë e parë, ndryshuar togfjalësh në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", shtuar togfjalësh në fund të shkronjës "ç", shfuqizuar shkronja "d me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Në varrezat pranohen:

a) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të personave të vdekur në territorin e njësisë bazë të qeverisjes vendore, pavarësisht nga vendi i banimit kur ishin gjallë;
b) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të personave të vdekur jashtë

territorit të njësive bazë të qeverisjes vendore, por që, kur ishin gjallë, ishin banues të tyre;

c) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të personave që nuk banonin në këtë njësi bazë e qeverisjes vendore kur ishin gjallë dhe që kanë vdekur jashtë territorit të kësaj njësie bazë të qeverisjes vendore;

ç) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të shtetasve të huaj me banim ose jo në Shqipëri, që dëshirojnë të varrosen në këto territore pasi të jenë pajisur me autorizim nga prefekti;

d) Shfuqizuar;

dh) të lindurit të vdekur.

Neni 6/a

Detyrimi për varrim

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Për çdo kufomë lind detyrimi për varrim. Këtu bëjnë pjesë dhe të sapolindurit e vdekur dhe fetuset e vdekura në lindje me peshë mbi 500 gramë.
2. Foshnjat e lindura të vdekura dhe fetuset e vdekura gjatë lindjes, me peshë nën 500 gramë, varrosen me shpenzimet e prindërve, kur këtë e kërkon së paku njëri nga prindërit. Kur ngjarja ndodh në institucione mjekësore, atëherë institucioni është i detyruar të informojë prindërit për këtë klauzolë. Në rast se prindi nuk bën kërkesë, atëherë institucioni bën trajtimin e mëtejshëm me shpenzimet e veta dhe në përputhje me procedurat e brendshme spitalore. Këto procedura duhet të garantojnë trajtimin në mënyrë dinjitoze të tyre.
3. Foshnjat dhe fetuset e lindura të vdekura, sipas pikës 2, të këtij neni, që nuk kërkohet të varrosen, lejohet të përdoren vetëm për qëllime shkencore. Për përdorimin për nevoja mësimore-shkencore kërkohet pëlqimi i të dy prindërve. Institucioni shkencor përgjigjet për varrimin e tyre sapo ato të mos jenë më të nevojshëm për veprimtarinë mësimore-shkencore. Nga ky moment institucioni mbart të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për prindin.
4. Pjesët e trupit të amputuara trajtohen në përputhje me procedurat e brendshme spitalore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6/b

Detyrimi për përkujdesje për varrimin

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Detyrimi për t'u përkujdesur për varrimin i takon familjarëve të të vdekurit, sipas radhës dhe rastit:
   a) bashkëshortit a bashkëshortes ose bashkëjetuesit a bashkëjetueses;
   b) fëmijëve në moshë madhore;
   c) prindërve;
   ç) prindërve të prindërve;
   d) vëllezërve e motrave madhore dhe fëmijëve të tyre.
2. Nëse detyrimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk plotësohet, administrata vendore duhet të urdhërojë kryerjen e varrimit nga shërbimi i varrimit dhe kalimin e shpenzimeve në ngarkim të familjarëve që kanë detyrimin sipas pikës 1, të këtij neni, në rast se kufoma nuk u përcillet shërbimit anatomo-patologjik. Kur detyrimi sipas pikës 1, të këtij neni, është i pamundur, shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar.
3. Pika 2, e këtij neni, zbatohet edhe për personat që jetojnë në kushtet e varfërisë, të braktisjes, të mungesës së interesit mes anëtarëve të familjes, ose për të cilët është e pamundur të identifikohen familjarë që bartin detyrimin, sipas pikës 1, të këtij neni. Kur këta persona nuk janë banorë të njësisë së qeverisjes vendore, shërbimi i varrimit kryhet nga njësia bazë e qeverisjes vendore, ku personi ka ndërruar jetë, duke marrë pagesën nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar.

Neni 6/c

Llojet dhe mënyrat e varrimit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Varrimi mund të jetë nëntokësor, mbitokësor ose me kremim dhe bëhet sipas ritualit fetar ose laik. Lloji dhe mënyra e varrimit përcaktohen sipas vullnetit të të vdekurit. Nëse i vdekuri nuk ka lënë vullnet të shprehur për llojin dhe mënyrën e varrimit, atëherë ato përcaktohen nga familjarët, sipas pikës 1, të nenit 6/b, të këtij ligji.

Neni 6/ç

Llojet e varreve

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrimi, si rregull, bëhet në varre individuale, ku mund të varrosen persona të tjerë vetëm pas kalimit të kohës së prehjes, sipas nenit 7/ç të këtij ligji, dhe vetëm me kërkesën me shkrim të familjarëve të personit të vdekur, për të cilin është lëshuar e drejta e përdorimit. Në këtë rast lidhet kontratë e re përdorimi, e cila nuk anulon kushtet e kontratës së parë të përdorimit.
2. Varrimi mund të bëhet në varre familjare nëntokësore, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 7

Shërbimi i varrimit

(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Pranë çdo varreze publike, fetare ose private, funksionon shërbimi i varrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe rregullores së administrimit dhe funksionimit të varrezës. Shërbimi i varrimit mund të kontraktojë të tretë për kryerjen e shërbimeve dhe për mallra të caktuara."
2. Shfuqizuar.
3. Çdo shërbim varrimi regjistrohet në dy regjistra të njëjtë, numri i faqeve të të cilave vërtetohet nga kryetari ose sekretari i njësisë bazë të qeverisjes vendore. Në regjistër shënohen:
   a) varrimet që janë kryer, duke saktësuar emrin, mbiemrin, moshën, vendin dhe datën e lindjes (siç rezulton nga leja e varrimit), vitin, ditën dhe orën e varrimit, numrin e gurit të varrit dhe numrin rendor të faturës së varrimit;
   b) çdo ndryshim që ka ndodhur si pasojë e zhvarrosjeve.
   Regjistri nënshkruhet në çdo fletë nga përgjegjësi i shërbimit. Modeli i tij përcaktohet në udhëzimin e ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.
4. Njëra prej kopjeve të regjistrit dorëzohet çdo fund viti në arkivin e njësisë bazë të qeverisjes vendore, ndërsa kopja tjetër mbetet në ruajtje pranë shërbimit të varrimit.

5. **Rakordimi i regjistrave me zyrat e gjendjes civile bëhet çdo tremujor.**
6. Regjistrat e përmendur në pikën 3 të këtij neni paraqiten pranë organeve të kontrollit të njësisë vendore pas çdo kërkese të tyre.

Neni 7/a

Kushtet për lejimin e varrimit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kufomat lejohet të varrosen vetëm pasi është lëshuar leja e varrimit nga zyra e gjendjes civile e njësisë bazë përkatëse të qeverisjes vendore. Shërbimi i varrimit merr në dorëzim dhe ruan për çdo varrim lejen e varrimit.
2. **Kur vdekja ndodh në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit kërkon dokumentet që vërtetojnë vdekjen, në përputhje me nenin 54, të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, dhe me këto dokumente bën deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile në ditën e parë të punës.**
3. Për kufomat, që transportohen nga një shtet tjetër, shërbimi i varrimit merr në dorëzim dhe ruan bashkë me certifikatën e vdekjes, të lëshuar sipas formës dhe modaliteteve në fuqi në shtetin tjetër, edhe lejen për transportimin e kufomës (pasaportën e kufomës), të lëshuar nga autoritetet konsullore shqiptare. Kur certifikata e vdekjes, si më sipër, mungon, atëherë certifikata e vdekjes u kërkohet autoriteteve shqiptare, sipas procedurave në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
4. **Rregullat e detajuara për aktin e vdekjes, deklarimin e vdekjes, lëshimin e lejes së varrimit, vërtetimin e vdekjes, si dhe për organet e personat përgjegjës përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për gjendjen civile.**

Neni 7/b

Kushte të veçanta për varrimin me kremim

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kufomat lejohet të varrosen me kremim vetëm nëse:
   a) njihet identiteti i personit të vdekur;

b) është lëshuar leja e varrimit, sipas nenit 7/a, të këtij ligji;
c) dokumenti që vërteton vdekjen konfirmon se vdekja ka ardhur për shkaqe natyrore dhe se shkaku i vdekjes është konstatuar jashtë çdo lloj dyshimi;
ç) ekziston vullneti i shprehur i personit të vdekur.

2. Nëse rrethanat, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk plotësohen, atëherë varrimi me kremim mund të zhvillohet vetëm nëse organi i prokurorisë autorizon me shkrim kryerjen e tij.

Neni 7/c
E drejta për përdorimin e varrit
(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. E drejta për përdorimin e varrit fitohet me anën e kontratës së përdorimit, të lidhur me shërbimin e varrezës. Kontrata e përdorimit të varrit nuk sjell pronësinë mbi të.
2. Kontrata e përdorimit lidhet nga vetë personi përpara vdekjes (prenotim varri) ose nga familjarët para ose pas vdekjes së personit.
3. Kontrata lidhet sipas kushteve, kritereve dhe tarifave të përcaktuara në rregulloren e administrimit dhe funksionimit të varrezës. Në kontratë përcaktohen identiteti i personit ose i personave që lejohet të varrosen në varrin, objekt kontrate, mënyra e veshjes dhe dekorimit të varrit, shenjat funebre që do përdoren, rregullat për kujdesin dhe mirëmbajtjen, lloji dhe mënyra e varrimit, kohëzgjatja e së drejtës së përdorimit, shërbimet që do të prenotohen, çmimet përkatëse dhe mënyra e pagesës.

Neni 7/ç
Koha e prehjes dhe afati për përdorimin e varrit
(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Koha e prehjes për të gjitha varrezat publike, fetare ose private, është e barabartë me 15 vjet. E drejta e përdorimit të varrit gjatë kohës së prehjes është pa shpërblim. Këtu nuk përfshihen shërbimet që ofron varreza, për të cilat ka tarifa të miratuara.
2. Afati për kohëzgjatjen e së drejtës së përdorimit të varrit është, në minimumin e tij, sa afati, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe, në maksimumin e tij, i përhershëm. Për çdo varr, afati i përdorimit

përcaktohet në kontratën e përdorimit, sipas nenit 7/c, të këtij ligji. Për periudhën përtej afatit minimal kontrata mund të parashikojë shpërblim, nëse për këtë qëllim ka tarifa të miratuara.

Neni 7/d
Shërbimi anatomo-patologjik
(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Shërbimi anatomo-patologjik pranon kufoma në kuadër të veprimtarisë mësimore-shkencore, për të cilat është lëshuar leja e varrimit, sipas nenit 7/a të këtij ligji.
2. Shërbimi anatomo-patologjik ka për detyrë të sigurojë që kufomat e administruara prej tij të mos bëhen burim për përhapjen e sëmundjeve.
3. Shërbimi anatomo-patologjik përgjigjet për varrimin e kufomës sapo ajo të mos jetë më e nevojshme për veprimtarinë mësimore-shkencore. Nga ky moment ai mbart të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për familjarin.

Neni 7/dh
Përpunimi i të dhënave personale
(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të veta shërbimi i varrimit ka të drejtë të përpunojë të dhëna personale. E drejta për përpunimin e të dhënave personale lidhet sidomos me mbajtjen e regjistrit të personave të varrosur, të klientëve dhe kontratave apo të të punësuarve.
2. Mbajtja, kontrolli, përpunimi dhe fshirja e të dhënave personale bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.

>>>

VENDIM

Nr. 426, datë 9.7.1998

PËR PËRBALLIMIN NGA SHTETI TË SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT PËR SHTETASIT SHQIPTARË QË VDESIN BRENDA DHE JASHTË SHTETIT

(Ndryshuar me VKM Nr. 788, datë 26.11.2003 dhe Nr. 721, datë 30.10.2007)

(perditesuar)

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për çdo rast vdekjeje jepet një ndihmë financiare nga Buxheti i Shtetit për përballimin nga familja të shpenzimeve të varrimit, në masën e përcaktuar më poshtë, sipas vendbanimeve përkatëse:
   - Për Bashkinë e Tiranës, në masën 10 000 lekë;
   - Për bashkitë e tjera, në masën 8 500 lekë;
   - Për komunat, në masën 5 000 lekë.".
2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet drejtorive rajonale dhe agjencive të sigurimeve shoqërore kryen pagesën e kësaj ndihme, në bazë të certifikatës së vdekjes së lëshuar nga zyrat e gjendjes civile të njësive përkatëse të qeverisjes vendore (komuna ose bashkia) dhe të kërkesës së paraqitur nga familjarët e personit të vdekur.
   Në buxhetin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin e sigurimeve shoqërore planifikohen, çdo vit, fonde për përballimin e shpenzimeve që lidhen me dhënien e ndihmës, në raste vdekjeje, si transfertë nga Buxheti i Shtetit.
3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, me fonde të Buxhetit të Shtetit, organizon shërbimin e transportit të kufomave dhe të eshtrave vetëm për rastet e fatkeqësive të ndodhura jashtë territorit të vendit, për personat që janë dërguar me shërbim ose mjekim shëndetësor nga shteti, për punonjësit e përfaqësive diplomatike, si dhe për rastet e veçanta, sipas kërkesës së bërë nga institucione, njësi të qeverisjes vendore apo shoqata të ndryshme.
   Për shtetasit shqiptarë, që vdesin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur shpenzimet e transportit përballohen nga familjarët e të ndjerit, Buxheti i Shtetit rimburson një pjesë të këtyre shpenzimeve. Rastet e veçanta dhe masa e kontributit të shtetit në përballimin e shpenzimeve të varrimit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Financave."
4. Këshillat e rretheve organizojnë heqjen, transportimin dhe rivarrimin e eshtrave të të ekzekutuarve, me ose pa vendim gjyqi, të të burgosurve politikë, që kanë vdekur në burg ose në vendet e dënimit, pa u dënuar, si dhe të të vrarëve në kufi, në orvajtje për t'u arratisur. Shpenzimet përballohen nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet buxhetit të këshillave të rretheve përkatëse.
5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përgatisin udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 28.8.1992, nr. 484, datë 10.11.1992, nr. 189, datë 16.4.1993 dhe nr. 8, datë 17.11.1994, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Udhëzim

Nr. 16, datë 18.4.2008

Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 30.10.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit"", të ndryshuar

Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 30.10.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 426, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë shtetit", të ndryshuar, udhëzojmë të zbatohen procedurat si më poshtë:

1. Pagesa e shpenzimeve të varrimit, në shumën e përcaktuar në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 30.10.2007, bëhet në emër të një familjari të personit të vdekur, **i cili paraqet pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të rrethit certifikatën e vdekjes**, faturën e funeralit ose një vërtetim nga kryeplaku i fshatit dhe një kërkesë të thjeshtë për tërheqjen e shpenzimeve të shërbimit të varrimit, ku cilësohet edhe relacioni me personin e vdekur.
2. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, nga drejtoritë rajonale ose ALSSH-ja do të hartohet çdo muaj urdhërpagesa e listuar në dy kopje, nga të cilat një kopje kalohet zyrtarisht në qendrën paguese të zgjedhur për kryerjen e këtyre pagesave dhe një kopje së bashku me dokumentet e tjera qëndron e arkivuar në zyrën e financës të rajonit apo agjencisë. Formati i urdhërpagesës së listuar gjendet bashkëlidhur.
3. Urdhërpagesa e listuar bëhet e vlefshme për të autorizuar pagesat e shpenzimeve të varrimit nga qendrat paguese, vetëm pasi të nënshkruhet nga KD financës e drejtori i drejtorisë rajonale ose personat e autorizuar në ALSSH e t'i vendoset edhe vula. Dërgimi i urdhërpagesës së listuar për t'u paguar nga qendra paguese e Postës Shqiptare bëhet në mënyrë protokollare dhe vetëm nëpërmjet filialit apo degës së Postës Shqiptare sh.a.
4. Urdhërpagesa e listuar plotësohet në fund të muajit mbi bazën e dokumenteve të cilësuara të pranuara gjatë muajit dhe dërgohet për pagesë që në datën 1 të muajit pasardhës. Kështu dokumentet e pranuara e të listuara në muajin janar 2008 do të dërgohen për pagesë në muajin shkurt 2008, e kështu në vazhdim.
5. Pagesa e shpenzimeve do të evidentohet në një listëpagesë, sipas formatit bashkëlidhur, e cila është dokument bazë që vërteton pagesën, plotësohet në dy kopje, nga të cilat një vjen zyrtarisht nga qendra e pagesës në zyrën e financës të sigurimeve shoqërore dhe shërben si dokument financiar për evidentimin në kontabilitet të pagesave të kryera. Procedurat e kontrollit, rakordimit, të financimeve paradhënie e përfundimtare dhe ato të kontabilitetit janë të njëjta si edhe për pagesën e pensioneve. Shpenzimet e kryera për këtë qëllim do të evidentohen në kontabilitet në nënllogarinë 60600.09 "Shpenzime të shërbimit të varrimit", ndërsa në raportin fiskal të muajit ato do të evidentohen së bashku me programet e tjera nënllogaria 60606.09.
6. Pagesat e kryera nga qendra paguese do të ballafaqohen çdo muaj me urdhërpagesën e listuar të dërguar duke evidentuar edhe rastet e papaguara. Këto raste, pasi të krahasohen edhe me listën e shpenzimeve të varrimit të papaguara të dërguara nga qendra paguese, do të evidentohen në urdhërpagesën e listuar të muajit pasardhës.
7. Në lidhje me marrëdhëniet me zyrat e pagesës, filialet dhe degët e Postës Shqiptare sh.a. procedurat janë përcaktuar në marrëveshjen e posaçme.
8. Shpenzimet e varrimit të identifikuara në vitin 2007 dhe të palikuiduara brenda periudhës do të likuidohen me fondet e akorduara për vitin 2008 në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste përfituesi duhet të paraqesë një dokument nga njësia e pushtetit vendor përkatës, që të vërtetojë moskryerjen e pagesës.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ministri i Financave
Ridvan Bode

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
Koço Barka

DREJTORIA RAJONALE _____
FILIALI I POSTËS SHQIPTARE_____
PËR ZYRËN POSTARE_____

Listëpagesë

(Për pagesën e shpenzimeve të varrimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 30.8.2007)

						DATA E PAGESËS
Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Nr. DOK. IDENTI-FIKIMIT	SHUMA	NËNSHKRIMI
			Shuma			

PËR QENDRËN E PAGESËS
Llogaritari
Arkëtari
vula e qendrës paguese

FILIALI I POSTËS SHQIPTARE_____
PËR ZYRËN POSTARE_____
LISTË PËR SHPENZIMET E VARRIMIT TË PAPAGUARA

(Për pagesën e shpenzimeve të varrimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 30.8.2007)

Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Nr. NË U.PAGESËN E LISTUAR	SHUMA	ARSYET

PËR QENDRËN E PAGESËS
Llogaritari
Arkëtari

DREJTORIA RAJONALE _____
FILIALI I POSTËS SHQIPTARE_____
PËR ZYRËN POSTARE_____

URDHËRPAGESË E LISTUAR Nr. _____
(Për pagesën e shpenzimeve të varrimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 30.8.2007)

						DATA E PAG-ESËS
Nr.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Nr. DOK.IDENTIFIKIMIT	SHUMA	(plotësohet nga sportelet e zyra-ve postare)

PËR DREJTORINË RAJONALE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
INSPEKTORI I AUTORIZUAR_____
PËR DEGËN E FINANCËS_____
DREJTORI____

Fletore zyrtare nr. 63, datë publikimi 14.05.2008

VENDIM

Nr. 867, datë 10.12.2014

PËR PROCEDURAT EBASHKËPUNIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE[38]

(Ndryshuar me VKM-në nr. 139, datë 20.3.2019; nr. 435, datë 26.6.2024; nr. 727, datë 20.11.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është rregullimi i mënyrës së bashkëpunimit nëpërmjet kërkimit të të dhënave, informacionit, ndihmës së nevojshme, ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës për hartimin e strategjive, politikave, akteve dhe krijimit të njësive të përbashkëta për të kryer detyra administrative ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore me qëllim mirëfunksionimin e aparatit dhe veprimtarisë shtetërore, si edhe realizimin e detyrave administrative me shpejtësi, efikasitet dhe besueshmëri.
2. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore realizohet në një nga format e parashikuara nga neni 24, i ligjit nr. 90/2012, dhe sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
3. Të gjitha institucionet e administratës shtetërore para, gjatë dhe në përfundim të procesit të bashkëpunimit janë të detyruara të japin ndihmën dhe kontributin e tyre me qëllim realizimin pa vonesa të funksioneve administrative dhe detyrave shtetërore.

38 *VKM nr. 867, datë 10.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 193, datë 22 dhjetor 2014.*
VKM nr. 139, datë 20.3.2019 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41, datë 28 mars 2019.

4. Funksionarët, nëpunësit dhe punonjësit e administratës shtetërore, të cilët pengojnë procedurën e bashkëpunimit institucional, kanë përgjegjësi disiplinore sipas legjislacionit përkatës që rregullon marrëdhëniet e tyre të punës.

KREU II
PROCEDURA E BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL PËR SIGURIMIN E TË DHËNAVE, INFORMACIONIT DHE NDIHMËS SË NEVOJSHME

1. *Institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet kësaj procedure, kanë të drejtë:*
   a) të kërkojnë nga institucionet e tjera të administratës shtetërore që t'u sigurohen të dhëna, informacione apo çdo lloj ndihme tjetër, të cilat janë të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale të tyre;
   b) të krijojnë rrjete profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve për fusha të caktuara, të cilat kontribuojnë në rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe komunikimit, me synimin e:
      i. shkëmbimit të eksperiencave më të mira, njohurive dhe praktikave për procese pune të ngjashme;
      ii. shkëmbimit/krahasimit të informacionit apo të të dhënave në fushën përkatëse;
      iii. diskutimit të çështjeve apo problematikave;
   iv. adresimit të kërkesave pranë institucioneve përgjegjëse për të bërë rregullime të posaçme nëpërmjet akteve rregullatore që mbulojnë fushën përkatëse.
2. *Bashkëpunimi, sipas shkronjës "a," të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, mund të shfaqet në një nga format e mëposhtme:*
   a) Kryeministria dhe ministritë me institucionet e tyre të varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome dhe me administratën e prefektit;
   b) Kryeministria me ministritë;
   c) Ministritë ndërmjet tyre;
   ç) Kryeministria me institucionet e varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të ministrive;
   d) Ministritë me institucionet e varësisë, njësitë e drejtpërdrejta

të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të ministrive të tjera;

dh) Institucionet e varësisë, njësitë e drejt-përdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome, brenda një sistemi ministror;

e) Institucionet e varësisë, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, agjencitë autonome, që i përkasin sistemeve ministrore të ndryshme, si dhe me administratën e prefektit.

3. Në çdo moment kur një institucioni të administratës shtetërore i nevojiten, me qëllim realizimin e funksioneve të tij, të dhëna apo informacione që disponohen nga një institucion tjetër, ai ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërdrejt atij institucioni.
4. Kërkesa në këtë rast duhet të përmbajë:
   a) organin që bën kërkesën;
   b) llojin e të dhënave, informacionit apo ndihmës që kërkohet në këto raste;
   c) arsyet e një kërkese të tillë;
   ç) argumentimin e urgjencës nëse ekziston;
   d) nënshkrimin e titullarit të institucionit apo personit përgjegjës.
5. Institucioni pritës duhet të kthejë menjëherë përgjigje për kërkesën për bashkëpunim dhe kurdoherë brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim.
6. Afatet për kthimin e përgjigjeve janë, si më poshtë vijon:
   a) Kur kërkesa bëhet nga Kryeministria apo institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të saj, drejtuar cilitdo institucion, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 7 (shtatë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.
   b) Kur kërkesa bëhet nga ministritë, drejtuar Kryeministrisë dhe/apo institucioneve, njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencive autonome, në varësi të saj, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 9 (nëntë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.
   c) Kur kërkesa bëhet nga ministritë për institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të tyre, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri)

ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 7 (shtatë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

ç) Kur kërkesa bëhet nga ministritë drejtuar ministrive të tjera, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 9 (nëntë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

d) Kur kërkesa bëhet nga ministritë drejtuar institucioneve, njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të ministrive të tjera, si dhe administratës së prefektit, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 4 (katër) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 10 (dhjetë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

dh) Kur kërkesa bëhet nga institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të një ministrie, ose administrata e prefektit, drejtuar institucioneve, njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencive autonome, në varësi të ministrive të tjera, si dhe administratës së prefektit, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 12 (dymbëdhjetë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme.

7. Afati për kthimin e përgjigjeve fillon nga e nesërmja e protokollimit të tyre në regjistrin përkatës të institucionit, të cilit i kërkohet informacioni, dhe mbaron në ditën përkatëse sipas afateve përkatëse brenda orarit zyrtar të asaj dite.
8. Institucioni pritës, për shkaqe me rëndësi dhe duke dhënë një përgjigje të arsyetuar, mund të shtyjë përgjigjen e tij përkatësisht sipas rastit deri në 3 (tri) ditë pune të tjera.
9. Në rastin kur kërkohen të dhëna, informacione apo ndihmë, për të cilat kërkohen njohuri të posaçme shkencore dhe mund të kërkohen ekzaminime apo eksperimente me karakter shkencor, afati për kthimin e përgjigjes nuk mund të jetë më shumë se 20 (njëzet) ditë pune.
10. Në rast se kërkesa ka të bëjë me të dhëna apo informacion të klasifikuar sekret shtetëror, veprohet sipas legjislacionit përkatës që rregullon këtë fushë.
11. Kërkesat për bashkëpunim shqyrtohen nga institucioni pritës, sipas radhës së paraqitjes së tyre, me përjashtim të kërkesave për

bashkëpunim që vijnë nga Kryeministria, të cilat kanë kurdoherë prioritet.

12. Në rast se përgjigjja nuk është e plotë, institucioni dërgues ka të drejtë të kërkojë plotësimin e saj me të dhënat apo informacionin e duhur, duke specifikuar edhe afatin kohor për plotësimin e të metave.
13. Afati sipas pikës 12 nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tri) ditë pune dhe jo më shumë se 7 (shtatë) ditë pune.
14. Institucioni pritës mund të kundërshtojë kërkesën për bashkëpunim, nëse legjislacioni që rregullon fushën e veprimtarisë së tij dhe/apo legjislacioni i fushave të tjera të veçanta e pengon atë për dhënien e të dhënave, të informacionit apo të ndihmës së kërkuar.
15. Në rastin e parashikuar në pikën 14, të kreut II, të këtij vendimi, institucioni pritës, kurdoherë brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, duhet të kthejë një përgjigje zyrtare refuzuese, në të cilën të saktësohet baza ligjore dhe të jepen shpjegimet e nevojshme për refuzimin e kërkesës për bashkëpunim me institucionin kërkues.
16. Nëse institucioni kërkues nuk merr përgjigjen në kohë apo nuk është i bindur nga arsyet e refuzimit të institucionit pritës, ai ka të drejtë t'i drejtohet institucionit epror të institucionit pritës, kur ky i fundit është institucion varësie, duke i kërkuar detyrimin e organit vartës për të dhënë të dhënat, informacionin apo ndihmën e kërkuar, dhe, nëse vonesa ka shkaktuar pasoja në veprimtarinë e institucionit dërgues, edhe propozimin për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës.
17. Kërkesa e përcaktuar në pikën 16, të kreut II, të këtij vendimi, përmban përveç elementeve të përcaktuara në pikën 4, të kreut II, të këtij vendimi, edhe një parashtrim të arsyeve të refuzimit të kërkesës për bashkëpunim, kur ato janë dhënë, si dhe argumentet se përse këto arsye nuk qëndrojnë. Kërkesës i bashkëlidhet edhe përgjigjja zyrtare refuzuese e institucionit pritës, nëse një përgjigje e tillë është dhënë.
18. Institucioni epror, në rast se kërkesa e institucionit kërkues i duket e bazuar, mund ta detyrojë institucionin e tij vartës për plotësimin e kërkesës për bashkëpunim ose ta zëvendësojë atë sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 90/2012.
19. Institucioni epror, në rast se kërkesa e institucionit dërgues i duket e pabazuar, kthen një përgjigje të arsyetuar.

20. Në rast se institucioni dërgues është institucion varësie, ai ka të drejtë t'i drejtohet institucionit të tij epror për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar në këtë rast.
21. Në rastin e parashikuar në pikën 19, të kreut II, të këtij vendimi, nëse institucioni epror e konsideron të bazuar kërkesën e institucionit të tij vartës, i paraqet Kryeministrit kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke parashtruar rrethanat e faktit, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues, përfshirë edhe korrespondencën përkatëse.
22. Kryeministri në këto raste vepron sipas parashikimeve të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe Kodit të Procedurave Administrative.
23. *Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, krijohen për të trajtuar çështje, të cilat lidhen me qëllimin e ekzistencës dhe/ose fushën e përgjegjësisë së institucionit që i krijon. Në to marrin pjesë nëpunës/punonjës të institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë të punësuar në njësitë organizative të ngarkuara me ekzekutimin e detyrave që lidhen me fushën për të cilën krijohet rrjeti dhe kanë njohuri e aftësi më të mira në këtë fushë.*
24. *Rrjetet profesionale ndërinstitucionale të nëpunësve ngrihen me urdhër të Kryeministrit, ministrit përkatës apo titullarit të institucionit, që ka në fushë përgjegjësie fushën për të cilën ngrihet rrjeti. Në urdhrin e ngritjes së rrjetit përcaktohen qëllimi, synimet e përfitimet, struktura udhëheqëse, struktura të tjera në përbërje të tij, nëse është rasti, anëtarët, detyrat e përgjegjësitë, mënyra e organizimit e funksionimit të tij dhe numri maksimal i anëtarëve. Si rregull, në përbërje të rrjetit nuk mund të ketë më shumë se 30 (tridhjetë) anëtarë.*
25. *Si rregull, struktura udhëheqëse e rrjetit profesional ndërinstitucional të nëpunësve është institucioni/njësia organizative, që ka kompetencat më të larta sa i takon fushës në të cilën ngrihet rrjeti.*

KREU III
NGRITJA E GRUPEVE TË PËRBASHKËTA TË PUNËS

1. Grupet e përbashkëta të punës janë grupe me karakter të përkohshëm, të cilat ngrihen sipas rastit me urdhër të ministrit/ministrave apo Kryeministrit dhe kanë si qëllim hartimin e strategjive, politikave, studimeve ose projektakteve të veçanta për administrimin e zbatimit të projekteve të Këshillit të Ministrave.
2. Këshilli i Ministrave, në çdo rast kur harton një projekt, përcakton edhe ministrin përgjegjës për zbatimin e tij. Nëse në projekt përfshihet fusha e përgjegjësisë së disa ministrave, atëherë Këshilli i Ministrave përcakton ministrin kryesor përgjegjës.
3. Në rast se Këshilli i Ministrave nuk ka caktuar ministrin përgjegjës në momentin e hartimit të projektit, atëherë ministri përgjegjës zgjidhet sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012.
4. Për realizimin e projektit të Këshillit të Ministrave, ministri përgjegjës, në rast se grupi i punës mund të krijohet me mjetet dhe personelin e ministrisë që ai drejton apo të institucioneve që janë në varësinë e tij, nxjerr urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës.
5. Në rastet kur projekti i Këshillit të Ministrave prek fushën e veprimtarisë, në përgjegjësi të disa ministrave dhe/apo të institucioneve në varësi të tyre, nxirret një urdhër i përbashkët i ministrave të përfshirë nën drejtimin e ministrit përgjegjës kryesor ose, sipas rastit, të Kryeministrit.
6. Në këtë rast, nismën për miratimin e urdhrit të përbashkët e ka ministri përgjegjës kryesor dhe, kur nuk është përcaktuar, ministri që ka më afër fushën e veprimtarisë, për të cilën është hartuar projekti i Këshillit të Ministrave.
7. Në urdhrin e përcaktuar në pikat 4 dhe 5, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të përcaktohen:
   a) qëllimi i ngritjes së grupit të përbashkët të punës;
   b) objekti i grupit të punës;
   c) struktura përkatëse pranë së cilës do të funksionojë grupi i punës;
   ç) numri i punonjësve që do të përfshihen në grupin e punës dhe ndarja e detyrave;

   d) vendimmarrja e grupit;
   dh) infrastruktura e nevojshme;
   e) mjetet financiare, nëse është e nevojshme;
   ë) afati, brenda të cilit grupi i punës duhet të realizojë detyrat e tij.
8. Në qëllimin e ngritjes së grupit të përbashkët tregohet në mënyrë të përmbledhur projekti i Këshillit të Ministrave dhe detyrat që duhet të realizojë grupi i përbashkët për realizimin e tij.
9. Në objektin e grupit të punës tregohet në mënyrë konkrete detyra, për të cilën është ngritur grupi i punës, që mund të jetë hartimi i një strategjie, politike, studimi apo projektakti ose një kombinim i këtyre rasteve.
10. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohet saktësisht struktura pranë së cilës ky grup do të mblidhet dhe do të funksionojë. Kjo strukturë është një njësi organizative pranë aparatit të Kryeministrisë, ministrive apo institucioneve të varësisë.
11. Në përzgjedhjen e strukturës sipas pikës 10, të kreut III, të këtij vendimi, duhet të merret në konsideratë aksesi i punonjësve që do të jenë pjesë e grupit, si dhe infrastruktura e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre.
12. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen saktësisht numri i nëpunësve që do të marrin pjesë në të, profili, kualifikimi dhe cilësitë e nevojshme që duhet të kenë, si dhe, kur është rasti, ndarja e tyre për çdo institucion të përfshirë në këtë proces.
13. Në rastin kur kërkohet që pjesë e grupit të jenë edhe ekspertë të jashtëm, duhet që në urdhër të specifikohen arsyeja e marrjes së tyre, si dhe profili e kualifikimi që duhet të kenë.
14. Në këtë rast, në urdhër duhet të përcaktohet edhe drejtuesi i grupit të përbashkët ose institucioni që ka të drejtën e emërimit të tij.
15. Me miratimin e urdhrit, titullarët e institucioneve përkatëse të përfshira në këtë proces bëjnë caktimin e nëpunësve të tyre që do të jenë pjesë e grupit të përbashkët.
16. Caktimi i ekspertëve të jashtëm bëhet nga ministri përgjegjës kryesor.
17. Nëpunësit e caktuar duhet që menjëherë t'i bëjnë me dije titullarit të tyre nëse kanë konflikt interesi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe nëse konflikti i interesit zbulohet më vonë.

18. Në rastin e përcaktuar nga pika 17, e kreut III, të këtij vendimi, ose në çdo rast tjetër pamundësie ligjore të nëpunësve të caktuar për të marrë pjesë në grupin e përbashkët, titullarët e institucioneve të përfaqësuara bëjnë zëvendësimet përkatëse.
19. Drejtuesi i grupit të përbashkët ka këto funksione:
    a) Përfaqëson dhe drejton grupin e përbashkët;
    b) U kërkon institucioneve të tjera përgjegjëse shpjegime, relatime dhe verifikime administrative për çështje të fushës që ata mbulojnë dhe që i shërbejnë punës së grupit të përbashkët. Në këtë rast, zbatohen me analogji dispozitat e kreut II, të këtij vendimi;
    c) Organizon dhe asiston në mbarëvajtjen e mbledhjeve të grupit të përbashkët;
    ç) Ndjek procesin e vendimmarrjes së grupit të përbashkët, që nga paraqitja e projekteve për shqyrtim e deri sa ato marrin formë të plotë;
    d) Përcakton detyrat për secilin prej anëtarëve të grupit të përbashkët dhe kontrollon zbatimin e tyre;
    dh) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave, për të cilat është ngritur grupi i përbashkët.
20. Mbledhjet e grupit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë të paktën 2/3 e anëtarëve të grupit.
21. Për shkaqe të arsyeshme, kur mungon njëri prej anëtarëve të grupit, drejtuesi i tij mund të vendosë shtyrjen e mbledhjes për një datë tjetër.
22. Vendimet në grupin e punës merren me votim nominal dhe me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të grupit. Në rast të barazisë së votave, vota e kryetarit të grupit është përcaktuese.
23. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen saktësisht mjediset dhe mjetet e nevojshme materiale, të cilat do t'i shërbejnë grupit të përbashkët për realizimin e detyrave të tij funksionale. Në rast se janë përfshirë disa institucione, në urdhër përcaktohet përgjegjësia e çdo institucioni.
24. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen saktësisht mjetet buxhetore dhe financiare që duhet të mbulojnë veprimtarinë e tij, ku përfshihet, nëse ka, edhe pagesa e ekspertëve të jashtëm. Në rast se këto mjete nuk mbulohen nga

buxhetet e institucioneve të përfshira ose nuk ishin parashikuar në fondet e tyre, atëherë përpara ngritjes së grupit kërkohet detyrimisht mendimi nga Ministria e Financave.
25. Ministria e Financave në bashkëpunim me institucionet e përfshira ndjek procedurat e nevojshme për shpërndarjen e fondeve, duke zbatuar legjislacionin përkatës për buxhetin e shtetit.
26. Në rast se mjetet financiare për grupin e përbashkët mbulohen nga një projekt i huaj, i dhënë nga organizma apo donatorë ndërkombëtarë, përdorimi i tyre bëhet në përputhje me marrëveshjen e arritur me këto subjekte, si edhe me legjislacionin përkatës për buxhetin e shtetit.
27. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët të punës duhet të përcaktohen periudha kohore, brenda së cilës grupi i përbashkët i punës duhet të realizojë detyrat, dhe objekti për të cilin është krijuar.
28. Në urdhër duhet të përcaktohet, gjithashtu, dhe mënyra e arkivimit të dokumentacionit të prodhuar nga grupi i përbashkët me pushimin e ekzistencës së tij.
29. Të dhënat e sipërpërmendura mund të ndryshohen në çdo kohë, sipas rastit, nga minstri përgjegjës me urdhër apo ministrat e përfshirë me urdhër të përbashkët, duke përcaktuar qëllimin, objektin, afatin, personelin, infra-strukturën apo mjetet financiare të tjera, duke zbatuar në këtë rast kërkesat e pikave 7-25, të kreut III, të këtij vendimi.

KREU IV
KRIJIMI I NJËSIVE TË PËRBASHKËTA

1. Njësitë e përbashkëta janë njësi të krijuara midis disa institucioneve me karakter të përkohshëm apo të përhershëm, të cilat krijohen sipas rastit me urdhër të ministrit apo ministrave dhe kanë si qëllim realizimin e detyrave administrative, të cilat për nga natyra e tyre kërkojnë pjesëmarrjen e disa institucioneve.
2. Njësitë e përbashkëta krijohen me personel dhe mjete nga institucione, të cilat janë në varësi të një ministri. Në këtë rast, urdhri për ngritjen e njësisë së përbashkët bëhet nga ministri përgjegjës që ka në varësi institucionet përkatëse.

3. Njësitë e përbashkëta mund të krijohen edhe midis ministrive apo institucioneve që janë në varësi të ministrave të ndryshëm. Në këtë rast, për krijimin e njësisë nxirret një urdhër i përbashkët i ministrave të përfshirë.
4. Nisma për ngritjen e njësisë mund të ndërmerret nga cilido institucion i cili ka interes në krijimin e tij.
5. Në rastin kur njësia e përbashkët do të krijohet për institucionet që janë në varësi të një ministri të vetëm, nisma mund të merret nga vetë ministri kryesisht apo nga institucionet në varësi.
6. Në rast se nisma merret nga institucionet në varësi, institucioni propozues duhet të paraqesë bashkë me propozimin edhe një relacion shoqërues, në të cilin të përcaktohen qëllimi i krijimit të njësisë së përbashkët, institucionet që do të përfshihen, detyrat administrative konkrete që do të realizohen bashkërisht, mënyra e realizimit të tyre, personeli i nevojshëm, mjetet financiare, infrastruktura e nevojshme dhe natyra e përkohshme apo e përhershme e njësisë.
7. Me marrjen e propozimit dhe relacionit shoqërues, ministri njofton nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve pune, institucionet që propozohen të përfshihen.
8. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, institucioni që propozohet të përfshihet në krijimin e njësisë së përbashkët duhet të kthejë përgjigje të argumentuar për pranimin ose jo të propozimit.
9. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së përgjigjes sipas pikës 8, të këtij kreu, ministri vendos për krijimin ose jo të njësisë së përbashkët.
10. Në rastin e ngritjes së njësisë së përbashkët nga disa ministri apo nga institucione, që janë në varësi të ministrave të ndryshëm, propozimi mund të vijë nga vetë ministrat e interesuar kryesisht apo nga vetë institucionet.
11. Në rast se propozimi vjen nga një prej ministrave, atëherë ai shoqërohet me një relacion, i cili përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 6, të kreut IV, të këtij vendimi, dhe i drejtohet ministrit apo ministrave, strukturat e të cilëve, aparat ministrie apo institucione varësie, kërkohen të përfshihen në krijimin e njësisë së përbashkët.
12. Ministri apo ministrat e përfshirë duhet të përgjigjen brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së propozimit.
13. Në rast se kërkohet që në këtë procedurë të përfshihen edhe

institucionet e tyre të varësisë, afati i përgjigjes është deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, me qëllim që ministri, të cilit i është drejtuar propozimi, të marrë edhe mendimin e institucionit/ institucioneve në varësi.
14. Në rast se propozimi vjen nga një institucion varësie, i cili kërkon të krijojë një njësi të përbashkët me një apo disa institucione në varësi të ministrave të tjerë, të ndryshëm nga ministri nën varësinë e të cilit ky institucion është, propozimi bashkë me relacionin shoqërues i dërgohet ministrit, në varësi të të cilit është institucioni propozues.
15. Institucioni i varësisë, në këtë rast, duhet që, brenda 5 (pesë) ditëve, të paraqesë propozimin te ministri, në varësinë e të cilit është.
16. Ministri që merr propozimin sipas pikës 15, të kreut IV, të këtij vendimi, vepron më pas me procedurën e propozimit të përcaktuar në pikën 11, të kreut IV, të këtij vendimi. Më pas, sipas rastit, zbatohen afatet e përcaktuara në pikat 12 dhe 13, të kreut IV, të këtij vendimi.
17. Në rastin e krijimit të njësisë së përbashkët sipas pikave 10-16, të kreut IV, të këtij vendimi, ministrat e përfshirë nxjerrin urdhrin e përbashkët.
18. Në raste të caktuara, nisma për krijimin e njësisë së përbashkët mund të merret edhe nga Kryeministri. Në këtë rast, propozimi shoqërohet me relacionin përkatës dhe u drejtohet ministrive që kërkohet të përfshihen. Ministritë janë të detyruara të japin përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.
19. Në rast mosmarrëveshjeje midis ministrave për krijimin e njësisë së përbashkët apo në rast të nismës së ndërmarrë nga Kryeministri, sipas pikës 18, të kreut IV, të këtij vendimi, njësia e përbashkët krijohet me urdhër të Kryeministrit.
20. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen:
    a) qëllimi i krijimit të njësisë të përbashkët;
    b) objekti i njësisë së përbashkët/detyrat administrative;
    c) struktura përkatëse pranë së cilës do të funksionojë njësia e përbashkët;
    ç) numri i punonjësve që do të përfshihen në njësinë e përbashkët dhe ndarja e detyrave;
    d) vendimmarrja e njësisë;
    dh) infrastruktura e nevojshme;
    e) mjetet financiare;

ë) natyra e njësisë, e përhershme apo e përkohshme, dhe, nëse është e përkohshme, afati brenda të cilit njësia duhet të realizojë detyrat e saj.

21. Në qëllimin e krijimit të njësisë së përbashkët tregohen në mënyrë të përmbledhur detyrat e përbashkëta që kërkohet të realizohen në këtë rast.
22. Në objektin e njësisë tregohen në mënyrë konkrete detyrat administrative, për të cilat është krijuar njësia dhe që mund të jenë inspektimi, kontrolli, sekuestrimi, konfiskimi, parandalimi, ndalimi dhe detyra të tjera të nevojshme për arritjen e qëllimit të përbashkët.
23. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohet struktura, pranë së cilës kjo njësi do të mblidhet dhe do të funksionojë. Kjo strukturë mund të jetë një njësi organizative pranë aparatit të Kryeministrisë, ministrive apo institucioneve të varësisë.
24. Në përzgjedhjen e strukturës sipas pikës 23, të kreut IV, të këtij vendimi, duhet të merren në konsideratë aksesi i punonjësve që do të jenë pjesë e njësisë, si dhe infrastruktura e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre.
25. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen numri i nëpunësve që do të marrin pjesë në të, profili, kualifikimi dhe cilësitë e nevojshme që duhet të kenë, si dhe, kur është rasti, ndarja e tyre për çdo institucion të përfshirë në këtë proces.
26. Në urdhër në këtë rast duhet të përcaktohet edhe drejtuesi i njësisë së përbashkët ose institucioni që ka të drejtën e emërimit të tij.
27. Me miratimin e urdhrit, titullarët e institucioneve përkatëse të përfshira në këtë proces bëjnë caktimet e nëpunësve të tyre që do të jenë pjesë e njësisë së përbashkët.
28. Nëpunësit e caktuar duhet që menjëherë të deklarojnë nëse kanë konflikt interesi. Konflikti i interesit deklarohet edhe në rastet kur ai lind gjatë ushtrimit të detyrës.
29. Në rastin e përcaktuar nga pika 29, e kreut IV, të këtij vendimi, ose në çdo rast tjetër pamundësie ligjore të nëpunësve të emëruar (të caktuar) për të marrë pjesë në njësinë e përbashkët, titullarët e institucioneve emëruese bëjnë zëvendësimet përkatëse, brenda 2 (dy) ditëve pune.
30. Drejtuesi i njësisë së përbashkët ka këto funksione:

a) Përfaqëson dhe drejton njësinë e përbashkët;
b) U kërkon institucioneve të tjera përgjegjëse shpjegime, relatime dhe verifikime administrative për çështje të fushës që ata mbulojnë dhe që i shërbejnë punës së njësisë së përbashkët. Në këtë rast, zbatohen me analogji dispozitat e kreut II, të këtij vendimi;
c) Organizon dhe asiston në mbarëvajtjen e mbledhjeve të njësisë së përbashkët;
ç) Ndjek procesin e vendimmarrjes së njësisë së përbashkët dhe kujdeset për realizimin e detyrave administrative përkatëse;
d) Përcakton detyrat për secilin prej anëtarëve të njësisë së përbashkët dhe kontrollon zbatimin e tyre;
dh) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilin është krijuar njësia e përbashkët.

31. Njësitë e përbashkëta të përhershme funksionojnë si struktura ekzekutive /urdhërdhënëse, me qëllim realizimin dhe përmbushjen e detyrave administrative të përbashkëta të institucioneve të përfshira në këtë njësi.
32. Në urdhrin për ngritjen e grupit të përbashkët, autoritetet e përfshira duhet të delegojnë edhe kompetencat e nevojshme për vendimmarrjen e kësaj njësie.
33. Këto kompetenca i delegohen si rregull drejtuesit të njësisë së përbashkët.
34. Delegimi i kompetencave duhet të bëhet në përputhje me parashikimet përkatëse në Kodin e Procedurave Administrative dhe në ligjin nr. 90/2012.
35. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen saktësisht mjediset dhe mjetet e nevojshme materiale, të cilat do t'i shërbejnë njësisë së përbashkët për realizimin e detyrave të saj funksionale. Në rast se janë përfshirë disa institucione, në urdhër përcaktohet përgjegjësia e çdo institucioni.
36. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohen saktësisht mjetet buxhetore dhe financiare që duhet të mbulojnë veprimtarinë e saj. Në rast se këto mjete nuk mbulohen nga buxhetet e institucioneve të përfshira ose nuk ishin parashikuar në fondet e tyre, atëherë përpara ngritjes së njësisë kërkohet detyrimisht mendimi nga Ministria e Financave.

37. Ministria e Financave në bashkëpunim me institucionet e përfshira ndjek procedurat e nevojshme për shpërndarjen e fondeve duke zbatuar legjislacionin përkatës për buxhetin e shtetit.
38. Në urdhrin për krijimin e njësisë së përbashkët duhet të përcaktohet nëse kjo njësi do të ketë natyrë të përhershme apo të përkohshme.
39. Në rast se ngritja e njësisë përcaktohet që të jetë me afat, në urdhër përcaktohet periudha kohore, brenda së cilës njësia duhet të realizojë detyrat administrative dhe qëllimin për të cilin është krijuar.
40. Urdhri, gjithashtu, duhet të përcaktojë dhe mënyrën e arkivimit të dokumentacionit të prodhuar nga njësia e përbashkët me pushimin e ekzistencës së saj.
41. Të dhënat e mësipërme mund të ndryshohen në çdo kohë, sipas rastit, nga Kryeministri/ministri përgjegjës me urdhër apo ministrat e përfshirë me urdhër të përbashkët, duke përcaktuar qëllimin, objektin, afatin, personelin, infrastrukturën apo mjetet financiare të tjera, por duke zbatuar në çdo rast kërkesat e pikave 21-41, të kreut IV, të këtij vendimi.
42. Titullarët e institucioneve të përfshira në njësinë e përbashkët mblidhen çdo gjashtë muaj për t'u informuar nga drejtuesi i njësisë në lidhje me ecurinë e punës dhe realizimin e detyrave administrative që i janë ngarkuar.
43. Punonjësit e njësisë së përbashkët, çdo 6 (gjashtë) muaj, vlerësohen për ecurinë e tyre në punë në njësi. Ky vlerësim nuk ndikon në vlerësimin e tyre të përgjithshëm që bëhet sipas legjislacionit specifik që rregullon marrëdhënien e tyre të punës.

KREU V

BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE VENDORE NË FUNKSION TË PROCESIT TË LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE

(Shtuar me VKM-në nr. 435, datë 26.6.2024)

1. ASHK-ja dhe bashkitë, sipas ndarjes territoriale, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë administrative, në kuadër të trajtimit me prioritet dhe përfundimit të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në zbatim të legjislacionit për përfundimin e proceseve

kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. Bashkëpunimi ndërmjet ASHK-së dhe çdo bashkie në këtë proces realizohet nëpërmjet marrëveshjes përkatëse, të nënshkruar sipas modelit të shtojcës A, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Rregullat për bashkëpunimin, sipas këtij kreu, zbatohen vetëm për procedurat administrative të papërfunduara në zonat me prioritet zhvillimin urban, për të cilat janë miratuar nga bashkia dokumente të planifikimit të territorit, në kuptim të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe për zonat informale, në të cilat evidentohet nga bashkia një numër i konsiderueshëm ndërtimesh pa leje, që shërbejnë kryesisht për funksione banimi.
3. Për qëllim të këtij procesi, ASHK-ja dhe bashkia shkëmbejnë informacion në mënyrë të vazhdueshme, sipas mënyrave të përcaktuara në këtë vendim, bashkërendojnë veprimtarinë administrative nëpërmjet asistencës dhe mbështetjes teknike në terren, si dhe lehtësojnë ndërveprimin e ndërsjellë.
4. ASHK-ja dhe bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin e këtij bashkëpunimi, duke përfshirë burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim trajtimin me prioritet dhe përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në marrëveshje.
5. Marrëveshja zbatohet vetëm për ndërtimet pa leje brenda territorit, që mbulon bashkia, sipas ndarjes territoriale në fuqi. Me qëllim zbatimin efektiv të këtij vendimi, bashkia harton listën e nënzonave dhe identifikon bllokun gjeografik prioritar, në funksion të planifikimit të territorit dhe i dërgon ASHK-së listën përkatëse.
6. Ministri i Shtetit për Pushtetit Vendor koordinon procesin e zbatimit të këtij vendimi, si dhe të marrëveshjes ndërmjet ASHK-së dhe bashkisë përkatëse.
7. Objekti i bashkëpunimit ndërmjet ASHK-së dhe bashkive përfshin:
   a) shkëmbimin në mënyrë të ndërsjellë të informacionit, lidhur me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim administrimin e të dhënave dhe monitorimin e ecurisë së procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje;
   b) identifikimin e subjekteve dhe evidentimin në terren. Bashkia, për efekt të planifikimit dhe të zhvillimit urban, mund të identifikojë subjektet që kanë paraqitur kërkesa për legalizim sipas ligjit dhe

të evidentojë në terren objektet pa leje në proces legalizimi, që ndodhen në zonën/bllokun kadastral gjeografik me prioritet zhvillimi urban dhe zonë informale banimi;

c) informimin dhe mbështetjen për plotësimin e dokumentacionit dhe evidentimin. Bashkia koordinon me ASHK-në dhe informon subjektet që kanë paraqitur kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje në zonat objekt i këtij vendimi, lidhur me procedurat e legalizimit, si dhe ofron asistencën e mbështetjen për plotësimin e dokumentacionit, procesin e evidentimit në terren e në përfundim njoftimin për vendimmarrjen;

d) bashkëpunimin gjatë procesit të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje në zonën/bllokun kadastral, nëpërmjet angazhimit të ndërsjellë të burimeve të nevojshme njerëzore e financiare, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.

8. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet ASHK-së dhe bashkive, sipas parashikimeve të këtij vendimi, kryhet në rrugë shkresore dhe/ose elektronike.

9. Në funksion të realizimit të këtij procesi, bashkia përkatëse:

a) njofton subjektet që kanë aplikuar për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonën me prioritet zhvillimi urban dhe zonën informale të banimit, që të paraqesin kopje të kërkesës për legalizim apo dokumentacion tjetër të nevojshëm për trajtimin me prioritet të procesit;

b) administron të dhënat dhe e plotëson atë me informacionin për të dhënat e objekteve ndërtime pa leje dhe subjektet përkatëse, sipas zonave/blloqeve përkatëse, që do t'i nënshtrohen procesit, duke i ndarë sipas kategorive përkatëse;

c) përcjell informacionin e grumbulluar dhe të konsoliduar në funksion të evidentimit të subjekteve dhe të ndërtimeve objekte pa leje të zonës/bllokut përkatës te ASHK-ja;

ç) vepron si ndërlidhës/ndërmjetës ndërmjet ASHK-së dhe komunitetit vendor në zonën përkatëse, lidhur me procesin e matjeve në terren të objekteve të ndërtimeve pa leje, kontribuon në ndërgjegjësimin e tij, si dhe lehtëson komunikimin e ndërveprimin e ndërsjellë ndërmjet ASHK-së dhe subjekteve.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në funksion të realizimit të këtij procesi:

a) bashkëpunon me bashkinë për evidentimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban e të zonave informale të banimit dhe identifikimin e subjekteve që kanë paraqitur kërkesat;

b) merr masa administrative për caktimin e punonjësve përkatës në funksion të bashkërendimit të veprimtarive administrative me bashkinë, si dhe për realizimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, me volumin e kërkesave të evidentuara për këto zona;

c) angazhohet të trajtojë me prioritet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban e të zonave informale të banimit, si dhe të njoftojë subjektet për vendimmarrjen dhe bashkinë.

11. ASHK-ja trajton kërkesat e subjekteve për ndërtimet pa leje që ndodhen në këto zona, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

12. ASHK-ja dhe bashkia rakordojnë e koordinojnë të dhënat e mbledhura, si dhe japin përkatësisht informacion periodik te ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

13. Në çdo rast, trajtimi me prioritet i kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje, të propozuara nga bashkia, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi, nuk pengon vijimin e veprimtarisë administrative të ASHK-së për legalizimet e ndërtimeve pa leje në zonat që ndodhen jashtë këtyre zonave/blloqeve kadastrale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

14. ASHK-ja u propozon bashkive lidhjen e marrëveshjeve brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri

Edi Rama

Shtojca A

(Shtuar me VKM-në nr. 435, datë 26.6.2024)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(SHTOJCA A)

BASHKIA..... **AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

Nr._____prot. Datë __.__.2024 Nr._____prot. Datë __.__.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
(TIP)

"Agjencia Shtetërore e Kadastrës" (**ASHK**), me seli në Tiranë, rruga "Dora d'Istria", person juridik publik, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, znj. Dallëndyshe Bici;
dhe
"Bashkia _____" , me seli në ....., person juridik publik, përfaqësuar nga kryetari .....;
të dyja së bashku të referuara më poshtë si "*Palë*t";
të ndërgjegjshëm për rëndësinë e trajtimit me prioritet të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të rritjes së efikasitetit të këtyre procedurave administrative;
të ndërgjegjshëm se përfshirja e bashkive në procese që lidhen me administrimin e territorit mundëson zbatimin më efikas të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe është më pranë qytetarit;
palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Neni 1
Qëllimi
Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve, në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me

prioritet të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.

Neni 2
Baza ligjore
Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në:
- Kushtetutën e Shqipërisë;
- Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën";
- Ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Neni 3
Objekti
Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe bashkisë, në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit të Bashkisë, në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit.

Neni 4
Parimet e bashkëpunimit
Zbatimi i bashkëpunimit, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, realizohet në respektim të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe autonomisë vendore, të ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 5

Mënyra e bashkëpunimit

Në kuadër dhe në zbatim të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, palët angazhohen të bashkëpunojnë, bashkëveprojnë dhe koordinohen, në lidhje me sa vijon:

- të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion, lidhur me ecurinë e procesit të legalizimit në funksion të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm për proceset tranzitore;
- të komunikojnë, bashkërendojnë dhe koordinojnë veprimtarinë administrative ndërmjet tyre, në funksion të realizimit të kësaj marrëveshjeje;
- të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, përcaktojnë planin e punës, si dhe grafikun e prioriteteve në funksion të trajtimit me prioritet të procesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- të caktojnë burime njerëzore të nevojshme për administrimin efikas të procesit administrativ. Për këtë qëllim, ASHK-ja dhe bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin të këtij bashkëpunimi, duke përdorur të gjithë mekanizmat ligjore, financiare dhe/ose në burime njerëzore në dispozicion për përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në këtë marrëveshje. Bashkia, sipas rastit, mund të transferojë fond me terma dhe specifikime të veçanta, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në favor të ASHK-së, për të mbuluar shpenzimet e pagave të stafit që do të angazhohet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në çdo rast, nëse palët vendosin transferimin e fondit nga bashkia tek ASHK-ja, fondi përdoret nga ASHK-ja vetëm për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje dhe në përputhje me specifikimet përkatëse. Bashkia, sipas rastit mund të vendosë në dispozicion të ASHK-së, nëpërmjet transferimit të punonjësve të bashkisë pranë ASHK-së, në funksion të realizimit të qëllimeve të kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes, stafi i nënshtrohet procedurave ligjore të punësimit, sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për kadastrën;
- të informojnë ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, në mënyrë periodike, në lidhje me ecurinë e zbatimit të marrëveshjes dhe të VKM-së për "Rregullimin e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe vendore, për përshpejtimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje";
- të bashkëpunojnë për realizimin sa më efikas, transparent dhe profesional të procesit administrativ në çdo formë tjetër që vlerësohet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Angazhimet e palëve

(Shtuar shkronja "gj" e pikës 2 me vendimin nr. 727, datë 20.11.2024)

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, angazhohet të kryejë si vijon:

a) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin dhe evidentimin e kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;
b) të organizojë dhe të caktojë stafin e drejtorisë vendore të ASHK-së, në territorin e së cilës ndodhen nënzonat e propozuar nga bashkia, në funksion të realizimit të këtij procesi me volumin e kërkesave;
c) të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shpenzimin e fondit të transferuar nga bashkia sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje. Të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe procedurat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, në lidhje me punësimin e stafit të bashkisë për periudhën e kohëzgjatjes së marrëveshjes;
ç) të bashkëpunoj me stafin e bashkisë në kryerjen e procedurave të evidentimit në terren të objekteve në proces legalizimi në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;
d) të kryejë veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga bashkia, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të palëve. Përfaqësuesit e palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm;
e) të trajtojë me prioritet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale të banimit;
f) të informojë bashkinë, pa vonesë, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, për problematikat e hasura gjatë procedurës

administrative, duke propozuar zgjidhje në funksion të ecurisë së procesit.

2. Bashkia, në zbatim të kësaj marrëveshjeje, angazhohet të kryejë si vijon:

a) të identifikojë dhe hartojë një listë të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale, kryesisht me funksion banimi, të ndara sipas nënzonave. Për këtë qëllim, bashkia harton listën me nënzonat brenda territorit dhe ia dërgon atë ASHK-së;

b) t ë përcjell te ASHK-ja nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, informacionin e grumbulluar dhe konsoliduar mbi evidentimin e subjekteve dhe ndërtimeve pa leje të zonës/bllokut përkatës, për procesim të mëtejshëm sipas legjislacionit në fuqi;

c) të vlerësojë krijimin e njësisë përgjegjëse dhe të caktojë stafin që do të përfshihet në administrimin e procesit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje;

ç) të identifikoj stafin e specializuar që do të vihet në dispozicion të ushtrojë detyrat pranë ASHK-së gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi, për propozimin dhe vënien në dispozicion për efekt të realizimit të parashikimeve të kësaj marrëveshjeje. Të identifikojë fondin që mund t'i transferohet nga ASHK-ja, për qëllim të realizimit të kësaj marrëveshjeje dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi për transferimin e fondit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje;

d) të ofrojë ndihmë dhe informacion nëpërmjet stafit të bashkisë për subjektet mbi statusin e aplikimit dhe fazën apo ecurinë e procesit, në bllokun gjeografik prioritar të identifikuar nga bashkia;

e) të informojnë dhe sensibilizojnë subjektet në nënzona për procedurat e evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje që do të kryhet nga ASHK-ja, si dhe të asistojë stafin e ASHK-së gjatë kryerjes së procedurave të evidentimit në terren të ndërtime pa leje;

f) të marrë pjesë në veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga bashkia, në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të palëve. Përfaqësuesit e palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm;

g) të informojë ASHK-në, në lidhje me projektet/studimet e bashkisë, të miratuara në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

gj) në rastet kur evidentimi në terren kryhet nga specialistët e bashkisë, akti i evidentimit në terren nënshkruhet prej tyre, sipas formatit të miratuar në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

Neni 7
Komunikimi midis palëve

Rakordimi i veprimeve administrative dhe shkëmbimi i informacionit shkëmbimit të informacionit kryhet vetëm në formë shkresore dhe/ose elektronike.

Neni 8
Përdorimi i informacionit

Informacioni i mbledhur, përpiluar, procesuar dhe shkëmbyer midis palëve, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, përdoret vetëm për realizimin e bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9
Shkëmbimi i informacionit në mënyrë periodike

1. Përfaqësuesit e palëve mbajnë kontakt të vazhdueshëm, në funksion të zbatimit efektiv të kësaj marrëveshjeje. Përfaqësuesit zhvillojnë çdo muaj takime, në lidhje me ecurinë e procesit administrativ.
2. Në fund të çdo muaji, çdo përfaqësues harton informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit dhe ia dërgon përkatësisht drejtorit të ASHK-së dhe kryetarit të bashkisë. Drejtori i ASHK-së dhe kryetari i bashkisë i dërgojnë, çdo muaj, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor informacionin e detajuar mbi ecurinë.

Neni 10
Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimin e saj nga palët dhe është e vlefshme 1 (një) vit nga momenti i nënshkrimit të saj.

2. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi bëhet në formë shkresore dhe me miratimin e të dyja palëve.
3. Secila palë, nëse për arsye objektive është në pamundësi objektive për të përmbushur angazhimet sipas kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, mund ta zgjidhë atë në mënyrë të njëanshme në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.
4. Secila palë mund ta zgjidhë marrëveshjen në çdo kohë, nëse pala nuk respekton detyrimet e përcaktuara dhe nuk merr masa për rregullimin e pasojave, brenda 10 ditëve nga njoftimi me shkrim i palës tjetër.

Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale.

BASHKIA	AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
KRYETAR	DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VENDIM

Nr. 623, datë 26.10.2018

PËR MIRATIMIN E KARTËS SË TË DREJTAVE TË QYTETARIT PËR PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 36, të ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Karta e të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Të drejtat e parashikuara në këtë kartë janë të zbatueshme për ministritë e linjës, institucionet e tjera përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.
3. Ngarkohen ministritë e linjës dhe institucionet e tjera, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KARTA E TË DREJTAVE TË QYTETARIT PËR PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Të drejtat e qytetarëve dhe të biznesit në procesin e përfitimit të shërbimeve publike nga institucionet që janë të autorizuara nga legjislacioni për dhënien e tyre janë, si më poshtë vijon:

1. E drejta për informim

Ne, institucionet e administratës shtetërore, ju informojmë për llojet e shërbimeve publike që ofrohen nga administrata shtetërore, qëllimin e tyre, mundësinë e përfitimit të tyre, dokumentacionin që duhet të sigurohet, me qëllim marrjen e shërbimit, procedurat që duhen ndjekur, llojet e vendimmarrjes gjatë procesit të dhënies së shërbimit dhe mundësinë për ankim. Informacioni, në çdo rast, duhet që të jetë i përditësuar dhe i plotë. Në asnjë rast, ne nuk mundet t'ju kërkojmë dokumentacion shtesë jashtë atyre të kërkuara nga legjislacioni në fuqi për dhënien e shërbimit dhe atyre që janë publikuar nga organi ofrues i shërbimit publik.

Ne ju garantojmë mundësinë që të njiheni dhe të informoheni në çdo kohë për ecurinë dhe fazën në të cilën ndodhet kërkesa juaj, duke ju garantuar informacion të saktë e të plotë. Ju keni të drejtë të njiheni me tarifat e shërbimit dhe nuk duhet të përballeni me tarifa të fshehta apo tarifa të tjera shtesë gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës suaj.

2. E drejta për përdorimin e shërbimeve publike

Ju, qytetarë dhe biznese, duhet të keni mundësi të plotë në përfitimin e shërbimeve publike. Për të realizuar këtë të drejtë, ju nuk keni detyrimin që të pajiseni me një autorizim apo të bëni një deklaratë para institucioneve të administratës shtetërore. Për këtë qëllim, ne ju krijojmë mundësi reale e të shpejtë për përfitimin e shërbimeve publike nëpërmjet sporteleve fizike dhe sporteleve elektronike. Sportelet fizike, në çdo rast, duhet t'i sigurojnë akses, për aq sa është e mundur, të gjithë popullsisë, pavarësisht se ku banon ajo. Gjithashtu, duke aplikuar zgjidhjet TIK, ne duhet të përpiqemi për ofrimin e shërbimeve nëpërmjet sporteleve elektronike dhe zgjidhjeve të tjera inovative.

3. E drejta e tërheqjes nga kërkesa

Ju keni të drejtë të tërhiqeni në çdo kohë nga kërkesa juaj për përfitimin e shërbimeve publike, me kusht që kërkesa juaj të mos jetë trajtuar me

vendim përfundimtar nga ana e institucioneve të administratës publike. Këto institucione duhet t'u përgjigjen sa më shpejt kërkesave.

4. Mënjanimi i barrës mbi qytetarët dhe bizneset

Ne duhet të kujdesemi të mos kërkojmë nga ju që të paraqisni informacion dhe/ose dokumen-tacion që prodhohet apo ndodhet pranë institucioneve. Ne, nëpërmjet zgjidhjeve inovative apo formave të tjera të përshtatshme, duhet të kujdesemi që informacionin/dokumentacionin e nevojshëm ta sigurojmë vetë. Në ato raste kur informacioni/dokumentacioni i kërkuar është në bazën e të dhënave të organeve të administratës shtetërore, mbajtësi i bazës së të dhënave duhet të sigurojë mundësinë e përdorimit të drejtpërdrejtë për institucionet e administratës shtetërore. Në çdo rast, informacioni/dokumentacioni i integruar apo që sigurohet vetë nga ana e institucioneve të administratës shtetërore bëhet publik, por ka vetëm vlerë informuese për ju. Ky informacion bëhet publik që ju të keni dijeni për të dhënat tuaja personale që do të përpunohen, por, në asnjë rast, nuk do të jetë detyrim për ju që t'i paraqisni ato.

5. E drejta për trajtim të barabartë në ofrimin e shërbimeve publike

Ne ju mundësojmë trajtim të barabartë në ofrimin e shërbimeve publike. Procesi i dhënies së shërbimit nuk mund të përmbajë kritere diskriminuese lidhur me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionin gjenetik, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër. Ne ju garantojmë mundësi të barabarta për të përfituar nga shërbimet e ofruara.

Personat me aftësi të kufizuara kanë përparësi gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve publike, duke mënjanuar pritjet në sportele, si dhe nëpërmjet ofrimit të asistencës nga ana e nëpunësve përgjegjës për ofrimin e shërbimit. Ofrimi i shërbimeve do të jetë në zbatim të standardeve të aksesueshmërisë fizike dhe në informacion. Mjetet, mënyrat dhe formatet e komunikimit të përdorura në ofrimin e shërbimeve publike do të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë në komunikim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. E drejta për ndihmë aktive gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve
Ju keni të drejtë të asistoheni nga nëpunësit e institucionit përgjatë procesit të marrjes së shërbimit, duke filluar që nga momenti i formulimit të kërkesës dhe në të gjitha fazat që kalon procesi për dhënien e shërbimit. Nëpunësit përgjegjës për ofrimin e shërbimit duhet të japin informacion dhe të kryejnë veprime aktive në favorin tuaj, me qëllim, lehtësimin e procedurës administrative, si edhe realizimin dhe ofrimin në mënyrë përfundimtare të shërbimeve të kërkuara nga ju. Ofruesi i shërbimit duhet të jetë bashkëpunues edhe në rastet kur ai nuk është kompetent për ofrimin e shërbimit të kërkuar, duke ju orientuar e sqaruar për vendin dhe mënyrën se si mund ta merrni shërbimin e kërkuar.

7. E drejta për zgjidhje efektive
Ju keni të drejtë të merrni një shërbim përfundimtar për kërkesën e paraqitur. Ne ju garantojmë zgjidhje efektive për shërbimet e kërkuara, duke ju ofruar zgjidhje të shpejtë e të sigurt në favorin tuaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ne nuk ju ngarkojmë me kërkesa, kritere apo dokumentacione shtesë, të cilat nuk janë të nevojshme në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Në çdo rast, ne duhet t'ju garantojmë një vendim përfundimtar për çdo kërkesë për përftimin e shërbimeve publike të paraqitur.

8. E drejta për të proceduar kërkesën tuaj sipas radhës së aplikimit
Ne ju garantojmë që kërkesa/aplikimi juaj do të trajtohet nga ana jonë sipas radhës së paraqitjes së saj dhe, kurdoherë, brenda afatit të parashikuar.

9. E drejta për marrjen e shërbimit brenda afateve të arsyeshme
Ne ju ofrojmë shërbimin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe, kur nuk ka afate të tilla, brenda një afati të arsyeshëm, sipas natyrës së kërkesës, në përputhje me përcaktimet në Kodin e Procedurave Administrative dhe/ose në legjislacionin sektorial. Në çdo rast, ne duhet të përpiqemi që kërkesat tuaja t'i trajtojmë edhe përpara përfundimit të afatit të përcaktuar për secilin shërbim publik.
Ne duhet të mënjanojmë kryerjen e hapave të panevojshëm në ofrimin e shërbimeve, të cilat zgjasin në mënyrë të paarsyeshme ofrimin e shërbimit të kërkuar. Ne duhet t'ju asistojmë në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe të dokumentacionit, me qëllim reduktimin dhe/ose mënjanimin e kërkesave me të meta, të cilat sjellin tejzgjatje të paarsyeshme në procesit e ofrimit të shërbimeve publike.

Ne ju garantojmë respektimin e një afati të arsyeshëm edhe gjatë pritjes apo kryerjes së veprimeve administrative pranë sporteleve të ofrimit të shërbimeve.

10. E drejta për marrjen e një shërbimi në mënyrë transparente
Ne duhet t'ju informojmë për mënyrën e trajtimit të kërkesave tuaja, me qëllim mënjanimin e pengesave ligjore apo ndikimeve të papër-shtatshme.
Ne duhet t'ju garantojmë një strukturë përgjegjëse për trajtimin e rasteve të korrupsionit, abuzimit, si dhe të hartojmë një procedurë të brendshme, që do të shërbejë për trajnimin dhe raportimin e këtyre rasteve.
Çdo informacion në lidhje me përfitimin e shërbimit ne do ta publikojmë në vende të dukshme, në sportelet ku aplikohet për marrjen e shërbimit, si dhe në faqen e internetit të çdo institucioni.
Ju keni të drejtë të pajiseni me numrat përkatës, që identifikojnë aplikimet tuaja, me qëllim gjurmueshmërinë e kërkesës suaj.

11. Alternativat në paraqitjen e kërkesës dhe në ofrimin e shërbimit
Ne ju mundësojmë mënyra alternativa për paraqitjen e kërkesave për shërbim, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të aplikimit, si p.sh., drejtpërdrejt në sportelet e shërbimit, të postës, në shërbime elektronike, si dhe në çdo mënyrë tjetër, që nuk ndalohet shprehimisht në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe që është e përshtatshme dhe përmbush qëllimin. Ne do të përpiqemi të sigurojmë, për aq sa është e mundur, realizimin e shërbimeve publike kurdo e kudo.
Ju keni të drejtë që të kërkoni që komunikimi me ne, gjatë ofrimit të shërbimit, të realizohet nëpërmjet të njëjtit kanal komunikimi që ju keni përzgjedhur.

12. E drejta për të mos u penalizuar për gabimet/pasaktësitë e institucioneve të administratës shtetërore
Ne ju garantojmë që çdo gabim apo pasaktësi në shërbimin publik që ju është ofruar dhe që rrjedh si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të nëpunësve/punonjësve tanë nuk do të rëndojë mbi ju. Ne marrim përsipër që pa kosto shtesë dhe brenda një afati të arsyeshëm të korrigjojmë dhe/apo plotësojmë gabimet e pasaktësitë, me qëllim ofrimin e një shërbimi publik sa më të plotë.

13. E drejta për ankim

Ju keni të drejtë të ankoheni kundër çdo veprimi administrativ, me të cilin shërbimi i kërkuar nga ana juaj është refuzuar, është ofruar jashtë afatit apo është dhënë i mangët ose paplotë. Ne ju mundësojmë mjetet e nevojshme për realizimin e ankimit tuaj. Njësia përgjegjëse për marrjen dhe shqyrtimin e ankimit, afati i paraqitjes së tij, periudha e shqyrtimit dhe e drejta për t'ju drejtuar gjykatës duhet t'ju bëhet e njohur që në momentin e paraqitjes së aplikimit për dhënien e shërbimit. Në çdo rast, ne duhet t'ju kthejmë një përgjigje të arsyetuar për trajtimin e kërkesës së ankuesit. Trajtimi i ankesave kundër shërbimeve të ofruara duhet të bëhet brenda një afati të arsyeshëm, sipas pikës 8 të kësaj karte.

14. Infrastruktura në ofrimin e shërbimeve publike

Ju keni të drejtë që të keni në dispozicion ambiente të përshtatshme gjatë pritjes, paraqitjes së kërkesave apo marrjes së shërbimit të kërkuar. Ne duhet t'ju sigurojmë infrastrukturën e duhur në marrjen e shërbimit, duke siguruar prioritet në trajtimit subjekteve dhe të kërkesave të paraqitura më parë në kohë.

Ne duhet të sigurojmë një përshtatje të arsyeshme në ambientet tona edhe për qytetarët me aftësi ndryshe (vendosje e sinjalistikës, rampës, parkimit etj.), të cilët kërkojnë të përfitojnë nga ofrimi i shërbimeve publike. Po ashtu, ne, për aq sa është e mundur, do të caktojmë një nëpunës/punonjës, i cili do të ketë njohuritë e duhura për të komunikuar me personat me aftësi ndryshe.

15. Përgjegjshmëria ndaj qytetarëve dhe biznesit

Ju gëzoni të drejtën e një shërbimi të përgjegjshëm nga ana jonë, për të përmbushur kërkesat dhe për realizimin e të drejtave tuaja. Në rastet kur ju dëmtoheni nga veprimet apo mosveprimet e kryera nga ana jonë, keni të drejtë të shpërbleheni për dëmin e pësuar, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Mbrojtja e të dhënave personale, informacioneve apo sekreteve tregtare

Ne ju garantojmë se, nëse gjatë ofrimit të shërbimeve publike përpunojmë të dhënat tuaja, ato do të ruhen dhe nuk do të përhapen në mënyrë të paautorizuar dhe pa shkaqe ligjore. Me të dhëna kuptohen të dhënat

personale, gjyqësore, sensitive, si dhe çdo e dhënë tjetër, që, në origjinë ose gjatë përpunimit, nuk mund t'ju publikohen. Po ashtu, ne duhet të ruajmë edhe informacionet apo sekretet tregtare të bizneseve, të cilat lidhen me ushtrimin e aktivitetit e tyre.

17. E drejta për këshillim paraprak

Ju keni të drejtë të kërkoni një mendim nga institucionet e administratës publike në lidhje me trajtimin e kërkesave dhe mënyrën e realizimit të së drejtës suaj. Në këto raste, institucionet e administratës shtetërore, që nuk janë kompetente për trajtimin e kërkesave të paraqitura, duhet t'ju këshillojnë për institucionin e administratës shtetërore kompetent, procedurën dhe afatet që duhen ndjekur, si dhe çdo të dhënë tjetër për marrjen e shërbimit të kërkuar.

Në rastet e këshillimit, ne do të shmangim terminologjinë e rënduar, duke ju orientuar qartë dhe thjesht në marrjen e shërbimit të kërkuar.

18. E drejta për shërbim cilësor

Ne detyrohemi të trajnojmë nëpunësit/ punonjësit tanë, të ngarkuar me ofrimin e shërbimeve publike, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me korrektësi. Trajnimet duhet të përfshijnë, por pa u kufizuar në to, njohjen e të drejtave të parashikuara në këtë Kartë, rregullat e etikës dhe të sjelljes në shërbimin ndaj qytetarit, si dhe zhvillimin e koncepteve të tjera, në funksion të trajtimit të kërkesave tuaja. Paraqitja dhe mënyra e shërbimit është edhe një nga matësit e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike.

19. Pjesëmarrja në përmirësimin e shërbimeve publike

Juve ju garantohet e drejta për të marrë pjesë në ndryshimin apo përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet mendimeve, vlerësimeve dhe/ose sugjerimeve të dërguara në drejtimin tonë. Në rastet kur ne vendosim të ndryshojmë mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike, duhet të marrim në konsideratë mendimet tuaja përgjatë procesit të ofrimit të shërbimeve.

20. Publikimi, informimi dhe edukimi

Ne marrin masa për publikimin në mënyrë të përshtatshme të kësaj Karte në ambientet tona, me qëllim njoftimin tuaj për të drejtat e njohura

dhe të parashikuara në këtë akt. Ky publikim duhet të bëhet jo më vonë 30 ditë, nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave, që miraton këtë kartë.

Të drejtat e njohura dhe të garantuara në këtë kartë duhet të transmetohen në mënyra të ndryshme te nëpunësit/punonjësit që ofrojnë shërbime publike, si dhe te ju, me qëllim edukimin dhe respektimin e këtyre të drejtave gjatë ofrimit të shërbimeve publike në praktikë.

Fletore zyrtare nr. 155, datë publikimi 14.05.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE

LISTA TIP ME AFATET E RUAJTJES SË DOKUMENTEVE ME RËNDËSI HISTORIKE KOMBËTARE (RHK)

Nr.	Artikulli përshkrues (emërtesa)	Afati i ruajtjes	Vërejtje
1.	2	3	4
9.			
A.	Dokumente për piramidën e popullsisë në Shqipëri.	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
	Vendime, statistika, studime, raporte, relacione, për piramidën e popullsisë në Shqipëri sipas seksesve dhe moshave.	**RHK**	
B.	Të dhëna periodike apo të pjesshme të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj.	5-10 vjet	
10.			
A.	Dokumente për popullsinë dhe familjet në Shqipëri.	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
	Ligje, vendime, urdhëra, udhëzime, statistika, raporte, relacione, regjistra të gjendjes civile, evidenca për regjistrimin, numrin e popullsisë dhe të familjeve në Shqipëri.	**RHK**	
B.	Të dhëna periodike dhe të pjesshme të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj.	5-10 vjet	

11.			
A.	Dokumente për popullsinë sipas qarqeve, qyteteve dhe fshatrave.	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
	Statistika, regjistra, vendime, raporte, relacione, evidenca sipas qarqeve, rretheve, bashkive, komunave, fshatrave për numrin e popullsisë.	**RHK**	
B.	Të dhëna periodike të pjesshme të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj..	5-10 vjet	
12.			
A.	**Dokumente për lindjet, vdekjet, zgjatjen mesatare të jetës dhe shtesa natyrore e popullsisë.**	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
	Statistika, regjistrime, vendime, urdhra, udhëzime, evidenca, raporte, relacione etj.	**RHK**	
B.	*Të dhëna periodike, të pjesshme të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj.*	5-10 vjet	
13.			
A.	**Dokumente për martesat dhe zgjidhjet e martesave.**	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
	Regjistra, evidenca, studime, studime, raporte, relacione, statistika, vendime, urdhëresa, udhëzime etj.	**RHK**	
B.	*Të dhëna periodike, të pjesshme të përfshira në permbledhëse, korrespondencë e thjeshtë.*	5-10 vjet	

14.			
A.	Dokumente për dëndësinë e popullsisë në Shqipëri, ndryshimet në numrin e popullsisë, përbërja moshore, sipas gjinisë dhe moshës dhe vendbanimit qytet-fshat.	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
B.	Regjistra, statistika, evidenca, studime, raporte, relacione, udhëzime etj.	**RHK**	
	Të dhëna periodike, të pjeshsme të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj.	5-10 vjet	
15.			
A.	**Dokumente për lindjet, zgjatjen mesatare të jetës, për vdekshmërinë.**	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
	Regjistrat e lindjes dhe vdekjes, evidenca, statistika, studime, raporte, relacione, udhëzime etj.	**RHK**	
B.	*Të dhëna periodike, të pjesshme të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj.*	5-10 vjet	
16.			
A.	Dokumente për numrin mesatar të fëmijëve për një grua, numrin mesatar të fëmijëve të lindur gjallë sipas moshës së nënës, koefiçienti fëmijë-nënë, vdekshmëria infantile.	**Ruajtje Historike Kombëtare**	
B.	Regjistra, statistika, evidenca, studime, udhëzime, raporte, relacione.	**RHK**	
	Të dhëna periodike të pjesshme të përfshira në përmbledhë-se, korrespondencë e thjeshtë etj.	5-10 vjet	

L I G J

Nr. 8116, date 29. 03. 1996

KODI PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU VIII
VERTETIMI GJYQËSOR I FAKTEVE

Neni 388
Kur mund të ngrihet kërkesa

Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi.

Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e rrethit në territorin e së cilës ndodhet sendi.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 389
Përmbajtja e kërkesës

Në kërkesën për vërtetimin e fakteve duhet të tregohen:

a. qëllimi për të cilin kërkuesi paraqit kërkesën për vërtetimin e faktit të caktuar;
b. shkaqet për të cilat nuk mund të merret akti ose për të cilët nuk është mundur që akti të bëhet përsëri;
c. provat me të cilat do të provohet si shkaku, për të cilin nuk është e mundur të merret akti ose ky akt nuk mund të bëhet përsëri, ashtu edhe fakti që kërkohet të vërtetohet.

Neni 390
Procedura e gjykimit

Kërkesa për vërtetimin e fakteve gjyqësore shqyrtohet në seancë gjyqësore, në prani të kërkuesit e të personave fizikë a juridikë që kanë interes në çështje. Kur çështja paraqet interes publik dhe gjykata e sheh të arsyeshme, mund të thirret edhe prokurori.

Neni 391
Vendimi i gjykatës

Në vendimin e gjykatës duhet të tregohet fakti i vërtetuar prej asaj dhe provat në bazë të të cilave është vërtetuar fakti.

Kundër vendimit, me të cilin pranohet ose nuk pranohet kërkesa, mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme, nga kërkuesi si dhe nga personat fizikë a juridikë që janë thirrur për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes. Vendimi nuk ka fuqi provuese kundër personave fizikë a juridikë që nuk kanë qenë thirrur në rast se e kundërshtojnë faktin e vërtetuar në vendim.

Neni 392
Efektet e vendimit të gjykatës

Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuesit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme.

KREU IX
NJOHJA E VENDIMEVE TË SHTETEVE TË HUAJA

Neni 393
Kushtet për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njohen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta.

Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes.

Neni 394

Pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur,

a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;
b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për ti dhënë atij mundësi që të mbrohet;
c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;
ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë vendim të formës së prerë;
d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;
dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 395

Shqyrtimi i kërkesës

Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit.

Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit.

Në këto raste në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën.

Neni 396

Kërkesës për ti dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet ti bashkëngjiten:

a) kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;
b) vërtetim nga gjykata që e ka nxjrrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si dhe përkthimi dhe legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu dhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë të vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;
c) prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.

Neni 397

Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394.

Për kërkesën e paraqitur gjykata e apelit jep vendim.

Neni 398

Zbatimi i vendimit të një gjykate të huaj

Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës së apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij kodi.

Neni 399

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj.

LIGJI

Nr. 7895, datë 27.01.1995,

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

i ndryshuar

Neni 190

Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë hartimin e tyre dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Neni 191

Falsifikimi i akteve të gjendjes civile

Falsifikimi apo përdorimi i akteve të gjendjes civile të falsifikuara dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një here apo ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 192

Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve

Prodhimi apo mbajtja e mjeteve për të kryer falsifikim të dokumenteve përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 192/a

Zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve

Asgjësimi me çdo mënyrë i dokumenteve të arkivit ose të bibliotekës, si dhe zhdukja dhe vjedhja e dokumenteve që janë të një rëndësie të veçantë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Vjedhja e dokumenteve të arkivit ose të bibliotekës, që janë të një rëndësie të veçantë, ose eksportimi i tyre në kundërshtim me interesat e ligjit dënohen me gjobëose me burgimgjer në pesë vjet.

Neni 192/b

Hyrja e paautorizuar kompjuterike

Hyrja e paautorzuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cënimit të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo system tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.